

PËR BESIMTARËT E ALLAHUT xh.sh.

**MUXHEDIDJA AISHE:
RIPËRTËRITËSJA E FESË ISLAME
DHE POPULLI SHQIPTAR NË REGJIMIN
KOMUNIST DHE DEMOKRATIK
NË SHQIPËRI NË SHEKULLIN E XX**

*Fakte për të diturit, urtësi për të devotshmit, mësim
për të paditurit dhe kritika për të pabindurit.*

المجدد الأخير في الدنيا

SON AHÝR ZAMAN D NYA M CEDDIDI

POSLEDNJI M DŽEDID U SVETU

THE LAST RENEWAL ISLAMIC IN THE WORLD

Përgatiti: H. HAXHI YMER AGA

TIRANE

(Ribotim)

2012

Përgatiti

H.Haxhi Ymer Aga. Tiranë.

Punoi në
kompjuter:.....
Grafika:.....

Haxhi Ymer Aga
Ilir Drizari

© e drejta e ribotimit i përket vetëm autorit

PARATHËNIE

Eudhu bil-lahi minesh-shejtani rraxhim bismilahi rrahmani rrahim. Elhamdu lil-lahi rrab-bil aalemin ves-salatu ves-selamu ala resulina Muhamed.

Ky libër ju vihet në dorë njerëzve që besojnë ekzistencën e Allahut xh. sh. = Zotit të madhrueshëm dhe ahiretin=ringjalljen në botën e përtejme pas vdekjes. Këtu në këtë libër tregohet jeta dhe veprimet e muxhedides=ripërtëritëses së fesë Islame, gruas së nderume të quajtur Aishe Daudi rahmetullahi alejha.

D.m.th.mëshira e Zotit qoftë për të. Pejgamberi ynë Muhamedi a. s. ka thënë: “Inall-llahe jeb athu li hadhi fil ummeti fi kul-li mietin senetin men juxhed-didu lehu dineha”-Trans. Imam Buhariu dhe Ebu Daudi. Hadithi sahih. I cili do të thotë: “Me të vërtetë = pa dyshim Allahu xh. sh ka me i sjellë ymetit tim në çdo njëqindë vjetë një ripërtëritës të fesë”=Për ta pastruar fenë nga bidadet=shpikjet në emër të saj dhe për të jua ripërtëri besimin njerëzve. Muxhedidja Aishe ishte e urdhëruar prej Allahut xh. sh. me lajm të posaçëm për ta thirr popullin Shqiptar në tobe. Të pendohej=tu largonte nga punët,veset dhe fjalët e liga. Kushti i parë i tobes ishte që populli ta njisonte Allahun xh. sh. = Zotin e madhrueshëm në gjuhën e tij amtare e çdo gjuhë tjetër që dinte dikush prej njerëzve. Njerzit pra, ta veçonin emrin e Tij nga emrat e tyre. Mos të bënin më shirk me gojë. Mos ti bënin shok e ortak Allahut xh. sh.kur të flisnin. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se ky lajm prej Allahut xh. sh. për ti thirr njerzit në tobe = në pendesë për fajet që kan bërë, është për të gjithë njerzit në mbarë botën, ata të cilët besojnë në ekzistencën e Zotit xh. sh.= në ekzistencën e Allahut xh. sh. një i vetëm pa shok e ortak dhe besojnë ahiretin=ringjalljen=jetën tjetër pas vdekjes. Për vërejtje e sqarimet që do tu sillte Allahu xh. sh. njerëzve në vazhdim pas profetit Muhamed a. s. na tregon Kurani. Allahu xh. sh. thotë: “Pasha engjëjt=betohem për engjëjt] që...të cilët sjellin shpallje [sjellin lajme ose njoftime] si arsyetim [për sqarim =zgjidhje të një çështje] ose si vërejtje [për tu tërhequr vërejtje njerëzve=për ti kritikuar ata]. S.Mursetat. Ajetet : 3, 4, 5, 6.

Kapitulli i të dërguarve. Allahu xh. sh. me këto ajete në fillim të kësaj surje në Kuran ka paralajmruar për shpalljet ose komunikatat e ndryshme për sqarim e vërejtje që Ai do ti sillte njerëzve nëpër mjet muxhedidave në çdo 100 njiqind vjet pas profetit Muhamed a. s. për ti sqaruar e kritikuar atëher kur njerzit fillojnë të vepronin në kundërshtim me Kuranin. Ndërsa shpallje të re për besim e veprim veç atyre që janë në Kuran nuk solli më Allahu xh. sh. pas profetit Muhamed a.s. Ai solli me anë të muxhedidave vetëm lajme e njoftime për sqarime e vërejtje, atëher kur njerëzit largoheshin nga rruga e drejtë që Ai ka përcaktuar në Kuran. Atëher kur njerëzit fillonin të flisnin e vepronin në kundërshtim me Kuranin. Nëpërmjet muxhedidave që Allahu xh. sh. i dërgoi me shërbim pas Pejgamberit a.s. ju bëri vërejtje e ju dha sqarime popujve të ndryshëm që të korigojnë gabimet e tyre. Muxhedidat ishin përfaqësuesat direkt të Pejgamberit a. s.

Nga këta muxhedida ishte edhe murshidja Aishe rahmetullahi alejha që ishte e fundit në radhën e muxhedidave të cilën e dërgoi Allahu xh. sh. me shërbimin e thirrjes së popullit në tobe në Shqipëri. Ajo i thoshte popullit se kjo është vërejtja e fundit që i bën Allahu xh. sh. ymetit të Muhamedit a.s. me anën time para kijametit=shkatërrimit të botës. Vërtetë Allahu xh. sh. ka paralajmruar në Kuran për këtë vërejtje të fundit para kijametit duke thënë: “Erdhi [u frua] caktimi i Allahut [kijameti]...e pastër dhe e lartë është Madhërija e Tij në krahasim me atë që ata [njerzit] i shoqërojnë [shokë]. Me urdhërin e Tij ia zbritet engjëjt me shpallje=me komunikatë] atij [njeriu=burrë ose grua] që Ai [Allahu xh.sh.] dëshiron nga njerëzit e vet [duke i thënë] tua tërhiqni vërejtjen [njerëzvet] se nuk ka të adhuruar tjetër [nuk ka tjetër Zot vetëm Un [jam] pra të më keni frikën [të friksohi nga Unë [të bëni tobe.” S..Nahl. ajete. 1, 2. Si në shum ajete të Kuranit që flasin për gjëra të ndryshme edhe në dy ajetet e para të kësaj surje, Allahu xh. sh. ka paralajmruar indirekt për lajmin e fundit që do tu sillte njerëzve para kijametit që ata të bëjnë tobe= të pendohen = të kthehen në rrugën e drejtë që Ai ka përcaktuar në Kuran duke u friksuar nga dënimi i Tij. Kuptimi i këtyre dy ajeteve të kësaj surje është kështu : [Kur të jetë afuar shumë kijameti =në fundin e botës Allahu xh. sh. do të ja zbritë engjëjt me komunikatë = me njoftim të posaçëm atij njeriu që do [burrë ose grua] duke i thënë atij ti tërheqësh vërejtje njerëzvet mos ti bëjnë shokë Allahut xh. sh.

se nuk ka tjetër Zot veç një Zoti=veç Allahut xh .sh. dhe të frikësohen prej Tij, të largohen nga veprat e liga = të bëjnë tobe”. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e kreu këtë detyr që i ngarkoi Allahu xh. sh. në Shqipëri nga viti 1955 deri në vitin 1995 duke shkuar me shumë mundime me financën e vet në shumë qytete e fshatra të Shqipërisë. Njerëzit besimtarë e quajtën atë Aisheja e Mir. Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë. Ajo thoshte: “Un jamë balta e këpucëve të profetit Muhamed a. s. por jam e dërguar prej Allahut xh. sh. me shërbim, për ta thirrë popullin që të bëj tobe=dorëheqje nga fjalët, besimet, punët dhe veset e liga, që kështu të shpëtojnë nga azabi=dënimi i Zotit xh. sh në dy botat , në dynja dhe ahiret=në botën tjetër pas vdekjes. Kjo thirrje për rikthim në rrugën e Zotit = në rrugën e Allahut xh.sh. është për të gjithë njerëzit në botë që e besojnë Zotin =Allahun xh. sh. dhe besojnë ahiretin=botën tjetër pas vdekjes, besojnë ringjalljen e dhënjen llogari Zotit xh.sh. për veprat e tyre të këqia. Thënjet e muxhedides Aishe rahmetullahi alejha që do ti lexoni në këtë libër janë dikttime prej Allahut xh. sh. Janë vërejtje e sqarime për njerëzit të cilat e kanë bazën në Kuran. Edhe un shkruesi i librit i kam vërte-tuar fjalët e saj me Kuran e hadith se ata janë vërtet të diktuar prej Allahut xh. sh. Duke u bazuar në Kuran e hadithe vërtetohet pa dyshim se gruaja e devotshme Aishe Daudi ishte muxhedide-[ripërtëritëse e fesë] të cilën e dërgoi Allahu xh. sh. me shërbim në Shqipëri në shekullin e [njëzet] për thirrjen në tobe të ymetit të Muhamedit a. s. Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë. Këtë libër me argumente të shumta e preçize e kuptojnë mir dijetarët e fesë që janë të thelluar në dituri dhe besimtarët e sinqertë. Ndërsa injorantëve e munafikëve [dyfytirëshve] libri jua shton më shumë hipokrizinë = dyfaqësinë. Allahu xh. sh. thotë në Kuran kështu : “Ata që i bënë [ose i bëjnë] të rreme faktet tona janë shurdhmemecë të mbetur në errësi...”S. En-nam. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha, gjatë shërbimit të saj 40 vjeçar mori lajme e njoftime të shumta prej Allahut të madhëruar me inspirim=frymëzim sikur nëna e Musait a. s. nëpërmjet melekëve si nëna e Haz. Isait a. s. Merjemja r. t. a. dhe shfaqëjeve në rruja=në ëndërr pjesë filmike mes gjumit e zgjimit siç morën dhe shumë profetë si: Ibrahim, Jakubi, Jusufi e tjerë paçin selam. Këto lajme, vërejtje, sqarime e njoftime të ndryshme që mori murshidja Aishe prej Allahut xh. sh. kishin të bëjnë me imanin=besimin e njerëzve me gjëndjen fetare

sociale e politike në përgjithsi që ishte populli shqiptar në mesin e shekullit të njëzet nën rregjimin komunist. Gjithashtu muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha me njoftimet që mori prej Allahut xh. sh. tregoi për besimin e veprimet e disa njerëzve të ndryshëm në veçanti duke filluar nga besimtarët e thjeshtë, deri tekë dijetarët e fesë dhe politikanët e rrangut të lartë të shtetit Shqiptar. Nga dija që mori prej Allahut xh. sh. nëpërmjet formave të ndryshme që tham më sipër, muxhedidja Aishe sqaroi se si qëndronte e vërteta në lidhje me popullin tonë dhe fenë në Shqipëri në kohën që vendi drejtohej nga Partia e Punës me rregjim Socialist. Muxhedidja Aishe ishte kundër Fashizmit, Komunizmit dhe Demokracisë pa moral me liri të pa kufizuar dhe me nënpunës të korruptuar. Ajo ishte kundër çdo sistemi tjetër kushdo qoftë ai dhe me çfar do emri qoftë i cili nuk e mbështet moralin e popullit tek feja. Nëse bëhej fjalë për të ashtuquajturën demokraci, muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte: Demokracia e vërtetë është demokracia Islame se aty ekzistojnë me të vërtetë si duhet të drejtat e njeriut. Me të vërtetë nuk ka shtërngim në fe por nuk ka dhe liri pa fre. Që nuk ka shtërngim në fe e vërteton Kurani me ajetin "La ikrahe fid dijn"=Nuk ka shtërngim=nuk ka dhunë në fe. Kurse përsa i takon çështjes së liris pa kufi Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "A mendon njeriu se do të lihet duke mos zënë asgjë? = i lirë pa kurrfar përgjegjësi? S. Kijame. Ajeti. 36. Për klasifikimin e njerëzve në të mirë dhe të këqijë, të dobishëm e të pa dobishëm, Allahu xh. sh. në Kuranë thotë : "Më i miri=më i dobishmi ndër njerëzit është ai [njeri] që më së shumti i frikësohet Allahut [që e ka më shumë frikë Atë] ". Ndërsa për rëndësinë e diturisë Kurani thotë : "Nuk barazohen ata që dine me ato që nuk dijnë ". Për të drejtën e udhëheqëjes=për çështjen e nëpunësivet Kurani thotë: "Allahu ju urdhëron tua jepni në dorë amanetin [detytyrën] atyre që ju takon dhe kur të gjykoni ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve ". S. Nisa. Ajeti. 58. Me dijen që mori direkt prej Allahut të madhruar, muxhedidja Aishe sqaroi disa çështje fetare të kuptuara gabim ose të spjeguar jo qartë nga shumë dijetarë e studjues të fesë, sikurse janë çështja e madhe e njisimit të Allahut xh. sh. në çdo gjuhë që flasin njerëzit , çështja e dexhalit, e jexhuxh-mexhuxhëvet e tjera dhe lajmëroi për ardhjen e kijametin=për fundin e botës. Gjithashtu muxhedidja Aishe mori njoftim prej Allahut xh. sh. se në një planet tjetër sipër

tokës ka jetë e qytetrim [zhvillim] njësoj si këtu tekë ne në Tokë. Për këto e tjera gjëra të ndryshme do të flasim gjëresishtë në libër më poshtë duke i faktuar të gjitha me argumente nga Kurani. Në këtë libër ju do të lexoni shumë gjëra që kanë të bëjnë kryesisht me çështje fetare por edhe politike, për çështje që kanë të bëjnë me dijetarë të fesë, me besimtar të mire, me politikanë e njerëz të tjerë. Me lajmin që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe tregoi arsyen e ndalimit të fesë në Shqipëri që u shpall shtetet ateist=shtet pa fe. I vetmi vend në botë, populli në Shqipëri në rregjimin komunist, me ateistët në ballë dhe me nxitjen e munafikvet dhe shejtanvet prej xhindësh e njerzish i prishi xhamiat e kishat në vitin 1967. Muxhedidja Aishe foli për gjëndjen fetare, sociale e politike të popullit tonë, për disa politikanë të rrangut të lartë të shtetit shqiptar duke filluar nga kryetari i shtetit Enver Hoxha i cili komandoi me një diktaturë të fortë në Shqipëri 40 vjet rresht duke filluar nga nëntori i vitit 1944 deri në prillë të vitit 1985. Ju do të gjeni në libër një pasqyrim të qartë për disa ngjarje fetare e politike që ndodhën në Shqipëri dhe për njerëz të ndryshëm të lidhur me këto ngjarje. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha i tërhoqi vërejtje popullit për rrugën e gabuar që ai ndiqte duke vepruar në kundërshtim me ligjin e Zotit=ligjin e Allahut xh. sh. Lajmurdhëresa që Allahu xh. sh. i solli muxhedides Aishe ishte që ajo ta thërriste popullin shqiptar në Tobe=në Pendesë. Të pendohej sinqerishtë duke u larguar nga rruga e gabuar që kishte marrë e të kthehej në rrugën e drejtë me kushtet e diktuarat prej Allahut xh. sh. Me lajmin që mori prej Allahut të madhëruar, muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e paralajmëroi popullin shqiptar se nëse ai nuk do të bënte tobe me kushtet e përcaktuarat nga Allahu xh. sh. do tu përballte në këtë botë me vuajtje shumë të mëdhaja, ndërsa në botën tjetër pas vdekjes do të përballte me valët përvëluse të xhehenemit. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha mori lajmin prej Allahut xh. sh. për ardhjen e kijametit=fundit të botës. Për kohën e kijametit, Allahu xh. sh. i ka thënë profetit Muhamed a.s. në Kura: "Thuaju [njerëzvet o Muhamed] unë nuk e di a do të jetë afër ajo që ju premtohet [kijameti] meti] apo Zoti im do ta vonojë shumë atë; Vetëm Ai e di të fshehtën por këtë fshehtësi Ai nuk ia zbulon [nuk ia tregon askujt] me përjashtim të ndonjë të dërguari [të ndonjërit prej të dërguarve]..."S. Xhin. ajetet. 25, 26, 27. Pa dyshim këtu është fjala për muxhedidat që do ti dërgonte Allahu xh. sh. pas profetit Muhamed a. s. në çdo 100 vjet. Lajmurdhë-

resa që Allahu xh.sh. i dha muxhedides Aishe rahmetullahi alejha ishte që ajo ti thërriste njerzit që të bënin tobe=të pendoheshin duke u larguar nga veprat e këqija. Kjo pendesë pa kthim prapa tek këqijat quhet arabisht Tobe Nesuh = largim përgjithmonë nga besimet, punët dhe fjalët fajtoresh=fjalët e kufrit dhe fjalët ithm = fjalët e liga. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “O ju që keni besuar pendohuni tekë Allahu [tek Zoti] me një pendim të sinqertë në mynyrë që Zoti juaj ti largoi prej jush të këqijat [në këtë dynja] e t’ju çoi në xhenete...” Sure. Tahrim. Ajeti. 8. Nga ky ajet i Kuranit kuptohet se tobja=pendimi është i domosdoshëm për ata që janë besimtarë. Siç e thash më lartë, populli ia dha asaj titullin Aisheja e Mir, ndërsa prej Allahut xh. sh. thoshte ajo e kam marrë titullin Nur=dritë. Ajo ishte një dritë=një llampë ndriçuese për njerëzit e kohës së fundit të dynjasë që e kan humbur rrugën e drejtë që i tregoi njerëzimit më i dashuri i Allahut xh. sh. i dërguari i Tij, vula e pejgamberëve Muhamedi a.s. njeriu me famën më të lartë në botë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ishte murshide=prijëse ose udhërrëfyse për rrugën e drejtë e dërguar me shërbim special prej Allahut xh. sh. për ymetin e Muhamedit a.s. Vërtet atë e dërgoi Allahu xh. sh. në Shqipëri me shërbimin e thirrjes së popullit në tobe por, siç e thash më sipër, urdhëri për të bërë tobe është për të gjithë popujt; për njerzit besimtarë të cilët e besojnë pa dyshim Zotin e mdhërushëm=Allahun xh. sh. dhe botën tjetër pas vdekjes. Atë e dërgoi Allahu xh. sh. për tu tërhequr vërejtje njerëzve, duke jua vënë në dukje atyre fajet dhe gabimet. Kush dëshiron nga njerëzit të mirën e tij, të fëmijëve të tij, familjes, fisit e gjithë shoqërisë duhet të bëjë tobe=të pendohet me kushtet që lajmëroi prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Të kthehet sinqerisht në rrugën e Zotit = në rrugën e Allahut xh. sh. sa është pa ardhur kijameti=kataklizma=fundi i botës. Kurani thotë: “Allahu ia falë [gjynahin] atij që pendohet e mëshiron atë që përmirësohet”. Sure Tobe.Ajeti. 102. Ndërsa për njerëzit që nuk penndohen, Allahu xh .sh. thotë: “Ata që nuk pendohen janë mizorë [zullumqar].” Sure. Huxhurat.ajeti.11. Tobja që i komunikoi njerzvet muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha fillon nga mosha 16 vjeçazare deri në pleqërin e fundit para matufosjes. Pasi bëri tobe çifti i par i njerëzve Ademi e Havaja, i sollti Zoti xh .sh. në tokë. Dhe pas lajmit për të bër tobe do të largohen përfundimisht pasardhësit e tyre,

gjithë njerzit nga kjo botë. Allahu xh. sh.=Zoti madhrushëm është Ai që i ka sjell njerzit në këtë botë dhe një ditë do ti largojë nga kjo botë. Kush dëshiron ta kuptojë drejtë këtë libër, duhet të zhvishet nga interesat dhe paragjykimet e ndryshme dhe të bëjë tobe=të pendohet për fajet që ka bërë e të kthehet në rrugën e Zotit xh. sh. që të shpëtojë nga të këqijat në dy botët. Mirnjohja dhe falenderimet janë të posaçme për Allahun xh. sh.= Zotin e madhrushëm që është Krijuesi i Gjithësis. Udhëzimi i drejtë është udhëzimi prej Allahut xh. sh. Ai udhëzon atë që do. Esh-hedu en la ilahe il-lallah ve esh-hedu en-ne Muhameden resulullah.

2- Ç'ËSHTË MUXHEDIDI ?

Fjala muxhedid do të thotë në gjuhën shqipe ripërtëritës i fesë, që e pastron fenë nga bidaded=gjërat e shpikura. Fjala e muxhedidit është e vërtetë se ai udhëhiqet direkt me dije e lajme prej Allahut xh. sh. Për këtë gjë do të flasim gjatë më poshtë me argumenta. Vëllezër besimtar feja e pranushme tek Allahu xh. sh. është feja Islame e cila është e plotësuar dhe e pa ndryshuar deri sa të jetë bota. Këtë e vërteton Allahu xh. sh. në Kur'an i cili thotë : "Sot plotësova fenë tuaj, plotësova ndaj juve dhuntinë=mirësinë time zgjodha për ju fe Islamit. " S. Maide. Aj. 3. Ndërsa profeti Muhamed a. s. është vula e gjithë peygamberëve-lajmëtarëve të Zotit xh. sh. Këtë na e vërteton Kur'ani i cili thotë: " Ai {Muhamedi} është i dërguari i Allahut dhe vula e gjithë peygamberëve, e Allahu është i ditshëm për çdo send. " S. Ahzab. Aj. 40. Kurani është kushtetuta e Allahut xh. sh. dhe është një libër i përhershëm dhe i përshtatshëm për çdo koh dhe vendë për të gjithë njerëzit deri sa të jetojnë në këtë botë. Por me qenë se njerëzit mund të dështojnë për të qëndruar në rrugën e drejtë, mund të largohen nga e vërteta e mund të zhyten në injorancë ose mund të bien në materializëm dhe nuk iu mbetet më aftësia e duhur për të marrë dritë prej kushtetutës së plotë të udhëhqëjes njerëzore, Kuranit të madhrushëm, për këto arsye Allahu xh. sh. nga mëshira e vet e ka paracaktuar që pas profetit Muhamed a. s. me ardhjen e të cilit u plotësua feja, të dërgojë ringja=llësa të fesë që në gjuhën arabe quhen muxhedida. Për ardhjen e

këtyre njerëzve siç e thash në parathënjen e librit, ka paralajmëruar Pejgamberi ynë hazreti Muhamedi a. s. i cili siç e thashë më sipër ka thënë kështu: "Inall-llahe jeb athu li hadhi fil ummeti fi kul-li mietin senetin men juxhed-didu lehu dineha"- d. m. th. "Me të vërtetë Allahu xh. sh ka me i sjellë ymetit tim në çdo njëqindë vjet një ripërtëritës të fesë [që e pastron fenë nga bidadet [shpikjet] në emër të saj që hynë në çdo shekull e për të jua ripërtëri besimin njerëzvet]". Transmeton. Buhariu dhe Ebu Daudi. Hadithi sahih. Fjala muxhedid siç e thash më sipër është arabisht dhe në gjuhën shqipe do të thotë ripërtëritës i fesë ose ringjallës i saj. Shpallje të re veç Kur'anit nuk ka më. Allahu xh. sh. nuk ka sjellë më ligje e urdhëresa tjera për njerzit pas profetit Muhamed a. s. Ndërsa njoftime, vërejtje, sqarime dhe sihariqe=lajme të mira [mubesherat] Allahu xh. sh. solli në tokë me anë të njerëzve të Tij të dashur edhe pas profetit Muhamed a. s. Allahu xh. sh. ka thënë në Kuran kështu: " Ne të dërguarit nuk i dërgojmë ndryshe vetëm si përgëzues e qortus [kritikus]. "S. En-nam Aj. 48. Kështu që Kurani i hedh poshtë fjalët e atyre njerëzve të cilët thonë se Allahu xh. sh. nuk ju sjell më njerzvet pas Pejgamberit a.s. lajme për sqarime e vërejtje ose sihariqe=lajme të mira [mubesherat]. Shum dijetarë e studius të fesë i kanë kuptuar ose komentuar gabim disa hadithe [fjalë] të Pejgamberit a. s. Ja një shembull: Pejgamberi a. s. ka thënë: "Nuk ka më shpallje të re pas meje ". Që do të thotë nuk ka më ligje feje të reja veç atyre që ka sjellë Allahu xh. sh. në Kuran. Ai nuk ka thënë se nuk ka për të sjellë më Allahu xh. sh. lajme për sqarime e vërejtje për njerzit pas meje. Allahu xh.sh. ka paralajmëruar se du tu sillte njerëzvet lajme për vërejtje e sqarime edhe pas Pejgamberit a. s. Këtë gjë e vërteton Kurani në fillim të sures Murselat [Kapitulli i të dërguarve]. Ajetet 3, 4, 5, 6. Allahu xh. sh. ka thënë: "Beto hem ...dhe për ata [engjëj] që sjellin shpallje si arsytim [për sqarim] e si vërejtje [për vërejtje] ". Por disa ajete të Kuranit e hadithe të Pejgamberit a. s. janë kuptuar gabim nga disa dijetar të fesë. Por sa her që besimtarët i ngatërroi shejtani i mallkuar dhe miqtë e tij qafirat e munafikët dhe njerëzit dolën nga rruga që ju përcaktoi Allahu xh. sh. në Kur'an, Ai ju dërgoi njerëzvet në çdo njëqindë vjet, një muxhedidë në ato vende ku Ai deshi. Muxhedidat ishin më lartë në grada se dijetarët e fesë si nga diturija ashtu dhe nga shkalla shpirtërore. Muxhedidat nuk gabonin në fjalët që ju thoshin popujve të tyre se udhëhiqeshin me njoftim direktë prej Allahut xh. sh. me inspirim ose me anë të

engjëjve [meleket] për atë çështje që ishin urdhëruar ta sqaronin popullin . Kurani madhrushëm është i mbushur me shumë pjesë letrare të shkëlqyera, me metafora bindëse e alegori të bukura. Për ti kuptuar qartë këto duhet një shpirtë i pastër me hikmet=urtësi=dije të thellë prej Allahut xh. sh. Duhet një mendje e shëndoshë me një gjykim të mprehët të cilën ia jep Allahu xh. sh. atij njeriu që do. Allahu xh. sh. në Kuran thotë : “Këta janë shembuj që Ne jua sjellim sjellim njerëzve por këta nuk i kupton kush përveç dijetarëve ”.

S. Ankebutë=Kapitulli Merimanga. Ajeti. 41.

Kurani të shumtat ajete i ka që kuptohen qartë nga të gjithë njerëzit e ndërsa disa ajete nuk mundet ti kuptojnë qartë gjithë njerëzit pasi kan shumë kuptime. Kështu që shumë dijetar të fesë kan dhënë mendime të ndryshme për të tillë ajetesh me shumë domethënje. Por dijetarët që e kishin shumë frikë Allahun xh. sh. pas komentimit të këtyre ajeteve, në fund kan thënë fjalën : “Allahu xh. sh. e di më mir të vërtetën ”. Vëllezër besimtar punët, veprimet e mrrekullitë e Allahut xh. sh. janë dy llojesh. Një pjesë janë të kuptueshme kollaj dhe një pjesë tjetër janë të vështira për tu kuptuar tamam si duhet. Arsyja njerzore mund të gabohet se nuk është në gjendje që ta kuptoi të vërtetën e domethënjen e këtyre punëve ose veprimeve. Kështu që njerëzit për këto gjëra formuan e dhanë mendime të ndryshme e shumë her dhe të gabuara. Ndërsa njerëzit e zgjedhur prej Allahut xh. sh. [muxhedidat] nuk gabuan në ato çështje për të cilën ju folën njerëzvet. Muxhedidat ishin të dërguar me shërbim prej Allahut xh. sh. për ti kritikuar e sqaruar popujt e ndryshëm e për ta pastruar fenë nga bidadet=shpikjet e këqia. Ata ishin në përgjithësi burra por Allahu xh. sh. nuk i ka përjashtuar dhe gratë. Allahu xh. sh. e ka paralajmëruar Pejgamberin a. s. indirektë në Kuran për dërgimin e muxhedidit grua. Allahu xh. sh. i ka thënë atij kështu: “Ne nuk dërguam para teje [o Muhamed] vetëm se burra nga banorët e qyteteve të cilët i paisëm me shpallje [me komunikatë]”. S. Jusuf. aj. 109. Ky ajet Kurani të lë të kuptosh që Allahu xh. sh. i ka thënë Pejgamberit a. s. se pas teje Unë bëj si dua vetë. Po desha dërgoj me shërbim të posaçëm edhe gra. Kuptohet pra se Allahu xh. sh. ka paralajmëruar në Kuran se pas Pejgamberit a. s. do të dërgonte njerëz me shërbim, ripërtëritësa të fesë për ti qortuar njerëzit që dalin nga rruga e drejtë që Ai ka përcaktuar në Kuran.

Ashtu sikurse me shiun që Allahu xh. sh. i jep gjallëri [gjelbërim] tokës së thatë ashtu dhe me anë të muxhedidave Allahu xh. sh. i dha shkëlqim mendjeve dhe imanit=besimit të njerëzve me dije e argumenta të qarta për ta zbuluar të vërtetën e të drejtën që shejtani i mallkuar dhe miqtë e tij qafirat dhe munafikët e fshehnin ose e shtrembërojshin atë her pas here. Ata mundohe gjithmonë që ti nxjerrin besimtarët nga rruga e drejtë, ti largojnë ata nga e vërteta që thotë Kurani i madhërushëm. Prandaj për ta dalluar të vërtetën nga e pa vërteta Allahu xh. sh. solli në çdo shekull një muxhedid. Në shekullin e njëzet Allahu xh. sh. dërgoi me shërbim në Shqipëri murshiden e quajtur Aishe Daudi rahmetullahi alejha që ishte e bija e Isait dhe Fatimes. Allahu xh sh. e mëshiroftë atë.

Për ardhjen e muxhedidave=ripërtëritësave të fesë me shërbim të caktuar nga Allahu i madhëruar, Kur'ani famëlart na ka paralajmëruar dhe me disa ajete tjera. Kurani thotë: "Allahu zgjedh të dërguar prej engjëjve dhe prej njerëzve. . ". S. Haxh. aj. 75. Gjithashtu Kurani thotë: "Allahu nuk është [i till] që ti lë besimtarët ashtu siç janë pa dalluar të keqin nga i miri. Allahu nuk jua zbulon juve të fshehtat por Allahu është Ai që nga të dërguarit e vet zgjedh atë që do [e ia zbulon ndonjë gjë të fshehtë=ndonjë gjë që njerëzit nuk e dijn.] Prandaj besoni Allahut dhe të dërguarit e Tij. " Pra sikurse e shikoni Allahu xh. sh, thotë: "Nuk i len besimtarët ashtu siç janë." dhe nuk thotë nuk i la besimtarët ashtu siç ishin duke treguar vetëm për kohën që ishte Pejgamberi a. s. por tregon gjithnjë për kohën që do të vinte në vazhdim. Kuptohet qartë që Allahu xh. sh. ka paralajmëruar me këtë ajet për kohën pas profetit Muhamed a. s. se Ai thotë: "Ne patjetër do ti ndihmojmë të dërguarit tanë në jetën e kësajë bote edhe ata që besuan [që ju besuan atyre]. "S. Gafir. aj. 51. Sikur e lexoni, në Kuran, Allahu xh. sh. i tregoi Pejgamberit a. s. për kohën e ardhme pas tij duke i thënë se do ti ndihmoj të dërguarit e mi në jetën e kësajë bote. Kështu pra ka qënë e paralajmëruar në Kuranë prej Allahut xh. sh. dhe me hadithë nga Pejgamberi a. s. ardhja e muxhedidave [ripërtëritësve] të fesë të dërguar prej Allahut xh. sh. me lajme për vërejtje e sqarime, njoftime të marra prej Tij në mënyra të ndryshme që ju o besimtar do ti lexoni më poshtë. Ndërsa për ardhjen e muxhedidit të fundit për thirrjen e fundit për Tobe = Pendesë në fundin e dynjasë para se të bëhet kijameti këtë

gjë sikurse e thash më sipër në parathënjen e librit, na e bën të qartë Kurani famëlartë me këto ajete ; " Erdhi [u afrua] caktimi i Allahut [kijameti] pra mos kërkoni ngutjen e tijë [ardhjen e para-kohëshme duke bër punë të liga]; E pastër dhe e lartë është madhëria e Tij në krahasim me atë që ata [njerëzit] i shoqërojnë [ortakë] Me urdhërin e Tij [Allahu] ia zbret engjëjt me shpallje, atij që Ai dëshiron nga njerëzit e vet [burrë ose grua] duke i thënë] tua tërhiqeni vërejtjen [ti njoftoni njerëzit] se nuk ka të adhuruar=Zot tjetër vetëm Unë, të më keni frikën. "[të frikësohi nga Un thotë Zoti xh. sh. të largohi nga të këqijat = të bëni tobe]." Sure Nahl. Ajeti 1 dhe 2. Këto ajete Kur'ani në krye të kësaj surje=kapitulli siç e thash më lart, paralajmërojnë dhe vërtetojnë pa as pak dyshim lajmurdhëresën që Allahu i madhërshëm i dha muxhedides Aishe që njerëzit = ymeti i Muhamedit a. s. ta njisojnë Allahun xh. sh. në çdo gjuhë që flasin dhe të frikësohen nga Ai duke bërë tobe duke u larguar nga veprimet dhe fjalët e liga.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ju thoshte njerëzvet se lajmurdhëresa për të bërë tobe istigfarë është vërejtja e fundit që ju bën Allahu xh. sh. njerëzve nga mëshira e vet në kohën e fundit para kijametit që ata të kthehen në rrugën e drejtë. Kjo thirrje për Tobe Nesuh=pendim të sinqertë është e vlefshme dhe e domosdoshme për të gjithë njerëzit kudo në botë që e besojnë Zotin xh. sh. dhe ahiretin [jetën tjetër pas vdekjes].

Pa dyshim është e vërtetë prej Zotit=prej Allahut xh. sh. fjala e murshides Aishe e cila thoshte : "Kjo është thirrja e fundit që ju bën Allahu xh. sh. njerëzve me anën time që ata të pendohen sinqerisht për punët e këqija që kan bërë e të kthehen në rrugën e drejtë që ndoqi profeti Muhamed a. s. ". Përsa i takon sqarimeve e vërejtjeve që do tu bënte Allahu xh. sh. njerëzve pas Pejgamberit a. s. , Ai na ka paralejmëruar në Kuran. Allahu xh. sh. ka thotë: "Betohem për erërat që fryjnë njëpasnjëshëm, që janë shumë e të stuhishme e shkaktojnë furtunë. Betohem për engjëjt që ju është besuar shpërndarja e reve dhe i shpërndajnë dhe që ndajnë qartë {çdo gjë } dhe ata {engjëj} që sjellin shpallje=komunikatë=lajme ose njoftime si arsyetim ose si vërejtje". Sure Murselat=Kapitulli i të dërguarëve. Ajetet: 1, 2, 3, 4, 5, 6. Këto ajete Kurani në fillim të kësaj surje siç i shihni tregojn qart për lajme e njoftime të veçanta speciale pas profetit Muhamed a. s se

ajetet flasin për kohën e ardhëshme pas Pejgamberit a. s. Sikurse i lexoni në Kuranë thuhet; ia zbret, zgjedh, dërgon e sjellë për kohën që do të vinte pas Pejgamberit a. s. Këto lajme e njoftime që u solli Allahu xh. sh. popujve të ndryshëm pas profetit Muhamed a. s. nëpërmjet njerëzve të Tij të zgjedhur muxhedidave=ripërtëritësve të fesë, nuk lëvizin as një fije floku nga Kur’ani i madhërshëm. Muxhedidat nuk sollën shpallje të re e sheriat=ligjë feje tjetër por i dërgoi Allahu xh. sh. për ti kritikuar njerzit e për ti sqaruar se cila ishte e vërteta që thotë Kurani, kur të vërtetën e fshihnin ose shtrembëronin munafikët që fshiheshin nën petkun e fesë . Pastaj dijetarët e sinqertë të fesë Islame i kuptonin gabimet për çështjet që shtroheshin në atë shekull nga muxhedidi se ata vet nuk mundë ta kuptonin me mendjen e tyre të vërtetën që thuhej në Kuran indirekt për atë çështje se ishte e koklavitur. Ndërsa muxhedidad i kuptonin drejtë e qartë çështjet se ata udhëhiqeshin me njoftim direkt prej Allahut xh. sh. me mynirat e ndryshme që tregon Kurani të cilat do ti tregojmë më poshtë. Muxhedidad ishin më të ditur se dijetarët në çështjet e fesë. Ata zëvendësonin direktë Pejgamberin a. s. Ata ishin evlijauallah=miqtë e Allahut xh. sh.

Për evlijat, per këta njerëz me hidajet=me udhëzim dhe dije të veçantë prej Allahut xh. sh. na tregon Kurani i cili thotë: “Pejgamberët dhe evlijatë si trashëgimtarë të pejgamberëve e vetëm këto i ka udhëzuar drejtë [plotësishtë] Allahu xh.sh. Gjithashtu Kurani thotë : “Këta ishin [njerzit] që i Allahu i gradoi nga pejgamberët dhe prej atyre, = [që nuk ishin pejgamberë por ishin evlija] të cilët i udhëzua e i bëmë të zgjedhur [i zgjodhi Allahu për shërbime të ndryshme]. ”S. Merjem. aj. 58. Gruaja e famshme Merjeme r. t. a. ishte njëra nga gratë në kohën para profetit Muhamed a. s. që ishte e udhëzuara direktë prej Allahut xh. sh. me inpririm=me vahj dhe me anë të engjëjve për të cilën tregon Kurani. Siç e thash më lartë, këta njerëz të zgjedhur Allahu xh. sh. i dërgoi me mesazhe e njoftime të qarta për ti sqaruar besimtarëve disa çështje të ndryshme e për ti qortuar njerzit= për tu tërhequr vërejtje atyre kur ata lenin të vërtetën dhe ndiqnin të kotën. Me anë të këtyre njerëzve të zgjedhur, Allahu xh. sh. në çdo shekull pas Pejgamberit e pastroi fenë nga bidadet [gjërat e shpikura nga njerëzit] duke ju treguar besimtarve të sinqert se cila ishte e vërteta që thuhet në Kuranin

famëlartë e cila ishte errësuar duke u mbuluar e përzier me mite e besytne të ndryshme prej munafikëve e të paditurve. Ndërsa ligje të reja veç atyre që janë në Kuran nuk solli e nuk sjell më Allahu xh. sh. për njerzit. Këtë gjë na e tregon Kurani i cili thotë: "Në fjalët e Allahut nuk ka ndryshim". Për lajm urdhëresat që do të sillte Allahu xh. sh. në botë pas profetit Muhamed a. s. nëpërmjet muxhedidave ka paralajmëru profeti Muhamed a. s. me këtë hadithë duke thënë kështu : "Kur Allahu do që të zbulojë një urdhër Ai flet me anë të zbulesës. Ai flet si të doi {është fjala me çdo lloj mynyre, me frymzim, pas perdes ose ti dërgoi melekun ati që do}, me kë të dojë [[burrë ose grua] dhe kur të dojë [në çdo kohë] dhe fjalën e Tij e dëgjon vetëm ai njeri që do Ai [që do Allahu xh. sh.]". Hadithi Sahij. Shiheni këtë hadith në librin : "Aalamu sun-netil menshureti li iëtikadi taifeti=Argumentet e synetit për akiden e grupit të shpëtuar e të ndihmuar. "Trans Ibni Kethiri. Dijetarët e ndryshëm Islam ndër ata edhe i dëgjuari Selman Aud ish myfti në Arabinë Saudite kan thënë kështu: Muxhedidat = ripërtëritësat e fesë mund të jenë prej burrash dhe prej grashë dhe nuk është kusht që muxhedidi të jetë arab ose të dijë gjuhën Arabe dhe të ketë dalë nga bangat e shkollës=me diplomë por vetëm të jetë besimtarë ose besimtare i njohur në popull si njeri me virtyte=veti të larta morale dhe me drejtësi si për miqtë dhe për armiqtë e tij. " Vellezër besimtar: Këto njerëz të tillë që erdhën me shërbime të ndryshme pas profetit Muhamed a. s. ishin vetëm nga besimtarët e devotshëm e të zgjedhur të fesë Islame. Këta ishin euvlijaullah=miqtë ose të dashurit e Allahut xh. sh. Muslimanët e par për cilësinë e fjalës së Allahut xh. sh kan thënë se : Allahu xh. sh. e ka pasur dhe do ta ketë cilësinë e fjalës. Kur'ani thotë: "Sikur deti të ishte bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, ai do të mbarohej para se të mbarohen fjalët e Zotit tim edhe sikur ti shtojm një detë tjetër për ti ardhur në ndimë {për shtesë}. Gjithashtu Kur'ani thotë: "Allahu çdo ditë është i zënë me çështje të reja. "Sure. Rrahman. Kapitulli Mëshirusi.

3- MYNYRAT QË ALLAHU XH. SH. I INFORMOI NJERËZIT E TIJ TË DASHUR

Në Kur'anë Allahu xh. sh tregon se i ka folur njerëzëve me tre lloj mënyrash. Ai thotë: "Nuk ka as një njeri që ti ketë folur Allahu ndryshe vetëm se me anë të frymzimit, pas perdes=prapa ndonjë pengese ose ti dërgojë të dërguar [melek=engjëll] e ai ti shpalli me lejen e Tij atë që do Ai {Allahu xh. sh. }. Sure Shura ajeti 51. Folja pas perdes është një nga mynyrat e foljes që Allahu xh. sh. i foli direkt njerëzve të tij të dashur. Ai të folur nuk është si të folurit kur njerzit i flasin njëri tjetrit. As dëgjimi nuk është i tillë. Pejgamberi jonë a. s. e të tjerë njerëz të zgjedhur që deshi Allahu xh. sh. e dëgjuan Allahun xh. sh. me të gjithë qënjen e vet sikur i gjithë trupi ishte kthyer në një vesh dëgjimi. Kështu që zëri vjen nga të gjithë anët. Ai të folur është i jashtzakonshëm. Ai është ndryshe, është jashtë rrethit dhe rregullit me të cilin njeriu është mësuar të dëgjoj të të folur. Prandaj kësaj folje kështu i thuhet folje pas perdes. Kështu si shumë të tjerëve prej njerëzve të vet të dashur prej burrave dhe grave i foli Allahu xh. sh. edhe murshides Aishe rahmetullahi alejha, muxhedides së fundit në dynja. Për mynyrën e foljes pas perdes shihni në Kuran përkthyer në gjuhën shqipe prej Hafiz Sherif Ahmetit në kapitullin: "Vështrim rreth Kuranit, me nën kapitujt ' "Vahji dhe mynyra e pranimit=e dëgjimit të tij dhe mynyra tjetër e frymëzimit ose ndryshe inspirimit dhe syneti i Pejgamberit a. s. " Ndërsa për ardhjen e melekve me shërbim Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ne nuk i dërgojmë ndryshe engjëjt vetëm se kur duhet {kur është e nevojshme}. Sure Hixhër ajeti 8.

Nga këto ajete Kurani dhe Hadithe=fjalë të Pejgamberit a. s. që tham më sipër kuptohet qartë se dera e diktimit të fjalëve të Allahut xh. sh. drejtë për së drejti me njerëzit e Tij të zgjedhur, nuk u mbyll edhe pas profetit Muhamed a. s. Kanë kaluar rreth dyqindë e pesëdhjetë vjet që shumica e muslimanëve e mohojnë vahin=frymëzimin ose inspirimin nga Allahu xh. sh. Ndërsa më përpara njerëzit e ditur dhe besimtarët e sinqertë e dinin dhe besonin që Allahu xh. sh flet me njerëzit e vet të zgjedhur me mynyrat e ndryshme që treguam më sipër. Ata e vërtetonin këtë gjë duke u bazuar në

Kur'anë dhe në hadithë dhe gjithashtu ishin në gjëndje ta dallonin të vërtetën nga gënjeshtra duke pas për bazë Kuranin famë lartë.

Mirpo më vonë disa dijetar të ndryshëm që u morën me studime për fenë Islame këtë të vërtetë që Allahu xh. sh. flet me njerëzit e tij të zgjedhur e hodhën poshtë pa drejtësishtë për arsye të ndryshme dhe e quajtën edhe kufër=mosbesim. Estagfirullah, estagfirullah. Për lajmet e fshehta që ju solli Allahu xh. sh. njerëzve të Tij të dashur kemi argumente nga Kur'ani dhe hadithi. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Këto janë nga lajmet e fshehta që po ti shpallim ty [o Muhamed...]" Sure. Ali Imran ajeti. 44. Pejgamberi Muhamedi a. s. ka thënë: "Mua më janë shpallur [në forma të ndryshme] për gjëra të ndryshme edhe një herë e gjysëm se ata që janë në Kuran. Trans. Buhariu. Shihni librin Udha Muhamedane e Imamit të njohur Muhammed Bergeviut. Ndërsa një pjesë gjërash që ka dashur Allahu xh. sh. ia ka hequr nga kujtesa Pejgamberit a. s. Kjo gjë tregohet në Kuran. Allahu xh.sh. i thotë Pejgamberit a.s. kështu: "Ne do ta lexojmë ty [Kuranin] e nuk do të harrosh. Përveç asaj që Allahu dëshiron [që ti ta harrosh]". S. A'ëla. ajetet 6, 7. D.m.th. "Ne do ta ruajmë ty në kujtesë atë që të shpallet përveç asaj që duam Ne që ti ta harrosh". Ta dini o besimtar se Allahu xh. sh. nuk e ndërpreu komunikimin me njerëzit e Tij të dashur edhe pas profetit Muhamed a. s.

Ashtu sikurse xhindët dhe shejtanët i frymëzojnë miqtë e tyre fallxhorët e magjistarët edhe Allahu xh. sh. i inspiron = i frymëzon miqtë e Tij = të dashurit e Tij = evlijatë. Në Kuran përmenden të dy palët=Evlijauallah=miqtë e Allahut xh. sh. dhe evlijaushejtan= miqtë e shejtanit lanetullah. Ato që janë besimtarë mos të nguten për ta mohuar këtë të vërtetë se mohimi i të vërtetës ju çon në kufër. Mos pranimi i inspirimit=frymëzimit nga Allahu xh. sh. njerëzit e Tij të zgjedhur ju intereson atyre që nuk janë besimtar se ata duan që ymeti Muhamedit=besimtarët e tij mos të kenë prijësa të ditur në fe, që nuk gabojnë në atë që ju thonë njerëzve pasi ata udhëhiqen me dije të saktë drejtë për së drejti nga Allahu xh. sh. me mënyrat e ndryshme që tregohen në Kur'anë. Për prijësat e pagabueshëm flet Kur'ani ku Allahu xh. sh. thotë: "Për ju krijuam prijësa që me urdhrin tonë udhëzojnë [ju tregojnë rrugën e drejtë njerëzve.]" Sure Sexhde ajeti 24. Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë; "Sikur të kishim dashur Ne, do të kishim dërguar pejgamber [lajmtarë] në çdo vendëbanim. [në çdo fshat e qytet] ". S. Furkan=kapitulli dallimi

ajeti. 51. Muxhedidat këto njerëz të zgjedhur që i çoi Zoti xh. sh. me shërbim të caktuar pas Pejgamberit a. s. në vënde të ndryshme të botës, nuk folën asnjë fjalë jashtë Kur'anit. Këta ishin vazhdues shpalljes së fundit që i erdhi Pejgamberit tonë Muhamedit a. s. Duhet ta dijë çdo njeri se Kur'ani është libri i fundit, kushtetutë për njerzit që e ka zbritur Allahu xh. sh. në tokë dhe nuk ndryshon= nuk shfuqizohet deri ditën e kijametit. Por Allahu xh. sh. edhe para dhe pas profetit Muhamed a. s. iu ka dhënë dije i ka njoftuar njerzit e Tij të zgjedhur edhe se ata nuk kan qënë pejgamberë. Po përmendim këtu Talutin. Allahu xh. sh. në Kuran për Talutin thotë; "Kur u largua Taluti prej qytetit bashkë me ushtrinë, ju dha atyre mësimet e duhura dhe ju tha; "Zoti do të ju provojë juve me një lumë, kushdo që do të pij ujë prej atij [lumi] nuk është prej ushtrisë time; [ai njeri nuk është me mua]..."S. Bekare. Kuptohet nga ajeti i Kuranit se Talutin e lajmëroi Allahu xh. sh. që ti vë në sprovë ushtrinë dhe ai ju tregojë atyre se kjo sprovë ishte e caktuar nga Allahu xh. sh. Mirpo Talutin nuk e kishte dërguar Allahu xh. sh, pejgamber por e zgjodhi prinjës=udhëheqës, për ta shpëtuar atë popull nga e keqëja që e kishte pllakosur e për ti dhënë lumturinë. Po kështu sikurse burrave Allahu xh. sh. i ka njoftuar duke ju dhënë ilham=inspirim-frymëzim ose iu ka dërguar melaike=engjëj edhe grave. Kjo gjë vërtetohet në disa ajete të Kur'anit. Për shembull në suren Taha ajeti 38 Allahu xh. sh. tregon që i ka thënë Musait a. s. kështu: "Atëhere kur nënën tënde e frymëzuam me atë që nuk kuptohet ndryshe veçse me inspirim {me frymëzim-shpallje}. Ndërsa në suren Kasas ajeti 7 thotë: "Ne nënën e Musait e inspiruam..."Këta ajete tregojnë se Allahu madhrushëm ju foli me inspirim edhe grave që ishin të zgjedhura nga Ai. Gjithashu Allahu xh. sh. ju ka dërguar grave të zgjedhura edhe melek=engjëj për tu folur atyre. Ja çfar thotë Allahu xh. sh. në Kuran për nënën e Isait a. s. : ". . Ne ja dërguam asaj {Merjemes}Xhibrilin e ai iu paraqit asaj njeri në tërsi{krejtësisht} Sure Merjem aje. 17. Kurse në Suren Ali Imran Ajeti 45 Allahu xh.sh. sh, thotë : "Përkujto kurë engjëjt i thanë o Merjeme Allahu të përgëzozon me fjalën e vet: "Disa grave kur ka dashur Allahu xh. sh. ju kanë folur engjëjt dhe më par në disa raste tjera, dhe këto gra i kanë pa me sy engjëjt. Këtë gjë e vërteton Kur'ani. Ne Suren Hud A. 69, 70, 71 Allahu xh. sh, thotë: "Edhe Ibrahimit i patën ardhur të dërguarit [engjëjt] tanë me myzhde [lajm gazmor] dhe i thanë : Selam. Ai

iu përgjigj; Gjithnjë paçi selam, dhe nuk vonoi të ju sjellë një viç të pjekur. Kur pa se duart e tyre nuk shtrihen kah ai {mishi pjekur} ju dukën{ata} të pa zakonshëm...E gruaja e tij {e Ibrahimit Sarja} rrinte në këmbë dhe qeshi, e ne [thotë Allahu] e përgëzuan atë=e lajmëruam atë me Is-hakun [për lindjen e Is-hakut] e pas Is-hakut Jakubin. Ajo tha; E mjera unë, si do të lindë unë [fëmijë] kur jam e vjetruar... Ata [engjëjt] i thanë; Si, Po çuditësh ti me caktimin e Zotit? "Po kështu tregohet edhe kur engjëjt erdhën te gruaja e Zekirjait, nëna e Jahjait a. s. Ndërsa për nënën e Ismailit a. s ka treguar Pejgamberi a. s kështu: Nëna e Ismailit dëgjojë një zë e pastaj pa një melek=engjëll duke gërmuar aty ku sot është uji i Zem-zemit. Kur doli uji ajo piu dhe kur u ngopë i dha djalit gj. Atëherë engjëlli i tha : Mos ki frikë se nuk do të jeni të humbur. Në këtë vend do të jetë tempulli i shenjtë i Allahut {Qabja} të cilën do ta ndërtojë ky djalë dhe babai i tij. Allahu nuk lejon të humbasin ndjeksit e Tij [ata që ndjekin rrugën e Tij]. "Trans. Ibni Kethiri. Kështu pra Allahu xh. sh. na ka treguar në Kuran se engjëjt e Tij duke përfshirë dhe Xhibrilin ju kan folur edhe grave sikurse kan folur me burrat. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ne nuk i dërgojmë engjëjt veç se kur duhet." Engjëjt vinë vetëm me urdhër të Zotit xh. sh. Në Kur'an tregohet për melaiket=për engjëjt që ata than: "Ne [engjëjt tha Xhibrili] nuk zbresim vetëm se me urdhrin e Zotit tënd.Vetëm Atij i takon gjithë çështja e tashme, e ardhme dhe mes tyre, e Zoti yt nuk është [i tillë] që harron". S. Merjem. aj. 64. Ja një shembull tjetër ku Allahu xh. sh. iu ka dhënë frymëzim edhe burrave që nuk kanë qenë pejgamberë: "Dhe kur i frymëzova havariunët të më besoni Mua [ju tha Allahu xh. sh.] dhe të dërguarin tim: "S. Maide. A. 112. Në librin e Ibni Kethirit në kapitullin Muxhizatun Nebij=Mrrekullitë e Pejgamberit a. s. është thënë se do të ketë njerëz të frymëzuar=me inspirim edhe pas Pejgamberit a. s. Këtë thënje shiheni dhe në librin Dritë e pashuar, botuar në gjuhën shqipe, përkëthyer nga turqishtja. Pra vërtetohet me fakte Kurani e hadithi se Allahu xh. sh. ju ka folur njerëzve të tij të dashur prej burrash dhe prej grash para dhe pas profetit Muhamed a. s. Kur'ani thotë : "Allahu zgjedh të dërguar prej engjëjve dhe prej njerëzvet. Allahu dëgjon dhe Shikon." = [Pra ai dëgjon se çfar thonë njerëzit dhe shikon se çfar bëjnë ata] ". Sure Haxh Ajeti 75. Por njerëzit shumë herë i ngatërroi dhe po i ngatërroi djalli i mallkuar se ata i kundërshtuan ato njerëz prinjësa që i zgjo-

dhi Zoti xh. sh. për ata dhe pranuan ato prijësa që i zgjodhën vet ata ose ua zgjodhën qafirat dhe munafikët atyre për drejtusa=për kryetarë. Muxhedidët që erdhën pas profetit Muhamed prej burrash e grashë me lajme të qarta të freskëta prej Allahut xh. sh. tekë popujt e ndryshëm, i kanë njoftuar, sqaruar e kritikuar njerëzit, me njoftimet që ju ka dhënë Allahu xh. sh. me mynyrat e ndryshme që tregohen në Kuranë atëher kur njerzit kanë besuar e vepruar jashtë Kur'anit e synetit të Pejgamberit a. s. Këto nuk kanë sjellë ligje të tjera se Kur'ani dhe feja Islame që zgjodhi Allahu xh. sh. për njerzit është plotësuar. Siç e thashë më sipër Allahu xh. sh. thotë në Kur'anë: "Sot përsosa për ju fenë tuaj ...Zgjodha për ju Islamin fe ...S Maide A. 3.

Për sa i takon profetësisë së grave një pjesë e dijetarëve kanë thënë se kanë qenë me gradën e pejgamberëve pasi atyre ju ka folur Allahu xh. sh. pamvarsishtë se ata nuk ishin të urdhëruara direkt me këtë shërbim. Kjo gjë tregohet në suren që mban titullin Merjem dhe flet për këtë grua. Allahu xh. sh. thotë: " Këto ishin [njerëz] që Allahu i gradoi nga Pejgamberët...dhe prej atyre [që nuk ishin pejgamberë] të cilët i udhëzuam dhe i bëmë të zgjedhur...]. S. Merjem. aj. 58. Gratë që kanë qenë me gradën e pejgamberisë para profetit Muhamed a. s. thonë dijetarët Islam janë: Hava nëna e parë e njerëzimit, Nëna haz. Musait a. s. nëna e hazreti. Isait a. s. Merjemja r. t. a. nëna e haz. Ismailit a. s. Haxhireja rahmetullahi alejha e ndonjë tjetër si këto që nuk janë përmendur me emra ne Kur'anë dhe në hadithe. Të këtijë mendimi janë dijetarët e njohur Islam; Ibni Hazmi, Ebu Hasan Eshariu, Imam Kurtubiu e tjerë. Nga grat e burrat e devotshëm murshida e murshide të ngarkuar prej Allahut xh. sh. me shërbim pas profetit Muhamed a. s. mendohet se mund të kenë qenë ndër shumë të tjerë nga gratë edhe e famshmja Adivije rahmetullahi alejha të cilës Allahu xh. sh. i dha shumë dituri e keramete. Ndërsa nga burrat ndër të tjerë edhe Muhidin Arebiu dhe ka mendime të shumta nga dijetarët Islam të kohëve të fundit dhe për Said Nursiun në Turqi i cili u quajt me të drejtë Bediu Zeman-mrekullia e kohës. Allahu xh. sh. i di të gjithë se kushë ishin muxhedidat që i dërgoi njëri pasë tjetrit me shërbime të ndryshme pasë profetit Muhamed a. s. në çdo 100 vjetë. Ndërsa në Shqipëri siç e thash më sipër ne mesin e shekullit të xx = njëzetë Allahu xh. sh. dërgoi si muxhedide me lajmin e fundit për tobe gruan me morale

të larta Islame e quajtur Aishe Daudi rahmetullahi alejha biografi-
në e të cilës do ta tregojm më poshtë dhe cilsitë e saja morale
fetare nga fundi i librit. . Një pjesë njerëzish nga populli shqiptar
e titulloi atë Aisheja e mirë. Allahu xh. sh. qoftë i kënaqur prej sajë.
Në Kuran Allahu xh. sh. thotë: "Allahu ia dhuron hikmetin=urtësinë
=diturinë e thellë= të zgjeruar] kuj të dojë dhe atij që i është dhënë
hikmeti me të vërtetë i është dhënë një shumicë e mirësive por
përveç të mençurve këtë [fjalë] nuk e kupton kush." "S. Bekare.
aj. 269. Disa prej këtyre njerëzve me hikmet Allahu xh. sh. i ngarkoi
me detyrën e muxhedidit=ripërtëritësit të fesë për ta pastruar fenë
nga bidadet [gjërat e shpikura në emër të fesë]. Në Kuranë Allahu
xh. sh. thotë: "Pejgamberët... dhe evlijatë [miqtë e Allahut] si
trashëgimtarë të pejgamberëve... vetëm këto i ka bërë hidajet=i ka
udhëzuar drejtë plotësishtë Allahu." Këtu është fjala për udhëzim
të veçantë me anë të engjëjve me ilham=me frymëzim=me inspirim=
dije të cilën ja ka dhënë Allahu xh. sh. drejtë për së drejti atij që ka
dashur nga pejgamberët dhe evlijatë me një nga mynyrat e veçanta
që ka dashur. Me folje pasë perdes. Dëgjon zë që i vjen nga të gji-
tha anët por nukë sheh gjë me sy ose i dërgon melek=engjëll për
ti komunikuar atë gjë që do Allahu xh. sh. Muxhedidja Aishe rah-
metullahi alejha sikurse e thash i deklaroi popullit shqiptar se ishte
e dërguar nga Allahu xh. sh. me shërbimin e thirrjes së njerëzve për
tobe që njerëzit të pendohishin sinqerisht për fjalët e veprat e liga
e të riktheheshin në rrugën e Allahut xh.sh. Ajo i tha njerëzve se
kushti i parë është që të largohi nga shirku me gojë=vënja shok e
ortakë Allahut xh. sh. në gjuhën që flisni e pas këtij faji të pafalshëm,
këtij shirku të madh ndaj Allahut xh. sh. të largohi nga punët e
veset e liga për të cilat do të flasim gjatë e gjërë më poshtë. Allahu
xh. sh. thotë në Kuran; "Ne asnjë nga të dërguarit nuk e dërguam
ndryshe vetëm se në gjuhën e popullit të vet, ashtu që ai tua
spjegojë atyre [mësimet e Allahut në atë gjuhë].... "S. Ibrahim. aj. 4.
Kështu edhe muxhedidat i dërgoi Allahu xh. sh. pas Pejgamberit
a. s. që ta sqarojnë popullin në gjuhën e tyre duke i tërhequr
vërejtje për çështje shumë të rëndësishme atëher kurë dijetarët
gabonin ose nuk ishin në gjëndje ti kuptonin drejtë e qartë disa
çështje të fesë që kërkonin zgjidhje në atë shekull si pasojë e ngatër-
rresave që fuste djalli mallkuar me shokët e tij qafirat e munafikët
=dyfytirshit. Për njerëzit e zgjedhur të udhëzuar direkt prej Allahut

xh. sh. Kurani thotë: " Këta ishin [njerëz] që Allahu i gradoi nga pejgamberët ... dhe prej atyre [prej sojit të tyre që nuk ishin pejgamberë] por që i udhëzuam e i bëmë të zgjedhur [i zgjedhëm për shërbime ".] S. Merjem. Aj. 58.

Nga ky ajet Kurani kuptohet se pejgamberët që ishin prej burrave dhe evlijatë që ishin prej burrash dhe prej grash të dy palët janë nga njerëzit e zgjedhur prej Allahut xh. sh. por me grada të ndryshme nga njëri tjetri. Diferencën e gradave e tregon Kurani ku Allahu xh.sh. thotë : "Ne i dalluam disa mbi disa të tjerë e Musait i foli Allahu me fjalë." S. Nisa. Ajeti. 164.

4- JA Ç'FAR KANË THËNË DIJETARËT E PARË ISLAM PËR FRYMËZIMIN

Dijetari i njohur Islam Ibni Kaim El Xhevziu ka thënë; Shkallët e udhëzimit janë të veçanta dhe të përgjithëshme dhe ndahen në disa mynyrash. Shkalla e parë është bisedimi i Allahut xh. sh, me njeriun e Tij të dashur, drejtë për së drejti pa ndërmmjetës. Shembull kemi kur Allahu xh. sh, i ka folur Musait a. s. Kurani thotë; Allahu i foli Musait me fjalë. "S. Nisa. aj. 164. Shkalla e dytë është ajo me të cilën dallohen të dërguarit në përgjithësi. Allahu në Kuran i thotë Pejgamberit a. s. kështu: "Ne të frymëzuam ty me shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe pejgamberët [tjerë] pasë tij..." S. Nisa. aj. 163. Fjala el-vahj do të thotë informacion=të dhëna të shpejta e sekrete nga ana e Allahut xh. sh. Shkalla e tretë është dërgimi i melekëve-engjëjve tek njerëzit që i ka caktuar Zoti xh. sh. me shërbim lajmëtarë prej Tij. Meleku i shpall atij njeriu atë gjë që e urdhëron Allahu xh. sh. Këto tre shkallë janë të posaçme për të dërguarit e Zotit xh. sh. Shkalla e katërt është el-tahdisi parandjeja që kjo nuk hyn në shpalljen e posatëshme të urdhëruar për ta zbatuar të gjithë njerëzit, porë i jepet njerëzve të sinqertë sikurse iu dha hazreti Ymer ibni Hatabit r. t. a. Pejgamberi a. s. ka thënë: "Me të vërtetë në mesin e popujve të kaluar ka pasur njerëz që kanë pasur parandjeja e nëse në ymetin tim ka sot të tillë, ai është Ymer ibni Hatabi. " Shkalla e pestë është hikmeti-hollëkuptimi e aftësija e të kuptuarit. Për kë të gjë Allahu xh. sh. thotë në Kuran për pejgamberin Isa a, s, "Ne i dhamë atij librin dhe hikmetin". Gjithashtu Kurani thotë: "Allahu ia dhuron hikmetin kujtë të dojë, dhe atij

njeriu që i është dhënë hikmeti, me të vërtetë i është dhënë një shumicë e mirësisë, por veç të mençurve këtë [gjë] nuk e kupton kush. "S. Bekare. aj. 269. Shembull kemi kur Allahu xh. sh. në Kuran thotë; 'Dhe [kujto] Daudin dhe Sulejmanin kur pleqëronin [diskutinin] për çështjen e bimës[të mbjellave] të cilën e kishin kullotur delet e atij populli natën, ndërsa Ne [thotë Allahu xh. sh.] ishim përcjellës-vëshgues-kontrollues të gjykimit të tyre, ndërsa Sulejmanit ia mësuam atë[përgjigjen apo vendimin që duhet të jepte] dhe secilit [prej tyre] iu patëm dhënë urtësi [hikmet] e dije... S. Enbija. aj. 78-79. Kurani gjithashtu na tregon: 'Ne [thotë Allahu xh. sh.] i patëm dhënë LLukmanit mençuri të përsosur... S. Llukman aj. 12. Në këtë shkallë porë në grada më poshtë se pejgamberët kanë qënë disa sahabë-shokë të Pejgamberit tonë a. s, sikurse janë Ymer ibni Hatabi, Ibni Abasi e disa të tjerë r. t. a. Aftësija për ta kuptuar thellë e tamam si duhet, atë fjalë që ka thënë Allahu xh. sh. dhe Pejgamberi a. s. është shenjë sinqeriteti e devotshmërije që kanë pasur shokët e Pejgamberit a. s, dhe dëshmi për sjelljen e tyre sipasë mësimëve të tij. Ibni Abasi r. t. a. e pyeti Ymer ibni Hatabin r. t. a. dhe pjestarët e luftës së Bedrit që ishin aty prezent lidhur me kuptimin e sures En-Nasër. . "Kur erdhi ndihma e Allahut dhe çlirimi dhe i pe njerëzit [ti o Muhamed] që po hynë turma turma në fenë e Allahut..." Këtu shikojmë dallimin e diturisë së thellë të Ibni Abasit r. t. a. kur ai komentoi për njoftimin e Allahut xh. sh. se Ai do ta largojë Pejgamberin a. s. nga kjo botë. Hazreti Ymeri r. t. a. është pajtuar me mendimin e Abdullah ibni Abasit r. t. a. me gjithëse ibni Abasi ishte më i riu prej sahabëve-shokëve të profetit Muhamed a. s. Gjithashtu njerëz me dije të thelluar ka pasur edhe nga dijetarët Islam pas sahabëve=shokëve të Pejgamberit a. s. Ja një shembull për dijen e thelluar. Dijetariët e par musliman ka thënë se pa dyshim nata e madhe =nata e Kadrit është në natën e njëzetë e shtatë të muajit të Ramazanit, sepse vetë surja Kadër sikur ta banë me sy për natën e cila të thotë se jam këtu, jamë në natën e njëzet e shtatë. Ibni Abazi ka thënë surja Kadër ka 30 fjalë dhe fjala e njëzet e shtatë është fjala [Hije] e cila do të thotë kjo natë. Po ashtu Ibni Mesudi ka thënë se nata e Kadrit është në natën e njëzet e shtatë. Trans. Tirmidhi. Hadithi sahij. Ibni Ymeri transmeton këtë hadithë se Pejgamberi a. s. ka thënë: "Ai që do natën e Kadrit le ta kërkojë në të njëzet e shtatën natë. Trans imam Ahmedi. Hadithi sahi. Të këtij

mendimi kanë qënë vazhdimishtë dijetarët e parë Islam në botë. Po ta shikoni me kujdes suren Kadër, ajo ka vërtetë 27 fjalë dhe pastaj mbaron. Shkalla e gjashtë është qartësija e përgjithshme që nënkuptohet sqarimi i së vërtetës dhe dallimi i saj prej së pavërtetës me fakte shembuj e njoftime të qarta për zemrën dhe mendjen e njerëzve në përgjithësi, ashtu sikurse janë gjërat e dushme për syun.

Kjo shkallë është argument i Allahut xh. sh.

ndaj krijesave të Tij, kur Ai do që ti udhëzojë ose në të kundërtën do që ti ndëshkojë ata njerëz tek të cilët kanë ardhur argumentet e Tij dhe ata përsëri nuk binden. Allahu xh. sh. në Kuran thotë; 'Ata që i bëjnë të rreme argumentet tona, janë shurdhmemecë të mbetur në errësirë=në injorancë...S. En-nam. aj. 39. Për të mos bindurit Kurani madhërshëm thotë: "Allahu nuk e humbë një popull pasi ta ketë udhëzuar atë, para se ti sqarojë ata se nga çfar [gjëje e keqe] duhet të ruhen. "S. Tobe. aj. 115. Ndërsa në suren Saff. Allahu xh. sh. thotë : ". . Dhe kur ata devijuan [nga e vërteta] Allahu i largojë zemrat e tyre = [Ai bëri që edhe zemrat e tyre të devijojnë-të largohen nga e vërteta. "]. S. Saf aj. 5. Për kombin e Themudit, Allahu xh.sh. i tha Pejgamberit a. s. kështu; "Ne jua patëm treguar [atyre] rrugën e drejtë por ata megjithatë më shumë deshën verbërin [errësirën [injurancën]]". S. Fusulet. Ajeti 17. Këtu bëhet fjalë për udhëzimet pasë sqarimit me argumente të ndryshme. Dijetari i njohur Islam Ibni Kajim Xhevziu ka thënë se shkallët e frymëzimit ose shpalljeve prej Allahut xh. sh. njerëzve të tij të dashur janë tre llojesh. Shkalla e parë është lajmi [en-nebe] i cili arrin me shpallje të qartë dhe është i dëgjueshëm me veshë. Ky është lajmë i cili ka një rëndësi të madhe se është lajmë lidhur me fshehtësitë madhore të Allahut xh. sh. Shpallja [el-vahj, inspirim= frymëzimi [ilhami] ishin informime ose njoftime prej Allahut xh. sh. për të dërguarit e Tij pejgamberët=lajmëtarët dhe resulët= të dërguarit me shërbim që ndiqnin mësimet ose librin e pejgamberit që ishte para tyre dhe muxhedidat që ndoqën rrugën e profetit Muhamed. a. s. me udhëzimet e librit të fundit Kuranit famëlartë. Frymëzimi i dijes prej Allahut xh. sh. thotë Ibni Kajimi dihet pa dyshim që është në shkallë më të lartë se inteligjenca ose dituria e fituar nga dijetarët me mundin e tyre. Nga kjo fjalë e tijë kuptohet se muxhedidat që i dërgojë Allahu xh. sh. me shërbim në çdo shekull kanë qënë në shkallë më të lartë në dijen e fesë se dijetarët për shumë çështje të ndryshme që

i përkritnin fesë lidhur kjo me njerëzit. Mendimi imë thotë Ibni Kaim Xhevziu rahmetullahi alejh është ky: Nëse është është fjala për lajmin i cili merret nëpërmjet shqisave të dëgjimit=dëgjohe me veshë, ky nuk është frymëzim porë është një llojë i të folmes me fjalë që ishte i posaçëm për lajmëtarët e të dërguarit e Allahu xh. sh. me shërbim. Ekzistojnë dy lloje të njoftimit. Njoftim me ajete të cilat lexohen ose dëgjohe dhe sqarim me ajete [me shenja apo argumente] që janë të dukëshme nga çdo anë. Të dyja mynyrat për ta qartësuar çështjen dëshmojnë dhe vërtetojnë njësinë e Zotit xh. sh. që Ai është një i vetëm pa shok e ortak e që nuk ia ngjason akujtë dhe është me cilësi të plota e të përkryera. Ajetet ose shenjat e dukëshme dëshmojnë edhe vërtetësinë e shpalljes që i ka ardhur Pejgamberit a. s. Ndërsa inspirimin-frymëzimin nga Allahu xh. sh. tek njerëzit e Tij të zgjedhur që disa nuk kanë qënë peygamberë por evlija, Ibni Kaim Xhevziu e ka ndarë në tre llojesh. Shkalla e parë është lajmi [en-nebe] icili arrin me komunikim të qartë tek njeriu që do Allahu xh. sh. me anë të melekut icili është me dëgjim. Shkalla e dytë është frymëzimi në shpirtë siç ja dha Allahu xh. sh. atëherë nënës së Musait a. s. dhe me ruja=nëpërmjet ëndrrës siç e urdhëroi Ibrahimin a. s. ta bante kurban djalin e tij Ismailin dhe me rujëjetun-me shfaqëje filmike para syvet duke qenë zgjuar, siç ja tregojë hazreti Ymerit në minberin e xhamisë rrethimin që po i bënte ushtriye e armikut ushtrisë së tij të komanduar nga komandanti i quajtur Sarij. Allahu xh. sh. ia ngren perdet atij njeriu që do [që është euvlija] dhe ai njeri shikon atë gjë do Allahu xh. sh. Ndërsa të tjerët nukë mundë të shohin gjë. Këtë gjë e vërteton Kurani. Allahu xh. sh. i tha Pejgamberit a. s. "Ti ishe në një paqartësi dhe Ne ta hoqëm perden tënde [pengesën tënde] dhe tani, ti shikon shumë mprehët [shikon hollë=qartë]. S. Kaf aj. 22. Shkalla e tretë e inspirimit ose frymëzimit është inspirimi nga Allahu xh. sh. që krijesa e Tij e zbulon vetë esencën e gjërave dhe si duhet të veprojë. Sikurse është inspirimi që i ka dhënë bletës për të cilën tregon surja Nahl ajeti 68 ku thuhet: "Zoti ytë e inspiroi = e frymëzoi bletën [i dha instikt bletës] ". Për këtë llojë inspirimi është e pa mundur të flitet se qysh është. Për këtë gjë flet Pejgamberi a. s. me hadithin që e transmeton Muslimi. Kështu që kuptohet se intelijenca=zgjuarsija dhe inspirimi ose frymëzimi ndahen në të përgjithshëm e të përveçëm=të posaçëm. Duhet ta ndajmë të përgjithshmen nga e veçanta. Epërgjithshmjia është

në shum raste ndërsa e posaçmja=e veçanta është shum e rrallë e shum pak takohet në të. Dallimi mes tyre thonë dijetarët Islam qëndron në atë se inteligjenca e dituria në një far mënyre mundet të arrihet e të fitohet me përpjekje ose të fitohet nga dikushi, sigurishtë me dëshirën e Allahut xh. sh. por tërthorazi = indirektë e ndërsa frymëzimi=ilhami ose inspirimi është drejt për së drejti dhu-ratë nga Allahu xh. sh. që ja jepë njerëzve të Tij të dashur dhe nuk mundë të arrihet nga dikush tjetër me asnjë lloj mënyre. Për in-spirimin ose frymëzimin Allahu xh. sh. në Kuran thotë: “Dhe Ne e frymëzuam Musain [duke i thënë] hidhe shkopin tënd...S. Araf. aj. 117. Gjithashtu Allahu xh. sh. iu ka dhënë frymëzim=inspirim edhe gravet. Allahu xh. sh. i tregoi Muasait a. s. për këtë gjë duke i thënë atij kështu: “Atëherë kur nënën tënde e frymëzuam me atë [llojë forme] që nukë kuptohet ndryshe veçse me inspirim= [me frymë-zim=shpallje] i thamë asajë] Vëje atë [fëmijën= Musain] në arkë, e pastaj hidhe në lumë e lumi e hedh [e nxjerrë] në breg...S. Taha. ajetet. 38, 39. Kurse shkalla e parë En-nebe siç e thashë, është lajmi i cili ka një rëndësi të veçantë se është lajm që ka të bëjë me fsheh-tësi madhore prej Allahut xh. sh. Shpallja [vahji] dhe frymëzimi [ilhami] i janë dhënë atij njeriu që ka zgjedhur Allahu xh. sh. për ta Informuar=për ta njoftuar atë njeri direkt. Mendimi im thotë Ibni Kaim Xhevziu rahmetullahi alejh është ky: Nëse është fjala për laj-min që dëgjohet përmes veshit, ky nuk është inspirim = frymëzim por, është një llojë i të folmes me fjalë dhe është i posaçëm për pejgamberët=lajmëtarët dhe për të dërguarit e Allahut xh. sh. Shem-bullin e kemi në Kuran kur Allahu xh sh. thotë; “O Musa: Unë të gradova ty mbi njerëzit [tjerë] me shpalljen Time dhe me të folurit Tim”. S. Araf. aj. 144. Shum njerëz besimtar në botë të zgjedhur prej Allahut xh. sh. pas Pejgamberit a. s. kanë marrë inspirim=frymëzim ose ilham në shpirtë prej Allahut xh. sh. dhe kanë marrë komunikim me fjalë duke dëgjuar me anë të veshit folje nga melekët=engjëjt. Një nga mynyrat është kur meleku=engjëlli iu ka drejtuar atij disa herë. Kësajë shkalle ia kanë arritur disa nga njerëzit e dashur të Allahut xh. sh, që nuk kanë qenë pejgamberë, nga burrat por dhe nga gratë. Kemi shembull kur melekët i janë drejtuar Imran ibni Hysejnit me selam. Argumentin shumë të qartë e kemi nga Kurani e hadithi se kur ka dashur Allahu xh.sh. engjëjt me lejen e Tij iu kanë folur dhe iu kanë dhënë lajme të ndryshme e të mira njerëzve që ka dashur Allahu xh.sh.

burrave dhe grave. Engjëjt i kanë folur nënës së haz Ismailit a. s. Haxhires rahmetullahi alejha. Hadithi thotë "Nëna e Ismailit dëgjo një zë e më pastaj pa një melek duke gërmuar aty ku sot është burimi i ujit të Zemzemit. Kur doli ujë, ajo u ngop me ujë dhe pastaj i dha gjirin djalit që ta ngopte me qumësht. Engjëlli i tha asaj: "Mos keni frikë se nuk do të jeni të humbur.... Trans. Ibni Kethiri. Engjëjt i kanë folur nënës së profetit Isa a. s, Merjemes r. t. a, gruas së hazreti Ibrahimit a. s. gruas së profetit Zekirja a. s. e tjerëve. Engjëjt i folën gjithashtu nënës së lumtur të Pejgamberit tonë fatbardhës Emine r. t. a. duke i dhënë lajme të gëzueshme për lindjen e djalit të saj të famshëm profetit Muhamed a. s. Ekzistojnë dy lloje të bisedimit me anë të melekëve [engjëjve] . Njëri është bisedimi që njerëzit e dashur të Allahut xh. sh. e dëgjuan me veshë dhe ky lloj është shumë i rrallë, dhe lloji tjetër është kur meleku=engjëlli i është drejtuar shpirtit të njeriut. Allahu xh. sh. ia bën të qartë këtë gjë Pejgamberit a. s. në Kuranë me këtë ajet kështu: "Kur Zoti yt i frymëzoi melekët; Un jam me ju, prandaj forconi ata që besojnë. "S. Enfal. aj. 12. Shembull të frymëzimit tek njerëzit kemi tek shokët e Isait a. s. Allahu xh. sh. në Kuran thotë; ...Dhe kur i frymëzuam Havarijunët, të më besoni Mua dhe të dërguarin tim. "S. Maide. aj. 112. Një nga shkallët e udhëzimit të njerëzve të sinqertë të Allahut xh. sh. thotë Ibni Xhevziu, është rrujaja=ëndrra e sinqertë, e vërtetë e cila është njëra prej pjesëve të pejgamberllëkut. Profeti ynë Muhamedi a. s, ka thënë: "Ëndrra e besimtarit të sinqert është 1\46 pjesë e profetisë". Trans. Buhariu. Para se Pejgamberit a. s. i vjenë shpallja ai ka shkuar gjashtë muaj para, ëndërra të bukura=ëndrra të sinqerta=të vërteta me kuptim, dhe pastaj i ka ardhur shpallja nga Allahu xh. sh. Po kështu dhe profeti Jusufi a. s. Imami Ahmed ibni Hambeli ka thënë: "Ëndrra e besimtarit të devotshëm [me takva të fortë] është një lloj të foluri me të cilën Allahu xh. sh. i flet atij njeriu në gjumë". Pejgamberi a. s. ka thënë: "Nga pejgamberllëku kanë mbetur lajmet e mira=lajmet e sakta për të vërtetën". Allahu xh. sh. në Kuranë thotë: "Ata që thonë Zoti ynë është Allahu dhe qëndrojnë besnikërishtë=të pa lëkundur [në atë që thonë] për ata ka lajme të mira në dynja dhe në ahiret. Melekët ju thonë....". Ndërsa për njoftimet me anë të ëndrrave Pejgamberi a. s. ka thënë: "Janë tre lloje të ëndrrave; ëndërra nga Allahu xh. sh. ëndërra nga shejtani lanetullah dhe ëndërr nga ajo që njeriu mendon duke qenë zgjuar dhe e sheh atë

gjë në ëndërr". Trans. Buhariu. Ndërsa në shkaqet e udhëzimit-drejtimit në të mbarën hyn vetëm ëndrra e besimtarëve të sinqertë që u vjen nga Allahu xh. sh. Ëndrra e besimtarit të dashur te Allahu xh. sh. është një lloj shpallje e pa gabuar dhe e pastër e ruajtur nga ndërhyrja e shejtanit të mallkuar. Për këtë gjë janë në mendim të përbashkët të gjithë dijetarët Islam të çdo kohe thotë dijetari Ibni Kaim Xhevziu rahmetullahi alejh. Për arsyen se iu shfaq në ëndërr nga Allahu xh. sh. disa herë, mikut të Allahut xh. sh. profetit Ibrahim a. s, ai deshi që ta theri djalin e vet Ismailin a. s. Njoftimet që kan marrë nëpërmjet ëndërrës njerëzit e dashur të Allahut xh. sh. pas Profetit Muhamed a. s. nuk janë në kundërshtim me Kuranin. -me librin e Allahut xh. sh. Ato kan qenë paralajmërime, sqarime e përforcime për të vërtetën që tregon Kurani. Për ëndërrat është i ngarkuar nga Zoti xh. sh. meleku=engjëlli i cili i tregon në ëndërr njeriut të devotshëm me shembulla për çështje të ndryshëme duke e lajmëruar ose duke e përkujtuar atë njeri. Imami Maliku r. t. a. ka thënë: Ëndërra e vërtetë e besimtarëve të devotshëm, është një llojë i shpalljes". Imam Maliku e kritikon atë njeri që e komenton ëndërrën pa njohuri=pa ilham prej Allahut xh. sh. Ai thotë: E si mundet të luash ti me shpalljen e Allahut xh. sh. Njerëzit që kan parë dhe mund të shohin ëndrra të vërteta, kanë qenë njerëz të devotshëm, të dashur nga Allahu xh. sh, janë ushqyer gjithmonë me ushqim hallall, kan qenë të pastër në trup dhe në shpirtë, kanë respektuar urdhërat e Allahut xh. sh, dhe janë larguar nga punët e liga dhe kanë pas në kokë vazhdimishtë mendime të mira. Ata kur shtriheshin të flenin gjumë, ishin me abdesin e jacisë dhe shtriheshin në drejtim të Kibles=Qabes duke e përmendur Allahun xh.sh. me zikër e dua. Këta njerëz të sinqertë ishin evlija= miqtë e Allahut xh. sh. Pra ëndërrat e mira dhe frymëzimi kan ardhur nga Allahu fuqiptotë xh. sh, dhe pasë profetit Muhamed a. s. Dijetarët Islam kan thënë se duke u bazuar në Kuran e Hadith njerëz me frymëzim-me me ilham-me inspirim do të ketë deri afër kijametit. E keqëja sot është se njerëzit kudo nuk duan të dijnë e të dëgjojnë për njerëzit e udhëzuar me hidajet-udhëzim të posaçëm prej Allahut xh. sh. por duan të dijnë e të dëgjojnë se çfarë thonë fallxhorët e magjistarët dhe pjesa tjetër duan të dëgjojnë çfarë thonë ata që kanë mësuar vetëm në shkolla dhe që kan marrë diploma. Pamvarësishtë si e kanë marrë diplomën, çfarë kanë mësuar dhe kush kan qenë mësuesat që i kan

mësuar ata. Me këto fjalë që themi, unë kurrë nuk e mohojë diturinë që merret në bankat e shkollës, se fjala e parë e Kuranit që ka ardhë nga Allahu xh. sh. është fjala Ikre=Mëso. Dhe thuhet në Kuran: Nuk janë të barabartë ata që dinjë me ata që nuk dinjë". Dhe thotë: Allahu xh. sh. "Pyetni dijetarët nëse nuk dini". Por problemi është se kush janë ata dijetarë që duhet pyetur për dije. A janë vërtetë ata dijetarë të sinqertë të fesë Islame, apo nën petkune dijetarëve Islam fshihen munafikët për të futur përçarje e grindje tek muslimanët. Pejgamberi a. s. ka thënë: "Dijetarët që nuk thonë e nuk veprojnë si kam thënë e vepruar unë, janë tradhëtarët e fesë." Nga muslimanët e parë dikurë thuhej kjo fjalë: Zgjidhe murshidin=udhëzuesin ose qamilë=të plotësuar nga gjitha pikpamjet. Nga diturija, nga morali dhe nga devotshmërija. Shumë njerëz shkojnë në shkollë për të mësuar por mvaret sa kanë mësuar, e si kanë mësuar. A kanë shkuar për të mësuar fenë e Zotit xh. sh. që të ruajn veten dhe popullin besimtarë nga humbja=nga devijimi duke qënë vigjilent në fe apo kan shkuar për të zën ndonjë vendë pune të lehtë e të të mirë. Që ti kuptosh mirë këto gjëra, nuk është bazë vetëm fjala e tyre por ajo duhet të jetë e bashkuar me vepra të mira e fjalë të drejta gjithmonë sipas Kuranit. Në sjelljet e tyre në jetën e përditshme të kenë shembull Pejgamberin a. s. Këta gjëra e tregojnë nëse ai njeri vërtetë e ka frikë Allahun xh. sh. Kurani thotë: "Allahun e kanë frikë dijetarët=të diturit." Kur detyrën e shejtë të fesë e marrin në dorë ata njerëz që janë munafikë=dy fytyrëshja dhe shtiren ose duken si besimtar, atëher nuk ke çfar ti pyesësh më ata por mëso vretë duke lexuar Kuranin që nuk ndryshon deri ditën e kijametit. Prandaj jo pa qëllim Allahu xh. sh. fjalën e par të Kuranit që ia shpalli hazreti Muhamedid a. s. Ai e dha në formë urdhëri ose porosije për ne: "Ikreh=Mëso". S. Alak. E që e kishim fjalën ke frymëzimi siç po shohim e dëgjojmë, ka rreth dyqindë e pesëdhjetë vjet që njerëzve u duket çudi që Allahu xh. sh.zgjedh njerëz prej burrash dhe grashë e ju flet atyre me mynyrat që do vetë, kur i dërgon ata me shërbim të caktuar tek një popull. Me të vërtetë ka shumë kohë që njerëzvet ju ka ngatërruar mendjen djalli dhe shokët e tij qafirat e mynafikët, dhe i mohuan njohuritë që ju erdhën prej Allahut xh.sh. njerëzve të Tij të zgjedhur evlijavet-miqëve të Allahut xh. sh. Ndërsa njerëzit që merren me xhindët e shejtanët lajmërojnë disa gjëra pa vlerë që nuk kanë të bëjnë fare me fenë me

besimin e drejtë por përkundrazi i largojnë njerëzit nga feja, nga ligji i Allahut xh. sh. Fatkeqësisht ka shumë njerëz që ju besojnë këtyre. Fallxhorët e sihirbazët ose magjistarët që janë miqtë e shejtanit të mallkuar i mësojnë njerëzit që të veprojnë në kundërshtim me urdhërat e Allahut xh. sh. që tregojnë Kurani, dhe të porositë të Pejgamberit a. s. Ata i bëjnë njerëzit kuriozë me disa të dhëna shumica të rreme që i marrin nga xhindët e shejtanët të cilat fjalë nuk kanë asnjë vlerë udhëzimi për njerëzit veç se devijimit nga e drejta. Pë këtë na tregojnë Allahu xh. sh, në Kuran kur thotë: “O grumbulli i xhinëve ju mashtruat shumë njerëz...”. S. En-nam. aj. 128. Ndërsa për ardhjen e shejtanëve lanetullahi alejh tekë njerëzit e këqijë të cilët veprojnë në kundërshtim me Kuranin Allahu xh. sh. thotë kështu: “A t’ju tregoj se kujtë i vinë shejtanët=djajtë? , Ata i vinë çdo rrenacaku çdo gjynahqari dhe hedhin fjalë, shumica e tyre rrenë-gënjejnë”. S. Shuara. aj. 222, 223. Gjithashtu mos të harrojmë se ka pasur e mund të ketë në botë dhe sot njerëz të cilët rrejnjë duke thënë se mua më ka ardhur shpallje= komunikatë ose lajmërim prej Allahut xh. sh. por në faktë ata gënjejnë. Në Kuran Allahu xh. sh. thotë: “E kush është më fajtor i madh se ai[njeri] që shpik rren ndaj Zotit e thotë: Mua po më shpallet dhe [atij] nuk i është shpallur asgjë”. S. En-nam. aj. 93. Nga ky ajet Kurani kuptojmë se Allahu xh. sh. ju sjellë lajme; njoftime e sqarime të ndryshme njerëzve të Tij të dashur por, ka njerëz që për këtë gjë rrejnjë=gënjejnë. Kështu njerëzish gënjeshtarë kanë dalë gjithmonë në çdo kohë e vendë që nga koha e Pejgamberit a. s. Në kohën kur ishte gjallë Pejgamberi a. s. doli i quajhuri Musejleme Kedhabi i cili u thoshte njerëzve që dhe mua më ka ardhur shpallje=kommunikatë prej Allahut xh. sh. Prandaj vëllezër besimtar nuk duhet ta ngatërroni të vërtetën me të pa vërtetën por ti luteni Allahut xh. sh. që tu bëj juve me e kuptuar të vërtetën që të dini ti dalloni miqtë e Allahut xh. sh. nga miqtë e shejtanit të mallkuar. Imam Tirmidhiu dhe Ahmed ibni Hambeli transmetojnë këtë hadithë të Pejgamberit a. s. se ai ka thënë; Allahu xh. sh, si shembull ka marrë rrugën e drejtë. Nga dy anët e sajë janë dy mure në të cilat ka dyer të hapura. Në dyrët janë varë perde. Në fundë të rrugës është zëdhënësi i cili bën thirrje. Edhe mbi rrugë është një zë dhëndës. Rruga e drejtë është Islami, muret janë janë dispozitat=ligjet e Allahut xh. sh, kurse dyrët e hapura janë ndalesat e Allahut xh. sh. Zëdhënësi në fundë të rrugës

është Kurani ndërsa zë dhënësi mbi rrugë është porosija e Allahut xh. sh, në zemrën e besimtarit të sinqertë. Kjo porosi në zemrat e besimtarëve të sinqertë është frymëzim i Allahut xh. sh, të cilin e bartin e sjellin melekët=engjëjt. E transmeton hadithin En-Nuvvas ibni Sem'ani. Ka dhe folje që e dëgjojnë me veshë njerëzit e prishur. Ky është dëgjim i zërave nga xhinët e shejtanët. Ata i rrejnë dhe i joshin me fjalë e shpresa të kota njerëzit e prishur, me fjalë jashta të vërtetës që thotë Allahu xh.sh. në Kuran. Me xhindët e djajtë meren fallxhorët e magjistarët të cilët i gënjejnë njerëzit duke i larguar nga mësimet e Kuranit që është fjala e Allahut xh. sh, dhe nga hathet e vërteta që ka thënë Pejgamberi a. s. Për këtë gjë Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Ai [shejtani] ju premton atyre dhe i bën të shpresojnë, por shejtani nuk premton tjetër vetëm se mashtrim". S. Nisa. ajeti. 120. =Pra shejtani i josh njerëzit e prishur me shpresa të rreme, ndërsa ajo që ju premton ai është mashtrim. Një pjesë nga kjo folje u vjen në zemër fallëxhorëve e magjistarëve=sihirbazëve, dhe një pjesë e dëgjojnë me veshë. Ndërsa njeriu që është mukarrebunë-që është evlija=është miku ose i afërmi i Allahut xh. sh. dhe është me shërbim prej Tij, inspirohet=frymëzohet nga Allahu xh. sh, ose lajmërohet me anë të engjëjve ose direkt merr njoftim prej Allahut xh. sh. që i thuhet pas perdes, për të forcuar të vërtetën që thotë Kurani duke i sqaruar njerëzit se cila është bidad=fjalë ose veprim i shpikur nga njerëzit që e kanë humbur rrugën e drejtë dhe cila është e vërteta për të cilën flet Kurani e cila është përzier me të pavërtetën ose është mohuar fare si pasojë e propogandës së qafirave = ateistave dhe e munafikve=dyfytirëshve dhe studjusat e fesë nuk janë në gjëndje ti kuptojnë drejtë. Këto njerëz që ishin euvlija=miqë të Allahut xh. sh. e që erdhën me shërbim pas Pejgamberit a. s. quheshin muxhedida=ripërtëritësa të fesë që përsërisnin të vërtetën, tregon Kurani. Jua bëjshin të qartë njerëzve të vërtetën kurë njerëzit vepronin në kundërshtim me të.

5- ARDHJA E MUXHEDIDAVE VËRTETOHET ME KURAN E HADITH

Vëllezër besimtarë siç e thamë dhe më sipër Kurani është fjala e Allahut xh. sh. Krijuesit të gjithësisë. Kurani është libër i pa

ndryshuar i përshtatshëm për çdo kohë dhe vënd por kur njerëzimi humbet rrugën e drejtë ose bie krejtësishtë në materializëm dhe nuk i mbetet më aftësi për të marrë dritë nga kushtetuta e plotësuar e udhëheqëjes njerëzore Kuranit për këto arsye Allahu xh. sh. nga mëshira vet e ka përcaktuar që pas profetit të fundit Muhamedit a. s. të dërgoi në çdo një qindë vjetë, një ringjallës të fesë që në fjalorin e termave fetare Islame sikurse e thamë quhet muxhedid. Këtë gjë e përsëris e ka treguar Pejgamberi a. s. me këtë hadithë; Inall-llahe jeb athu li hadhi fil ummeti fi kul li metin senetin men juxhed didu lehu dineha. "d. m. th. =Me të vërtetë Allahu xh. sh. ka për ti çuar ymetit tim në çdo njëqindë vjetë, një ripërtëritës të fesë. Transmeton Buhariu dhe Ebu Daudi. Hadithi sahi. Vërtetë pas pejgamberit Muhamed a. s, që erdhi me shpalljen e fundit për të gjithë botën, erdhën pas tijë, në çdo shekull, shumë muxhedida me njoftime prej Allahut xh. sh, për të sqaruar shumë çështje që njerëzit binin në konflikte, nuk ishin në një mendim të përbashkët dhe duke pëlqyer secili mendimin e vet, ndaheshin në grupe sikurse po i shohim dhe sot. Më në fundë pak kohë para se të vië kijameti. Allahu xh. sh. dërgojë me shërbim edhe muxhedidin e fundit për të ju tërheq vërejtje njerëzve që ta njisojnë Zotin xh. sh. për një të vetëm pa shok e ortakë dhe të frikësohen nga Zoti xh. sh. të pendohen-të bëjnë tobe. Për këtë gjë sikurse e thashë më sipër Kurani thotë; Erdhi [u afrua koha për tu ba=për të ndodh] caktimi i Allahut [kijameti], por mos kërkoni ngutjen e tij. E pastër dhe e lartë është madhëria e Tij në krahasim me atë që ata[njerëzit] i shoqërojnë[shokë], Me urdhërin e Tij [Allahu] ia zbret engjëjt me shpallje=me njoftim atij [njeriu] që Ai dëshiron nga njerëzit e Tij [të dashur duke iu thënë]: "Të jua tërhiqni vërejtjen [ti njoftoni njerëzit] se nukë ka të adhurar tjetër [Zot], vetëm se Unë, pra të më keni frikën=të frikësohen nga unë". S. Nahl. ajetet. 1 dhe 2. Ndërsa Pejgamberi a. s, ka thënë në hadithë; Pa dyshim Allahu xh. sh, në çdo një qindë vjetë, ka për ti dërguar ymetit tim një muxhedidë-ripërtëritës të fesë. Trans. Buhariu dhe Ebu Daudi. Hadithi sahih-i vërtetë. Muxhedidad ishin udhëheqës fetarë që i ngarkoi Allahu xh. sh. me shërbim në çdo shekull për sqarime të çështjeve të fesë tek ai popull, kur dijetarët e fesë binin në gabime e jepnin mendime të ndryshme për një ose disa çështje të koklavitura që dilnin në atë shekull. Muxhedidad ishin të siguar nga të bëmit gabime përse

i takon sqarimeve për çështjet e fesë sepse ata udhëhiqeshin qartë e drejtë nga ana e Allahut xh. sh. Allahu xh. sh. në Kuran iu thotë besimtrëve; “Mos bëhi si idhujtarët që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe dhe secili grup kënaqet me mendimin e vet”. S. Rum aj. 32. Muxhedidat të cilët i dërgojë Allahu xh. sh, me shërbim pas Pejgamberit a. s. ishin të pa gabushëm në atë që thoshin pasi nuk flisin sipas dijes që kishin fituar gjatë jetës. Muxhedidat nuk flisin sikurse dijetarët e zakonshëm sipas dijes së tyre aqë sa kishin mësuar nga të tjerët, dhe ashtu si e kishin mësuar, por sikurse sikurse e thashë, muxhedidat udhëhiqeshin drejtë pa gabime, prej Allahut xh. sh. me format e ndryshme që përcaktohen në Kuran e që i treguam më sipër. Në kohën para profetit Muhamed a. s. kur njerëzit dilnin nga rruga e drejtë, Allahu xh. sh. ju dërgonte herë pas here pejgamberë atje ku e shihte të arsyeshme ndërsa pas Pejgamberit tonë a. s. solli muxhedidat për të jua ba të qartë njerëzve me argumente të ndryshme, të prera e të qarta, të vërtetën që thotë Kurani dhe për ti kritikuar ata kur e ngatërronin ose e humbënin fare rrugën e drejtë dhe binin në konflikte të ndryshme mendimi me njëri tjetrin për çështje fetare Islame në fusha të ndryshme të diturisë. Si shumë muxhedidat të tjerë që erdhën për ti udhëhequr njerëzit drejtë pa gabime e shtrembërime në rrugën e Profetit Muhamed a. s. ishte edhe muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha që ishte e fundit nga muxhedidat e dërguar me shërbim nga Allahu xh. sh. Kjo ishte një murshide e zgjedhur nga Allahu xh. sh. në mesin e popullit në Shqipëri në shekullin e njëzetë, dhe ashtu si tha ajo ishte e fundit nga muxhedidat me shërbim të caktuar nga Allahu xh. sh. për thirrje e njerëzve në tobe=në pendesë.

Muxhedidja Aishe qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej asaj. e cila ishte me shërbimin e thirrjes së njerëzve në Tobe, ju merrte besën njerëzve kur ju komunikonte lajmin e Zotit xh. sh. për Tobe, porë kryesishtë për njisimin e Zotit në çdo gjuhë, largimin nga shirku gjuhësorë=shirku me gojë në çdo gjuhë. Ajo thoshte se për këtë gjë kam urdhër nga Allahu xh. sh. E vërtetë ishte fjala e saj se kështu ka vepruar edhe Pejgamberi a. s. Kurani thotë: “Kur të vin besimtarët që të japin besën ty, se nukë do ti shoqërojnë asnjë sendë Allahut, [nuk do të bëjnë shirk], se nuk do të vjedhin, se nuk do të bëjnë kurvëri, se nuk do ti mbysin fëmijët e tyre, se nuk do të gënjejnë...”. S. Mumtehin. aj 12. Kurani gjithashtu thotë: “Me të vërtetë

Allahu qe i kënaqur me besmtarët, kur ata nën hijen e atij druri të jepnin besën ty [o Muhamed]”. S. Fet’ h aj. 18. Allahu xh. sh. i thotë Pejgamberit a. s. kështu: “Ata që ta japin besën ty [o Muhamed] në të vërtetë ia japin Allahut, se dora e Allahut është mbi duart e tyre dhe kush e thye besën, ai e thyen vetëm në dëm të vehtes dhe kush e zbaton atë që i është premtuar Allahut, Ai do ti japë atij [njeriu] shpërblim të madhë”. S. Fet’ h. aj. 10. Gjithashtu transmetohet se Auf Ibn Malik ka thënë; Ishim tek Profeti a. s. një grupë njerëzish. Shtatë tetë apo nëntë vetë dhe Pejgamberi a. s. na tha; “A nuk po i jepni besën të dërguarit të Allahut xh. sh? Ne zgjatëm duart dhe i thamë; Ta japim o i dërguari i Allahut. Ai tha: “Ti jepni besën Allahut xh. sh. që ta adhuroni atë e mos ti bëni shokë Atij ”.Më kujtohet se murshidja Aishe rahmetullahi alejha kur ju merrte besën burrave, ju jepte vetëm gishtat e dorës e jo plot dorën.

Vëllezër besimtarë çifti i parë i njerëzve, Ademi dhe Hava, paçin selam e filloj jetën me banim në tokë pasi bënë tobe dhe kështu përsëri për të bërë tobe lajmërohemi nga Allahu xh. sh. ne pasardhësit e tyre në fundin e kësaj bote, para largimit nga kjo. Pra me lajmin nga Allahu xh. sh. për të bërë tobe e kan filluar jetën njerëzit në këtë botë dhe me lajmin për të bërë tobe do të largohen përfundimisht nga kjo botë. Ky është caktimi i Allahut xh. sh. Për fillimin e jetës njerëzve në tokë pasi bënë tobe Kurani na tregon kështu: “E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë=[pranoi disa këshilla prej Allahut xh. sh. prandaj Ai ia fali [gabimin]. Ai [Allahu xh. sh.] është mëshirues dhe pranues i pendimit=i tobes”. S. Bekare. aj. 37. Për thirrjen për tobe para fundit të kësaj bote për mbar pasardhësit e Ademit a. s. që do të jenë besimtarë, Allahu xh. sh, thotë në Kuran: “Pendohuni të gjithë te Allahu, o besimtarë, në mynyrë që të gjeni shpëtim”. S. Nurë. aj. 31. E nëse pas ardhësit e Ademit që janë besimtarë, do të bëjnë tobe nesuh=pendes të sinqertë=tobe të vërtetë, ata kur do të ikin nga kjo botë, do të shkojnë në xhenet. Këtë gjë na e tregon Allahu xh. sh. në Kuran që thotë: “O ju që keni besuar; pendohuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, në mënyrë që Zoti juaj, ti largoi prej jush të këqijat, të ju çojë në xhenete...”. S. Tahrim. aj. 8. Pra sikurse e lexoni, Allahu xh. sh. i drejtohet besimtarëve që të bëjnë tobe të qëndrueshme, pa këthim prapa nëse duan të hyn në xhenet. Besonja pra ju o besimtarë të sinqertë se muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ishte vërtetë e dërguar me

shërbim nga Allahu xh. sh. që ti thërriste njerëzit në tobe=në pendim Prandaj bëni tobe o besimtar me kushtet që ju parashtroui Allahu xh. sh. nëpërmjet murshides Aishe që do ti lexoni më poshtë. Përndryshe jeni të humbur në dynja dhe në ahiret në jetën tjetër pas vdekjes. Un mendoj se ardhja e muxhedidave pas Pejgamberit a. s. në çdo shekull tek popujt e ndryshëm ishte dhe një sprovë besimi për besimtarët e çdo kohe. Popujt para nesh i thirrën në besimin e drejtë pejgamberët ndërsa pas profetit Muhamed a. s. i thirrën për rikthim tek feja, muxhedidat të cilët ishin të ngarkuar me shërbim prej Allahut xh. sh. Por ashtu sikurse shumica e njerzvet në çdo popull nuk i besuan pejgamberët, po ashtu nuk i besuan edhe muxhedidat. Allahu xh. sh. i përsërit ngjarjet në këtë botë si në ndonjë skenë teatri që regjizori ndërron aktorët por komedija komedija është e njëjtë. Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë: “E kemi zbritur Kuranin me mrrekulli që përsëriten herë pas here”. Pa dyshim dhe mrrekullit ose kerametet i përsërit Allahu xh. sh. tek njerëzit e Tij të dashur her pas here me mynyra të ndryshme. Subhanallah.

6- KUSH ISHTE MUXHEDIDJA AISHE?

Rametullahi alejha.

Ajo quhej Aishe Daudi. Lindi në vitin 1923 nga një familje besimtare Islame në fshatin Radovesh rrethi i Peshkopisë [Dibra e Vogël], zona e Gollobërdës. Babai i saj quhej Isa Daudi dhe nëna quhej Fatime e cila ishte nga Reka e Dibrës së madhe në Maqedoni. Baba i saj ishte me kombësi shqiptare ndërsa nëna i përkiste kombësis maqedonase. Kështu tregonte Aisheja. Ajo ndërroi jetë në qershor të vitit 1998 në Tiranë në një shtëpi përdhese prej qerpiçi e rrethuar në mbikqyrjen e besimtarëve të devotshëm Islam pasi ajo nuk kishte fëmij. Aisheja veç gjuhës shqipe fliste mir maqedonisht, greqisht dhe pak italisht e turqishtë. Babai i saj ndërroi jetë kur ajo ishte në moshën dy vjeç. Kur Aisheja ishte në moshën shtatë vjeç e ëma me vajzën dhe dy djemtë shpërngulet nga Dibra e vjen në Tiranë. Babës së saj ja dogjën dy herë shtëpinë në Dibër. Një here sërbët dhe herën tjetër ja dogjën kaçakët ose komitat në kohën e mbretit Ahmed Zogu. Kur erdhën me nënën në Tiranë ja dogjën shtëpinë këtu fashistët italianë bashkë me shtëpitë e tjera të lagjes ku banonte. Me që e ëma ishte në gjendje të keqe ekonomike, Aishen e morën për ta rritur

dajat e saj, familja e Hysni Rekës. Atje Aisheja qëndroi nëntë vjet. Kështu që ajo u rrit krejtësisht jetime. Në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare Aisheja u martua. Burri i sajë ishte nga Kosova dhe quhej Kurt Rama i cili në atë kohë punonte në kuestur ose ndryshe në degën e punëve të brëndëshme. Ai e besonte Zotin xh. sh. por kishte një besim pa vepra. Aisheja thoshte se ai mbante në shtëpi libra feje. Edhe Kurti sikurse unë, thoshte Aisheja, ishte rritur jetim. Pas tre viteve martesë Aisheja mbeti pa burrë pasi burri i sajë u arratisiku jashtë Shqipërisë, për arsye politike pasi në pushtet erdhi Partia Komuniste, dërsa Kurti ishte anti komunist. Aisheja thoshte se ai me komunistët kishte ra disa herë në përpjekje me armë ballë për ballë me ata. Më kujtohet një rastë thoshte Aisheja që burri im Kurti erdhi vonë natën nga zyra, duke qënë i bërë gjithë baltë bashkë me gjithë dy shoqërusat e tij, Qaniun dhe Sadriun nga Devolli i Korçës që ishin vërtetë besnikë dhe trima. Atë natë kishin shpëtuar për pak gjë nga atentatorët e njësiteve guerile komuniste. Arsyeja që Kurti nuk e donte komunizmin thoshte Aisheja, ishte më tepër nga që ata ishin të lidhur me sërëbët. Në mbarim të luftës së dytë botërore, para ardhjes së Partisë Komuniste në pushtet, Kurt Rama si shumë të tjerë u detyrua të iki Shqipëria. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se ai bërë çmos që të më merrte mua, por un nuk ika me të se nuk desha të ndahem nga nëna, vëllezërit, fisi dhe atdheu im. Gjithashtu thoshte ajo un mendoja rreziqet gjatë rrugës ku burri im mund të vritej dhe un grua e re do të mbetejsha e vetmuar në mes të rrugës. Që atëherë për shkakun e burrit filluan vuajtjet e një pas njëshme për Aishen nën diktaturën e egër komuniste dhe nuk i mbaruan gjatë gjithë jetës së saj.

Ajo thoshte se në ditët e para kurë hyri fituse Partija Komuniste në Tiranë, vinin njerëzit e tyre duke i gjuajtur me gurë për sipër shtëpiat e atyre që i dinin se ishin kundër komunizmit duke bërëtitur me të madhe; poshtë reaksionarët; hakmarrje, hakmarrje. Ata i tërboi Rusia Komuniste dhe bërëtitnin si të tërbuar nga triumfi kundër bashkë atëdhetarëve të tyre. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ishte kundër fashizmit e kundër komunizmit se që të dyja teoritë politike ishin anti fetare dhe e kishin prejardhjen nga çifutët e të vëna në praktikë nga kristianët. Vëllezërit filluan ta marrin me të keqë murshiden Aishe se ajo ishte kundër idealit të tyre komunist. Vëllezërit e saj kishin marrë pjesë në luftën kundër fashizmit. Vëllai

i parë Beqiri kishte marrë pjesë në çlirimin e Kosovës prej gjermanëve dhe ishte bërë komunist. Megjithatë luftimet kundër Aishes nga partia komuniste ishin të rrepta. Në fillim i plaçkitën shtëpinë, duke ia marrë edhe rrobat e nusërisë. Tri dhoma e një aneksë që kishte prej qërpiçi të sovatuara, dy dhoma ia morën, duke futur njerëz të tjerë në to. Kështu ajo mbeti bashkë me nënën dhe vëllain beqarë në një dhomë e një guzhinë të vogël pasi shtëpinë e nënës e dogjën nazifashistët. Ajo thoshte se në muajt e par të ardhjes së partisë komuniste nuk mund të lëvizte lirisht. Vuajtjet çdo ditë shtoheshin. Në atë kohë gjithë vendin e kishite mbuluar varfërija. Bukë nuk kishte thoshte muxhedidja Aishe.

Ajo ishte e pakët aq sa për të mbajtur shpirtin. Ishte me triskë=me racion nga qeveria vetëm për nëpunësit e shtetit se vendi porsa kishte dalë nga lufta dhe ishte varfëri e madhe. Populli bënte çbënte vetë e ishte simos më keq. Mua më vinte keq për njerëzit që vuanin nga uriya e madhe t hoshte murshidja Aishe. Gjithmonë thoshte ajo un iu lutesha Allahut xh. sh. për njerëzit nga mëshira që kishim edhe para se ngarkohesha nga Allahu xh. sh. me shërbimin e tobës.

Muxhediden Aishe rahmetullahi alejha e mundoi shumë rregjimi komunist edhe se dy vëllezërit e sajë sikurse e thash kishin marrë pjesë në luftën antifashiste. Murshidja Aishe rahmet pastë thoshte: Ata dhe shumë të tjerë si ata, panë yllin dhe morën pyllin. Ishte fjala se u mahnitën nga propoganda komuniste=u joshën nga fjalët e bukura por rrena të komunizmit. Mua thoshte Aisheja më merrte shumë her policija në pyetje se dyshonin se burri im ishte i fshehur në Shqipëri pasi ai qëndroi deri në ditën e fundit duke luftuar kundër forcave komuniste që po hynin në Tiranë. Pastaj ai u arratis në Siri e më vonë në Kanada. Aisheja ankohej e fliste keq për të quajturin Stefan Grabocka ish drejtor policije në Tiranë në vitet e para të çlirimit të Shqipërisë i cili e kishte munduar shumë Aishen. Disa her thoshte murshidja Aishe vinte toga e policisë me armë në dorë dhe mua që isha grua e vetmuar e pafajshme më merrnin e më bëni presion në degën e punëve të brendëshme duke më futur në birucë dhe më mbanin disa orë të ditës e deri natën në kohën e darkës që të tregoja se ku gjindej burri im dhe shokët e tij pasi ata ishin të bindur se ai ishte i fshehur këtu në Shqipëri por në fakt ai kishte ikur nga Shqipëria në çastet e fundit pak orë para se të hynin në Tiranë forcat komuniste duke luftuar kundër tyre. Aisheja thoshte: “Burri im ishte anti komunist i flakët”. Për këtë shkak mua më internoi qeveria komuniste në Berat. Atë natë kur arritëm Berat thoshte ajo,

ishte natën vonë dhe meqë vendi ku kishin menduar të na futshin nuk na nxente të gjithëve dhe na lan të shpërndarë. Unë thoshte Aisheja me sugjerimin dhe ndihmën e një të afërmit tim ika nga Berati fshehurazi natën me makinë dhe u ktheva përsëri në Tiranë pasi për fat të mir, kur arritëm në Berat, nuk na e bënë apelin se akoma nuk kishte arritur makina që kishte listën e emrave të internuarve. Pasi u ktheva në Tiranë u strehova për disa muaj te një familje tirance duke ndenjur fshehur e veshur si të isha vajzë fshatare tirance e rrija mbyllur brenda katër mureve të shtëpisë. Më vonë shteti nxori ligjin që i lejonte gratë që tua hiqnin kunorën burrave të tyre të arratisur nga Shqipëria për arsye politike dhe çështja e internimit tim u mbyll. Sigurisht gratë që i çkunorëzonin burrat e bënë këtë gjë nga halli që mos të persekutoheshin". Ashtu si shumë gra të tjera të vendit tonë dhe Aisheja u detyrua nga situata politike ta ç'kunorëzonte burrin e saj me të cilin nuk kishte fëmijë por ajo nuk u martua më. Çdo ngjarje ndodh me vendimin e Zotit xh. sh.

Zoti xh.sh. në Kuranë thotë: "Ne e kemi përcaktuar ndër ato [njerzit] gjëndjen e jetesës në këtë botë...". Në vitin 1955 Allahu xh. sh. e ngarkoi Aishen me detyrën e thirrjes së popullit në tobe. Udhëtimet në qytete e fshatra të vendit ajo i bënte me financën e saj. Ajo qepte rroba fëmijësh e grashë privatishtë në shtëpi me një makinë qepje të vjetër dhe i shiste tekë shtresa e vuajtur e njerzvet me ngjyrë [tek magjypët] në qytetin e Durrësit dhe lekët jua merrte me pritje. Ajo punoi me shumë mundime pa asnjë qëllim tjetër por vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut xh. sh. duke zbatuar urdhërin e Tij për ta larguar popullin e saj nga shirku dhe punët e liga që ai tu përmironte moralisht. Muxhedidja Aishe nuk ishte në tarikat. As babai e gjyshi i saj nuk kan qenë në tarikat. Aisheja ishte kundër çdo politike e cila nuk e mbështet tekë feja moralin e popullit. Siç e thash në parathënje, muxhedidja Aishe ishte kundër laïcizmit, ateizmit, fashizmit, komunizmit e të ashtuquajturës demokraci e cila është pa kufij morali e pa drejtësi. Me të vërtetë çdo sistem që nuk e mbështet moralin e popullit tek feja, të çon në anarshi në degjenerim, korrupsion dhe krim. Murshidja Aishe ishte kundër çdo rregjimi që e lufton ose nuk e përkrah fenë. Vërtetë prej propogandës dhe edukimit laik e ateistë u shkatërrua morali i njerëzve në çdo vendë të botës. Bota sot është në krizë të madhe morale e sociale si pasojë e ateizmit i cili është opjum [helm] për popujt. Muxhedidja Aishe vuajti fizikisht, shpirtërisht e një pjesë të jetës ajo vuajti shumë edhe ekonomikisht.

Ajo u mundua shumë për ta larguar popullin e saj prej ateizmit dhe prej bidadeve = shpikjeve dhe zakoneve të këqia në emër të fesë. Muxhedidja Aishe ndërroi jetë në Tiranë në qershorë të vitit 1998 në mbikqyrjen e besimtarëve dhe besimtareve nga Tirana, Peshkopia dhe Berati. Në momentet e fundit të jetës i shërbyen besimtarët nga Dibra. Në varrimin e muxhedides Aishe morën pjesë besimtarë nga disa rrethe të vendit. Nga Tirana, Dibra, Durrësi e më të shumtët ishin të ardhur nga Kavaja.

7-MUXHEDIDJA AISHE NË MOSHËN E FËMIJËRISË

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, vinte nga një familje fisnike, babai i sajë Isai ishte i dëgjuar si burrë i mirë, trim i ndershëm. Aisheja thoshte unë nuk e kam njohur babën tim, pasi ai ndërroi jetë, kur unë akoma nuk i kisha mbushur dy vjetë. Një burrë i moshuar nga krahina jonë i quajturi Asllan Mata më ka treguar mua këtë ngjarje për babën tim thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha. Ishim një rast duke ecur në një rrugë të Tiranës thoshte Asllani ndërsa pa pritur babai ytë Isai menjëherë u përkul dhe vazhdoi duke ecur disa hapa kërrusur tregonte ai. Unë thoshte Asllani i thash atij: Çfarë pate kështu ti o Isa që u përkule? A mos të dhembti gjë? Ai më tha : Jo, jo, por duke ecur me trupin tim të madh e të drejtë dhe kokën lart më ra ndërmend frika e Allahut xh. sh. tha Isai se Allahu xh. sh. nuk i do ata njerëz që kanë tangërllek qibër [madhështi] prandaj u kërrusa se pata frikë se mos po ecja me madhështi në tokë. Vërtetë Allahu xh. sh. për ecjen me madhështi ka thënë në Kuran se ti o njeri që ecën ashtu, nuk mund të matesh me malet [nuk je më i lart se ata] që po mburresh me trupin tëndë të gjatë dhe nëse njeriu i lun për madhështi duart, Allahu xh. sh. për atë tip njeriu ka thënë në formë kritike: Ti nuk mudet ta masish tokën time. Nga kjo që më tregoi Asllan Mata tha murshidja Aishe unë u gëzova se kuptova që babai im kishte qenë nga ata njerëz që e kishin frikë Zotit xh. sh. Kurani tregon se edhe pejgamberët kanë patur prejardhje nga familje të mira= nga familje fisnike e jo kryelarta. Muxhedidja Aishe rahmetullahi

alejha thoshte se Allahu xh.sh. më kishte futur në shpirtë një besim të pa tundur që kur isha fëmijë. Nuk kishim qef thoshte ajo, që të merresha me lojra si gjithë fëmijët zakonisht. Kishim dëshirë që të dëgjoja ku flisnin të rriturit dhe i urreja shumë ata që rrenin. Ajo thoshte un e kishim shumë kujdes pastërtinë që kur isha fëmijë. Un kënaqesha shumë kur shikoja njerëz duke falur namaz. Në moshën 9 vjeçare fillova të agjëroja muajin e Ramazanit. Muxhedidja Aishe tregonte kur un isha fëmij, një rast shkua me nënën time për vizitë tek një njeri i yni. Aty ishin mbledhur edhe gra të tjera me fëmijët e tyre. Fëmijët si zakonisht filluan të luanin në oborrin e shtëpisë dhe gjatë lojës grindeshin me njëri=tjetrin. Ndërsa un thoshte murshidja Aishe rrija duke i shikuar ata dhe kur grindeshin njëri me tjetrin unë ndërhyja për ti qetësuar ata. Kur gratë dolën nga dhoma e pritjes një grua besimtare e vjetër në moshë ju tha grave të tjera këto fjalë. Unë i shikova me vëmendje gjithë fëmijët që luanin e grindeshin me njëri tjetrin ndërsa kjo vajzë [e kishte fjalën për mua] vetëm i shikonte kur luanin fëmijët dhe kurë ata grinteshin ajo i pajtonte. Dëgjoni këtu ju tha ajo grua shoqeve të saja: Unë jam e vjetër tani ndërsa ju jeni më të reja se unë. Por ta mbani mend se kjo vajzë [tha për mua] do të bëhet njeri me famë. Ju keni për ta parë këtë gjë. Kjo vajzë ju tha ajo gravet, mua më ka bërë shumë përshtypje se nuk lëvizte e shkujdesur si fëmijët tjerë. Un i vura re me kujdes që ajo ishte shumë e matur. Unë thoshte murshidja Aishe që në atë kohë isha rrethë tetë ose nëntë vjeç u skuqa në fytyrë nga turpi kur ajo foli ato fjalë të mira të mëdhaja për mua mes të tjerëve dhe un isha aty prezent. Me të vërtetë njerëzit e zgjedhur prej Allahut xh. sh. kanë qenë të mir e të mbarë që kur ishin fëmijë. Në Kur'an Allahu xh. sh. na tregon për miqtë e Tij dhe thotë: "Ne ja dham atijë {Ibrahim} që herët [që kur ishte fëmij] të mbarën: "

8- MUXHEDIDJA AISHE NË MOSHËN E RINISË.

Pasë mbarimit të luftës së dytë botërore ishte varfëri e madhe si gjithë populli edhe un thoshte Aisheja vuanim për bukën e gojës.. Buka ishte me racon dhe me triska. Un thoshte murshidja Aishe isha e pa punësuar në shtet. Shtëpinë prej tre dhomash me oborrin e saj dhe gjitha orënditë e shtëpisë aq sa ishin, i mori qeveria

komuniste, mi konfiskoi për shkakun e burrit. Mua thoshte ajo më lanë të banoja në një dhomë të vogël ngjitur me shtëpinë, me përmasat dy e gjysëm me tre metra, me një bodrum të ulët që nuk mund të rrije drejtë në këmbë të cilën neve më parë e përdornim si qurë= magazine e vogël. Këtu thoshte ajo, jetoja bashkë me nënën pas ikjes së burrit nga Shqipëria. Muxhedidja Aishe qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej saj thoshte: Para se të ngargohem prej Allahut të madhërueshëm për thirrjen e popullit në tobe, un shihja ëndra të bukura. Por më e çuditëshmjia ishte kjo: Pash në rruja=në ëndërr një pjesë filmike në kohën e namazit të sabahit, mes gjumit e zgjimit kështu: "U hap qelli në mes të tijë u duk një panoramë e madhe shkruar në gjuhën arabe e cila lëshonte nga lartë rreze dhe rrezet e sajë binin mbi mua. "Këtë çfaqje të çuditëshme tha Aisheja shkova dhe ia tregova dijetarit të dëgjuar Hasan Tahsinit që populli e thërriste Hasan Beu të cilin thoshte ajo e kishim në lagje. Ai ishte njeri shumë i ditur e i përkushtuar në fenë Islame. Ai ishte dhe shumë oratorë. Hasan Tahsini gjithashtu kishte mbaruar akademinë ushtarake në Turqi dhe pasi kishte studiuar dhe për fenë jepte mësim në medresen e Tiranës. Unë thoshte murshidja Aishe pasi ia tregova se çfar shikova e pyta Hasanin se si ishte domethënja e kësaj ëndërre të çuditshme, pasi në atë kohë un nuk kishim dituri. Ai më tha; Ti Aishe do të marrësh një lajmë të gëzueshëm ose ndonjë dhuratë të madhe. Kështu ëndërrash të mira kanë parë pejgamberët më tha ai. Kaq ishte fjala e Hasanit. Në Kuranë për ëndrat flasin këto ajete

" E ai [Jusufi] tha; O baba im kjo është domethënja e ëndrës time të më parshme; Zoti im tani këtë e bëri realitet..." Sure Jusuf. Kurse në suren Fet-h Aj 27 Kurani tregon; "Allahu ëndrën e të dërguari të vet e vërtetoi me realitet se me vullnetin e Allahut do të hyni në xhaminë e shenjtë[në Qabe]. "Për ëndërrat profeti Muhamed a. s. ka thënë" Ëndrra e mirë është pjesë e pejgamberisë. Trans. Ahmedi r. t. a. Gjithashtu ai ka thënë; "Ëndrrat e besimtarëve të devotshëm janë paralajmërime" Ai gjithashtu ka thënë ëndërrat janë 1\46 pjesë e profetësisë" Trans Muslimi. 4203. Ndërsa në një hadith tjetër Pejgamberi a. s. ka thënë; Ëndrra e mir me kuptim është prej 1\70 një e shatëdhjetë pjesë e profetësisë. Trans. Muslimi.

4205. Përsa i takon 46 ose 70 pjesëve, kjo mvarret sipasë grades së devotshmërisë së njeriut, afrimit të tij me punë të mira tek mëshira e Zotit xh. sh. duke fituar kënaqësinë e Tij. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“ Disa pejgamberë e kan marrë shpalljen=komunikatën prej Allahut xh. sh. ekskluzivikisht=posaçërisht nëpërmjet ëndrrës” Shembull për ëndrat e vërteta kemi profetin Ibrahim a. s. që mori urdhër nga Allahu xh. sh. nëpërmjet ëndrrës që ta bënte kurban djalin e tij Ismailin a. s. e tjera. Pejgamberi a. s. ai ka thënë: “Kushë më ka parë mua në ëndërr është sikur të më ketë parë zgjuar se shejtani i mallkuar nuk mund të marri pamjen time”. Pejgamberi a. s. ka thënë: “Ëndrrat janë tre llojesh: 1-trillime e mashtrime të shejtanit alejhilananet për ti mërzitur e pikëlluar njerëzit, 2-Ajo gjë që sheh ose i intereson njeriut në jetën e tij të përditëshme dhe i paraqitet në ëndërr dhe 3-lloji i tretë janë ëndërrat e mira me kuptime që janë pjesë e profetësisë.” Trans. Imam Ahmedi dhe Ibni Maxheja. Pejgamberi a. s. ka thënë: “Ëndrra e mirë është prej Zotit xh. sh. “. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte që vërtetë nuk vonojë shumë kohë dhe mua më erdhi lajmi prej Allahut xh. sh. që ta thërras popullin tim në tobe=në pendesë të largohet nga shirku me gojë mosë ti bëjë shokë Allahut në çdo gjuhë që të flasin dhe të largohen nga punët e liga-haramet. Kurani thotë: “Të dashurit e Allahut janë ata që ruhen nga të bëmit shok Zotit tit dhe nga gjërat e ndalume=haramet”. Vëllezër besimtar duhet ta dini se kemi rruëja dhe rrujetu. Rrujaja është ajo çfaqëje që sheh njeriu kur është në gjumë ndërsa rrujetu është ajo shfaqëje që të paraqet Allahu xh. sh. ta shohësh duke qënë zgjuar. Për këtë do flasim më poshtë. Pamje që ju shfaqet evlijavet duke qënë zgjuar quhet keshf.

9-MUXHEDIDJA AISHE NGARKOHET NGA ALLAHU XH. SH. ME SHËRBIMIN E THIRRJES SË POPULLIT PËR TOBE = PER PENDES.

Ajo tregonte kështu: Ishte ora 10 para dite e qershorit të vitit 1955. Isha ulur në një karrige të vjetër prej druri përballë dritares dhe në dorë kishim diçka duke qepur. Duke qenë ashtu dëgjova një trokitje dy tre her. Un u ngrita e shikova në dritare se mendova që dikush i ra xhamit të dritares. Pastaj u ula por e dëgjova përsëri trokitjen dhe ngrita kokën lart se kujtova që trokitja erdhi nga tavani i dhomës. Pa pri-tur dëgjova që vijuan këto fjalë: “Aishe, Aishe; Qëndro ashtu. Mos lëviz.

Nuk mund të më shohësh. Të urdhëroj me dëshirën tënde ta thërrasësh këtë popull në tobe istigfar duke filluar nga mosha 15 vjeçare deri në pleqërinë e fundit {para matufosjes} pasi ky popull ka dalë nga rruga e drejtë. Ti [Aishe] së pari tërhiq vërejtje njerëzve të mos thërrasin njëri tjetrin me atë emër që më thërrasin mua në gjuhën e tyre. Ju me emrin Zoti më thërrisni mua në gjuhën tuaj e pastaj po thirrni njëri-tjetrin me këtë emër [Zoti, Zotnia, i Zoti, im Zot, Zotnjusha e Zonja.] Thuaju { njerëzve} Allahu është i lartëmadhëruari që ju e thirrni Zoti në gjuhën tuaj. Të frikësohen nga unë. {të bëjnë tobe=të pendohen}:

Pasi të më njisojnë mua, Thuaju atyre: Të mos bëjnë dallim racash. Mos ti ofendojnë njerëzit me ngjyr të zezë jevgjë e arxhij; Të mosë gënjejnë e mashtrojnë, të jenë të sinqertë e të flasin fjalë të drejta, Të mosë spiunojnë njëri tjetrin, [në qeveri]; Atij që i është bërë një e pa drejtë nga dikush tjetër, ka të drejtë të ankohet në qeveri [në organet shtetërore kopetente] ; Të mbulohen femrat, mos ti zbulojnë pjesët e trupit që duhet të mbulohen kudo qofshin ata; Lakuriqëlliku shkakton imoralitet dhe imoraliteti i ka prishur qetësinë në mbarë rruzullin toksorë. Të largohen nga vjedhja e mashtrimi; [nga haku i huaj ; send pasuri ose e drejta që i takon atij tjetrit në çdo lloj forme; me peshë, me matje, me pushtime ose zaptime me forcë ose me gjyge dhe ndarje të pa drejta]. Të largohen nga imoraliteti dhe nga aborti. Të mos tradhëtojnë, ta mbajnë amanetin që ju është besuar atyre ose fjalën e dhënë. Të largohen nga kamata=fajdeja. Të mos shpifin-të mos akuzojnë e të mos i përqeshin njerëzit. Të mos kenë hased [smirë=zili] dhe të mos merren me thash e theme; të largohen nga grindjet; Të largohen nga pijet alkolike, lojërat e bixhozit, sihiri=magjia dhe falli. Të largohen nga vrasja e njerëzve të pa- fajshëm. [në kundërshtim me ligjin që ka caktuar Zotit në Kuranë. Thuaju atyre [njerëzve] të mbajnë pastërtinë e trupit e mos të rrinë xhunub[ffjala është kur eksitohen=kur bëhen për tu larë];Të falin namazin e pesë kohëve dhe të argjërojnë muajin e madhërueshëm të ramazanit muslimanët e muslimanet, Të mos i festojnë festat që nuk janë fetare; {si Viti ri, Dita verës e tjera.]”

“Shko ti [Aishe] ti gjejshe ku janë dhe ti lajmërosh të bëjnë tobe edhe ato njerëz që ju [njerëzit] me ngjyrë të bardhë nuk i përfillët ata dhe ju that atyre për ofendim jevgjë e arxhij. Nëqoftë se ata

bëjnë tobe janë vëllezërit e tua në fe. Edhe sikur njeriu të jetë më i bardhë se qumështi nuk bëhet i dashur tek Un askush me për jashtim të atyre që më binden Mua. ”

“Lajmëroi ti edhe ata që i than vetes kristianë [e quajtën veten kristijanë”] Të bëjnë dhe ata tobe. [të largohen nga punët e liga]. Sa për ceremonitë fetare, le ti bëjnë ata në faltoret e tyre, që mos të quhen fare të pa fe, se të pa fevet ju kërcënohet Allahu me kijametin dhe katastrofa në dynja dhe ahiret [në këtë botë] dhe në botën tjetër pas vdekjes]. Nëqoftë se ata [“kristjanët”] do të sjellin ndo pak besim e frikë në zemër nga ky lajm për tobe, ky besim e kjo frikë do tu vlej atyre ditën e gjykimit pasi këta kan qenë të pa ditur e të udhëhequr në rrugë të gabuar nga priftërijtë e tyre. ”

Thuaju ti atyre [njerëzve] në qoftë se do të bëjnë tobe, do ti mëshiroj ata por nëse jo; Lajmërojë ti ata se një azab pikllues [dënim i dhëmshëm] do ti përfshijë ata e që ashtu azabi [dënimi pikëllues] mos ta kenë parë dhe dëgjuar ndonjëherë ata nga të parët e tyre. Ky gazep pikllues do të përfshijë mohusat [qafirat e munafikët] dhe ata që u lajmëruan për të bërë tobe dhe nuk bënë dhe me anën e këtij gazepi pikëllues do ti transferojë një e nga një në valët e xhehenemit. Janë të përjashtuar nga ky gazep pikëllues vetëm ata njerëz që do të bëjnë tobe. Nëse ata, [njerëzit] të thonë ty: Po ti e ku do të jeshë kur do të vië gazebi pikëllues? Ti thuaju atyre: Allahu është ai që qimen e flokut e ndan katër pjesësh për së gjati. Do të shpëtoj ty dhe ata që besuan si ti [që bënë tobe]”

Ky ishte vëllezër besimtarë lajmi ose mesazhi për Tobe=për pendesë që i erdhi prej Allahut xh. sh. murshides Aishe rahmetullahi alejha për mbarë popullin në Shqipëri. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se kjo tobe është e domosdoshme për gjithë njerëzit kudo në botë=për gjithë ymetin e Muhamedit a. s. Kurani thotë: “Allahu ia fal [gjynahet=fajet] atij që pendohet; e mëshiron atë që përmirësohet. ”S. Tobe. ajeti. 102. Përsa i tokon zekati e haxhit murshidja Aishe thoshte se këto i kan detyrë të pasurit dhe në haxh shkohet nëse rruga është e lirë. Ndërsa këtu në Shqipëri në këtë kohë sot, qeverija nuk të len me shkuar për të kryer haxhin. Kur rruga të jetë hapur atëherë çdo besimtarë që është i pasur e ka farz=e ka detyrë haxhin.

Vëllezër besimtarë; Allahu xh. sh. ka thënë në Kuran; “Le

të ruhen ata [njerëz] që veprojnë në kundërshtim me urdhërin e Tij, mos ti godasë ndonjë ngatërrësë ose mos ti godasë ndonjë dënim i dhëmshëm [azab=dënim pikllus]". S. Nur. ajeti. 63. Me të vërtetë, Allahu xh. sh. i bëri realitet fjalët e veta paralajmëruse sikurse do ta tregojmë këtë gjë me fakte më poshtë gjërësishtë. Dënimi i dhimshëm=azabi pikëllus ndodhi vërtetë në vendin tonë. Populli në Shqipëri vuajti shumë nën një diktaturë të fortë dyzet vjet e cila ishte nga diktaturat më të egra në Evropë që nuk e kishte parë e dëgjuar ndonjëherë populli ynë. Populli u përçan e u vranë duke luftuar njëra palë kundër tjetrës. Gjatë shërbimit të sajë dyzet vjeçarë, si do ta shihni më poshtë, muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, mori shumë lajme; njoftime, sqarime e udhëzime të ndryshme prej Allahut të madhëruar me inspirim=frymëzim, me folje pasë perdes, me melek dhe me anë të rruëjas=ëndërrës së qartë e të vërtetë mes gjumit e zgjimit, të shumtat në kohën para namazit të sabahut. Për mynyrën se qysh Allahu xh. sh. i foli atyre njerëzve që deshi, Ai këtë gjë e tregon në Kuran siç e thash më sipër ku thotë: "Nuk ka asnjë njeri që ti ketë folur Allahu ndryshe vetëmse me anë të frymëzimit, pas perdes [pas një pengese në mynyrë të pa dukshme] ose ti dërgojë të dërguar [melek=engjëll] e ai ti shpalli me lejen e Tij [e Allahut] atë që do Ai [Allahu xh. sh.] ." S. Shura. Ajeti. 51. Siç e kam thënë më lartë dhe do ti shihni më poshtë, këto njoftime që mori nga Allahu xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha kan të bëjnë me popullin në përgjithësi, për njerëz të veçantë të çdo klase e kategorije dhe për ngjarje të veçanta që ndodhën në vëndin tonë.

10-MUXHEDIDJA AISHE FILLOI TI KOMUNIKOJË POPULLIT

LAJMIN E ALLAHUT XH. SH. QË NJERËZIT TË BËJNË TOBE.

E befasuar nga kjo gjë që më ndodhi thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, shkova me një herë përsëri tek dijetari i njohur Islam në vëndin tonë Hasan Tahsini nga Shkodra me prejardhje nga Podgorica. Populli i Tiranës e thërriste atë për respektë Hasan Beu. Ai ishte profesor i gjuhës shqipe dhe arabe në medrese në e Tiranës. Unë thoshte Aisheja e kishim Hasanin në mëhallë

ishim komëshij me të. Të nesërmen në mëngjes shkova në shtëpin e Hasanit dhe e gjeta Hasan Begun duke kënduar Kuranë ndërsa grua e Hasanit po fshinte e pastronte shtëpinë. Hasani nuk vonojë së lexuari dhe e mbylli Kur'anin me respektë e dua, dhe pastajë u përshëndetëm. Unë pastaj thoshte Aisheja i tregova atijë çfar dhe si më kishte ndodhur. Porsa unë e mbarova fjalën Hasani me sytë e përlotur nga gëzimi dhe me zërin pak të ngritur tha; Tani paska zbritur rahmeti-mëshira e Zotit xh. sh. për neve [për këtë popull]. Unë tha Aisheja rahmetullahi alejha i thashë, po inshallah, nëse i bindet populli urdhërit të Allahut xh. sh. Inshallah të njëjtën fjalë e përsëriti edhe dijetari i fesë Hasan Beu. Ti Aishe nuk gënjen më tha Hasani se unë të njoh mirë ty. Pastajë unë thoshte murshidja Aishe i thash Hasanit tregoja këtë lajmë tani Asijes gruas tënde. Hasani më tha : Jo Aishe, thuaja ti vetë me gojën tënde se goja jote ka forcë më shumë, pasi ty ta ka dhënë Allahu xh. sh. këtë dhuratë, ty të preferoi Ai. Por më vonë thoshte muxhedidja Aishe, Hasan Beun e futi djalli mallkuar në dyshim. Nga frika e rregjimit komunist ndoshta ai ka menduar se çështja e tobës është ndonjë gjë e kurdisur nga njerzit për qëllime tjera dhe kështu ai nuk e ndalojë gojën nga shirku gjuhësorë që ishte kushti i parë i tobës por vazhdojë që të bëjë shirk dhe kështu siç do ta tregojmë më poshtë sipas njoftimit që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe, përfundimin në ahiret Hasan Tahsini= [Hasan Beu] e pati jo të mir me gjithëse ishte njeri i ditur shumë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte gjithmonë kështu: "Tobja është ajo që i shoshit=i dallon mir punët e njerëzve." Hasan Beu ishte në tarikatin Tixhanij. Që nga ajo ditë murshidja Aishe filloi ti komunikoi popullit lajmurdhëresën për tobe, të gjithve pa përjashtim, muslimanëve e kristjanëve me përjashtim të hebregjeve ose çifutëve thoshte ajo, që nuk mora urdhër ti thërras në tobe. Kjo ndoshta sepse në Shqipëri ata nukë njiheshin. Kishin ardhur pasë luftës së parë botërore e fillimit të së dytës vëtëm disa familje për ti shpëtuar përndjekjes së gjermanëve ose e vërteta është se Allahu xh. sh. çifutë ose hebretë i ka mallkuar në Kur'anë. Por për këtë gjë se përse nuk mora urdhër nga Allahu xh. sh. që ti thërras çifutët në tobe, un nuk mora njoftim nga Ai thoshte muxhedidja Aishe. Allahu. xh. sh. e di të vërtetën se përse porë e dijë thoshte ajo se çifutët janë të mallkuar nga Allahu xh. sh. Vërtetë Kurani thotë; Për shkak

se ata [çifutët] e thyen premtimin e tyre [besën që i patën dhënë Allahut xh. sh. nëpërmjet pejgamberëve të dërguat tekë ata], Ne [thotë Allahu xh. sh.] i mallkuam ata. ” . S. Maide. aj. 13. Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë; ‘Ne i shpërndam ata [çifutët=jahuditë ose hebrejtë] në grupe në tokë [nëpër botë]. ”S. Araf. aj. 168. Muxhedidja Aishe vazhdoi ta kryej detyrën e thirrjes së popullit në Tobe=në pendesë pa asnjë shpërblim nga njerëzit porë përkundrazi me shumë mundime ajo shkoi nëpër qytete e fshatra të Shqipërisë me financën e sajë. Ajo i lajmëronte njerëzit për tobe kudo që ti gjente; nëpër shtëpia, në sheshe, në xhamia e në rruga duke shfrytëzuar rastin edhe gjatë ecjes me trenë ose autobus. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e kreu shërbimin e ngarkuar nga Allahu xh. sh. në kushte të rënda politike të asajë kohe dhe me shëndetin jo të plotë pasi ajo më vonë vuajti nga reumatizma, veshkët dhe pak nga sëmundja e sheqerit=diabeti. Murshidja Aishe ju thoshte njerëzve : “Un jamë balta e këpucëve të Pejgamberit a. s.=profetit Muhamed a. s. por jam e dërguar me shërbim nga Allahu xh. sh. për ta thirr popullin tim në tobe por nuk ka dyshim se kjo tobe është e domosdoshme për të gjithë njerëzit kudo në botë”. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuranë thotë; “Pendohuni të gjithë te Allahu, o besimtarë, në mynyrë që të gjeni shpëtim. ”S. Nurë=Kapitulli Drita. aj. 103.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte sikur e thash më sipër se jeta e njerëzve në tokë ka filluar pasi njeriu i parë Ademi bëri tobe atëherë Allahu xh. sh. e zbriti pastaj çiftin e parë të njerëzve në tokë. Po kështu jeta në tokë do të marrë fund pas lajmit prej Allahut xh. sh. për të bërë tobe=për tu penduar. Pas këtij lajmi të fundit për të bërë tobe njerëzit për të këqiat që kan bërë në tokë, ata do të largohen përsëri nga kjo botë.Pas fjalëve që i diktoi Allahu xh. sh. Ademit për të bërë tobe filloi jeta e njerëzve në tokë dhe përsëri pas lajmit për të bërë tobe pasardhësit e Ademit do të marri fund jeta e njerëzve në tokë.

11-MUXHEDIDJA AISHE LAJMËROI PËR RREZIKUN E SHIRKUT GJUHËSORË.

Në 5 e 6 vitet e para, përhapja e lajmit për tobe, pati shumë jehonë në popull, filluan të mbushen xhamiat me njerëz pasi patën

qenë, pothuajëse të boshatisura. Por e keqëja ishte se njerëzit nuk u larguan nga shirku me gojë. Populli në përgjithësi me përjashtim të disa njerëzve të pakët vazhdonin të bënin shirk në gjuhën shqipe duke i përdorur gjithënjë për njerëzit emrat ose shprehjet; Zoti, i Zoti, im Zotë, Zotni, Zotneshë e Zotnush ose Zonjë e Zonjush, e Zotëroj, e Zotëron, Zotohem e Zotohet, Zoti i vetes, ose filani ka Zotësi, unë i dal Zot ose ai i del për Zot, jam Zoti i kësaj ose ai është Zoti i asaj gjëje esagfirullah, estagfirullah, estagfirullah. Allahu xh. sh. i ruajtë besimtarët e Tij nga kufri nga shirku i madhë. Po ashtu edhe ata njerëz që dinin gjuhë tjera, vazhdonin ti thirrnin njerëzit për ti respektu me emrin e përveçëm që në atë gjuhë thirrej Zoti xh. sh. Maqedonisht i thirrnin Gospod ose Gospodin, greqisht, Theos, ose qirja, sërbsishtë Bog, italishtë Dio ose Don që don dotë thotë, im Zot ose Zoti im, persishtë, Mullah, që do të thotë shqip Allahu im ose ndryshe Zoti im ose im Zot, dhe arabishtë indirektë me për emrin Meuvlana=i lartë madhëruari.

Muxhedidja Aisheja tha se pasi edhe njerëzit që falnin namazë nuk po largoheshin nga shirku me gojë, Allahu i madhëruar më solli mua tha ajo, këtë lajmë që tua themi atyre: "Thuaju ti atyre [njerëzve]: Nëse do të thërrasin njëri, tjetrin me atë emër që më thërrasin Mua në gjuhën e tyre, [pasi u lajmëruan] namazin do tua shkruaj atyre për idhujt. Nëse ata të thonë ty, ne nuk i falemi idhujve si popujt e mëparshëm të paditur, ti thuaju atyre; idhuj jeni bërë ju për njëri, tjetrin, pasi po e thirrni njëri,tjetrin me atë emër që thirrni Allahun në gjuhën tuaj. Të gjithë ata që do të më bëjnë mua shokë e ortakë do ti fus në xhehenem". Nga ky lajm që ka marrë muxhedidja Aishe prej Allahut të madhëruar, kuptohet qartë që, ata njerëz që nuk e njisojnë Allahun xh. sh. në gjuhën që flasin, Ai do ti fusi ata në regjistrin e atyre që nuk janë muslimanë. Allahu xh. sh. në Kuranë thotë; "Për Allahun ty të është shpallur, por edhe atyre para teje; Nëse i bën shokë [Allahut], veprat tuaja [të mira o besimtarë] janë të asgjësuar [të pa regjistruara-të pa pranuar], dhe ti [o besimtarë] do të jeshë prej të humburve." Sure Zumer Aj 65. Të humburit janë ata që nuk janë në fenë e vërtetë Islame. Kur Aisheja i komunikonte popullit lajmin e Allahut xh. sh. për të bërë tobe, hoxhallarët në përgjithësi i thoshin asaj; Ne nuk kemi nevojë për tobe se ne kemi Kur'anin, dhe i falemi e i lutemi Allahu xh. sh. Aisheja u thoshte atyre kështu; Tobja është nga Kurani dhe

Kur'ani thërret për të bërë tobe porë ju nuk po e zbatoni Kuranin. Ju po i bëni shokë Allahut xh sh. Ashtu sikurse populli i pa ditur, edhe ju po i thirrni njerëzit me atë emër që thirrni Allahun xh. sh. në gjuhën që flisni. Kjo gjë që bëni ju është shirk i madh, është padyshim qyfer-kufër. Ju me gojën tuaj [në praktikë] vërtetoni se jeni në kundërshtim të hapur me Kuranin. Vërtetë Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “E kushë i bën shok Allahut është sikur të jetë gremisur nga qielli; sikur ta ketë rrëmbyer shpendi[grabitqarë] ose sikur era e stuhishme ta ketë përplasur në ndonjë vënd të humbur”. S. Haxh. aj. 31. Allahu xh. sh. thotë: “O ju që besuat... mos ndiqni rrugën e djallit sepse ai është armiku juaj i hapët, e nëse devijoni pasi iu kanë ardhur argumentet e qarta, ta dini pra se Allahu është i plotëfuqishëm, i vetëdijshëm”. S. Bekare. ajeti. 208. Vërtetë dhe dijetarët e fesë ashtu si populli, kishin ra me kohë në këtë shirk, në kufër=në krim ndaj Allahut të madhërshëm të cilin e kishin mësuar duke imituar në të folur të krishterët. Ata nuk e ruajtën gojën nga shirku=nga krimi ndaj Zotit xh. sh, por i thirrën njerëzit dhe veten e tyre Zoti ose Zotni, Zotnesh ose Zonjë, Zotnush ose Zonjush, im Zot=Zoti im, e Zotnoj, ose kam Zotsi, Zotohem, i Zoti, e Zotëroj, i dal Zot, jam Zoti vetes e tj. Estagfirullah estagfirullah. Në gjuhën persishte atë njeri që kishte dituri feje e thirrnin Mullah që do të thotë në gjuhën shqipe Allahu im ose im Zot ose Zoti im. Në maqedonishtë i thirrëshin Gospod, Gospoda ose Gospodin dhe greqishtë i thirrnin Qirja ose Kirja. Ndërsa Kurani thotë: “Kush i bën shokë Allahut [Zotit] është i humbur dhe i larguar nga e vërteta”. S. Nisa aj. 116. Kur i pyeste populli dijetarët e fesë= hoxhallarët për këtë gjë, ata ju thoshin; Nuk ka gjë të keqe se ne i themi pa qëllim këto shprehje. Ne nuk e besojmë njeriun për Zotë estagfirullah. Ne e dimë se ai nuk është Zoti. Muxhedidja Aishe ju thoshte atyre; Atëher përse ju i thoni ashtu njeriut kur e dini? Ata i thoshin asaj; Ne i themi për respekt. Ajo ju thoshte se kjo që bëni ju është shirk i madh që Zoti xh. sh. këtë faj nukë jua falë kurrë juve. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se kam marrë këtë lajmë prej Allahut xh. sh. kështu: “Kush bën shirk duke më vënë Mua [tha Allahu xh. sh.] shokë e përngjasim, pasi të jetë lajmëruar për këtë çështje, ai njeri nuk pranohet për Muhamedanë, [është fjala nuk është me Muhamedin=nuk është në rrugën e Muhamedit a. s.] dhe kush nuk pranohet për Muha-

medanë [Kush nuk është me Muhamedin a. s.] nuk pranohet [ke Allahu xh. sh.] për musliman". Vërtetë kjo fjalë është prej Allahut xh. sh. se Ai në Kuran ka thënë: "Kush i bindet Pejgamberit, iu ka bindur Allahut, E kush refuzon, Ne [thotë Allahu xh. sh.] nukë të dërguam ty roje kundër tyre. ". S. Nisa. aj. 80. Profeti Muhamed a. s. i këshillonte gjithmonë shokët që të kenë kujdes nga shirku i çdo lloj forme. Ai nuk ka lejuar ta titullojnë ose cilësojnë me tjetër titull, vetëmse me këto; Resullallahu-i dërguari i Allahut-i dërguari i Zotit xh. sh. ,Habiballah=i dashuri i Allahut xh. sh, Nebijallah, lajmëtari ose pejgamberi i Allahut xh. sh. Muxhedidja Aishe që Allahu xh sh, e mëshiroftë u thoshte dijetarëve të fesë se kam urdhër nga Allahu xh. sh, që ti lajmëroj njerëzvet se është shirkë=krim ndaj Allahut xh. sh. që të thërrasësh njeriun me atë emër të veçantë=të përveçëm me të cilin thërret Allahun xh. sh. në çdo gjuhë.

Të tillë emrash të ndaluar në gjuhë të ndryshme për të thirrë njerëzit sikurse e thashë janë; Gospod ose Gospodin në gjuhën maqedonishtë, Bog sërbsishtë, Theos ose Qirja, greqishtë, Gad, anglishtë, Mullah persishtë, Dio ose Don italishtë, Mevlana indirektë arabishtë, e kështu si këto në çdo gjuhë tjetër të botës. "Si në atë kohë edhe sot shumica e njerëzvet thonë të njëjtën fjalë si të parët e tyre; i themi Zoti njeriu në gjuhën që flasim por i themi për respekt pa qëllim. Estagfirullah, estagfirullah, estagfirullah. Kjo fjalë që thonë ata është kundër fesë por dhe në kundërshtim me mendjen=me llogjikën e shëndoshë. Njeriu është njeriu dhe Zoti është Zoti xh. sh. që ka krijuar njeriun dhe gjithsinë. Ne i thoshin në pëgjithsi hoxhallarët, shehelerët dhe populli pas tyre muxhedides Aishe rahmet past e dëshmojmë me gojë në gjuhën arabe fjalën La ilahe il-lallah=nuk ka tjetër Zot veç Allahut xh. sh. Ndërsa murshidja Aishe ju thoshte atyre: Ju vërtetë në gjuhën arabe e thoni fjalën e dëshmisë = "Nuk ka tjetër Zot veç Allahut xh.sh." por në gjuhën shqipe ju po e kundërshtoni këtë fjalë pasi po thirrni edhe njeriun me këtë emër që thërrni Allahun xh. sh.

A nuk mendohi për këtë gjë?. Pa dyshim o vëllezër besimtar dëshmija me gojë është faktë i pa kundërshtushëm. Teuhidi=njisisimi i Zotit xh. sh. është ndarë nga dijetarët Islam në tre llojesh. 1Tuhidi-Rrububije-me besuar se Zoti xh. sh. është një i vetëm dhe nuk ka ngajshmëri me askënd. 2 Teuhidi El Ibade- me i ba detyrat fetare

me qëllim të pastër për të fituar kënaqësinë e Zotit xh. sh. 3 Teuhidi Esma ue Sifaat që do të thotë njësimi i emrit të Zotit xh. sh. në çdo gjuhë.

Për dëshminë e cila bëhet me gojë Allahu xh. sh. thotë në Kuranë; "Ju po dëshmoni [po e faktoni vet me gojë] se përveç Allahut ka dhe Zota tjerë; Thuaju [o i dërguari im atyre] unë nuk dëshmoj [nuk deklaroj si ju]; Ai është vetëm një Zot..." S. En-nam

A. 19. Dijetari Arab Hafudh Ibën Ahmed Hakemi në librin e tij pyetje dhe përgjigje ka thënë; Nga kushtet e fjalës së teuhidit-fjalës La ilahe il lallah=Nuk ka tjetër Zot veç Allahut, janë; ta dish kuptimin e kësaj fjale, çfar do me thënë=çfar vërteton dhe çfar e mohon=e kundërshton këtë fjalë. Do me thënë ti qëndrosh besnik kësaj fjale në çdo gjuh që flet. Ta duash me shpirtë këtë fjalë, ti nënshtrohesh kësaj fjale me besim dhe me veprime dhe të duash e të urreshesh për nderim të kësaj fjale=ti duash ata që e pranojnë këtë fjalë e ti urresh ata që e kundërshtojnë. Vëllezër musliman; Kjo fjalë në Kuran quhet fjala e fortë. Kurani thotë; 'Allahu forcon ata që besuan në fjalën e fortë në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër ndërsa mizorët [rrebelusat=të pa bindurit] Allahu i bën të humbur. "S. Ibrahim. aj. 27. Për besimin dhe qëndrimin besnikërisht në këtë fjalë Allahu xh. sh. në Kuran thotë; "Ata që thanë Allahu është Zoti ynë dhe qëndruan besnikërisht [nuk e mohuan këtë që than në asnjë lloj gjuhe e forme] për ata [njerëz] nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikllohen...". S. Ahkaf. aj. 13. Në Inxhil fjala la ilahe il lall-llah është quajtur

'Fjala e Madhe' Në Ungjillin ose Biblën e sotme thuhet Zoti është Zoti e askush tjetër. =[Kapitulli=Urdhëresa e Madhe. "Kuptohet qart se kuptimi e përkëthimi rregullishtë është kështu; "Nuk ka tjetër Zot veç një Zoti"E pa dyshim Zoti xh. sh. është ai që ka krijuar botën 'Krijusi i Gjithësisë' nuk është Mesihu=Isai i biri i Merjemes r. t. a. që kristjanët e quajnë Jezusi i biri i Marijes. Dijetarët e parë dhe populli musliman pas tyre dikur kristjanët i thirrnin kaurë= kaurrit=mohusat e së vërtetës. Me gjith atë besimi gabim ose cilsimin gabim i Zotit xh. sh. është puna e tyre Ata do të kenë përgjegjësi para Zotit xh. sh. në ditën e llogarisë. Kristjanët i thonë Jezusit "Krishti" që do të thotë në gjuhën shqipe 'Shpëtimtari' dhe veten e tyre ata e quajnë të kristianë e cila fjal shqip do të thotë "të shpëtuarit" Ata i kan thënë vetes ashtu = e kan quajttë

Ashtu veten se Allahu xh. sh. nuk ju ka thënë atyre ashtu por përkundrazi atyre ju ka thënë në Kuran të "Humbur" e ndërsa çifutëve ju ka thënë të "Mallkuar". Ndërsa muslimanëve ju ka thënë "Muminunë e Muslimanë"=besimtar dhe të sigurtë-të bindur e të nënshtruar ndaj Zotit xh. sh. Lajmi që i erdhi prej Allahut xh. sh. muxhedides Aishe për kristjanët ishte kështu: "Thuaju atyre që i than vetes kristianë" Këto fjalë të folura ose të diktuar në këtë mynyrë janë pa dyshim prej Allahut xh. sh. dhe jan me shum kuptim, janë me domethënje të madhe. Prandaj siç e thash më sipër dijetarët e parë Islam të bazuar në Kuran dhe populli pas tyre para 100 vjetësh nuk ju thoshin atyre të krishterë=që do të thotë= "të shpëtuar" se ata nuk janë të shpëtuar por ju thoshin atyre kaurë =kaurr=qafir=kaurrit=mohusat e Zotit të vërtet, me cilsitë e plota që ka Ai se ata e bëjnë Zotin njeri dhe njeriun e bëjnë Zot. Estagfirullah, estagfirullah, estagfirullah. Dhe që e kishim fjalën për shirkun me gojë, Zoti xh. sh. në Kuran thotë; ". . . Të mos konsiderojmë=mos ta quajm=mos ta titullojmë njëri tjetrin Zotër përveç Allahut [përveç Zotit xh. sh.]. " S. Ali Imranë. A. 64. Dhe thotë Allahu xh. sh. në fomë pyetje e çudije; "A din ti [o njeri] që unë të kemë emnak=adash? S. Merjem A 65. Sikurse dihet adashë quhen dy vetë me të njëjtin emër. Në suren Enbija Allahu xh. sh. thotë; " Kushë i thotë vehtes se un jam Zoti veçë Atij [Allahut] dënimi për atë njeri është xhehenemi. " S. Enbija A. 29. Atëher kurrë ti o besimtarë nuk duhet të thuash jam Zoti i kësaj ose i asajë gjëje ose i dalë për Zotë asajë estagfirullah estagfirullah ose të pranosh të thonë të tjerët ty Zoti ose Zotnija, i Zoti, e Zotnon estagfirullah, estagfirullah. Kurani thotë: "Nuk ka tjetër Zot vetëm ai që jep jetë dhe vdekje. "S. Duhan. A. 8.

O ju njerëz që besoni në ekzistencën e Zotit të plotëfuqishëm. Duhet ta keni të qartë se emrat e përveçëm me të cilët thirret Allahu xh. sh. në çdo gjuhë të botës i kan përdorur për njerëzit ateistët=ata që nuk bësojnë fare në ekzistencën e Zotit xh. sh. që është Krijuesi i Gjithësisë. Këtë gjë na e tregon Allahu xh. sh. në Kuranë që thotë; "A mos menduan ata që nuk besuan se veç meje mund të marrin-mund të quajnë ose titullojnë Zot njerëzit e mi?

Ne [thotë Allahu xh. sh.] kemi përgatitur xhehenemin vend pritje [për qafirat mohusat]. S. Kef aj. 102. Më qartë kuptimi është; Thotë Allahu xh. sh. A e kanë menduar mirë[qafirat] a e kanë bërë

mirë llogarinë qafirat se përveç meje mund të madhështojnë duke i quajtur zotër veten dhe të tjerët?

12-GJYNAHIN E SHIRKUT-VËNJEN SHOKË E ORTAKË ALLAHUT XH. SH. NË ÇDO LLOJË MYNYRE, ALLAHU NUK JA FAL ASKUJTË.

Përsa i takon shirkut për ata që e besojnë Zotin-Allahunxh. sh. Kurani thotë: "Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun vetëmse duke i shoqëruar [Zota të tjerë]; A mos janë të siguar ata prej dënimit që mundë tu vinjë nga Allahu e ti mbulojë, ose befas duke mos e hetuar fare tu vië katastrofa e përgjithshme[Kijameti]; Thuaju [njerëzve] kjo është rruga ime e vënë në fakte të qarta që un thërrasë tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje...." Sure Jusuf A 106, 107, 108. Disa nga muslimanët i thoshin murshides Aishe; Ne e dimë moj Aishe që njeriu nuk është Zoti, por na është mësuar goja kështu. Këto fjalë=këto tituj me zotësi i kan folur edhe më par të parët tan të diturit dhe të pa diturit. Fjalët e tyre për ta shfajësuar veten ishin njëllojë si fjalët e idhujtarëve që i thoshin Pejgamberit a. s. në atë kohë se; Ne e dim që idhujt nuk janë Zoti por i respektojmë se kështu e kemi gjetur këtë gjë nga të parët tanë. " Por Allahu xh. sh. në Kuranë thotë; "Është e vërtetë se Allahu nuk e fal shirkun=krimin ndaj Tij, veç këtij gjynahu ia falë të tjerat atij që do. ". S. Nisa. A. 116. Allahu xh. sh. thotë "Nëse i bën shokë Allahut veprat tuaja [të mirat tuaja] janë të asgjësuar [të fshira=të pa pranuar] dhe do të jeni prej të humburve. " S. Zumer aj. 65. Dihet se të humbur janë të vetquajturit të krishterë se ata i thonë Zoti njeriut estagfirullah, i thonë Jezusit dhe priftërive të tyre. Allahu xh. sh. në Kuran thotë; "Le kad kaferel-ledhine kalu innallahe huve'Imesi h'ubnul Merjem..."=Betohem se vërtetë u bënë qafira =[u bënë mohusa=mohuan të vërtetën] ata që thanë se Meshu- Isai ibiri Merjemes është Zoti..." Ai që i përshkruan Zotit shok Ai ja ka ndaluar atij [njeriu] xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. "S. Maide.ajeti 72. Sikurse e lexoni ajeti thotë ata than e nuk thot besuan e thënja dihet që del nga goja. Ata e kan të qartë se Krishti nuk është Zoti por i than në atë kohë dhe i thonë dhe sot Zoti estagfirullah. Por Krishti=Isai a. s. dhe Muhamedi a. s. dhe të tjerë para tyre kanë qenë të dërguarit e Zotit xh. sh. që u sollën njerëzve mesazhin

e Tij. Po ti pysesësh besimtarët kristjanë se kush e ka krijuar botën? Ata të thonë; e ka krijuar Zoti e nuk të thonë e ka krijuar Krishti se bota ishte e krijuar para Krishtit. Të krishterët dhe gjithkush e di se Jezusi ishte njeri si gjithë njerëzit. Mirpo ata e mohojnë të vërtetën dhe e besojnë atë për Zot estagfirullah. Ata jo vetëm 'Jezu Krishtit' por dhe priftërive të tyre si atëherë dhe sot ju thon zoti ose ndryshe im Zot filani. Estagfirullah, estagfirullah. Këtë gjë na e tregoi Allahu xh. në Kuran ku thotë; 'Ata i quajtën ruhbanët [murgjit=priftërijtë] e tyre dhe Mesihun [Isain] të birin e Merjemes për zota veç Allahut [veç Zotit-Krijusit të Gjithsisë]...S. Tobe. aj. 31. Kristjanët besimtarë vërtetë besojnë në Zotin xh. sh. por nuk e besojnë Zotin xh. sh. me cilsitë e plota që ka Ai. Ata besojnë në një Zot njeri e në një njeri Zot. estagfirullah, estagfirullah. Zoti i vërtetë=Allahu xh. sh. i ruajtë besimtarët e tij nga besimet e kota e fjalët jashtë llogjikës. Mirpo fatëkeqsishtë edhe vëllezërit tanë muslimanë kudo në botë me përjashtim të Arabëve dhe Turqëvet, ka më shumë se 100 vjetë me gojën e tyre po i thonë direktë njeriut Zoti estagfirullah, në çdo gjuhë që flasin duke e marrë këtë fjalë nga të krishterët në kundërshtim me fenë e tyre Islame. Allahu xh. sh. i drejtoftë tani e prapa se ky është shirk i madh, është krim ndaj Allahut xh. sh. që ne në gjuhën shqipe e thërrasim atë Zoti xh. sh. Kjo gjë jo vetëm nga ana fetare Islame që është e dënuar por edhe nga ana llogjike sikurse e thash është e pa pranushme. Nuk thirret edhe Allahu xh. sh. edhe njeriu Zoti estagfirullah. Gjithashtu nuk pranohet kjo gjë edhe nga ana gjuhësore. Është jashtë rregullave gjuhësore që emri i përveçëm Zoti xh. sh. të bëhet i përgjithshëm. Ebu Hurejre-sehab=shoku i Pejgamberit a. s. ka thënë; "Titulli ose emri më ofendusë tekë Allahu xh. sh. të cilin titull mundë ta pretendojë çdo njeri është ai titull apo emër që thirret Krijusi i gjithësisë. Nuk ka tjetër me këtë titull, nukë duhet të thirret askushë tjetër veçë Allahut xh. sh. me këtë titull=me këtë emër. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Kush do që thotë se nuk ka tjetër Zot veç Allahut një i vetëm dhe kundërshton që ti lartëmadhërojë krijesat tjera ashtu sikurse lartëmadhëron Allahun, atij njeriu Allahu xh. sh. do të ia mbrojë gjakun, kokën, pronën dhe fatin e tij. Trans Buhariu. Si guxonë besimtarët musliman në kundërshtim me Kuranin thërrasin njëri tjetrin Zoti, i Zoti, Zotnia, Zotnesha ose Zonja e Zotnusha ose Zonjusha, i del ose i dal Zot, Zotohet, e Zotnon, im Zot ose

ndryshe do të thotë Zoti im [estagfirullah] që kristjanët kështu i thonë priftit; Disa muslimanë në vendë të fjalës turqishtë efendi= që do të thotë në shqip i nderuar i thonë shehut ose hoxhës persisht Mullah që do të thotë në gjuhën shqipe Allahu imë=Zoti im ose im Zot. Estagfirullah, estagfirullah. e stagfirullah. Deri këtu në këtë faj të madh, në këtë kufër të madhë i ka futur shejtani mallkuar muslimanët duke folur edhe ata si kristjanët. Gjithashtu shprehjet në format tjera si përshembull, Zoti i vetes, Zoti shtëpisë, Zoti i tokës, të Zotët e mëndjes që do të thotë Zota me mend=Zotat e mençur ose mendje Zotat estagfirullah. Allahu xh. sh. i faltë ata që se kan dijtë e se kan kuptuar këtë hile të ateistëve-dexhalëve dhe qafirave=mohusëve të së vërtetës. Largohuni menjëher o besimtar nga fjalori i ateistëve=nga fjalët që flasin ata në kundërshtim me ligjin e fesë e jo vetëm nga veprimet e tyre. Sikur e thash më sipër Allahu xh. sh. thotë në Kuran; "Nuk dërguam të dërguar veç se nga gjiri i tyre [nga ai popull] e ai [i dërguari] me gojën e tyre=në gjuhën e tyre tua spjegoi të vërtetën. "Ka shumë koh por sot më shumë se kurrë ateistave=dexhalëve me pozita të larta dhe me pasuri të madhe në çdo vend të botës, jua ka rritur djalli i mallkuar mendjen dhe duan që populli në çdo gjuhë që flasin, ti thërrasin ata me emrin e përveçëm që në atë gjuhë thirret Krijuesi i Gjithësisë-Allahu xh. sh. Në gjuhën shqipe duan që ti thërrasin Zoti ose Zotni dhe Zotnesha ose Zonja e Zotnusha ose Zonjusha. Siç jua thash më sipër po jua theksoj dhe një here; Mos i përdorni ju o besimtar për veten tuaj dhe për të tjerët fjalët; jam i Zoti e Zotnoj, i Zoti i e asaj, e Zonja, të Zotët, Zotnoj, ai e Zotnon ka Zotësi, i dal per Zot ose ai i del Zot se Do ta fikni veten tuaj o besimtar. Nuk do të jua pranoi Allahu xh. sh.namazin, agjërimi e çdo punë të mir. Mos flisni ju o besimtar të Allahut xh. sh. fjalë kufri si kristjanët e ateistat. Nuk duhet ta thotë besimtari fjalën mbizotëroj. Nuk ka tjetër Zot mbi Zotin e madhruar o besimtar. A e mendon fjalën kur e fol ti o besimtar ? Zoti xh. sh. në Kuran thotë: "Thuaj: Sikur të kishte zota tjerë përveç Atij sikundër thonë ata, atëherë ata [zotat tjerë] do të kërkonin rrugë për mbizotërim ndaj të Madhëruarit [për të dal mbi Zotin e madhruar, Zotin e plotfuqishëm për ti marrë pushtetin = fuqinë atij] i pa të meta është Ai [Allahu=Zoti xh. sh.]. Lartësia [epërsija e fuqia] e Tij është e madhe nga ajo që thonë ata [njerëzit e humbur]. Lartëmadhëri të merituar i shprehin atij shtatë qiejtë dhe toka. "S.

Isra. aj. 42, 43, 44. O ju besimtar bëni menjëherë tobe=pendohuni. Kurani thotë; 'Allahu ia falë [fajin] atij që pendohet se e mëshiron atë që përmirësohet''S. Tobe aj. 102. O besimtarë të Allahut xh. sh. mos i thirrni njerëzit që janë krijesat e Zotit xh. sh. me atë emër që ju në gjuhën tuaj dhe çdo gjuhë tjetër që flisni thirrni Allahun xh. sh.=Krijusin e Gjithësisë se do të jeni të humbur dhe Allahu xh. sh. pa dyshim do të ju fusi juve në xhehenem se Allahu xh. sh. nuk e fal shirkun. Po jua kujtoj dhe njëherë fjalën e Allahut xh. sh. i cili thotë : ''Pa dyshim Allahu nuk e fal [gjynahin] e të bëmes shok

Atij, e përveç këtij [gjynahi] të tjerat ia fal atij që do. Kush i bën shok Allahut [Zotit] ai [njeri ose xhind] ka trilluar [ka shpikur-ka bërë] një faj shumë të madh. ''S. Nisa. aj. 48. Ateistët e munafëkët bëjnë dredhina në fjalë, kur ju thua atyre, mosni kështu.

Ata në të gjithë botën kanë qëllim që ti kalojnë njerëzit nga ateizmi në politeizëm-në idhujtari. Njeriu ta njohë njeriun tjetër më të ngritur, në rrang pozite shtetërore ose pasurije, ta respektoj, ta njohë, ta shquaj atë për Zot, estagfirullah dhe për këtë gjë ata po i mësojnë-po i detyrojnë në një far mynyre njerëzit që ata ta faktojnë me gojën e tyre këtë gjë. Ateistët=dexhalat sot duan si titull nderimi emrin e përveçëm Zoti xh. sh. me të cili emër thirret Krijusi i Gjithësisë në çdo gjuhë që flasin njerëzit kudo në botë se ky emër, ky titull është më i madhi, më dashuri, më i lavdruar e më i respektuar nga besimtarët kudo në botë në çdo gjuhë. Besimtarët kurë e thonë ose e dëgjojnë emrin e përveçëm me të cilin thirret Krijuesi i Gjithësisë përgjithësisht me respekt në shenjë nderimi e frike dhe thonë fjalët xhele shanuhu=i lartësuar e i lavdruar është gjithmonë Zoti xh. sh. Prandaj o besimtar ta dini se ky është mashtrimi më i madh që po ju bën sot njerëzve në gjithë botën dexhali ose numrin shumë dexhalat=mashtrusat e mëdhenjë që ju ti thoni secilit nga ata Zoti estagfirullah e stagfirullah. Për ne besimtarët musliman që flasim shqip për ne Zoti xh. sh. është vetëm Allahu xh. sh. Pejgamberi a. s. ka thënë: ''Në ymetin tim do të dalin 30 dexhala të mëdhenjë=mashtrusa intrigantë të mëdhenj'' Që do të thotë teoricienë mashtrusa të mëdhenj. Ndërsa të vegjëlit që do tu shkojnë pas dexhalave të mëdhenjë kuptuhet qartë nga fjala e Pejgamberit a. s, se do të jenë me mijëra e miljona njerëz që janë ushtria e tyre. Është thënë nga Pejgamberi a. s. ; ''Nuk do të ketë asnjë vend të botës që nuk do të hyjë dexhali [që nuk do ta marri në dorë fuqin

nga çdo pikpamje njeriu dexhal = dexhalat=mashtrusat=anti fetarët], me përjashtim të Mekës dhe Medines''. Të bazuar në hadithin e Pejgamberit a. s. është thënë e shkruar nga dijetarët e parë Islam kështu; Ka për të dalë dexhali me shëtit gjithë dynjanë, mjerë gjynahëqari se të mirëve nuk ka çfarë i bën. E përsëris se dexhalë do të thotë njeri mashtrus i madh ose në numrin shumë njerëz mashtrusa të mëdhenj. Ashtu sikurse përmendet në numrin njëjës shejtani një shejtan qoftë mallkuar ai, por shejtana ka shumë, ashtu dhe dexhali në hadithin e Pejgamberit a. s. është përmendur njëjës, një dexhal por dexhala ka shumë. Për dexhalin do të japim sqarime më poshtë.

13-BESIMTARËT E ALLAHUT DUHET TË JENË TË KUJDESSHËM NË FE QË MOS TË BINË NË GRACKËN E QAFIRAVE E MUNAFIKËVE.

Ata që e besojnë Zotin xh. sh, duhet të kenë shumë kujdes kur ti lexojnë librat e ndryshëm, se fjalët e kufrit, fjalët me shirk janë shkruar në të gjitha librat. Janë shkruar edhe në librat e fesë të përkëthyer në gjuhë shqipe nga gjuha arabe, turke e persjane. Ateistët=qafirat e munafikët=dyfytirshit i kanë shkruar vetë me dashje në librat e tyre fjalët e kufrit, ndërsa besimtarët e Zotit xh. sh. kanë ra viktimat të thënjeve të qafirave duke mos e kuptuar kurthin e tyre. Besimtarët duhet të gjejnë fjalët e përshtatshme për ti zëvendësuar sipas rastit kur të flasim e lexojnë fjalët që formojnë kufër e shirk në gjuhën shqipe e në çdo gjuhë tjetër. Besimtarët e singertë e të zgjuar le ta mendojnë mirë kuptimin e hadithit të Pejgamberit a. s. i cili ka thënë; Kur do të vij dexhali [njeriu mashtrus i madhë=brezi i njerëzve mashtrusa të mëdhej] do tu thotë besimtarëve që ti thonë Zoti e stagfirullah atij [ose atyre]. " Ai ka thënë se dexhali [dexhalët] kanë për të shkelur [për të sunduar=për të qeverisur] gjithë dynjanë, mjerë gjynahqari se të mirit [besimtarit të mir] nuk ka çfarë i bën. "Vërtetë sot kjo ka ndodhur. Dexhalat=mashtrusat e mëdhej sotë janë me mijëra e miliona nëpër popujt e ndryshëm të botës, të cilët janë të lidhur me njëri tjetrin për të mbrojtur interesat e tyre politike dhe ekonomike. Kurrë nuk do të shpëtojnë besimtarët e Allahut xh. sh. nga sundimi i tyre në çdo vend të

botës për derisa të bëjnë tobe të vërtet= Tobe Nesuh. Ti japin besën Allahut xh. sh. duke u penduar sinqerisht dhe ti luten atij me lot në sy. Në radh të parë besimtarët e Zotit xh. sh. ta njisojnë Zotin e madhërshëm, Allahun xh. sh. në çdo gjuhë që flasin duke mos ju thonë më njerëzve Zoti, Zotri, Zotnjusha e Zonja i Zoti, i del Zot ose i dalë për Zot, e Zotnon ose Zotnoj, Zotohem estagfirullah në çdo gjuhë që flasin. Allahu xh. sh. i drejtoftë besimtarët e Tij. Për ndryshe Allahu xh. sh. njerëzit e pa bindur në dynja do ti lë nën shtypjen e dexhalave dhe në ahiret=[në botën tjetër pas vdekjes] do ti fusi në xhehenem ata njerëz që dëgjuan për këtë thirrje dhe nuk e pranuan. Allahu xh. sh. do ti fusi në xhehenem së bashku me dexhalat që ata i adhuruan-i respektuan duke i thirrur ata me atë emër të përveçëm që thirrën në dynja Krijusin e Gjithësis=Allahun xh. sh. duke ju thënë dexhalëve=[mashtrusave të mëdhej të pa fe] me gojën e tyre; Zoti estgfirullah, në çdo gjuhë që dijnë të flasin. Allahu xh. sh. thot në Kuran: "Thuaju O injorantë, a po më thirrni të adhuroj tjetër veç Allahut? . . . Ty të është shpallur. . . Nëse i bën shokë [Allahut], veprat tuaja janë të asgjësuar [të pa pranuar] dhe do të jeshë prej të humburve. S. Zumer. aj. 64, 65. Përse qafirat= mohosat e Zotit xh. sh. nuk e pranojnë të thirren për respekt me emrin shejtan filani ose djalli filan ? Si pas logjikës që përdorin ata, për ta fshehur të vërtetën që mos tu kuptohet qyfri ose kufri edhe shejtan ose djall nuk bëhet njeriu sepse i thua atij ashtu. Por emrin shejtan ose djalli filani ata nuk e duan si titull se e dijnë që është emër i keqë është emër i urryer i mallëkuar e i poshtruar nga njerëzimi brez pas brezi në çdo gjuhë të botës. Allahu xh. sh. i zgjofte dhe i udhëzofte besimtarët e Tij që të largohen nga shirku i madh që po bëjnë me gojë çdo cast, çdo ditë në çdo vend. Vërtet besimtarët musliman e ruajn në shpirt fjalën La ilahe il lallah, besimin në një Zot të vetëm pa shokë e ortakë i cili nuk ka lindur prej kujt dhe nuk ka lindur askend por ata në praktikë me gojë po e kundërshtojnë këtë fjalë çdo cast në jetën e tyre të përditshme. Pas njisimit të Allahut xh. sh. me gojë në çdo gjuhë duhet njisimi i rracës njerzore. Mos të bëjmë dallim rracial për shkakun e ngjyrës së fytyrës. Ta din mir besimtarët e Allahut xh. sh. se me fjalët ofenduse j evg e arrxhij, kuluf dhe evgjit kanë ofenduar rëndë indirektë shumë pejgamberë=profetë me ngjyrë të zezë si haz. Llukmanin e haz. Musain a.s. dhe shumë sehabë=shokë të profetit Muhamed a. s. ndër ta edhe muezinin e Pejgamberit a. s. Bilal Hbeshiun r.t.a.

e tjerë Profeti Muhamed. a. sishte nga fisi Benu Hashim dhe e kishte ngjyrën të bardh. Ai në një hadith ka thënë nuk është më i mir arabi mbi jo arabin e as i bardhi mbi të ziun por më i mir është ai që i nënshtrohet Allahut xh. sh. e bën vepra të mira.

“Fjalët ofenduse e përbuzëse për njerzit me ngjyrë të zezë i kan shpikur qafirat e i kan futur tek besimtarët për të futur ndarje dhe urrejtje ndërmjet besimtarëve me ngjyr të bardhë ndaj atyre me ngjyr të zezë. Ndërsa përsa i takon çështjes së martesave mes të bardhëve dhe të zivet të një feje të përbashkët është e lejuar nga ana fetare por jo e detyruar prej Allahut xh. sh. Allahu xh. sh. nuk i detyron njerzit ti përzijnë racat por përkundrazi Ai në Kuran thotë:

“Ju kam ndarë në kombe [popuj] e fise që të jeni të njohur [të dalluar] nga njëri tjetri”. Nga Kurani kuptohet se feja Islame është kundër globalizmit [përzirjes së popujve e zhdukjes së kombeve dhe etnive ose fiseve me tipare të ndryshme nga njëri tjetri edhe brenda një populli. Feja Islame nuk është kundër nacionalizmit. Ajo e pranon nacionalizmin = mbrojtjen e kombit e të identitetit kombëtar. Dhe siç e patëm fjalën më sipër për njerzit që i bëjnë shokë Allahut xh. sh. Ai thotë në Kuran kështu; “Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun veç se duke i shoqëruar [zotër tjerë]

A mos janë siguruar ata prej dënimit që mund tu vinjë nga Allahu e ti mbuloi [ti kapi-=ti zëjë nga çdo anë] ose befaz duke mos e hetuar fare, tu vinj katastrofa e përgjithëshme [kijameti]. ” S. Jusuf. Allahu xh. sh. e bëri realitet fjalën e vet paralajmëruse që ka thënë në Kuran dhe në kohën tonë me popullin shqiptar. Ai i pati thënë muxhedides Aishe rahmetullahi alejha se; “Nëse ata [populli] nuk do të bëjnë tobe [me kushtin e par njisimin e Allahut xh. sh. në çdo gjuhë] do ti ndëshkoj ata me një azab=dënim pikllus që sytë dhe veshët e këtij populli mos ta kenë parë dhe dëgjuar nga të parët e tyre ndonjë herë. “Vërtetë dënimi pikllues ndodhi dhe tani po vjen dhe kijameti i cili është shumë, shumë afër. Këtë dënim me anë të rregjimit komunist e pësuan pariya dhe vegjëlja. Për këtë flet historija. Treguan dhe vazhdojnë të tregojnë dëshmitarët e gjallë. Allahu xh. sh. i udhëzoftë sot besimtarët e Tij se nuk po dijnë se çfar po flasin por imitojnë në folje përsëri ateistat= mohusat e Zotit xh. sh. dhe flasin si ata që janë të humbur por që e quajnë veten “kristianë ” = “të shpëtuar”.

**14-NJOFTIMI QË I BËN ALLAHU XH. SH.
BESIMTARËVE NË KURAN PËR SHIRKUN
TË CILIN E BËNË KAURRIT = "KRISTIANËT"**

Këtë shirk të madh = këtë krim ndaj Zotit të madhrueshëm e bënë dhe vazhdojnë ta bëjnë "kristianët" që ndryshe muslimanët atyre ju thonë kaurë=kaurrit. Ata bëjnë shirk me besim dhe me me gojë. Zoti xh. sh. thotë për ata në Kuranë; " Ato i quajtën priftat e tyre ruhbanët murgjit priftat krishterë të tyre dhe Mesihun [Isain] të birin e Merjemes për zota veç Allahut [Zotit të vërtetë]. "S. Tobe. A. 31. Allahu xh. sh. i tha Pejgamberit a. s. në Kuran; "Thuaju; "O ndjekësit e librit [jehudi e të krishterë] ejani të mblidhemi në një fjalë që është e njëjtë mes nesh e mes jush, të mos adhurojmë tjetër veç Allahut [veç Zotit] të mos i bëjmë Atij asnjë send shok dhe të mos quajmë njëri tjetrin zotër veç Allahut.... "S. Ali Imran aj. 64. Duhet ta kenë të qartë këtë gjë ata që i thonë vetes të krishterë se ata janë në kundërshtim dhe me Ungjillin sipas tyre. Në Bibël thuhet; Nuk ka tjetër Zot veç një Zoti. Kapitulli Korinthjanët.

Ndërsa profeti ynë Muhamedi a. s. e ka shprehur në gjuhën e tij Arabe La ilahe il lallah = Nuk ka tjetër Zot veç Atij =veç një Zoti = veç Allahut. xh. sh. Kurse në Inxhilin=Ungjillin e Mateut në kapitullin Urdhëresa e madhe thuhet se kur njerëzit e pytën Krishtin se kush është Zoti ? Ai u tha atyre; Zoti është Zoti [Ai që krijoi gjithësinë] e askush tjetër. Ndërsa në Kuran Allahu xh sh. thotë për kristianët; "E mohuan të vërtetën ata që thanë se Zoti është ai Mesihu biri i Merjemes. "S. Maide. aj. 17. Gjithashtu Allahu xh. sh. në Kuran përsëri thotë: "Bënë kufër[mohuan të vërtetën ata [njerëz] që thanë; Allah është ai Mesihu, [Isai] biri i Merjemes, E vetë Mesihu [Isai] u tha: O beni israil [o bijtë e Israilit] adhuronja Allahun, Zotin tim [atë që më krijoi mua] dhe Zotin tuaj [që ju krijoi dhe juve] se ai [njeri] që i përshkruan Zotit shok, Zoti ia ka ndaluar atij xhennetin, dhe vendi i tij është zjarri. "S. Maide aj. 72. Siç e lexoni Mesih është titulli ose mbiemri i hazreti Isait a. s. Ai i ka thënë popullit të tij se Zoti është Allahu xh. sh. që është Zoti im-Zoti që më krijoi mua dhe Zoti juaj. Ai që ju krijoi dhe juve. Nuk

ka tjetër Zot veç atijë. Një natë në televizor dëgjova krytarin e kishave katolike në Shqipëri Rrok Mirdita që në një intervistë në vitin 2007 me rastin e krishtëlindjeve tha; njeriu Zot e Zoti njeri=[d. m. th. sipas tij se njeriu është Zot e Zoti është njeri.] Estagfirullah, estagfirullah, e stagfirullah. Zoti i madhërshëm i ruajtë besimtarët e vërtetë e të sinqertë nga këto fjalë jasht fesë e jashtë logjikës që e kanë burimin nga ateistët thotë Kurani sikurse e theksuam më sipër. Çdo njeri pasi të vdesë do të japi llogari ke Zoti xh. sh, për mëkatet = gjynahet e tija dhe të atyre që i ka drejtuar gabim. Megjithatë secili është i lirë në zgjedhjen që bën. Nga gjiri i popujve kristjanë kan dalë shumë dijetarë në fusha të ndryshme të shkencës por përsa i përket diturisë për fenë, kristjanët kanë mbetur në errësirë që prej 2000 vjetësh. Ata janë fare të pa ditur. Edhe se sot në këtë kohë kur zhvillimi mendor e dituria=shkenca ka arritur kulmin e zhvillimit, kristjanët akoma adhurojnë idhujt. Ju përgjërohen atyre, pikturave e skulpturave. Njeriun e bëjnë Zot e Zotin e bëjnë njeri. [estagfirullah, estagfirullah]. Vërtetë është çudi e madhe por është dëshira e tyre ashtu Zoti xh. sh. i drejtoftë në rrugën e drejtë se besimi i tyre ashtu është i pa pranuar tek Zoti xh. sh. Tobja=largimi nga punët e këqia me kushtin e par njisimin e Zotit xh.sh. është e domosdoshme për të gjithë njerëzit që besojnë në ekzistencën e Zotit xh.sh. Çdo i dërguar nga Zoti xh. sh. që ju erdhi popujve të ndryshëm, fjala e parë që ai ju komunikoi atyre ishte; Nuk ka tjetër Zot veç një Zoti i cili nuk i përngjan askujt dhe askush nuk është i barabartë me të. Edhe sipas Ungjillit të sotëm, Mesihu=Isai që të krishterët i thonë Krishti = "Shpëtimtari"i ka bërë thirrje popullit të tij si çdo profet tjetër që ta njisojnë Zotin xh. sh.një të vetëm pa shok e ortakë i cili nuk ka lindur prej askujt dhe nuk ka lindur askush prej Tij dhe pastaj të largohen nga rrena, vjedhja, imoralitet, smira=hasedi, kamata, krimi, aborti, magjija, lakmija në gjën e tjetrit, lakuriqësija e tjera.Për kuzistencën e një Zoti të vetëm në Bibël thuhet : "Nuk ka tjetër Zot veç një Zoti." Zoti".Kapitulli Korinthjanët.Dhe thuhet "askush nuk është si Zoti".Askush nuk ia përngjason atij.Ndërsa për lakuriqësinë=daljen e gruas zbuluar Ungjilli thotë: Nëse gruaja del zbuluar ti qethen asaj flokët e kokës krejtësisht si shenjë ndëshkimi."Ndërsa për pijet alkolike në Ungjill gjendet kjo thënie: Ata [Farisejtë] i than Krishtit: "Gjon pagëzori nuk e pinte as birrën. "Në kohën

kur ishte gjallë Profeti Muhamed a. s. i erdhën një rast te xhamija 40 prifta ortodoks nga ish krahina kristjane e Nexhranit, për ta pytë Pejgamberin a. s. për çështjen e Mesihut=hazreti Isait a. s. Ndër këto prifta ishin dhe më të dëgjuarit e atij vendi; Haritheja dhe Akidi. Ata i thanë Pejgamberit a. s. ; O Muhamed a. s. . na trego; Mesihu=[Krishti] a është Zoti apo i biri i Zotit, apo është shpirtë i shenjtë, se ai ka bërë shumë mrekullina dhe ata i numruan disa nga ato. Profeti Muhamed a. s. ju shpjegoi atyre me Kuranë dhe pastaj dhe me argumente llogjike, që Mesihu=Isai a. s. kurrë nuk ka qënë Zoti e asë i biri Zotit estagfirullah=Allahu xh. sh. i ruajtë besimtarët nga këto fjalë jashtë llogjikës. Kurrë nuk duhet të thuhet këto fjalë nga të mençurit ju tha Pejgamberi a. s. atyre. Zoti=Allahu xh. sh. ju tha ai, është i pastër nga këto gjëra. Ai nuk ka as birë, as bija e as familje, dhe ju këndoje atyre suren Ihlas. Ndërsa priftat kundërshtuan e i thanë Pejgamberit a. s, se Mesihu='Krishti'ka qënë Zoti [estagfirullah] por na e vranë çifutët atë. Pejgamberi a. s. kur e shikoi që ata nuk po binden, iu tha atyre; Allahu xh. sh, i ruajtë besimtarët e sinqertë nga kjo fjalë e keqe, që i vjen rëndë qiellit e tokës. Kurrë nuk duhet të thuhet kjo fjalë nga njerëzit e mënçur. Nuk është ashtu sikurse thoni juve ju tha Pejgamberi a. s. priftave se po të jetë ashtu si thoni ju, atëherë si pas jush, kuptohet që njeriu e paska vranë Zotin? [estagfirullah tha Pejgamberi a. s. Atëher në se ju vazhdoni të jeni me mendimin se atë e vranë çifutët, fjala e juaj tregon se jehudët=çifutët paskan qënë më të fortë se Zoti xh. sh. [estagfirullah tha Pejgamberi a. s.]. A nuk i mendoni fjalët që flisni ju i tha priftave profeti Muhamed a. s. Mesihu = Isai a.s. ka qënë një njeri i dërguar nga Allahu xh. sh. tek populli i vet si unë e të tjerë para neve. Priftat nuk patën çfar të thonë, por thoshin se ai ka ba shumë mrekullina, ka shëruar njerëz, ju ka sjellë dritën e syvet disa qorrave, ka ngjallë njeriun e vdekur dhe ai ka lindur pa babë. Profeti Muhamed a. s. ju tha atyre; Edhe un kur ka dashur Allahu xh. sh kam ba mrekullina porë çështja e mrekullinave është në dëshirën e Allahut xh. sh. Sa për lindjen e Isait, vërtetë Allahu xh. sh. e krijoi pa babë, vetëm me nënë, porë për këtë gjë ju nuk keni përse të thoni se ai është Zoti ose i biri i Zotit estagfirullah, estagfirullah. Po të jetë puna ke mynyra e krijimit ju tha Pejgamberi a. s, atëherë përse ju nuk thoni ashtu për njeriun e parë Ademin a. s. Ai nuk kishte as nënë e as babë. Kështu thotë Inxhili dhe Kurani. Allahu

xh. sh. ju tha Pejgamberi a. s. atyre e ka krijuar Ademin pa babë e pa nënë. Gruan e parë Havanë e krijoi me babë, por pa nënë. Isain a. s. e ka krijuar me nënë por pa babë. Ndërsa të gjithë njerëzit tjerë veç tyre i ka krijuar me nënë dhe babë. Kjo gjë juve duhet tu bëj që të kuptoni diturinë e pa kufijshme të Allahut xh. sh. I cili krijon si të dojë e çfar të dojë. Zoti xh. sh. na mëson në Kuran që tu themi të krishterëve për ti heshtur ata, përse ju nuk i thonë ata fjalë për Ademin të cilin e krijoi Zoti xh. sh. panënë dhe pa babë? Ndërsa dijetari Islam Ahmed Didati në një dialog ndër fetarë para disa dekadash i pyeti të krishterët. Çfar është=çfar simbolizon për juve të krishterët kryqi. Ata i thanë është mjeti me të cilin çifutët na e mbytën më të dashurin tonë Jezu Krishtin. Dijetari Islam ju tha atyre; A prandaj ju e mbani për gjë të shenjtë kryqin dhe e bëni atë dhe prej floriri dhe e mbani të varë në qafë dhe e puthni vazhdimisht atë? . Po i thanë të krishterët. Ai ju tha atyre; Po nëse dikush me ndonjë thikë dikujtë nga juve i ka vvarë më të dashurin e tij prindërin, babën ose nënën; A është e llogjikëshme që atë thikë ta bësh simbol prej florni e ta mbashë në qafë dhe çdo herë ta puthësh? Dhe kur të pyesin të tjerët çfar e ke atë thikë në qafë. Përse e mban dhe e puth atë? Ndërsa ti tu thuash atyre se këtë thikë e mbajë me nderim si kujtim se me këtë mjet ma kan vvarë mua babën ose nënën kriminelët. Të "krishterët" heshtën ulën kokën dhe i dhanë të drejtë dijetarit Islam Ahmed Didatit për argumentin logjik që u sollti atyre. Është vërtetë për tuçuditur se çifutët sipas thënjeve të krishterëve e vranë Krishtin, gjithashtu çifutët ose hebrejtë e kanë e kanë akuzuar Marijen=Merjemen r. t. a. për imoralitet dhe të birin e sajë Isain a. s, për muslimananët dhe Krishtin për të krishterët, çifutët e kanë quajtur kopil. Ndërsa me gjithëse çifutët kanë thënë këto fjalë kaqë të ulta diskredituse për 'Krishtin' dhe nënë e tij Marijen, është për tu çuditur se përsëri gjithmonë kristianët i duan çifutët oso jehuditë dhe i urrejnë muslimanët të cilët besojnë e deklarojnë për ndershmërinë e virgjërinë e Marijes=per kristianët se muslimanët i thonë asaj Merjeme r. t. a. e cila ishte nga gratë e lartësuar nga Allahu xh. sh. mbi gratë e botës. Muslimanët pastërtinë morale-pafajësinë e Merjemes ose Marijes për të krishterët e mbrojnë me Kuran. Por çudija për urrejtjen që kanë të krishterët në përgjithësi ndaj muslimanëve hiqet menjëherë nga ne besimtarët muslimanë kur lexojmë Kuranin në të cilin Allahu xh. sh. na par-

alajmëron 1400 e ca vite më parë duke na thënë kështu: "O ju besimtar [o ju muslimanë]; ...Ata [çifutët e 'të krishterët = kaurrit] janë miq të njëri-tjetrit e kush prej jush i miqëson ata, ai [njëri] është prej tyre." S. Maide. aj. 51. Përsa i përket qëndrimit ndaj fesë Islame e muslimanëve çifutët ose hebrejtë dhe të krishterët janë me një mendim të përbashkët për këtë gjë. Ata janë miq me njëri tjetrin dhe kur ju paraqitet rasti ata bashkohen me njëri tjetrin kundër muslimanëve në çdo pikëpamje, ekonomike dhe politike. Kurani është fjala e Allahut xh. sh. dhe Allahu xh. sh. thotë të vërtetën. Këtë gjë e ka vërtetuar gjithmonë koha e ka treguar historia. Ne po përmendim këtu faktin më të fortë se shteti çifut i Izraelit u themelua në tokat e muslimanëve në Palestinë në vitin 1948 me ndimën e kristjanëve=kaurrëve dhe mbahet në këmbë po me ndihmën e tyre. Kristianët e përdorin Izraelin si kobure në lindjen e mesme kundër muslimanëve. Por megjithëse çifutët e kristjanët janë të bashkuar me njërin tjetrin përsa i përket qëndrimit armiqsorë ndaj muslimanvet, ata përsëri kanë armiqësi mes njëri tjetrit. Allahu xh.sh. tregon në Kurranin famëlartë se Ai ka futur mosmarrëveshje e urrejtje mes kristianëve e çifutëve për arsye të fesë. Miqsia e tyre është e bazuar në interese politike të caktuara të momentit se ata eurrejnë fenë e njëri tjetrit. Për këtë gjë Allahu xh. sh. në Kuranë thotë: "Jahuditë [çifutët] thanë se të krishterët nuk janë të mbështetur në asgjë [nuk kanë fe të vërtetë]. Edhe të krishterët thanë se jahuditë [çifutët] nuk janë të mbështetur në asgjë [të vërtetë]... S. Bekare. aj. 113. Jahuditë=çifutët kanë armiqsi edhe mes njëri tjetrit. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ne ndërmjet tyre [çifutëve] hodhëm armiqësinë e urrejtjen e cila do të vazhdojë deri ditën e kijametit." S. Maide. ajeti. 64. Këtë armiqësi mes njëri tjetrit tregon Kurani, çifutët e kanë se e thyn besën që i patën dhënë Zotit xh.sh.nëpërmjet profetëve që Ai i dërgoi tek ata. Kjo armiqësi mes tyre do të vazhdojë deri ditën e kijametit.

Gjithashtu Allahu xh. sh.tregon në Kuran se ka futur armiqësi dhe ndërmjet kristianëve me njëri tjetrin, Ortodoks e Katolikë.

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: "Ne e morëm premtimin edhe prej atyre që than: "Ne jemi nasara = "Ne jemi të 'krishterë" por edhe ata e harruan një pjesë të asaj me të cilën ishin të udhëzuar, prandaj Ne kemi ndërsy [kemi futur] armiqsinë e urrejtjen ndërmjet tyre [katolikë e ortodoks] e cila do të vazhdojë deri ditën e kijametit'". S.Maide.aj.14.

Si pas të dhënave zyrtare prej ideologjive fashiste e komuniste të shpikura nga çifutët sipas statistikave gjatë luftës së dytë botërore u vranë rreth 50 milion njerëz. Thuhet se vetëm çifutë u vranë 6 milion prej Hitlerit në luftën e dytë botërore. Kështu pra që e pësuan edhe vetë çifutët. Allahu xh.sh. ju thotë muslimanëve në Kuran : “O ju besimtar: “Mos i merrni për miq [mos i konsideroni e mos i bëni miq ata që ju është dhënë libri [që ju ka ardhur libër] = kristjanët e çifutët [jahuditë] dhe as ata që nuk janë besimtarë [idhujtarët e ateistët] që me fenë tuaj tallen e luajnë. Keni frikë Allahun nëse jeni besimtarë.” S. Maide. aj. 57. Allahu xh. sh. na tregon në Kuran që sa do lëshime ose tolerim tu bësh çifutëve e kristianëve, ata përsëri nuk bëhen të kënaqur nga muslimanët. Këtë gjë na e ka treguar Allahu xh.sh. në në Kuran dhe thotë: “As jahuditë [çifutët] e as krishterët, kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty [o musliman] deri sa ti të ndjekësh fenë e tyre. Thuaju [atyre] udhëzimi i Allahut është udhëzim i drejtë... = [Feja Islame është fe e vërtetë] “. S. Bekare. aj. 120.

15- QËNDRIMI I POPULLIT TË THJESHTË NDAJ THIRRJES PËR TOBE QË BËNTE MURSHIDJA AISHE.

Populli në ata kohë në përgjithësi të ditur e të pa ditur nuk e morën seriozisht çështjen e tobes me përjashtim të disa njerëzve të rrallë. Ata i thoshin murshides Aishe se ne jemi në punë të rënda dhe na duken të vështira për ti zbatuar të gjitha kushtet e Tobes. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se Allahu xh.sh. që din e dëgjon çdo gjë, më solli mua këtë lajm si përgjigje për tua thënë atyre : “Thuaju ti atyre [njerëzve] nëqoftë se do të më njisojnë Mua duke e veçuar emrin tim nga emrat e tyre do ti ndihmoj Un ata për tu drejtuar në kushtet e tjera të tobes. [që atyre ju duken të zorshme për ti zbatuar].” Allahu xh. sh. në Kuran thotë: “Allahu i forcon ata që besuan në fjalën e fortë [fjalën la ilahe il Lallah [Nuk ka tjetër Zot veç Allahut, i forcon] në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër ndërsa mizorët [kryeneçët=të pa bindurit] Allahu i bën të humbur. Allahu punon çka të dojë”. S. Ibrahim. Ajeti.27. Vëllezër besimtar duhet ta dini se fjala e par që i kan mësuar popujve të tyre gjithë pejgamberët e të dërguarit është fjala La ilahe il lallah të cilën e kan folur me gojë në gjuhën e tyre duke e besuar me shpirtë gjithë besimtarët në çdo popull.

Kur njerzit e kundërshtojnë këtë fjalë në gjuhën që flasin duke dëshmuar me gojën e tyre Zotër tjerë veç një Zoti, atëher Zoti xh. sh. i shkatron ata në dynja dhe ahiret se bëjnë kufër=bëjnë shirk të madh=krim ndaj Zotit xh. sh. I bëjnë karshillëk Atij duke i thënë vetes së tyre Zoti, Jam i Zoti, i dal Zot asaj ose atij e tjera fjalë si këto. Estagfirullah. Për ata njerëz që i thonë vetes së tyre Zoti estagfirullah, Zoti xh. sh. në Kuran ka thënë : "Ve min jekul minhum in-nij ilahum min dunihî fedhalike nexhzijhi xheheneme. Kedhalike nexhzi dhalimine". = Kush i thotë prej tyre [prej njerëzve e xhindëve] vetes se un jam Zoti përveç Tij [përveç Zotit=Allahut xh.sh.] dënimin për atë është xhehenemi. Kështu i ndëshkoi Ne zullumqarët [thotë Allahu xh. sh]. "Sure Enbija=Kapitulli i lajmtarëve. Aj.29. E si guzon ti o besimtar dhe thua se jam Zoti ose i Zoti I kësah gjëje ose i dal për Zot asaj gjëje ? Estagfirullah, estagfirullah, estagfirullah. Mos fol ti o besimtar si qafirat. Pendohu menjëher o besimtar i Allahut xh. sh. dhe lutju Allahut xh. sh. që të fali se për ndryshe pa dyshim të pret xhehenemi. Allahu xh. sh. i tërheq vërejtje njeriut në Kuran në formë duke i thënë atij: "Hel taëlemu lehu semij-jen ? ". =A din ti për Të [për Zotin xh. sh.] ndonjë emnak=adash? "=Pra a di ti o njeri=ti o besimtar thotë Allahu xh. sh. që Un të kem emnak=adash?, që të thirret tjetër kush me atë emër që thirrem Un ? Allahu xh. sh. thotë: "Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me pa drejtësi [dhulm], atyre [njerëzve] ju takon të jenë të sigurtë dhe ato janë në rrugë të drejtë. S. En-nam. aj. 82. Komentatori i njohur i Kuranit Hazini thotë se qëllimi me fjalën dhulm, në këtë ajet Kurani, është për shirkun. Ai këtë thënje e bazon në një hadith që transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ibni Mesudi. Kurani famëlartë thotë: "Allahu nuk e fal atë njeri që i bën shokë e ortakë Atij. "S. Nisa aj. 48. Muxhedidja Aishe tha se Allahu xh.sh. më lajmëroi që ti marr besën besimtarvet duke e qokur me dorë. Ajo e qokte me njerzit paksa me me gishtërijtë e duarve. Kështu ka vepruar dhe Pejgamberi a.s. Kurani thotë : " O Pejgamber, kur të vij në besimtarët që të japin besën se nuk do ti shoqërojnë asnjë send Allahut, se nuk..., atëherë, prano premtimin e tyre ...". S. Mumtehine. aj. 12. Kurani thotë : "Vërtet Allahu që i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të jepnin besën ty [o Muhamed].. S. Fet-hit. aj. 18. Allahu xh. sh. thotë: thotë: "Ata që ta japin besën ty, në të vërtetë ia japin Allahut se dora e Allahut është mbi duart e tyre; e kush e thyen besën e thyen në dëm të vetes".S. Fet-hit.aj.12. Disa njerëz i thoshin muxhedides Aishe se ne nuk duam të bëjmë shirk por harrojm se kështu na është mësuar goja. Ndërsa murshidja Aishe ju thoshte: Nëse dikush thotë se un harroj , un po ju tregoj

ilaçin e harresës i cili është ky: Ai njeri që din të fali namazë, le të fali dy rekatë namazë nafile një orë pas lindjes së diellit 10 ose 15 dit rresht pa ndërprerje, me nijetin që ta ruaj Allahu xh.sh. nga harresa. Ai që nuk di të fali namazë, le ta agjëroi 10 ose 15 dit rresht pa ndërprerje.

Nëse i ndërpret një ditë si namazin ashtu dhe agjërimin, duhet ta rifilloi përsëri nga dita e parë. Pas namazit ose agjërimin nafile, me dëshirën e Allahut xh. sh. askush nuk do të harrojë më". Për çështjen e mbulesës gratë i thoshin murshides Aishe se ne duam të mbulohemi por nuk na lënë se jemi në punë të shtetit, kurse disa të tjera i thoshin asaj se neve nuk na lënë burrat që të mbulohemi. Ndërsa vajzat e reja thoshin: Nëse ne mbulohemi sot në këtë kohë, nuk na marrin djemtë për martesë. Muxhedidja Aishe tha se pas këtyre ankesave e justifikimeve të gravet, Allahu xh. sh. që di çdo gjë që mendojnë e flasin njerëzit thoshte ajo, më solli mua këtë lajm për gratë e reja dhe vajzat kështu: "Të mbulohen krejtësisht duke lënë vetëm kokën pa mbuluar [fytyrën dhe flokët] Le të rrinë kështu ata me këtë urdhër special [të veçantë] deri sa ta rregulloj situatën". Allahu xh. sh. në Kuran thotë; "Allahu nuk ju ngarkon juve [o njerëz] për atë gjë që ju nuk keni mundësi [ta bëni] ". Kështu urdhëresash speciale=të posaçme i kan ardhur dhe Pejgamberit a .s. na tregon Kurani, siç ishte çështja e alkolit në fillim të ardhjes së fesë Islame i cili nuk ishte i ndaluar krejtësisht menjëher prej Allahut xh. sh. për disa arsye. Më vonë zbriti Allahu xh.sh. ajetin e Kuranit për ndalimin e pijeve alkolike krejtësisht. Si dhe përse, Allahu xh. sh. e din më mir çdo gjë. Ndërsa për ata gra që nuk ishin të reja dhe nuk i detyronte askush, murshidja Aishe thoshte se Allahu xh. sh. solli këtë vërejtje për ata: "Çfar kan këta që nuk i detyron kush dhe i nxjerrin laprat [gjijtë] e tyre për fushë ? ". Vërtetë edhe sot të njëjtën gjë po bëjnë të gjithë femrat të reja e të vjetra duke i nxjerrë gjijtë jashtë që tua shohin meshkujt; me përjashtim të disa besimtareve të rralla. Sa turp, sa keq. Unë them që burrave sot në këtë kohë ju ka humbur kontrolli mbi familjen. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Nuk ka mend ai njeri që nuk ka fe dhe nuk ka fe ai që nuk ka mend. " Vërtet feja Islame është feja që e pranon mendja e kulluar e pranojnë njerëzit e mençur.

16-MUXHEDIDJA AISHE DHE NJERËZIT QË ISHIN NË TARIKATE.

Disa njerëz në atë kohë që ishin në tarikate i lavdroheshin Aishes e i thonin asajë; Ne nuk kemi nevojë për të hyrë në tobe sepse jemi në tarikat. Aisheja tha; Allahu xh. sh, më lajmërojë tu the- mi atyre kështu, "Thuaju atyre që të lavdrohen ty me tarikatet se unë jamë në tarikatin e Ismailit, Ibrahimit dhe kryesishtë në tarikun e Muhamedid; Sa tarik i bukur është ky tek Unë" [tek Allahu xh. sh.] Selami qoftë mbi pejgamberët. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, tha që u përmend në veshin tim emëri i Ismailit para Ibrahimit, sepse Ismaili po jepte shpirtin për Allahun xh. sh, kurse Ibrahim i djalit. Këtë kuptim ma dha Allahu xh. sh. për brenda shpirtit me ilham. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha: Pasi Allahu xh. sh. më solli lajmin që ti thërras njerëzit në tobe, u ndalua hyrja e tyre nëpër tarikate të ndryshme. Ajo tha se Allahu xh. sh, më solli këtë lajm që tua themi atyre: "Thuaju ti besimtarëve: Pas lajmit për të bërë tobe, është e ndaluar hyrja në tarikate. Ashtu sikurse nuk kam lënë sy pa kapakë, ashtu nuk kam lënë gjë mangut në Kuranë. Tarikati bektashij është i anolluar krejtësishtë, se ato nuk veprojnë me Kuranë. Ata ngrejne [lart] Aliun mbi më të dashurin tim Muhamedin në gradën e të cilit nuk mbërrin askush. Sikurë ata të besonin si Aliu edhe ndoshta Unë do tua falësha atyre, por ata nuk veprojnë si ai. "Vërtetë Allahu xh. sh thotë në Kuran: "Kapuni që të gjithë ju për litarin e Allahut [Kuranin fjalën e Allahut] e mos u përçani... ". S. Ali Imran ajeti 103.

Me të vërtetë tarikatet kush më shumë e kush më pak dolën nga bazat e Kuranit. Tarikati Bektashij i cili sikurse dihet e shihet nuk vepron e as nuk vepron sipas Kuranit. Ata nuk e falin namazin në pesë kohët, nuk agjërojnë ramazanin, nuk falin namazin e xhumasë, nuk veprojnë sipas Kuranit e synetit, pinë pije alkolike e tjera e tjera. Gjithashtu edhe tarikatet tjera filluan të merren me nafilet e mystahabet me ibadete-punë të mira të pa detyruara dhe shumica e tyre lanë farzet e synetet. Disa nga ata deshën gjoja të bënin tejkalim mbi normën detyrën e caktuar por nuk arritën të bënë as detyrën që e kishin farz të cilën ja u

ngarkon-te sheriati=ligji i fesë Islame. Ndërsa të tjerët filluan të krenohen me të parët e tyre me shehelerët e jo me Pejgamberin a. s. Ata i lanë thënjet e Kuranit e të hadithit dhe filluan tu tregojnë njerëzve veprimet e shehelerëve të tyre duke ju lavdruar njëri-tjetrit dhe në këtë mynyrë filluan përçarjet mes muslimanëve. Më vonë drejtimin e tarikatis e morën në dorë njerëzit që ishin pa dituri feje e disa ishin dhe mynafikë. Në disa vënde arritën ta marrin në dorë udhëheqëjen ose drejtimin e tarikatis dhe kristianët e çifutët të maskuar si muslimanë me emër dhe me veshje. Ata lanë zbatimin e detyrave, farzeve e syneteve dhe në kundërshtim të hapur me Kuranin, filluan të bëjnë veprime në kundërshtim me fenë Islame. Filluan të pinin pije alkolike, lanë namazin e agjërimin e filluan të merren me bidate. Duke u maskuar me tarikatin mynafikët=dyfyturshist në bashkëpunim me qafirat filluan të shkatërrojnë fenë Islame duke futur dyshime e përçarje tek besimtarët e pa ditur.

Ata arritën në bidadet=shpikjet e tyre nga më të çuditëshmet. Një shembull ishte dhe ky; Nëse me rastin e një gostije në sofër ose tavolinë vihej tepsjia e mbushur me pilaf dhe pilafi në tepsi ishte në formë mullari me majë dhe nëse atë e trazonte kush për ta rrafshuar ai njeri bënte gjynah të madh si pas atyre që gjoja ishin në tarikat. Kështu thoshin disa shehelerëve të tarikateve të ndryshme që një pjesë i kishte hutuar shejtani mallkuar me propogandat e qafirave dhe munafikëve, dhe një pjesë ishin vetë qafira e munafikë. Nëse aty në atë sofër apo tavolinë ndodhej ndonjë sheh ose dervish, ai e ndërpriste ngrënjen e ushqimit nga që ia prishën majën pilafit-e rrafshuan atë, dhe kështu ai u ngrejte nga sofrja ose tavolina dhe kishte raste i hidhëruar ikte nga gostija. Me këtë lloj demonstrimi ata i çonin njerëzit e pa ditur në kundërshtim me mësimet e fesë Islame. Shehelerët dhe dervishat kur i jepshin dorën njëri tjetrit i puqnin me njëri tjetrin, dy gishtat e veçuar të dorës që nuk janë të puqur sëbashku me katër të tjerët, duke i takuar ata me njëri tjetrin majë më majë. Sipas mendjes së tyre dhe të atyre që i kishin mësuar, kështu baraz=-njëllojë me njëri tjetrin thoshin ata janë Pejgamberi a. s. me Aliun r. t. a. Kështu gjërash e të tjera gjëra si këto i thoshin ata nga mendja e tyre që ti ndanin muslimanët nga njëri tjetri. Për këto bidadë të tyre që tregova, të rrijtë le të pysin të vjetrit që mundet ti kene dëgjuar këto gjëra dhe shumë të tjera si këto. Disa nga të vetë quajtur shehelerë merreshin me xhindët, dhe gjoja bënin

sikur çpoheshin me shtiza në gojë e nofulla dhe sikur hanin xhama. Edhe sikur të duan disa njerëz të rrallë me qëndru në rregull në tarikatat duke vepruar me sheriatë e hakikat, ata në këtë koh nuk kanë as mundësi, as durim, as vetpërmbytje e përkushtim që përveç sheriatit=ligjit ose detyrës që është normë e caktuar për të gjithë njerëzit, të bëjnë edhe tarikatit tejkalim mbi normën. Norma është detyrë për të fituar kurse tejkalimi është nderim për tu graduar nga Allahu xh. sh. Sot në këtë kohë nuk ka më të tillë njerëzish. Ata që sot deklorojnë veten të tillë, janë vetëmse mashtrusa për të grabit njerëzit e pa ditur për të bërë grupe të ndryshme që të bëjnë përçarje në popull. Edhe nëse mund të jetë ndonjë njeri i drejtë në ndonjë qoshe të ndonjë vëndi, ai është njeri i vetëm që askush nuk ka mundësi ta ndjeki atë, se njerëzit e sotëm nuk po bëjnë ata gjëra që janë farz e jo më të bëjnë tepër farzeve e syneteve. Sot bota është në krizë të madhe morale, si pasojë e mësimëve ateiste e luftës kundër besimit në Zotin xh. sh. Ateizmi është opjum-helmë për popullin. Ai është ideologji kundër moralit dhe se i tillë ai është anti njerëzore. Ateizmi ju ka turbulluar mendjen dhe ju ka helmuar shpirtat njerëzve kudo në botë. Puna ka shkuar deri aty sa, fëmijët po vrasin prindërit e tyre, dhe prindërit po vrasin fëmijët e tyre. Vetëm feja por pikërisht feja Islame është në gjëndje ta shëroi këtë krizë të madhe morale në mbarë botën. Të mençurit duhet ta kuptojnë këtë gjë. Të gjithë njerëzit kudo nëpër botë, sot në këtë kohë, duhet të bëjnë tobe, të besojnë dhe të veprojnë sipas urdhëresave bazë të Kuranit. Kushtet e tobës janë baza e Kur'anit. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha tha se gjatë kryerjes së shërbimit mora këtë lajmë prej Allahut xh. sh. kështu; " Ata që do të bëjnë tobe të plotë do ti fus në xhenet direkt pa peshim [pa i shikuar hollë] gjatë peshimi punët e tyre]; Këtë shpërblim e kanë të posaçëm vetëm njerëzit e shekullit të njëzet. Këtë privilegj nuk ia kam bërë askujt nga popujt e kaluar. " Vërtetë Kurani thotë" " Ai [Allahu] veçon me mëshirën e vet ke të dojë..." S. Ali Imran. aj. 7.

Ata të cilët vazhdojnë të grumbullojnë njerëz nëpër tarikate duhet ta dijnë se mashtrojnë vehten dhe të tjerët që shkojnë pas tyre sepse me të vërtetë kudo nëpër botë nuk ka më tamam shehelerë sikurse quheshin më parë, por ka vetëm sherrëlerë. Tani atyre u ka mbet vetëm mbiemri shehu, ashtu skurse ka mbet dhe mbiemri hoxha por që nuk janë vërtet hoxhallarë ata që kanë mbiemrin hoxha.

Ndërsa të vetquajturit shehelerë që disa as nuk janë fare besimtarë veprojnë qëllimisht në kundërshtim me ligjin Islam=sheriatin për ti përçarë muslimanët. Disa për të jetuar në kurriz të njerëzve të pa ditur e disa të tjerë janë të financuar nga qarqet e ndryshme anti muslimane në shumë vende. Edhe nëse dikush me sinqeritet ka dëshirë që ti bëjë shariat e tarikat e të ndjeki vërtetë e plotësishtë rrugën e drejtë=tariki mustekimin, ashtu sikurse e ndoqën murshidat e famshëm të devotëshmit; Ahmed Tixhanija, Shabi Nakshibendiu, Ahmet Rufaiu e tjerë, sot kjo gjë në këtë kohë sot është fare e pa mundur. Por edhe sikur të jetë e mundur, hyrja e njerëzve në tarikat është e ndaluar prej Allahut xh. sh. që pas ardhjes së lajmit nga Ai për të bërë tobe. Allahu xh. Sh. e di mir forcën e besimit të njerëzve sot, aftësinë për të frenuar nefsin=vetpërmbajtjen dhe forcën e trupit tek njerëzit e kohës së sotme. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ai [Allahu] i udhëheq çështjet prej qielli në tokë..." "S. Sexhde. aj. 5. Murshidja Aishe qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej sajë thoshte; Pas njisimit të Allahut xh. sh. të kemi dashuri për më të dashurin e Tijë, profetin Muhamed a. s. sepse vetëm kështu është i kënaqur Allahu xh. sh. nga ne. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Nuk e ka besimin të plotë ai njeri për derisa un të mos jemë tek ai më i dashur se fëmijët dhe prindët e tij. Trans Buhariu e Muslimi. Muxhedidja Aishe tregonte se një ditë po lexoja një libër, në të cilin dikush nga muslimanët që ishte në tarikat lavdronte Ahmet Rrufainë, që Allahu e mëshiroftë atë. Dikush mua ma dha këtë libër dhe fillova ta lexoj. Allahu xh. sh. që sheh e di çdo gjë thoshte Aisheja më solli këtë njoftim; "Mos e harxho kotë frymën duke lavdruar Ahmed Rufainë, se për këtë gjë nuk merr shpërblim; Po deshe me marrë shpërblim lavdro gjithmonë më të dashurin tim Muhamedin a. s. "E vërtetë nga Allahu xh. sh. është kjo fjalë sepse Ai e lavdronë Pejgamberin në Kuran dhe e përshëndet atë me selam. Zoti xh. sh. thotë; "Dhe ne ta ngritëm lartë famën tënde [o Muhamed]. " S. Inshira Aj. 4. "Me të vërtetë ti je në një shkallë të lartë të moralit. " Sure Kalem A. 4. Për përshëndetjen me selamë nga Allahu xh. sh. Kurani thotë; " Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e tijë [me krenari e respektë] e lavdrojnë Pejgamberin; O ju besimtar lartësojeni atë= ngrenja lartë famën atij dhe për shëndeteni [atë] me selam. " S. Ahzab aj. 56. Sa her që muxhedidja Aishe kjo murshide e famëshme e shekullit të njëzetë i përmendte urdhërat

e Allahut xh. sh. dhe porosinë e Pejgamberit a. s. i dilnin lotët nga sytë. Unë ju betohem në Allahun xh. sh. për këto fjalë që themi. Ata që e kundërshtojnë ndalimin e hyrjes në tarikate një pjesë janë njerëz që u pëlqenë vetja e tyre nga që nuk dijnë gjë nga feja, janë të pa ditur, ndërsa disa të tjerë janë njerëz të shitur tek armiqtë e muslimanëve dhe paguhen prej tyre për të shkatërruar fenë Islame. Ata duan që të maskohen me anë të tarikateve, për ti përçarë muslimanët, që ata mos të jenë të bashkuar. Vërtetë muslimanët sotë janë të përçarë në gjithë botën. Me të vërtetë Allahu xh. sh. që sheh dhe di çdo gjë, nëpërmjet muxhedides Aishe qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej sajë, solli lajmin për ndalimin e hyrjes në tarikate, ndarjes së muslimanëve në grupe të ndryshme. Allahu xh. sh. në Kur'anë thotë: 'Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të '. Sure Shuara aj 13. 'Mos bëhi si idhujtarët që e përçanë fenë e tyre e u ndanë në grupe dhe secili grup i gëzohet ides së vet [kënaqet me mendimin e vet]'. S Rrum. Aj. 32. Allahu xh. sh. thotë : 'Kapuni që të gjithë ju për litarin e Allahut [Kuranin fjalën e Allahut] e mos u përçani''. S. Ali Imran. aj. 103.

17-Ç'ËSHTË TARIKATI?

Fjala tarikat vjen nga emri tarik që do të thotë rrugë. Në tarikat do të thotë në rrugë. Ata njerëz që thonë jemi në tarikat por nuk veprojnë sipas Kuranit, ata janë jashtë rrugë. Shkallët e punëve të mira të njeriut ndahen në disa kategori që quhen mekame- grada. 1-Shkalla e shariatit. Ai që është në këtë shkallë duhet të largohet nga haramet dhe të zbatojë urdhëresat e Allahut =farzet që thotë Ai në Kur'anë, ku më kryesoret janë, Shehadeti, Namazi, Agjërimi, Zeqati, Haxhi e tjera. 2-Shkalla e tarikatit. Tarikati duhet të ketë brenda shariatit-ligjin e fesë të bazuar në Kuran. Nuk mund të jetë një njeri në tarikatë, kur ai njeri nuk ecën-nuk vepron sipas shariatit. Hyrja në tarikat do të thotë me i shtuar më shumë punët e mira, mbi normën që e ke detyrë=borxhë. Është fjala më shumë se çka je i urdhëruar, veç farzeve e syneteve me ba shumë nafile e mustehabe dhe me iu përkushtua më shumë ibadetit e sinqeritetit. Nëse nuk zbaton shariatit-ligjin e fesë, atëherë nuk je në tarikat por në dhalalet=humbje=devijim. Mekami ose shkalla e tarikatit, është një shkallë ku do të kërkohet me kalu nga bota e dukëshme që quhet

natyrë, në botën e pa dukshme [alemgajb] që quhet tejnatyrë ose bota e mbinatyrshme.

Sikur se e tham më sipër, qëllimi i hyrjes në tarikat dikur ishte me shtua më shumë ibadetin=punët e mira ndaj Zotit xh. sh, veç asaj që je i urdhëruar. Mirpo më vonë ata që thoshin se jemi në tarikat dhe nuk e zbatonin sheriatin Islam, u bënë grupe politike ose ndryshe parti opozitare kundër njëri tjetrit.Me hyr në tarikat dikur ishte qëllimi me shtuar më shumë veprat e mira, me qenë më shumë i përkushtuar=me qëndruar në rrugën e fes me korektësi. Jo vetëm të largohesh nga haramet se largimi nga ato është urdhër i Allaut xh. sh. por të mposhtësh nepsin e unin dhe mos të lakmojshë shum dynjanë edhe në ata gjëra që janë të lejuara=hallall të përmbahesh. Përshebull; me ngrënë bukë është vërtetë hallall, por me bë zakon ngrënjën shumë, nuk është mirë. Kjo gjë është cilësi e qafirvet. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Ai njeri që e bën zakon ngrënjën shumë. i nxihet zemra atij. "Vërtetë zemra i nxihet atij njeriu si nga ana shpirtërore ashtu dhe nga ana shëndetit. Faktet po e vërtetojnë sot këtë. E që e kishim fjalën më sipër e dyta gjë është të mposhtësh dëshirat e liga dhe ta kontrollosh mirë nepsin, të jeshë i pa lëkundur në fe, si në kohën që je mirë ashtu kur je dhe në vështirësi. Duke ndjekur sheriatin që është detyr është normë të përkushtohesh më shumë për të shtuar veprat e mira. Veç farzeve e syneteve të bësh dhe nafilet e mustehabet. Allahu xh. sh. thotë në Kuran; "Ata që bëjnë vepra të mira u takon e mira edhe më tepër. "S. Junus. aj. 26. Sheriati është norma e detyruar për besimtarët ndërsa tejkalimi i normës=tarikati që bëhej dikurë ishte nderë ishte një angazhim personal për tu afruar më shumë tek Allahu xh. sh. duke shtuar veprat e mira. Allahu xh sh. gjithashtu thotë; "Kush angazhohet për të mirë do të ketë të mirë. "S. Nisa. aj. 128. As nuk ka qenë dhe as nuk është në tarikat ai njeri që nuk zbaton sheriatin=ligjin fetar Islam. Tarikati pa sheriatin të çon në dhalalet = në humbje. Nuk bëhet fjalë të marrësh shpërblim për tejkalimin e normës, kur ti nuk ke bërë akoma normën. Sikurse e thash fjala tarikat vjenë nga emri tarik, që do të thotë rrugë. Tarikatëli do të thotë rrugë ndjekës. Rrugë ka shumë por rrugë e drejtë që është pa të përperja e pa të përposhta, porë që është e drejtë e sheshtë e pastër dhe pa kthesa është tariki mustekim. Të gjithë muslimanët kur falin namazin i luten Allahut xh. sh. kështu me këto fjalë nga Kurani; "Ihdinas sirratal

mustekijm''=na drejto o Zot në rrugën e drejtë=tariki mustekijm. Në këtë rrugë kanë mundësi që të ecin vazhdimisht të gjithë muslimanët, të rinjë e të vjetër se është rrugë e sheshtë pa pengesa dhe pa ngarkesa e kështu arrin në vendin që dëshiron. Kjo rrugë është farz i detyruar për të gjithë njerëzit. Hyrja në tarikate dikurë ishte qëllimi të ecësh po në tarikun mustekijm=në rrugën e drejtë por jo duke ecur me zig zake, një herë në një anë të rrugës e herë në anën tjetër të sajë dhe duke u lëkundur herë majtas e herë djathtas. Gjithashtu gjatë ecjes ti mbash sytë në tokë se në çvënd po i vë këmbët. Nëse njeriu ecën pa e kontrolluar vehten do të thyej ndojë këmbë e dorë ose do të përplasat me ndonjë objekt tjetër e do ti bien për tokë edhe ato ushqime që i ka në dorë e që i ka fituar me shumë mundim. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se ata që hynin dikur në tarikate mundoheshin që të rrishin detyrës gati duke qenë shumë vigjilentë ndaj djallit të mallkuar. Ajo thoshte mos i shani udhëheqësat e parë të tarikateve se ata ishin njerëz të rrallë që e kishin ndar mendjen me ecur në rrugën e drejtë=sirrati mustekijm pa zigzake dhe pa u lëkundur majtas e djathtas por me shikimin ngulur drejtë përpara duke pasur për bazë Kuranin. Ata mundoheshin të bënin sa më shumë punë të mira për të fituar kënaqësinë e Allahut xh. sh. Këta njerëz shembull kishin, moralin e Pejgamberit a. s, familjes dhe shokëve të tij të nderuar. Nën shembullin e tyre për të shtuar veprat e mira u angazhuan pas tyre shumë njerëz në botë, me qëllimin e mirë për tu përngjarë atyre, për ti ndjekur ata por shumica nuk qëndroi në rrugën e tyre se ajo kërkonte shumë sakrifica. Ata që i ndoqën këto njerëz, të rrallë, e emëruan ose titulluan veten ; Rrufai, Nakshibendi, Sadij e tjerë. Ndërsa prijësat që ishin dikurë, ishin njerëz me urtësime hikmet, dhe ishin bërë shembull për njerëzit me veprimet e tyre atje ku jetonin, ndërsa ata që erdhën më vonë pas tyre, e quajtën veten shehelerë se në faktë nuk ishin. Ata e lanë tariki mustekijmin=rrugën e drejtë që përcakëton sheriatin=ligji fetar Islam dhe morën një tarik=rrugë sipas mendjes së tyre dhe jo atë rrugë që ecën dikur udhërrëfysat e shquar të rrugës së drejtë siç ishin Ahmed Rrufaiu. Haxhi Bektash Veliu e tjerë të cilët ishin me hikmet prej Allahut xh. sh. Njerëzit më vonë pas tyre dolën nga rruga e drejtë që tregon Kurani dhe mbajtën në kujtesë si trashëgim prej këtyre prijësve, vetëm disa fjalë e veprime të pa rëndësishme shumë. Disa mbajtën si trashëgim veshjen e tyre e asgjë tjetër. Prij-

sat e dikurshëm të tarikateve e zbatonin me përpikëmeri sheriatin Islam. Ata veç farzeve e vaxhibeve=detyrës së urdhërume e asaj të domosdoshme zbatonin synetet e Pejgamberit a. s. dhe bënin shumë nafile=vepra të mira por të pa detyrushme. Ata veç farzevet e syneteve bënin dhe shumë mustehabe=punë të pëlqyeshme tepër detyrës për të kënaqur Allahun xh. sh. se Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ata që bëjnë vepra të mira ju takon e mira edhe më shumë". S. Junus. ajeti. 26. Në këtë mënyrë ata bëheshin të dashur dhe shembull për njerëzit tjerë. Ata edhe në hallallet=në të lejushmet nuk e tepronin. Një shembull nga punët e mira është agjërimi i 10 dhjetë ditëve të para në muajin hënorë Dhulhixhe. Ky agjërim vërtetë nuk është farz=i detyrushëm sikurse agjërimi i Ramazanit por është i pëlqyer tek Allahu xh. sh. agjërimi në këto dhjetë ditë. Për rëndësinë e këtyre dhjetë ditëve Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Beto hem për dhjetë netët=dhjetë ditët." S. Fexhër. ajeti. 2. Murshidat e dikurshëm gjithashtu i kishin vënë vehtes një kufi edhe për gjërat e lejushme. Ata nuk e tejkalonin masën edhe në gjërat hallall. Ata ruheshin edhe nga gjërat e vogla të dyshimta, nga mufsidet = nga ata gjëra që të neverisin. Ja një shembull; Gruaja e Pejgamberit a. s. hazreti Aisheja r. t. a. është betuar në Allahun xh. sh. duke thënë se Pejgamberi a. s. nuk ka parë gjë të fulliqur tek un e as unë nuk kam pa gjë tek ai". [Është fjala për aurretin=organet e turpëshme]. E që e kishim fjalën për prinjësat= murshidat ata vëpronin me përpikëmeri sipas shariatit=ligjit të fes Islame. Baza e tyre për të mësuar ishte Kurani dhe shembull për të vepruar ishte profeti i lavdishëm hazreti Muhamedi a. s. që nderimet më të mëdhaja dhe lëvdatat më të bukura i meritonë ai. Vetëm Zoti, i Zoti, Zotënija, i Lartëmadhërueshmi e i Plotëfuqishmi nuk e lejon Kurani ti thash atij, dhe asë lutje nuk lejohet ti bëjsh atij. Sot si kudo nëpër botë dhe në trevat shqiptare janë disa njerëz të pa ditshëm, mendje lehtë e ngatërrestarë që thonë se jemi në tarikat por që nuk veprojnë sipas shariatit Islam të bazuar në Kuran. Këta njerëz me veprimet që bëjnë në kundërshtim me Kuranin dalin kundër fesë Islame. Allahu xh. sh. në Kuran për të tillë njerëzish thotë: "Ata nuk e studiojnë me vëmendje Kuranin. S. Muhamed. ajeti. 24. Ndërsa një pjesë e këtyre njerëzve ja u ka qefi të veprojnë ashtu se duan të mos mundohen me detyrat e fesë me ibadete, ndërsa një pjesë tjetër veprojnë qëllimisht për ti shkatërruar muslimanët dhe fenë Islame.

18-MURSHIDJA AISHE MORI NJOFTIME PREJ ALLAHUT XH. SH. PËR DISA DIJETARË MUSLIMAN TË DEVOTSHËM TË VENDIT TONË.

Në fushën fetare Islame nga populli shqipëtar kan dalë shumë dijetarë të cilët kanë punuar gjithë jetën e tyre për edukimin moral fetarë të popullit tone që njerëzit të jenë të lumtur në dy botët këtu dhe në jetën pasë vdekjes. Disa nga këta dijetar musliman kanë qenë njerëz të devotshëm, njerëz me grada prej Allahut xh. sh. Ata kanë qenë njerëz me dije të thellë e me hikmet prej Allahut xh. sh. . Këta njerëz të rrallë kanë qenë të dalluar nga të tjerët. Muxhedidja Aisheja rahmetullahi alejha thoshte se Allahu xh. sh. më lajmëroi mua, që prej dijetarëve të devotshëm Islam me grada ke Allahu xh. sh. në vëndin tonë në mesin e shekullit të njëzetë, kanë qenë; dijetarët e njohur Haxhi Hafiz Mahmud Dashi nga Tirana dhe Sheh Qazim Hoxha nga Shkodra. Allahu xh. sh. i mëshiroftë ata. Në vitin 1930 qyteti Shkodra ka qenë qendra e diturisë Islame në Shqipëri.

Sheh Qazimi Hoxha ishte në tarikatit Tixhani. Ai vepronte sipas sheriatit Islam. Këto njerëz kanë qenë me hikmet-me urtësi-me dije e devotshmëri të madhe. Për këto llojë njerëzish si këto flet Allahu xh. sh në Kuranë e thotë; "A tyre [njerëzve] që u është dhënë hikmeti, ju është dhënë një shumicë e mirësive." S. Jusuf. Sheh Qazim Hoxha ndërroi jetë pasi muxhedidja Aishe ishte ngarkuar nga Allahu xh. sh. me shërbimin e tobës por ajo nuk më tha që e takoi personalisht atë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se duke qenë zgjuar e po merresha me punët e shtëpisë mora këtë lajm nga Allahu xh. sh. për vdekjen e Sheh Qazim Hoxhës rahmutullahi alejh kështu; "Sot ndërroi jetë sheh Qazim Hoxha. Vdekja e tijë i sollti dëm banorëve të vendit." Ndërsa me ilham=me frymëzim thoshte muxhedidja Aishe e mora njoftimin kështu: "Por jo në gradën tënde se ti je e ngarkuar me shërbim." [Se ajo ishte me shërbimin e thirrjes në tobe]. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ne ngrejme në shkallë të lartë atë [njeri] që duam". Sure En-nam. Aj. 83. Mos çuditi o besimtar për njoftimet e veçanta që u jep Allahu xh. sh. njerëzve të Tij të dashur për njerëz të ndryshëm. Shembullin e kemi tek Pejgamberi a. s. të cilin e lajmëroi Allahu xh. sh.

për vdekjen e Nexhashiut ishë mbretit të Abisinisë në atë kohë=sot Etiopia. Pejgamberi a. s. i lajmëroi shokët e vet për vdekjen e tij. Dhe që e kishim fjalë më sipër; vërtetë ata që e kanë njohur; e kanë vlerësuar tamam diturinë e thellë-urtësinë dhe moralin e njeriut të devotshëm Sheh Qazim Hoxha rahmetullahi alejh i cili ishte profesor disa vite në medresen e Tiranës. Shkalla e diturisë dhe devotshmërisë së tij kuptohet kur lexojmë pjesë nga predikimet e tij në ish revistën e përmuajshme të Komunitetit Musliman të Shqipërisë me titullin Zani i Naltë.

19-PJESË NGA PREDIKIMET FETARE ISLAME TË DIJETARIT TË DEVOTSHËM ISLAM SHEH QAZIM HOXHA NGA SHKODRA.

Ndër të tjera Sheh Qazim Hoxha rahmetullahi alejh thotë se Allahu xh. sh. tregon në Kuran se besimtarët e vërtetë janë ata që kanë këto tre cilësi. 1-Duan Zotin xh. sh. 2-Duan Pejgamberin a. s. 3- Përpiqen në rrugën e Zotit xh. sh. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Thuaju [besimtarëve o i darguari im]; Në qoftëse etërit tuaj, [prindërit tuaj] bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasurija që e fituat, tregëtija që frikësoheni se do të dështojë, vendëbanimet me të cilat jeni të kënaqur, [nëse të gjitha këto] janë më të dashura për ju se Allahu, se i dërguari i Tij [Muhamedi a. s.] dhe se lufta [e përpjekja] për në rrugën e Tij, [rrugën e Allahut xh. sh.], atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin e Tij. Allahu nuk i vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur [popullin që bën punë të liga]." S. Tobe. ajeti. 24. Njerëzit që nuk e duan Zotin xh. sh. dhe Pejgamberin a. s. në bazë të ajetit të Kuranit që themë quhen fasikë-të prishur= njerëz që nuk i shtrohen asnjë ligji e rregulli të caktuar. Rruga e lartësimit moral e shpirtërorë është dashurija për Allahun xh. sh. dhe Pejgamberin a. s. dhe përpjekja, sakrifica e deri në dhënjen e jetës që duhet të bëhet për këta dy ideale të larta. Dashurija në Zotin xh. sh. njeriun që ka ra poshtë moralishtë e ngren në shkallët ma të larta. Që ta themi me termat e Kuranit e ngre nga esfeli safilini e ngren në shkallën e lartë aëlai ilijjin. Vërtetë se njeriu nuk është i pa gabueshëm, se është njeri, por dashurija e madhe që ka në Zotin xh. sh. e mbron nga punët e liga. Dashurija në Zotin xh. sh. njeriut ia zhduk egoizmin dhe e bën altruist. Dashuri-

ja në Zotin xh. sh. njeriut ia shëron të gjitha sëmundjet e zëmrës e të shpirtit si, krenarinë=madhështinë, vetëpëlqimin, mëninë, tradhëtinë, smirën=hasedin, hipokrizinë, dinakërinë e tjera e tjera vese të liga. Dashurija në Zotin xh. sh. është ilaçi që pastron zemrën, pastron shpirtin. Është një zjarrë që i djegë të gjitha veset. Dashurija në Zotin xh. sh. është rruga më e shkurtër që të afron tek Ai. Dashurija për Zotin xh. sh. arrihet vetëm me dëshirën e Tij e fitohet nga njeriu duke bër vepra të mira. Zoti xh. sh. mirësitë e Tij morale e materiale i ka shpërndarë te njerëzit nëpërmjet një rregulli të caktuar nga Ai. Ai nuk e ka ba ligjë që mirësitë e Tij ti shpërndajë pa përpjekjen e mundin tonë, sado që Ai e ka fuqinë me e ba këtë punë. Mirësija më e madhe e Allahut xh. sh. për muslimanin e vërtetë është me dashtë atë. Mjeti me të cilën fitohet kjo dashuri arrihet atëher kur të ndjekësh me sinqeritet së bashku Sheriatin= ligjin fetar Islam dhe Hakikatin-të vërtetën pa hile =pa aspak hipokrizi. Për tu ba i dashur tek Zoti xh. sh. duhet të të ecësh ose të fluturosh si zogu që fluturon me të dy krahët. Duhet sheriatit dhe hakikati=sinqeriteti që do të thotë se ligjin fetarë ta zbatosh pa asnjëllojë interesi në dynja por vetë për të fitu kënaqësin e Zotit=kënaqësinë e Allahut xh. E megjithatë puna përsëri qëndron në dëshirën e Allahut xh. sh. i cili thotë; Juhib-buhum ve juhib-bunehu=Zoti i do ata edhe ata e duan Zotin. "Në një rën anë duhet me ndjek=me zbatuar sheriatin= ligjin e fesë Islame dhe në anën tjetër me i pasë qëllimet të pastra pa hile e dredhina, me qënë i vërtetë në fjalë dhe i sinqertë në veprime. Për të qënë të pranushme tek Zoti xh. sh. punët tona të mira, duhet të kenë shpirtë, dhe shpirti i tyre është qëllimi i kulluar ose ndryshe ihlasi. Ihlasi e ka kuptimin me zhdukë nga vetja rijanë=punën për sye faqe-për tu dukur, dhe shirkun e fshehur, hipokrizinë dhe po- liteizmin e fshehtë. Një dijetarë i njohur Islamë ka thënë; shpirti i pu- nës është kur gjindet në të sirri ihlasi-sekreti i thjeshtësisë. Ndërsa sirri ihlasi e ka kuptimin; Nefjul-uxhbi ve mulahadhatin-nefsi" Do me thënë; Me zhdukë mendimin ose kujtimin për veten tonë se jemi dikushi dhe bëjmë ndonjë gjë vetë pa fuqinë e Zotit xh. sh. Uxhbi do me thënë me u mbështet vetëm në fuqinë tënde dhe me harru fuqinë e Zotit xh. sh. e ndihmën e Tij. Pejgamberi jonë a. s. ka thënë tre punë e prishin njeriun. Këto janë; 1 Me qenë sarraf= koprrac=dorë shtërngutë me iu bindë këtij vesi, 2 Me u dhënë pasë dëfrimeve epshore. 3 Egoiz-

mi=vetëpëlqimi duke thënë ose menduar se unë di ose unë kam e unë jam dikushi. I pari që ka thënë fjalën [unë] ka qenë shejtani-djalli i mallkuar. Pra vëllezër besimtarë punët tona duhet ti bëjmë me qëllim të kulluar-me ihlasë, se ihlasi është shpirti i punës. Për ta sjellë në vend ihlasin duhet ta zhdukim egon=unin. Që ta zhdukim këtë ta dimë ta mendojmë dhe ta shprehim me gojë fjalën; La havle ve la kuv-vete il-la bil-lah. =Nuk ka fuqi tjetër veç Allahut=veç Zotit. [xh. sh.]. Pejgamberi a. s. ka thënë: “Allahu xh. sh. nuk shikon trupat tuaj as fytyrat tuaja, as veprat tuaja por shikon zemrat tuaja dhe qëllimet tuaja në veprat=punët që bëni. ”Njerëzit që i falen Zotit xh. sh vetëm me trup por pa dëshirë e dashuri në zemër por vetëm për të kryer detyrën që iu është ngarkuar nga Ai, cilësohen me partikularitet me [ferd]. Ata që i falen Zotit xh. sh. me zemër-me gjithë shpirt cilësohen me xhem-un=me bashkim, dhe kush i ka të dyja këto quhet njeri i plotësuar [insani qamilë]. Allahu xh. sh. e krijoi njeriun dhakir [përmendës] që ai ta përmendi Allahun xh. sh. hapur dhe fshehurazi. E bani dhe medhkur të përmendur. E përmend Allahu xh. sh. njeriun e dashur të Tij tek krijesat e tjera=tekë engjëjt. Në Kuran thuhet; “Ve le dhikrull-llahi ekber”. Me të përmend Zoti është mirësia më e madhe. Kësaj shkalle në radhë të parë ia kanë arritur Pejgamberët paçin selam dhe pastaj ata njerëz që patën dashuri të madhe për Zotin xh. sh. dhe Pejgamberin a. s. Ata njerëz që e kërkojnë përsosmërinë ose plotësimin prej nefsit=dëshirës së vet jepen shumë pas dynjasë duke kërkuar të mbledhin mall e pasuri jashtë ligjeve të Zotit xh. sh. Më vonë kërkojnë me zënë rangje e pozita të larta shtetërore e shoqërore, pastaj kërkojnë me zaptuar toka dhe më në fund aq shumë ju rritet mendja sa që e mohojnë fare Zotin xh. sh. dhe pretendojnë se janë Zoti estagfirullah, estagfirullah. Pra duan që të tjerët më poshtë ti thërrasin ata Zoti estagfirullah; siç po i shohim dhe po i dëgjojmë sot këta lloj njerzish. Zoti xh. sh. na ruajt imanin. Allahu xh. sh. i ruajtë besimtarët e Tijë. Shembull ata që pretendojnë për Zotër kanë Firaunin dhe Nemrudin. Ku është sot Firauni e Nemrudi dhe pasuria e tyre? Kjo kategori njerëzish si këta që kërkojnë me qënë dikushi duke u nisur prej dëshirave të gabuara të vetes së tyre janë në errësirë dhe nuk mundet që të dalin në dritë. Për këtë kategori njerëzish Allahu xh. sh. thotë në Kuranë: “In nel insane le jetga en reahustagna”= “Me të vërtetë njeriu rrebelon =ngren krye,ban tangërlilik=i rritet

mendja po të pasurohet. "Sheh Qazim Hoxha gjithashtu i këshillonte njerëzit që nuk punonin as për dynja e as për ahiret se Pejgamberi a. s. ka thënë; Marrja e njeriut me punë të kota të pa dobishme është shenja që tregon se Zoti xh. sh. ka heq dorën e mëshirës së Tij prej atij njeriu... Pejgamberi gjithashtu ka thënë; Puno për këtë jetë për aqë sa do të qëndrosh këtu, puno për Ahiretin për aq sa do të qëndrosh atje, puno për xhehenemin [ruhu nga xhehenemi] për aqë sa do mundë të durosh atje; puno për Zotin xh. sh. aq sa ia ke nevojën Atij. "Afrimi i njeriut në këtë botë me Zotin xh. sh bëhet duke u paisur me moralet e larta që urdhëron Ai. Prandaj ka dhën urdhër Zoti xh. sh. kështu: "khal-leku bi akhalakil-lahi"-vishuni paisuni me moralet e Zotit=me moralet që do Zoti xh.sh. Kjo bëhet duke mësuar dituri të saktë duke krye rregullishtë namazin duke ba bamirësina duke thirrë njerëzit në rrugën e Zotit xh. sh. duke vepruar drejtë dhe duke fol drejtë duke ba vazhdimisht punë të mira dhe duke i këshilluar njerëzit që të largohen nga veprat e liga që i ndalon sheriat=ligji i fesë Islame. Atëherë secila nga këto veprime të mira na afron me Zotin xh. sh. por jo në ditancë por në miqësi me Të. Afrimit me Zotin xh. sh i bëjnë shenjë këta ajete Kurani; 1-Ve jeseluneke anir-Ruhi kuli ruhu min emri Rab bi ve ma utitum minel ilmi il la kalila. " D. m. th. Të pyesin ty për shpirtin [o Muhamed] thuaju [njerëzve] shpirti është çështje që i përket Zotit tim e juve [njerëzve] ju është dhënë shumë pakë dije."2-Fe idha sev vejtuhu ve nefakktu fihi min ruhi" Thotë Allahu xh. sh; Kur ti jap formën [njeriut] dhe ti fryjë shpirt=ti jap shpirtë që është krijesë e imja. "Ka dhe të tjerë ajete që nuk është më nevoja me i përmend. Vërtetë i thelluar në dijen Islame ishte Sheh Qazim Hoxha nga Shkodra që Allahu xh. sh. e kënaqtë me të mirat e xhenetit. Tregova pakë nga predikimet e Sheh Qazim Hoxhës rahmetullahi alejh për të kuptuar diturine e vlerën e tij duke vërtetuar kështu lajmin që mori prej Allahut xh. sh. për këtë dijetar musliman të devotshëm muxhedidja Aishe rahmetul-lahi alejaha. Është pa dyshim lajm prej Allahut xh. sh. nëpërmjet melekut=engjëllit fjala që tha muxhedidja Aishe, për Sheh Qazim Hoxhën me këto fjalë; "Sot ndërroi jetë Sheh Qazim Hoxha. Vdekja e tij i solli dëm banorëve të vendit. " Ai vërtetë ishte njeri me gradë të lartë tek Allahu xh. sh. por jo në gradën e muxhedides Aishe se vetë Allahu xh. sh. thoshte ajo më njoftojë mua kështu; "Por jo në gradën tënde se ti [Aishe] je e dër-

guar me shërbim. "[Aisheja rahmetullahi alejha ishte e ngarkuar me shërbim prej Allahut xh. sh. për thirrjen e popullit për të bërë tobe.

**20-NJOFTIMI QË MORI NGA ALLAHU XH. SH. MUXHEDIDJA
AISHE PËR DIJETARIN DEVOTSHËM ISLAM HAXHI HAFIZ
MAHMUD DASHIN NGA TIRANA.**

Haxhi Hafiz Mahmud Dashi rahmetullahi alejh ka qënë një dijetarë musliman i dëgjuar në vendin tonë. Ai ka qënë njeri me kulturë të lartë shpirtërore, ka qënë njeri shumë i devotshëm. Populli e kujtonte në atë kohë dhe e kujton dhe sotë me shumë respektë këtë dijetar mjaftë popullor. Hafiz Haxhi Dashi lindi në Tiranë në vitin 1873 dhe ndërroi jetë në vitin 1961. Ai ishte vendas në Tiranë. Ka qënë profesor në medresen e përgjithshme të Tiranës. Gjithashtu ka qënë dhe imam xhamije deri sa ndërrojë jetë. Allahu xh. sh. e mëshiroftë duke i bërë rrisk xhenetin atij. Sot medreseja e përgjithshme në Tiranë, mban në shenjë respekti emrin e tij.

Për Haxhi Hafiz Dashin, muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se mora dije nga Allahu me këtë rrujë=ëndërr=pjesë filmike mes gjumit e zgjimit kështu në këtë mënyrë: Haxhi Hafiz Dashi më dha mua një letër, që në të ishin shkruar katër emrat e melekëve-engjëjve të mëdhej, Xhebrail, Mikail, Israfil, Azrail dhe secili emër lëshonte nga një llojë drite me ngjyrë të bukur secili i veçantë nga tjetri. A aty thoshte; Punën e fesë po ta lë ty tani Aishe, në dorë shikoje mirë ti atë, "Kurani thotë; "Allahu zgjedh të dërguar prej njerëzve dhe engjëjvet." S. Haxh. aj. 75-76. Në Kuran Allahu xh.sh. thotë: "Allahu e di më mirë ku ta vë risalen-dërgesën e vet. "S. En-nam. ajeti. 124. Aisheja qoftë i kënaqur Allahu xh.sh. prej saj thoshte; Nga kjo ëndërr që më shfaqti Allahu xh. sh. nëpërmjet melekëve-engjëjve unë kuptova se Haxhi Hafiz Dashi kishte qënë njeri i devotshëm dhe me hikmet= urtësi-hollëkuptim dhe vigjilent për ruajtjen e pastërtis së fesë Islame nga bidadëcijtë e nga armiqtë saj. Ai ishte dhe një faktor unifikimi mes muslimanëve. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Për ju krijuam imamë [prijës] që me urdhërin tonë udhëzojnë" S. Sexhde A. 24. Pra është kuptimi që me hidajetin= udhëzimin e hikmetin=diturinë e thellë ose hollë kuptimin tonë që u japim atyre, ata i tregojnë me fakte e shembulla konkrete

rrugën e drejtë njerëzve. Kurse në suren Bekare ajeti 269 Kurani thotë: "Allahu ia dhuron hikmetin [diturinë e thellë] kuj të dojë dhe atij njeriu që i është dhënë hikmeti, me të vërtetë i është dhënë, një shumicë e mirësive" Dhe e dyta thoshte murshidja Aishe kuptova se Haxhi Hafiz Dashi për së shpejti do të largohej nga kjo botë e përkohëshme për në ahiret. Nuk kaluan veçse dy, tre muaj dhe Haxhi Hafiz Dashi koloj nga kjo botë, ndërroi jetë. Allahu xh. sh. e mëshiroftë. Për shkallën e diturisë dhe gradën devotshmërisë së Haxhi Hafiz Mahmud Dashit flasin shumë populli musliman që e kanë njohur dhe dëgjuar për të nga shumë qytete të Shqipërisë. Edhe un po ju tregoj juve fjalët që kam dëgjuar për këtë njeri nga besimtarët e vjetër musliman të cilët më kanë treguar për devotshmërinë dhe diturinë e tij. Në një rast disa njerëz i thanë Haxhi Hafiz Mahmud Dashit këto fjalë kështu: Lum si ti o Hafiz efendi se me punët e mira të shumta që ke bërë e ke fituar inshallah xhenetin, por mjerë halli i jonë; Ti ke dhënë shumë dije në popull, ti ke mësuar shumë nxënës, ti je Hafiz Kurani, ke kënduar shumë Kuranë, namazin e ke filluar që i ri në moshë dhe ke qenë në haxh. Ndërsa Haxhi Hafiz Mahmud Dashi ju thotë atyre këto fjalë; Për ato punë të mira që përmendët ju, për një pjesë nga ata, unë i kam marrë shpërblimet e tyre pak ose shumë këtu në këtë dynja se populli mua më ka respektuar. Për nxënësit jam paguar, për hafizllëkun që kam mësuar, jamë imam në xhami dhe paguhem ndërsa për namazin dhe haxhin un kam bërë detyrën që na është urdhëruar nga Allahu xh. sh. por vetëm për shkakun e një gjëje un rrij me shpresë që të fitoj xhenetin me dëshirën e Allahut xh. sh. dhe kjo gjë është se : Gjashtëdhjetë vjet rreshtë mua nuk më ka mbetur asnjë ditë pa e falur në kohën e vet namazin e sabahut. Kjo gjë është një argument i fortë që tregon gradën e Haxhi Hafiz Mahmud Dashit rahmetullahi alejhi. Ai vdiq në moshën 88 vjeç. Vërtet gjë e çuditshme kjo gjë. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Vërtetë namazi i sabahit= mëgjesit është i mbikqyr=është i shikuar me kujdes = i përcjell me vigjilencë nga Allahu xh. sh. dhe engjëjt e Tij." S. Isra. 78. Gjithashtu për të kuptuar sinqeritetin e devotshmërinë e Haxhi Hafiz Mahmud Dashit, përkushtimin e tij në fe me fjalë dhe vepra sipas Kuranit duket qartë dhe nga kjo bisedë e tij me ish mbretin e vendit tonë Ahmed Zogun. Mbreti në atë koh kishte bërë një takim me kuadrot=dijetarët e fesë në Shqipëri. Të gjithë kur e e kishin takuar mbretin e kishin

përshëndetur për respekt atë me titullin naltëmadhni=ose lartmadhë-ri që në gjuhën Arabe do të thotë Meuvlana] Edhe gjatë bisedës me të gjithë dijetarë e fesë i drejtoheshin mbretit me titullin Lartmadhëri. Ndërsa Haxhi Hafiz Mahmud Dashi përdorte për respekt ndaj mbretit titullin Bej gjatë bisedës me të sipasë fjalëve në bisedë po ose jo o Ahmed bej. Mbretit i kishte bërë përshtypje ky ndryshim nga të tjerët i Haxhi Hafiz Dashit, përse i takonte titullimit të tij në shenjë respekti. Mbasi kishte mbaruar takimin mbreti Ahmed Zogu kishte njoftuar që Hafiz Haxhi Mahmud Dashi të qëndronte pak pasi mbreti kishte një bisedë me të. Mbreti i kishte thënë Hafizit; Dua të më tregosh të vërtetën se mua më intereson ajo. Përse të gjithë dijetarët e tjerë më thoshin mua për respektë Naltë madhëri, kurse ti më thoshe Ahmed bej? Bejlerë në Shqipëri ka shumë ndërsa Naltëmadhëri nuk ka tjerë. I devotëshmi Haxhi Hafiz Mahmud Dashi i tha këto fjalë; Ti o mbret je fis bejlerësh edhe unë Ahmed Bej po të themi; Ku po do me shku më ? Në hava=në ajër=në qiell? Naltëmadhëria është për Zotin xh. sh. që ka krijuar qiellnat dhe tokën. Madhërimi i lartë ose ndryshe lartmadhërimi i takon vetëm Mbretit të Gjithësisë-Zotit=Allahut xh. sh. e jo ty që je robë i Zotit xj. sh. je krijesa e Tij. Kurani famëlartë thotë; "Vetëm Atij[Allahut] i takon lartë madhëria-madhërimi i lartë pa kufi në qiellna dhe në tokë. . . " Sure Xhathije Aj37. Me të vërtetë titujt e mëdhej si ky për të cilin po flasim, lartëmadhëri, ose i madhërueshmi, i plotë fuqishmi, ose mbreti i gjithësisë janë të posaçëm vetëm për Sovranin e Botrave Allahun e madhërueshëm xh. sh. që është Krijuesi Gjithësisë. "Ti o mbret i tha Haxhi Dashi shtëpi bejlerësh ke qënë edhe unë ty Ahmed Beu po të themi nuk po ta mohojë atë që je. Mbreti Ahmed Zogu pasi kishte ulur pak kokën i kishte thënë atij; Mirë o Hafiz efendi por a vetëm ti e lexon Kuranin, apo dhe dijetarët e tjerë? Haxhi Hafiz Dashi i tha mbretit kështu: Kuranin ka shumë njerëz që e këndojnë por pak janë ata që veprojnë si pas tij.

Ata që të thonë ty o Ahmed Bej sot naltëmadhëri e kanë hallin me mbush barkun si lopët, se nesër nëse ti o Ahmed Bej bie nga fronin mbretëror, nuk kanë për të folë me gojë më dhe nëse del në rrugë, ty nuk kanë për të thënë as si u ngryse o Ahmed por vetëmse kanë për të sharë. Mbreti Ahmed Zogu vuri buzën në të qeshur e i tha Haxhi Hafiz Mahmud Dashit; Unë nuk kam detyruar asnjë njeri që të më thotë mua lartëmadhëri, por gazetarët e kanë shpikur

vetë këtë gjë i tha mbreti. Haxhi Hafiz Mahmud Dashi rahmetullahi alejh i tha; Këtë gjë e di ti; un nuk di gjë. Me kaq biseda mes tyre kishte marr fundë. Gjithmonë drejtë dhe bukur me urtësi=me hikmet, fliste i devotëshmi Haxhi Hafiz Mahmud Dashi rahmetullahi alejh, për të cilin lajmëroi muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha se ai ka qënë njeri me grada tek Allahu xh. sh. Me të drejtë sot medreseja e Tiranës mban emrin Medreseja Haxhi Hafiz Mahmud Dashi. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha më tregoi mua dhe një sekret personal për mirë të Haxhi Hafiz Mahmud Dashit që ajo e mori prej Allahut xh. sh. por un këtë sekret personal të tij nuk po e tregoj duke pas parasysh një ndër dhjetë porosinë që Hizri i beku i dha hazreti Musait a. s. e cila ishte kjo këshillë: "O Musa mos e hap atë derë që nuk mund ta mbyllësh më" Dijetari me hikmet Haxhi Hafiz Mahmud Dashi rahmetullahi alejh u fliste popullit sipas diturisë e fuqisë mendore që ata kishin me shembulla të bukura konkrete të qarta dhe nga njëherë dhe në formë bejtesh. Një rastë e pyetën Haxhi Hafiz Dashin disa besimtarë për festimin e ditës së quajtur dita e shëngjergjit apo shënjeqit sikurse i thonë Tiransit. Haxhi Hafiz Dashi u tha atyre; Kësaj dite i thonë shënjeqi për ata që nuk kanë punë, gjetshin belanë magjypët e katundarët, që u hynë kaurrvet ndër hundë. [ishte fjala bëjnë festat e kristianëve. Unë shkruesi i librit këtë njoftim që më dha mua muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha për Haxhi Hafiz Mahmud Dashin rahmetullahi alejh, ia tregova ish nxënësit të Hafiz Haxhi Dashit, ish medresistit Mehmet Balla nga fshati Farkë e Tiranës, mësues i shkollës laike në fshat në kohën e rregjimit komunist dhe hoxhë i fshatit në rregjimin demokratik. Mehmeti pasi u mendua pak kur dëgjojë nga unë fjalët e muxhedides Aishe për Haxhi Hafiz Dashin tha: Vërtetë kjo që po më tregon ti mua për Hafiz Haxhi Dashin po më bën të mendohem. Unë tha Mehmeti vërtetë shikoja tek Haxhi Hafiz Dashi disa cilësi që nuk i shikoja tek të tjerët. Ai më tha se Haxhi Hafiz Mahmud Dashin nuk e shikoja asnjëherë që ta shkonte kohën kot, pa bërë ndonjë ibadet=punë të mirë që ka urdhëruar Zoti xh. sh. Ai jashtë orës së mësimit në medrese ose falte namazë nafile, ose kur kishte njerëz aty fliste e tregonte për besimin-për fenë e kur nuk kishte njerëz për tu folur atyre për fenë, ai bënte vazhdimisht zikër Allahun xh. sh. Vërtetë Allahu xh. sh, në Kuran ka thënë : "Udhkurullahe dhikren kethira."=Përmendeni Allahun

shumë. " Haxhi Hafiz Dashi tha ai vërtet ishte njeri i thelluar në dijen e fesë Islame. Hoxha Mehmet Balla më tha se Haxhi Hafiz Dashi kurrë nuk e shkante kohën kot asnjëherë me fjalë boshe. Sipasë kësaj që më tha ai, unë themi që Hafiz Haxhi Dashi e kishte kuptuar ashtu si duhet Kuranin e madhërshëm për çdo gjë që flet ai. Ai në këtë rast e kishte kuptuar si duhet plotësisht kuptimin e sures Asër=Kapitulli Koha, ku Allahu xh. sh, thotë: "Vel asri....

"Beto hem për kohën, se vërtetë njeriu është në humbje të sigurtë, me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njerëzit për drejtësi dhe që këshilluan për durim. " Kështu që Haxhi Hafiz Mahmud Dashi e zbatonte Kuranin me përpikmëri. Vërtetë është për tu çuditur se rregjimi komunist i futi në burg të gjithë hoxhallarët e njohur, vetëm Haxhi Hafiz Mahmud Dashin nuk e burgosi. Kjo është vërtetë çudi. Unë mendoj se ky njeri nga të tjerët pa dyshim ka patur imunitet=pa paprekshmëri=kishte mbrojtje prej Allahut të plotëfuqishëm. Kjo nuk mund të kuptohet ndryshe kur regjimi komunistë në burgje nuk i kurseu as grate. Hamid Shehri ish arsimtarë dhe sot është në moshën 80 e ca vjeç më tregoi mua kështu: Un jam nga fisi i Hysen Shehrit. Origjina jonë është nga fshati Surrel i Tiranës. Fisi jonë ka ardhur në Tiranë rreth vitit 1600. Gjyshi im me dijetarin e njohur Islam të asaj kohe Hysen Shehri kan qenë djem xhaxhallarësh. Hysen Shehri dhe Isuf Zorba kan qenë dy mësuesat e Haxhi Hafiz Mahmud Dashit. Un tha Hamidi pak e mbaj në kujtesë dijetarin e dëgjuar të Tiranës Hysen Shehri. Mua më kujtohet se shkuam me disa fëmij të fisit e lagjes time për ti uruar festën e Bajramit dijetarit të nderuar Hysen Shehrit. Në atë kohë un isha i vogël dhe pak e kam në kujtesë por më kujtohet se ai na jepte lekë neve fëmijëve. Atë ditë në festën e Bajramit ai ishte veshur një xhybe jeshile dhe çallmën në kokë e kishte të bardhë. Kjo Kjo hera e fundit që e pashë atë se ai nuk zgjati shumë dhe vdiqë pasi ishte i vjetër e i sëmurë në atë koh bashkë me gjithë gruan e tij. Ndërsa Haxhi Hafiz Dashin un e kam njohur mir se isha i rritur, isha i martuar. Haxhi Hxfiz Dashi ishte njeri me shumë autoritet ose sikurse e thoshim ne në atë kohë fjalën: Njeri me rytbe, me shumë itibar. Ishte vërtet çudi se Haxhi Hafiz Mahmud Dashi ta impononte edhe pa dashur rrespektin ndaj tij. Kjo gjë ishte e çuditëshme dhe shihej qart kudo që shkante ai. Këtë gjë e thoshin të gjithë, besimtarë e jo besimtar.

Ai rrinte shumë pastër. Veshja në trupin e tij shkëlqente dritë. Me që e kemi fjalën për Hafiz Mahmud Dashin, po ju tregoj përsëri një ngjarje mes tij dhe mësimit të tij Hysen Shehrit të cilën mua shkruajtë të librit ma ka treguar i biri i Haxhi Hafiz Mahmud Dashit, Muharremi kështu: Haxhi Hafiz Dashi sapo kishte mbaruar studimet. Një rastë jashtë Tiranës i ishte paraqitur nevoja që të japi fetva= zgjidhje me argumenta për një çështje me rëndësi. Ai e kishte dhënë në rregull rrugë zgjidhjen e çështjes, por mësuesin e tij e kishte informuar se goja ish nxënësi i tij e kishte thënë gabim fjalën. Mësuesi ishte mërzhitur dhe pa dashur, pa qëllim të keq i kishte rrëshqitur goja dhe iu kishte thënë shokëve të vet kolegëve të tij, se Tutin sikurse ja thoshin shkurtimishtë emrin mësuesit Haxhi Hafiz Mahmud Dashit; Vall-llahi kam për ta rrahur, kam për ti ra disa herë me shkop në kurriz që mos të gaboje më.=[goditje të lehta me domethënje për vërejtje]. Pas tre katër ditësh, djali i ri Mahmud Dashi që sapo kishte filluar të japi mësimet feje në popull, kur erdhi te mësuesi i tij ia tregon të vërtetën se qysh ishte. Mësuesi u qetësua dhe u kënaq nga fetvaja në rregull [argumente për zgjidhjen e problemit] që u kishte dhënë njerëzve atje në atë vend ish studenti i tij i ri Hafiz Mahmud Dashi por ai ishte betuar se do ta rrihte duke i ra mbrapa kurrizit disa herë me shkop. Mësuesi i thotë të vjeshë nesër këtu përsëri. Profesori Hysen Shehri ose Isen Shehri sikurse i thoshte populli i Tranës, porositi disa thupra prej shelku të qëruara me të cilat bënin kosha në atë kohë dhe të lidhura tufë = dengë i mbajti aty. Të nesërmen kur vjen ish nxënësi i tij Hafiz Mahmud Dashi, mësuesi i tregon atij për fjalët që ishte betuar dhe i thotë tani këtheje kurrizin që të zbatojë fjalën se jamë betuar. Ish studenti i tij Hafiz Mahmudi i thotë duke qeshur; Po zbatoje mos e theyej betimin o mësuesi im Isen Efendi. Profesor Hysen Shehri e godet me dengun e thuprave vetëm një herë mbrapa kurrizit që mos ta dëmtonte djalin e ri studentin e dalluar Hafiz Mahmud Dashin, por që dhe betimin në Allahun=në Zotin xh. sh. ai mos ta thyente. Vërtetë Allahu xh. sh. na tregon këtë shembull në Kuran për raste si ky, me profetin Ejub a. s, kur Allahu xh. sh, i thotë atij: “E merre me dorën tënde një deng thupra dhe bjeri me të [asaj ose atij], e mos e theyej betimin; Vërtetë ne e gjetëm atë [Ejubin] të durushëm...”S. Sad. aj. 44. Kështu dijetarësh Islam ka pasur dikurë populli Shqiptarë, të cilët i zbatonin me përpikmëri urdhëresat e Allahut xh. sh. që jepen

në Kuran. Ata ishin vëtet njerëz që e kishin shumë frikë Allahun xh. sh. Ndërsa hoxhallarët tanë të rinjtë sot në këtë kohë tek ne dhe kudo në botë, veçse grinden e bëjnë konkurecë me njëri tjetrin me mjekra, pantallona apo xhelabije, me çallma ose qeleshe të bardha dhe grinden me njëri tjetrin duke thënë se unë e di këtë hadith dhe ti nuk e di. Ndërsa për Kuranin fjalën e Allahut xh. sh. as që e zënë fare në gojë. Ata nuk po i dëgjojmë asnjëherë që të kritikojnë veten e tyre e të thonë se jemi me gabime shumë por Allahu xh. sh. na faltë=na mëshiroftë por thonë vetëm fjalën; unë e di, ai nuk di gjë. Nga goja e tyre sot dëgjohet vetëm fjala; un, un dhe vetëm unë. Fjalën un për të kundërshtuar të vërtetën e ka thënë djalli i mallkuar. Vëllezër besimtar ta dini se Uni është i dënuar nga feja Islame Allahu xh. sh. i udhëzoftë ata të sinqertit që kanë studiuar dhe studiojnë për fenë sot në të gjithë botën dhe ata që duan të dijnë të vërtetën. Le të marrim të gjithë shembull nga dijetarët e parë të devotshëm Islam që kishin shumë dije dhe e kishin shumë frikë Zotin e madhrueshëm .

Nga sa thashë deri këtu për Haxhi Hafiz Mahmud Dashin, vërtetohet pa asnjë dyshim që njoftimet që dha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha për Haxhi Hafiz Mahmud Dashin dhe Sheh Qazim Hoxhën rahmetullahi alejhi exhmeijn, janë të vërteta prej Allahut xh. sh. Për të tillë hoxhallarësh të ditur e të devotshëm si Haxhi Hafiz Mahmud Dashi dhe Sheh Qazim Hoxha ka nevojë populli në çdo kohë kudo në çdo vënd. Rahmeti i Allahut xh. sh. qoftë për ata dhe gjithë besimtarët e sinqertë.

21-MUXHEDIDJA AISHE TREGOI PËR DIJETARË TJERË ISLAMË TË DEVOTSHËM TË VËNDIT TONË.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha fliste fjalë të mira, për Hafiz Abdullah Zemlakun nga Korça i cili ka punuar shumë për fenë Islame thoshte muxhedidja Aishe. Vërtetë Hafiz Abdullah Zëmlaku rahmetullahi alejhi ka qënë njeri shumë i devotshëm dhe ka punuar shumë pa interesë në shërbim të fesë Islame, me gojë dhe shkrim. Ai ka shkruar rreth 28 libra. Muxhedidja Aishe thoshte se mua nuk mu dha mundësia që ta takoja Hafiz Abdullah Zemlakun këtë njeri të sinqertë por Allahu xh. sh. ma shfaqti në ëndërr mua pamjen dhe punën e tij në një rast duke mësuar disa

fëmij. Allahu xh. sh. më dha të kuptoj se ai ka punuar shumë për fenë Islame. Muxhedidja e shekullit të njëzetë Aisheja rahmetullahi alejha më tregoi këtë njoftim prej Allahut xh. sh. për predikusin dhe oratorin e famshëm, profesorin e gjuhës arabe në medresen e Tiranës, Hasan Tahsinin që populli i Tiranës i thoshte për rrespekt Hasan Beu. Njoftimi prej Allahut xh. sh. ishte kështu: "Do të çuditen njerzit në ahiret [në botën tjetër] me diturinë e Hasan Tahsinin por dituria nuk i bëri dobi atij". Nga ky lajm prej anës së Allahut xh. sh. kuptohet qartë shkalla e diturisë që ka patur Hasan Tahsinin në dynja por ai gaboi rëndë dhe e dëmtoi veten se nuk bëri tobe prej shirkut gjuhësor. Ai nuk e ruajti gojën prej shirkut megjithëse u lajmërua i pari nga populli shqiptar dhe në fillim e pranoi lajmin. Muxhedidja Aishe tha se Allahu xh. sh. më njoftoi mua që: "Hasan Tahsinin është nga ata njerëz që Allahu xh. sh. ja asgjësoi veprat e mira që kishte bërë për shkakun e bërjes shirk me gojë [në gjuhën shqipe e tjera që dinte ai]". Vërtetë Allahu xh. sh. ka thënë në Kuran: "Nëse i bën shok Allahut, veprat tuja janë të azgjësuar dhe ti [o musliman] do të jesh prej të humburve". S. Zumer. aj. 65. Murshidja Aishe thoshte se Allahu xh. sh. ma shfaqti mua në ëndërr Hasan Tahsinin pas vdekjes duke ecur në një rrugë të Tiranës i veshur me një xhaketë të vjetër pa këmishë në trup. Allahu xh. sh. i tha Pejgamberit a. s. në Kuran: "Tregoj atyre [njerzvet] ngjarjen e atij [njeriut nga kombi i Musait a.s.] që i patëm dhënë dituritë Tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre, Atëher atë e shoqëroi shejtani dhe ai u bë prej të humburve". S. Araf. Aj. 175. Prandaj mendohi mir ju që e mbami veten të ditur. Thirrni mendjes. Allahu xh. sh. i sprovon njerzit, të diturit e të pa diturit. Kur vinte fjala për Hasan Tahsinin, muxhedidja Aishe thoshte gjithmonë: Allahu xh. sh. e faltë Hasan Beun se i vinte keq për të. Edhe un shkruasi i librit them: Allahu xh. sh. e faltë Hasan Tahsinin ose ndryshe Hasan Beun. Ai para se të vinte në Tiranë kishte banuar në Shkodër. Origjinën e kishte nga Podgorica. Ai veç diturisë fetare kishte mbaruar dhe akademinë ushtarake në Turqi. Hafiz Xemal Dibra i mirënjohur në atë kohë në popull për zërin e tij të bukur në këndimin e Kuranit në disa mynyra, ka thënë për Hasan Tahsinin në atë kohë kështu: Hasan Beu është mbreti i hoxhallarëve të Tiranës. Duhet ditur se në atë kohë, gjithë ajka e dijetarëve Islam të Shqipërisë ishte mbledhur në Tiranë për shkak se aty ishte medreseja e përgjithëshme e vendit. Un kam ndiguar nga burrat e vjetër besimtar se profesori Hasan Tahsinin nga do që ulej në ndonjë vendë ose shtëpi, gjithmonë kur ishte e mundur rrinte me fytyrën drejt Kibles [Qabes]. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Secili [njeri ose popull] ka një anë së cilës i kthehet [nga e mbara ose nga e prapa]. Ju shpejtoni nga punët [ose veprimet] e mbara...Kahdo që të shkosh ktheje fytyrën tënde kah ana e xhamisë së shejtë [Qabes]... dhe kahdo që të dalësh ktheje fytyrën tënde kah ana e xhamisë së shejtë [Qabes] dhe

kudo që të gjendeni [ju o besimtarë] ktheni fytyrat tuaja kah ana e saj. " S. Bekare. ajetet. 146, 149, 150. Me këto ajete Kurani është urdhëruar prej Allahut xh. sh. Pejgamberi a. s. dhe nëpërmjet tij gjithë muslimanët që ta kthejnë fytyrën drejt Qabes kur të falin namazin. Por për veç kthimit të fytyrës drejtë Qabes kur të falim namazë e cila gjë është farz= urdhër i Allahut xh. sh. , gjithashtu është mustehab = e pëlqyeshme që kur jemi duke ndenjtur, ne muslimanët të rrimë me fytyrën nga Qabja e sidomos në biseda e kuvende të ndryshme. Kjo gjë është mustehabë. Ne muslimanët jemi të porositur nga Pejgamberi a.s. që ta nderojmë Qaben edhe jashtë namazit. Ai ka thënë: "Mos pështyni drejt Qabes dhe mos e mbaroni nevojën personale drejtë Qabes ". Kështu që muslimani i devotshëm që ruhet shumë dhe nga mekruhet e mëdhaja nuk ia kthen kollaj kurrizin Qabes kur është duke ndejtur e as duke fjetur veç se kur nuk ka mundësi. Njerzit e naltë nga dija e nga shpirti kështu kan vepruar. Edhe kur vdes muslimani varroset me fytyrën drejtë Qabes. Atëher nuk ka aspak dyshim për nderimin që duhet të kenë të gjallët për Qaben që mos ta përcmojnë atë. Muslimanët e parë të devotshëm që ruheshin shumë dhe nga mekruhet, ata dikurë nuk i bënë WC [nevojtoret] në shtëpijat e tyre private në drejtim të Qabes. Ata zbatonin porosin e Pejgamberit a. s. për të mos e nënçmuar Qaben, vendin e shejtë, kiblen e gjithë muslimanëve të botës. Kështu që ky veprim që ka bërë dijetari Hasan Tahsini është me vend e i pëlqyeshëm shumë prej Allahut xh. sh. dhe ka vlera për shumë arsye për besimtarin, por shkon gjatë me i treguar. Dijetari i devotshëm me hikmet prej Allahut xh. sh. Haxhi Hafiz Mahmud Dashi ka thënë për Hasan Tahsinin ose ndryshe Hasan Beun se ai ishte shumë i zgjuar. Allahu xh. sh. e mëshiroftë Hasanin. Muxhedidja Aishe thoshte nga ana e saj fjalë të mira për hoxhën e quajtur Hasan Hysa nga Tirana që Allahu xh. sh. sh. e mëshiroftë atë. Murshidja Aishe thoshte se ai ishte njeri me rytbe=me autoritet fetar Islame. Ishte njeri i matur që jua impononte njerzvet rrespektin me sjelljen e tij. Ai rrinte i rregullt e i pastër në veshje. Hasan Hysa kishte mbaruar studjimet fetare Islame në medresen Turke. Ai ishte nga fshati Bastar i Tiranës dhe banonte në qytet, në Tiranë. Un shkruasi i librit për të vërtetuar se murshidja Aishe fliste të vërtetën ose godiste në të vërtetën edhe me firaset=hollëkuptim duke e pare me sy njeriun, po ju tregojë këtë ngjarje për Hasan Hysën për këtë hoxhë të ditur e të sinqertë. Ky vërtetë ishte hoxhë me disiplinë fetare Islame e nga njerëzit e sinqertë që e kishin frikë Allahun xh. sh.

Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë. Pasi Hasan Hysa mbaroi studjimet për fenë Islame u kthye në Shqipëri. Mirpo vend pune nuk kishte për shkollën që kishte bërë ai. Atëherë Hasani bashkë me një shok tjetër bëhen ortakë e marrin një dyqan sëbashku dhe shesin metrazhe-pëlhura e basme. Një ditë në dyqan duke qënë aty dhe ortaku i tij, vjen të blejë pëlhurë për vajzën e saj që do ta martonte një grua e moshuar. Ajo pasi shikon, kërkon atë copë pëlhure që e kishte hëngër mola. Hasani i tha asaj se ajo nuk ban, është me naksanllik=me difekt. Plaka i tha; un atë dua se ajo më pëlqen nga ngjyra. Ortaku i Hasanit ngrihet menjëher në këmbë dhe tha: O Hasan le të marri cilën të dojë plaka dhe e mori e ia vu para topin e metrazhit të basmas plakës i tregoi asaj çmimin e mallit pa asnjë zbritje edhe se malli ishte i pa vlefshëm. Plakës i pëlqeu basmaja dhe i thotë më ban 5 metra. Ky ortaku e preu e ia dha plakës e ajo me qefë doli nga dyqani. Ortaku duke qeshur nga fitimi që pati mori lekët dhe i ndau përgjysëm me ortakun e tij Hasan Hysën. Hasani i numëroi lekët gjysmën e atyre që mori ia ktheu mbrapësh ortakut të vet. Ortaku i tha janë të tuat se jemi ortakë. Hasan Hysa i tha: Un me ty jam ortak në hallall dhe jo në haram. Ajo tregëti që bëre ti tani, ishte haram=e ndaluar nga Zoti xh. sh. Ti mua nuk më lejove që të ia tregoja plakës të vërtetën [të metat e mallit]. Ti e shite mallin po me çmimin e mallit të rregullt. Pas pak kohësh me ndërmjetësimin e ish kryetarit të parë të Komunitetit Musiliman të Shqipërisë pas luftës së dytë botërore, të nderumit Hafiz Musa Basha nga Elbasani, atëherë hoxha i devotshëm Hasan Hysa filloi punën i emëruar imam xhamije në Tiranë.

22-VIZITA E MUXHEDIDES AISHE NË QYTETIN E SHKODRËS.

Duke vazhduar thirrjen e popullit për tobe në vitet e para të shërbimit të saj në Tiranë e Durrës, muxhedidja Aishe rahmetullallahi alejha, rreth vitit 1962 shkoi për të lajmëruar njerëzit për tobe në qytetin e Shkodrës. Në këtë qytet pati shumë jehonë ardhja e sajë. Gjatë takimit që bëri murshidja Aishe me popullin e Shkodrës kishte shumë njerëz të pranishëm nga të dyja fetë=musliman e kristian. Atë e priti populli në rrugë i rreshtuar në dy krahët e

rrugës që të çonte tek xhamia ku ishte mbushur plot e për plot me njerëz brënda e jashtë. Shumica e njerëzve kishin ardhur pasi ishin ba kuriozë nga lajmi që ishte përhapur gojë më gojë, se ka ardhur një njeri i shenjtë që thotë se jam i dërguar me lajm nga Zoti xh.sh. Për muxhediden Aishe rahmetullahi alejha kishte rëndësi që lajmin e Allahut xh. sh. ta dëgjonin, sa më shumë njerëz. Allahu xh. sh, në Kuran i thotë Pejgamberit a. s. ; "O ti i dërguar; komuniko atë që të është zbritur prej Zotit tënd, e në qoftëse nuk e bën [këtë], atëherë nuk e ke kryer detyrën. Allahu të garanton mbrojtje nga njerëzit..."S. Maide. aj. 67. Për çdo kusht të tobës që unë flisnja thoshte muxhedidja Aishe, disa hoxhallarë me çallma që më ranë në sy mua në mesin njerëzve e vërtetonin fjalën time duke luajtur kokën poshtë e lartë në shenjë miratimi=po ashtu është dhe i mbushnin sytë me lot. Në këtë qytet murshidja Aishe rahmetullahi alejha shoqërohej dhe nga e bija e dijetarit të dëgjuar Islam sheh Ahmed Shkodra e quajtura Fatime, që në shtëpinë e sajë bujti një natë. Pasi kjo gjë pati jehonë në popull, të nesërmen organet e shtetit e thirrën muxhediden Aishe në degën e punëve të brendëshme dhe pasi ajo i sqaroi për detyrën që bënte, ata mbajtën një proces verbal=shënimet përkatëse për të dhe e detyruan murshiden Aishe që ajo me një her të kthehet në Tiranë mbrenda ditës se për ndryshe ata do merrnin masa tjera. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e detyruar nga organet shtetërore kthehet në Tiranë. Megjithse Aisheja me popullin e Shkodrës bëri vetëm një takim por ai takim pati shumë jehonë në atë qytet. Muxhedidja Aishe e predikon Toben dhe në qytetin e Lezhës. Një pilot emri i të cilit nuk më kujtohet bashkë me gruan e tijë e nderuan shumë murshiden Aishe. Piloti emrin e të cilit nuk e kam të shkruar ishte shprehur për murshiden Aishe kështu; Fetare më të zgjuar dhe më oratore se Aishenë nuk kemi parë kurrë ndonjë herë. Me të vërtetë ajo ishte e ngritur në dije e kulturë. Aisheja e shoqëruar ka qëndruar në shtëpinë e tyre gjatë udhëtimit në qytetin e Shkodrës. Piloti dhe gruaja e tij e nderuan shumë në shtëpinë e tyre muxhediden Aishe rahmetullahi alejha.

23-MURSHIDJA AISHE I THIRRI NË TOBE SHEHELERË E KRYETARË TË TARIKATEVE

Një ditë gjatë shërbimit të saj muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha shkoi dhe takoi kryetarin e tarikatit Helvetij sheh Ali Pazarin. Ai pasi e dëgjoji murshiden Aishe i tha asaj: Unë nuk kam nevojë për të bërë tobe. Murshidja Aishe i tha atij; Po përse kështu ju more sheh Aliu ? A nuk paske nevoj ti për të bërë tobe? Sheh Aliu i skuqur në fytyr i tha asaj: Un nuk jam sheh por vesh shehelerë. A më kuptove ti Aishe i tha ai ? Ndërsa murshidja Aishe i tha atij: Do me thënë ti nuk pranon ti nënshtrohesh urdhërit të Allahut xh. sh, se e quan veten më të preferuar se unë që po të thërras dhe mendon se je i ditur shumë dhe pa gabime pasi ti qenke mbi shehelerët se ti i vishke ata=i bëke shehe. Me kaq fjalë muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha u ngrit dhe iku. Allahu xh.sh. thotë në Kuranë; "Këshillo aty ku këshilla bën dobi. " dhe për ata që e mbajnë veten lart Allahu thotë; "A nuk e ke kuptuar për ata që vlerësojnë veten. Jo Allahu vlerëson atë që do dhe nuk bënë as një fije pa drejtësi. " S. Nisa. aj. 49. =Kapitulli Gratë. Ndërsa kryetari i sektit Bektashij pasi e dëgjoji se murshidja Aishe rahmetullahi alejha i thoshte popullit se hyrja në tarikate është e ndaluar dhe tarikati Bektashij është krejtësishtë i pa pranuar tekë Allahu xh. sh. pasi ata nuk veprojnë mbi bazat e Kuranit. Kryetari i këtij sekti ishte shprehur kështu: Ku është more kjo Aisheja se për perëndi do ta vras se ajo po na shan tarikatit tonë. Thoshin në atë kohë se ai mbante pistoletë pasi e kishte me leje nga shteti [nga ministria e punëve të mbrendëshme].Kryetari i tarikatit Rrufai, Sheh Mustafa Reka i tha këto fjalë murshides Aishe që lajmëronte popullin për tobe; Hajde na tako më shpesh o Aishe se imani=besimi jonë, ka nevojë për ty-për fjalët tuaja. Ti Aishe je në një pozitë të lartë tek Allahu xh. sh. Muxhedidja Aishe e kishte fis nga nëna Sheh Mustafain. Babai im Ymer Aga mua shkruajtë të librit më tregoi kështu: Një rast bëmë një takim me Sheh Mustafa Rekën në shtëpinë e tij, un dhe disa shokë besimtar. Aty erdhën dhe disa dervisha=anëtarë të tarikatit Rrufai që drejtonte Sheh Mustafai rahmet pastë. Pasi erdhi koha e namazit të ikindisë, ne thoshte babai im u ngritëm për të falur namazin e ikindis bashkë me Sheh Mustafain

imam, ndërsa dervishat nuk u ngritën ta falin namazin por rrinin ulur me tespijtë në dorë. Nga ky veprim i tyre që nuk e falën namazin, unë u çudita shumë më thoshte babai. Pasi u ngritëm të ikim e dolëm jashtë në oborr unë thoshte babai i thash shehut: Përse nuk e falnin namazin dervishat tuaj o sheh? Sheh Mustafai me zë të ulur më tha: Dëgjo këtu o Ymer Aga; Ata vërtet nuk janë miq ashtu si i duam ne por edhe armiq nuk i kemi. Unë ata po i shoh që nuk po largohen nga rakija, lakmija e qefet e dynjasë por mendohem ti zbus sa do pak duke bërë zikër e duke u kënduar ilahi, që të paktën mos të bëhen shokë me armiqtë tanë e në rastë lufte mos të na godasin pasë shpine, se për të na ndihmu ato nuk janë, dhe unë këtë gjë e di mir tha shehu. Një besimtar i vjetër më ka treguar këtë ngjarje: Ishim duke ecur në një rrugë të Tiranës unë dhe tre shokë besimtarë së bashku me Haxhi Hafiz Mahmud Dashin dhe Sheh Mustafa Rekën rahmet paçin nga Zoti xh. sh. Sheh Mustafai filloi të flasi se përse ai ju bënte thirrje njerëzve që të futen në tarikat. Ndërsa Hafiz Haxhi Dashi i bien me shkop në shpatull nga dalë në formë vërejti Sheh Mustafa Rekës dhe i tha: Mos more se me ndarjen në tarikate po e prishni popullin, po e përcani atë. Populli sot nuk di sheriatin, ai nuk di asgjë nga feja, kurse ju i thoni ejani në tarikat. Sheh Mustafai kishte ulur kokën dhe i kishte thënë Haxhi Hafiz Mahmud Dashit; E kemi qëllimin për mir o Haxhi Efendi. Haxhi Hafiz Dashi i kishte thënë: Nuk fitohet vetëm duke pasur qëllimin e mir jo jo, por duhet puna të bëhet tamam dhe në bazë të rregullave të caktuara nga Allahu xh. sh. Duhet të mbjellësh që pastaj të korrësh. Me kaq kishte marr fund biseda mes Haxhi Hafiz Mahmud Dashit e Sheh Mustafa Rekës që Zoti xh. sh. i mëshiroftë ata dhe gjithë besimtarët e vërtetë. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: “Dhe besimtarët e vërtetë janë vetëm ata të cilët kur përmen-det Allahu u rrënoqethen zemrat e tyre, [dhe] të cilëve kur iu lexohen ajetet e Tij [ajetet e kuranit] iu shtohet besimi dhe janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre; dhe të cilët falin namazin dhe nga ajo me çka Ne [thotë Allahu] i furnizuem, ata japin [sadaka-lëmosh e zeqat].” S. Enfalë. aj. 2 dhe 3.

Vëllezër besimtarë hyrja në tarikat e disa njerëzve dikurë ishte me qëllim të sinqertë por ata njerëz ikën nga kjo botë dhe erdhën më vonë njerëzit e prishur, batakçij e xhahila= fare=injoranta=të pa ditur, derisa arritën të hyjnë në tarikate dhe munafikët, qafirat

dhe njerëz të agjenturave të huaja të cilët me anë të tarikateve i përçanë dhe i larguan muslimanët nga Kurani dhe kështu i nxorrën nga praktikimi i fesë Islame. Në mesin e shekullit të njëzetë kudo në botë ishin shumë të rrallë ata njerëz që zbatonin Kuranin, që veç sheriatit që është detyrim-normë, bënëin tejkalim-mbi normën.

Prandaj Allahu xh. sh. që di çdo gjë e ndalojë hyrjen në tarikate që nga mesi i shekullit të njëzetë me lajm urdhëresën për tobe që solli nëpërmjet muxhedides Aishe rahmetullahi alejha. Disa munafikë=hipokritë- dy fytyrësha mashtroshin e thoshin dhe thonë edhe sot se jemi në tarikat=jemi me imam Aliun r. t. a. dhe nuk i zbatojnë urdhëresat e Allahut xh. sh. që Ai i ka përcaktuar në Kuran. Ata donin dhe duan edhe sot me pi raki, mos me fal namaz, mos me agjëru ramazanin, mos me bër gysyl=mos me e la trupin gjatë kontakteve seksuale bashkëshortore, me mbushur barkun dhe me trash qafën duke hëngër qyl nga njerëzit e pa ditur të cilët i mashtroshin dhe duan ti mashtrojnë akoma edhe sot njerëzit duke u maskuar në emër të ehlibejtit= në emër të njerëzve të shtëpis së Pejgamberit a. s. = në emër të familjes së tij por që në fakt nuk veprojnë si ehlibejti i cili vepronte sipas Kuranit. Këta tipa njerëzish të tillë ia përngjasin rabinëve e priftave të fesë çifute e kristjane për të cilët Allahu xh. sh. në Kuran për ata thotë: “Vërtetë një shumicë e madhe e paris fetare e jahudijve [çifutëve] dhe e të krishterëve [kaurrëve] e han në mënyrë të pa ligjëshme pasurin e njerëzve [pasurin e popullit] në çdo vend.” S. Tobe=Kapitulli Pendesa. aj. 34.

24-TAKIMI I MUXHEDIDES AISHE ME HAFIZ SABRI KOÇIN. QËNDRIMI I TIJ NDAJ LAJMË URDHËRESËS SË ALLAHUT XH. SH. PËR TOBE.

Në vitin 1963 muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e takon Hafiz Sabri Koçin në Tiranë. Hafiz Sabriu ishte me origjinë nga Librazhdi nga fshati Orejë. Kishte shkuar në qytetin Shkodër që kur ishte fëmijë dhe nuk u kthye më në vendlindjen e tij. Në Shkodër ai mësoi për fenë Islame tek dijetarët musliman të asaj kohje që ishin aty. Ai pastaj aty u bë Hoxhë. Aty ai u martua e më vonë hyri në tarikatën Rrufai.

Kur u vendos rregjimi demokratik në Shqipëri e zgjodhën

Hafiz Sabri Koçin kryetarë të komunitetit musliman të Shqipërisë. Në lidhje me Hafiz Sabriun, muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se; Hafiz Sabri Koçi kishte pas dëgjuar në Shkodër për detyrën time; thirrjen për tobe porë ai nuk e kishte besuar dhe kishte folur dhe keq për mua. Këtë gjë thoshte murshidja Aishe mua ma njoftoi Allahu madhrueshem me anë të një ëndërre, mes gjumit e zgjimit duke ma paraqitur dhe pamjen e tij pasi un nuk e kishim par ndonjëher atë. Nuk vonuan shum dit dhe un duke qenë e shoqëruar me një gru të vjetër nga Shkodra e cila rrinte në Durrës, e takova Hafiz Sabri Koçin duke ecur në një rrugë të Tiranës. Porsa e pash nga larg rreth dyqind e ca metra e njoha atë sipas shfaqjes filmike që më kishte dhënë Allahu xh. sh. Un thoshte Aisheja i thash shoqëruses nga Shkodra e quajtur Emine këto fjalë: Ai Hafizi me çallmë në kokë që po vjen përball nga ne, atje larg në krye të rrugës është Hafiz Sabri Koçi. Ajo më tha un e njoh atë se e kam pas në një lagje por nuk e dalloj tani aq larg. Pasi ai u afrua pak , Eminja e njohu atë por u çudit se nga e njihja un Hafiz Sabriun. Un i tregova asaj se pamjen e tij ma ka shfaqur Allahu xh. sh. në ëndërr. Pasi u afrua Hafizi Eminja i thirri atij. Ai ndaloi e u përshëndet me Eminen. Ajo e prezantoi Hafiz Sabriun me mua duke i treguar atij se kjo është shoqja ime Aisheja që thërret popullin që të bëjë tobe, tobe nesuh=pendim të sinqert pa këthim prapa. Un tha muxhedidja Aishe i fola Hafizit për lajm urdhëresën e Allahut xh. sh, për të bërë tobe të gjithë si popull pa përjashtim. Hafiz Sabriu aty para nesh e pranoi lajmin për tobe dhe tha këto fjalë: Un kam folur keq për ty në Shkodër kur më pyetshin njerëzit, pasi un nuk të kishim takuar ty dhe mendoja ndryshe. Tani që të takova e të dëgjova vetë, un tërhiqem nga mendimet që kishim dhe jam plotsishtë dakort me thirrjen që bën. Këto kushte për të cilat i thërret njerëzit ti Aishe, janë bazat e fesë. Me kaqë u ndam me Hafiz Sabri Koçin. Ky ishte takimi i parë dhe i fundit me të, i cili mu duk tepër i zgjuar dhe oratorë thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Unë mendoja dhe dëshiroja thoshte ajo se Hafiz Sabri Koçi si njeri i zjuar e oratorë që ishte do të jepte ndihmesën e tij, për përhapjen e lajmit të Zotit xh. sh. për tobe pasi ai tha se jam dakort me fjalët që thua ti Aishe. Mirpo dëshira e njeriut nuk përputhet gjithëmonë me dëshirën e Allahut xh. sh. Porsa ai u largua nga Tirana thoshte murshidja Aishe, un mora lajmin nga Allahu xh. sh. kështu; "Hafiz Sabri

Koçi e përgënjeshtroi lajmurdhëresën për tobe por do ti jap atij dënimin që meriton. " Murshidja Aishe rahmet pastë për këtë gjë i njoftoi disa besimtarë dhe vërtet fjalët që tha ajo u vërtetuan. Nuk vonoi shumë veçse 3 vjet, dhe në vitin 1966 një vitë para se të ndalohet feja në vendin tonë, Hafiz Sabri Koçi u dënua nga shteti shqipëtar me 22 vjetë burg. Doli nga burgu në vitin 1986. Ai u dënua si pjestarë i një grupi prej katër vetash që kishin dëmtuar pasurinë socialiste=pasurinë e përbashkët të popullit. Dy nga këta katër veta u dënuan me vdekje dhe dy me burgim që njëri nga këta ishte Hafiz Sabri Koçi. Këto i dëgjua më vonë nga populli i Shkodrës. Muxhedidja Aishe tha se Hafiz Sabri Koçi gjithnjë vazhdonte edhe në burg për ta minuar urdhëresën e Allahut xh. sh.= çështjen e Tobes. Këtë gjë ai atje e bënte kur e pyesnin njerëz që kishin dëgjuar për çështjen e tobes. Për këtë gjë thoshte murshidja Aisheja, mua më njoftoi Allahu xh. sh. nëpërmjetë ëndrrës.

Atëher muxhedidja Aishe i çoi fjalë Hafiz Sabri Koçit në burg, nëpërmjet mikut të tij nga Kruja, Hamid Hoxha, me të cilin ai kishte lidhur miqësi, ishte bërë kumbarë, pasi Hafizi kishte qënë disa kohë në qytetin e Krujës nënmyfti. Muxhedidja Aishe tha se ia lash amanet Hamid Hoxhës që kur të shkonte për takim tek ai në burg ti thoshte Hafiz Sabriut këto fjalë nga un kështu: A nuk të mjaftoi akoma dënimi i Allahut xh. sh ka thënë Aisheja që e thërret popullin për të bërë tobe ?. E pyta Hamid Hoxhën tha ajo kur e takova më vonë për amanetin që ia lash e ai më tha që ia thash fjalët tuaja Hafizit se ishin amanet por ama me shumë keqardhje. Në kohën kur u vendos rregjimi Demokratik në vendin tonë Hafiz Sabri Koçi u bë kryetarë i Komuniteti Musliman në Shqipëri. Un shkruasi i librit ia çova vetë në dorë Haxhi Hafiz Sabri Koçit librin Tobe-Istigfarë në zyrën e tij në ndërtesën e administratës së Komunitetit Muslman. Ai pasi e mbajti disa dit për ta lexuar, ma ktheu përsëri librin me mirsjellje. Kur un e pyeta se qysh tu duk libri, ai vetëmse rrudhi supet dhe ngriti duart lartë si njeru i dorëzuar në fushën e betejës. Dëshiroj që Hafiz Sabri Koçi i cili ishte i ditur e oratorë dhe me autoritet që ta ketë pranuar të vërtetën e të ketë kaluar nga kjo jetë i pastruar nga shirkun i madhë gjuhësor. Zoti xh. sh. e mëshiroftë. Dëgjova më vonë nga disa besimtarë se Hafiz Sabri Koçi e kuptoi rrezikun e shirkut gjuhësor, për të cilin bënte thirrje muxhedidja Aishe. Mua më than disa besimtar se

Hafiz Sabriu në një ligjëratë të tij në xhaminë e Tiranës një ditë xhumaje iu kishte thënë njerzvet që mos ta thërrasin njëri tjetrin me emrin Zoti xh sh. Vetëm kaq, pa u shtjelluar më shumë e më qartë, në të gjitha format tjera si, Zotni e Zotnesh ose Zonjë e Zotnush i Zoti, i del Zot filani e tjera. Estagfirullah. Inshallah dhe ai më së fundi e ka pranuar lajmin e Allahu xh. sh. që komunikojë muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, kjo murshide e famshme e shekullit të njëzet. Muxhedidja Aishe vazhdonte pa pushuar ta kryente detyrën që ia kishte ngarkuar Allahu xh. sh. pamvarsisht qëndrimit që mbanin në atë kohë hoxhallarët e besimtarët e thjeshtë muslimanë e kristianë në vendin tonë. Muxhedidja Aishe thoshte se ortodoksit bëheshin shumë kurjozë prej ndonjë mrrrekullije ose kerameti që ju tregoja un atyre.

25-MURSHIDJA AISHE VAZHDOI TAKIMET ME INTELEKTUALË E DIJETARË TË FESË DHE MBARË POPULLIN E THJESHTË.

Një nga ntelektualët ishte edhe Hafizi Isa Dollneni që dikurë kishte qenë nëpunës shteti por me ardhjen e regjimit komunist në fuqi ai punoi puntor krahu. Murshidja Aishe ishte njohur rastësisht me gruan e tij. Në atë kohë Hafizi ishte i sëmur. Muxhedidja Aishe i bëri vizitë Hafizit për ta lajmëruar atë për toben e kryesisht për largimin nga shirku me gojë. Hafiz Isa Dollneni rahmet past e besoi që murshidja Aishe ishte e dërguar me shërbim prej Allahut xh.sh. për tu tërhequr vërejtje njerzvet pasi ai shikoi argumentet në Kuram. Në atë kohë Hafiz Isa Dollneni rrinte i shtrirë në krevat prej sëmundjes së rëndë. Ai vuante nga sëmundja prej disa kohësh tregonte Aisheja. Gruaja e tij i kishte thënë Aishes që ti bënte lutje Allahut xh. sh. që burri i saj Hafiz Isai tu shëronte. Muxhedidja Aishe i tha asaj: Un jam e dërguar me shërbim nga Allahu xh.sh. për shërimin e shpirtrave të njerëzve dhe jo të trupave të tyre por me që Allahu xh. sh. mua mi ka pranuar lutjet, un po ta plotsoj dëshirën ty dhe po i lutem Allahut xh. sh. për burrin tënd. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha tha se un iu luta Allahut xh.sh. natën dhe pas disa orësh të nesërmen mora këtë njoftim kështu : "Do ta shëroj për 2 vjet që ai të bëjë namaz [të falet] pa bërë shirk". Këtë lajm ia thash gruas së tij thoshte Aisheja dhe i thash asaj që

mos ti tregonte Hafizit se ai do tu shëronte vetëm për dy vjetë. Vërtetë pas një jave Hafiz Isai u përmirësua dhe pas pak ditëve u ngrit nga krevati dhe filloi të falte namazin. Posa u mbushën plot 2 vjet thoshte Aisheja atij iu kthye përsëri sëmundja dhe vdiq. Allahu xh. sh. e mëshiroftë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha i komunikoi lajmin për tobe intelektualit të njohur profesor Haki Sharofit nga Dibra që banonte në Tiranë. Ai ka qenë drejtor e redaktorë i revistës së përmuajshme Kultura Islame. Ai ishte njeri i penës. Ka shkruar për fenë Islame broshura e tema të ndryshme. Murshidja Aishe i tregoi atij urdhërin e Allahut xh.sh.për të bërë tobe e bashkimin e gjithë popullit rreth saj. Profesor Haki Sharofi trembet shumë dhe i thotë muxhedides Aishe këto fjalë; O bo bo paske për të na marr më qafë tani të gjithëve. Muxhedidja Aishe i thotë po përse more profesor efendi? Ai i thotë; Do të dyshoi qeverija për ndonjë lëvizje politike me flamurë fetarë dhe neve që kemi mbaruar studimet për fenë do të na kapin me një herë. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha i thotë; More profesor qeverija le të mendojë e të hetojë si të dojë se ajo për atë punë është, për të menduar, hetuar e vepruar. Por un nuk po të thërras ty dhe as të tjerët si ti, për të bërë grupe kundër shtetit por po e thërras mbarë popullin pa dallim që të bëjë tobe, të këthehet në rrugën e Zotit xh. sh. sinqerisht. Për këtë gjë keni nevojë dhe ju të diturit që në radhë të par ju nuk e njisoni Zotin xh. sh. bëni shirk dhe keni dhe shumë e shumë gabime tjera. Po të jetë puna për frikën, duhet të kemi unë që jamë një grua e vetme pa njeri, që po e shëtis vëndin me qefinin në krah, në këtë situatë të rëndë politike që është këtu. E dhe un njeri me mish, me kocka e gjakë jam por ti duhet ta besosh se unë sinqerisht po kryej shërbimin që më ka ngarkuar Allahu xh. sh. në këtë vendë. Me kaq fjalë unë u ndava me profesorin Haki Sharofi thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha.

Në verën e vitit 1964 Muxhedidja Aishe e shoqëruar bën takim në Tiranë me profesorin Sherif Putra, nga Bilishti i Korçës e i komunikoi atij urdhërin e Allahut xh. sh. për të bërë tobe. Profesor Sherif Putra kishte mbaruar shkollën Islame në Lahorë të Pakistanit dhe kishte qënë disa vite drejtor i revistës Kultura Islame në Shqipëri. Ai u shpreh në prani të njerzve për shërbimin që bënte muxhedidja Aishe kështu: Detyra e sajë tha ai është e shejtë. Të tillë njerëzish kanë ardhur në çdo shekull me shërbim prej Allahut xh. sh. në faqe

të tokës duke iu bërë thirrje njerëzve që ti rikthehen rrugës së Allahut xh. sh. , rrugës së drejtë e të pastër që ndoqi profeti jonë Muhamedi a. s. Këto njerëz të ngarkuar me shëbimë nga Allahu xh. sh. e pastrojnë fenë nga bidadet, nga gjëra të shpikura prej njerëzvet në emër të saj [në emër të fes]. Në Kuran Allahu xh. sh. thotë në një ajet kështu; “Ata [njerëzit] mendojnë se janë duke bërë mirë, por....” por në fakt veprojnë në kundërshtim me ligjet e Zotit xh. sh. Tobja sot në këtë kohë tha ai është çështje e madhe, çështje primare, dhe njerëzve si mua që kanë dituri duhet të jenë të parët që ta pranojnë dhe ta përkrahin këtë çështje të madhe. Un po ti kishim mundësitë do ta shpallësha me shkrim, çështjen e madhe të Tobes, por sot situata politike që është në vendin tonë nuk më lejon. Nëse un do ta merrsha këtë inisiativë, kam frikë, se do të rrezikohem dhe kam hallin e dy vajzave dhe gruas që do të mbeten vetëm, pa as një mashkull në shtëpi, pasi nuk kam as djalë dhe as njeri tjetër të fisit që të interesohet për ta dhe kështu do mbesin rrugëve. Hafiz Mehmeti nga Rrazhbulli i Durrësit me origjinë nga Gjakova në takimin me murshiden Aishe pasi e kishte dëgjuar atë i kishte thënë asaj këto fjalë të çuditëshme; Un moj Aishe, do të besoja ty, që ti je me lajm direkt prej Zotit xh. sh. nëse ti do të folshe si profeti Ibrahim a. s. ndërsa ti po më flet si Muhamedi a. s. prandajë un nuk të besojë ty. [Estagfirullah, estagfirullah] Un thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha u çudita nga këto fjalë të çuditëshme që tha ky njeri i cili ishte Hafiz Kurani. Un ja argumentova atij me Kuran pozitën e lartë që ka tek Allahu xh. sh. profeti Muhamed a. s. por ai u nxeh e u skuq në fytyrë dhe nuk u bind. Allahu xh. sh. në Kuran për haz. Muhamedin a. s. thotë; “Ju e keni shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut [pra në personalitetin e tij]. S. Ahzab. aj. 21. Gjithashtu Allahu xh.sh. në Kuran thotë; “Lart ta ngritëm famën tënde o Muhamed.” S. Inshirah. aj. 4. Kurani thotë: “Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt=melekët e Tij me madhërim [me tepër nderim e krenari] e lavdrojnë Pejgamberin...” S. Ahzab. aj. 56. Pasi un u ktheva në shtëpi thoshte Aisheja dhe pasi fala namazin, rashë të flej gjumë duke qenë e mërzhitur nga këto fjalë jashtë ligjit fetar Islam që foli ky njeri i cili ishte Hafiz Kurani. Allahu xh.sh. e din se çka mendojnë dhe sheh e dëgjon se çka thonë e bëjnë njerëzit. Porsa un vura kokën në jastëk, Allahu xh.sh. më ngushulloi me këto fjalë thoshte murshidja Aishe: “Nuk të kam dërguar ty vetëm për disa hoxhallar

që janë të xhindosur [që merren me xhindët] por shiko popullin.”
Më vonë thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha dëgjova dhe nga njerëzit që hafiz Mehmeti u merrte me xhindët, qofshin largë nesh. Gjithashtu dëgjova nga njerëzit e shtëpisë së tij thoshte muxhedidja Aishe, se Hafizi nuk i falte pesë kohët e namazit me përjashtim kur ai ishte në xhami se aty ishte i punsuar me detyrën imam për të faljen e namazit. Po deshi Allahu xh. sh. e fal se ndoshta e kan ngatrruar xhindët. Prandaj nuk duhet me u marrë me xhindët se ata ta ngatërrojnë mendjen.

Ish myftiu i Durrësit Selim Gashi nga Tropoja pasë tre takimesh që bëri me muxhediden Aishen me prezantimin e një mjekje që quhej Emine e cila punonte në ambulancën qëndrore të Durrësit, ai pranojë më së fundi ta njisoj Zotin xh. sh. Pas kerameteve që shikoi tek murshidja Aishe rahmetullahi alejha, myftiu tha këto fjalë për të: Zoti xh. sh. i madhërshëm e paska lartësuar në gradë të lartë Aishen.

Në vjeshtën e vitit 1965 muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha shkoi në fshatin Bultic të Tiranës dhe ju bëri thirrje për tobe popullit të fshatrave aty për rreth: Bulticë, Arban e Furtuzje. Kryetari i kooperativës Hasan Merja i mbledh kooperativistët tek qendra e kooperativës në fshatin Bulticë. Hasan Merja ishte komunist dhe ishte krytarë kooperative i fshatrave që tham më sipër por në fakt ai kishte thënë: Aisheja është grua besimtare e sinqert. Ajo nuk thotë asgjë të keqe kundër shtetit e popullit. Të nesërmen Hasanin e raportuan dhe nga organet e shtetit në Tiranë atij i tërhoqën vërejtje në ish komitetin e partis në Tiranë se ai nuk kishte të drejtë ti mblidhte fshatarët, që tu fliste Aisheja për tobe me gjithëse feja në atë kohë ishte e lirë, por feja ishte e ndarë nga shteti që pas pamvarsis nga Turqia. Ai si njeri me detyr shtetërore që ishte duke qenë kryetar kooperative dhe komunist nuk kishte të drejtë si pasë ligjeve në fuqi, që të mblidhte kooperativistët për tu folur dikush atyre për fenë. Ndërsa Abdullah Shehu nga Farka e Tiranës që kishte mbaruar medresen-shkollën fetare Islame në Tiranë para vitit 1944, dhe pas mbarimit të shkollës fetar punoi nëpunës shteti, u shpreh kështu për murshiden Aishe rahmetullahi alejha : Aisheja tha ai flet drejtë tamam ato që thotë Kurani. Ajo është grua e sinqertë. Ndër hoxhallarët e asaj kohje ishte dhe Ali Gapi nga Gurra e Tiranës, që kishte mbaruar medresen në Tiranë dhe

ishite disa kohë myfti në Gjirokastrës, para ndalim të fesë, u shpreh kështu, për çështjen e tobes që fliste në popull muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Ai tha: Aisheja flet fjalët e Allahut që thuhet në Kuranë dhe vepron dhe vetë ashtu. Kushdo qoftë ai njeri, grua ose burrë që vepron vetë ashtu sikurse i thotë fjalët e Zotit, ai njeri është i mirë. Njeri i keq është ai njeri që flet keq dhe vepronë keq. Muxhedidja Aisheja rahmetullahi alejha, nuk i shante dijetarët e fesë, përkundrazi thoshte ata janë munduar për fenë por gabimi i tyre që është i pa falshëm nga Allahu xh. sh, ka qenë shirku me gojë. Pa dyshim muxhedidja Aishe qoftë i kënaqur Allahu xh.sh. prej asaj fliste në bazë të Kuranit. Vërtetë Allahu xh. sh. në

Kuran thotë: "Ata [njerëz besimtarë] të cilët erdhën pas tyre [pas atyre që vdiqën] thonë; Zoti ynë na fal neve dhe vëllezërit tanë që para neve u paisën me besim, dhe mos lejo në zemrat tona far urrejtje ndaj atyre që besuan, Zoti ynë Ti je i butë=i durushëm dhe mëshirusë." S. Hashër. aj. 10.

26-MUXHEDIDJA AISHE VAZHDOI DETYRËN E SAJ DUKE E THIRRË POPULLIN NË TOBE EDHE PAS NDALIMIT ME LIGJË TË FESË NGA SHTETI SHQIPTARË.

Rreth vitit 1970-72 muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, viziton për së dyti qytetin e Kavajës. Ajo nëpërmjet një besimtarje vendase i mblodhi njerëz në shtëpinë e të quajturit Fadil Noga. Aty atë ditë në atë shtëpi kënduan Mevludin. Shtëpia ishte mbushur plot me njerëz. Murshidja Aishe i thërriti njerëzit të bëjnë tobe me kushtet që ka urdhëruar Allahu xh. sh, që në radhë të parë ishte që ata të largoheshin nga shirku. Në atë takim kishte qënë aty dhe një grua spiune. Pasi unë mbarova bisedën tha muxhedidja Aishe, ajo gruaja spiune ishte nisur të lajmërojë në organet e shtetit, në lidhje me lajmin e Allahut xh. sh. që ju tregova unë njerëzve për të bërë Tobe. Kur unë dola jashtë në koridorin e shtëpisë dëgjova zhurmë thoshte murshidja Aishe. Aty shikova dy gra besimtare të mira që e kishin mbërthyer këtë gruan spiune e skuqur në fytyrë e cila ju kishte thënë gravet se tani unë menjëherë do të shkoj të raportojë në organet e shtetit për propogandën e rrezikshme fetare që bëka kjo gruaja nga Tirana. Kur unë dëgjova se përse po e mbanin të

mbërthyer spiunen thoshte Aisheja iu thash gravet që e mbanin që ta lëshojnë atë, të iki e të shkojë ku të dojë se tani do ta shohi qartë ajo fuqin e Allahut xh. sh. nëse un jamë vërtetë e urdhëruar nga Allahu xh. sh. apo gënjej siç mendo ajo. Ato dy grate që mezi po e mbanin u shtangën pak por kur un iu bërtita atyre: lëshonja tani po ju themi, ata menjëherë e lëshuan. Porsa dy gratë i hoqën duart nga ajo spiunja, un thoshte murshidja Aishe thash: Haz bunallahu ve niamel vekijl. Pastaj i thash gruas spiune; Hajde ikë spiuno tani nëse ke mundësi. Mirpo ajo menjëherë u step e u nxi në fytyrë dhe fillojë të dridhet sikur fimija i vogël jashtë në të ftohtin dhe ulet pastaj se gati po i binte të fikët duke qenë më këmbë. Të gjithë u çuditën. Ajo nuk lëvizi më. Allahu xh. sh. thotë në Kuran : “Ata të cilët i kumtojnë shpalljet e Allahut, i friksohen Allahut e askujt tjetër përveç Tij...”S. Ahzab. aj. 3. Gjithashtu në një ajet tjetër të Kuranit thuhet: “Kush i mbështet plotsisht Allahut, Ai i mjafton atij. ”Fjalët hazbunallai ve niamel vekijl i tha i mbështetur plotësisht tek Allahu xh. sh. haz. Ibrahimimi para se ta hidhte Nemrudi në zjarr dhe Allahu xh. sh. e shpëtoi atë.

Muxhedidja Aishe e shoqëruar duke bërë thirrje për Tobe shkon në Fushë Krujë në fshatin Arrameras në shtëpinë e Hysen Çelës. Ai ishte i persekutuar nga rregjimi komunist, ishte kulak. Në shtëpi e pritën mirëmurshiden Aishe me shoqërusët e sajë. Pasi Hyseni e kishte dëgjuar në shtëpinë e tij Aishen, nuk e kishte kundërshtuar por i kishte thënë më pas një mikut të vetë; Unë mendova se ajo po thoshte se kur do të përmbysët komunizmi, se ata e kanë fajin e jo neve të persekutuarit, kurse ajo thoshte ejani në tobe=në pendesë të gjithë pa përjashtim. Gjatë takimeve të ndryshme me popullin, shumë njerëz nga shtresa të ndryshme të popullsisë që nuk e donin rregjimin komunist, e pynin muxhediden Aishe; A ke ndonjë njoftim ti nga Allahu xh. sh. se sa kohë do të qeverisi në këtë vendë Partia e Punës= komunistët me miqtë e dashamirësit e tyre? . Aisheja tha se Allahu xh. sh. një ditë më solli këtë lajm mua duke qënë zgjuar për tua thënë atyre që më pyesnin për këtë gjë. Lajmi ishte kështu; ”Thuaju ti atyre [njerëzve që të pyesin]; Kjo parti- [grup njerëzish], do të sundoi deri ditën e kijametit. ”Të mençurit sot duhet ta pranojnë të vërtetën = lajmin që erdhi prej Allahut xh.sh. Vërtet forma e rregjimit politik dhe ekonomik u ndryshua por njerzit që qeverisin jan po ata që ishin=jan komunistët, fëmijët

miqtë dhe dashamirsit e tyre. Dhe që e kishim fjalën më sipër me që njerëzit nuk bënin tobe çdo ditë ata bëheshin gjithnjë e më të këqij. Dhe Allahu xh. sh. jua fuste në mendje drejtusave të shtetit që ti forconin më shumë ligjet nga çdo pikëpamje, ta forconin më shumë diktaturën në këtë vend për ti mbajtur të shtypur=me forcë njerëzit të cilët kishin dalë nga rruga e Zotit xh. sh. Allahu xh. sh. thotë në Kuranë; "Disa mizorë [të ashpër=kokëfortë= të pa bindur] i shtypim me disa të tjerë. " Rreth vitit 1976 muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha bëri një vizitë në familjen e hoxhës së mirë Adem Gurra nga Gurra e Tiranës, ku aty u foli njerëzve të familjes. Hoxha i tha këto fjalë Aishesë; Zoti madhrushëm të ruajt e të lartësoftë ty Aishe se të drejtën po flet dhe ky njeri shumë i mirë lëshonte lot nga sytë kur fliste murshidja Aishe rahmetullahi alejha. Kur u larguam nga shtëpia e Ademit Aisheja më tha mua këto fjalë për të; Ky njeri ishte shumë i sinqertë, ishte vërtetë njeri mytekij. " Allahu xh. sh na takoftë me të mirët në xhenet. Murshidja Aishe vazhdonte të kryente gjithnjë detyrën që i kishte ngarkuar Allahu xh. sh. duke e thirr popullin në tobe. Ajo shkoi dhe u takua me Haxhi dhe Muharrem Vranën e të tjerë njerëz nga fshati Prezë i Tiranës. Muharremi i biri i Haxhiut në kohën e rregjimit komunist ishte mësues për arsimin laik ndërsa babai Haxhiu ishte hoxhë. Muxhedidja Aishe tha se ata ishin njerëz besimtarë të mirë por inshallah do të largohen nga shirku me gojë dhe do ta njisojnë Zotin xh. sh. në gjuhën e përditshme amtare. Udhëzimi i drejtë vjen prej Allahut xh. sh. Ai i udhëzoftë ata dhe gjithë të tjerët. Sot me vendosjen e rregjimit demokratik në vendin tonë Haxhi e Muharrem Vrana shërbejn të dy imamë në dy xhamijat e qytetit Fushë-Krujë.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha rreth vitit 1978 shkoi dhe lajmëroi për tobe në shtëpinë e ish hoxhës së vjetër Halil Peti, në fshatin Sauk të Tiranës. Hoxha pasi e dëgjoi mirë murshiden Aishe, nxorri lot nga sytë dhe foli këto fjalë ; "Tobja është gjëja më e çmuar për njerëzit se me tobe siç e the ti o Aishe, gjejnë shpëtim njerëzit. Tobja=pendesa është porosia e Zotit xh. sh. dhe e Pejgamberit a. s. Me tobe shpëtoi nga dënimi i Allahut çifti i parë i njerëzve Ademi dhe Havaja. Në atë takim që hoxha i mir Halil Peti foli këto fjalë, aty isha edhe un shkruasi i librit, dhe i biri i tij, Ramazani me gruan e tij e të tjerë. Rreth vitit 1980, 81 un e kam shoqëruar muxhediden Aishe edhe në fshatin Shtish të Tiranës

në shtëpinë e besimtarit të mirë medresistit Qamil Meta. Ai mbeti i kënaqur dhe më pyeste gjithmonë mua për Aishen=për shëndetin e sajë. Në vitin 1982 muxhedidja Aishe shkoi për të dytën herë në qytetin e Shijakut për tu bërë thirrje njerëzve për tobe. Një natë dhe një ditë ajo dhe dy shoqërusat që e shoqëronin ndër të cilët isha dhe unë shkruasi i këtij libri ndejtëm tek shtëpia e Hafiz Maksut Çelës dhe të nesërmen tek vëllai i tij Sulejmani që ishin nga fashati Mollagjeç i Elbasanit dhe banonin në Shijak. Ata na pritën me shumë respekt. Muxhedidja Aishe ju foli njerëzve aty për lajmurdhëresën e Zotit xh. sh, për toben. Hafiz Maksut Çela rahmetullahi alejh ka deklaruar me gojë kështu; Aisheja është grua e devotshme që punon pa interes për të thirrur popullin në rrugën e Zotit xh. sh. Muxhedidja Aishe tregoi këtë njoftim prej Allahut xh. sh, për Hafiz Maksutin, nëpërmjet një rrujaje=ëndërre. Ajo tha; Ishin mbledhur disa hoxhallarë e besimtarë në një vend dhe po diskutonin për çështjen e tobës mesa kuptova nga fjala që foli Hafiz Maksuti. Ky njeri i cili mu paraqiti në ëndërr me fytyrë të pastër u tha atyre hoxhallarëve të tjerë kështu : Un jam dokort me ato fjale që thotë Aishja. Në Kuran thuhet: "... Allahu udhëzon në rrugë të drejtë atë që do." S. Ibrahim. aj. 4. Hafiz Maksuti kishte gjashtë vëllezër të cilët agjëronin muajin e Ramazanit dhe pothuajse të gjithë mudo-heshin ta falnin namazin në atë kohë që feja ishte e ndaluar me ligj nga shteti. Por nga vëllezërit e tij vetëm Hafiz Maksuti e besoi me bindje lajmin e Zotit x. sh. që i komunikoi popullit muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Hafiz Maksut Çela rahmet pastë mori pjesë në shoqërimin e muxhedides Aishe në fshatin e tij Mollagjeç. Murshidja shkojë e shoqëruar në fshatin Mollagjesh të Elbasanit në shtëpinë e Halil Çelës icili ishte vëllai i Hafiz Maksutit, për tu komunikuar njerëzve në atë zonë lajmin e Allahut xh. sh. për të ba tobe. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e bëri këtë udhëtim në atë rrugë të vështirë e të largët duke qenë e sëmurë nga veshkat dhe duke ecur me këmbë në këtë rrugë të largët përpjetë nëpër mal. Pas shumë lodhësh bashkë me ata që e shoqëronin ajo arriti në shtëpinë e Halil Çelës. Muxhedidja Aishe i kërkojë të parit të shtëpisë Halil Çelës që veç familjes së tij, ai të lajmëronte të vinin në shtëpinë e tij, fisi i tij i afërt dhe disa komshinjë besimtarë. Ai ashtu veprojë dhe murshidja Aishe i lajmërojë ata për të bërë tobe. Në shtëpinë e Halilit atë natë ishim si bujtës unë shkruasi i këtij libri Haxhi Ymer

Aga bashkë me hafiz Maksutin rahmet pastë. Ndër vëllezërit e Hafiz Maksutit vëllai i madh Halili ishte dakord për çështjen e njisimit të Allahut xh. sh. në gjuhën shqipe dhe ruhej disi nga të bëmit shirk me gojë por ai nuk besoi që Aisheja rahmetullahi alejha ishte e dërguar muxhedide nga Allahu xh. sh. Ai thoshte: A një grua paska çuar Zoti xh. sh. për të na sqaruar neve? Por Allahu xh. sh. në Kuran thotë; Allahu zgjedh kë të doi. "Ai thotë; Njerzit nuk kanë të drejtë ti bëjnë vërejtje Allahut xh. sh. [përse kështu e përse ashtu]. "Me këtë popull është hall të jesh burrë e hall të jesh grua. Halili vdiq me mendimin se gruaja nuk mundet të jetë në atë gradë të lartë prej Allahut xh. sh. por vetëm burrat. Allahu xh. sh. e faltë këtë besimtar të mir themi un. Allahu xh.sh. jua ndriçoftë mendjen njerëzve dhe e udhëzotë fisin e Hafiz Maksutit që të largohen nga shirkun e ta njisojnë Allahun xh. sh. në çdo gjuhë. Ndërsa Reshit Bali burrë i dëgjuar në atë kohë në zonën e Baldushkut të Tiranës, për detyrën e murshides Aishe dëgjojë në kohën e pleqëris. Ai u shpreh kështu; "Megjithëse nuk e kam njohur atë grua që populli i thonë Aishja e mirë, por përse kam dëgjuar nga fjalët që thotë dhe puna që ban, mendoj se duhet të jetë njeri i mirë. Kam dëshirë ta takoj atë. Reshit Bali ishte besimtarë agjëronte dhe shkonte në xhami për të falur namazin e xhumasë kur xhamijat akoma nuk ishin mbyllur nga qeveria në vendin tonë. Ai edhe pas mbylljes së xhamijave e agjëroi disa vite ramazanin. Reshiti ishte rritur jetim pa babë, pasi ai kishte vdekur dhe Reshitin e kishte lënë fare të vogël. Reshiti mori pjesë në luftën për çlirimin e vëndit nga nazifashistët Gjermanë. Në fshatin Picallë- Stërmas Reshiti me shokët e tij të çetës u ndesh me gjermanët dhe në këtë përpjekje mbeti i vrarë shoku i tij Ramazan Muharrem Dervishi të cilin pas çlirimit të vëndit nga fashizmi, qeverija e shpalli dëshmorë. Reshit Bali thoshte un kam luftuar për vendin tim, por komunizmin un nuk e dua se ata janë të pa fe. Megjithëse Reshit Bali luftojë për çlirimin e vëndit të tij nga të huajt, atë e futi në burg dy herë rregjimi komunist dhe e bëri kulak=armik të popullit. Unë dhe muxhedidja Aishe rahmetullahi aleha u nisëm në vitin 1982, për ta thirr në tobe familerisht Reshit Balin, pasi un i kishim miq ata por nuk ishte e mundur atë ditë që të gjenim makinë të rastit për të udhëtuar deri në Baldushk dhe u këthyem prapa në rrugë duke qënë në fshatin Sauk. Pas pak kohësh Reshit Bali vdiq e nuk e takojë muxhediden Aishe.

Allahu e mëshiroftë. Në vitin 1983 unë e kam shoqëruar murshiden Aishe rahmetullahi alejha në një udhëtim që bëri ajo për thirrje në Tobe, në fshatin Kasharë të Tiranës, në lagjen e Hykajve, tek shtëpia e të quajturit Ramazan Hyka. Ai ishte njeri i thjeshtë që punonte në atë kohë në fabrikën e tullave. Ishte ditë e ngrohët në orët e mbas mesditës, që muxhedidja Aishe i mblodhi aty disa njerëz e iu foli për toben. Aty në atë shtëpi gjetëm një djalë të ri besimtar por pa dituri fetare të cilin e quanin Lulzim Hyka. Pastaj kur u larguam nga aty Lulzimi na përcolli për respekt deri poshtë tek shtëpitë e lagjes së Kamerëve. Ai na tha se e kishte agjëruar muajin e ramazanit. Muxhedidja Aishe i foli përsëri atij gjatë rrugës më gjërë për çështjen madhore të tobes. Me kaq u ndamë me të. Pasi u ndamë me Lulin murshidja Aisheja rahmet pastë më tha mua për atë; Ishte djalë i urtë fakiri por nuk kuptonte shumë. Allahu xh. sh. e udhëzofte dhe e qëndroftë në Islam tha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Tani në kohën e demokracisë, dëgjova se Lulzimi ose Zimi i thoshin në fshat, shkonte në xhami. Rreth vitit 1984 Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e shoqëruar ku isha dhe un vizitoi fshatin Sharrë të Tiranës. Ajo shkoi në shtëpinë e hoxhës së i qujtur Islam Vrapit që kishte mbaruar medresen=shkollën fetare në Tiranë. Në fillim hoxha dyshoi që Aisheja ishte e dërguar me shërbim të posaçëm,direkt prej Allahut xh. sh. për thirrjen e popullit në tobe por më vonë ai u shpreh, kështu; Aisheja ishte grua e zgjuar me shumë seriozitet dhe edukatë fetare. E kam parë me sytë e mi dhe kamë biseduar me të tha ai. Ajo flet të vërtetën dhe rrin e mbuluar sipas sheriatit Islam. Kishim fatin që në këto takime me emrat që përmenda, mora pjesë edhe unë shkruasi i librit Haxhi Ymer Aga që sot jam imam xhamije.

27-MUXHEDIDJA AISHE SHKOI NË QYTETIN E PESHKOPISË OSE DIBRA E VOGËL PËR TU NJOFTUAR NJERËZVE KOMUNIKATËN E ALLAHUT XH. SH. PËR TOBE.

Në vitin 1986 murshidja Aishe rahmetullahi alejha vetë i treti i shoqëruar dhe nga unë Haxhi Ymer Aga shkoi për të lajmëruar për tobe në qytetin e Peshkopisë. Një natë bujtëm në qytetin e Bulqizës në shtëpinë e një çifti të ri nga fshati Maqellarë që kishte një fëmijë

të vogël por që emri i tijë më ka humbur nga kujtesa pasi nuk po e gjejë të shënuar diku në letër. Allahu xh. sh ua shpërbleftë atyre me më të mirin shpërblim. Ata na pritën e na përcollën me shumë respektë. Djali ishte guzhinjer në mencën e punëtorëve, ndërsa gruaja e tijë punonte rrobaqepëse. Atyre aty në atë shtëpi dhe sa mundi rrugës, muxhedidja Aishe ua komunikojë lajmin e Allahut xh. sh. për të bërë tobe, dhe i porositi njerëzit si gjithëmonë, që ta shpërndanin këtë lajm ku të munden tek të njohurit e tyre. Të nesërmen iu drejtua qytetit të Peshkopisë ku pastaj qëndruam dy ditë në fshatin Rashnapojë në shtëpinë ku jetonte Hafizi i urtë e i nderuar Tahir Salkurtit. Në shtëpinë e tij Hafiz Tahiri mblodhi njerëz të njohur besimtar që ishin aty për rreth shtëpisë, fisi e miq të tij. Më kujtohet që pasi muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha mbarojë së komunikuari lajmin e Allahut xh. sh, për tobe, e falënderojë Allahun xh. sh. dhe tha fjalën inshallah Allahu xh. sh, e drejton për së mbari gjithë popullin. Një burrë nga të pranishmit aty e pyeti Aishen; Nga je, sa fëmijë ke, ku i ke e si i ke? Murshidja Aishe rahmetullahi alejha i tha: Jam nga Dibra, jam dibrane por që nga mosha 7 vjeçare banoj në Tiranë. Ndërsa fëmijë kam shumë sa që nuk mundë ti mbajë në kujtesë i tha ajo me marifetin dibranshe me buzët në të qeshur. Asheja si duket e kuptoi që ai e kishte ndonjë qëllim që i bëri asaj atë pyetje, se pytjen e parë ai e burri me dredhi se ai nuk e pyeti për çështje feje. Për fëmijët zakonisht pyesin më shumë gratë. Ndoshta ai e bëri pytjen pa qëllim por kur ai burri iku dëgjua se ai ishte komunist. Ai pas përgjigjes që i dha murshidja Aishe uli pak kokën e pasi u mendua pak tha : Kam ndej me shum njerëz e kam dëgjuar fjalë e përgjigje të ndryshme në shumë kuvende por kështu përgjigje nuk kam ndigju ndonjëher dhe po çuditë. Muxhedidja Aishe i tha atij: Ashtu si për fëmijët e mi përpiqem për të mirën e gjithë popullit se të miët janë të gjithë. Un nuk i mbajë në kujtesë sa njerëz kam porositur që ti largohen të keqes ta ruajnë veten. Ai burri dibranë i tha: A e ke ba lanet [a e ke mallkuar] ndonjë fëmij ose disa që mund të kenë mërëzitur ?

Ai e kishte fjalën për kategori të ndryshme njerëzish ose klasash, të ditur e të pa ditur, të thjeshtë e pushtetarë, të persekutuar, të pa persekutuar ose të ledhatuar. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha i tha atij: Un jam si nëna që i do të gjithë fëmijët njëllëj, por fëmijët dallojnë veten e tyre me sjelljen që bëjnë. Dibrani pastaj i tha asaj: Tani nuk kam fjalë më me ty. Të gjithë sa ishim aty filluam të qeshim.

Hafiz Tahir Salkurti nga Rashnapoja e Peshkopisë deklaroi kështu : Nuk ka dyshim aspak që Aisheja është me shërbim të caktuar prej Allahut xh. sh. Ajo pa asnjë lloj interesi dhe me shumë sakrificë kryen shërbimin që i ka ngarkuar Allahu xh. sh. Ndërsa murshidja Aishe tha për Hafiz Tahir Salkurtin kështu: Ai është besimtar i sinqertë=i vendosur dhe me terbijet=edukatë Islame. Ai është njeri i urtë, nuk është mendjemadh. Hafiz Tahiri ishte vërtetë njeri shumë i mirë. Pas disa vitesh kur muxhedidja Aishe u sëmur, Hafiz Tahiri e solli gruan e tijë Xhemilen nga Peshkopia në Tiranë për ti shërbyer murshides Aishe rahmetullahi alejha. Ajo ndejti në Tiranë 7 muaj pa u ndarë asnjë ditë nga murshidja Aishe deri sa ajo ndërroi jetë.

Në Peshkopi muxhedidja Aishe u takua në atë kohë dhe me të riun Xhemal Reçi që sapo kishte mbaruar në Tiranë shkollën. Xhemali më vonë kreu dhe studime fetare në një vëndë arab por që nuk e di plotësishtë tamam se në çvëndë. Për këtë njeri dëgjova që atëherë pasë takimit që pati me muxhediden Aishe se ai nuk besonte që Aisheja rahmetullahi alejha ishte vërtetë me shërbimin të caktuar prej Zotit xh. sh. për thirrjen e popullit në Tobe. Më vonë, pas vendosjes së rregjimit Demokratik në Shqipëri dëgjova se ky njeri kishte folur shumë keq për murshiden Aishe rahmetullahi alejha. Allahu xh. sh. e drejtoftë atë dhe të tjerët si ai që kanë ra viktimë të hileve të shejtanit të mallkuar e shokëve të tij munafikëve e qafirave. Ky njeri dhe shumë të tjerë si ky, nga që nuk janë të thelluar në çështjet e fesë ju ka rritur mendjen djalli i mallkuar dhe mendojnë se i dinë të gjitha gjërat. Muxhedidja Aish e shoqëruar shkoi dhe në fshatin Dahoshishtë në shtëpinë e Abdusamed Shehut i cili sot është imam xhamije në Tiranë dhe njohës i gjuhës Arabe. Në atë kohë ai ishte me punë në Bulqizë. Për murshiden Aishe ai në kohën e rregjimit komunist u shpreh kështu: Pa dyshim Aisheja pa dyshim është grua besimtare e devamshme [e devotshme]. Këto fjale un shkruasi i librit i kam dëgjuar vetë nga goja e tij.

28-MUXHEDIDJA AISHE VAZHDOI TI KOMUNIKOJË POPULLIT SHQIPTARË URDHËRESËN E ALLAHUT XH. SH. PËR TË BËRË TOBE. QËNDRIMI I DISA HOXHALLARËVE DHE NJERËZVE TË NDRYSHËM NË VENDIN TONË NË ATË KOHË NDAJ SHËRBIMIT TË SAJ.

Dibra me rrethinat e sajë ka nxjerrë shumë njerëz të dijes. I tillë ishte kohët e vona dhe ish myftiu i qytetit të Peshkopisë Sali Ferhati por që muxhedidja Aishe nuk arriti ta takonte. Dibrës nuk i kanë munguar dhe nëpër fshatra njerëzit e ditur e të devotshëm. Një ndër zonat që ka pasë hoxhallarë të ditur e të vendosur në fe, ka qënë dhe zona e Lumës, rrethi i Peshkopisë. Nga këta hoxhallarë të devotshëm që jetuan në kohën e rregjimit komunist ishin: Vehbi Ferhati, Basri Selmani dhe Zeqir Hoxha të cilët kishin studjuar jashtë Shqipërisë. Hoxha i dëgjuar i asaj zone Vehbi Ferhati kishte vdekur në vitin 1949 para se Aisheja të ngarkohej prej Allahut xh. sh. me shërbimin e Tobes. Muxhedidja Aishe nuk pati mundësi ti takonte hoxhallarët e dëgjuar të Lumës për arsye të largësisë së madhe nga Tirana që ishin ata dhe se në kohën e rregjimit komunist mjetet e transportit ishin të rralla dhe jo të rregullta sidomos për gratë. Duhej të hipje e zbritje nëpër kamjona të mëdhej transporti. Më vonë kur erdhi rregjimit komunist këtu dolën hoxhallarë të rinjë, që si kudo i ngjanë kohës. Nga këta ishte edhe hoxha Ymer Ferati nga Luma e Dibrës që kishte mbaruar medresen në Tiranë. Ai e takoi muxhediden Aishe rahmetullahi alejha në Tiranë në vitin 1978 pasi kishte ardhur për hallet e tija në Tiranë. Ai në fillim u entuziazhua dhe e mori përsipër=i premtoi me dëshirën e tij muxhedides Aishe që lajmin e Allahut xh. sh. për tobe ta përhapte në zonën e Lumës. Mirë po çdo gjë është në dëshirën e Allahut xh. sh. dhe me rriskë prej Tijë. Nuk kaluan veç se pak ditë dhe murshidja Aishe, mori njoftim prej Allahut xh. sh. se Ymer Ferhati nuk qëndroi në fjalën që dha por përkundrazi. Këtë njoftim që tha Aisheja unë shkruasi i librit e vërtetova me fjalët e vetë Ymer Ferhatit që më tha mua në kohën e demokracisë, rreth viteve 1992- 93 i cili u shpreh me këto fjalë; Aisheja tha ai është një copë grua, një besimtare e thjeshtë e asgjë më shumë dhe thotë se jam e dërguar me shërbim nga Zoti xh. sh. Unë e kam takuar Aishen tha Ymeri dhe ajo thoshte

që njerëzit të bëjnë tobe=të largohen nga haramet e si kusht i parë të mos bëjnë shirk, mos ta thërrasin njëri tjetrin me fjalët Zoti, Zotni, Zotnjush ose Zonjë e Zotnush ose Zonjush, i Zoti, i dal Zot e Zotnoj, kam Zotësi e Zotohem, por Zoti xh. sh. e di qëllimin që kemi ne tha Ymeri dhe qeshte me ironi. Për njerëzit që nuk i përfillën ata njerëz që i dërgoi Allahu xh. sh. me shërbim, Ai në Kuran i thotë Pejgamberit kështu : “Kur të shikojnë ty, nuk të çmojnë ndryshe, por vetëm me tallje dhe thonë: A ky është ai që Allahu e dërgoi pejgamber=lajmëtarë ?”. S. Furkan. aj. 41. =Kapitulli Dallimi. Unë pastaj së pari Ymer Ferhatit i thashë; Edhe gruaja e Pejgamberit tonë a. s, e famëshmjia Aishe r. t. a, grua ka qënë, por ajo ka qënë një dijetare e madhe. Tek ajo morën mësimë shumë njerëz pasi ndërroi jetë Pejgamberi a. s. Ajo u transmetoi njerëzve mijra hadithe=fjalë të Pejgamberit a. s. Pastaj së dyti i thashë atij, dëshmjia-shehadeti thuhet me gojë, por edhe kufri ose qyfri nga goja del. Megjithatë i thash Ymer Ferhatit, ti bëj si të duash por unë ta rikujtova dhe një herë çështjen e Tobes, me kushtin e parë kryesorë, largimin nga shirku me gojë. I famshmi dijetarë i devotshmi Hasan Basriu r. t. a. ka thënë; Ose duku si je, ose të jeshë si të dukesh. Ndërsa imami i madh Ebu Hanifja r. t. a. ka thënë; Sikur të ishte imani vetëm me zemër pa patur rëndësi goja, do të pretendojshin gjithë qafirat se janë besimtar, dhe po të ishte imani vetëm me gojë pa pasë rëndësi zemra, do të dilnin munafikët si besimtarë, por ai thotë që Allahu i kërkon nga njerëzit që të dyja, besim me zemër dhe vërtetimin me gojë. Me gjithë atë ai nuk u bindë. Në dashtë Allahu xh. sh. ndoshta bindet tani sa është akoma gjallë. Më mirë vonë se hiç fare. Ndërsa Besim Ferhati, vëllai i Ymerit që ishte imam xhamije në fshatin Mullet të Tiranës, me sa kam konstatuar unë, është distancuar nga vënja shokë e ortakë Zotit xh. sh. Allahu xh. sh. i drejtoftë të gjithë njerëzit për së mbari. Pak koh më vonë në shtëpinë e Hasan Qytykut në kohën që feja ishte e ndaluar me ligjë nga shteti unë u njoha me Kadri Hoxhën nga një fshat i Burreli afër Klositi cli banonte në Tiranë. Kadriu ishte studjues autodidakt i fesë Islame dhe gjuhës Arabe. Në atë kohë ai ishte spiker=folës i gjuhës arabe në radio Tirana, për emisionin e lajmeve në gjuhë të huaja dhe thoshte duke u lavdruar, që mua këtu në Tiranë më ka sjellë vetë Nexhmije Hoxha, bashkëshortëja e Enver Hoxhës. Një ditë unë shkova tek Radio Televizioni Shqiptarë për ta takuar Kadriun.

Pasi mbaroi dhënjen e lajmeve e takova gjatë rrugës kur ai po shkante për në shtëpi, i fola atij për muxhediden Aishe, për çështjen e madhe fetare të tobës. Ai më dëgjoji shumë, dhe nuk fliste fare, dhe kur unë e mbarova fjalën më tha; Eja të shkojmë dua ta takojë atë njeri. Shkuam dhe për fatë e gjetëm në shtëpi Aishen qoftë i kënaqur Zoti xh. sh. prej asaj. Pasi e prezantova me Kadri Hoxhën, ajo filloi ti flasi Kadriut për çështjen e madhe të rëndësishme të Tobës. Në fillim Kadriu nuk e kundërshtoi për kushtet e tobës se ata janë kushtet bazë në Kuran për të pastru veten e ripërtëri besimin çdo besimtar e besimtare duke i dhënë besën Allahut xh. sh. Por kur murshidja Aishe gjatë bisedës e kaloi fjalën tek formula e besimit, ametu bil lahi ve melaiketihî ve kutubihî ve rusulihî, vel jevmil ahîri ve bil kaderihî dhe deri në fund Kadriu u hodhë përpjetë duke e kundërshtuar muxhediden Aishe. Ai i tha asajë se kjo është formulë që e kanë shpikur turqit dhe nuk e përmban Kurani. Muxhedidja Aisheja i thoshte se nuk është ashtu si thua ti se këto fjalë janë të treguara në Kuranë. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran thotë: ...Por mirësi e vërtetë është ajo e atij[njeriu]që i beson Allahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librave [të Allahut xh. sh], pejgamberëve... S. Bekare. aj. 177. Kadriu menjëher u nevríkos dhe si i lajthituri nga mendja filloi të flasi me një fjalorë shumë të keq pa edukatë duke e kundërshtuar detyrën që i kishte ngarkuar Allahu xh. sh. murshides Aishe rahmetullahi alejha e duke i thënë asajë se ti gënjen. nuk është ashtu, ti nuk paske dije feje etj. Unë në atë çast për të vërtetuar fjalët e muxhedides Aishe i dhash në dorë Kadriut revistën fetare Islame Zani i Naltë që ishin shkruar aty ajete Kurani e hadithe dhe që tregonte aty dhe për ardhjen e muxhedidave=ripëtëritësve të fesë në çdo njëqindë vjet, të cilët i dërgon Allahu xh. sh.me shëbim për ringjalljen e besimit në zemrat e njerëzvet. Aty kishte ajete nga Kurani të komentuar nga dijetari i njohur I vendit tonë Haxhi Vehbi Dibra e tjerë. Në atë moment Kadri Hoxha u hodh përpjetë e zhubrosi revistën dhe e poshtëroi duke u ulur sipër saj e duke folur si i lajthitur llojë, llojë fjalësh të këqia. Unë u çudita dhe mbeta i shtangur nga sjellja shumë e keqe e tij. Ndërsa murshidja Aishe rahmetullahi alejha më urdhëroi që Kadriu të largohej menjëher. Kur dolëm jashtë unë i thash atij: Ti Kadri të keshë turp, për sjelljen e keqe pa edukatë e respekt ndaj Aishes dhe Kuranit të shkruara në revistë. Ti qenke njeri pa kulturë e pa dituri. Ndërsa unë mendova ndryshe për ty o Kadri Hoxha. Ndërsa

Kadriu më tha: Ti më qafsh hallin mua se un jamë krenar se këndoju si bilbil në Radio Tirana. Në ata momente un shikova majtas e djathtas që mos të më dëgjonte tjetër njeri, pasi isha dhe i persekutuar kulak, dhe i thash Kadriut; Ti në Radio Tirana çirre si sorrë se ti flet aty për marksizëm-leninizmin e jo për fenë Islame. Ai diç murmuriti nëpër dhëmbë dhe un i thash së fundi këto fjalë: Dëgjo mir këtu o Kadri Hoxha dhe mbajë në mendje këto fjalë; Cili njeri që e ka ofenduar murshiden Aishe rahmetullahi alejha ai e ka marrë shpejtë që këtu në dynja dënimin nga Allahu xh. sh. Ai qeshi me ironi e më tha asnjë herë jo. Un i vendosur i thash nëse ti nuk do ta marrësh dënimin pas një muaji sa herë të më shohësh mua në rrugë të më pështyshë mes njerëzish dhe për këtë gjë un po të jap dorën. Ai e zgjati dorën dhe me kaq u ndamë. Nuk kaloi veç se një muaj dhe Kadri Hoxhën e nxorën nga puna në Radio Tirana për dëmtim të pasurisë socialiste dhe e çuan në fabrikën e qumështit në aneksin e frigoriferit, për të ngarkuar makinat me fuçijat e gjizës që shpërndaheshin nëpër dyqane. Nuk mund të ecte më. Muxhedidja Aishe rahmetullahi aleha thoshte se Allahu xh. sh. më ka njoftuar mua kështu: "Cili njeri që të armiqsohet ty, ai njeri është në luftë me mua se Un i kam shpall luftë atij njeriu". Është vërtetuar me fakte konkrete se cili njeri që ka ofenduar muxhediden Aishe vërtetë e ka dënuar Allahu xh. sh. Atij njeriu i ka filluar dënimi me mynyra të ndryshme që këtu në këtë dynja. Edhe pas vitit 1990 kur u rihapën xhamijat përsëri Kadri Hoxha veproi keq. Ai nuk e lejoj një villain tonë musliman që t'u fliste popullit në xhaminë e Et'hem Beut për çështjen e njisimit të Allahut. xh. sh. në gjuhën shqipe. Në fillim të demokracisë Kadriu punoi si përkëthyes në një shoqatë arabe. Më vonë kur ikën shoqatat arabe mua më than se Kadri Hoxha gjeti një dhomë me pagesë e aty filloi ti shkruante popullit nuska. Tani kohët e fundit un dëgjova se i shkreti Kadri ishte paralizuar. Nuk mund të ecte më. Shpresoj që Kadri Hoxha ta ketë kuptuar gabimin e madh që ka bërë dhe të pendohet sinqerishtë për të mirën e tij para se të vdesi. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Allahu ia pranon toben atij që do se Allahu i di të fshehtat e me urtësi zgjidh çdo çështje". S. Tobe ajeti. 5. Mirpo për shkakun se un i solla muxhedides Aishe në shtëpi Kadri Hoxhën që kishte qenë pa edukate e unë nuk kishim mundësi për disa arsye të reagoja më shumë, për këtë gjë murshidja Aishe rahmetullahi alejha u zëmrua pak me mua.

Më vonë në vitin 1987 un nga dëshira e madhe që kishim që të përhapej sa më shumë lajmurdhëresa e Allahut xh. sh. për Tobe desha ta takoja muxhediden Aishe me një person tjetër, që ai ishte puntor i thjeshtë. Aisheja porsa e shikojë atë tha; Nuk kam kohë që të bisedoj me të. Un u çudita se ky njeriu më pati thënë mua në rrugë para se të shkojmë tek Aisheja se ajo gruaja [Aisheja] që ti po më flet për të, nuk do të më pranojë mua. Un pa ditur gjë i thash atij; Të pranon se ti je i shoqëruar me mua. Mirpo në faktë ndodhi ashtu si tha ky njeriu. Muxhedidja Aishe vërtetë nuk pranojë që të takohet me atë por e priti tek porta e shtëpisë me fytyrë shumë të mvrejtur që nuk e kishim parë ndonjëherë atë ashtu. Un nga që u çudita se përse ajo veproi ashtu, të nesërmen shkova për ta pyet atë se përse ajo e priti keq atë njeriun e i thash murshides Ashe: Përse u tregove aq e ashpër në fytyr ndaj atij njeriut. Ndërsa murshidja Aishe rahmetullahi alejha më tha mua; Atë e di unë. A ti do të më mësosh mua. Ti nuk e di atë që di unë. Largohu tani prej meje se ty nuk të pëlqeu veprimi im. Për këtë shkak Aisheja i ndërpreu disa kohë takimet me mua. Ndarja ime për disa kohë me muxhediden Aishe ia përngjas ndarjes së haz. Musait a. s. me Hizrin a. s. Unë e pësova si Musai në takimin me Hizrin i cili nuk i kuptonte veprimet që bënte Hizri se Musai gjykonte si pas asaj që shikonte me sy se ai nuk kishte dije prej Allahut xh. sh. për të pa dukshmen=për të fshehtën ndërsa Hizrit kishte. Un këtë njeriun që e çova tek muxhedidja Aishe nuk e njihja nga afër por vetëm e njihja si filan njeri. Pas disa kohësh që unë nuk shkoja më tek Aisheja dëgjova se ai njeriu që unë e çova tek muxhedidja Aishe bënte tre gjynahe të mëdhaja të pa pafalshme. 1] Shante me fjalë të pista Allahun xh. sh. 2] Sillej shumë keq me prindërit që thoshin se edhe i rreh ata. 3] Ishte i xhindosur e merrej me fall e ndoshta dhe me magji. Sharjen e Zotit xh. sh. e dëgjova vetë, për xhindët më tregojë veti ai ndërsa për çështjen e prindërve më treguan familjarët e tij. Vërtetë këto që bënte ai ishin fajet më të mëdhaja. Allahu xh. sh. thotë në Kuran; Janë të mallkuar ata që ofenduan=shanë Allahun = Zotin xh. sh. " Ndërsa për rëndësinë e respektit ndaj prindëve Allahu xh. sh. thotë : " . Mos adhuronit tjetër veç Allahut e të silleni mir ndaj prindërve. "S. Isra. Për këtë njeri më vonë dëgjova që atij i iku mendja dhe u bë anormal me kartelë mjekësore. Allahu xh. sh. po deshi e mëshiron. Unë këto gjëra nuk i dija për atë njeri se nuk e

kishim afër me banim atë dhe nuk e njihja se çfar njeriu ishte porë vetëmse dëgjoja prej tij që u betonte shumë në Zotin xh. sh. për pak gjë. Kështu që muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha nuk gabonte në veprimet që bënte se merrte inspirim=frymëzim prej Allahut të madhërushëm që është dijtës i të fshehtave. Nga kjo gjë duhet kuptuar se nxënësi duhet të jetë i bindur e i sjellshëm ndaj mësusit se nxënësi nuk i di ata që di mësusi. Allahut xh. sh. i lutem të ma fali gabimin edhe se pa qëllim të keqë. I lutem Allahut xh. sh. me lutjen nga Kurani : “O Allah ma shto diturinë. ” Kështu që dy vjetë para se vjen në vendin tonë rregjimi demokratik mua muxhedidja Aishe rahmetullahi aleja mi ndërpreu takimet me të dhe i rifillova më vonë në rregjimin demokratik atëherë kur deshi Allahu xh. sh.

Kur u vendos sistemi politik demokratik në vendin tonë erdhën shumë shoqata fetare e bamirëse. Një ditë në xhaminë e Et-hem Beut në Tiranë, pasi falëm namazin dhe njerëzit shkuan, unë qëndrova pak aty. Imami i xhamisë Hasan Qytyku bëri shirk me gojë duke folur. Un i thash atij: Mos kështu o Hasan se të kam folur për shirkun me goj disa herë. Mos e tradhëto në gjuhën shqipe fjalën e fortë = fjalën më të madhe; La il lahe il lallah se do ta dëmtosh rëndë veten tënde duke menduar se ti i di të gjitha çështjet e fesë. Hasani u mërzi dhe e ngriti pak zërin. Aty brenda kishte qënë dhe një njeri me banim në Siri që kishte ardhur në atë kohë në Shqipëri. Ai ishte i ditur në fe siç më tha më vonë Hasani i cili kishte pas folur me të. Ai ishte njeri me trup të madh e të mbushur. Kokën e kishte pak të madhe dhe ballin të gjërë. Sytë i kishte të mëdhej dhe hundën të vogël me maj. Flokët i kishte shumë të shkurtër. Ishte nga rraca e bardhë e i kuq në fytyrë e nuk ishte nga kombi arab. Fliste arabisht, anglisht e gjuhë tjera, por kishte mësuar edhe shqip pasi kishte disa kohë që kishte ardhur në Shqipëri. Kur Hasani e ngriti zërin ai i pa njohuri u bë kurjoz dhe u afrua tek ne dhe ju drejtua Hasanit, imamit të xhamisë: Përse grin-deni? Hasani duke qeshur i tha atij për mua kështu : Ky besimtari thotë dhe beson se një grua e ka dërguar Allahu xh. sh. me shërbim si muxhedide. Ai i huaji më shikojë mua. Unë i thashë hadithin e Pejgamberit a. s. që paralajmëron për muxhediat që vin me shërbim në çdo një qindë vjetë. Këtë hadithë i thashë e transmetojnë Buhariu dhe Ebu Daudi e thonë që është hadith sahi=i vërtetë. Ai i huaji tha po, e vërtetë është. Pastaj unë i tregova atij për thirrjen në tobe me

çështjen kryesore largimin nga shirku me gojë në çdo gjuhë, për të cilën e thërriste popullin muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Ai pasi më dëgjojë i tha Hasanit për mua se ky ka të drejtë për këtë gjë. Hasani, imami i xhamisë heshti por nuk u bind për këtë gjë.

Pasi dolëm jashtë xhamisë në koridor ai i huaji nga Sirija më pyeti mua se a është gjallë ky njeriu që i ka bërë këtë thirrje për tobe popullit tuaj kështu si po më tregon ti. Unë i thash se është gjallë por është e vjetër dhe e sëmurë tani dhe nuk lëviz më. Ai më tha se unë dua ta takoj këtë njeri. A e di ti ku e ka shtëpinë kjo grua? Unë i thashë atij e di por ka disa kohë që ajo nuk pranon të takohet me mua për një çështjen e një njeriu që unë e çova tek ajo që ti fliste për toben. Unë e kishim qëllimin të mirë për ti shërby fesë por ajo nuk e pranoi dhe unë u mërzita e i fola= ndërhyra në punën e saj. Ndërsa i huaji nga Sirija më tha; Hajde me mua ti se ajo do të pranojë ty se jam unë me ty. Unë qesha se ata nuk e njihnin njëri tjetrin dhe i thashë e po hajde shkojmë. Unë e pyta për emrin dhe ai më tha më quajnë Ahmed. Ndërsa ai më kishte pyetur mua në xhami për emrin tim. Gjatë rrugës ai vetëm se këndonte Kuranë. Kur u afruam afër shtëpisë Ahmedi nga Sirija më tha mua: Unë do të marr ndonjë send në dyqan për këtë gruan [Aishen]pasi ajo është e vjetër ndërsa ti më tha ai mua bëj si të duash. Unë i thash se do të marr edhe unë ndonjë send për të. Ai mori mollë e banane e diçka tjetër, ndërsa unë mora rrush. Kur u afruam te porta, ai trokiti në portë. Portën na e hapi një grua ish arsimtare që i shërbente gjatë sëmundjes muxhedides Aishe rahmetullahi alejha disa ditë para se të vinte nëna e Jusuf Salkurtit nga Dibra=Peshkopija. Dëgjova me sa më kujtohet nga thirrja që i bëri Aisheja asaj, se ajo grua e kishte emrin Drita. Ai i pa njohuri që quhej Ahmed i tha asaj gruas = Dritës që na hapi portën kështu : Thuaj Aishes se unë quhem Ahmed nuk jam këtu i këtij vendi dhe jamë i shoqëruar me Haxhiun. Thuaj ti asaj; A pranon ajo të vim brenda të dy së bashku apo jo? Ajo grua u fut brenda në dhomë e i tregojë murshides Aishe fjalët që i tha Ahmedi dhe pasi mori leje nga ajo, na lejoi neve të futeshim së bashku brenda në shtëpi. Kur u futëm në dhomë tekë Aisheja u përshëndetëm me të me selam dhe u ulëm në minderin prej dërrase. Gruaja që i shërbente Aishes ato ditë në fillimin e sëmundjes para se të vinte nënë Xhemilja nga Peshkopia, na gostiti me diçka siç e do zakoni për miqtë. Dëgjova se ajo ishte me origjinë nga Berati e cila banonte në

një lagje me muxhediden Aishe rahmetullahi alejha. Në fillim kur u futëm në oborr për çudinë time ai Ahmedi qesen që kishte të mbushur me fruta nuk e futi në shtëpi por e la në oborr ngjitur me murin e shtëpisë dhe më tha mua dhe ti kështu vepro; këtu lëre. Unë u çudita pak nga ky veprim i jashtë zakonshëm, por ashtu veprova. Më vonë un duke menduar që dhurata nuk lihet jashtë në oborr, u ngrita e mora qesen time e futa në dhomë. Ndërsa Ahmedi që Allahu xh. sh. e mëshiroftë më tha; Përse e fute brënda dhuratën. Murshidja Aishe qeshi dhe shikojë Ahmedin me një shikim domethënës që dojte ti thoshte atij për mua, se ky nuk e kupton punën si është. Un nuk kuptova gjë se çfar ishte ai veprim ashtu që bëri njeriu i pa njohur që tha se e kishte emrin Ahmed. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha i tregojë Ahmedid për shërbimin e thirrjes në tobe që i kishte ngarkuar Allahu xh. sh. Ai e dëgjonte me vëmëndje. Nuk kaluan veç se disa dit dhe kur un shkova për së dyti e gjeta të sëmurë të shtrirë në krevat muxhediden Aishe rahmetullahi alejha. Pas kësaj dite unë fillova të shkoj çdo javë tek murshidja Aishe për ta shikuar = për ta vizituar atë. Edhe Ahmedi kishte shkuar për të pyetur për shëndetin e sajë tek porta e shtëpisë por nuk ishte futur më brënda në shtëpi por pyeste aty tek porta nënë Xhemilen nga Peshkopia e cila erdhi ti shërbente gjatë sëmundjes murshiden Aishe rahmetullahi alejha. Një ditë Ahmedi më tha se Aisheja është shumë e lodhur gjatë shërbimit që ka bërë në popull. Pas disa ditësh që un isha njohur me Ahmedin nga Sirija, pasi falëm bashkë namazin tek xhamia, një ditë unë e pyes atë. Po ti o Ahmed përse ke ardhur këtu në Shqipëri dhe me çfar pune merresh ? “Ai më tha edhe un jam me shërbim. Unë shkoj në çdo vend të botës dhe luftoj me shtrigat. Luftoj kundër sihirbazëve=magjistarëve që ata mos të kenë sukses në punët e tyre të poshtra që bëjnë kundër njerëzve. Mua nuk më ndalon askush që të shkoj në çdo vend të botës ku ka besimtarë”. Un u çudita dhe duke qënë në dyshim i thash : Çfar titulli ke ti që qenke me shërbim prej Allahut xh. sh. ? Ahmedi më tha: Un e kam titullin “Shpata.” Pasi unë u çudita e pyes përsëri: Si e ke mbiemrin ti ? Ahmedi më tha e kam Shafiu. Unë përsëri e pyes : Po babain tënd si e quajn? Ai më tha : babai im e ka emrin Abdullah. Mua më shkojë mëndja tek një hadith i Pejgamberit a. s. i cili ka thënë:“ Para se të zbresi Isai a. s.

në tokë Allahu xh.sh.do të dërgojë Mehdiun që do të thotë të udhëzuarin. Pejgamberi a. s. thotë tekstualisht kështu : “Kjo botë nuk do të marrë fund para se pas ardhësit e mi [muslimanët] ti udhëheqi një njeri që emri i tij është i njëjtë me emrin tim Ahmed dhe emri i babait të tij është i njëjtë me emrin e babait tim. [Abdullah]”Trans. Ebu Daudi dhe Tirmidhi nga Abdullah Ibni Mesudi. Ibni Kethiri thotë se ai do të paraqitet në kohën e zbritjes së hazreti Isait a. s, pak para zbritjes së tij. “Në një hadithë tjetër Pejgamberi a. s. ka thënë: “Sikur vetëm një ditë ti mbetet botës para kijametit pa dyshim Allahu xh. sh. do ti dërgojë umetit tim një njeri nga fisi im. ”Gjithashtu Ummi Seleme ka transmetuar se Profeti Muhamed a. s. ka thënë: “Mehdiu=që do të thotë i udhëzuar do të jetë me origjinë nga fisi im-familja ime. ”Hadithe të tjera transmetojnë se ky i udhëzuar do të jetë i madh në trup e i bardhë në fytyrë. [nga njerëzit me ngjyrë të bardhë]. Emri i babës së tij do të jetë Abdullah dhe emri i nënës Emine. Në kohën që do paraqitet do të jetë në moshën 40 vjeç. Udhëzimin [dijen për të vepruar] do ta marrin direkt prej Allahut xh. sh. Ndërsa Ebu Seid El Hudriu ka thënë se Resulullahu=i dërguari i Allahut xh. sh. hazreti Muhamedi a. s. ka thënë : Mehdiu do të jetë nga pasardhësit e mi. Balli i tij do të jetë i gjërë dhe hunda e ngritur.... Ai do të udhëheqë [muslimanët] shtatë vite”. Trans. Ebu Daudi dhe Hakimi. hadithi është hasen=i mirë. Fjala Mehdi është titull që në gjuhën shqipe do të thotë: i udhëzuar=pra i udhëzuar drejtë për së drejti nga Allahu xh. sh. Kështu ka thënë Pejgamberi a. s. Allahu xh. sh. e di të vërtetën se kush ishte dhe çfar ishte ai njeri. Ndoshta ka qënë Hizri? Allahu xh. sh. alimulgajb=Allahu xh. sh. është ditës i të fshehtës. Diturija dhe mrrekullitë e Allahut xh. sh. nuk kanë anë e fund. Një ditë unë po rrija me Hasanin në koridorin e xhamisë dhe para portës së xhamisë kaloi ky Ahmed. Unë prita që ai të futet brenda në xhami por ai nuk erdhi. Hasani më tha se Ahmed i kishte kritikuar Hasanin për mos veprime sipas ligjit të fesë duke i thënë atij se ti bën shirk dhe mendjen e ke tek nuskat. Hasani ishte mërzhitur prej tij nga këto fjalë e i kishte thënë Ahmedit se unë e di vetë punën time si veproj. Kështu më tregojë mua Hasani. Që nga ajo ditë Ahmed i nuk u fut më në xhaminë e Et, hem Bej ku aty imam xhamije ishte Hasan Qytyku. Të nesërmen kur Ahmed i po kalonte pranë xhamisë, unë i dola para dhe e përshëndeta. Ai e kishte me

ngutje punën e tij dhe unë e shoqërova pak deri afër hotel Dajtit. Kur po ndahesha me të, ai më tha : Po të lë këtë porosi : “Mos rri bashkë me ata hoxhallarë që bëjnë shirk, e që nuk e kanë mëndjen tek feja, por tek lekët, pasi ata nuk e kanë frikë Allahun xh. sh. .” Un i thash atij se nuk është e mundur që mos të takohem e të rrij me ata se jeta është e tillë që puna na lidh por fjalët dhe veprimet e tyre mua nuk ma ngatërrojnë mëndjen= rrugën. Ahmedi më tha: Ke kujdes dhe heshti. Nuk kaluan veçse disa ditë dhe Ahmedi nuk u duk më në Tiranë. Ky ishte takimi im dhe biseda e fundit me Ahmed Abdullah Shafiq që tha se banonte në Siri i cili nuk ishte arab siç më tregoi vet ai. Babai i tij kishte emigruar në Siri. Pas disa kohësh imami i xhamisë Hasan Qytyku më tregoi mua se disa njerëz të xhematit teblig=grupit të thirrjes në Islam e kishin pa më vonë Ahmedin në Malin e Zi në një xhami të qytetit të Ulqinit. Kaq ishin fjalët e mija për këtë njeri që mua më bëri shumë përshtypje se më bëri kurioz. Mirpo për çudi nuk më ra ndërmendë që ta pys muxhediden Aishe për këtë njeri duke i treguar asajë ato që më tha ai. Allahu xh sh. mua ma hoqi këtë gjë nga kujtesa, me gjithëse ajo në atë kohë ishte shumë e sëmurë. Ishte në ditët e fundit të jetës. Cili do që të ketë qenë ai njeri që erdhi e takoj muxhediden Aishe rahmetullahi alejha, por një gjë duhet ditur se; Ashtu sikurse mbretërit e shumtë në tokë kanë të besuarit e tyre që disa i titullojnë me gradën gjeneral, e disa të tjerë i duan shumë por nuk ngarkojnë me detyrën e gjeneralit. Ashtu edhe Mbreti i Gjithësisë=Allahu xh. sh, ka në këtë botë miqtë e Tij [evlijatë] që disa nga këta i ka ngarkuar me detyra të veçanta dhe e dijnë veten që janë njerëz të zgjedhur. Ndërsa disa të tjerë që nuk janë me detyrë nuk e dijnë veten që janë euvlija= miqë të Allahut xh. sh. Muxhedidat që ishin me shërbimin për ta thirrur e mësuar popullin ishin të urdhëruar nga Allahu xh. sh. që ta tregonin veten me detyrën për të cilën ishin dërguar nga Allahu xh. sh. Në kohën që muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ishte e shtrirë nga sëmundja dhe ishte në ditët e fundit të jetës së saj, un e pyta atë : Po për çështjen e tobes, si do të bëhet? A ia ke lënë ti këtë shërbim ndonjërit që ta bëj ? A mos ia ke lënë Jusufit [Jusuf Salkurtit] që ta vazhdojë ai këtë detyrë? Murshidja Aishe më tha : Un vetë me caktimin tim, nuk ja kam lënë askujtë, por kush dëshiron vetë le ta vazhdojë këtë thirrje me dëshirën tij se Allahu xh. sh do të ia shpërblejë atij njeriu. Unë i thash asajë : A të

vazhdoj unë ta shpallë me shkrim këtë thirrje? Muxhedidja Aishe më tha: Mirë do të bësh. Nëse ti dëshiron njoftoje popullin se Allahu xh. sh. do ta shpërblej. Unë i thashë muxhedides Aishe : A ta përmënd emrin tënd në libër? Ajo u mendua pak dhe më tha: "Mirë kujtoja njerëzve se për këtë tobe e thërriste dikur popullin një grua e quajtur Aishe. "Me kaq e përfundova bisedën me murshiden Aishe rahmetullahi alejha. Kjo ishte biseda e fundit fare me atë. Pastaj atë e rëndojë më shumë sëmundja dhe pas pak ditësh ajo ndërrojë jetë. Allahu xh. sh e mëshiroftë atë. Allahu xh.sh. më takoftë mua në xhenet me të dhe me të gjithë besimtarët që bënë tobe dhe me ata që do të bëjnë tani e prapa me kushtet që i treguam, duke u larguar në radhë të parë prej shirkut me gojë. Amin.

29-DËSHMITIË E DISA BESIMTARËVE TË THJESHTË PËR MUSHIDEN AISHE RAHMETULLAHI ALEJHA.

Nga besimtarët e thjeshtë që e besoi dhe e përkrahu muxhediden Aishe që ta përhapte lajmin e Allahut xh. sh, për të bërë njerëzit tobe=pendesë, ishte edhe babai im Ymer Aga nga fshati Farkë e Tiranës. Familja jonë u njoh me muxhediden Aishe rahmetullahi alejha që në vitin 1960. Babi im Ymer Aga ishte njeri i thjeshtë por besimtar i vendosur. Ai thoshte se disa ditë para se të takohem me Aishen, un e kishim parë atë në ëndër, me të njëjtën veshje sikurse e pashë në realitet. Ymeri thoshte se një besimtar i singhtë nga fshati im më tha mua në ëndërr këto fjalë: O Ymer shiko andej përpara; ajo gruaja që po vjenë drejtë teje e mbuluar me çarçaf= me hixhabë, është e dërguar me shërbim nga Zoti xh. sh. Pas disa ditëve thoshte Ymer Aga e tokova vërtetë murshiden Aishe rahmetullahi alejha me të njëjtën veshje nëpërmjet një gruaje të vjetër besimtare e quajtur Xhuvane Bulku që familja jonë kishim miqësi, krushkësi me të, dhe që ajo e njihte mir muxhediden Aishe e cila lajmëronte popullin për të bërë tobe. Porsa Aisheja i foli për tobe, Ymeri i kishte thënë asajë; Un të besojë pa dyshim, se kështu sikur je e mbuluar të kamë parë dhe në ëndërr. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Mjafton që çdo njeri të kishillohet me ëndrrën e vet. "Ai gjithashtu ka thënë; "Ëndrrat e besimtarve të mire janë paralajmërime. "Ymer Aga i tha asajë, me të vërtetë ne si pop ulla duhet të bëjmë

tobe se kemi shumë të meta=mangësina. Në atë kohë Ymer Aga ishte i ri në moshë. Ai atëherë falte vetëm namazin e xhomasë dhe agjëronte ramazanin. Në atë takim ishin edhe dy bashkë fshatarë të Ymerit. Edhe ata nuk e kishin kundërshtuar muxhediden Aishe rahmetullahi alejha për fjalët që u tha. Nga këto vetëm Ymeri bëri tobe duke e njisuar Allahun xh. sh, duke filluar faljen e namazit në pesë kohët dhe duke korigjuar veten për ndojë fajë tjetër, siç ishte ofendimi i njerëzve me ngjyrë të zeze me fjalët jevg e arrxhij, festimi i vitit të ri e ndonjë gabim tjetër. Edhe nëna e Ymerit Safija dhe vëllai Junuzi filluan të falin namazin. Besimtari Islam Ymer Aga me gjithëse ishte i cilësuar nga rregjimi komunistë kulak, më vonë u bë njëriu më inisiatorë për përhapjen e lajmit të Allahut xh. sh që solli murshidja Aishe rahmetullahi alejha për tobe, megjithëse njerëzit në fshat që ishin me dy fytyra-munafikët folën shumë kundër tijë. Inshallah pendohen ata që jan gjallë. Ku-rani thotë; "Allahu i do ata që pastrohen [që bëjnë tobe]"S, Tobe aj 108. Aisheja erdhi në fshatin Farkë e shoqëruar nga besimtarët ndër të cilët ishte dhe një grua e moshuar besimtare nga Shkupi e quajtur Qamile që kishte ardhur në Tiranë bashkë me burrin e saj pa fëmijë, që para luftës së dytë botërore. Aisheja rahmetullahi alejha, e thërriste atë për respektë, Qamile hanmi. Ajo ishte me origjinë Turke mesa më kujtohet mua, pasi gjuhën turke ajo e fliste mirë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha erdhi në fshatin Farkë nëpërmjet Ymer Agës. Ajo i bëri thirrje për tobe popullit në fshatërat Farkë e madhe dhe Farkë e vogël. Gjithashtu muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e shoqëruar nga Ymer Aga dhe shoqërusa e shoqëruse tjerë, më vonë bëri takime me njerëzit në disa fshatra tjera të Tiranës si në Gurrë e vogël, Bulticë, Barbas, Fikas Sauk e tjer. Fshati Farkë vërtetë ishte fshat me tradita fetare, por nuk mungonin dhe njerëzit e këqij, ego-istë e munafikë. Në fshatin Farkë e vogël, një munafikë=dj fytyrsha një spiun raportoi në organet e shtetit për murshiden Aishe, se gjoja ajo merrej me politikë, bënë agitacion e propogandë kundër partisë e shtetit me anë të fesë. Ajo merret me kulakët, armiqtë e popullit siç është kulaku Ymer Aga. Ata nuk donin ta dinin dhe ta besonin se Aisheja shoqërohej dhe i donte pa përjashtim të gjithë njerëzit që bënë tobe = pendesë të ktheheshin në rrugën e Zotit pa përjashtim kushdo qofshin ata të persekutuar e të pa persekutuar, të bardhë e të zi, kulakë e komunistë. Por Ymer Aga nuk u

tronditë nga besimi, megjithëse vuajti shumë shpirtërishtë, ekonomikisht dhe fizikisht, derisa ndërroi jetë në vitin 1988 në moshën 60 vjeç, pa e parë rihapjen xhamiave. Murshidja Aishe i ngushllonte njerzit e vujtur duke iu thënë bëni durim se kanë vuajtur dhe pejgamberët. Vërtetë kanë vuajtur shumë Pejgamberi i jonë dhe familja e tij ehlibejti bashkë me sehabët=shokët e tij dhe shumë e shumë murshida që ishin më pas bashkë me besimtarët e mir. Besimtari i mir që falte me rregull 5 kohët namaz Shazivar Shehu nga Çaja e Kuksit i cili banonte në Tiranë u shpreh kështu: Aisheja është grua e devotshme. Ajo nuk gënjen por thotë të vërtetën. Besimtari Sulejman Tufa nga Tirana tha këto fjalë për Aishenë; Ajo ka qenë e caktuar nga Zoti xh. sh. me shërbim, por shumica e hoxhallarëve nuk e besuan këtë gjë. Vërtetë hoxhallarët thoshin në popull këto fjalë siç e kan zakon Shqiptarët në përgjithësi: A gruaja more do që të na japi mendë neve=[të na japi dije neve]? Edhe atyre jua kishte futur djalli në harresë thënjen e Allahut xh. sh. në Kuran ku thotë: “ Ju [o njerëz burra e gra] jeni shfaqur=keni dal [në dynja] nga njëri tjetri. ” Ata harronin në atë kohë edhe sot hoxhallarët e rinjë harrojnë se gratë dhe burrat janë të barabartë tek Allahu xh. sh. në shpërblime e dënime dhe se Allahu xh. sh. preferon kë të doi. Besimtari i mir Muharrem Shehu nga Farka e Tiranës që i falte pesë kohët e namazit dhe lexonte vazhdimishtë Kuran, për murshiden Aishe tha; Aisheja është grua besimtare e mirë. Ajo rrin e mbuluar sipas sheriatit dhe i thërret njerzit të bëjnë tobe. Besimtari i mir Ramiz Shkëmbi edhe ky nga fshati Farkë tha para njerëzve se Aisheja ka qenë me shërbim prej Allahut xh.sh. Ajo ka qenë njeri i shejtë, =njeri me grada tek Allahu xh. sh. Ramizi kishte dije feje. Ai ka qenë pak kohë imam xhamije në fshatin Shkallë të Tiranës para se shteti shqiptar ta ndalonte me ligj fenë. Xhemile Salkurti nga fshati Rashnapojë e Peshkopisë deklaroi: Un i shërbeva 7 muaj rreshtë Aishes gjatë sëmundjes deri sa vdiq dhe nuk e kam dëgjuar asnjë her atë të ankohej si gjithë të sëmurët, of e uf, por thoshte gjithmonë vetëm Allah, Allah, Elhamdulilah, La il lahe il lallah Muhamedun Resulallah. Ajo ishte shumë e devotëshme. Pa dyshim ka qënë e zgjedhur nga Allahu xh. sh. Nënë Xhemilja më tregoi një keramet në lidhje me murshiden Aishe rahmetullahi alejha. Ajo thoshte : Në darkë në dollapin e bukës nuk kishim fruta ndërsa kur ngrihesha në mëngjes i gjeja pjatat të mbushura

plot me fruta të ndryshme. Jamë tepër e çuditur më tha ajo. Atëher mua mu kujtuan fjalët e Aishes e cila mi kishte thënë disa vite më parë se duke e mbajtur mendjen tek halli për pleqërinë e fundit, kishte marrë nga Allahu xh. sh. këtë lajm ngushëllus e sihariqus kështu: "Ti [Aishe] mos u mendo shumë për pleqërinë, se Allahu është ia që ja sjellë rriskun [ushqimin] krijesave të tijë, nga magribi [perëndimi], në mashrik [në lindje] dhe anasjelltas. Ashtu sikurse ia sollëm Merjemes [nënës së Isait] frutat në faltore, edhe ty do ti sjellim në shtëpi." Me të vërtetë Allahu xh. sh. e bëri realitet premtimin e vet. Allahu xh. sh. në Kuran tregon për Merjemen dhe thotë: "Sa herë që Zekirjai hynte në mihrabin [dhomën e faljes së sajë] dhe gjente tek ajo ushqime i thoshte [asaj]. O Merjeme; prej nga [të vjen] ty ky ushqim. Ajo thoshte; Ai [ushqim] është nga Allahu, se Allahu e furnizon pa masë atë që do." S. Ali Imran. aj. 37.

30-KOMUNIKIMI QË U BËRA UNË SHKRUESI I LIBRIT DISA HOXHALLARËVE TË VËNDIT TONË NGA KOHA E RREGJIMIT KOMUNIST DHE NË RREGJIMIN DEMOKRATIK, PËR ÇËSHTJEN E TOBES QË KOMUNIKONTE MUXHEDIDJA AISHE.

Nga dashurija që kishim unë për fenë e Allahut xh. sh. dhe dëshira që kishim që njerëzit të drejtohen tamam në rrugën e Tij; unë vazhdoja ti komunikojta njerëzve mesazhin ose lajmin e Allahut xh. sh. për të bërë Tobe.

Hoxha Abdulla Muça nga Tirana, imamë në fshatin Tufinë, nuk pranonte të takohej me Aishenë, se thoshte unë jamë i ditur e njoh mirë fenë dhe nuk kamë nevojë për njeri të më këshillojë. Në një rastë hoxhë Dullën sikurse e quan populli, unë shkova e takova në shtëpinë e tij në kohën e rregjimit komunist kur feja ishte e ndaluar dhe i njoftova atij lajmin e Allahut xh. sh. për tobe që i komunikonte popullit muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Ai pasi më dëgjoi, më tha kështu; Nëse Aisheja është ashtu sikurse thotë e dërguar me lajmë prej Allahut xh. sh. le të shkoi të thërrasi në tobe Enver Hoxhën dhe byronë politike dhe jo neve. Unë i thashë atij edhe ata kanë dëgjuar për këtë çështje o hoxhë. Abdulla

Muça pastaj nuk e zgjati më fjalën pasi po e pritnin në rradhë disa njerëz për tu shkruar nuska dhe më tha nuk kam kohë tani të bisedoj me ty më gjatë se po më presin njerëzit. Ndërsa në një takim që unë pata në kohën e monizmit me njeriun e urtë Hafiz Shaban Bylyku nga fshati Marikaj i Tiranës në lidhje me muxhediden Aishe dhe çështjen e tobes ai foli këto fjalë; Un nuk mund të themë as po dhe as jo se kamë frikë Zotin xh. sh. . Por dhe kundër saj nuk flas sepse Kurani ka thellësira që duhen njerëz kopetentë për ti kuptuar. Fjalët që ajo flet në popull; kushtet e Tobes janë nga Kurani. Ndërsa Hafiz Hasan Aruçi nga fshati Bilalas i Shijakut dhe hoxha Adem Lala nga fshati Rrubjekë i Shijakut, ish imam i xhamisë së fshatit Bërxullë i Tiranës, kur dëgjuan për Aishen dhe detyrën e saj, ata u shprehën; Thirrja që bën ajo për Tobe është nga Kurani. Nga puna që ajo bën në popull pa interesë, vërteton, që është grua besimtare e devotëshme, por përta i takon fjalës që thotë se jam e dërguar nga Zoti xh. sh. me këtë shërbim ne kemi frikë ta pranojmë këtë gjë se neve në shkollë na kan thënë; që nuk vin më njerëz të dërguar, nga Allahu xh. sh, pasë profetit Muhamed a. s. Ndërsa Hafiz Hasan Aruçi tha: Ajo mund të jetë prej euvlijashë=prej atyre njerëzve që janë miq të Allahut xh. sh. Hafiz Hasan Aruçi kur dëgjonte për muxhediden Aishe, gjithashtu thoshte këto fjalë për atë. Thirrja që bën Aisheja për toben është nga bazat e Kuranit. Un mendojë që ajo është njeri me keramete prej Allahut xh. sh. por jam në dyshim për sa i takon dërgimit direkt prej Allahut xh. sh. me urdhër të veçantë për këtë popull pasi ajo është grua. Neve në shkollë na kanë mësuar se nuk ka pas gra të dërguara për thirrje kurse gra me grada të larta dhe me keramete po, ka pasur para profetit Muhamed a. s. dhe pas tij. Un lajmin e tobes që komunkonte murshidja Aishe, ia tregova edhe hoxhës Hasan Qytykut nga Elbasani emrin e të cilit e përmeda më lart. Ai ishte njeri i urtë, fjalë pakët dhe lexonte shumë libra. Kishte në shtëpi një bibliotekë me libra të ndryshme Islame. Pas vitit 1991 kur u rihapën xhamijat dhe deri sa ndërroi jetë, Hasani ishte imam i xhamisë Et-hem Beu në qëndër të Tiranës. Ai pasi më dëgjoji më tha, Ato që thotë Aisheja i përmban Kurani por: A nuk paska gjetur njeri tjetër Zoti xh. sh. dhe paska dërguar Aishenë një grua për të thirrur njerzit në tobe ? Këtu në këtë vend ka shumë njerëz të ditur. Ndërsa Allahu xh.sh. në Kuran thotë; "A nuk e ke kuptuar [ti o besimtar i sinqertë]

për ata [kryelartë] që vlerësojnë veten? Jo [nuk është ashtu si mendojnë ata] Allahu vlerëson atë që do dhe nuk bën padrejtësi. "S. Nisa=Kapitulli Gratë. Ajeti 49. Me njerëzit është çudi se hall me qenë burrë e hall me qenë grua. Un i thashë që Zoti xh. sh. vepron si e di vetë dhe nuk pyet njerëzit se cilin të çojë për thirrje. Nëse do të ishte burrë lajmëtari për tobe dijetarët e fesë do ta akuzonin atë se ai e ka shpallur veten pejgamber, ndërsa qeveria do të dyshonte se po përpiqet me anë të fesë që të bëhet kryetar për të ngrit popullin në kryengritje për përmbyshjen e rregjimit politik komunist në fuqi. Në Kuranë Allahu xh. sh. thotë; "Më së miri Allahu e di ku ta vëjë dërgesën-risalen e vet. . ."S. En-nam. aj. 124. Me kaq un e mbylla bisedën me Hasan Qytykun, por ai nuk u bind që murshidja Aishe ishte me shërbim nga Allahu xh. sh. Çështjen e madhe të Tobes me kushtin e par kryesor që është largimi nga shirku; unë ia komunikova kur u rihapën xhamiat edhe ish myftiut të Elbasanit Mersin Duka. Ai nuk e kundërshtojë këtë gjë. Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë. Besimtari i vjetër Halil Çela që e ka falur gjithmonë namazin e pesë kohëve, më ka treguar se me Mersin Dukën kemi qënë sëbashku ushtarë, dhe ky ashtu si unë, asnjëherë nuk rrinte pa e larë trupin kur bëhej xhunub-kur eksitohej në gjumë. E kam pa me sytë e mi Mersinin që lahej jashtë në dimër me ujë të ftohët se në ushtri nuk i kishim kushtet e duhura. Vërtetë Pejgamberi a. s. ka thënë; Pastërtija është pjesa e besimit Islam. "Ndërsa vëllai i Mersinit, Qaniu e pranoi thirrjen që bëhej në broshurën e vogël 'Thirrje e Posaçme''të cilën e dërguam dhe në fshatin Mengël të Elbasanit dhe u tregua i gatshëm për ta shpërndarë në xhamijat e fshatrave Godolesh, Mengël, Labinot e tjera. Këtë gjë mu ma tha shpërndarësi i broshurës kushurini im Enveri i cili kishte takuar e biseduar me Qaniu. Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë. Për rëndësinë e madhe të tobës me kushtin e parë njisimin e Allahut xh. sh. në çdo gjuhë unë i fola dhe Hafiz Qamil Baçës nga fshati Gurakuq ish myftiu i Librazhdit i cili nuk mi kundërshtoi fjalët që i thash un. Ndër njerëzit tjerë me dije feje ishte edhe

Selim Stafa nga Tirana i cili i kishte krye studimet për fenë Islame në medresen e Tiranës. Kur u rihapën xhamiat ai ishte disa kohë myftiu i Tiranës. Në kohën e rregjimit komunistë ai kishte qenë folës në radio Tiranën për emisionin në gjuhën Arabe. Un ia dhash atij librin që flet për toben dhe më vonë kur u bë myfti ia

shpjegova dhe me gojë toben që komunikonte muxhedidja Aisheja. Ai pasi më dëgjoi u shpreh me mentalitetin e një shqipëtar i të zakonshëm pak me të qeshur dhe tha; Nuk ka qënë gjë Aisheja o Haxhi, se ajo një copë grua ka qënë. E si paska çuar Allahu xh.sh. si muxhedide Aishen për ti thirr popullin në Tobe tha Selimi. Por Allahu xh. sh. thotë në Kuranë : “A mos iu erdhi çudi [juve njerëzve] që ju erdhi shpallje[komunikim] nga Zoti juaj përmes një njeriu nga mesi juaj për tu tërhequr vërejtjen”? . S. Araf. aj. 69. Për thënjet e njerëzve mos përfillës që nuk i pëlqejnë ata njerëz që i zgjedhë Allahu xh. sh. na tregon Kurani i cili thotë: “E kur të shohin ty [ata] nuk të çmojnë ndryshe por vetëm me tallje e thonë: A ky është ai që Allahu e dërgojë lajmëtarë. ”S. Furkan ajeti. 41. Selimi vazhdoi duke më thënë mua se ti kotë e bënë të madhe e bënë problem këtë gjë o Haxhi Ymer Aga dhe kështu ai nuk u bindë. Ndërsa Allahu xh. sh. thotë në Kuranë: “. . . Allahu e di më mirë se cilit të ia japi mesazhin e vet. S. En-nam. aj. 124. Un për muxhediden Aishe dhe shërbimin e saj i tregova dhe një besimtari musliman të mirë e të ditur nga Sanxhaku që ndodhet në republikën e Serbisë. Ai pasi më dëgjoi me vëmendje u bindë plotësishtë duke mos pas as pak dyshim se murshidja Aishe rahmetullahi alejha ishte e ngarkuar me shërbim të posaçëm prej Allahut xh. sh. Besimtari i mirë e i ditur nga Sanxhaku e takoi muxhediden Aishe e cila në atë kohë ishte akoma gjallë por ishte e sëmurë dhe ishte në javët e fundit para se të vdiste. Megjithatë dëshira atij ju plotësua. Ai bisedoi vetë me murshiden Aishe rahmetullahi alejha dhe e pranoi që ajo ishte me shërbim të posaçëm prej Allahu xh. sh.

31-VAZHDOJMË TË TREGOJMË LAJMET DHE NJOFTIMET QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE r. a.

Muxhedidja Aishe, rahmetullahi alejha, qartësoi shumë gjëra e shumë çështje me dijen e njoftimet që merrte prej Allahut xh. sh, me inspirim, me ilham, me anë të engjëjve dhe me rrujaë=ëndërr. Përsa i përket gjynahit që bëhet me shikim Aisheja thoshte se njerëzit e dijnë që është e ndaluar me shkuar në plazh por e një llojtë me plazhin është edhe shikimi i njerëzve të tjerë lakuriq në çdo vend

me çdo formë e mjet. Ajo gjithashtu u thoshte njerëzve se duhet ti mendoni mirë fjalët që flisni. Mendohi mir kur dëgjoni e flisni. Vërtet Allahu xh. sh. thotë në Kuran; "Dënimin ju jep Allahu atyre që nuk mendohen. S. Junus. Përsa i takon foljes ajo duhet me rregull sipas sheriatit = ligjit të fesë. Allahu xh. sh. flet bukur = me rregull thoshte muxhedidja Aishe dhe do që njerëzit të flasin me rregull. dhe jo çfar fjalë tu vinjë për kollaj në gojë. Në fenë Islame veç fjalëve që janë shirk janë ndaluar me Kuranë edhe fjalët ithm = fjalët e këqija fjalët që formojnë gjynah. Për këtë gjë murshidja Aishe tha se mora këtë lajmë prej Allahut xh. sh. ; "Thuaju njerëzve mos ta përdorin shprehjen tu bëfsha kurban o Zot se Un nuk kam nevojë për asgjë, por le të thonë : O Zot ju bëfshim kurban emreve = [caktimeve ose vendimeve] të madhërisë tënde. " Me të vërtetë Kurani thotë: "Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre por te Ai arrin bindja e juaj. " S. Haxh. aj. 37. Gjithashtu Aisheja ju thoshte njerëzve mos e përdorni shprehjen të keqen tënde o Zot të marrsha të keqen o Zot se Zoti xh. sh. nuk ka të keqe. Ajo i mësonte njerëzit që të flasin bukur, drejtë dhe qartë. Ajo ju thoshte njerëzve se kur ti drejtoheni për lutje Zotit xh. sh. mos thoni o Zoti madh se kjo fjalë të lë të kuptosh, që ka dhe Zota tjerë të vegjël estagfirullah. Thoni fjalët qartë dhe bukur në gjuhën shqipe kështu; O Zot i madhrushëm xh. sh. Me të vërtetë folja i madhërushëm në gjuhën tonë, është në kuptimin që Zoti xh. sh. është i pa krahasushëm me askend tjetër në çdo aspekt ose cilësi. Gjithashtu ajo thoshte; mos i thoni njeriut Meuvlana në gjuhën Arabe që do të thotë në gjuhën shqipe i lartëmadhërushmi ose lartëmadhërija. Këtë gjë e vërteton i dërguari i Allahut xh. sh. Pejgamberi jonë a. s. me kritikën që ua ka bërë anëtarëve të delekacionit nga fisi Benu Amir, të cilin e transmeton Ebu Dudi nga Abdullah Ibni Shehir, sehabi = shoku i Pejgamberit a. s. i cili thotë kështu: Isha anëtar i një delekacioni nga fisi Benu Amir që shkua tek Pejgamberi a. s. dhe në shenjë respekti me rradhë njëri pas tjetrit, filluam ta përsëhendesim Pejgamberin a. s. me këto tituj nderimi; I pari i tha, mirëse të gjeta o lartëmadhëri = mevlana, tjetri i tha o i plotëfuqishëm i treti i tha; mirëse të gjeta o mbreti i gjithësisë. Pejgamberi a. s. u nxeq aq shumë tha Abdullah Ibni Shehiri e u skuq në fytyr që kurrë ndonjëher nuk e kishim parë atë ashtu dhe na tha: "Flisni o njerëz drejtë ata fjalë që meritojnë për njeriun dhe mos lejoni që tu komandoi

shejtani i mallkuar. Këto tituj janë vetëm për Allahun xh. sh. Un nuk jam tjetër veç se Muhamedi i biri i Abdullahit por jam resuli =i dërguari i Allahut xh. sh. Antarët e delekacionit i thanë :

“O Muhamed a. s. neve na u duk i vogël ky titull për të nderuar ty. Pejgamberi a. s. ju tha atyre: Nuk ka titull më të dashur tekë Allahu xh. sh. dhe më të pëlqyshëm tek un se titulli Resulallah=i dërguari i Allahut. ” Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha i tërhiqte vërejtje njerzvet në shum raste për fjalët që flisnin pa u menduar. të cilat fjalë janë futur në popull nga qafirat e munafikët dhe nga të pa diturit me nxitjen e djallit të mallkuar. Shum fjalë thoshte murshidja Aishe janë në kundërshtim me ligjin Islam janë haram-të ndaluara ose kufër e shirk prandaj keni kujdes kur flisni. Mendoni mirë se çka po flisni dhe mos imitoni ateistët = të pa fetë e kaurrit ose kaurët = “ kritianët ”. Pejgamberi a. s. ka thënë; “Shumicën e fajeve njerzit e bëjnë me gojën e tyre ”. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha ju thoshte gravet; Mos thoni, jaallah mor burrë, jaallah more djalë, jallah moj grua që zakonishtë këto shprehje i përdorin gratë, se me këto fjalë, pa e kuptuar bëni shirk, bëni kufër. Allahu xh. sh. është një i vetëm e nuk ka tjetër veç Tij. Përdorni shprehjen ç’është kështu more burrë e ç’është kështu more djalë e tjera. Gjithashtu shprehja që përdorin burrat zakonishtë duke i thënë njëri tjetrit; ti je ose ti paske qenë Allah Allah o filan. Estagfirullah. Të përdoret shprehja ti paske qenë i çuditshëm more filan ose Allahu na ruajt prej teje ose prej veprimt tend o filan. Ndërsa shprehjet ose fjalët në gjuhën shqipe Zoti, i Zoti, Zotnia, Zonja, Zotnusha, i del Zot, Zoti i vetes, filani e Zotnon ose ka Zotësi i bëjnë njerëzit në çdo gjuhë me qëllim të caktuar për të nderuar e madhruar njëri tjetrin pa kufij për ti dhënë madhështi vetes tyre me titullin ose emrin që thirret Krijuesi i Gjithësis=Allahu xh. sh. Më kujtohet një rast kur djali im që ishte 7 vjeç në atë kohë, po këndonte në qefin e tij këngën e shoferit, që e këndojnë turqit, jallah shofer estagfirullah dhe muxhedidja Aishe menjëher ia ndërpreu këngën djalit e i tha: Mos thuaj ashtu se shoferi nuk është Allahu, por ti thuaj hajde shofer hajde. Në atë çast un u mendova thellë për hilet që bën shejtani i mallkuar sëbashku me shokët e tij, shejtanët prej njerëzish, për ti çuar në shirk besimtarët duke jua ngatrruar atyre mendjen që ta kundërshtojnë në gjuhën e tyre fjalën e teuhidit = fjalën e njisimit=fjalën fortë La ilahe il=lallah të cilën e thonë në

gjuhën arabe por e kundërshtojnë në gjuhët tjera. Allahu xh. sh ju dhashtë hidajet, hikmet e zjuarsi besimtarëve kudo në botë. Allahu xh. sh. na ruajtë nga hilet e shejtanit. e qafirave dhe të mufikëve që duan ti çojnë besimtarët në shirk në kufër e haram.

Muxhedidja Aishe ju thoshte njerëzve keni kujdes shumë në shprehjet. Mendoni mirë fjalët para se të flisni se shumica e njerëzve nga goja e kan gjetur në dynja belanë=nga goja ju ka ardhur e keqëja dhe prej fajeve të gojës do të dënohen shumë njerëz në ahiret.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha i ndalonte njerzit nga betimi në tjetër send, veç Allahut xh. sh. por dhe këtu shumë rrallë, vetëm kurë e lyp nevoja dhe është e domosdoshme për një gjë me rëndësi. Ajo ju thoshte njerëzve gjithashtu; Kurrë mos betohi ju për prindët tuaj, për fëmijët-për kokën e djalit ose të vajzës, për xixën e zjarrit, për këtë bukë, për këtë diellë, për këtë hanë, për këtë qiellë e për këtë tokë, për këtë xhamië e për këtë teqe e për këtë kishë. Muxhedidja Aishe i kritikonte besimtarët që betoheshin në tjetër gjë veç Zotit të madhërshëm xh. sh. Ajo i kritikoi disa muslimanë nga Kruja, që betoheshin me fjalët, për atë sallsatik=Sari Salltik dhe muslimanët nga fshatrat e Beratit e Skraparit që betoheshin për malin e Tomorrit. Po kështu vepronin dhe veprojnë dhe të krishterët katolikë që betohen për kishën e Laçit dhe të krishterët ortodoks që betoheshin e betohen për shën Naumin e tjera si këto. Këto faje njerëziti i bëjnë nga injoranca e nga pa dituriija. Profeti Muhamed a. s. ka thënë ; Cili njeri betohet në ndonjë send tjetër veç Allahut xh. sh.=veç Zotit xh. sh. ai njeri vërtetë ka bërë shirk.=i ka ba shokë= ortakë Allahut=Zotit xh. sh. ” Betimi kur e kërkon nevoja e domosdoshme thoshte murshidja Aishe të jetë vetëm me fjalët; Vallahi, =për Allahun xh. sh.=për Zotin xh. sh. Muxhedidja Aishe më thoshte se nuk është mirë që dhoma ku flen ose rrin njeriu të jetë e mbyllur hermetikisht, pa asnjë vrimë të vogël për ajrim. Kjo gjë kështu nuk është e mirë si nga ana shëndetsore ashtu dhe nga ana shpirtërore. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha më tregonte se unë nga merakun se mos ftohesh dhe nuk kishim as njeri që të më shërbente nëse sëmuresha, e mbyllja në dimër çdo plasaritje të derës, deri dhe vrimën e çelsit. Vetëm pak ajër futej ndoshta nga tavani prej dërrase i shtëpisë. Porsa rashë në gjumë dëgjova një herë që melekët e shërbimit folën me zëra të hollë këto fjalë me njëri tjetrin: “Duam të futemi brënda por nuk po kemi ku të futemi. Nga

do të futemi? Ja, ja e gjetëm një të çarë me gjithëse qenka shumë e hollë por po e provojmë njëherë. "Unë me njëherë u ngrita dhe e hoqa leckën-pengesën poshtë derës tha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Sikur se e dim nga Kurani e hadithet melekët-engjëjt futen nëpër vrima apo të çara sado të vogla të jenë por jo në një dhomë që është e mbyllur plotësisht e hermatikishtë. Gjithmonë murshidja Aishe muslimanët e muslimanet që ta ruajshin gojën nga shirku nga kufri e nga fjalët ithm=nga fjalët e këqia në kundërshtim me rregullat fetare Islame. Më kujtohet një rastë kur muxhedidja Aishe i tërhoqi vërejtje një gruaje tirance e cila e mbulonte kokën me nap të bardhë që në Tiran njerzit i thonë marhaman kësaj mbuluese.

32-NJOFTIMET QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MURSHIDJA AISHE PËR RENDESIN E NAMAZIT.

Për çështjen e namazit muxhedidja Aishe thoshte: Isha duke bërë davet=thirrje për tobe në një shtëpi të një besimtari në Tiranë dhe aty u këndua dhe Mevludi Sherif. Unë thoshte Aisheja u këtheva në shtëpi natën e shoqëruar. Në atë shtëpi ku isha dhe gjatë rrugës un vazhdoja duke kënduar Kuranë me zë të ulur. Arrita në shtëpi vonë. Atë natë ishte shumë ftohët. Isha shumë e lodhur dhe ujë të ngrohët për abdes nuk kishim. Mendova që për këtë rastë me e lënë namazin e jaciesë pa e falur, mendova që isha duke punuar për në rrugën e Allahut xh. sh. dhe rashë në gjumë. Allahu xh. sh. që din çdo gjë që mendojnë njerëzit më shfaqti mua në rruja-në ëndërr këtë pjesë filmike mes gjumit dhe zgjimit kështu; "Ishte një mal i madhë i bërë me copa letrash të holla dhe me shumë ngjyra, dhe një zë më foli këto fjalë; A e sheh këtë mal të madh me copa letrash dhe me kaq shumë ngjyra të ndryshme? Sa ky mal i madh me kaq shumë latra dhe me kaq shumë lloje ngjyrash ti bëjshë sevapet=të mirat, nuk hyn në xhenet nëse nuk e falë namazin që është farz = i detyruar. Ti [Aishe] mendove; se me që isha duke bërë devet=thirrje për tobe, dhe mevludin e dëgjova që e kënduan në xhami, mendove me veten tënde se më fal Allahu xh. sh. inshaallah për këtë rast që po e lë pa e falur namazin e jaciesë, por këndimi ose dëgjimi i mevludit është sevab i madhë=mirësi e madhe, por nuk e zëvendëson

asgjë tjetër namazin; Nëse edhe peygamberët ta kishin lënë namazin nuk do të hynin në xhenet por ata e bënë. " Në Kuran Allahu xh. sh. thotë; "...Faleni namazin në mynyrë të rregullt se namazi është detyrim i caktuar [urdhër i prer=detyr e domosdoshme] për besimtarët. "S. Nisa. aj. 103. Me një herë tha Aisheja u ngrita nga shtresat dhe e fala namazin e jacisë. Ajo iu thoshte njerëzve që sikur sa malet të jenë sevapet e njeriut, ai nuk hyn në xhenet nëse nuk e ka falur namazin rregullishtë. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran thotë: Ve ma halaktul xhine vel inse il la lijaëbudun"Nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit për tjetër gjë veç se të më njohin= të më falen mua. "Për vërtetësinë e ëndrrave të njerëzve të dërguar nga Allahu xh. sh. profetëve, euvlijave dhe të besimtarëve të devotshëm na tregon Kurani dhe Peygamberi me hadith=fjalët e tij. Në Kuranë tregohet njoftimi ose informimi që Allahu xh. sh. i dha Peygamberit a. s. me anë të ëndrrës kështu; "Dhe kur Allahu ti tregoi ty në ëndërr ata [armiqtë] të pakët në numër. "S Enfalë A 43. Peygamberi a. s. ka thënë; " Ëndrrat e vërteta të besimtarëve të devotshëm janë një pjesë nga profetësia. Për namazin e sabahut=agimit murshidja Aishe tha se mora këtë lajm prej Allahut të madhërshëm duke qenë zgjuar kështu : "Ata njerëz që nuk e falin namazin e sabahit në kohën e vet vetëm se mallkimin ju kam lënë mangut atyre. "Nga ky njoftim prej Allahut xh. sh. që na tregon muxhedidja Aishe kuptohet qartë se të gjitha të këqiat i kanë mbi kurriz ata njerëz që nuk e falin namazin e sabahut në kohën e vet. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Lutja [namazi] i sabahit është i përcjellë [i vrojtuar=i shikuar mir]". S. Isra. ajeti.78. Gjithashtu për namazin e sabahit murshidja Aishe rahmetullahi alejha tregon se ka marrë këtë diktim prej Allahut xh. sh. Ajo tregoi kështu; Isha zgjuar për të falur namazin e sabahit. Koha e namazit sapo kishte hyrë. Pa pritmas dëgjova këto fjalë nga ana e Allahut xh. sh, kështu; Ngrehu dhe fale tani namazin, se tani po e fal namazin e sabas-mëngjesit Imam Aliu me haz. Fatimenë. " r. t. a. Unë thoshte muxhedidja Aishe thashë me zë: Kush më foli kështu ?. Un mora përgjigjen: Jam unë Xhibrili. Për ardhjen e Xhibrilit dhe foljen e tij edhe grave, na e tregon Kurani ku Allahu thotë: "Ne ia dërguam asaj [Merjemes] Xhibrilin, e ai iu paraqit asajë njeri në tërësi. " S. Merjem. aj. 18. Ndërsa Xhibrili ka thënë; Ne [tha Xhibrili] nuk zbresim, vetëm se me urdhërin e Zotit tëndë. Vetëm Atij i takon e tërë çështja e

tashme, e ardhme dhe mes tyre, e Zoti ytë nuk është që harron. S. Merjem. aj. 64. Nga ky lajmë që mora prej Allahut xh. sh. tha muxhedidja Aishe, kuptova me ilham se është e pëlqyeshme që namazin e sabahit ta falësh sapo të fillojnë të duken prej ndriçimit majat e maleve. Në këto çaste është e pëlqyeshme falja e namazit të sabahit. Kështu ka vepruar hazreti Ademi a. s. kur e zbriti Allahu xh. sh. në tokë. Atë e zbriti Allahu xh. sh. natën dhe u tmerrua nga errësira duke menduar gjithashtu se qysh do ta kalonte jetën në errësi të gjithmon. Ai posa shikoi majat maleve se po zbardhonte drita=po agonte u gëzua shumë dhe menjëher iu përul Allahut xh. sh. me kokën në sexhde duke falur dy rekat namaz. Gjithashtu Allahu xh. sh. më dha të kuptojë thoshte muxhedidja Aishe se dhe në xhenet njerëzit do të falin namaz por pa detyrim. Ata do të falen vetëm për tu ngritur në gradadat më të larta të xhenetit. E vërtetë prej Allahut është fjala që thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha se Allahu xh. sh. për ngritjen në gradat ose në vëndet më të larta=më të bukra të xhenetit, në Kuran ka thënë kështu; “E ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut, atyre kurrësesi [Allahu] nuk jua humbë veprat [por jua shton]. Ata do ti udhëzojë dhe do ta përmirësojë gjëndjen e tyre, dhe do ti fusi në xhenetin të cilin jua ka bër të njohur atyre.” S. Muhamed. aj. 4, 5, 6. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se në lutjen që çdo besimtar i bën Allahut të madhrueshëm duhet ti përfshijë të gjithë besimtarët në atë lutje, e jo vetëm fëmijët e të afërmit e tij. Për këtë gjë Aisheja tregoi kështu; Një ditë një besimtar që falte 5 kohët namazë më tha; pasi unë o Aishe falë namazin sabahun, un bëj shumë zikër dhe pastaj i lutem shumë Allahut xh. sh. Un thoshte Aisheja i thashë atijë, Zoti ta pranoftë lutjen tregonte murshidja Aishe. Kur un tha ajo erdha në shtëpi mora këtë lajmë nga Allahu xh. sh. : “ E çfar po të thoshte ai i cili lutet vetëm për vehten e tij, bërr,bërr, bërr, nuk e dua atë lutje ashtu. ” Allahu xh. sh. dëshiron që muslimani ti lutet Atij dhe për të mirën e besimtarëve tjerë dhe për gjithë njerëzit që të vinë në besim në rrugën e drejtë. Kurani tregon për Pejgamberin a. s. që është lutur për shokët e tij e për gjithë ymetin. Gjithashtu Kurani tregon për profetin Jakub a. s. i cili tha: “Më vonë do ti kërkoj Zotit tim faljen tuaj [falje për ju] tha ai...”. S. Jusuf. aj. 98. Gjithënjë për sa i takon çështjes së

namazit muxhedidja Aishe gjithashtu thoshte që ka rëndësi shumë dhe namazi i ikndisë = mbas mesditës. Un e kam pa me syt e mi në qytet Aishen duke nxituar në rrugë shumë shpejtë dhe kur un e pyeta se çka kishte ? . Ajo më tha : Nuk kam asgjë por po më ikën namazi i ikindis. Allahu xh. sh. për namazin e ikindis në Kuranë thotë; "Kujdesuni=vazhdoni rregullishtë namazet, e edhe atë [veçanërishtë] namazin e mesëm..."S. Bekare aj. 238. Shumica e dijetarvet kan thënë se nemazi i mesëm është namazi i ikindis. Pejgamberi a. s. ka folur shumë për rëndësinë e namazit të ikindisë. "Në lidhje me namazin tehexhud=namazin e natës murshidja Aishe rahmetullahi alejha na tregoi: Ishte muaji i Ramazanit. Unë fala namazin e jacisë dhe të taravivet pak me vonesë pasi isha në udhëtim thoshte ajo. Porsa u futa në shtresa të flejë gjumë; menjëherë mora këtë lajmë nga Zoti xh. sh. nëpërmjet engjëllit duke qenë zgjuar; "Përse nuk e fale dhe tehexhud namazin? , pasi e kishe abdesin. "Nga këto fjalë kuptojmë që nëse është vonë rrethë orës 12 e natës është i vlefshëm namazi i natës-tehexhudi edhe nëse je pa fjetur vetë për arsye se në atë kohë të gjithë njerëzit janë më gjumë.

Murshidja Aishe rahmetullahi alejha tha: Një ditë në kohën e sabahit Allahu xh. sh. më shfaqti në ëndërr një hoxhë të ditur që unë e njihja i cili posa mbaroi së faluri namazin, kur pëfundoi lutjen, pasi i fryni tespijvet i hodhi para vetes në sexhaden që falej dhe shikonte se në çfarë pozicioni ranë ata. Në ato momente unë thoshte Aisheja dëgjova këto fjalë: "Ja çfarë bën ai [hoxha], kërkon të dij për të ardhmen me anë të tespijvet. Kjo që bën ai është fall. Thuaj atij që mos të veprojë më ashtu. " Muxhedidja Aishe që Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë kur kishte qëllim të bënte ndonjë veprim ose punë të lejshme por nuk e kishte të qartë nëse ishte e dobishme për të ajo gjë apo jo, murshidja Aishe bënte namaz istihare për ta marrë njoftim prej Allahut xh. sh. indirektë me anë të ëndrrës nëse ishte e dobishme apo jo. Ajo më mësonte mu shkrusin e këtij libri se pas namazit të istihares, të ia parashtrosh lutjen Allahut xh. sh. qartë, shkurt dhe bukur e pastaj pasi të këndosh tre herë suren ihlasi sherif shtrihu dhe flej gjumë. Nëse në gjumë sheh pamje ose sende të ndryshme të zeza, largohu nga ai vendim ose punë që ke ndërmend të bësh. Nëse sheh sende të ndryshme ose pamje të ndryshme jeshile është e mirë për ty ajo punë ose ai veprim që ke ndërmendë të bësh e nëse sheh bardhësi me këtë meleku i ëndrrës

të sinjalizoi që është akoma më i mirë veprimi që ke ndërmend të bësh. Nëse sheh sende të ndryshme me ngjyr të zezë largohu nga ai mendim ose veprim që ke ndërmend të bësh. Pejgamberi a. s. ka thënë; Nuk është penduar prapa për ndonjë punë që ka bërë, ai njeri që ka bërë më parë istihare= [namaz istihare]. "Muxhedidja Aishe gjithmonë për një gjë që nuk e dinte tamam si duhej vepruar thoshte : "Allahu xh. sh. na mësoftë si të veprojmë". E përsa e kishim fjalën më para tek falli, gjithashtu dhe hoxha i njohur për librat e tij fetare të shkruara në gjuhën shqipe hafiz Abdullah Zemlaku nga Korça që ishte njeri i devotshëm dhe ka punuar shumë për fenë Islame shkruan në librin Dija e ëndrrave disa thënje në adresë të fatit dhe thotë se kjo quhet Fatnameja e imam Xhafer Sadikut. Hafiz Abdul-lahi rahmet pastë thotë kështu: Përgadisni një katërkëndësh të vogël prej druri sa një kokërr thane dhe në katër qoshet e saja shkruani gërmat e ebxhedit kështu; A. B. XH. D. Pastaj thoshte ai këndon ajeti Kursinë një herë, seren Ihlas tre herë, suren Fatiha një herë dhe këtë dua.... dhe pas kësaj këndon salavati sherifin tre herë. Mbasi mbaron së lexuari këta atëherë i adresohet fatit duke hedhur zarin prej druri. Sipas gërmës që bie poshtë shih në fletoren thënjeve për fatin, ashtu të del dhe fati thotë Hafizi që Allahu xh. sh. e faltë se ka gabuar që ka shkruar këtë gjë kështu, duke menduar se këto thënje janë vërtetë të imam Xhaferr Sadikut rahmetullahi alejh. Në faktë ky është fall, dhe falli është rreptësishtë i ndaluar nga feja jonë Islami. Prandaj Allahu xh. sh. për ta ruajtë fenë e Tij të pastër, i dërgoi ymetit pas Pejgamberit a. s. në çdo njëqindë vjet një muxhedidë me dije, njoftime e sqarime direkt prej Tij për tua bërë të qartë besimtarëve se cila është e vërteta që duhet ndjekur dhe cilat janë gjëra të këqia shpikura nga qafirat e munafikët-dy fytyrshit për tua humbur besimtarëve rrugën e drejtë. Kurani na e bën të qartë ku thotë; Allahu nuk është [i tillë] që ti lë besimtarët ashtu sikur janë, pa dalluar të keqin nga i miri. Allahu nuk ju zbulon juve [të gjithëve sa jeni] të fshehtat, por Allahu është Ai, që nga të dërguarit e vet zgjedh atë që do[e ia zbulon ndonjë të fshehtë]. Prandaj besoni Allahut dhe të dëguarve të Tij, e në se i besofshi dhe nëse ruheni, atëherë ju keni një shpërblim të madh. "S. Ali Imran. aj. 179. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ishte muxhedidja e fundit për thirrjen e njerëzve në tobe në pendesë =për rikthim në rrugën e Allahut xh. sh. me kushtet që vetë Allahu xh. sh. i përcaktoi për

ymetin e Muhamedid a. s. për besimtarët e kohës së fundit të dynjasë. Ajo dha sqarime të ndryshme dhe për disa çështje fetare që në Kuran dhe hadithë janë folur në mynyrë metaforike. Këto çështje janë kuptuar gabim në përgjithësi nga njerëzit e thjeshtë por dhe shumë dijetarë të fesë kanë pas mendime të ndryshme për ato. Me dijen që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha dha sqarime të sakta për shumë çështje të fesë që dijetarët kishin dhënë mendime të ndryshme. Ajo i sqaroi njerëzit për dexhalin, për xhuxhë maxhuxhët, për zbritjen e Isait a. s. në tokë e tjera e tjera për të cilat dijetarët Islam kanë pasur mendime të ndryshme. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha me lajmin që mori prej Allahut xh. sh. paralajmëroi gjithashtu dhe për kohën se kur do të bëhet kijameti që për të cilën gjë Allahu në Kuran thotë se do të ia tregoj këtë gjë ndonjë të dërguari. Më hollësisht për këto çështje do tu tregojmë më poshtë në vazhdim.

33-MUXHEDIDJA AISHE MORI LAJMI PREJ ALLAHUT XH. SH. SE DEXHALI KA DALË. KUSH ËSHTË DEXHALI ?

Sikurse e kam thënë fjala dexhal e cila është arabisht në gjuhën shqipe do të thotë mashtrus i madhë, i rafinuar për mashtrime, për djallëzira. Nga njoftimi që mori prej Allahut xh.sh.muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha iu dha këtë sqarim njerëzvet për dexhalin kështu: "Dexhal është ai njeri i cili nuk beson në ekzistencën e Allahut xh. sh. dhe në jetën tjetër pas vdekjes [ahiretin] dhe nuk ka asnjë lloj cilsije morale të mir por një qindë për përqidë i ka veset dhe veprimet të këqia ". Këta njerëz pra janë dexhala= mashtrusa të mëdhej. Janë ateistë mashtrusa të rafinuar për djallëzira. Munafikët janë shërbëtorët e tyre. Ateistët e rafinuar janë shejtanë prej njerzish. Këto janë më të rrezikshëm për mashtrime e poshtërsira se shejtanët e mallkuar]. Pra vëllezër besimtarë duhet ta dini se dexhali nuk është një njeri i vetëm por janë shumë. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Ruanja veten dhe familjen tuaj prej sherrit të dexhalit ". Gjithashtu Pejgamberi a. s. ka thënë: "Nuk do të mbesi vend në tokë që nuk do ta shkeli [që nuk do ta nënshtroi e sundoi dexhali [njerëzit dexhala]. Ai [ose ata] kanë për të bërë përçarje e lufta të mëdhaja në botë." Vërtet ashtu kanë bërë duke i përça popujt në grupe ose parti të ndryshme. Edhe nga fjala e Pejgamberit a. s. kuptohet se nuk është vetëm një dexhal se nuk ka mundsi një dexhal ta sundojë gjithë botën. Ibni Abazi [djali i xhaxhait të Pejgamberit a. s.] ka thënë; Unë nuk e kam dëgjuar nga Pejgamberi a. s. që ai të ketë thënë se

dexhali e ka të shkruar mes dy syvet fjalën kafir [qafir] por Pejgamberi a.s.ka thënë: "Ibrahimi ka qënë kështu...kurse Musai ka qenë ashtu....". Për dexhalin në Kuran nuk flitet direkt. Për çështjen e dexhalit shum dijetarë të fesë kan dhënë mendime të ndryshme e të gabuara. Titulli arabisht dexhal vjen nga folja dexhele që do të thotë mashtron. Kjo fjalë vjen në të folur në numër njëjës sikurse emri shejtan lanetullah. Sikurse shejtanë ka shumë dhe dexhala ka shumë. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Në ymetin tim do të ketë 30 dexhala të mëdhej [Teoricjenë të mëdhej]. "Trans Muslimi. Nga këto pa dyshim kanë qënë; Musdeku në ish Perësi e që sot quhet Iran, Marksi, Darvini, Niçe, Lenini, Frojdi e tjerë. Kështu që dhe me hadithe-fjalët e Pejgamberit a. s. vërtetohet se ajo që tha muxhedidja Aishe për dexhalin është fjalë e vërtetë sqarim prej Allahut xh. sh. për të gjithë njerëzit kudo në botë. Fjalët që fliten ndryshe për dexhalin, një pjesë janë fjalë të shpikura me qëllim nga ateistat për të mbuluar veten e tyre, dhe një pjesë janë të kuptuara gabim nga dijetarët e fesë të cilët i kanë nxjerrë prej haditheve të Pejgamberit a.s. i cili në shum raste ka folur me metafora=me shembuj krahasusë = me nënkuptime.

Në një hadith thuhet se dexhali do të udhëtoi me gomarë në tokë detë dhe ajër dhe gomari i tij do të ushqehet me zjarr. Ai dhe njerëzit që e shoqërojnë do të qëndrojnë hipur në barkun e gomarit e jo sipër tij. Nga këto fjalë kuptojmë që gomari i dexhalit është çdo llojë mjeti transporti që ecën me naftën që digjet. Pejgamberi a. s. thotë. . "Dexhali do ta ndajë për gjysëm njeriun e gjallë dhe pastaj duke qënë i vdekur do ta ringjalli". Ky hadithë është me kuptim= është në mynyrë metaforike. Është fjala për operacionet që po i bëhen sot njeriut në kokë e në zemër. Sot po ia heqin njeriut zemrën dhe po ia vënë përsëri. Kjo është si një llojë vdekje për pacientin i cili rikthehet normal në jetë. Sa për ringjalljen e vërtetë kjo është e posatëshme vetëm për Allahun xh. sh. Dexhalët nga këto gjëra të çuditshme që po bëjnë sot me mëndjen që iu ka dhënë Zoti xh. sh, e kanë mohuar Zotin xh. sh, dhe po e quajnë veten Zotër në çdo gjuhë të botës, ashtu sikurse po shohim dhe po i mësojnë njerëzit që tu thërrasin atyre Zoti, estagfirullah, siç po i dëgjojmë. Dexhalat me teorin e tyre të mashtrimit të madh e të stërholluar dexhalizmin ose shqip po i them mashtruizmin, me propogandën e tyre të shumllojshme kundër moralit me ligjet e tyre në kundërshtim me fenë, sot po i shkatrojnë

njerzit në gjithë botën. Ata po i këthejnë njerzit nga natyra njerzore në atë kafshore e më keq se kafshët e egra e se kafshët e mallkuara, sidomos brezin e ri të cilin e kan zhveshur nga morali krejtësisht. Bota tani është në krizë të madhe morale. Ajo sot është si në kohën para ardhjes së profetit Muhamed a. s. që në Kuran thuhet; 'Në tokë e në detë [në kontinente e ishuj] ishte prishur morali [i njerëzvet] '' . Dexhalat nga triumfi i madh që kanë arritur nga ana ekonomike dhe ushtarake në gjithë botën po ju thonë njerëzve në çdo vend të botës, që të zbatoni ligjet tona e jo ligjet e fesë. Ata sot po e mësojnë popullin në çdo vend që në çdo gjuhë tu thonë atyre : Zoti, Dio, Gospod, Bog,, Theos, Gad, Mullah, Muvlana e tjera. Allahu xh. sh. i ruajtë besimtarët nga kjo intrigë e dexhalëve që e kan mohuar Allahun xh. sh. dhe ahiretin=jetën tjetër pas vdekjes. Sot më shum se kurrë ndonjëher dexhalat e çdo populli, janë të bashkuar me njëri tjetrin në gjithë botën në një mendim të përbashkët; Të luftojnë fenë dhe fetarët për ti prishur moralin njerëzvet kudo në botë e duke i i mashtruar , ti nënshtrajnë e ti sundojn kollaj. Dexhalat e fuqishëm po bëjnë përpjekje natë e ditë me anë të mjeteve të propogandës, televizionit, radios, gazetave, revistave, librave, internetit dhe shfaqjeve teatrale e humoristike që tu prishin moralin e popujve në çdo vend të botës. Ata sot në televizor po shfaqin vetëm imoralitet, rrena, krime e pisllice për ta shkatërruar rininë nga të gjitha pikpamjet.

Ata nëpërmjet televizionit duke dhënë lloj lloj lojrash të kota po i marrin njerëzvet në përgjithësi gjënë më me vlerë, po i marrin kohën e cila është flori thotë një fjalë e urtë popullore. Allahu xh. sh. në Kuran për kohën është betuar duke thënë: 'Vel asri...'=Betohem për kohën. ''S. Asër. =Kapitulli Koha. Dexhalat po e shkatërrojnë celulën e shoqërisë familjen duke ja prishur mendjen të rijëve me anë të mjeteve të propogandës anti fetare. Ata me anë të propogandës në medja me lloj lloj gënjeshtresh e poshtërsirash përpiqen për ta larguar rininë nga të menduarit mir e drejtë. Për ta larguar ata nga diturija e fesë e nga problemet e mrehta shoqërore e sociale që ata mos të mendojnë për të ardhmen e tyre. Kështu duke e degjeneruar rininë, dexhalat me fëmijët e tyre të sigurojnë sundimin e tyre të përhershëm. Dexhalët në të gjithë botën po përdorin taktikën e Firaunit [Faronit] e cila ishte: ''Poshtro, përçaj dhe sundo''. Allahu xh. sh. në Kuran për atë thotë: ''Ai [Faraoni] e ndau popullin në grupe dhe njërin grup e

shtyp...". Të shtypurit sot në gjithë botën janë besimtarët e Zotit xh.sh. Por Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ne dëshirojmë ti ndihmojmë më ata që u shtypën në faqe të tokës".

Është kuptimi i fjalës se nëse njerëzit pendohen për veprat e tyre të liga e këthehen tek ligjet e Allahut xh. sh. Ai atëher bën që të fitojnë të shtypurit. Siç e shpjegova më lart, Pejgamberi a.s. ka thënë se dexhali nuk është vetëm një njeri i vetëm, siç thonë disa njerëz. Ata thonë se ai është qorr me një sy. Disa të tjerë thonë se dexhali me një sy në ballë do të vië hipur në gomar e do të shetisi botën. Këto fjalë që folin këta njerëz janë përralla çifutësh. Allahu xh. sh. jua kthjelloftë mendjen besimtarvet. Gjithashtu dhe logjika nuk ta pranon se vetëm një njeri do të shëtisi gjithë vendet e botës për të provokuar njerzit për tu prishur imanin=besimin. Nuk ka mundësi, është e pa mundur kjo gjë që ta bëjë vetëm një dexhal por janë me mijëra e miljona dexhala. Sot këta e kan fuqin në çdo vend të botës dhe po i mashtrojnë e po i sundojnë njerzit kudo. Ndërsa ai që e bën çdo gjë kur të doi me fjalën "bëhu" është vetëm Allahu xh. sh. e askush tjetër. Pejgamberit a. s. ka thënë: "Këndoni suren Kehf që tu ruaj Allahu xh. sh. nga sherri i dexhalit". Dhe pikërisht Surja Kehf do do të thotë: Kapitulli Vendet. Elhamdulil i qoftë Allahut xh. sh. i cili nëpërmjet murshides Aishe na e sqaroi qartë se kush është dexhali.

34-MUXHEDIDJA AISHE MORI NJOFTIM PREJ ALLAHUT XH. SH. QË NJERËZIT TA KËNDOJNË MEVLUDIN-LINDJEN E PEJGAMBERIT=MUHAMEDIT A. S.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte kam marrë njoftim prej Allahut xh. sh. kështu: "Allahu xh. sh. gëzohet kur njerëzit mblihdhen sëbashku të gëzuar në festën mevludit për ta nderuar e lavdruar më të dashurin e Tij Muhamedin a. s". Pra duke kënduar e dëgjuar mevludin lindjen dhe jetën e tij të pastër". Muxhedidja Aishe tha se në lidhje me rregullat që duhet të zbatojmë gjatë këndimit të Mevludit un mora këtë vërejtje prej Allahut xh. sh. kështu: "Mos e përqëndro vëmendjen tek zëri e melodija gjatë këndimit të mevludit por kujdesohu mirë në shkoqitjen e fjalëve dhe mendohu se çfar thuhet aty. "Duke u nisur nga kjo këshillë që ka marrë prej Allahut xh. sh, muxhedidja Aishe, edhe unë shkruasi

i këtij libri Haxhi Ymer Aga, e bëra më të qartë për lexusat dhe dëgjusat, mevludin e Hafiz Ali Ulqinakut rahmetullahi alejh. E pastrova atë nga fjalët e shumta turqishtë dhe arabishtë, duke përdorur në vend të tyre fjalë shqipe, por duke i qëndruar besnik origjinalit të Hafiz Ali Ulqinakut. Shkrova në libër edhe argumentet për Mevludin se përse duhet ta këndojmë atë. Gjithashtu e pastrova dhe nga disa fjalë shqipe që kanë qenë folur në atë kohë në vitin 1879 të cilat në gjuhën shqipe ishin shirkë. Lejen për këtë gjë e mora nga vetë Hafiz Ali Ulqinaku i cili në parathënjen e Mevludit të shkruar prej ti në atë kohë me alfabetin turk thotë; Kushdo që ta shikoi në këtë libër ndonjë hata [gabim të madh] le ta ndreqi atij njeriu i bëj rixha [i themi]. Titullin librit un ia vura kështu; Hafiz Ali Ulqinaku.

35-ARGUMENTAT E DIJETARËVE TË PARË ISLAM PËR FESTIMIN E MEVLUDIT-DITËLINDJES SË PROFETIT MUHAMED A. S.

Dijetari mirënjohur Ebu Bekër Sujuti në veprën e tij El Havi lil Fetava në lidhje me mevludin thotë; Veprimet për mevludin siç është; mbledhja e njerëzve, leximi i pjesëve të Kuranit i salevateve përshëndetjeve, tregimi i ngjarjeve dhe i ndodhive para, gjatë dhe pas lindjes së Pejgamberit a. s, të mbështetura në fakte, dhe shtrurja e ndonjë gostije për besimtarët, janë padyshim gjëra të mira. Ai që i bën shpërblehet me sevabe-mirësina nga Allahu xh. sh. se i bëhet respekt autoritetit të Pejgamberit a. s, dhe shprehet gëzim e hare për lindjen e tij. Ky është mendimi e fetvaja e Sujutiut. Dijetari i mirënjohur bashkohorë Muhamed Myteveli Sharavi, në librin e tij Maidetul Fikril Islamiye faqe 295, thotë; Kur gjithë njerëzit në atë kohë janë gëzuar me ardhjen e Pejgamberit Muhamed a. s, në këtë botë, janë gëzuar dhe gjithë krijesat tjera, engjëjt, xhinët, kafshët shpendët, bimët bota inorganike, e përse vallë mos të gëzohemi ne sot dhe mos ta festojmë ditëlindjen e tij? Në sahihul Buhari përmendet se Pejgamberi a. s. ka thënë se; “Cdo ditë e hënë Ebu Lehebit i ndërpritet dënimi në zjarrin e xhehenemit sepse ai u gëzua kur mori lajmin për lindjen time nga shërbëtorja e quajtur Thuvejbe, dhe ai e shpërbleu atë për lajmin e gëzushëm që ajo i dha. ” Dijetari Ibni Xheriri thotë: Meqënë se një qafir i betuar kundër Pejgamberit

a. s, si Ebu Lehebi përfiton mbrenda në xhehenem vetëmse u gëzua kur lindi Pejgamberi a. s. mendoni tani se çfar favorit, se çfarë të mirash do të ketë një besimtarë që gëzohet për ditëlindjen e hazreti Muhamedit a. s. Imam Tirmidhiu tregon këtë hadithë se Pejgamberi ka thënë; Kush gëzohet për mua=për limdjen time edhe Allahu xh. sh. është i kënaqur prej atij njeriu. "Dijetari Imami Shafiu ka thënë; Çdo veprim që nuk e kundërshton Kuranin e synetin është i mirë është i lejuar. Në mevlud nuk ka kundërthënje, nëse fjalët që thuhet janë të bazuara në Kuran e hadith.

Disa dijetarë Islam mendojnë se festimi dhe gëzimi për ditë lindjen e Pejgamberit a. s. është i qartësuar dhe nga ky ajet i Kuranit: "Thuaj vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le ti gëzohen [besimtarët]..." S. Junus. aj. 58. Sipas komentatorëve të Kuranit mirësia më e madhe është dërgimi i Pejgamberit a. s. si mëshirë për çdo gjë. Allahu xh. sh. në Kuranë ka thënë; "Beto hem për jetën tënde o Muhamed.] S. Hixher aj. 72. Dijetari i njohur Islam Ibni Tejmije në në librin e tij Iktidau us Siratul Mustekijm Muhalefetu As-habil Xhehim thotë; "Të respektuarit e Pejgamberit a. s. që disa nga njerëzit e bëjnë, është vepër e mirë që do të shpërblehet për shkak të respektimit që i bëhet atij. Ibni Tejmija thotë se jo vetëm që lejohet të festohet festa e Mevludit por thotë që ata që e festojn këtë ditë për dashurin që kanë ndaj Pejgamberit a. s. do të shpërblehen nga Allahu xh. sh. për shkak e nderimit që i bëjnë atij. Nëse e lexoni librin e Ibni Tejmijes do të shikoni në të se ai ka shprehur mendimin e tij se festimi i ditë lindjes së Muhamedit a. s. është vepër e lejuar e pëlqyer dhe jo e ndaluar siç thonë disa injoranta e mendje shkurtër të vetë quajtur 'selefi' me nxitjen që ju bëjnë qafirat e munafikët kudo në botë me qëllim për të ulur poshtë autoritetin e Muhamedit a. s. duke zbehur dashurinë që kanë besimtarët për të. Kur e kanë pyetur Ibni Tejmijen për ata njerëz që mblidhen në një vëndë së bashku për të lexuar e dëgjuar Kuran e për të bërë zikër, vetëm për të arritur kënaqësinë e Allahut xh. sh. ai ka thënë; Elhamdulillah grumbullimi i njerëzve për të dëgjuar Kuran, për të bërë zikër, për të lavdruar e përshëndetur Pejgamberin a. s. dhe për të iu lutur Allahut xh. sh. nuk ka dyshim që janë vepra të mira e të urdhëruara në Kuran. Atë herë nuk ka dyshim se me kënduar Kuran dhe me lavdruar dhe me përshëndetur me salevat Pejgamberin a. s. është vepër e pëlqyeshme, vepër shumë e mirë

por lavdrimi të jetë brënda masës ose kufirit që e lejon e përcakton Kurani. Ndërsa Imam Sehaviu ka thënë: Edhe nëse në bërjen e Mevludit nuk do të kishte asnjë të mir por vetëm prej asaj që shejtanët, qafirat dhe mynafikët hidhërohen për nderimin që i bëhet Muhamedit a. s. e ndërsa besimtarët gëzohen, vetëm kjo gjë do të mjaftonte për festimin e Mevludit fisnik = ditëlindjes së Profetit tonë Muhamedit a. s. Dijetari Ebu Shame mësuesi i Imami Neveviut ka thënë; Më e mira shpikje që është paraqitur sot në kohën tonë është ajo që veprohet çdo vit për festimin e ditëlindjes së Pejgamberit tonë a. s, duke shprehur gëzim e hare për lindjen e tij dhe duke dhënë sadaka e hedije-lëmoshë e dhurata me rastin e kësaj dite të madhe. Të tilla shpikjesh të mira pas Pejgamberit a. s. kemi bërjen e minareve të xhamiave, mbledhjen dhe regjistrimin e haditheve të Pejgamberit a. s. vënjen e çallmës në kokë nga dijetarët e fesë e tjera. Ibni Haxheri thotë se Mevludi ka bazë në synet se Pejgamberi a. s. kur erdhi në Medine i gjeti Jahuditë- çifutët e asaj kohe që agjëronin ditën e ashures dhe kurë i pyeti se përse agjëroni, ata i than; Është dita që Zoti xh. sh, fundosi në detë Faronin dhe shpëtoi Musain a. s. Ne u tha Pejgamberi a. s, atyre jemi më të merituar se ju që ta agjërojmë. Ne e besojmë atë për pejgamber. "Kjo transmetohet në Buhari dhe Muslim. Pejgamberi a. s. agjërojë në atë ditë, si falenderim Allahut xh. sh. që e shpëtoi hazreti Musain a. s. Atëherë këtu kemi të bëjmë me kijas-krahasim se qëllimi është i njëjtë. Kështu pra duhet dhe neve ta falenderojmë Allahun xh. sh. që me anë të hazreti Muhamedit a. s. e shpëtoi njerëzimin nga injoranca dhe armiqësija. A ka mirësi më të mirë e më të madhe se lindja e këtij Pejgamberi që është mëshirë jo vetëm për muslimanët por për të gjithë njerëzit dhe për gjithë krijesat e gjalla se ai tregoi bazat themelore për mbrojtjen e të drejtave të njerëzve dhe të kafshëve. Gjithashtu Pejgamberi a. s. ka agjëruar në ditën që ka lindur vetë që të nesërmen pastaj ishte dita e mevludit-lindjes së tij. Pejgamberi a. s, e ka agjëruar në ditën kur ka lindur vetë, si shenjë falenderimi Allahut xh. sh, që e sollti në këtë jetë. Pejgamberi a. s. gjithashtu ka agjëruar gjithmonë në ditët e hënë dhe të enjte. Kur e kanë pyet se përse e agjëron? Ai për ditën e hënë ka thënë; "Të hënë Linda dhe të hënë ka filluar të më vinë shpallja. "Trans Muslimi. Dijetari i dëgjuar Imam Bin Ijadi ka thënë; Festimin e ditëlindjes së Pejgamberit a. s. unë e quaj festë

për gjithë muslimanët. Festë në të cilën muslimanët shprehin gëzimin dhe harenë e tyre për lindjen e Pejgamberit a. s. të dërguarit të Allahut xh. sh. Dijetari i njohur Sujuti thotë se festimi i ditëlindjes së Pejgam-berit a. s. është i lejuar dhe është veprim i mirë-me vlerë. Mendimin e tij ai e mbështet në një transmetim të Bejhekiut nga sehabi=shoku i Pejgamberit a. s. Enesir. t. a. që ka thënë se; Pejgamberi a. s. ka therë kurban për ditëlindjen e tij, për të falenderuar Allahun xh. sh. Kështu që është pa dyshim e rekomandushme dhe për ne muslimanët që ti shprehim Allahut xh. sh, falenderimet tona për lindjen e Pejgamberit-lindjen e profetit Muhamed a. s. Dijetari i mirënjohur ish myftiu i Mekës në Arabinë Saudite Ahmed Zejni Dahlani që ka vdekur në vitin 1066 ka thënë; Tradita e njerëzve të cilët festojnë ditëlindjen e Pejgamberit a. s. për respekt e nderim ndaj tij, është vepër e lejushme e mirë që të praktikohet. Dijetari dhe muxhtehidi i mirënjohur Shevkaniu rahmetullahi alejh ka then: Festimi i mevludit=ditëlindjes së Pejgamberit a. s, është vepër e mirë që lejohet të bëhet. Ndërsa historiani i njohur i shekullit të 8 Ibni Batuta tregon; Pas çdo namazi të xhumasë dhe në ditën e lindjes së Pejgamberit a. s, dyrët e Qabes hapeshin nga rojet e saj dhe Kadiu i Mekës Nexhmedin Muhamed bin el imam Muhjidin Taberiu shpërndante ushqim për njerëzit në qytetin e Mekës. Nga fjalët e tij kuptohet që në festën e mevludit është shumë sevab-shumë mirë të japësh sadaka të varfërve, të ndash dhurata dhe të shtrojnë gosti për njerëzit ai njeri që ka mundësi, si shenjë dashurije për Pejgamberin a. s. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Ata që bëjnë vepra të mira ju takon e mira dhe më shumë." S. Junus. Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë; Kush angazhohet për të mirë ai do të ketë të mirë." S. Nisa. aj. 128. Vetëm djalli mallkuar, qafirat dhe munafikët-hipokritët janë të hidhëruar për lindjen e tij. Pejgamberi a. s, ka thënë:"Kush gëzohet për mua edhe Allahu xh. sh. është i gëzuar prej atij njeriu." Trans Imami Tirmidhi. Sehabët-shokët e tij e kanë lavdruar Pejgamberin a. s, kur ai ishte gjallë. Shembull kemi Ebu Bekrin që një ditë i tha Pejgamberit a. s. ; Kam shëtitur në shumë vende o i dërguari i Allahut xh. sh, por njeri më të bukur si ti nuk kam pa. Po kështu poeti i njohur i kohës Hasan Thabiti ka thënë; Më të hijshëm se ti nuk kanë parë sytë e mi , më të bukur se ti nuk kanë lindur gratë ndonjë fëmij. Ti je i krijuar në trup pa asnjë të metë, ashtu deshi e të krijoj Zoti i vërtetë. Edhe pasi ndërroi jetë Pejgam-

beri a. s. shumë dijetarë të ndryshëm e kanë lavdruar atë duke i përmendur cilësitë dhe mrekullitë e tij. Të tillë janë Ebu Hanifeja me kasiden e tij të famëshme që është e njohur në të gjithë botën. Ebu Siriu me kasiden burde të tij e tjerë. Dijetarët Islam në çdo vëndë të botës, në ditën e lindjes së profetit Muhamed a. s. veçë këndimit të Mevludit që duhet ta këndojmë me shumë respektë në gjuhën që njerëzit e kuptojnë duhet të mbajnë dhe ligjëratat të ndryshme për jetën e tij. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “Ata që bëjnë vepra të mira u takon e mira edhe më shumë.” S. Junus. ajet. 26.

Muslimanët në përgjithësi por siç e thash sidomos të diturit duhet të jenë krenarë që përkujtojnë me respekt të madh, ditëlindjen e njeriut më të famshëm në botë, që nga krijimi e deri në fundin e kësaj bote, se ai është [mëshirë për botrat]. Profeti Muhamed a. s. është themelusi i paqes së vërtetë në mbarë botën. Feja Islame që i komunikoi botës profeti Muhamed a. s, është ilaçi i shërimit të krizës morale për mbarë njerëzimin. Të gjithë njerëzit e mençur duhet ta kuptojnë këtë gjë, dhe që ta kuptojnë duhet të studiojnë Kuranin dhe jetën e profetit Muhamed a. s, me hollësi. Intelektualët janë borxhëli ndaj profetit Muhamed a. s, se ai e ngriti lartë vlerën e të diturve mbi të pa diturit, kur ju komunikojë njerëzve shpalljen që i sollti Allahu xh. sh. ajetin e Kuranit; “Nuk janë një llojë ata që dijnë, me ata që nuk dijnë.” Profeti Muhamed a. s. ka qënë personaliteti më i madh në jetën e përditshme shoqërore civile e ushtarake. Ai ka qënë dhe një krytarë shteti i shquar, një organizatorë e administratorë i përsosur, një komandantë i zgjuar dhe shumë trim, një ushtarë i disiplinuar, e një gjykatës i drejtë e i pa shembullt në zbatimin e drejtësisë, duke u bërë kështu njeriu me famën më të madhe në faqen e tokës, njeriu që e shikriu jetën e tij për të bërë mirë njerzimit. Bota as nuk ka parë dhe as nuk ka për të pa njeri më të ditur, më bamirës, më human dhe me veti morale më të larta se profetin Muhamed a. s. Ai është shembulli i të gjitha mirsive. Profetin Muhamed a. s. e ka ngritur në shkallë të lartë, vetë Krijusi i Gjithësisë Allahu xh. sh. që e dërgoi atë për mbarë njerzimin dhe thotë për të në Kuran; Lartë ta ngritëm famën tënde o Muhamed’’. S. Inshirah. ajeti. 4. Nga sa thamë deri këtu, vërtetohet se janë pa dyshim prej Allahut xh. sh. fjalët që tha Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha se: “Allahu xh. sh. gëzohet kur njerëzit mblidhen së bashku të gëzuar për festën e Mevludit për ta nderuar e

lavdruar më të dashurin e Tij Muhamedin a. s. "Vërtet Kurani thotë ; "Është e vërtetë se Allahu dhe melekët-engjëjt e Tij me krenari e lavdrojnë Pejgamberin. O ju besimtarë ngrëjeni lartë famën e tij-nderojeni pra atë [dhe ju] dhe përshëndeteni [atë] me selam. "S. Ahzab. aj. 56. Të gjitha lavdrimet e titujt më të mirë që i përkasin njeriut i thohen Pejgamberit a. s. por nuk lejohet ti thuash atij Zoti filan, ose Zotëri, i Zoti ose i biri i Zotit estagfirullah, estagfirullah, estagfirullah në gjuhën Shqipe dhe po kështu si këto në çdo gjuhë tjetër nuk lejohet ta thërrasësh atë se atëherë ke bërë kufër. Nuk lejohet kurrë ti thuash njeriut Mullah që do të thotë im Zot=Allahu im dhe Mevlana që do të thotë i Lartmadhrueshëm. Gjithashtu edhe indirektë me këta tituj të mëdhej; I plotëfuqishëm, Mbreti i gjithësisë, i lartë madhërushëm ose lartëmadhëri nuk e lejon feja Islame ti thuash njeriut. Pejgamberi a. s. e ka ndaluar që të respektohet njeriu me këto fjalë se këto tituj të mëdhej janë cilësi vetëm të Allahut xh. sh. që është krijusi i gjithësisë. Njeriu në çfardo pozite shoqërore që të jet, ai është njeri si të tjetrët. Por duhet ditur se nuk mjafton si shprehje dashurije ndaj Pejgamberit a. s. vetëm gëzimi për lindjen e tij, këndimi i mevludit, dëgjimi e këndimi i kasideve ose i ilahive me të cilat lavdrohet Pejgamberi a. s. Dashurija më e madhe për Pejgamberin a. s. është që muslimanët të ndjekin rrugën e tij. Njohja sa më thellë e jetës dhe veprimeve të tij. Ai duhet të jetë shembull për ne muslimanët në çdo aspekt të jetës tonë. Për këtë gjë Allahu xh. sh. thotë në Kuran besimtarve; " Ju e keni shembullin më të lartë [më të mir] në të dërguarin e Allahut [në veprimet e tij] ai që ka shpresë në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai [njeri] që atë shpresë e shoqëron duke përmendur Allahun. [duke fal namazë, duke bërë zikër e duke iu përulur urdhrave të Tij]. "S. Ahzab ajeti 21.

36-NJOFTIMET QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE PËR KËNDIMIN E KURANIT, DHE ÇFAR THA AJO PËR NUSKAT E SHKRUARA NË TO VETËM KURAN.

Vëllezër besimtarë Allahu xh. sh. do që njerëzit të kenë disiplinë dhe përulësi kur ti luten Atij. Muxhedidja Aishe rahmetullahi

alejha tha mora këtë vërejtje nga Allahu xh. sh. për tua thënë njerëzve; "Mos ta lëkundin trupin majtas e djathtas kur ti luten Allahut." "Kjo vërejtje pa dyshim është dhe për njerëzit kur këndojnë Kuran. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha kur fillonte të lexonte Kuran, merrte qëndrim me përlulësi duke ndenjtur në gjunjë, dhe me respekt të madh pasi e puthte librin, thoshte Eaudhu bil-lahi minesha=shejtani rrahim, bismil-lahi rrahmani rrahim dhe fillonte ta lexonte atë. Për lutjen e namazit muxhedidja tha se kam marrë dije nga Allahu i madhëruar që është më e pëlqyeshme nga Allahu xh. sh. që lutjen e namazit njerëzit ta bëjnë në këmbë. Kështu e bëjnë lutjen e namazit të sabahit Shafitë në Misir [Egjpt], por nuk ka dyshim që edhe ulur është e pranuar nga Allahu xh. sh. se gjatë faljes ka njerëz të vjetër , të sëmurë e të lodhur me punët e ditës. Allahu thotë në Kuran; "Lutuni Allahut në këmbë ulur dhe mbështetur. " Në këtë ajet përfshihen dhe të moshuarit, të sëmurët e të lodhurit Muxhedidja Aishe rahmeti i Allahut xh. sh. qoftë për atë iu këndon= te gjithmonë Kuranë fisit dhe besimtarëve të vdekur. Ajo thoshte se të vdekurit presin ndonjë të mirësi nga ne, si dhënen e ndonjë sadakaje, lutje e këndim Kurani, sevapin e fituar qëllimin për ata. Dhuratat i pranon Allahu xh. sh. për besimtarët e tij se të vdekurit presin dhurata prej të gjallëve. Ata gëzohen shumë thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Kurse ne të gjallët nuk përfitojmë asgjë nga të vdekurit thoshte ajo, pasi libri i punimeve të tyre është mbyllur për këtë botë, ata presin nga neve dhuratë, që janë; sadakaja, këndimi Kuranit e lutja për ata. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se Allahu xh. sh. mi shfaqti në ëndërr disa të vdekur ku ndër ata ishte edhe nëna ime të cilët kishin ardhur këtu në këtë dynja me liridalje. Ata me fytyra të qeshura po iknin të gëzuar nga që i kishin mbushur çantat me ushqime me rastin e festës së bajramit. Vëllezër besimtarë, kjo që na tregon Aisheja, është plotësisht e vërtetë, se vërtetohet me Kuran ku thuhet; "Tenez, zelul melaikei verr rruhu. " S. Kadër. që do të thotë 'zbresin melekët-engjëjt dhe shpirti=shpirtat. " Gjithashtu ka hadithe që tregojnë se shpirtat e të vdekurve vine me leje prej Allahut xh. sh. në dynja. Jeta e varrit-berzahu është e vërtetuar me Kuranë e hadithë. Pësa i takon çështjes së shpirtit Allahu xh. sh. i thotë Pejgamberit a. s. me Kuranë kështu; "Të pyesin ty [njerëzit] për shpirtin; Thuaju [ti atyre]; shpirti është çështje që i përket

vetëm Zotit tim, kurse juve ju është dhënë shumë pak dije. "S. Isra aj. 85. Unë thoshte murshidja Aishe i këndoja çdo natë nga një herë suren Jasin familjes time të vdekur nënës, babait dhe vëllait. Një natë isha tepër e lodhur dhe nuk këndova gjë për ata. Porsa më zuri gjumi mu paraqit në ëndërr vëllai dhe më tha; 'Përse nuk ma ndeze sonte dritën'?. Muxhedidja Aishe thoshte që duhet me ju çuar dhurata edhe fëmijëve. Në faktë ata gëzohen më shumë se të rriturit prej dhuratave sikurse në dynja. Ajo tha se; Allahu xh. sh. mi shfaqti në rruëja disa fëmijë të vegjël, të cilët mu ankuan mua për prindërit e tyre duke më thënë : "Neve na kan harruar. Po neve përse na harroni e nuk na çoni dhurata ? ". Gjithashtu muxhedidja Aishe tha kështu: Unë i çoja gjithmonë vëllait nga një Jasinë më vehte. Një herë ia çova bashkërishtë me njerëzit tjerë të fisit. Atë natë tha murshidja Aishe; mu paraqit në ëndërr vëllai e më tha; Sonte përse ma përgjysmove dhuratën. Nga kjo ankesë e tij thoshte murshidja Aishe kuptohet se të vdekurit duan secili dhuratën të veçantë e jo së bashku me të tjerët Vërtetë për lutjen ose këndimin e lutjeve nga Kurani për të vdekurin, Allahu xh. sh. thotë; Dhe as njërit prej tyre [që nuk kanë qenë besimtarë] kur të vdesin mos ja falë namazin [e xhenazes] kurrë, e as mos qëndro pranë varrit të tij [për lutje- për këndim] sepse ata mohuan Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe vdiqën kryeneçë=të pa bindur. "S. Tobe. aj. 84. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Këndonja suren Jasinë të vdekurvet tuaj. " "Trans. Imamë Ahmedi, Ebu Daudi, imam Tirmidhiu, Dari Kutniu, Ibni Maxheh e të tjerë. Gjithashtu për këndimin Kuran për të vdekurit transme- tojnë hadithin e Pejgamberit a. s. edhe Taberaniu dhe Bejhekiu në librin Eshuab. Shumë dijetarë Islam kan folur rreth dobisë që ka i vdekuri prej lutjes që bën i gjalli për të prej këndimit të Kuranit, sadakas=dhuratës që jep për shpirtin e të vdekurit e deri tek larja e borxhëve të tij por me kusht që i vdekuri të ketë qenë besimtar. Nëse nuk ka qenë besimtar sevapet i shkojnë fisit të tij që kan qenë besimtarë të Allahut xh. sh. Për këtë gjë kan thënë dijetarët tregojnë shumë hadithe të Pejgamberit a. s. Dhe murshidja Aishe rahmetullahi alejha, siç e thash më lartë thoshte se atë natë që unë e këndova suren Jasin dhe sevapin e saj dhuratë për gjithë të vdekurit e mi familerisht, pikërishtë atë natë porsa rashë në gjumë, mu paraqit mua në ëndërr vëllai dhe më tha kështu; Përse ti mua ma përgjysmove sot dhuratën? Nga kjo gjë thoshte

Aisheja unë kuptova se të vdekurit kanë dëshirë që të ia këndoshë secilit në veçanti suren Jasin. Unë e pyta muxhediden Aishe rahmetullahi alejha; A vlejnë nuskat? A e a ka dobi shëruse prej tyre? Muxhedidja Aishe më tha; Nuska që është e shkruar në të Kuran, po deshi Allahu xh. sh. ajo ka efekt se Allahu xh. sh. shëron dhe jo hoxha. Muxhedidja Aishe vetë nuk shkruante nuska por i pranonte ato. Allahu xh. sh. thotë në Kuran kështu: “Ne ta shpallëm Kurani [ty o Muhamed] që është shërim [ilaç] dhe mëshir [rahmet=mirësi e shpëtim] për besimtarët, ndërsa jo besimtarëve nuk ju shton tjetër veç se dëshprim [nuk ju ban dobi]. ” S. Isra. aj. 82. Kur muxhedides Aishe rahmetullahi alejha iu paraqiste ndonjë rast i rrallë pasi ndodhte që ishte tek ndonjë familje besimtare, ajo vetëm frynte me Kuran në një gotë me ujë dhe pastaj bënte lutje për të sëmurin me duart lartë nga qielli. E para gjë është se njerëzit duhet të kenë besim të plotë tek Allahu xh. sh. dhe jo tek hoxha që është vetëm një mjet-një shkak. Duhet të ketë qëllimi të pastër e trup të pastër si ai që e bën nuskën dhe atij që i bëhet nuska. E dyta është që duhet patur kujdes mos të abuzohet me nuskat, duke i bërë mjet për të fituar, dhe mos të hidhet nuska për tokë, kur kryhet halli, por ajo duhet të digjet kur mbarohet qëllimi për të cilin e ke mbajtur. E treta gjë është se nuk lejohet të hysh me nuskën në trupë në vëndin e pistë. Kështu që më mirë besimtarët duhet të këndojnë vetë Kuranë dhe ti fryjnë vetes së tyre kur të sëmuren duke ju lutur Allahut xh. sh. qoftë edhe shqip nëse nuk din ta këndojnë Kuranin arabisht. Ti mbështeten Allahut xh. sh. që ti ruaj ata prej sherrit=prej të keqes së xhinëvet, djallit të mallkuar dhe shokëve të tij magjistarvet. Besimtarët ta mbajnë trupin pastër gjithmon, të këndojnë Kuran vazhdimisht dhe le ti thonë disa herë në ditë fjalët; ‘Eudhu bilahi mineshejtani rrahim, Bismil-lahi Rrahmani Rrahimj. ” dhe fjalët “La havle vela kuv-vete il-la bil lahil alijil aadhijm”. Vëllezër besimtarë nuska e shkruar në të Kuran nuk është e rrekomanduar që të bëhet por është e lejuar. Për çështjen e nuskave ose hajmalive të shkruara me Kuran për qëllim shërimi, sehabët-shokët e Pejgamberit a. s. dhe dijetarët Islam, janë ndarë në dy mendime. Një pjesë është e mendimit se nuskat me Kuran lejohen. Të këtij mendimi janë Amër Ibnul Asi, hazreti Aisheja gruaja e Pejgamberit a. s. , Ebu Xhafer el Bakiri dhe Imami Ahmed Ibni Hambeli që është prinjës i muslimanëve.

Allahu qoftë i kënaqur prej tyre. Ndërsa të mendimit që nuska mos të shkruhen janë këto; Ibni Abasi, Ibni Mesudi, Ukbetu Bini Amiri dhe Ibni Hakimi, qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej tyre. Unë shkruasi i këtij libri kamë pyetur nxënësit dhe bashkëkohësit e dijetarit Haxhi Hafiz Mahmud Dashit për mendimin e tij për nuskat dhe ata më kanë thënë se edhe ai ka shkruar nuska me Kuran ndonjëherë rrallë por jo që ta ketë bërë zakon. Më mir është të këndohet Kuran e ti fryhet ujit për të sëmurët, se shkrimi i nuskave, është bërë dhe bëhet si profesion nga disa njerëz për fitim. Me këtë rast i hapet rruga kështu njerëzve të ligë, e të pa ditur që mashtrojnë duke shkruar gjëra jashtë Kuranit famëlartë që është fjala e Allahut xh. sh. Gjithashtu ata që shkruajnë nuska duhet të kenë shumë kujdes se ngarkohen me gjynah, pasi ata bëhen shkakëtarë për uljen e autoritetit të Kuranit të madhërshëm, pasi njerëzit e pa kujdes-sëshëm, sidomos sot në këtë kohë e hedhin për tokë në vënde të pista. Shkrimi i nuskave ose fryrja të sëmuarve që në to nuk këndohet Kuran por përmenden emra xhindësh e shejtanësh dhe emra njerëzish të vdekur duke kërkuar ndihmë prej tyre dhe nuskat me eshtra të ndryshëm, hekura ose tunxhë, fije peni ose të shkruar në to emra xhindësh, shejtanësh ose thënje të kota, të gjitha këto janë rrebtësisht të ndaluara nga feja Islame. Ata njerëz që i bëjnë këto gjëra bëjnë shirk. Ai njeri që bën shirk Allahu xh. sh. nuk ia fal këtë gjynah atij. Kurani thotë; "Kjo ngase Allahu është Ai i vërteti dhe atë që lusin ata përveç Tij është e kotë. Allahu është vërtetë Ai i larti i madhërshmi. "S. Haxh. Aj. 62. Mynyra për të kërkuar mbrojtje ose shërim prej Allahu xh. sh. është vetëm me ata ajete e lutje që burojnë nga Kurani e syneti i Pejgamberit a. s. Pejgamberi a.s. iu ka fry shokëve të tij duke kënduar Kuran dhe i ka porositur shokët që ti shërbejnë njëri tjetrit duke i kënduar Kuran e duke i bërë lutje Allahut xh. sh. për njëri tjetrin. Gjithashtu është e lejuar që të shpërblehet njeriu që i shërben dikujtë me Kuran se ai humbet kohën për punë dhe prish qetësinë e vet por jo duke bërë pazar kaq e aq lekë për këtë gjë. Nëse dikush nuk ka dëshirë të marri shpërblim, le mos të marri. Kështu transmetojnë Buhariu dhe Muslimi. Disa dijetarë kanë thënë se mendimi për ndalimin e nuskave është më i përshtatshëm për ta ruajt Kuranin nga poshtrimi se njerëzit që mbajnë nuskën të shumtën e rasteve nuk janë të pastër e gjithashtu kur e mbarojnë hallin e hedhin nuskën në tokë e kështu

që Kurani poshtrohet e shkilet me këmbë nga njerzit. Një tjetër arsye e mos mbajtjes së nuskave me Kuran në trup është dhe kjo se; mbajtja e këtyre nuskave jep shkak pastaj që njerëzit të mbajnë dhe nuska që nuk janë të shkruara në to ajete Kurani. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tregonte këtë ngjarje; Ajo thoshte se kur isha në moshë të re më bënë sibir ose ndryshe quhet magji. Ajo thoshte se disa ditë ndjeva shumë debulesë në trup. Isha fare e pa fuqishme. Edhe syt nuk mundesha ti mbaja hapur. Unë nuk po e kuptoja se çfarë kishim thoshte ajo. Allahu xh. sh. më njoftojë në ëndërr kështu : “ Ty të kanë bërë magji. Magjinë ta kanë bërë Shaba dhe e ke filan vendë. ” Ai quhej Shaban por për shkurtim njerëzit në lagje e thërrisnin atë Shaba. Këtë gjë thoshte Aisheja unë ia tregova dijetarit të njohur në atë kohë Hasan Tahsini që i thoshim për respektë Hasan Beu të cilin e kishim komshi dhe ai e shkatërrojë magjinë. Ai më shkroi mua dhe një nuskë me Kuran thoshte Aisheja. Vërtetë Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “Thuaj [njerëzve o Muhamed] ai [Kurani] është për besimtarët udhëzues dhe shërues. ” S. Fusulet. ajeti. 44. Kjo ngjarje thoshte ajo më ndodhi para se të ngarkohem prej Allahut xh. sh. me shërbimin e tobes. Hasan Tahsini nga Shkodra me origjinë nga Podgorica ishte njeri shumë i ditur. Ai ishte profesor i talentuar i gjuhës arabe në medresen e Tiranës. Shkaku që i bënë magji Aishes ishte kështu: Pasi erdhi në pushtet rregjimi komunist, murshides Aishe me që ishte e persekutuar, ja mori shteti shtëpinë që i kishte lënë burri, me përjashtim të një dhome të vogël. Murshidja Aishe tregonte se shtëpia me katër dhoma e një guzhinë të vogël ishte me dy porta=me dy hyrje. Shteti ma mori shtëpinë mua dhe ja dha familjarëve tjerë që njëri ndër ata ishte dhe ky Shaba i cili ishte në atë kohë afër gjashtëdhjetë vjeç. Ky dojte që edhe atë guzhinë të vogël që banoja unë, të ma merrte prandaj më bëri magji që unë të largohesha prej shtëpisë time vetë me dëshirë nga halli. Sikurse e dijmë edhe profetit Muhamed a. s i kanë bërë magji. Allahu xh. sh. ja tregojë atij me anën e dy melekëve se cili njeri i kishte ba magji dhe në çvendë e kishte futur magjinë ai. Pejgamberi a. s. lajmëron haz. Aliun r. t. a. se në çvend ishte magjija, dhe ai e shkatërroi atë.

37- ALLAHU XH. SH. E NJOFTOI MUXHEDIDEN AISHE SE LARTË NË QIELL NË NJË PLANET SIPËR TOKËS KA NJERËZ - KA QYTETËRIM SI KËTU NË TOKË.

Muxhedidja e shekullit të njëzetë Aisheja rahmetullahi alejha më tregonte kështu: Ajo thoshte; "Një ditë akoma pa ardhur koha e namazit të yles [drekës] un isha duke lexuar Kuranë. Menjëherë se çfar ma ngriti kokën lartë me sytë nga qielli, sikur të ma ngrente dikushë me dorë. Në atë çastë pamjen e syve të mi nuk e pengonte më tavani i shtëpisë ku isha un. Në ata momente kur po shikoja lartë me sytë nga qielli pashë një qytetë që kishte në të njerëz, makina e karroca. Në ato çaste degjova një zë që më tha mua kështu; "Ja edhe këtu ka njerëz si tek ju në tokë." Un u mahnita thoshte Aisheja qoftë i kënaqur Zoti xh. sh. prej saj. Ajo thoshte se njerëzit në atë planetin sipër nesh, kishin pak diferencë në masën e trupit me njerëzit në tokë, por unë shkruesi i librit nuk e kam të regjistruar se a më të shkurtër apo më të gjatë. Që ka njerëz në planetin tjetër sipër nesh, na e bën të qartë Allahu xh. sh. në Kuranë në disa ahete ku thotë: "Nga argumentet e Ti j[ë Allahut] është krijimi i qiellnave dhe i tokës dhe shpërndarja e krijesave të gjalla në të dyjat [në tokë e qiell] dhe Ai [Zoti] me fuqinë e tij mund ti bashkoi kur do që të dëshiroi S. Shura Ajeti. 29. Ndërsa në suren Nahl Kurani thotë; "Vetëm Allahut i bën sexhde [përrulje me kokën në tokë] çdo krijesë e gjallë që është në qiellë e që është në tokë, gjithashtu edhe engjëjt=melekët, ata nuk bëjnë kryelartësi." S. Nahl. Aj. 49. Gjithashtu në Kuran thuhet: "Allahun e lartësojnë me adhurim [namaz, zikër e lutje] ç'ka [gjindet] në qiellë e ç'ka në tokë...Ai jep jetë dhe vdekje dhe Ai ka fuqi për çdo send." S. Hadidë. aj. 1 dhe 2. Gjithashtu Kurani thotë: " E Atij [Allahut] i është dorzuar gjithë çka në qiell e në tokë me dashje e pa dashje dhe tek Ai këthehen" S. Ali Imran. aj. 83. Un shkruesi i librit mendoj se do të vië shpejtë koha që do të vërtetohen fjalët e Kuranit që Allahu xh. sh. i thotë indirekt me nënkuptim për këtë gjë dhe do të vërtetohet sqarimi i qartë që bëri Allahu xh. sh. nëpërmjet muxhedides Aishe rahmutullahi alejha në mesin e shekullit të njëzetë. Atëherë shkencëtarët e kozmosit që janë studjuesit e veprës së Zotit xh. sh. do ti japin dorën

në shenjë mirënjohje dhe respekti dijetarëve të fesë Islame që janë studjuesat e fjalës së Zotit xh. sh. , Kuranit famëlartë; Po atëher. Pa dyshim kjo që tha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ka qënë një pamje që ia ka çfaqur Allahu xh. sh. asajë të filmuar nëpërmjet engjëjve. Është e vërtetë ajo që tregon murshidja Aishe se për këtë gjë kemi argumentin në Kuran. Allahu xh. sh. thotë: “Dhe kështu ne ia treguam Ibrahimit perandorinë ose mbretërinë e qiejve dhe tokës, për të besuar [ai] vendosmërisht. ”S. En-nam. Aj. 75. Gjithashtu Allahu xh. sh. i ka tregur shumë ngjarje të çuditëshme Pegamberit tonë a. s. në ruëjetu=në vision-pamje para syve ditën duke qënë zgjuar. Një pjesë ngjarjesh kishin ndodhur para se të vinte Pejgamberi a. s. në këtë botë, Një pjesë ndodhën kur ishte gjallë ai dhe pjesa tjetër ndodhën pasi ai ndërroi jetë, kaloi në botën tjetër. Një nga ngjarjet që kishte ndodhur para se të vinte Pejgamberi a. s. në këtë botë disa shekuj më parë ishte dhe kjo e kombit të profetit Azkail a. s. të cilën Allahu xh. sh. ia kishte çfaqur të filmuara para syvet Pejgamberit tonë a. s. disa kohë më parë dhe ia rikujton atij në një rast duke i thënë kështu: “A nuk i shikove ti [o dashuri im Muhamed] ata njerëz që dolën [dikurë] prej qyteteve të tyre dhe ishin me mijra njerëz duke pas frikë nga vdekja? Allahu atyre jut ha vdisni e ata vdiqën. Pastaj Ai [Allahu] i ngjalli përsëri ata. ”S. Bekare. aj. 243. Një pjesë nga dijetarët Islam kanë thënë se ata njerëz që ikën nga qytetet e tyre prej frikës së armiqëve të tyre kan qenë kombi i një pejgamberi të quajtur Azkail a. s. të cilët ishin urdhëru nga pejgamberi i tyre për të luftuar kundër armikut të tyre. Ata e kishin shumë frikë vdekjen dhe nuk ju bindën Azkailit për të luftuar kundër armikut dhe morën rrugën e ikjes nga vendi i tyre. Për këtë faj që bënë ata gjoja për tu ruajt nga vdekja, Allahu xh. sh. ju hudhi sëmundjen e mortajës dhe i vdiq të gjithë në rrugë që tu tregonte atyre me anë të mrrekullisë se vdekjes e cila është e caktuar nuk mund ti shpëtoi askush. Allahu xh. sh. i mbajti të vdekur disa ditë=tre e më shumë thuhet në tevsirin e Kuranit dhe me lutjen që i bëri Allahut xh. sh. pejgamberi i tyre Azkaili i ngjalli përsëri Allahu xh. sh. dhe secili shkoi në shtëpin e vet dhe jetuan deri sa Allahu xh. sh. më vonë i solli secilit vdekjen sipas kohës së caktuar për secilin. Një ditë Pejgamberi a. s. me shokët po gërmonte hendekun=kanalin për ta qarkuar qytetin që ta mbronte atë nga sulmet e armiqëve. Duke thyer një gurë të fortë Allahu xh. sh. i

shfaq atij në keshf= vizion para syve vëndet e Sirisë, dhe Jemenit, dhe ju tha shokëve se këto vende do të bien në dorë të muslimanëve. Ai ju tha atyre po i shoh tani dhe qytetet e Persisë=sotë Irani. Pejgamberi në ata çaste tek po punonte me shokët ju tha atyre; Ja po i shoh qytetet e Persisë, ja po i e shoh Kisranë, mbretin e Persis me bylyzykët në dorë e taxhën=përkrenaren në kokë, dhe ja tani ata i mori Ymeri r. t. a. Shokët u çuditën, por ata i besonin fjalët e Pejgamberit a. s. Dhe kur u tregonte shokëve pejgamberi thoshte Allahu Ekber. Vërtetë ashtu ndodhi, pasë rrethë 25 vitesh u bënë realitet fjalët që iu tha Pejgamberi a. s. Në kohën kur u bë halif = kryetar i mualimanvet hazreti Ymeri r. t. a. u çlirua nga kufri Irani. Ai ra nën sundim të muslimanvet dhe ditën e çlirimit vendasit që u bënë muslimanë i dorzuan haz. Ymerit bylyzykët dhe taxhën=përkrenaren e Kirsasë=ish mbretit të Persisë. Hazreti Ymeri r. t. a. e vuri vërtetë në kokë taxhën=përkrenaren e Kirsasë. Allahu xh. sh. e bëri realitet pasë rreth 25 vitesh, shfaqëjen filmike=vizion para syve duke qënë zgjuar që ia kishte treguar më parë më të dashurit të vet , Pejgamberit Muhamed. a. s. Kurani thotë: " Ai [Allahu] i di më së miri gjithçka për ju [se çfar do bëni] edhe para se tu krijoi. "S. Nexhm. aj. 32. "Allahu ju ka krijuar juve dhe atë [veprën] që bëni ju. "S. Safat. aj. 96. Gjithashtu në Kuran thuhet: "Allahu i di çka është bërë e çka do të bëhet. "Allahu xh. sh. i tregoi dhe shumë gjëra tjera Pejgamberit a. s. natën e Israsë dhe Miraxhit. Kështu pra edhe murshides Aishe që thirri popullin e sajë për tobe, ja tregoi Allahu xh. sh, me pamje=vizion para syve duke qenë zgjuar se në një planet tjetër sipër tokës ka njerëz ka qytetërim sikurse këtu në tokë. Shembull se Allahu xh. sh. i ka treguar të filmuar shfaqje të ndryshme edhe gravet, kemi Aminen, rahmetullahi alejha, nënën e nderuar të Pejgamberit a. s, që Allahu xh. sh. i shfaqti asajë në vision para syvet duke qenë zgjuar pamje të ndryshme para dhe pasë lindjes së djalit të vet Pejgamberit tone Muhamedit a. s. Prandaj mos u çuditni o besimtar nga fjalët e muxhedides Aishe rahmetullahi alejha se ajo ka thënë të vërtetën. Muxhedidja Aishe tha :

"Një ditë në shtëpi duke ndenjtur ulur tek po bëja zikër pasi mbarova namazin më çfaqti Allahu xh. sh. para syve, gjithë njerëzit në tokë e në qiellë duke falur namazin e ikindisë dhe pamja ose pjesa filmike që mu paraqit para syve ishte pozicioni i rukusë=përkuljes. Ajo thoshte un mendoj se ndoshta koha e namazit të ikndis në

planetin tokë duhet të jetë në një kohë me namazin e ikindisë ose me një namazë tjetër në planetin tjetër të banuar sipër nesh thoshte murshidja Aisheja rahmetullahi alejha. Edhe nga kjo shfaqëje të cilën ja sollën të filmuar engjët muxhedides Aishe vërtetohet se në qiell në një planet tjetër sipër tokës ka njerëz, ka qytetërim sikurse këtu në tokë. Përsa i takon sinjalit të qënjes në një kohë të përbashkët me njëri tjetri të ndonjëres kohë të namazit në tokë me namazin në planetin tjetër sipër tokës, Allahu xh. sh. në Kuranë thotë; Keni kujdes namazet dhe sidomos faljen e mesme [namzin e ikindisë]. S.Bekare..aj.238 .Në një ajet tjetër të Kuranit thuhet : “Zoti i dy lindjeve dhe dy perendimeve.” Pamjet filmike=vizion para syvet duke qënë zgjuar ia dërgon Allahu xh. sh. njerëzve të tij të dashur nëpërmjet melekëve-engjëjve të filmuara. Sikurse dihet, kemi ruja dhe rrujetu. Rrujaja është shikimi i syrit në ëndërr ndërsa rujetu quhet shikim me sy kur je zgjuar. Këtë gjë e vërtetojnë shumë ajete nga Kurani dhe hadithe që ka folur Pejgamberi a. s. Transmetohet nga Ebu Hurejre kjo ngjarje që i ka treguar Pejgamberi a. s. shokëve të tij: Pejgamberi a.s. ju tha atyre: “Në natën e pesëmbëdhjetë të muajit Shaban më erdhi meleku Xhebrail dhe më tha : O Muhamed a. s., ngreje kokën lartë në drejtim të qiellit që të shohësh disa mrekullina. Kur un tha Pejgamberi a. s. ngrejta kokën lart me sytë nga qielli shhikova shium gjëra të çuditëshme ndër të cilat dhe këtë: Pejgamberi a.s. tha : I pash të hapura dyrët e qiellnave prej qiellit të parë e deri në Arsh dhe i shikova melekët të përkulur në sexhde, duke i kërkuar falje Allahut xh. sh. për pasardhësit e ymetit tim.” Kurani i madhrushëm në suren Gafir Aj 8. na tregon se melekët ose ndryshe engjëjt i luten Allahut xh. sh. për besimtarët.

38-KËSHILLAT DHE VËREJTJET QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MURSHIDJA AISHE PËR VETEN E SAJË.

Murshidja Aishe tregonte që kishte marrë dhe ndonjë këshillë e vërejtje nga Allahu xh. sh. për vehten e saj. Sigurisht që njeriu nuk është i pa gabushëm kushdo qoftë ai. Allahu xh. sh. ka thënë Sikur njerzit mos të bënin gabime, Un nuk kishim ku ta hedh mëshirën time. Nga vërejtjet që mori muxhedidja Aishe janë këto: 1-Një rastë ajo duke qënë e mërzhitur nga shtëpia e vjetër prej qërpiçi që e fuste

ujin e shiut brenda në dhomë u ankua. Un thoshte muxhedidja Aishe murmurita nëpër dhëmbë fjalë në formë ankese. Nuk vonoi veç se pak sekonta dhe nga Allahu xh sh. thoshte murshidja Aishe erdhi kjo vërejtje për mua kështu: "Mos u anko se shokët tuaj [Të dërguarit e tjerë] kan fjetur jashtë e me brinjët në ujë [me trupin në tokë] kurse ti po flen në krevatin me sustë.]" 2], Ajo thoshte se një ditë un pregadita ujë për të larë trupin. Në ata momente që po hyja në banjo për tu larë, mu desh që të kryeja nevojën personale. Vendin e nevojës nuk e kishim as 10 metra larg nga banjo-vedi i larjes. Zakonishtë në atë kohë shtëpitë private VCët ose nevojtoret i kishin të ndara nga banjot që laheshin në ato. Un e dija që në nevojtores nuk kishte ujë çezma, por meqë do të futesha menjëherë në banjo për tu larë krejtësishtë, unë mendova thoshte ajo se nuk ishte e nevojshme në atë rastë që të merrja ujë me kanaçe për pastrim dhe ashtu veprova. Me një herë dola nga njëra derë dhe u futa në derën tjetër në banjo. Mbasi u lava, menjëherë porsa dola në dhomë, mora këtë vërejtje të rrebët nga Allahu i madhërushëm kështu: "Edhe një herë mos të shoh më ta përsërisësh këtë xhest = këtë veprim që ia përngjas veprimeve [huqeve ose cilsive] të kaurëve =[të vetëquajturve kristianë]". Nga kjo që thash Muslimanit e muslimanes nuk i lejohet me lëvizë këmbën nga vendi nëse nuk është i pastruar me ujë, thoshte murshidja Aishe që Allahu e mëshiroftë. Nëse nuk gjenë ujë për momentin duhet të pastrohesh me një sendë tjetër dhe posa të gjeshë ujë të pastrohesh me ujë. Kjo vërejtje e rreptë prej Allahut xh. sh. për Aishenë ishte vetëm për kaqë gjë por mendoni tani ju o besimtarë se çfar dënimesh kanë nga Allahu xh. sh. ata njerëz që nuk lahen krejtësishtë pas kontakteve bashkëshortore ose eksitimit. Vëllezër besimtarë ndërtesa e fesë Islame është e mbështetur në dy shtyllat kryesore; Teuhidi=njisimi i Zotit dhe Pastirimi. Këtu hynë, pastrimi trupit dhe i ambjentit për qark mjedisit ku rrimë ku jetojmë. Pjgamberi a. s. ka thënë: " Feja Islame është e mbështetur mbi pastërtinë; Pastërtia është pjesë e beimit Islam".

Gjithashtu besimtari duhet ta lajë vazhdimishtë trupin që mos ti vinjë era djersë. Muslimanët dhe muslimanet e kanë porosi nga profeti Muhamed a. s. që njëherë në 7 ditë çdo ditë Xhumaje=e Premte duhet ta laj trupin edhe nëse nuk është bër për tu la ose nuk ka punuar në punë me pluhur e baltë. Të presi thojt dhe ti mbajë pastër dhëmbët, ti pastroi gjithmonë që mos ti kundërmoi

goja aromë të keqe. Besimtari duhet ta mbajë pastër veshjen dhe vendin për qark ku rrin. Gjithshtu besimtarit duhet ti vië aromë e mir=aromë e këndëshme kudo që rrin. Vënja e aromës së morë është nga synetet=veprimet e gjithë pejgamberëve. Kur njeriut i ndihet aromë e këndëshme, kënaqen dhe engjëjt. Ndërsa shejtanët ose djajtë mallkuar qofshin shkojnë aty ku nuk ka pastërti dhe i dëmtojnë njerëzit. Duhet ta dimë se si çdo gjë tjetër dhe pastërtia ka një kufij, se pastaj në se e teprojmë, kalojmë në vesvese, bëhemi manjakë e harrojmë detyrat tjera. Për këtë gjë muxhedidja Aishe tha; Allahu xh. sh, mua ma bëri të qartë me anë të ëndërrës, se nuk duhet të bëhemi manjakë [vesvesë] pas larjes së rrobave që veshim dhe të veshjes së shtëpisë, kur në to nuk dëgjohet erë ose aromë e keqe, dhe nuk duken të zhulosura. Murshidja Aisheja, rahmetullahi alejha tregojë kështu; Më shfaqti Allahu xh. sh, me anë të rrujasë=ëndërrës, këtë pamje kështu: “Shikova veten time thoshte ajo që kishim disa rroba në dorë por që ishin të pastërta. Un nga merak i tepërt i shikoja me kujdes të madhë duke i kthyer herë në njërin anë e herë në tjetrën, duke i shikuar që të gjeja ndonjë shenjë pa pastërti tek ato. Lëshoja një rrobe e kapja tjetrën nga merak i tepërt. Në ato momente që po vepra kështu dëgjova një zë që tha: “Shikoni çfarë bën kjo nga merak i tepërt, sikur nuk ka më punë tjetër. Menjëher më doli gjumi thoshte ajo dhe ishte koha e namazit të sabahut=mëngjesit. Allahu xh. sh. me anë të kësaj rruaje më sinjalizoi se nuk duhet pasur aq shumë merak duke e tepruar, duke u bërë vesvese-manjake në çështjen e pastërtisë.

Vërtet sot gratë kudo në qytet e në fshat janë bërë me vesvese. Po shpenzojnë shumë duke blerë lloj llojë pluhurash e sapunash, dhe duke e shkuar të shumtën e kohës me larjen e rrobave dhe veshjes së shtëpisë. Pejgamberi a. s. ka thënë: “Njerëzit e fundit të dynjasë kanë me qenë shumë merakli-[vesvesë ose ndryshe manjakë] mbas pastërtisë së veshjes.” Vërtetë kjo gjë sot është fakt i pakundërshtueshëm. A nuk do të ishte më mirë që kohën e cila është flori thotë një fjalë popullore ta shkonin duke mësuar veten dhe duke edukuar fëmijët në rrugën e Zotit xh. sh. që mos të vuanin me fëmijët e tyre sikurse po vuajnë? ! Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha iu thoshte njerëzve se nuk është pastërti e plotë ajo lloj pastërti vetëm për tu dukur nga jashtë siç e bëjnë sot shumica e njerëzve por trupin nuk e mbajnë të pastër. Ata rrinë

xhunub, nuk lahen ashtu siç e kërkon feja Islame. Mikrobet më të dëmshme për njerzit janë ata që i dalin nga trupi njeriut gjatë kontakteve intime burrë e grua ose gruja me menstruacionet=me të përmujshmet. Këtu duhet të jetë shumë merakli gruaja dhe burri në çështjen e pastërtisë thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Allahu xh. sh. thotë: "O ju që besuat, nëse jeni xhunub [jeni bërë për tu larë] atëherë pastrohuni [lani gjithë trupin]." S. Maide. aj 6. Thuhet në një hadith të Pejgamberit a. s. se edhe toka i ankohet Zotit xh. sh. për njerzit që rrinë xhunub=me trupin të pa larë. Sipas një hadithi kudsij, Zoti xh. sh. i ka thënë asajë: Mos u mërzi mojt tokë se pa ardhur akoma tek un, do të vinë para tek ti. "Është fjala për pytjet dhe mundimet në natën e parë në varrë dhe gjithë jetën e varrit. Një rëzve që nukë dijnë, kjo që thash u duket çudi por besimtarëve po ju kujtoj ajete nga Kurani që në to thuhet; "E nuk ka asnjë send që nuk e madhëronë[nuk i bën tesbih] duke i shprehur falenderim Atij [Allahut] por ju nuk e kuptoni atë madhërimin e tyre..." S. Isra ajeti. 44. Në një ajet tjetër Allahu xh. sh. thotë; "Ne ia nënshtruam [Daudid] kodrat që sëbashku me atë bënin tezbih=e përmëndënin [Allahun xh. sh.], mbrëmje e mëngjes. S. Sad. aj. 18. Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë; "Ne bëmë që kodrat dhe shpendët të madhërojnë [të lavdrojnë=të bëjnë tezbih] së bashku me Daudin. Ne kemi mundësi [ta bëjmë këtë gjë thotë Zoti xh. sh.] dhe e bëmë. "S. Enbija aj. 76. Allahu xh. sh. thotë; "Juve [njerëzve] u është dhënë pakë dije. "Ndërsa në suren Nemël ajeti 66. Ai thotë; "Diturija e tyre [e njerëzve] arrihet [plotësohet] në botën tjetër. " Për aromat e këqija muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tregoi se ka marrë këtë vërejtje nga ana e melekëve=engjëjve. Ajo më tregojë kështu: Ishte një rastë tha ajo që un i bëra duart me vajguri dhe nuk i lava në atë minut. Ashtu si isha shtërngova napën=shaminë e kokës që më ishte zgjidhur dhe po pastroja në shtëpi. Pa pritur dëgojë këto fjalë me zë të hollë nga një melek=engjëll i cili më tha; "Laje këtë erën e vajgurit se nuk mund ta durojmë. " Dhe ishte pikërishtë meleku që rrin në krahun e djathtë ai që foli. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha me këto që tregonte vinte në dukje rëndësinë e madhe që i ka dhënë Allahu xh. sh. për besimtarët e tij pastërtisë dhe vënjes së aromave të mira. Besimtarit asnjëher nuk duhet ti vinjë erë ose aromë e keqe si nga trupi prej djersës dhe nga goja. Muxhedidja Aishe rahmet pastë e këndonte çdo vit Mevludin vetë

me gra. Përsa i takon rregullit të këndimit të Mevludit, Aisheja tha se mora këtë vërejtje prej Allahut xh. sh, duke qenë zjuar kështu; Mos e përqëndro vëmendjen tek zëri e melodija gjatë këndimit të Mevludit por kujdesohu mir në shkoqitjen e fjalëve, dhe mendohu se çfar thuhet aty. " Kjo kritikë vlen pa dyshim dhe për këndusat e Kuranit të mdhrueshëm..

Një rast në xhami në Durrës, Muxhedidja Aishe i bërtiti një gruaje nga Kavaja e quajtur Hatixhe që kishte pranuar urdhëresën për toben. Asajë i rrëshqiti goja e bëri shirk. Ajo e kuptoi gabimin që bëri por për ta lehtësuar pak veten i tha Aishes se për këtë gjë kam pyetur Hafiz Nexhipin dhe ai më ka thënë se nuk idhnohet Zoti xh. sh. se ka shumë emra tjerë. Në fakt ata janë mbiemra me të cilat cilësohet Zoti xh. sh. ishte fjala për esmaul husnatë] Un thoshte Aisheja i thash asaj: Emri Allahu xh. sh. që i themi në gjuhën shqipe Zoti xh. sh. është përmbledhës i gjitha cilësive tjera dhe për ne shqiptarët është i barabartë me emrin Allahu xh. sh.në gjuhën Arabe. Ti Hatixhe nëse do, kapu prapa xhybes hafiz Nexhibit dhe shko ku të shkojnë ata që të thonë ty ashtu. E mërzitur tha murshidja Aishe u ktheva në shtëpinë e sahabes=shoqes time Caje Mali po aty në Durrës. Muxhedidja Aishe i tha asaj se Hatixheja është e lëkundur nuk po qëndron në tobe. Ajo i merr fjalët tona çon adej, e të atyre i sjell këndeje, prandaj do ta largoj nga shoqërimi me ne. Shoqëja ime Caje më tha po edhe unë ashtu mendoj. Mirpo Allahu xh. sh. që di çdo gjë më solli mua këtë këshillë:"Mos i jep të shtymen=mos e largo ti atë [Hatixhen] se nuk është nga ata që nuk ka besuar se e kam futur në tobe pjesërishtë pasi nga shirkun e kam ndaluar, nuk më bën shokë Mua. Më parë ajo ka qenë terribël=e prapë. "Vërtetë për pranimin e tobës Allahu xh. sh. thotë : "Allahu ia pranon pendimin atij që do, se Allahu i di të fshehtat, me urtësi e zgjidh çdo çështje. "S. Tobe ajeti 15. =Kapitulli Pendim. Vërejtje ka marrë nga Allahu xh. sh. edhe Pejgamberi jonë a. s. Shembull kemi kur atijë i erdhi njeriu i verbët që kërkonte të dij për shpalljen e Allahut xh. sh. ndërsa Pejgamberi a. s, po bisedonte me disa njerëz nga të pasurit e Mekës. Allahu xh. sh, na tregon në Kuran ku thotë; "Ai vrenjëti [fytyrën] dhe u këthye [ktheu kurrizin] Ngase atijë i erdhi i verbëri. "E ku mund ta dishë ti ndoshta ai do të pastrohet do të këshillohet dhe këshilla do ti bëjë dobi. S. Abese. aj. 1, 2, 3, 4. Një tjetër vërejtje nga ana e Allahut xh. sh. për

mua thoshte murshidja Aishe erdhi, si pasojë e vrasjes nga un të disa insekteve, që më kishin hyrë në dollapin e bukës. Vërejtja erdhi në këtë mënyrë; "Aisheja disa i shpëton, e disa i vret. "Fjala ishte që ti njerëzit përpiqesh ti shpëtojshtë nga xhehenemi duke i largu nga rruga e gabuar ndërsa insektet i vret. Por të dy llojet e krijesave janë me shpirtë. Nga ky njoftim në formë çudije që më erdhi mua thoshte murshidja Aishe kuptohet që besimtarit nuk i lejohet me vra asgjë me shpirtë nëse ai insektë ose kafshë nuk paraqet rrezikë për jetën e njeriut. Duhet me përdor sa të jetë e mundur mjete tjera për ti mënjauar ose zhdukur fare. Nuk është e lejuar që ta djegësh çdo gjë me shpirtë. Për ta eliminuar miun duhet macja për atë punë. Ka leje nga ligji i fesë me vra ato kafshë që i bëjnë dëm njeriut, si qeni i tërbuar, ujku, gala e tjera, që paraqesin rrezikë për njeriun ose bëjnë dëme të mëdhaja. Muxhedidja Aishe më tregoi se un thoshte ajo e mallkoja çdo ditë dhe disa herë në çdo kohë të ditës komunizmin=Partinë Komuniste që më vonë u quajtë Partia e Punës. Një ditë afër drekës pasi mallkova si gjithmonë në mënyrë të përgjithëshme rregjimin komunist, për çudi dëgjova këtë kritikë prej anës së Allahut xh. sh. [nëpërmjet melekut] kështu: "Mjaftë më se kjo gjë kështu është vendosur." Murshidja Aishe rahmetullahi alejha e kishte pasur dikurë njërin vëlla të saj, Beqirin komunist të viteve 1943-44 dhe që kishte luftuar për çlirimin e vëndit nga fash-istët italianë e naziztët gjermanë. Beqiri kishte luftuar deri në Kosovë kundër fashizmit. Pasë luftës punoi disa kohë si kontroll rrugorë i veshur ushtarak, dhe tjetri vëllai i vogël Shaqiri në polici. Më vonë rreth viteve 1955 ata të dy i xhveshën nga uniforma ushtarake . Njëri pastaj punojë gjithë jetën muratorë e tjetri deri sa vdiq punoi shofer megjithëse entuziastë si dikur nuk ishin më për Partinë Komuniste por nuk pendoheshin plotësishtë që e kishin dashur komunizmin. Ata justifikoheshin duke thënë jo e dinim kështu e jo e dinim ashtu. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte kam vuajtur shumë me ata, sidomos me vëllain e vogël për arsye të ides komuniste që ata kishin në shpirt. Ata mua më shanin gjithmonë dhe më thoshin ti je reaksionare, je anti komuniste, të ka frymëzuar burri ytë kosovari Kurt Rama me iden antikomuniste. Un iu thosha atyre, nuk e kam dashur ndonjëherë dhe nuk e dua as fashizmin e as komunizmin dhe as ndonjë ide tjetër që nuk pajtohet me moralin fetarë Islam. Unë nuk

e kam dashur kurrë komunizmin dhe para se martohem me një njeri të zgjuar e anti komunistë si kosovari Kurt Rama. Por ju o vëllezrit e mi ju thosha atyre, ashtu si shumë të tjerë, shikuat yllin e morët pyllin për të kapur yllin por do ta shihni më vonë të vërtetën. Ju harruat që babai ynë luftojë kundër sërbevët dhe ata me që nuk e kapën që ta vrasin , na dogjën shtëpinë në Dibër. Ndërsa vëllezrit më thoshin se ata kan qenë sërbevët nacionalistë borgjezë, nuk kan qenë komunistë inernacionalistë, kurse tani neve na ka vëllazëruar ideja komuniste me njëri tjetrin. Jemi bërë vëllezër ideali dhe nuk do të luftojmë me njëri tjetrin. Kurse unë thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha u thosha atyre se sërbevët të gjithë një llojë janë, të djeshmit ashtu dhe të sotëmit e të ardhëshmit. Populli jonë thotë një fjalë të urtë kështu; Ujku qimen e ndërron, por zakonin nuk e harron. Vëllai më tha edhe fashistët neve na e dogjën shtëpinë përsëri këtu në Tiranë. Ndërsa unë tregonte murshidja Aishe i thash atij, që dhe italianët na pushtuan, dhe ata armiqë të vendit tonë ishin. Më kujtohet një herë rreth vitit 1945,-48, për shkak të ushqimeve që ishin me triska=rracion i kushtëzuar, unë harrova që ishte vëllai i vogël në shtëpinë time dhe shava komunizmin. Vëllai pa pritmas më goditi me pëllëmbë mbrapësh dhe më doli gjaku nga hudët cërril, dhe as që u pendua çfar bëri. Kaq të bindur, të vendosur dhe pa mëshirë për të mbrojtur idenë e tyre kanë qënë komunistët dhe zimpatizantët e tyre. Egërsija e tyre ishte e madhe sidomos më shumë në vitet e para pasi ata morën pushtetin në dorë, se sapo dolën nga lufta, thoshte muxhedidja Aishe që Zoti xh. sh, e mëshiroftë atë. Kjo ngjarje thoshte ajo ishte para se un të ngarkohem prej Allahut xh. sh. me shërbimin e Tobes. Allahu xh. sh. i mëshiroftë dhe i udhëzofhtë në rrugën e drejtë njerëzit që janë të padijshëm e që nuk e kanë humbur krejtësishtë besimin në Zotin xh. sh. Aq të rrebtë e të vendosur në idenë e tyre kanë qënë komunistët thoshte murshidja Aishe, sa që ata para shokëve të tyre nuk donin të dinin as për fisin e vet të afërt, për motrën e vëllanë si domos në kohën e luftës e disa vite pas mbarimit të saj. Muxhedidja Aishe thoshte se mu Allahu xh. sh. më kishte ngulitur në shpirtë urrejtjen kundër komunizmit që kur isha fëmijë. Dëgjoja nga më të rriturit se komunistët nuk besonin në Zotin xh. sh. ishin të pa mëshirshëm dhe rrenin shumë. Më vonë unë i pashë në praktikë punët e tyre thoshte ajo. Muxhedidja Aishe thoshte se Allahu xh.

sh. më kishte bërë besimtare të vendosur në fenë e Tij. Ai e kishte përgaditur shpirtin dhe mendjen time për shërbimin e thirrjes në Tobe që kur ishim fëmijë.

39-MUXHEDIDJA AISHE TREGOI PËR XHINDËT QË I KA PARË ATA. ALLAHU XH. SH. IA SHFAQI PAMJEN E TYRE NË=RRUJETU=DUKE QËNË ZGJUAR.

Sikurse e kam thënë më sipër fjala shfaqëje me anë të rrujasë do të thotë shqip pamje me anë të ëndërrës ndërsa fjala rrujeta do të thotë shikim duke qënë zgjuar. Për xhindët larg nga ne qofshin ata muxhedidja Aishe tregonte kështu; Një rast thoshte ajo kur un shkova për të lajmëruar për tobe në një fshat të Durrësit, gjeta aty një grua të sëmur e prekur nga xhindët, pasi i kishte shkelur ata. [Mesa më kujtohet mua shkruarit të librit ishte fshati Arapje por nuk e kam të shënuar emrin e fshatit. Nga përgjigjet që u jepte e sëmura xhinëve, thoshte muxhedidja Aishe, e kuptova që kishte shkelur xhindë të krishterë se ata i thonin puthe kryqin ndërsa ajo ju thoshte atyre nuk e puth kurrë kryqin tuaj dhe jua ofendonte keq kryqin. Un i këndova asaj Kuran, e ajo me mëshërinë e Zotit xh. sh. pas pak minutash, u ngrit, pasi ishte e shtrirë duke u përplatur për toke dhe foli këto fjalë, Zoti xh. sh. ty ta shpërbleftë se u qetësova. Për efektin që ka Kurani dhe për shërim Allahu xh. sh. i thotë Pejgamberit a. s. ; Ne ta shpallëm Kurantin që është ilaçë dhe mëshirë për besimtarët. "S. Isra. aj. 82. "Në ato çaste që po rrija duke bërë zikër, thoshte muxhedidja Aishe, mua ma zbulojë Allahu xh. sh, perden dhe mi shfaqti xhindët qofshin largë nga neve që unë ti shikoja. Ata visheshin me atë llojë veshje sikurse vishet populli atij qarku. Ata mua më kërcënuan se i këndova të sëmurës Kuran dhe i u luta për shërimin e saj Allahut xh. sh. Ata më bëlbëzuan nga inati, nga që rrija vazhdimishtë duke kënduar Kuran dhe me tespitë në dorë duke bërë zikër Allahun xh. sh. Njëra nga xhindeshat i tha me inat tjetrës : Nuk kemi çfar ti bëjmë asaj që rrin vazhdimishtë duke bërë bërr, bërr, bërr. Ajo e kishte fjalën për këndimin e Kuranit dhe zikrin që bëja un thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Mos çuditi o besimtarë se pa dyshim është fjalë e vërtetë kjo që tha muxhedidja Aishe.

Kjo gjë vërtetohet me Kuran e hadith. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: “Ti [o Muhamed] ishe në paqartësi dhe ne ta hoqëm perden dhe tani ti shikon shumë mprehët=shum hollë=qartë”. S. Kef. aj. 23. Në suren Isra aj. 45. Allahu xh. sh. thotë : “Kur ti lexon Kuran, mes teje dhe atyre që nuk e besojnë botën tjetër, [ne thotë Allahu] vemë një perde të pa dukëshme ”. Nga sa thash, kuptohet se sytë e njerëzve kan perde që mos ti shohin krijesat e pa dukshme. Për shfaqjet filmike para syvet duke qenë zgjuar kemi argument nga Kurani i madhërshëm. Ja çfar thotë Allahu xh. sh. : “Kur një parambrëmje iu çfaqën kuaj atij [Sulejmanit] të cilët kur ishin ndaluar rrinin gaditur në tri këmbë e ishin edhe shumë të shpejtë.”S. Sad. aj. 30, 31. Kurani tregon se Allahu xh. sh. ia shfaq kur të dojë, si të doi e kujtë të dojë nga njerëzit e Tij të dashur, ndonjë gjë kur dëshiron. Atëher Allahu xh. sh. ia hap perden atij njeriu ose po e themi ndryshe i hap Allahu xh. sh. frekuencat e syvet. Ka shumë thënje në Kuran se disa njerëz kur ka dashur Allahu xh. sh. i kan shiku engjëjt ose melekët duke qenë zgjuar. Shembullin e kemi kur erdhën engjëjt tek haz. Ibrahim i a. s. dhe e lajmëruan për lindjen e Is-hakut. Kurani tregon: “E gruaja e tij [e Ibrahimit] qeshi...e mjera unë tha ajo: A mos vallë kështu plakë do të lindë unë ? Kjo [tha ajo] me të vërtetë është një gjë e çuditshme. A mos vallë ti po çuditesh me caktimin e Allahut i than melekët= engjëjt. S. Hud. aj. 19. Gjithashtu kemi ngjarjen kur engjëjt kanë shkuar tekë Profeti Zekirja a. s. Të dy pejgamberët dhe grate e tyre i panë engjëjt të cilët u paraqitin në formën e njerëzve. Prandaj ju o besimtarë mos çuditi nga fjalë që tha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Allahu xh. sh. i përsërit kerametet kur do dhe tek ai njeri që Allahu xh. sh. do. Gjithashtu meleku ka ardhur tekë Pejgamberi ynë me pamjen e një njeriu. Atëher melekun e pane dhe shokët e tij që ndodheshin aty. Profeti Sulejman a. s. i ka shikuar e komanduar xhindët. Po ashtu xhindët dhe djallin e mallkuar i ka pa Pejgamberi jonë a. s. dhe disa shokë të tij që u ndodhën atë rastë aty. Atyre jua u çfaqti Allahu xh. sh. që ta dijnë sa i shëmtuar është shejtani i mallkuar e se qysh i bën hilet ai. Murshidja Aishe thoshte: Mos merri me xhindët larg nesh qofshin. Ata janë krijuar ndryshe nga njerëzit si nga brumi i krijimit, nga pamja qëllimet veprimet. Ata janë në kundërshtim me njerëzit dhe i dëmtojnë ato. Xhindët janë shumë gënjeshtarë. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran thotë: “ O grumbulli i xhindëve; ju mashtruat shumë njerëz...S. Ali Imran.

aj. 44. Për tu mbrojtur nga ata duhet që vazhdimisht të këndojmë Kuranë. Duhet të mos harrojmë se shejtani mallkimi qoftë mbi të përgjithmonë, është nga rraca e xhindëve tregon Allahu xh. sh. në Kuran. Xhindët dhe shejtanët=djajtë e mallkuar futen tek njerëzit që i gjejnë xhunub të pa pastër nga trupi, nga shpirti ose i gjejnë të pa mbrojtur me Kuran. Ata veprojnë në trupin dhe mëndjen e njeriut dhe kur ata e prekin njeriun në trup në fillim njeriu nuk i ndjen dhe nuk i dëgjo ata. Por më vonë ai i vuan pasojat e veprimit të tyre. Mënyrën se qysh ata veprojnë në trupin e njeriut pa e ndjerë dhe pa e kuptuar njeriu, këtë gjë e di vetëm Zoti xh. sh. Ne për të kuptuar pak, po marrim shembull njeriun dhe pultin e televizorit. Njeriu duke qenë disa metra larg, pa e prekur realishtë me dorë televizorin, ai ndizet dhe fillon programin që ka, të flasë ose të këndojë. Ashtu sikurse rrezet e pa dukshme që dolën nga pulti që pati në dorë njeriu dhe ndikuan tek televizori duke e vënë në veprim atë pa e prekur relisht me dorë, ashtu dhe xhindët e shejtanët që janë të pa dukshëm, veprojnë tek njerëzit me mynyrat e tyre që ju ka dhënë Allahu xh. sh. dhe njerëzit nuk i ndjejnë. Ata i prekin njerëzit e iu hynë edhe në trup ashtu sikurse hyn korenti elektrik. Njeriu realishtë ashtu sikurse nuk e sheh rrymën elektrike, por e ndjen veprimin që bën ai në trupin e tij, ashtu dhe xhindët e shejtanët larg qofshin nga ne, njerëzit në përgjithsi nuk i shikojnë por e ndiejnë veprimin e tyre në trup. Disa njerëz të veçantë i kan shikuar ata e i kan dëgjuar bisedat e tyre sikurse e tregova rastin më sipër. Allahu xh. sh. na ruajt nga sherri=e keqëja e xhinëve dhe djajve=shejtanve. Për tu ruajtë nga e keqëja e xhinëve e shejtanëve duhet me e mbajtë trupin pastër e ti lutesh vazhdimisht Allahut xh. sh. me fjalët : “Eudhu bil lahi minesh shejtani rraxhijm”, që Ai të ruaj. Të falësh namazë e të këndosh vazhdimishtë Kuran se Allahu xh. sh. i ruan besimtarët.

**40-SHFAQËJE FILMIKE, KERAMETE DHE LAJME TË
TJERA QË IU DHANË PREJ ALLAHUT XH. SH.
MUXHEDIDES AISHE rahmetullahi alejha.**

Murshidja Aishe tha: “Më shfaqti Allahu xh. sh. në ëndërr në kohën e sabahit hazreti Isain a. s. i cili ishte i kuq në fytyrë

si- kurse kuqet njeriu që del nga banjo me ujë të nxehtë. Flokët ai i kishte të shkurtër ashtu sikurse njeriu që e qeth kokën krejtësishtë. Pejgamberi a. s. ka thënë; Ëndrrat e besimtarëve të devotshëm janë të vërteta. Ata janë 1\46 e deri 1\70 pjesë e profetësisë. Ai ka thënë; E kam parë rruja Isain, Musain dhe Ibrahimin. Isai ishte lëkurë bardhë, ndërsa Musai ishte zeshkan..." Trasmetojë imam Ahmedi nga Ibni Abasi e Xhabiri r. t. a. Aisheja thoshte se Allahu xh. sh. më njoftoi mua para se të fillonte lufta mes arabëve dhe izrailitëve. Duke qenë zgjuar dhe po fshija oborrin e shtëpisë në atë kohë Allahu xh. sh. më ngrii e më çoi fizikishtë=me gjithë trup për pak kohë në Palestinë për ti parë me sy, istikamet ose fortifikatat që kishin luftuar në atë vendë dikurë të dashurit e Allahut xh. sh. Un i pashë ato pozicione luftimi dhe mua mu dukë për momentin sikur isha në ëndërr. Por Allahu xh. sh. me anën e një meleku më njoftoi kështu; " Ty [Aishe] tu duk sikur ishe në ëndërr, por ti ishe atje në realitet. [me gjithë trup] dhe sikur para gjysëm ore ty të kërkonte dikush në shtëpi; ti nuk ishe aty. Të çuam ty atje [në Palestinë] që ti shikosh ata vende se së shpejti atje do të ndizet një luftë e cila do të vazhdojë gjat" Kjo ngjarje tha ajo më ndodhi në vitin 1964. Ajo që thotë muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha nuk është gënjeshtër e as çudi se në Kuranë tregohet për profetin Sulejman a. s. dhe ushtrinë e tij që e ngrente Allahu xh. sh. me anë të erës dhe për një gjysëm dite ecte sa për një muaj rrugë me këmbë. Më qartë për udhëtimin e njeriut me fuqinë e Zotit xh. sh. , në një vendë të largët, për pakë çaste na e tregon Allahu xh. sh. në Kuran me këtë ajet kështu; " Pa të meta është lartëmadhëria e Atij që njeriun e vet e kalojë në një pjesë të natës prej mesxhidi haramit- prej Qabes deri në mesxhidi Aksa...; Për ti treguar atij disa nga argumentet tona...S Isra Aj; 1. Gjithashtu kemi ardhjen e fronit të Belkizës nga Jemeni tek Sulejmani a. s. në Palestinë e tjera. Kurani thotë: " ...Çështja e mrekullive është në duar të Allahut. "S. Ankebut. aj. 50. Shum dijetarë Islam në botë duke u bazuar në Kuranë e Hadithë kanë thënë se mrekullitë e pejgamberëve dhe kerametet e evlijavet janë të vërteta. Edhe dijetari ynë i njohur Hafiz Ibrahim Dalliu në librin e tij thotë se mrekullitë e pejgamberëve dhe kerametet e evlijave janë të vërteta. Hafiz Ibrahim Dalliu thotë se mundet që një evlija= miku i Allahut xh. sh. ta bëjë një rrugë të gjatë në pak çaste ose të eci mbi ujë me fuqinë e Allahut xh. sh. ose të paralajmroi ndonjë

të kënaqësive vetëm të kësaj bote, Allahu xh. sh. në Kuran thotë : “Kush dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne [thotë Allahu] ja japim por në botën tjetër nuk ka hise= nuk ka pjesë. ”S. Shura. ajeti. 20. Muxhedidja Aishe rahmet pastë tha; mora nga Allahu xh. sh. këtë lajm kështu; ”Nëse çereku i popullit [njëzetë e pesë përqind e popullsisë] të kishin bërë tobe, do të jua ndryshoja atyre situatën [gjëndjen politike]. Pra ishte fjala se Allahu xh. sh. do ta ndryshonte situatën politike në Shqipëri me shkaqet dhe shkaktarët që donte Ai ”. Kurani thotë; ”Allahu çdo ditë është i zënë =[i prokupuar ose i angazhuar] me çështje të reja. ”S. Rrahman=kapitulli Mëshirusi. Aj. 29. Gjithashtu në Kuran thuhet: “ Allahu nuk ia ndryshon gjendjen [e jetesës] një populli për deri sa ata të ndryshojnë veten e tyre=të përmirësojnë veten e tyre. ”S. Rrad. Por siç e thash më sipër pupulli ynë në përgjithësi me përjashtim të disa njerëzve të rrallë nuk bani tobe edhe se 75 përqindë e popullsisë e dëgjuan këtë lajmë të posaçëm që ju erdhi prej Allahut të madhërshëm nëpërmjet muxhedides Aishe qoftë i kënaqur Allahu xh. sh prej asajë. Çdo ditë e më shumë populli largohej nga rruga e Allahut xh. sh. nga feja e tijë. Të persekutuarit nga rregjimi komunist që kishin qënë të pasur i humbën shpresat nga Allahu xh. sh. Ata ranë në pesimizëm. Aq tepër u dëshpruan nga humbja e pushtetit e ofiqeve, pasurisë dhe pronave, që edhe se e pësuan kështu nga që dolën nga rruga e Allahut xh. sh. u larguan akoma më shumë nga feja. Atyre nukë ju vinte ndërmendë që ti përuleshin Allahut xh. sh. me kokën në sexhde e ti luteshin Atij duke qa shumë e duke qeshur pak. Për të tillë njerëzish të pa bindur Allahu xh. sh. thotë në Kuranë ; ” Ne i sprovuam ata me denim por ata nuk ju përulën Zotit të tyre e as nuk iu drejtuan me lutje. ” Sure. Mu’minunun. A. 76. Allahu xh. sh. gjithashtu thotë: “E nëse ata [njerëzit] i godet ndonjë e keqe për shkak të veprave të tyre [të këqia] atëherë ata e humbin shpresën. ”S. Rum. aj. 36. Ndërsa klasa e varfër në Shqipëri u përkrah nga Partia e Punës me Enver Hoxhën në krye i cili i ngriti lart ata. Të varfërit me përkrahjen e ledhatimet që ju bëri rregjimi komunist, u bënë aq shumë optimista e u azdisën aq shumë sa që një pjesë e madhe e tyre e mohuan fare Zotin xh. sh. kurse pjesa tjetër e harruan. Për këto njerëz të këtyre dy llojë kategorive, Allahu xh. sh. në Kuran thotë; ” E kur e begatojmë njeriun [me të mira] ai prapësohet dhe largohet [nga feja e Zotit] i

mashtuar e kur e godet e keqëja, ai e humbë shpresën. ” Për rastin tonë këtu në Shqipëri ata që u prapësuan [morën për së koti] u larguan nga feja ishin njerëzit e përkrahur nga rregjimi komunist dhe ata që humbën shpresën nga Zoti xh. sh. ishin të persekutuarit nga ky rregjim të cilët u horrladisën shumë keq. As njëra klasë e as tjetra nuk ishte në rrugën e Zotit xh. sh. Kjo ishte e vërteta. Prandaj duhet ta themi të vërtetën që ta dinjë brezat e ardhëshëm.

45-MUXHEDIDJA AISHE MORI NJOFTIM PREJ ALLHUT XH. SH. PËR XHUXH-MEXHUXHËT. Ç’JANË JEËXHUXH E MEËXHUXHËT ?

Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “...Derisa të hapet=të hiqet penda [pengesa] e jeëxhuxhë maëxhuxhëve dhe ata të zbresin nga çdo bregore me shpejtësi...S. Enbija. Aj. 96.

Fjalët jeëxhuxh dhe meëxhuxh nuk janë fjalë arabe dhe për rrjedhojë nuk dihen nga askush në asnjë gjuhë se çfarë kuptimi kanë këto të përkëthyer drejtë për së drejti. Shumë dijetar të fesë nëpër botë, për shumë gjëra që fliten në Kuranë në mënyrë metaforike kanë dhënë medime të ndryshme. Kështu dhe për jexhuxh mexhuxhët kanë thënë fjalë të ndryshme. Disa kanë thënë se jexhuxh e mexhuxhët janë njerëz e disa të tjerë kanë thënë se janë kafshë që do të shihen me sy nga njerëzit në kohën që do të dalin dhe ata do të pinë ujrat. Kurse Aisheja muxhedidja e fundit e shekullit të njëzetë, me njoftimin që ka marrë prej Allahut xh. sh. e ka sqaruar qartë këtë çështje. Ajo tha se Allahu xh. sh. mi shfaqti mua para syve jeëxhuxhë e meëxhuxhët duke qënë zgjuar në momentet që isha një ditë duke ecur rrugës në qytet. Një rastë në rrugë para meje po ecte një grua e pa mbuluar që kishte mbathur një palë sandale me taka të ngritura dhe kishte veshur një fund të ngushtë e të shkurtër që i dukeshin gjunjët. Ajo ecte duke përdredhur trupin majtas e djathtas dhe shikonte veten me bishtë të syut në xhamat e vitrinave të dyqaneve. Në ato momente që ajo gruaja po ecte ashtu, mua tha muxhedidja Aishe, ma hoqi Allahu xh. sh. perden dhe më shfaqti një krijesë të pa parë ndonjëherë e cila më tepër ia përngjaste qenit por nuk ishte tamam ashtu. Kjo krijesë ecte me dy këmbët e prasëme ndërsa dy këmbët e para që dukeshin dhe si duar i mbante të ngritu-

ra paralel me gjokësin dhe ecte ngjitur sëbashku me këtë gruan, duke qëndruar në anën e djathtë të saj. Kur po shikoja këtë pamje tha Aisheja, në veshin tim u dëgjuan këto fjalë që një zë më tha; "Kjo gruaja është dexhale, dhe kjo krijesa në krahun e djathtë të sajë është xhuxhë meëxhuxhi." Zejnebja gruaja e Pejgamberit tonë a. s. ka treguar kështu; Ajo ka thënë : Një ditë Pejgamberi a. s. erdhi me nxitim dhe posa hyri në shtëpi i mërziur e i skuqur në fytyrë tha; la il lahe il lallah, mjerë për sherrin që i është afruar arabëve. Sot është hapur pënda=pegesa e jeëxhuxhë e meëxhuxhëve dhe i bëri dy gishtat e parë në formë rrethi. Zejnebi r. t. a. thotë unë i thash: O i dërguari i Allahut, a do të shkatërrohem derisa në mesin tonë ka njerëz të mir ? Pejgamberi a. s. tha; Po nëse shtohet e keqëja." Trans Buhariu dhe Muslimi. Hadithi sahi.

Nga ky hadithë që tregon Zejnebja r. t. a. kuptohet se jexhuxhë meëxhuxhët kanë filluar të dalin që në kohën e Pejgamberit a. s. dhe nuk mundet ti shohin gjithë njerëzit. Ata ja ka çfaqur Allahu xh. sh. njerëzve të Tij të dashur. Për origjinën e jeëxhuxhë meëxhuxhëve tregohet ky hadith nga Buhariu në librin Fet-hul Kadir e Fet-hulbari i dijetarit të njohur Askalaniu që ka treguar se Pejgamberi a. s. ka thënë; "Origjina e jeëxhuxhë e meëxhuxhëve është nga bashkimi apo kryqëzimi i farës së Ademit=farës së njeriut me xhindët." Askalaniu e shtjellon hadithin duke thënë: Ademi është eksituar [është bërë xhunub] në gjumë dhe spermën=farën e tij mashkullore e kanë marrë xhindët. [Pra e kanë mbjellë atje ku ata kanë dashur vetë.] Trans Ibni Kethiri. Shembull kemi veterinarët që ndërzejnë lopët me gjilpanë. E sa për marrëdhënjet seksuale mes krijesave të ndryshme që shihen me sy kemi bashkimin ose kryqzimin e lopës me gomarë që del lopë mushkë dhe të gomarit me pelë që lind mushka. Kemi tre lloje eksitimesh kur njeriu bëhet xhunub për tu larë; 1 Në realitet, 2 në gjumë dhe 3 me imagjinat. Eksitimi në gjumë ose zgjuar me mendim apo imagjinatë në atë që nuk e ke hallall, është haram=e ndaluar dhe vjen nga ndërhyrja e djallit të mallkuar. Përsa i takon ndërhyrjes së shejtanit ose ndryshe djallit të mallkuar, Pejgamberi a. s. ka thënë; " Cili njeri bën afrim-marrëdhënie intime me gruan e tij dhe nuk thotë Eudhubilahi mineshejtani rraxhim duhet ta dijë se në aktin seksual me gruan e tijë merr pjesë dhe djalli i mallkuar lanetullah." Trans. Buhari, Muslim e tj. Ndërsa Allahu xh. sh. në Kuran thotë; "Aty

[në xhenet] janë ato [gra] që përqëndrojnë shikimet e tyre [vetëm ke burrat e vet] dhe që nuk i ka prekur kush para tyre, as njerëz, as xhin ". S. Rrahman=kapitulli Mëshirusi. ajeti. 56. Nga ky ajet Kurani kuptohet që dhe xhindët prej të cilëve është shejtani lanetullah ose shejtanët mallkuar qofshin, e kanë mundësinë të kontaktojnë nga ana seksuale me njerëzit, që janë krijesë jashtë llojit të tyre. Shumica e mufesirave= komentatorëve të Kuranit janë të mendimit se Belkiza njërin nga prindërit e kishte nga rracat e xhindëve. Trans Ibn Kethir. Allahu xh. sh. e di të vërtetën se qysh dhe si. Nga fjala e Pejgamberit a. s. në hadithin që tregoi gruaja e tij Zejnebja rahmetullahi alejha e nga sqarimi që na bën muxhedidja e shekullit të njëzetë murshidja Aishe vërtetohet plotësisht se xhuxh maxhu xhët nuk janë njerëz e as kafshë që shikohen me sy nga njerëzit, por janë të pa dukshëm sikurse xhindët. Vetëm Allahu xh. sh. e di si dhe me çfarë brumi i ka krijuar ata. Kurani thotë; "Allahu krijon çfarë ju nuk dini ". S. Nahl. aj. 8. Në Kuran përmendet fjala pendë. Kjo fjalë ka dhe kuptimin pengesë. Allahu xh. sh. thotë; "Derisa të hapet [penda=pengesë ose perdja] e jehxh mexhuxhëve dhe ata të zbresin nga çdo bregore me shpejtësi ". S. Enbija. aj. 96. Pra sikurse e lexoni ajetin e Kuranit thuhet; kur të hapet [pënda] e jo kur të shëmbet [pënda ose pengesa] Nga kjo gjë kuptohet se sytë e njerëzve kanë perde-pengesë dhe nuk mundet ti shikojnë gjërat e fshehta. Atyre njerëzve që ka dashur Zoti xh. sh. ju ka hapur perden=ju ka hapur frekuencat e syve. Shembull për tu kuptuar po marrim televizorin. Kanale tjera merr televizori me antenë satelitore dixhitale, dhe ndryshe merr pa antenë satelitore. Televizorët të një lloji janë. Për perden e pa dukëshme flet Allahu xh. sh. në Kuran dhe i thotë Pejgamberit a. s. kështu; "Kur ti lexon Kuran, mes teje dhe atyre që nuk besuan botën tjetër vëmë një perde të pa dukëshme. "S. Isra. aj. 45. Shembull për këtë gjë kemi njeriun që i hiqet perdja, i zbulohet e vërteta në momentet që është duke i dalë shpirti. O ju që e quani veten të ditur, mos e kundërshtoni të vërtetën që thotë muxhedidja e fundit në botë murshidja Aishe rahmetullahi alejha se ajo nuk ka folur nga mendja e saj por Allahu xh. sh. e lajmëroi atë për të jua bërë të qarta njerëzve disa çështje të fesë që ata i kishin kuptuar gabim.

46-MUXHEDIDJA AISHE MORI LAJMIN PREJ ALLAHUT XH. SH. PËR ARDHJEN KIJAMETIT = KATAKLIZMËS-FUNDIT TE BOTËS.

Në Kuran Allahu xh. sh. thotë; Nuk ka asgjë të fshehur në qiell e në tokë që të mos jetë e shënuar në librin e saktë [në dijen e Zotit xh. sh.] S. Nemël. aj. 75. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha tha se kam marr këtë lajm prej Allahut xh. sh. kështu : "Lajmëtarja e fundit për Tobe je ti dhe shekull tjetër pas këtij shekulli [shekullit të njëzet] nuk ka më ". Është fjala shkon disa vite bota në shekullin e 21 njëzetë e një aqë sa do Allahu xh. sh. dhe Ai do ta shkatërroi atë. Vërtetë për dijen e këtij sekreti të kohës së kijametit na lajmëron Allahu xh. sh. në Kuranë i cili thotë : "Thuju [njerëzve ti o Muhamed] unë nuk e di a do të jetë afër ajo që ju premtohet [kijameti] apo Zoti im do ta vonojë atë shumë, Ai [Allahu] është që e di të fshehtën por fshehtësinë e vet [sekretin e tij] nuk ia zbulon askujtë me përjashtim të ndonjë të dërguari që ai do ". Sure Xhin Ajeti 25, 26, 27. Vërtet jeta e njerëzve në tokë filloi pasi çifti i parë i njerëzve bëri Tobe dhe po kështu pas thirrjes së fundit për të bër tobe = pendesë, do të largohen njerëzit prej kësaj bote të cilët janë pasardhësit e Ademit e të Havës paçin selam. Eshtë krejtësishtë e qartë se thirrja për të bërë tobe është thirrja e fundit për ata që kuptojnë. Pa dyshim Aisheja është muxhedidi i fundit që erdhi para kijametit për ti thirr njerëzit në Tobe=në Pendesë që të rikthehen në rrugën e drejtë që ka përcaktuar Allahu xh. sh. në Kuran të cilën e ndoqi Profetii ynë Muhamedi a.s. dhe pas shekullit të njëzet nuk ka më shekulli tjetër veç disa vite. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha : "Një ditë Allahu xh. sh. më çfaqti mua në ëndërr këtë pjesë të vogël filmike mes gjumit e zgjimit të filmuar nga engjëjt. Ishte koha e sabahit dhe unë shikova Pejgamberin a. s. përballë me gruan e tij Aishen r. t. a. i cili i tha asaj këto fjalë: "O Aishe: Një grua me emrin tëndë Aishe do ta dërgoi Allahu xh. sh. në fundin e botës për ti thirrur njerëzit në tobe. Për këtë gjë le ti shikojnë mirë muhadithat fjalët e Pejgamberit a. s. se ndoshta do ti gjen fjalët që i tha Pejgamberi a. s. gruas së tij Aishes r. t. Të shikojnë hadithet që ka transmetuar haz. Aisheja r.t.a.

Një nga emrat e ndryshëm me të cilët thirret kijameti është emri ose mbiemri "Dita e premtuar=Ajo që ju premtohet" S. Dhariat.ajet 5 e 6. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se në lidhje me kijametin Allahu xh. sh. më lajmëroi mua kështu: "Do ta kishim bërë me kohë kijametin, [do ta kishim bër më parë] por e kishim planifikuar që të dërgoja ty [Aishe] me shërbimin e thirrjes [së ymetit të Muhamedit] në tobe. " Pejgamberi a. s. ka thënë; "Nëse kijametit i ka mbet edhe një ditë për tu bër, Allahu xh. sh. atë ditë e zgjatë disa vite..."Trans Buhariu, Muslim e tjer. Hadithi sahi=i vërtetë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se për çshtjen e kijametit Allahu xh. sh. më njoftoi mua se tani ka ardhur koha për tu bër kijameti. Së pari më shfaqti Allahu xh. sh. në ëndërr diellin duke lindur atje ku perëndo. Ishte tepër tronditëse kjo gjë thoshte ajo. Kur u ngrita nga gjumi tha Aisheja unë thashë me vehten time; O Zot i madhërshëm: Ne [besimtarët] kemi dëgjuar se para se të bëhet kijameti nuk do të shtohen më as njerëzit e as kafshët. Allahu xh. sh. thoshte ajo më njoftoi kështu: "Po është e vërtetë ajo gjë por ju nuk e kuptoni që shtesa e njerëzve është paksuar dhe shtesa e kafshëve është paksuar se Un i kam paksuar lindjet." Pa dyshim kjo është fjalë e vërtetë prej Allahut xh. sh. Vërtetë ne sot po e shohim vetë me sytë tonë që lindjet janë paksuar. Gratë nuk lindin më shumë fëmijë dhe një pjesë nuk lindin fare fëmijë. Po ashtu edhe shtesa e kafshëve është paksuar si pasojë e ikjes së njerëzve në masë nga fshatrat në qytete. Murshidja Aishe nuk kishte fëmijë. Ajo thoshte kështu: Një ditë thoshte kishim thirrur për festën e dashur të Mevludit disa gra besimtare. Pas këndimit të Mevludit gjat bisedës gratë me njëra tjetrën, filluan të lavdrohen me fëmijët e tyre se shpresonin tek ata. Dikush nga gratë ju tha me keqardhje shoqeve të saj këto fjalë: Më vjen keq për Aishen e cila qenka harxhuar shumë se kjo nuk ka fëmijë që të punojë e ne kemi dhe fëmijë që ponojnë. Un i dëgjova këto fjalë tha Aisheja gjatë hyrjes në dhomë tek po ju shërbeja. Kur ikën ata mua më shkoi mendja tek fëmijët që sikur të kishim pasur dhe un fëmijë. Allahu xh. sh. që di çdo gjë që i shkon ndërmendë njeriut më solli këtë lajm: "Ti [Aishe] mos u dëshpro se nuk ke fëmijë se fëmijët e kohës së sotme nuk janë të hajrit [të dobishëm] se po të ishin ata të mir ose do të jepsha ty fëmijë ose nuk i jepsha askujt por fëmijët e kohës së sotme do të përplasen me valët tronditëse të kijametit ". Ishte fjala se fëmijët

duke mos qenë të edukuar me edukatë fetare, do të jenë në përgjithsi të prishur nga morali : Të pa sinqertë, pa ndërgjegje të pastër dhe pa turp. Intrigantë, alkolistë, gënjeshtarë dhe jo të bindur e respektues ndaj prindëvet. Ishte fjala se janë të pa dobishëm për prindët e tyre. Fjala ishte për fëmijët e lindur pas vitit 1944, të cilët do të përplaseshin me valët tronditëse të kijametit ndër të cilat janë: Imoraliteti, alkolizmi, gënjeshtria, mos bindja ndaj prindëve, pa drejtsija, ndarja nga fisi, tradhëtija, kurvërija, pa besija, bërija keq tjetrit e tjera. Kjo gjë u vërtetua në përgjithësi me brezin e fëmijëve që urritën pa besim tekë Zoti xh. sh. pas vitit 1944. Për këtë gjë ka paralajmëruar 1430 e ca vite më parë mësuesi i madh i njerzimit më i dashuri i Allahut xh. sh. hazreti Muhamedi a. s. i cili ka thënë : “Fëmijët e kohës afër kijametit nuk do të jenë të dobishëm për prindërit e tyre”. Lajmi që mori prej Allahu xh. sh. muxhedidja Aishe u vërtetua. Vërtet fëmijët që lindën pas vitit 1944, kudo, në përgjithësi, më shumë ju dhanë mundime, se ndihmë e lehtësi prindëve të tyre. Ndërsa fëmijët që lindën pas vitit 1984, dyzet vjet më prapa, për të cilët do të flasim në kapitullin 80, vetëm se vuajtje e mundime po ju japin sot prindëve të tyre në përgjithësi. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se Allahu xh. sh. më lajmëroi mua që tu jap prindëve këtë njoftim nga Ai kështu: “Thuaju ti atyre [prindëvet] Nëse nuk do ti mësojnë fëmijët e tyre të më njohin Mua [të më binden Mua] dhe Un do ti bëj ata që mos tu binden atyre”. Një grua besimtare e pyeti muxhediden Aishe në vitin 1959 kështu: A do ti zëjë kijameti fëmijët tanë që ne kemi bërë tobe ?. Aisheja tha se nuk kaloi vetëm se pak kohë dhe nga Allahu xh. sh. mora këtë lajm: “Ata burra e gra që kanë bërë tobe, do tua marrë shpirtat bashkë me fëmijët e tyre para se të vië kijameti”. Një rast një grua besimtare e quajtur Hasibe i tha murshides Aishe që ti bënte një lutje Allahut xh. sh. për vajzën e saj Fitneten e cila nuk kishte fëmij që ti jepte Allahu xh. sh. asaj fëmij. Un thoshte muxhedidja Aishe i bëra lutje Allahut xh. sh. por mora këtë përgjigje duke qenë zgjuar; “Thuaj atyre [çiftit] le të rrinë [le të durojnë] ashtu sikur janë”. Sikurse e thash më sipër muxhedidja Aishe tha se Allahu xh. sh. më lajmëroi duke qenë zgjuar kështu: “Lajmëtarja e fundit për tobe je ti dhe shekull tjetër pas këtij shekulli [shekullit të 20 njëzetë] nuk ka më”. Është fjala që në shekullin e 21 njëzet e një, pak vite do të kalojnë dhe Allahu xh. sh. do ta shkatrojë këtë botë. I vërtetë është ky lajmë se Allahu xh. sh. i ka thënë profetit Muhamed a. s. kështu: “Thuaju [o Muhamed atyre që të pyesin] Un nuk e di se a do të jet afër ajo që ju premtohet [kijameti] apo Zoti im do ta vonojë atë shumë. Ai është që e di të fshehtën por fshehtësinë e vet nuk ia zbulon askujt me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do... Sure Xhin. Ajetet 25, 26 dhe 27. Lajmi që thotë muxhedidja Aishe është prej Allahut xh. sh. pa dyshim.

Allahu xh.sh. ju bëri thirrje njerëzvet për her të fundit bëjnë të pendohen. Të largohen duke largohen nga falët veset dhe veprat e liga. Për vërejtjen e fundit para kijametit Allahu xh. sh. ka paralajmruar në Kuran në fillim të sures Nahl kështu: “Erdhi [është afruar] caktimi [vendimi] i Allahut [kijameti], pra mos kërkoni ngutjen e tij [duke bër punë të liga] E pastër dhe e lartë është madhërija e Tij, në krahasim me atë [gjë] që ata [njerziti] i shoqërojnë [i bëjnë shokë]. Me urdhërin të Tij, [Allahu] ia zbret engjëjt me shpallje [me komunikatë =me njoftim të posaçëm] atij që dëshiron nga njerëzit e vet [burrë ose grua duke i thënë atij]; Tua tërhiqni vërejtjen [ti njoftoni njerëzit] se nuk ka të adhuruar [Zot] tjetër vetëm Unë [jam], Pra të më kenë frikën. ”-[Të frikësohen nga Unë [të largohen nga punët e liga=të bëjnë Tobe]. ” S. Nahl. aj. 1- 2. Tani vëllezër besimtar jemi në çastet e fundit afër kijametit=shkatërrimit të kësaj bote. Allahu xh. sh. në Kuran ka paralajmruar indirekt=me nënkuptim se fundi i botës=kijameti do të vinjë atëherë kur zhvillimi shkencor material në tokë të ketë arritur kulmin. Pra kur bota të ketë arritur kulmin e qytetimit. Allahu xh.sh. thotë: “...Kurë toka të ketë marrë stolinë e vet [zbukurimin e saj të plotë të lloj llojshëm] dhe banorët e saj [njerëzit] të mendojnë se janë sundusat e sajë [janë të aftë e kopetentë për çdo gjë] =atëher asaj [tokës rruzullit toksor] i vjen urdhëri ynë [vjen vendimi im thotë Allahu xh. sh.] natën ose ditën dhe Ne [thotë Allahu xh. sh.] e bëjmë atë [që është mbjellë [që është ndërtuar e zbkuruar] sikur të mosë ekzistonte dje [të mosë kishte ekzistuar fare] ”. S. Junus. aj. 24. Shenjat e kijametit që ka paralajmruar Pejgamberi a.s. kan dalë të gjitha.Ne po i shohim ato në çdo vendë çdo ditë. Kan mbetur pa dal dy shenjat e mëdhaja që thotë Kurani. 1-zbritja e Isait a. s. në tokë dhe 2- lindja e diellit nga perëndimi. Pejgamberi a. s. në një hadithë ka thënë; ”Kur të humbasi dëshmija=shehadeti atëherë vjen kijameti. ”Kuptimi i saj është: Kur të humbasi domethënja, rëndësija e fjalës La il lahe il, lallah=nuk ka tjetër Zot veç Allahut xh. sh. atëherë vjen shkatërrimi i përgjithshëm i botës. Me të vërtetë sot fjala e Teuhidit=Njisimit=Është një Zot=Nuk ka tjetër Zot veç Atij e ka humbur sot rëndësinë dhe domethënjen e sajë. Një pjesë njerëzish, nuk e thonë se nuk besojnë këtë fjalë, një pjese nuk u bie fare ndër mend që ta thonë se i ka hutuar dynjaja dhe pjesa tjetër nga besimtarët e thotë në gjuhën arabe dhe e kundërshtojnë përsëri në gjuhët e tyre

kombëtare, si shqipe, maqedonishtë e tjera gjuhë, duke thirrur njeriun estagfirullah, Zoti, ose i Zoti, Zotni, Zotohem, Zotnesh ose Zonjë, Zotnjush ose Zonjush estagfirullah. Allahu xh. sh, thotë në Kuran: “Myzhide [lajm i gëzushëm] për besimtarët për ata që thanë, Allahu është Zoti jonë dhe qëndruan [në këtë fjalë] besnikërishtë. [nuk e mohuan këtë thënje as me shpirtë e as me gojë]. S. Ahkaf. aj. 13. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha: Një ditë më shfaqti Allahu xh. sh. një grua shkenctare astronome që po merrej me vrojtime në hapsirën qiellore. Në ato momente që ajo po shikonte në teleskop qiellin menjëher e tmerruar bërtiti, au. u. u. vetëm kaq. Murshidja Aishe tha: Mesa kuptova un ajo shkencëtarja shikoi çrregullime në sistemin planetarë dhe u trembë shumë. Kush të dojë që të shpëtoi nga dënimi i Allahut xh. sh. në këtë botë dhe në tjetrën, menjëherë të largohet nga shirku me gojë e pastajë të filloi namazin duke u larguar nga të gjitha veprat e liga që kemi treguar më sipër. Pejgamberi jonë a. s. ka thënë: “Mjerë për ymetin tim [për popullin=për njerëzit] pas vitit 1200. Vërtetë si me kalendarin musliman hënorë hixhri ashtu dhe me kalendarin diellor kristian fjala e Pejgamberit=Muhamedit a. s. është vërtetuar tamam. Këtë fjalë pejgamberi a. s. e ka thënë në shekullin e 6 rreth viteve 620, 630 sipas kalendarit diellorë kristian që përdorim sot. Pejgamberi lindi në vitin 570 dhe kur u bë 40 vjeç në vitin 610 atij i erdhi shpallja prej Allahut xh. sh. Shtojmë 1200 vite më pas që e tha fjalën profeti Muhamed a. s. dhe i takon fill pas vitit 1800. Vërtetë pas vitit 1810 filloi të përhapet në botë ideologjija çifute anti fetare e ateizmit=mohimit të Zotit xh. sh. dhe botës së përtejme. Dexhali çifut Karl Marksi me teorinë ideologjike anti fetare ndezi zjarrin e luftës kundër fesë në gjithë botën. Në vitin 1840 këtë teori idellogjike e politike e përforcojë duke e stërholluar me lloj lloje gënjeshtresh çifuti tjetër Carl Darvini me librin e tij imagjinar: “Origjina e llojeve” duke e mohuar kështu përfundimisht ekzistencën e Zotit xh. sh. me teorinë e manipuluar të evolucionit. Kështu që ka 200 e ca vite që njerzimi ka filluar të shkoj poshtë e më poshtë nga ana morale dhe sot në këtë kohë ka arritur kulmin e poshtërsivet. Pejgamberi e tha hadithin=fjalën “Vaj ymeti im pasi të kalojnë 1200 vjet pas meje rreth vitit 20 hixhri. Shtojmë 1200 vite ve arrijmë në vitin 1220 hixhri. Ne tani jemi në vitin 1434 hixhri.

Nga viti 1434-heqim 1220=214 vite. Si pas këtij hadithi ka afër 214 vite që jemi në periudhën e vështirsive të mëdha që ka paralajmruar Pejgamberi jonë Muhamedi a. s. Sot dexhalat mashtusat e mëdhej janë të bashkuar në të gjithë botën në një mendim të përbashkët : Ti shkatërrojnë moralisht njerzit e sidomos brezin e ri që ai mos të dij të mendojë për të ardhmen e vet e kështu ti sundojnë sa më lehtë duke i bërë skllëvër të lirë. Ata e kanë arritur këtë gjë duke ju prishur mendjen të rijvet me teorinë politike “Liri pa kufij” në kundërshtim me fenë dhe atdhenë=me zakonet e mira kombëtare. Sipas shenjave që tregon Kurani dhe hadithevet=fjalëve të Muhamedid a. s. dijetari i njohur i fesë Islame Imami Sujutiu në librin e tij “Zbulesa” para disa shekujsh ka thënë kështu: “ Viti 1000 me kalendarin musliman hixhri e gjen të pa prishur botën, ndërsa viti 1500 nuk arrin se do të jetë bërë kijamti. Kjo fjalë e tij transmetohet në librin shumë të njohur “Ibni Kethijr” e gjithashtu dhe në librin Vaidhijn.Ne sot jemi në vitin 1433-1434 me kalendarin musliman të hixhretit. Ndërsa me kalendarin diellorë kristian jemi në vitin 2012.

Sikurse e thash më sipër muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se nga Allahu xh. sh. e kam marr lajmin për kijametin kështu “Shekull tjetër pas shekullit të 20 [njëzetë nuk ka më. “Nga kjo fjalë prej Allahut xh. sh. mësojmë se bota në shekullin e njëzetë e një do të jetë pak vite dhe do të vinjë fundi i saj=do të shkatërrohet. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte “Unë jamë balta e këpucëve të profetit Muhamed a. s. por jam me shërbim të caktuar prej Allahut xh. sh. për thirrjen e njerëzve në Tobe pak kohë para kijametit ndërsa feja është e plotësuar që me ardhjen e Pejgamberit-Muhamedit a. s. “Lajmi për tobe=për pendesë siç e thash më sipër është vërejtja e fundit para kijametit për gjithë njerzimin për njerzit që duan të shpëtojnë nga të këqiat veten e tyre në dy botët. Njerzit në fillim [çifti i parë i njerëzve] erdhën këtu në tokë pasi bënë tobe=pasi u penduan dhe me lajmin për të bërë tobe=për tu penduar do të largohen nga kjo botë pasardhësit e tyre gjithë njerzit. Pas lajmit për të bërë tobe filloi jeta në tokë dhe përsëri pas lajmit për tobe do të marrë fund ajo. Lum si ata njerëz që do të pendohen sinqerisht duke u kthyer tek Zoti i madhrushëm ashtu sikurse bëri tobe=u pendua njeriu i parë Ademi a. s. Në Kuran Allahu xh. sh. për atë thotë kështu: “Dhe Ademi dëgjoi disa fjalë pranoi disa fjalë [dëgjoi disa këshilla] prej Zotit të vet [Krijuesit të tij] prandaj Ai [Allahu

xh. sh.] ia fali [atij gabimin] Ai [Allahu xh. sh.] është mëshirus dhe pranues i pendimit-i tobës. S. Bekare. ajeti 37.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se Allahu xh.sh. më paraqiti mua para syve stinën e vitit që i takon në Shqipëri koha që do të bëhet kijameti. Ajo tha: Ishte pranverë dhe shikova fiqtë që kishin çelur gjethe por nuk shikova kokrra të pjekura. Ishte atmosferë feste por nuk e kuptova qart se çfar feste ishte. Mua mu duk sikur ishte atmosfera e festimit të Mevludit, rreth hënës Rebiul ev vel''. Vendeve të botës nuk ju takon të gjithave në stinën e pranverës ndërsa hëna është e njëllotë për të gjitha vëndet. Allahu xh. sh. i zhduku dikur më parë njëri pas tjetrit shumë popuj me qytetërimet e tyre pa fe, pa moral. Disa nga popujt e parë që i zhduku Allahu xh.sh. ishin:

Populli i Nuhut, populli i Adit, i Themudid, populli i Ibrahimit në Babilonijt=Babilonasit, populli i Firaunit në Egjiptin e lashtë, populli i Lutit=banorët e Medjenit, të Sodomës e Gomorrës, aty ku sot ndodhet deti i vdekur, populli i Sebeit, populli i Pompeit në Italinë e sotme e të tjerë që nuk janë përmendë në Kuran. Së fundi me katastrofën e përgjithëshme=me kijametin Allahu xh. sh. do ti shkatërrojë të gjithë kombet e botës me qytetërimin ose zhvillimin e tyre material ateistë= pa fe=pa besim në Zotin xh. sh. =pa moral, pa drejtësi dhe pa qetësi që është sot në botë.

47-SHENJAT E KIJAMETIT QE PARALAJMEROI PEJGAMBERI A. S.

Allahu xh. sh. thotë në Kuran: " Për çka ata [njerzit] i bëjnë py- etje njëri tjetrit ? Për lajmin e madhë tronditës në të cilin ata janë në kundërschim. Jo të mos pyesin se ata do ta kuptojnë [nga shenjat]. "S. Nebe. ajetet. 1-2-3-4. I dërguari i Allahut xh. sh. Muhamedi a. s. ka thënë; 1-Në çdo ditë që vjen njerëzit bëhen më të këqijë se ishin më përpara.

2-Lindja do të jetë burimi i luftrave se atje do të dali briri i Shejtanit=rruga e shejtanit=koka e kufrit=mohimi i Allahut. xh. sh. 3-Në kohën e fundit afër kijametit do të shtohet pirja e alkolit, kurvërija, livataja=homosualizmi=pederastija=marrëdhënjet seksuale burri me burrin.Veprimet imorale do të bëhen në mes të rrugës. 4-Nuk do të turpërohet njeriu nga imoraliteti=kurvërija. Do të veprojnë haptas njerzit si gomarët. E keqëja do të mbërrijë deri aty sa që do

të quhet njeri i ndershëm ai që e bën punën e ligë pak nën rrugë. Njerëzit në atë kohë do ta vizitojnë njëri tjetrin për qëllime të poshtra =të liga e jo për dashamirsi. 5-Afër kijametit do të pakësohen meshkujt dhe do të shtohen femrat. 6-Afër kijametit do të shtohen shumë vdekjet e rastit-do të vdesin njerëzit pa qenë të sëmurë më parë. [vdekje nga zemra, nga hemoragjija celibrare e tj.] 7-Afër kijametit do të ketë shumë tërmete, shumë tufane ose ndryshe ciklone dhe shumë njerëz të luajtur nga mendja. 8-Afër kijametit diturija e saktë-e pastër pa gabime nuk do të jetë më tekë dijetarët e kohës së fundit dynjasë. Xhamiat do të shtohen, por njerëzit që hynë në to do të pakësohen dhe të diturit që do tu folin popollit nuk do të jenë vetë në rregull. 9- Në kohën e fundit afër kijametit djali nukë do të respektojë nënën por do të respektoj gruan, ndërsa baba do të internohet largë familjes. [Këtu ndoshta është qëllimi i fjalës se baba do të punojë gjithmonë largë fëmijve ose ndryshe është fjala se nuk do të dihet tamam se kush është baba i vërtetë i fëmijës. Allahu xh. sh.e di të vërtetën për këtë.] 10-Afër kijametit do të ndërpritet dashuria për fisin. Njerëzit nuk do të shkojnë më tek njëri tjetri.11-Afër kijametit gadishulli i Arabisë do të bahet si kopësht i bukur por do të shtohen vrasjet. 12-Në kohën e fundit afër kijametit do të shtohen luftat. Ai që lufton nuk do ta dijë përse po lufton dhe ai që vritet nuk e di kushë përse është vrarë. 13-Afër kijametit do të vërsulen popujt tjerë [kristjanë, çifutë e budistë] kundër muslimanëve ashtu sikurse mbliidhen ngrënësit rreth pjatës së gjellës.

Armiku i tyre nuk do ti ketë më frikë muslimanët se ata do të jenë të përçarë e do ta urrejnë njëri tjetrin. 14-Afër kijametit popujt do të kenë në krye udhëheqësa jo besimtarë=të pa fe-ateistë. Nga poshtërsitë e tyre do të rrënoqethen zemrat e njerëzve. 15-Dijetarët e mirë që e kanë frikë Zotin xh. sh. afër kijametit do të kenë kaluar prej kësaj bote. Do të japin gjykime injorantët e ata që se kanë frikë Zotin xh. sh. Do të përhapen e reklamohen me të madhe pijet alkolike dhe imoraliteti=kurvërija. 16-Nuk do të respektohet ligji i fesë. Fëmijët do të jenë kundër prindëvet, i riu kundër të vjetrit dhe komshiu do të sillet keq me komshiu.17-Në kohën e fundit në prag të kijametit njerëzit do të kenë zemrat e djajve=shejtanëve, do të jenë si kafshët e egra grabitqare, pa mëshirë në zemrat e tyre. Ata do të vrasin fëmijë, gra dhe pleqë. 18-Në fundin e dynjasë Kurani do të lexohet për të ba konkurrencë se cili e lexon ma bukur por

jo për ta zbatuar atë dhe do të hyjnë shumë shpikje=shumë bidade të dëmshme në fe. 19-Besimtarët e besimtare e sinqertë të Allahu xh. sh. nuk do ti përfilli kush por përkundrazi do ti ofendojnë e përgojnë. Ata do të jenë të nënshtruar. 20- Do të ketë shumë sekte=grupime të ndryshme fetare. Muslimanët do të ndahen deri në 73 grupe të ndryshme por vetëm një grupë njerëzish do të jetë në rrugë të drejtë. Këta janë ata njerëz që besojnë e veprojnë si unë dhe shokët e mi. Feja Islame nuk do të zhduket se atë do ta mbrojë Allahu xh. sh. se një grupë nga besimtarët Islam do të eci në rrugën e drejtë dhe ata nuk mundë ti pengojë askush. 21- Për njerëzit e fundit të dynjas gjërat ma të rëndësishme do të jenë e ngrëna dhe e pira [llojet e ushqimit dhe llojet ose modelet e veshjes]. Ata do të jenë njerëzit më të këqijë. 22-Në fundin e dynjasë do të bëhen shumë ndërtime. Do të ngrihen ndërtesa të larta të veshura e të stolisura. 23-Të varfërit do të bëhen të pasur e të pasurit e dikurshëm do të bahen të varfër. [Këtë gjë e bën Allahu xh. sh. se do që ti provojë në këtë botë të gjithë se dikurë të varfërit shanin të pasurit]. 24-Do të iki dashurija, dhëmsburija e respekti i njerëzve për njëri tjetrin. Do të ndërpritet vizitimi i fisit. = shkuarja dhe ardhja e fisit tek fisi dhe ndihma për njëri tjetrin [Njerëzit do ta harrojnë fisin e gjakun e tyre]. 25-Pijet alkolike do të jenë me shumë emra të ndryshëm dhe do të shtohet aq shumë homoseksualiteti=pederastija sa që do të përdhunohet dhe fëmija ashtu si femra. 26-Do të shtohet në gjithë botën imoraliteti dhe fëmijët ilegalë=kopilat. 27- Njerëzit e kohës së fundit do të jenë shumë lakmiqarë e të pa ngopur dhe askush nuk do të urdhërojë për punë të mira e as që do ti ndalojë punët e këqia. [Këtu është fjala se qeveritarët që kanë mundësi ti ndalojnë me forcë veprat e këqia, nuk do ti ndalojnë dhe as nuk do ta urdhërojnë popullin e tyre për vepra të mira]. 28- Njerëzit e fundit të dynjas do të mësojnë në shumë shkolla të ndryshme por do të mësojnë vetëm për interesë për qëllim fitimi në këtë botë se botën tjetër-ahiretin do ta harrojnë. 29-Në kohën e fundit qyteti Meka do të zmadhohet, po ashtu edhe Medinja do ti kalojë kodrat. 30-Mbretërit në atë kohë do ta bëjnë haxhin për shëtitje = si turista, të pasurit do të shkojnë në Haxh për të bërë tregëti dhe të varfërit për të lypur ndonjë sendë. 31-Në fundin e dynjasë do të jenë disa njerëz që do të mbajnë në dorë disa bishta si bishtat e lopëve dhe me këta bishta do të rrahin njerëzit. [Mendoj se është fjala për policët e

sotëm nëpër botë që mbajnë në dorë shkopijtë e gomës dhe me këto rrahin popullin. 32-Do të shkruhen shumë libra dhe shiu në kohën e fundit nuk do të bjeri kur duhet e sa duhet. [Shiu=ujrat do të bëjnë dëme të mëdhaja] e do të ketë shafitje=humbje ose ulje të mëdha të tokës. 33-Shtetet e perëndimit do të jenë më të fuqishme afër kijametit. 34-Në fundin e dynjasë xhamiat do të shtohen por njerëzit që falen në to do të pakësohen dhe imamët=drejtusat e tyre do të flasin ato gjëra qi vetë ata nuk i veprojnë. 35-Në kohën e fundit = afër kijametit njerëzit do ta vrasin njëri tjetrin për pak gjë. Në kohën e fundit njerëzit do ti flasin me gojë njëri tjetrit bukur porë në zemër do ta urrejnë shumë njëri tjetrin dhe do të ja kenë shumë frikën njëri tjetrit. 36-Kur të ndërtohet e forcohet shumë Kudsi [Jerusalemi] atëherë do të shkatërrohet Medinja dhe në shkatërrimin e Medines do të ndodhi një luftë e madhe e pastaj do të zbresi në tokë [hazreti] Isai a. s. 37-Në fundin e dynjasë njerëzit kan me qenë të hidhëruar shumë në shpirtë dhe nuk do të jenë të durushëm fare. Nukë kanë me e folur dhe me e dëshmuar më njerëzit të drejtën e të vërtetën. 38-Afër kijametit gratë do të bëhen porsì burrat dhe burrat do të bëhen porsì grate [nga shumë pikëpamje] e atëherë prishet rregulli dhe në mbarë botën do të ketë shumë fesatë=grindje të mëdhaja ndërmjet njerëzish. 39-Në fundin e dynjasë kan për të dalë disa njerëz të cilët do të thonë se ne e duam shumë ehlibejtin=familjen e fisin e Pejgamberit a. s. por ata do të jenë kundër sheriatit- nukë do të veprojnë sipas Kuranit . Ata do të thonë se ne e duam shumë Aliun por ata nuk do të besojnë e veprojnë si Aliu r. t. a. 40- Afër kijametit do të largohen njerëzit prej syneteve të mia tha Pejgamberi a. s. [Vërtet sot dhe ata që janë besimtar zbatojnë ata synete që ju vin pas qefit. E lën mjekrën por nuk i falin synetet e nama-zit. Lënë mjekër por nuk e mbulojnë kokën me kësulë. Pejgamberi a.s.e ka mbajt të mbuluar kokën. Këto gjëra tregojnë që e pranojnë synetin vetëm në paraqitjen e jashtëme..Synetet e Pejgamberit a.s. jan të shumta. Nuk është vetëm mbajtja e mjekrës. 41-Do të degjenerohet inija dhe pushtetin [qeverisjen] do ta marrin në dorë të rijtë ndërsa të vjetrit do të merren me horrlqe e pisllice dhe mendjelehtët me dituri. 42-Do të shkojnë e do të vijnë njerëzit nga një vendë në vendin tjetër të largët shumë shpejt, [Fjala është për mjetet e transportit të shpejtë= avjonët e makinatat]. 43-Afër kijametit nuk kanë me pas më kënaqësi njerëzit kur ta dëgjojnë Kuranin dhe gjëja e parë që ka me ikur prej njerëve është turpi dhe besa ose amaneti. 44-Në kohën fundit të dynjasë

do të paraqiten shumë gënjeshtarë, fallxhorë e magjistarë që do ta quajnë veten njerëz të shenjtë. [por të diturit i kuptojnë se ata veprojnë në kundërshtim me Kuranin librin e Allahut xh. sh. 45- Njerëzit në fundin e dynjasë kanë me qënë të hijshëm=të bukur në dukjen e jashtëme [të veshur mirë e pastër] nga jashtë por të pistë nga trupi për brenda e të prishur nga shpirti. Afër kijametit do të shtohet kamata=fajdeja do të bahet tregëti me të. Njerëzit do ta lënë namazin, do të zhyten në gjynahe të mëdhaja dhe nuk do të jenë besnikë. Në fundë të dynjasë kur të jetë afruar kijameti, njerëzit rrenën do ta besojnë ndërsa të vërtetën jo. Do ti besohet rrenacakut e tradhëtarit e jo atij që fol të vërtetën e besnikut, njeriut të mirë. Njeriun e keq do ta pëshëndesin me rrespekt ndërsa njeriun e mirë nuk do ta përfillin njerëzit. Fëmijët në fundin e dynjasë kanë për të qënë të dëmshëm për babën e nënën. Më shumë ata kanë për të dashur kafshët e shtëpisë [qentë e macet] se prindërit e tyre. Kështu që do të jetë më i lumtur ai njeri që nuk ka fëmijë se ai që ka. Kryetarët e vendit=ministrat e zyrtarët do të jenë renacakë, imoralë, të pa drejtë dhe tradhëtarë. Do të pakësohen dijetarët e mirë të fesë por do të shtohen lexusat e Kuranit. [Pra do të ketë shumë që e lexojnë Kuranin por nuk do ta zbatojnë atë. Afër kijametit do të hyjë në çdo shtëpi çallgija=muzika dhe do ta vizitojnë njerëzit njëri, tjetrit jo për hatrin e Allahut xh. sh. por për qëllime të ndryshme. Gruja do ta shoqërojë burrin për bërë tregëti. Në fundin e dynjasë gratë do tu hipin kuajve. [ose makinave]. Do të dalin njerëzit dëshmitarë rrejshëm. Zeqati do të bëhet gjobë. [Këtu është fjala se njerëzve që nuk do ta japin zeqatin e pasurisë do tua marrin atyre disa njerëz të tjerë me gjoba, tatime ose vjedhje me lloj lloje mynyrash e shkaqesh dhe shpërblim tek Allahu xh. sh. ata nuk marrin. Amaneti do të jetë për fitim dhe burri do ti nënshtrohet gruas. Fjala është nëse i lë dikujt një send amanet ai do të kërkojë shpërblim. Në kohën e fundit afër kijametit burrat do të stolisen porsitë gratë me rruza e byzlykë në duar e në qaf. Të këqijtë e të paditurit do të mbajnë fjalime e ligjërata dhe do të shtohen ruajtësit e qetësisë-[policët]. Shumica e dijetarëve të fesë në kohën e fundit do të folin sipas dëshirës së krytarëve të vendit [politikanëve] e jo sipas ligjit të fesë = sheriatit se ata do ta mësojnë diturinë për të fituar mirsinë në dynja për të qënë rahatë këtu në këtë dynja e jo me qëllimin për të fituar xhenetin në botën tjetër të përherëshme. Afër kijametit do

të përhapen shumë pijet alkolike dhe kumara=bixhozi [ose lojrat e fatit. Kur të afrohet kijameti, njerëzit nuk do të bëjnë më punë të mira dhe as nuk do të flasin fjalë e këshilla të mira. Afër kijametit do të vritet njeriu i pafajshëm me qëllim që të armiçësohet shumica. [është fjala do të vritet për ngatërresë]. Gënjeshhtarit do ti besojnë ndërsa të sinqertin do ta përgënjeshtrojnë. Rrena do të besohet si e vërtetë dhe e vërteta nuk do të besohet se do të quhet rrenë. Afër kijametit nuk do të ketë martesë të rregullta e të sigurta=do të shtohen shkunorëzimet. Njerëzit e kohës së fundit pa turpsinë e imoralitetin do ti quajnë përparim, kulturë e zhvillim. Do të shtohet dhënja e rushfetit dhe hajdutët që do të vjedhin me mynyra të ndryshme. [me dorë direktë, me laps, me peshore, me gjyge me dëshmitar gënjeshtarë, me rushfet, e tjera mynyra]. Kurë të jetë afruar plotësisht kijameti atëherë kanë me zbritur baritë e dhenvet nga kodrat e malet dhe do të vin për të jetuar në qytet. Baritë e dhenvet atëher do të ndërtojnë ndërtesa të larta e të bukura. Ata do ti lavdrohen njëri tjetrit duke i thënë: Kush e ka gadit shtëpinë më të bukur se unë. Bariu simbolizon njeriun e sinqertë-njeriun e pastër moralisht që rrin largë zhurmave, rrëmujave, shikimit e dëgjimit të harameve dhe që nuk kënaqet me shtëpinë e madhe e të veshur, por me bukurinë e tufës së bagative. Por kur edhe baritë e dhenvë dhe lopëve do të vinë nga kodrat e malet dhe do të futen nëpër qytete duke punuar që të bëjnë shtëpija të larta e të bukura dhe do të shikojnë e dëgjojnë në qytet maskaralliqe e horrlloqe, atëherë nuk mbeten më në botë njerëz të drejtë e të pastër në shpirt që nuk e lakmojnë dynjanë.

Ashtu si gjithë të tjerat edhe kjo gjë sot ka ndodhur në gjithë botën. Vërtetë sot njerëzit kudo në botë kanë ikur nga fshatrat e kanë zbritur në qytete duke kërkuar një jetë më të mirë = më të rehatshme por pa rezultat. Nga shenjat e mëdhaja të kijametit Pejgamberi Muhamedi a. s. lajmërojë këta; 1-Dalja e dexhalit dhe jexhuxhë e mexhuxhëve të cilët ka kohë që kanë dalë dalë për të cilët na tregoi muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Këta dy shenja nga të mëdhajat janë vëtetuar e për të cilat folëm më sipër me argumente e fakte konkrete. Nga shenja e mëdhaja të kijametit që përmend Kurani janë dhe këta; 1-Do të lindi dielli nga perëndimi 2-Do të zbresi hazreti Isai a. s. në planetin tokë dhe do ta zhduki kudo në botë qeverisjen e dexhalëve-ateistëve dhe ligjet e tyre anti fetare-

anti morale e anti njerëzore i cili do të vërtetohet se feja e vërtetë=ligji i drejtë që ju sjellë lumturinë njerëzve në gjithë botën, është feja Islame dhe do të vendosi ligjin e drejtë: Sheriatin Islam. Koha se kur do të zbresi haz. Isai a.s. në planetin tokë nuk është e qartësuar plotsisht se para apo pas lindjes së diellit nga perëndo për arsye se shejat e mëdhaja të kijametit nuk janë të radhitura në hadithe njëra pas tjetrës. Disa dijetarë musliman kanë thënë se hazreti Isai a. s. do të zbresi në planetin tonë në tokë pasi të lindi dielli nga perëndim. Kështu ka thënë në librin e tij Mevludi Sherif në vitin 1879 edhe dijetari nga trevat shqiptare Hafiz Ali Ulqinaku i cili thotë kështu : “Lindë dielli ku perendo dhe zbret Isai ruhullah [i krijuar me shpirt prej Allahut xh. sh.” Nuk është e përcaktuar në Kuran nëse Isai a. s. do të ketë ose jo ndonjë ushtri nën komandën e tij për të luftuar kundër dexhalëve, nëse ai do të përdori forcën për ti zhdukur ata? dhe se çfarë ushtrie do të jetë ajo. Nëse Isai a. s. do të ketë ushtri nuk dihet nëse kjo ushtri a do të jetë ushtri prej melekësh=engjëjsh, apo do të jetë ushtri e përbërë nga krijesa tjera jashtë toksore=njerëz tjerë në planetin jashtë tokës të cilët mund të jenë më të zhvilluar=më të fortë ushtarakisht se njerëzit në tokë apo Isai do ti bashkoi gjithë besimtarët e devotshëm të kësaj bote e do tu prinj atyre si komandant ushtrie për të luftuar kundër dexhalëve në gjithë botën me forcën dhe mrrekullitë e mëdhaja që ai do të ketë prej Allahut xh. sh. Këtë gjë e di vetëm Allahu xh. sh. Në Kuran thuhet kështu: “Ushtritë e Allahut janë të shumta”. Për zbritjen e ushtrivët nga qielli Allahu xh.sh. thotë: “..Ne nuk zbritëm ndonjë ushtri nga qielli kundër popullit të tij [që nuk besonin] e as nuk ishte vendimi ynë që të zbrisim tjetër [gjë] përveç një britme të tmerrëshme...”. S. Jasin. Aj. 28, 29. Allahu xh. sh. e ka ndihmuar profetin Muhamed a. s. me një ushtri të pa dukshme në luftën me idhujtarët. Kurani tregon se Allahu xh. sh. i tha atij kështu : “Allahu zbriti një ushtri që ju nuk e shikuat e i dënoi ata që mohuan”. S. Ahzab. Aj. 26. E që e kishim fjalën më sipër tekë shenjat e mëdhaja të kijametit pas zbritjes së hazreti Isait a. s. në tokë dhe lindjes së diellit andej nga perëndo, shenjat tjera do të vin shpejt njëra pas tjetrës. 3-Do të përgjysmohet hëna. 4-Një tym si mjegull do ta mbulojë tokën dhe do të vdesin kollaj të gjithë ata që e kanë besuar Zotin xh. sh. dhe botën tjetër=ahiretin. 5-Pastaj do të dalin një kafshe e çuditshme nga toka e cila do tu flasi njerëzve që nuk besuan=mohuan të Zotit xh. sh. duke i kritikuar ata për mosbesimin e tyre. 6-Yjet do të zhduken dhe qielli do të bëhet si bakër i shkrir. Pastaj toka fillon të lëkundet pa pushuar si djepi i fëmijës. 7- Detrat do të

shterroj në se do të ndizen flakë e do të avullojnë si ujët e nxehtë në kazan. 8-Së fundi është krisma e tmerrshme kur toka do të përplaslet me planetet tjera dhe çdo gjë me shpirtë zhduket. O besimtar pranonia thirrjen e fundit për tobe=për pendesë që ju bëri Allahu xh. sh. nga mëshira e vet nëpërmjet muxhedides Aishe rahmetullahi aleha, para se të lindi dielli atje ku perëndo se pastaj tobja [pendimi] atëher nuk pranohet më. Allahu xh. sh. na e ruajtë imanin=besimin sot në këtë koh që është shumë vështirë për ta ruajtë atë. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte që besimtarët ti luten Zotit xh. sh. me këto fjalë kështu: “ O Zot i madhrushëm pasi na drejtove për së mbari mos na len të rrëshqasim nga e vërteta”. Allahu xh. sh. i drejtoftë nga e mbara gjithë njerzit, para kijametit për nderimin e profetit Muhamed. a. s.

48-GJITHËNJË ME NJOFTIMET QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE.

Është në natyrën e njeriut që kërkon të fitojë pa u lodhur shumë ose duke mos u lodhur hiç fare. Populli si atëherë edhe sot shkojnë të hutuar dhe kërkojnë shërim tek varret dhe tek fallxhorët tek shkëmbijtë e tek drurët. Për të tillë njerëzish Kurani thotë: “Ai në vënd të Allahut lut [ti o njeri] atë që nuk mundë ti bëjë as dëm as dobi. E kjo është ajo humbja pa mbarim [humbja e përhershme]”. S. Haxh. Aj. 12. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ju foli shumë njerëzve në lidhje me të vdekurit. Ajo i ndalonte njerëzit që ata mos të shkojnë tek varret për të kërkuar ndihmë nga të vdekurit. Ajo thoshte se të vdekurit për këtë gjë nuk janë fajtorë. Fajtorë janë të gjallët që kërkojnë prej tyre. Murshidja Aishe tha se Allahu xh.sh.më njoftojë mua nëpërmjet ëndrrës duke më shfaqur mes gjumit dhe zgjimit këtë pamje. “Më shfaqti Allahu xh. sh. mua dervishe Hatixhen Ishte një grua Tiranse e thjeshtë e veshur me dimiq dhe napë të bardhë në kokë sikurse visheshin dikurë tiranset e vjetra. Dimiqtë i kishte bojë blu me disa lule të bardha. Ajo mu drejtua mua me këto fjalë; Unë nuk kam faj që njerëzit vin këtu për të kërkuar ndihmë e shërim nga unë. Jam tepër e mërziur për këtë gjë. Un kur isha e gjallë i ndihmoja njerëzit me çfar kishim mundësi por tani un nuk kam çfar tu bëj atyre të mos vinë këtu kotë. Vetëm Allahut i kër-

kohet ndihmë ". Vërtetë Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Dhe mos lut tjetër kën veç Allahut ndonjë që nuk sjellë as dëm e as dobi. "S. Junus Aj.106. Aisheja që Zoti xh. sh. e mëshiroftë gjithashtu tregoi dhe për historikun e ndërtimit të kishës në rrethin e Durrësit që i thonë kisha e shën Vlashit. Ajo tha: Më shfaqi Allahu xh. sh. në ruja=pjesë filmike mes gjumit e zgjimit këtë pamje; "Ishte një vajzë rreth 15-16 vjeç, dhe mua mu drejtua me këto fjalë. Njerëzit janë hutuar, vijnë kot këtu për të kërkuar ndihmë e shërim prej meje. Unë kam qënë kristjane. Në shtëpi kishim shumë libra feje. Kishim dhe Kuranin që sëbashku me Ungjillin i mbanim sipër këtij oxhaku për respektë = [Duke treguar ajo me dorë oxhakun e shtëpisë thoshte Aisheja]. Unë tha kjo vajza nuk dija gjë nga feja muslimane, por kishim shumë dëshirë pastërtinë. Nuk e kuptoja se qysh, por më ishte bërë i dashur Kurani në zemrën time se shkronjat e tij mua më dukeshin, sikur bënin dritë.

Unë pothuajse çdo ditë e merrja në dorë Kuranin e puthja dhe e vinja në ballë megjithëse nuk dija ta lexoja atë. Pas pak kohësh unë vdiqa tha ajo. Njerëzit pastaj tek varri im thoshin se kishin shikuar një dritë [një shenjë] dhe ata sipër varrit tim pastaj ndërtuan kishën. Tani ata vinë këtu në kishë për të kërkuar ndihmë e shërim tek unë. Unë nuk mund të ndihmoj e te shëroj as njeri. Vetëm Zoti xh. sh. po deshi të ndihmon dhe të shëron. "Ky ishte njoftimi që i bëri Allahu xh. sh. muxhedides Aishe për historikun e kësaj kisha që njerëzit shkonin atje për të gjetë shërim. Muxhedidja Aishe kur punonte në makinën qepse e vinte orën para syve. Ajo e planifikonte kohën, një pjesë për punë, një pjesë për ibadet në rrugën e Allahut, një pjesë për pastrim e gatim gjelle dhe pjesën tjetër për gjumë. Për edukatën që duhet të kenë njerëzit kur ti luten Allahut xh. sh. ajo tha se mora këtë vërejtje për njerëzit nga ana e Allahut të madhëruar: "Mos e lëkundëni trupin kur bëni lutjen e namazit. " Duke udhëtuar për të bërë davet- thirrje për tobe Aisheja i thotë një besimtarë që ta bënte gjithmonë këtë lutje kështu; "Elhamdulillah=lavdrimi të qoftë Ty o Allah xh. sh. që na drejtove në rrugën e të dërguarit Tënd më të dashur Pejgamberit Muhamad a. s. dhe pasi na drejtove, mos na lë me rrëshqit. "Ajo ju thoshte besimtarëve se kam marrë këtë lajmë prej Allahut xh. sh. për tua thënë juve o besimtarë "Kur të thërrasin ty ata [njerëzit] mos të thon Ishe por të thonë me respektë Aishe. "Vërtetë nuk lejohet nga feja, por dhe nga logjika shkurtimi

i emrave se ju humbet atyre kuptimi ose marrin kuptim tjetër.

P. sh. Adem nuk duhet të bëhet Dem . Ramazan jo Zan ose Xan e tjer. Gjithashtu nuk është mirësjellje. Allahu xh. sh. i ka kritikuar në Kuranë në atë kohë njerëzit që i thirrnin Pejgamberit a. s. nga larg pa edukatë siç thirrnin njëri tjetrin. Allahu xh. sh. thotë: "Thirrjen e të dërguarit mos e konsideroni si thirrjen tuaj ndajë njëri tjetrit..." S. Nur A. 63. Murshidja Aishe qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej asaj tha: "Mora njoftim prej Allahut xh.sh. se Pejgamberi ynë a. s. ka ardhur në Shqipëri deri në Tiranë, në anën veriore të saj, në vendin ku ka qenë gashina=thertorja e mishit, aty ku sot është afër Dispanceria= klinika për kontrollin e sëmundjeve të mushkrive. "Kurani na e bën të qartë se Allahu xh. sh. njerëzit e Tij të dashur e të zgjedhur i ka ngritur me anë të melekve-engjëjve ose me anë të erës e i ka çuar atje ku ka dashur vetë. Shembullin e kemi në Kuran siç e thash më sipër i cili tregon për pejgamberin Sulejmanin a. s. se Allahu xh. sh. e ngrente me gjithë ushtrinë e tij dhe për një gjysëm dite bënte një muaj rrugë me këmbë . Gjithashtu tregojnë dhe hadithet e Pejgamberit a. s. për këto lloje mrekullish. Allahu xh. sh. e din se kur dhe me çfarë mënyre ka ardhur në vendin tonë Pejgamberi a. s. Murshidja Aishe thoshte: "Një ditë duke ecur në rrugë të Tiranës e po shkoja tek një familje për vizitë. Vura re se dy njerëz të sigurimit të shtetit po më ndiqnin prapa, hapë pas hapi se në çfarë shtëpie do të futesha unë. Unë i shikoja ata me bishtë të sytë dhe e shpejtoja hapin. Pasi u largova pak nuk po e shikoja më hijen e tyre por nuk isha e sigurt nëse po më ndiqnin më apo jo. Nuk kishim rastin që të kthej kokën për të shikuar se atëherë ata do të dyshonin dhe menjëherë do të më ndalonin. Pas disa metrash, rruga nuk vazhdonte më se ishte pa krye dhe unë isha e detyruar pa tjetër të futem në atë familjen që po shkoja për vizitë. Kjo familje ishte e persekutuar nga regjimi komunistë ashtu siç isha e deklasuar edhe unë për shkakun e burrit. Në ato çaste në rrugë para meje po loznin disa fëmijë. Unë mendova me veten time për një moment: Ah sikur këta fëmijë të detyrojnë Zotin xh. sh. që të më hedhin mua ndonjë pluhur ose guricë të vogël ashtu siç veprojnë ndonjëherë fëmijët e vegjël në moshë që mua të më jepej shkakun për të shikuar prapa. Në ato momente që po mendoja kështu unë kalova tek fëmijët e ata ishin ulur me kokat në tokë por

menjëher kur un atyre ju ktheva shpinën, Allahu xh. sh. i detyroi ata që të më hedhin mua prapa pak pluhur. Unë menjëher thash Allahu ekber dhe me shkakun për tu bërtitur fëmijëve, këtheva kokën për të parë ata që po më ndiqnin nga pas. Në ata momente Allahu xh. sh, më shfaqti, menjëherë një murë me tulla, mesë meje dhe atyre që po më ndiqnin dhe tullat viheshin shpejtë mesa kuptova nga melekët=engjëjt në mynyrë të habitëshme, tamam sic bëjnë sot në ekranet e televizorit me anë të kumpjutrave. Atëherë nga pasë murit dëgjova zërin e tyre që i thanë njëri tjetrit: Nga na iku kaq shpejt=nga na u zhduk kjo more ? E ngatërruam rrugën.” Kështu më shpëtoi Allahu xh. sh, në atë rastë, nga ndjekja e atyre spiunëve që me siguri dikushë kishte raportuar se unë gjoja mere-sha me politikë kundër shtetit e jo me fenë. E vërtetë është kjo shfaqje që na tregonë murshidja Aishe, se këto mrrekulli i vërteton Kurani famëlartë. Allahu xh. sh. thotë: “Ai [njeriu] ka roje para dhe prapa, atë e ruajnë me urdhër të Allahut. ”S. Rrad. aj. 11. Gjithashtu Allahu thotë: “Ne ju kemi vënë para tyre pëndë=perde=pengesë edhe prapa tyre pëndë dhe jua kemi mbuluar sytë prandajë ata nuk shohin. ”S. Jasin. aj. 9. Allahu xh. sh. i thotë Pejgamberit a. s. në Kuran; Në mes teje dhe atyre që nuk besojnë kemi vënë perde=pengesë. Allahu xh. sh. gjithashtu thotë: “Ne nuk i dërgojmë engjëjt veçse kur duhet. ”S. Hixhër. aj. 8. Ndërsa engjëjt thanë : Ne [engjëjt] nuk zbresim, vetëmse me urdhërin e Zotit tënd [i than ata Merjemes] Vetëm Atij [Allahut] i takon çështja e tashme e ardhme dhe mes tyre, e Zoti ytë nuk është[i tillë]që harron. ”S. Merjem. aj. 64. Allahu xh. sh. e mbron njeriun drejtë për së drejti, por e mbron dhe me anë të melekëve=engjëjvet.Kjo mvaret nga dëshira e Allahut xh. sh. Detyrat që u janë dhënë engjëjve=melekëve nga Allahu i madhërushëm, mund ti radhisim kështu, duke u bazuar në Kuran dhe në Hadithet e Pejgamberit a. s. 1-Të deklarojnë se Allahu xh. sh. nuk ka asgjë të mangut dhe asnjë herë Ai nuk bën gjë gabim dhe gjë të kotë. Këto engjëj kanë detyrë ta lavdrojnë dhe ta falenderojnë Allahun xh. sh, natë e ditë, dhe ta lartësojnë atë me fjalët më të bukura kuptim plote që i meriton Ai. Shih në Suret Shura ajeti 5, S. Nisa aj. 30, Araf. 206, Nahl. 50, Enbija. 19, 27, Shura. 5.] 2-Tu komunikojnë fjalën e Allahut xh. sh, njerëzve të zgjedhur nga Ai, burrave ose gravet. Shih Suret Shura ajetet 193, 194, S. Haxh 75, S. Murselat ajetet. 5 dhe 6, S. Nahl. aj 2. dhe në suren Merjem

ajeti 45 ku thotë; Përkujto kur engjëjt i thanë; 'O Merjem; Allahu të përgëzon me fjalën e vet.'] 3-Të lartësojnë profetët=pejgamberët me salatu selam=përshtëndetje e lavdrim dhe të luten Allahut xh.sh. për të gjithë njerzit besimtar. Shih Suret Shura, aj 5, Nexhm. ajeti 26. Kurse në një hadithë të Pejgamberit që tregon Buhariu, bëhet fjalë dhe për shefaatin e engjëjve.] 4-Tu bëhen mbështetje pejgamberëve, të dëguarve, evlijave dhe besimtarëve të mirë, ti qetësojnë e ti ndihmojnë njerëzit në çaste të vështira, dhe të fusin tek qafirrat, pa siguri e shqetësim. Shih S. Bekare. ajeti. 87, Ali Imran, ajet, 124, 125, Enfalë e tjera.] 5-Ti ruajnë njerëzit kur dëshiron Allahu xh. sh, si ndjekës të njerëzve që janë, në një farë kuptimi tu shërbejnë atyre, kur do Allahu xh. sh. Shih Sure Rrad, ajet 11.] 6-Të regjistrojnë veprat e njerëzve të mira e të këqija. Shih S. Kaf, 17, 18, In fitar. 10, 11, 12, Tarik, 4.] 7-Të shërbejnë për ndryshimet në aspektet e ndryshme që ndodhin në mbarë gjithësinë. Shih Sure Naziat. Aj. 4 e 5 dhe S. Murselat aj. 3, 4.]-Të kryejnë detyrat në lidhje me krijimin dhe vdekjen e njeriut. Shih S. Naziat aj. 1, 2, 3 dhe S. Sexhde ajeti 11.] 9--Të kryejnë detyra të ndryshme si funksionar, apo nënpunës të Allahut xh. sh, për nderimet e shpërblimet e njerëzve të mirë, kryesishtë në ahiret-botën pas vdekjes. Shih në Sure Rrad, 23, 24, Nahl aj 32. e tj.

10-Të kryejnë detyra të ndryshme duke shërbyer si funksionar të ekzekutimit të vendimeve të Allahut xh. sh. për ndëshkimin ose dënimin e njerëzve që do Allahu xh. sh. në dynja por kryesishtë në xhehenem. Shih në Suren Bekare aj. 210, S. Enfal. aj. 50, S. Furkan. aj. 22, S. Muhamed. aj. 27, S. Tobe aj. 26, S. Ahzab. aj. 9.] Kështu që ata informatorët apo spiunët në atë rast, po të mos ishte mbrojtja e Allahut xh. sh, do të shfrytëzonin rastin që ta akuzonin murshiden Aishe rahmetullahi alejha për politikë dhe kështu do ta mundonin atë, duke e akuzuar padrejtësishtë. Por Kurani thotë: "Ai [Allahu] kujdeset për të mirët". S. Araf. aj. 196. Në lidhje me hënën e ramazanit muxhedidja Aishe tregonte: "Më shfaqti Allahu xh. sh. në ëndërr një treg ku shiteshin shelqinj por shitej me llokma shelqini e jo i plotë. Njerzit merrnin secili nga një llokëm. Kur e mora unë llokma e ime nuk ishte e kuqe shum ashtu sikurse e kishin disa njerëz të tjerë. Ndërsa disa të tjerë e kishin edhe më të bardhë llokmën se e imja, megjith se

të gjithë llokat që i merrnin njerëzit ishin nga i njëjti shelqin. Kjo ëndërr mu shfaqë 2 ditë pasi kishte filluar hëna e Ramazanit. Ajo thoshte se Allahu xh. sh. më bëri të kuptojë me ilham=me inspirim se, jo të gjithë vëndet e botës e shohin njëllojë hënën. Disa e shohin më me qartë-më me precizion, dhe ky është shkaku që ndonjëherë lëvizin një ditë njëri me tjetrin njerëzit e vëndet e ndryshme. Agjërimi është i pranushëm thoshte muxhedidja Aishe se është brenda 24 orëve diferenca e kohës. por nuk është e pëlqyshme kjo gjë pasi nuk është shikuar me ekzaktësi hëna. Vëndet që janë largë neve siç është Australia, Filipinet e Zelanda e re dhe Amerika kanë ndryshim me ne në Evropë përse i takon orës së lindjes e perëndimit të diellit me neve. Në Australi dita vjenë më shpejtë se në Europë. Ndërsa vëndet Lindja e Mesme dhe Evropa nuk kanë diferencë të madhe mes tyre për sa i takon orës së lindjes e perëndimit të diellit. Sikurse e thashë më lartë shikimi i hënës është vaxhib për të përcaktuar hënën e Ramazanit. Un shkruasi i librit jam në dyshim përse i takon shikimit të hënës me teleskopë e satelitë se a është i drejtë e i saktë ky veprim apo jo. Arsya që mendoj un kështu është se teleskopi e sateliti e shikon hënën disa mijra kilometra largë tokës pa ardhur akoma mirë në tokë drita e diellit dhe shkëlqimi mirë i hënës. Un mendoj se kjo gjë është si shikimi i fëmijës me E.K.O në barkun e nënës kur ai sapo ka marrë formën si njeri por që nuk është i plotësuar e forcuar tamam nga pamja dhe shëndeti ashtu sikurse është kur lindë nga barku i nënës Duhet shikuar hëna me sy me shumë kujdes nga njerëzit besimtarë të mirë e të kujdesshëm për këtë gjë e që e njohin mirë hënën=lëvizjet e sajë. Muxhedidja Aishe ishte tepër e kujdesëshme në shikimin e hënës. Ajo ishte në hall e siklet kurë ishte koha e vrëjtur dhe atëherë dilte e pyeste besimtarët nëse dikush nga ata e kishte parë hënën. Pejgamberi a. s. ka thënë:

“ Agjëroni kur të shihni hënën dhe bëni Bajram kur ta shikoni atë. Nëse qielli është i vranët, atëherë plotësoni [ose llogaritni] muajin e Shabanit me tridhjetë ditë. ” Trans. Buhariu. Fjala është shikoni hënën dhe agjëroni [kur është për të agjëruar] dhe shikoni hënën e hani= prishnja agjërimin kurë nukë është për ta agjëruar. “Në fjalën që thuhet kur nuk është për të agjëruar është qëllimi se është e ndaluar me agjëruar në ditën që është e dyshimtë e që quhet jeu- vmi shek. Nëse është koha e vrëjtur dhe hëna nuk duket me sy atëherë dita e tridhjetë që vjenë pas ditës së njëzet e nëntë të

muajit Shaban quhet ditë e dyshimtë dhe është e ndaluar [është mekruh [qeraheti tahrimije] për të filluar agjërimin me nijetin për hënën e Ramazanit se nuk dihet që ajo është dita e fundit e muajit Shabanë apo është dita e parë e muajit Ramazan. Agjërimi është disa llojesh; farz, vaxhib, synet, mustehab. Agjërimi i Ramazanit është sipas hënës=me kalendarin hënor. Muajt hënorë ashtu sikurse dhe muajt me kalendarin diellorë disa janë 29 ditë e disa 30 ditë. Për shembull muaji shkurtë sipas kalendarit diellorë është 28 ditë por në çdo 4 vjetë ai bëhet 29 ditësh. Kështu që për ta gjetur tamam ditën e parë të fillimit të muajit të Ramazanit është vaxhib kifaje=detyrë për të gjithë besimtarët shikimi i hënës në të 29-njëzetë e nëntën ditë të muajt hënorë Shaaban nëse qielli është i kthjellët pa re. Po kështu veprohet edhe në të njëzetë e nëntën ditë të Ramazanit. Por nëqoftëse është vranët plotësohen 30 ditë Ramazan pastaj bëhet Bajram. Siç e thamë më para është e ndaluar të agjërohet në ditën e dyshimtë [jevmi sheq] me nijetin agjërimin për ditë Ramazani. Ashtu sikurse nuk falet namazi pa hyrë koha e tij dhe po ashtu nuk agjërohet Ramazani pa hyrë hëna. Pejgamberi a. s. gjatë jetës së tij i ka qëlluar 4 herë që ta agjërojë Ramazanin me 29 ditë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte për çështjen e shikimit të hënës kështu: Kur del hëna e re, ajo del nga perëndimi i diellit dhe duket në horizontë pak minuta para akshamit =para mbrëmjes dhe ajo shihet kurë është dy ose tre ditëshe nëse qielli është i kthjellët pa re E kështu numron ditët deri kur ajo të bëhet 15 ditëshe. Kur bëhet pesëmbëdhjetë ditëshe është e plotë=shumë e rrumbullakët, tepër e shkëlqyshme dhe del për njëherësh me kohën e akshamit=e mbrëmjes në kohën që dielli është në çastet e fundit të perëndimit të tij=të zhdukjes nga horizonti. Dielli dhe hëna pothujse ndodhen për ballë njëri tjetrit. Kur Hëna është 14 ditëshe nuk është shumë e rrumbullakët dhe delë para akshamit. Ndërsa kurë hëna bëhet 16 ditëshe ajo është e rrumbullakët por del pas hyrjes së kohës së faljes të akshamit dhe është pak e kuqe e nuk është e shkëlqyeshme siç është kur është pesëmbëdhjetë ditëshe. Hëna e vjetër=hëna që është duke u mbaruar mbetet si një drapër i hollë dhe duket nga lindja e diellit mbas kohës së sabahit=mëngjesit çdo ditë kur është duke u mbaruar. Një natë tha murshidja Aishe më shfaqti Allahu xh. sh. nëpërmjet ëndrrës varrezat që në atë vendë ishte varrosur e bija e Pejgamberi tonë a. s.

hazreti Fatimeja r. t. a. Toka tek varri i saj kishte lëvizur dhe trupi i sajë ishte mënjeluar. Koka i kishte ra poshtë. Muxhedidja Aishe që Allahu xh. sh. qoftë i kënaqur prej sajë tha; Unë kur e pashë ashtu në këtë gjëndje i fola asajë e i thashë; Motra ime Fatime; A ta rregullojë pakë trupin se qenke në siklet? . Ajo tha: Mir do ta bëjsh, Unë tha muxhedidja Aishe i vura duart prapa krahëve të saj duke e tërhequr dhe e vura drejt në pozicionin që duhej shtrir.

Kur ma tregonte këtë gjë murshidja Aishe rahmetullahi alejha, asaj i rridhnin lotët si shiu nga dashuria për ehlibejtin-njerëzit e shtëpisë së Pejgamberit a. s.= familjen e fisin e tij. Un e pyta murshiden Aishe për domethënjen e kësajë rrujaje.Ajo më tha: "Vërtetë pa dyshim mund të ketë lëvizur dheu tek varri i saj dhe nuk interesohehet askush për të ia rregulluar varrin. Me të vërtetë sikurse e shohim sot, arabët nuk kujdesen fare për varrezat të cilat kanë rëndësinë e vet dhe ata. Ata mbajnë në kujtesën e njerëzve, dashurinë dhe respektin për Pejgamberin, familjen dhe shokët e tij, dhe pa përjashtim për të gjithë brezat e kaluar nga të afërmit e gjithësecilit nga ne. Mirëmbajtja e varrezave ka rëndësinë e vet. Prandaj mendoj unë, hazreti Fatimeja që Allahu e ka lartësuar në xhenet i është shfaqur në ëndërr duke i thënë murshides Aishe fjalët: "Mirë do ta bësh." Nga kjo gjë kuptohet se është mirë o vëllezër besimtarë që të dihen e të mirëmbahen varret e të afërmëve tanë. Pejgamberi jonë a. s. ka thënë: "Unë nëse nuk kam rrugë tjetër ku të eci, më mirë e vë këmbën sipër prushit të zjarrit e nuk e vëj sipër varrit". Varrezat na kujtojnë vdekjen dhe përmallohemi me të afërmit tanë kur i vizitojmë. Pejgamberi a. s. ka thënë: "Kush më viziton mua varrin, është një llojë sikur më ka vizitur për së gjalli. Trans Buhari, Muslim, Ebu Daud etj. Gjithashtu Pejgamberi a. s. ka thënë: "Kush besimtarë e viziton varrin e nënës e të babës, ose të njërit nga këta ditën e Xhuma=të Premten, Allahu xh. sh. do të bëj mëshirë për atë njeri." Por duhet ditur se varri nuk duhet të mbyllet me beton e pllaka dhe mos të bëhet në formë drejtkëndëshi të rrafshët. Ai duhet të jetë vetëm prej dheu në formë kulmi si dikur dhe jo në formë drejtkëndëshi e i mbuluar me pllaka e beton.Duhet të ketë dy gurë, që në atë që vihet te koka e varrit të jetë shënuar emri e mbiemri pa fotografi, data e vdekjes dhe në fund duaja e shkurtër, rahmet pastë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte kur shkohet te varri jepet selam e i lutesh Zotit xh. sh, për të vdekurin

se i vdekuri nuk lutet për ty. Ai nuk ka më fuqi ti bëjë mirë të gjallëve për asgjë. Shënimet për punimet e tyre janë mbyllur. Kan leje në Ahiret në ditën e ringjalljes, që të bëjnë shefaat=të ndër-mjetsojnë për mir tekë Allahu xh. sh. pejgamberët dhe ata të mir të tjerë që ju jep leje Allahu xh. sh. Kështu thotë Kurani. Mjer ata njerëz që i shejtërojnë varret duke kërkuar ndihmë nga të vdekurit. Ndihma nuk i kërkohet askujt për veç Allahut=Zotit xh. sh. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte që i vdekuri pret ndonjë dhuratë nga të gjallët si : dhënjën e ndonjë sadakaje = dhurate të varfërve për shpirtin e tij, dua=lutje për të herë pas here Zotit xh. sh. që të ia fali atij gjynahet=mëkatet dhe këndim Kurani sevapin e këndimit dhuratë për shpirtin e të vdekurit. Ata që shkojnë e kërkojnë derman nga të vdekurit janë injorantë=të paditur dhe kështu ata bëjnë gjynah të madh ndaj Allahut të madhruar. Pejgamberi a. s. ka thënë: "Kush i lutet tjetër kujtë për derman veç Allahut xh. sh. ai njeri ka bërë shirk [i ka bërë shok Allahut xh. sh.] " Trans. Buhariu e Muslimi. Hadithi sahi = i vërtetë. Kurani thotë; "...Dhe mos lut tjetër ken veç Allahut ndonjë që nuk sjellë asë dëm e as dobi. "S. Junus. aj 106 ". Njeriu e shikon në ëndërr të vdekurin dhe flet me atë kur dëshiron Allahu xh. sh. Ndërsa pejgamberët paçin selam dhe evlijatë=miqtë e Allahut xh. sh. edhe duke qenë zgjuar kanë folur ose i kanë dëgjuar fjalët e të vdekurit. Këtë gjë e vërteton Kurani me haz. Musain a. s. dhe djalin e vetëm të një prindi që e vranë kushurinjtë e tij për ti marr pasurinë dhe Musai a. s. iu tha njerëzve të atij fshati që të gjenin një lopë lopë me këto tipare dhe ta therni atë.... dhe si përfundim djali i vdekur u ngrit e foli duke i treguar vrasësit. Gjithashtu kemi shembull tek Isai a. s., tek haz Muhamedi a.s. e tjer e tjer. Dijetari i devotshëm Hasan el Basriu tregon; Një burrë erdhi duke qa tek Pejgamberi a. s. dhe i tha atij; Unë kishim një vajzë të vogël e ajo vdiqë se mbyt në filan vend. Pejgamberit a. s. i erdhi keqë për të dhe i tha atij burrit që të shkonin të dy tek vendi që ishte mbytur. Pejgamberi a. s. i thirri vajzës së vdekur në emër. Menjëher vajza e vdekur u përgjigj : Un jam prezentë dhe i përgjigjem tani thirrjes tënde me kënaqsi. Pejgamberi a. s. i tha asaj : A dëshiron ti të këthehesh tek babai ytë? Vajza tha: Jo nuk këthehem, unë tani kam gjetur diçka më të mirë. Ndërsa imam Bejhekiu dhe të tjerë kanë treguar se Abdullahu ibni Ubejdullahu el Ensariu ka thënë Un isha aty i pranishëm

kur Thabit ibni Kajs ibni Shammas u vra shehid në betejën e Jemames dhe u varros. Kur po futej në varr pa pritmas erdhi një zë nga ai duke thënë: Muhamedi është i dërguari i Allahut xh. sh. Ebu Bekri është Siddik [i drejtë], Ymeri është caktuar për shehidë e tjera. Ne zbuluam varrin me një herë dhe shikuam nëse e kemi varrosur të gjallë pa e kuptuar por ai ishte pa dyshim i vdekur. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Mos thoni se janë të vdekur ata që u vranë në rrugën e Allahut; (jo) Ata janë të gjallë por ju mënyrën e gjallnisë së tyre nuk e shihni. "S. Bekare. Vërtetë Hazreti Ymeri r. t. a. ra shehidë kur u bë khalif=kryetarë ose pari i muslimanëve. Gjithashtu imam Taberaniu dhe Ebu Nuajimi në veprën e tij Dela' il el-Nubuvveh tregojnë këtë ngjarje prej të quajturit Numan ibni Beshirit se i quajtori Zejd ibni Harixhi pa pritur vdiq duke qënë në treg. E morëm trupin e tij dhe e çuam në shtëpi. Në kohën e mbrëmjes mes faljes së akshamit e të jacisë gratë po qanin me lot pranë tij. Në ato çaste i vdekuri thirri: Heshtni, heshtni dhe vazhdojë duke thënë: Muhamedi a. s. është i dërguari i Allahut xh. sh. Paqëja qoftë mbi ty o profeti i Allahut xh. sh. Ne menjëherë e zbuluam thanë ata por ai ishte pa dyshim i vdekur. Vëllezër besimtarë duhet ta keni të qartë se çështja e shpirtit është e pa kuptushme për neve. Për këtë Allahu xh. sh. në Kuranë i thotë profetit Muhamed a. s, kështu: "Të pyesin ty [njerëzit] për shpirtin [se qysh është] Thuaju [atyre] Shpirti është çëhtje që i përket vetëm Zotit tim [Allahut xh. sh.] e juve [thotë Allahu xh. sh.] ju është dhënë fort pak dije. " S. Isra. aj. 85. Në Kuran Allahu xh. sh tregon se kur po e krijonte njeriun ju tha engjëjve kështu: "Kur ta përsos atë [njeriun në formën e vet] do ti japë atij shpirtë që është krijes e imja. "S, Hixhër. aj. 29. Allahu xh. sh. thotë: Frymë tek ai [njeriu shpirtë] prej shpirtit tonë. "Gjithashtu Allahu xh. sh. ju tha engjëjve: "Dhe kur Un ta përsos atë [njeriun] dhe ti kemë dhënë nga ana ime shpirtë, ju menjëherë përuuni atij [nderonja atë]. "S. Sad. ajeti. 72. Nga këto ajete kuptohet qartë se trupi i njeriut zhduket pas vdekjes ndërsa shpirti i tij nuk vdes se është esencë direktë prej Allahut xh. sh. që ja ka dhënë vetë Ai dhe do ta bëjë njeriun me trup tjetër në botën tjetër pasë vdekjes, që ai ti shijojë të mirat e xhenetit. Prandaj disa njerëz të pa thelluar në dije, por që e tregojnë veten nga jashtë me mjekra si dietarë mos të nguten shumë duke dhënë fetva sipasë mëndjes e dijes së pakët që mund të kenë, se ata nuk e dinë të fshehtë. Të fshehtë e di vetëm

Allahu xh. sh. dhe bën me dije kur dëshiron, vetëm atë njeri që do Ai. Kështu thotë Kurani famë lartë. Prandaj lexoni me vëmëndje sqarimet për çështje të ndryshme që tha muxhedidja e shekullit të njëzetë, murshidja Aishe rahmetullahi alejha.

49-ALLAHU XH. SH. E NJOFTOI MUXHEDIDEN AISHE QË TË MË TËRHEQË VËREJTJE MUA TË QUAJTURIT HAXHI YMER AGA.

Ishte viti 1976 dhe unë një ditë si gjithmon shkova pas dite tek Aisheja rahmetullahi alejha. Posa hyra tek porta ajo më tha: E bëre mirë që erdhe o Haxhi se do të tregoj që mbrëm mora një njoftim nga Allahu xh. sh. në formë vërejtje për ty nëpërmjet një rrujaje=me anë të ëndrrës. Un i thash hajër inshallah. Po tha ajo inshallah. Ajo më pyeti mua: Çfar bën me librat ti more? I lexon apo i shikon? . Un pa kuptuar se çka do thoshte ajo me këto fjalë i thashë asaj : Un i lexoj. Ajo tundi kokën majtas e djathtas e pastaj më tregojë se kishte pa në ëndërr këtë pjesë filmike të vogël të filmuar nga engjëjt. Ajo më tha “Më shfaqi Allahu xh. sh. afër namazit të sabahit që ti o Haxhi ishe duke lexuar një libër të cilin e kishe mbështetur në një stol të vogël dhe sa e shihje pakë fletën e librit kaloje në faqen tjetër dhe atë po ashtu si e para, dhe të tjerat, shpejt e shpejtë po ashtu, vazhdoje. Në atë çast që ti po veproje kështu, dëgjova një zë me këto fjalë; Shikoje çfarë bën ky. [Haxhiu]” Kaq tha Aisheja ishte kjo rruja-çfaqëje filmike nga melekët=engjëjt. Dëgjo më tha Aisheja; kjo është vërejtje për ty, se kur e lexon librin, nuk e lexon me vëmëndje, por e lexon, sa për të shuar kuriozitetin. Nuk lexohet libri ashtu. Duhet ta lexosh me kujdes më tha murshidja Aishe rahmetullahi alejha. Vërtetë Allahu xh.sh. për përqëndrimin e kujdesin gjatë leximit të librit i tërhoqi vërejtjen profetit Jahja e i tha: “O Jahja, merre librin me shumë kujdes-[lexoje librin me shumë vëmëndje] dhe ashtu Ne [thotë Allahu] i dham atij urtësi [zjuarsi = maturi] që kur ishte fëmijë.” S. Merjem.Aaj.12. Ashtu është i thash un asaj. Drejtë të është shfaqur ty veprimi edhe vendi ku un e mbështes librin. Me të vërtetë un nga dëshira e madhe që kishim për të ditur sa më shumë gjëra i lexoja librat shpejtë pa u thelluar në kuptimin e tyre por vetëm që të lexoja sa më shumë libra.Dhe kur e lexoja librin e mbështesja në një stol të vogël, pasi në atë kohë nuk kishim

në shtëpi tavolinë e karrige. Që nga ajo ditë që mora vërejtje nga ana e Allahut xh. sh. nëpërmjet muxhedides Aishe rahmetullahi alejh un e ndryshova metodën e leximit dhe u përqëndrova me kujdes gjatë leximit të librave të fesë. Në atë kohë unë lexoja shumë libra. Lexoja libra të ndryshëm. Isha dhe anëtar i rregullt në bibliotekën kombtare për rreth 3-4 vjet dhe më vonë disa kohë në bibliotekën e insitutit të historisë. Unë lexoja libra fetarë dhe historik më shumë dhe më pak politikë dhe shëndetësorë. Kishim shumë etje për dituri por për shkak të biografisë pasi ishim i cilësuar kulak un nuk munda ta vazhdoj shkollën e lartë. Pa dyshim që kështu ishte e caktuar prej Allahut xh. sh. kjo gjë. Ai i krijon situatat e ndryshme kudo në botë dhe i ndryshon kur do.

Rreth vitit 1980, un i quajturi Haxhi Ymer Aga, mundohesha shumë që fenë tua predikojta së më shumë njerëz që i shihja që nuk ishin kundërshtar. Kishim një dëshirë të madhe që si i ri në moshë dhe i vetëm në atë kohë e vendë që isha unë, të kishim dhe shokë si veten. Mirpo dëshira e njeriut nuk përputhet çdo herë që duan njerëzit, me dëshirën e Allahut xh. sh. Një ditë si gjithmonë unë shkova tek shtëpia e murshides Aishe rahmet pastë. Pasi u përshëndetëm ajo më pyti se çfar po bëja dhe si i kishim punët me besimin=imanin. Un i thashë se po vazhdoj rregullishtë namazin dhe po merrrem me studime librash. Gjithashtu bëj dhe davet=thirrje për në rrugën e Allahut xh. sh. Ndërsa muxhedidja Aishe qeshi e më tha. Po qëllimin a e ke në rregull ti apo jo. Un i thashë në rregull e kam. Ajo përsëri me buzën në të qeshur më tha; Thua ti ashtu por çfar thotë Allahu xh. sh. për ty se. Un mblodha krahët dhe prita se çfar do të më thoshte. Kurse ajo më tregojë: Mbrëmë tha më shfaq Allahu xh. sh. këtë ëndërr, këtë pjesë filmike të filmuar nga engjëjt. Të pash ty që po sillej vërdallë shtëpisë me kokën kërrusur duke u menduar. Në atë moment dëgjova një zë prej anës Allahut xh. sh. që më tha për ty kështu: "Ky e ka hallin se do shokë. " Kaq më tha ishte sinjali nga ana e Allahut xh. sh, këtë rradhë për ty more djalë, prandaj rregolloje qëllimin e hyrjes në fe dhe ke kujdes të gjitha qëllimet për çdo gjë. Vërtetë feja me shokë është më e lehtë dhe je më i gëzuar por në rrugën e Allahut xh. sh. duhet të vendosesh e të qëndrosh edhe i vetëm deri në vdekje. Ky duhet të jetë për ty dhe për çdo njeri qëllimi i hyrjes dhe qëndrimit në rrugën e Allahut xh. sh. hurjes në Islam. Kështu dhe vetëm kështu është dhe

duhet të jetë besimtari i mirë, besimtari i vendosur se me shokë qëndrojnë të gjithë. Ndërsa për të bërë shokë të punojmë e të shprejsojmë aq sa do Allahu xh. sh. dhe kur do vetë Ai. Ti duhet ta dijshë më tha Aisheja se ka pasur pejgamberë që kanë qenë pa shokë. Ata kanë pas dy tre vetë që iu kanë besuar atyre dhe do të jenë dëshmitarë në ahiret që këta të dërguar thanë të vërtetën. Unë ula kokën në shenjë pranimiti plotsishtë të fjalëve që më tha murshidja Aishe se vërtetë unë doja shokë. Përsëri një herë tjetër në vitin 1986 muxhedidja Aishe më tregoi se më kishte parë mua në ëndërr mes gjumit e zgjimit, në kohën e sabahit, por që nuk e kuptova tha domethënjen e kësaj ëndrre. Ajo më tha; "Të pash ty në ëndërr o Haxhi që kishe një çallmë të cilën e mbaje në shtëpi. Në atë çallmë ti kishe futur disa letra të palosura me shënime. Ti e fute dorën në çallmë dhe nxorre një fotografi të pasaportës time dhe po e shikoje me mallëngjim. Pasi e fute brenda në çallmë e nxorre përsëri atë për ta shikuar. Këtë veprim ti e përsërite disa her. Un thash me veten time: "Çfar bën ky kështu ? Ky qenka hutuar ". Kështu ishte pjesa filmike tha murshidja Aishe. Un i thash hajër inshallah. Po inshallah e përsëriti fjalën ajo dhe tha: Kjo ëndërr mua më duket pa kuptim e duke nënqeshur më tha: Ti nuk ke çallmë se sot në vendin tonë nuk ka as xhamia e as çallma. E dyta gjë është se un nuk kam fotografi veç fotografinë e pasaportës. E treta gjë tha ajo është se çfar të duhet ty fotografia ime. Un për këtë ëndërr tha ajo nuk kam ilham ose dije nga Allahu xh. sh. për domethënjen e saj. Me kaq u mbyll kjo bisedë. Mirëpo ja se çfar ngjau pas 11 vitesh në kohën e demokracisë. Në këtë kohë un u bëra imam xhamije në fshatin tim Farkë e Tiranës. Në xhaminë ku shërbeja unë, ashtu sikurse nëpër shumë xhamija tjera, në fillim të vitit 1996 vjen një grupë besimtarësh muslimanë, të përzier, tre vetë ishin arabë dhe tre ishin turqë. Ata bënin davet=i bënin thirrje njerzvet për fe=për në rrugën e Allahut xh. sh. Njëri ndër këta turqit që ishte hafiz Kurani mua më tha; Ty o imam të kam sjellë një xhybe, dhe një çallmë që ti veshësh kur të falesh. Nuk jua lash atyre imamve të qytetit se ata i gjejnë më kollaj, por ti solla ty. Allahu ta shpërbleftë i thashë. Un i veshja por ata ishin të mëdhaja për trupin tim. Xhyben e mora dhe e rregullova te rrobaqepësi se ajo ishte e madhe për mua ndërsa çallma më mbeti në xhami. Pasi nuk doli njeri që ta merrte atë se ishte e madhe, unë atë e çova në shtëpi dhe e vura në sirtarin e bufesë. Aty në të, unë

për kollaj fillova të fus mbrenda disa letra shënimesh të mia. Në vitin 1998 muxhedidja Aishe ndërroi jetë Rahmetullahi alejha. Pas vdekjes së sajë disa komshij të saj të pa thelluara në diturin e fesë e marrin fotografinë e sajë të pasaportës për ta zmadhuar që të ia vënin tek varri, pa dëshirën e sajë. Murshidja Aishe kur ishte gjallë ju thoshte njerëzve se fotografia për qef, pa ndonjë detyrim, është e ndaluar qoftë edhe i veshur rregullishtë burri e gruaja. Lejohet për hall, për pasaportë, të dalësh në fotografi duke qenë e zbuluar vetëm fytyra për njohje. Vërtetë një nga mjetet e përhapjes së imoralitetit në botë janë fotografitë e femrave me trupin të zbuluar krejtësisht ose pjesërisht. Dhe që e kishim fjalën më sipër, fotografia e pasaportës së Aishes, më ra në dorë mua. Un e mora e solla në shtëpi dhe ia tregova nënës. Nëna posa e pa fotografinë esaj filloi të qajë nga mallëngjimi për Aishen dhe më tha ruje këtë fotografis se nxjerrim mallin me të. Un e mora fotografinë dhe e vura tekë bufeja në atë çallmën që tregova. Të nesërmen mbas dite nëna më tha: nxirre ta shoh përsëri fotografinë e Aishes se kam shumë mallë dhe un ia nxorra dhe e shikonim bashkë me nënën. Të nesërmen po kështu, të pasnesërmen përsëri po kështu. Dhe të tjetër pasnesërmen të njëjtin veprim bëra e kështu disa ditë e u bënë një javë e kohë pasi nëna kërkonte ta shihte çdo ditë nga mallëngjimi. Un e dija që dalja në fotografi, mbajtja e shikimi i tyre herë pas here është i ndaluar por meqë ishte fotografi pasaporte dhe Aisheja aty kishte dalë e vjetër në moshë, unë u hutova=çorodita fare. Kjo gjë erdhi gjithashtu dhe nga dëshira e nënës që dëshironte ta kishte kujtim fotografinë e Aishes rahmet pastë. Pas një jave kohë, mua ma kujtoi Allahu xh.sh. ëndrrën që më kishte treguar dikur muxhedidja Aishe rahmetullahi alejh, para 11 vitesh në kohën e monizmit = rregjimit me një parti të vetme, rregjimit komunistë. Menjëherë e mora dhe e bëra copa, copa fotografinë e Aishes rahmetullahi alejh. Kur un i tregova nënës për këtë gjë ajo u mërzit pak dhe më kritikojë se përse e bëra kështu këtë gjë. Un e sqarova sipas ligjit Islam. Un i hutuar sikurse më pati thënë Aisheja veprova si xhahilat=të paditurit, bashkë me gjithë nënën, që ishte e pa ditur. Njeriu është harraq thotë Kurani i madhërushëm. Allahu xh. sh. në Kuranë thotë: "Atyre [njerëzve] jua futi djalli në harresë porositë e Allahut." S. Muxhadele=Kapitulli Bisedë ajeti. 19. Vërtetë dhe mes meje e nënës time u zhvillua kjo bisedë për çështjen e fotografis së Aishesë, që Zoti xh. sh. e mëshiroftë atë. Ajo nuk mund ta

dinte se çfar veprimi do të bëja un në të ardhmen por Allahu xh. sh. ia tregoi asaj me anë të ëndrrës. Allahu e di se çfar do të bëjnë njerzit në të ardhmen. Kurani thotë: “Allahu e di atë [gjë] që punuan njerzit më përpara dhe atë që do të punojnë më vonë ata”. S. Haxh.aj. 76. Kurani na tregon : “Askush veç Allahut në qiellna e as në tokë nuk e di të fshehtë. S. Nemël.aj. 65. Vërtetë si shumë e shumë gjëra të tjera dhe kjo që tregova ishte një keramet nga murshidja Aishe prej Allahut xh. sh. e cila më tregoi se çfar do të bëja un në të ardhmen. O vëllezër besimtar nga sa thash, kuptohet qartë nga Kurani se çdo gjë që ndodh në botë ose tek vetja e jonë është e paracaktuar, është bërë plani nga vetë Zoti xh.sh. që të ndodhi ashtu ajo gjë. Ndërsa njeriu me dëshirën e tij është i lirë për ta zgjedhur atë që do. Njeriu e pëlqen e Allahu xh. sh. po deshi e krijon atë gjë. Për ta thënë më qartë njeriu është zbatues i projektit që e ka bërë= e ka planifikuar vet Allahu xh. sh. sipas dëshirës dhe dijes së tij. Elhamdulillah.

50-DISA KËSHILLA MJEKSORE QË MËRI NGA ALLAHU XH. SH. MURSHIDJA AISHE RAHMETULLAHI ALEJHA.

Aisheja qoftë i kënaqur Zoti xh. sh prej asaj, thoshte se kam marrë shumë njoftime nga Allahu xh. sh. në lidhje me anën shëndet-sore. Disa nga këto që unë i kam pas të shënuara e po i shkruaj në këtë libër. Ajo tregonte se një shoqe e saj e quajtur Caje Mali nga Kruja ishte e sëmurë nga e plevita. Doktor i kshte dhënë asaj të pi nikotibinë. Ajo gjithënjë u keqsonte më shumë. Një ditë ajo i ankohet Aishes gjatë bisedës se ilaçet që më ka dhënë doktori mua po më bëjnë më keq. Aisheja i thotë Zoti të shëroftë. Ajo i thotë më fryj ti mua se ty ti pranon Allahu xh. sh. lutjet. Kur shkova un në shtëpi tha murshidja Aishe mora këtë njoftim prej Allahut xh. sh. “Thuaj asaj mos të pijë Nikotibinë, se ajo ta shkakton tuberkulozin. ” Aisheja thoshte se për ata që janë të ftohur në mushkëri të bllokuar në rrugët e frymëmarrjes mora njoftim nga Zoti madhërshëm që të përdorin kontelion [bar kinë fushë] ta zinë e ta pijnë si çaj disa ditë tha Aisheja qoftë i kënaqur Zoti xh.sh. prej saj. Këtë mjekim me këtë lloj bari e kam përdor vetë un shkruasi i librit rrethë 1 muaj

rreshtë kur isha shtruar në senatoriumin e Tiranës i prekur në mushkëri T. B. C. dhe me dëshirën e Allahut xh. sh. unë u shërova. Doktorët e senatoriumit u çuditën me rikthimin e shëndetit, pasi ata ishin me shpresa të humbura për mua. Doktoresha e pavjonit që kujdesej për mua e quajtura Mimoza Nikolla nga Himara, pas 3 javësh kurë më futi në EKO u çudit me përmirësimin e mushkurive të mija dhe më pyeti se çfar ilaçi tjetër kishim përdorur unë veç atyre të spitalit. Unë i thashë asaj që kam përdorur 250 deri 300 gr kontelion ose ndryshe barë kinë fushë duke zier me ujë, një lugë buke të mbushur me kontelion të tharë dhe zjeva në zjarr me 300 gr ujë për 30 minuta. Pastaj e kullova lëngun dhe e piva si çaj. Doktoresha u çuditë dhe më pyeti se cili të ka treguar ty për këtë gjë. Unë tha ajo po çuditë se ti u bërë mir nga shëndeti.

Unë i thashë se këtë ilaç mua ma ka rrekomanuar një mjeke e cila ka vdekur dhe ti nuk e ke njohur atë. Unë e kishim fjalën për Aishen. Ajo mua më ka thënë : "Nikotibina nuk vlen për shërimin e plevitës së rëndë [tuberkulozit] por përkundrazi ta shkakton tuberkulozin". Kaq i thashë unë, pa e zgjatur më. Doktoreshë Mimoza e mbështeti kokën në njërin dorë dhe pasi u mendua pakë e ngriti kokën dhe foli këto fjalë : E kam lexuar në një libër mjeksie për sëmundjen e mushkurive se një mjek i njohur nga Parisi në një tribunë shkencore ka shprehur mendimin e tij se nikotibina është e pa sukseshme për të luftuar tuberkulozin por përkundrazi ajo bën të kundërtën. Por rofesorët e dëgjuar thuhej në atë libër ia hodhën poshtë atij këtë mendim. Kjo gjë që më tregove ti o Hoxhë, vërtet mua po më çuditë tha ajo. Ata më thirrnin Hoxhë pasi e morën vesht se unë isha imam xhamie. Doktoreshë Mimoza tha : Atëherë edhe indimicina që përdoret sot në spitale qenka e dëmshme se ajo është motra e nikotibinës. Me kaq u mbyll biseda ime me doktoreshën e senatoriumit Mimoza Nikollën. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha: mora këtë urdhër prej Allahut xh. sh. për veten time kështu: "Mos ha shumë yndyrna se dëmton shëndetin". Kjo këshillë sigurisht vlen për të gjithë njerzit. E kam dëgjuar prej murshides Aishe rahmetullahi alejha e cila tha: Atij njeriu që i kanë bërë shtet [magji] le të marrë krimba mëndafshi. Ti theri ata, tu heqi kokat me thikë me kujdes se edhe ata kanë shpirtë. Pastaj të pjekura ti hajë ose nëse nuk mundet ti hajë të pjekura le ti ziej në gjellë. Aisheja tha: Mora njoftim nga engjëjt të cilët vinë me urdhër të Allahut xh. sh. që unë të përdorja për veten time vitaminën H. Unë nuk e kam të shënuar se përse e

H. Un nuk e kam në shënimet e mia se përse e përdorte Aisheja këtë vitaminë, por di se ajo vuante pak në atë kohë nga sëmundja e sheqerit dhe reumatizma. Më vonë pati dhe problem veshkat. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se merrja njoftime e rekomandime prej Zotit madhrushëm se qysh të vëproja kur u un sëmuresha. E mbaj në kujtesë që ajo përdorte nenexhikun. Ajo e zjente dhe e piente por nuk e kam të shënuar se përse e pinte, pasi un në atë kohë isha i ri dhe nuk e dija rëndësinë e shëndetit e kështu nuk bëhesha kurjoz për ti shkruar të gjitha ata që më tregonte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Murshidja Aishe thoshte; Un do ta kishim dëmtuar veten nëse do të kishim përdor ilaçet farmaceutike që më rekomandonin mjekët. Ajo thoshte : Allahu xh. sh. mua më mësonte me anë të engjëjve se qysh të veproja në ngrënje, në veshje, në ndejtje e në fjetje edhe çfarë barnash të pija un për kurim, ose për shërim. Vërtetë profeti Muhamed a. s. ka thënë; Allahu xh. sh. në tokë ka sjellë sëmundjet, por ka sjellë dhe ilaçet në tokë kundër tyre. Kërkojeni ilaçin e çdo sëmundje në tokë në hallall [me atë që është e lejuar]. "Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte : Sikurë unë mos të kishim marrë dije nga Allahu xh. sh. për ilaçet që duhet të përdorësh për trupin tim, do ta kishim dëmtuar veten porë unë kam përdor gjimonë barnat ose ilaçet popullore bimore për të cilat më informonte Allahu xh. sh. me anë të engjëjve ose me anë të ëndrës.

Aisheja rahmetullahi alejha thoshte se kam marrë njoftim me Ilham=frymzim nga Allahu xh. sh, se njeriu duke ngrënë shumë, duke ngrënë ushqime me yndyrna shumë duke përdor shumë ilaçe farmaceutike dhe duke mos e ruajt shëndetin , njeriu e shkurton jetën e tij. Sigurishtë kjo me dëshirën ose lejen e Allahut xh. sh. Ndërsa për ta zgjatur jetën e vet nukë mundet kurrë njeriu ta zgjasi atë. Që njeriu ka mundësi ta shkurtojë jetën e vet, kjo fjalë është e vërtetë se Allahu xh. sh. në Kuranë thotë "Mos e vritni veten tuaj. "dhe në një ajet tjetër në Kuranë Ai thotë: "Mos e hidhni veten tuaj në rrezik" Nga këta ajete Kurani kuptohet qart se njeriu mundet ta shkurtojë jetën e vet nëse do, por për ta zgjatur atë nuk ka mundësi asnjë minut. Kjo gjë është hikmet=dituri e thellë prej Allahut xh. sh. Vëllezër besimtar siç e thash më sipër dhe po e përsëris që ta mbani në kujtesë se ngrënja ushqim të ndaluar [haram] siç është mish i derrit, ngrënja tej mase, ngrënja me shumë yndyrna dhe ilaçet e

shumta farmaceutike, vërtet këto e dëmtojnë shëndetin e njeriut. Kjo është gjë e vërtetuar nga mjekësija. Terapija moderne ka treguar se ushqimi bën efekt të madh psikologjik, moral dhe shpirtëror tek njerëzit. Për të gjitha këto ka paralajmëruar feja Islame me Kuranë dhe Pejgamberi Muhamed a. s. me hadithet-fjalët e tij, 1400 e ca vite më parë. Veç asaj që ka zbuluar mjekësija, mësimet e dhëna në Kuran shkojnë më tej, më gjatë. Allahu xh. sh. në Kuran na tregon se dhe ushqimi i fituar në mynyrë të pa ndershme ndikon në anën shpirtërore-në formimin e personalitetit të njeriut. Allahu xh. sh. në Kuran na mëson kështu: "Ti nuk do ta ushqejshë gruan e fëmijët tuaj me ushqim të fituar pa nderë". Arsya pa dyshim është se ngrënjja e një ushqimi të tillë influencon në moralin e njeriut. Feja Islame na tregon një lidhje të ngushtë të gjëndjes fizike të njeriut me moralin e tij. Veçanërishtë pra lloji i ngrënjës dhe i pijes së njerëzve luan një rol të madh në formimin e personalitetit të njeriut. Gjithashtu duhet që besimtarët të kenë kujdes e mos të hanë shumë edhe pse janë ushqime hallall-të lejshme nga feja Islame se dëmtojnë trupin dhe shpirtin e ia përngjasin qafirave=mohusave të së vërtetës. Në Kuranë Allahu për ata thotë: "Ata [qafirat] hanë pors kafshët." Për shërimin e sinozitetit muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se veprohet kështu; Zihet 6-7 kg ujë në një në një tenxhere derisa të valojë dhe aq sa ta durojë fytyra mbulohet koka bashkë me tenxheren që mos të dali avulli dhe e thith avullin e nxehtë me hundë. Këtë veprim duhet ta bësh një javë rreshtë dhe sinoziteti me dëshirën e Allahut xh. sh. hiqet. Edhe këtë llojë mjekimi e kam bërë vetë provë dhe vërtetë dhe mjekimi doli me sukses me dëshirën e Allahut xh. sh. Murshidja Aishe rahmetullahi alejh thoshte se për ata që vuajn nga veshkët, se mëllaga e egër ta zihet e të pihet si çaj disa herë në ditë, të pastron veshkat. Muxhedidja Aishe më tregoi për një njeri, se në një rast kishte marrë këtë njoftim nga Allahu xh. sh. duke qenë zgjuar kështu; "Kur ti fus Unë kancerin atij, ta shohi ai pastaj." Ishte fjala që do ta pësojë keq nuk do të gjej më shërim. Nga ky lajmë prej Allahut xh. sh. kuptohet se kanceri nuk ka dhe nuk do të ketë shërim. Kurrë nuk do gjindet ilaçi për sëmundjen e kancerit. Ky është një mikrop i krijuar direktë me urdhër të Allahut xh. sh. për njerëzit e kohës së fundit të botës. "Kur Allahu xh. sh. do që të krijojë ndonjë gjë thotë; "Kun feje kun=bëhu=krijohu dhe ajo bëhet. " S. Jasin. aj. 82. Kurani gjithashtu thotë: "Allahu krijon çfar ju nuk

dini. " S. Nahl aj. 8. Vëllezër dhe motra besimtar dhe besimtare duhet ta dini se Allahu xh. sh. ja pranonte shumë duatë=lutjet murshides Aishe rahmetullahi alejha. Asaj i vinte keq për të gjithë njerëzit që vuanin me trup-fizikishtë dhe ekonomikishtë pa dallim feje. Ajo thoshte të gjithë njerëzit janë krijesat e Zotit xh. sh.dhe Atij i vjen keq për ata por njerëzit i bëjnë keq vetes së tyre dhe njëri tjetrit. Ajo i bënte këtë lutje Zotit xh. sh. ; "O Zot drejtoi të gjithë për së mbari për nderim të dashurit tëndë hazreti Muhamedit a. s. se njerëzit nuk po dijnë se çka po bëjnë ". Murshidja Aishe rahmetullahi alejha derdhte lot nga sytë se i vinte keq për njerëzit. Ajo i këshillonte ata për tobe muslimanë e të krishterë. Ndodhi një herë që një i krishterë ortodoks që quhej Vasil banorë i lagjes Ali Demi që dikurë kishte punuar në parkun e kamjonave në Tiranë ishte i sëmurë shumë. Ai kishte sëmundjen e gangrenës në këmbë e cila ia hante=ia mbrejte gjithnjë këmbën. Çdo ditë ai keqësohej më shumë. Si përfundim mjekët i kishin thënë se nuk kishte rrugë tjetër por vetëmse me ia prerë këmbën, që mos ti kalonte mikropi sëpër gjurit. Aisheja njihej me një besimtare kristjane që quhej Pandora e cila e besonte dhe e njisonte Zotin xh. sh. Ajo kishte dyqanin ushqimorë në lagjen që banonte Aisheja. Unë e kishim pa si fytyrë Pandorën duke biseduar me muxhediden Aishe por që nuk e mbajë në kujtesë mbiemrin e sajë. Ajo e deshte Aishen e respektonte shumë. Ishte grua e zgjuar e serjoze. Një ditë Pandora duke biseduar me Aishen i tregoi asajë për sëmundjen që kishte Vasili pasi ajo e kishte atë nga fisi i saj. Ajo i tha Aishes që ti lutej Zotit xh. sh.për Vasilin se inshallah ia shëron këmbën atij. Aisheja e pyeti atë: A e di ti që Vasili e beson Zotin xh.sh. pa dyshim ?. Pandora i tha unë e di që e beson. Aisheja qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej sajë i thotë asaj, inshallah bisedojmë nesër për këtë gjë. Të nesërmen Aisheja e shoqëruar shkon tekë shtëpia e Vasilit që e kishte në lagje. Pasi e pyet që ta faktonte vetë besimin në Zotin e madhërshëm, i flet atij për toben, në krye të saj njisimin e Zotit xh. sh në çdo gjuhë që mund të dij secili njeri dhe së fundi i thotë shpresojë që Zoti xh. sh. që ka krijuar gjithësinë, Allahu madhërshëm ka me të shëruar, nëse ti e beson dhe e njison atë. Aisheja ikën në shtëpi, fal namazin dhe i lutet Allahut xh. sh. për Vasilin, që ta shëronte. Ajo merr një shishe me ujë dhe pasi i këndon Kuranë i fryn dhe ia jep Pandorës që ta pinte Vasili 3 ditë rreshtë, në tre kohët e ushqimit duke thënë fjalën Bismilah- Me

emrin e Zotit xh. sh. Aisheja i tha asajë se pas dy javësh Vasili të shkoi për vizitë te mjeku. Kurë shkoi Vasili tek mjeku tregonte Pandora, ata të gjithë ishin çuditur kur kishin shikuar se këmba e Vasilit kishte filluar të shërohej krejtësisht. Ata e kishin pyetur Vasilin se çfarë ilaçi kishte përdor. Ai iu kishte thënë vetëm kaq: Mua më ka shëruear Zoti që ka krijuar gjithësinë. Mjekët kishin mbetur të habitur dhe se kishin zgjatur më fjalën sepse feja ishte e ndaluar në atë kohë. Vasili u shëruea dhe filloi punën përsëri. Këtë gjë e di unë dhe shumë të tjerë. Kurë Vasili u shëruea, mori gruan e tijë, dhe erdhën për ta nderuar e për ta shpërblyer Aishenë sipasë traditës, por ajo ju tha atyre se unë në asnjë mynyrë nuk pranoj shpërblym megjithëse Vasili dëshironte tej mase. Muxhedidja Aishe ju tha atyre që respekti më i mir për mua në radhë të parë është që ju të këtheheni në rrugën e Zotit xh. sh. e ti mësoni fëmijët dhe fisin tuaj ta besojnë dhe ta njisojnë Zotin e madhërshëm. Nëse doni mirësinë nga Zoti xh. sh. ju thoni dhe të tjerëve që të këthehen në rrugën e Zotit xh. sh. Nëse më duni e keni respekt për mua ju, mos i tregoni të tjerëve sepse vinë e rreshtohen këtu ke porta ime njerëzit njëri pasë tjetrit, që edhe sikurë feja të jetë e lirë, unë nuk jamë e urdhëruar nga Allahu xh. sh. për shërimin e trupave të njerëzve por për shërimin e shpirtave, sado që Zoti xh. sh. mua mi pranon lutjet. Vasili së bashku me gruan e tijë vinin nga një herë sipasë rastit, për vizitë tek Aisheja. Aisheja tregonte se kurë Vasili vinte tek porta e harronte bënte Kryq. Unë thoshte Aisheja i bërtisnja atij: Mos, jo ashtu o Vasil se është i kotë dhe i dëmshëm për ty veprim që bënë ti. Zoti xh. sh. nuk vdes, dhe nuk ka tjetër Zot veç Atij që ka krijuar gjithësinë me krijesat sa janë. Edhe profeti Isa a. s. që ju i thoni "Krishti" edhe profeti Muhamed a. s. kanë qënë njerëz si ne por Zoti xh. sh. i dërgoi ata si shumë të tjerë para tyre për ti thirrur njerëzit në rrugën e drejtë në fenë e Tijë. Zoti xh. sh. është i pa vdekshëm. Vasili thoshte edhe unë e kamë kuptuar që Krishti ka qënë një nga profetët e Zotit xh. sh. e nuk ka asgjë në dorë ai, por vetëm Zoti që ka krijuar gjithësinë e ka në dorë çdo gjë por harroj e bëj kryq se që fëmijë e gjithë jetën unë kështu jam mësuar nga prindët dhe të parët tanë. Është vështirë të hiqet zakoni moj Aishe e uruar por Zoti xh. sh. na mësoftë. Njëra nga porositetë që thoshte murshidja Aishe për ruajtjen e shëndetit ishte dhe kjo. Ajo thoshte : Është e domosdoshme mbajtja në trup e trikes prej leshit të deles, për fshatarët e punëtorët që djersisin

shumë në punë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha më thoshte se një her me një shoqen time shkuam tek shtëpia e mjekut të njohur Arqile Boti. Shoqëja ime e njihte nënën e mjekut dhe mjekun. Ajo ashtu si un, ishim në atë kohë afër gjashtëdhjetë vjeç. Kur u futëm në shtëpi gjetëm vetëm nënën e mjekut në shtëpi e cila mu ankua mua thoshte Aisheja për pa gjumsinë dhe mos ngrënjen me rregull të djalit të saj doktor Arqilesë. Ajo më tha se djali më mbeti nëpër male duke mbledhur bimë mjekësore. Ai është bërë kockë e lëkurë se nuk e han ushqimin sa duhet dhe e ka harruar fare familjen. Bën ti ndonjë gjë për djalin tim. Un tha Aisheja i thash asaj se do ti lutem Zotit xh.sh. i cili ka krijuar gjithësinë dhe inshallah djali ytë e ka fat që të qetësohet siç do ti. Pasi e pyta se çfar ushqimi han djali zakonisht, ajo më tha se ai han pak. Jeton duke ngrën biskota dhe duke pir çaj. Un i thash asaj përgadite tani një gotë me çaj se do të këndoju pak Kuran e do të fryj në çaj. Ashtu bëra dhe porsa mbarova, për çudi erdhi doktor Arqileja. Si u përshëndetëm e ëma menjëher ia dha çajin e përgaditur që unë i këndova Kuranë. Doktorin nisi ta pinte çajin por e ndërpreu të pimen dhe filloi ta nuhasi atë duke hingëllin me hudë. Ai e la çajin në tavolinë e i tha nënës së tij: Nuk po më pëlqen sot çaji se nuk e paske bërë si gjithmonë atë.

Çfar ke futur brënda në çaj sot moj ?. E ëma i tha: Çaji është i mir, ashtu si herët tjera, pije të marrtë nëna të keqen, se të bënë mir. Kurse ai e la çajin në tavolinë pa e pirë e menjëher u ngrit e iku përsëri në punën e tij. Murshidja Aishe thoshte se un e kuptova që atë nuk e lënin xhindët që ta pinte çajin pasi ata ndoshta e lajmëruan që ka diçka brënda. Kështu doktor Arqileja nuk e kishte rrisk ose fat që ta qetësonte trupin dhe trurin. Allahu xh sh. thotë në Kuran: "O grumbulli i xhinëve ju mashtruat shumë njerëz. E nga njerëzit që ishin miqë të tyre do të thonë; Zoti ynë ne përfituam prej njëri tjetrit dhe arritëm afatin të cilin e caktove..."S. En-nam. aj. 128. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte ; Allahu xh. sh. i ka ndaluar njerëzit që të merren me xhindët. Ajo thoshte mos merri me xhindët, largë neve qofshin, se ata janë krijuar ndryshe nga njerëzit, si nga lënda, pamja, qëllimi e veprimi. Ata janë në kundërshtim me njerëzit. Sado pak të cënohen i sulmojnë. Për tu mbrojtur nga xhindët dhe nga shejtani ose djalli i mallkuar që është nga rracat e xhindëve, Allahu xh. sh. na mëson të lexojmë Kuran. Një nga ajetet e famshme të Kuranit për tu mbrojtur nga shejtani lanetullah, është ajeti Kursija që duhet të këndohet vazhdimisht. Prandaj dijetarët e parë Islam i

kan mësuar besimtarët, që këtë ajet Kurani ta këndojnë në mbarim të çdo namazi para numërimit të tespihëve për zikër dhe në mbarim të këndimit të këtij ajeti ti frynë gjoksit të tyre. Kjo gjë kan thënë dijetarët muslimanë bazohet në hadith. Muxhedidja Aishe rahmet pastë prej Zotit xh. sh. thoshte; Përsëritnja gjithmonë gjatë ditës fjalën Eudhu bilahi mineshejtani rrahim, kudo që të rrini e të shkoni që tu ruaj Allahu xh. sh. nga sherri i djallit të mallkuar dhe shokvet të tij magjistarëve e fallxhorëve. Gjithashtu për ti kërkuar ndimë Allahut xh. sh. që të ruaj nga xhindët këndohet surja e fundit e Kuranit En,Nas. Ndërsa për tu mbrojtur nga magjija=sihiri dhe hasreti=zilia e njerëzve që populli i thotë syu i keqë, duhet të këndonin vazhdimishtë Ajeti Kursin dhe Suren Felek, suren=kapitullin e parafundit të Kuranit. E kam pa muxhediden Aishe duke i fry vetes. Murshidja Aishe thoshte atij njeriu që i kanë bërë magji, të kërkoj shërim vetëm me Kuran se magjija = sihiri do vefkun = do ajetet e përcaktuara për atë gjë. Po kështu dhe për ata që i kan sulmuar xhindët, pasi i kan gjetur të pa mbrojtur me Kuran. Allahu xh. sh. i ruajt besimtarët nga çdo e keqe. Gjithashtu po përmendë këtu edhe Marijen nga Shkodra, që e respektonte shumë Aishen. Ajo kur e thërriste i thoshe gjithmonë : O motra ime Aishe. Marija nga dashuria që kishte për Aishenë i thoshte se jamë bër muslimane por Allahu xh. sh që di çdo gjë që fshehin njerëzit në krararorët e tyre thoshte Aisheja, më lajmëroi mua kështu : “Marija ty të do dhe të rrespekton por muslimane ajo nuk është bërë ”.

Nga kjo thënje kuptohet se nuk është e kollajtë ta ndryshojë njeriu fenë e tij. Besimtari i një feje tjetër është e pa mundur që të ndërrojë fenë që ka marrë trashëgim nga e prindët pa dëshirën dhe pa udhëzimin e Allahut xh. sh..dhe të bëhet musliman. Gjithashtu janë dhe të tjerë njerëz për tu kujtuar nga radhët e të krishterëve porë un nuk i kujtojë emrat e tyre, pasi i kishim takimet të rralla me ata. Nuk mund të lë pë përmëndur dhe besimtarene me moshë të vjetër nënë Halimen nga Gjakova e cila banonte në Tiranë dhe vinte tek Aisheja për tu interesuar për natat e mëdhaja dhe për hënën e Ramazanit. Nënë Halimja na bënte për të qeshur me fjalët e saja plot humor. Nuk e harrojë dhe një nënë çame që vinte në shtëpinë e Aishesë dhe dëgjonte këshillat e saj. Ajo i ankohej murshides Aishe për djalin e nusen që nuk i zbatonin rregullat e fesë në lidhje me pastërtinë E trupit pas kontaktimit seksual. Nëna çame i ankohej muxhedides

Aishe për sjelljen e keqe të fëmijëve të sotëm, për mos respektimin e prindërve. Ajo fliste me Aishen në gjuhën greke që mos të kuptoja gjë unë se isha djalë i rittur. Nëna çame këndonte pjesë nga Kurani që i kishte mësuar që e vogël në Çamëri. U bëjmë thirrje fëmijëve që ti respektojnë prindët e tyre, nëse duan të jenë fatë lumtur në jetën e tyre në dy botët se përndryshe do të jenë të humbur. Për çdo gjynah = mëkat që bën njeriu, Zoti xh. sh. ia vonon dënimin atij por për sjelljen e keqe që bën fëmija ndaj prindërve të tij, Zoti xh. sh. nuk ia vonon dënimin. Zoti xh. sh. në Kuran thotë: "Njisoje Allahun [mos i ban shokë Atij] dhe sillu mir me prindët." Këtu në këtë libër dua të kujtoj dhe një grua me moshë të mesme nga Gjirokastra që nuk ia kujtojë emrin por që djali i motrës së Aishes ishte martuar me vajzën e saj. Muxhedidja Aishe i fliste asaj për fenë Islame dhe urdhëresën për të bërë tobe dhe ajo dëgjonte me vëmëndje. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha fliste fjalë të mira dhe për një grua të re Boshnjake e quajtur Razije e cila agjëronte në muajin e Ramazanit në atë kohë që feja ishte e ndaluar me ligjë nga shteti shqiptarë. Razija e familja e sajë banonin në Durrës. Murshidja Aishe shkonte në shtëpinë e tyre pasi ata e respektonin familersht atë. Murshidja Aishe i këshillonte ato dhe muhaxhirët tjerë të ardhur në Shqipëri nga Bosnja që të bëjnë tobe=të largohen nga haramet me kushtin e parë largimin nga shirku nga kufri duke e njsuar Allahun në çdo gjuhë. Ajo ju thoshte atyre mos i thirrni njerëzit në gjuhën tuaj Bog, Bozhe, Bogodorica dhe në të gjitha format ose trajtat tjera si kurse i kemi treguar ata në gjuhën Shqipe. Familja e Razijes si shumë familje tjera muslimane boshnjake kishin ardhur nga Bosnja në Shqipëri shumë koh para luftës së parë botërore, ndoshta si pasojë e persekutimit nga të krishterët Serb. Në Shqipëri boshnjakve ju thoshin muhaxhirë= të ikur nga vatani i tyre = të mërguar. Ata gjinden më shumë në rrethin e Durrësit. Shqiptarët i pritën mirë boshnjakët dhe i përkrahën. Shteti shqiptar ju dha tokë atyre. Ata janë bashkuar e përzim me shqiptarët se janë vëllezër feje me shumicën e shqiptarëve. të cilët janë muslimanë. Un kam përmendur vetëm disa emra por njerëzit që e takuan dhe e njihnin murshiden Aishe rahmetullahi alejha ishin të shumtë dhe nga zona të ndryshme të vëndit tonë.

51-GJITHNJË VAZHDOJMË ME LAJMET DHE NJOFTIMET E NDRYSHME QË MORI NGA ALLAHU XH. SH. MURSHIDJA AISHE R. A.

Një ditë muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha; se Allahu xh. sh. më njoftoi me anë të rrujasë=ëndrrës kështu: Më paraqiti Allahu xh. sh. nëpërmjet engjëjve para syve të mi një thes të mbushur me krunde dhe në atë çast dëgjova një zë që më tha: "A e sheh këtë thes me krunde? Unë u përgjigja po, [tha Aisheja.]; Ashtu sikurse krundet nuk bashkohen që ti bësh bukë, edhe njerëzit sot në këtë kohë, nuk bashkohen më[në një mendim të përbashkët, për punë të mëdhaja të mira]. " Vërtetë vetëm për punë të këqia në kundërshtim me ligjin e Zotit zh. sh. bashkohen njerëzit në një mendje. Në koncerte muzikore, në diskoteka, për të pirë pije alkolike, vallzime, lojra fati, ahengje, festa të kota, sporte e plazhe e tj. Vërtetë në këtë kohë tani, me çrënjosjen e moralit në shkallë botërore nga ateizmi dhe përçarjet që ka bër ai kudo në çdo vendë të botës, si pasojë kjo e luftës kundër fesë=kundër besimit në Zotin xh. sh. sot është i pa mundur bashkimi i njerëzve për punë të mira të mëdhaja për ndryshime rrënjësore morale e sociale.

Bashkimin e njerëzve me një qëndrim të përbashkët kundër ateizmit, fëlliqësirave të tij anti morale dhe pa drejtësive të tij sociale, në shkallë kombëtare e botërore e bën vetëm feja dhe kryesishtë feja Islame e cila është feja e pranushme tekë Zoti xh. sh. Kjo është fe morale e sociale, fe e pastërtisë, e punës dhe e paqes me ata që duan paqe. Vërtetë tani është koha e fundit. Jemi në prag të kijametit-shkatërrimit të përgjithëshëm të botës. Secili që do që të shpëtojë nga e keqëja, të ruaj veten dhe familjen e tij, por mos ta lë dhe detyrën e këshillimit të tjerëve, se nuk ia humbet Allahu xh. sh të mirën që bën. Allahu xh. sh, është Ai, që ditën e bën natën dhe natën e bën ditë.

Murshidja Aishe tha se mora nga Allahu xh. sh. këtë njoftim kështu: "Mjaftojnë vetëm fëmijët e jashtë ligjeshëm [kopilat] për ta prishur një popull. "Këta fëmij nuk janë vetë fajtorë që kan lindur ilegalishtë = jashtë lidhjes së rregulltë martesore. Fajtorë për këtë gjë janë prindët imoralë që janë bër shkaktarë të ardhjes në jetë të këtyre fëmijëve ilegalishtë por fjalën këtu e kemi tek mynyra

e edukimit të tyre. Veç veseve të liga që trashëgojnë këta fëmijë nga prindët imoralë, një pjesë e madhe e këtyre fëmijëve kopila rriten në befitorë pa marrë fare edukatë prindërore sa do pak qoftë ajo.

Aisheja rahmetullahi alejha tregoi se një ditë në vitet e para të shërbimit të sajë për thirrjen në Tobe, kishte parë këtë shfaqje në ëndërr, natën e 31 dhjetorit e hyrjen së 1 janarit [e hyrjes së Vitit të Ri. Disa besimtarë musliman që agjëronin e falnin namazin kishin festuar dhe vitin e ri. Këta besimtarë që disa unë i njihja tha Aisheja, ishin duke ndenjtur ulur në formë rrethi. Përqarkë në mes tyre sillej shejtani=djalli i mallkuar lanetullah i veshur me bizhama duke i përqeshur këto besimtarë muslimanë me xhestet më të fëlliqura që ai bënte. Ishte shumë i zi me mjekër të gjatë e të pistë. Shejtani i mallkuar hidhej e përdridhej duke zbardhur dhëmbët dhe herë pas here me duart , një herë i binte prapanicave e here tjetër prekte organet e turpshme [organet seksuale] dhe u bënte njerëzve shenja të fëlliqura me duar e sy. Un thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha bërtita: Au, au. U hutua ymeti i Muhamedit a. s. dhe menjëher më doli gjumi. Allahu xh. sh. pastaj me ilham = me inspirim për brenda shpirtit më bëri të kuptoj që veshja e shejtanit lanetullah me bizhama simbolizonte festimin e vitit të ri nga që e bëjnë natën. Prandaj melekët=engjëjt ma paraqitën të filmuar djallin e mallkuar të veshur me bizhama. Festimi i Vitit të Ri ka filluar të festohet prej kristianëve që në kohën e mbretërimit të Kostandinit. Ai i detyroi priftërijtë e asaj kohe që të shtonin në ungjillë trinitetin [Ati, i biri dhe shpirti i shejtë]. Në këtë kohë ai e shpalli festë edhe natën e hyrjes së vitit të ri sipas kalendarit diellorë.

Në fenë Islame nuk ka asnjë festë sipas kalendarit diellor. Nga kristianët ortodoks dita e vitit të ri quhet: "Shën Vasili" ndërsa ditët tjera para saj quhen "Krishtlindjet." Nuk lejohet në asnjë mynyrë për muslimanët festimi i vitit të ri, as dita e 21 marsit e quajtur "Dita e Novruzit ose ndryshe dita e Sulltan Nevruzit , as dita e verës e tjera si këta që janë festa kristiane e pagane. Imami Rabani ka thënë : "Nëse muslimani feston festat e paganëve, e mexhuvet dhe vitin e ri të kristianëve [krishtëlindjet] ky veprim duke ndjekur zakonet e tyre ta humbë besimin Islam ". Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë: "Lekum dijnukum ve lije dijn ". D. m. th. Ju [o musliman] keni fenë tuaj e ata kan të tyren". Sure

Kafirun. Profeti ynë Muhamedi a. s. ka thënë : “Mos iu përngjani ju o musliman në huqe = vese e veprime [të kota e të këqia] atyre që nuk janë muslimanë”. Në një hadithë tjetër Pejgamberi a. s. ka thënë: “ Kë të duash me atë do të jeshë. ”Në natën e vitit të ri është haram për muslimanin gatimi i gjelit të detit, zbukurimi i shtëpisë me pemën e vitit të ri, nderzja e qirijvet, vizitat tek njerzit e ndonjë veprim tjetër. Murshidja Aishe tha, se mora këtë njoftim prej Allahut xh. sh. në vitin 1972 kështu: “Njerëzit e drejtë [njerëzit e sinqertë] kaluan prej kësaj bote. Për të gjetur sot një njeri që e ka frikë shumë Allahun xh. sh. është një gjë shumë e rrallë. Është njësoj sikur me gjet një shtetas të huaj në një vend tjetër të largët ”. Ajo tha se ishte fjala për brezin e lindur rreth vitit 1900. Mbi rëndësinë dhe shpërblimin e madh që ka ai njeri që ndihmon për fenë e Zotit xh. sh. dihet kjo gjë, por murshidja Aishe rahmetullahi alejha më tregoi këtë ngjarje kështu për një besimtarë të mirë. Ajo tha se filani [një njeri që un e njihja mirë], një ditë nxorri nga xhepi 1000 lekë të asaj kohe dhe më tha: O Aishe ti merri këto dhe përdori për udhëtimet që bënë në rrugën e Zotit xh. sh. që të marrë dhe unë sado pak pjesë inshaallah.

Un u çudita thoshte murshidja Aishe se ishte e para herë dhe fundit që një besimtari në Shqipëri në atë kohë i ra ndërmendë kjo gjë, gjatë shërbimit tim 40 vjeçarë. Unë tha Aisheja i thashë; Ty Allahu xh. sh. ta shpërbleftë, por un nuk kamë nevojë se e kam marrë për sipër vetë me dëshirën time këtë detyrë, por meqë ti e ke taksur këtë, unë po ta marr. Nuk kalun veçse pakë ditë, dhe në atë fshatë ku ishte ky njeriu që dha këtë ndihmën e vogël për fenë, aty u vra një burrë nga dikush. Ky njeriu që më dha dhuratën për ndimë në rrugën e Zotit xh. sh. , dikur nuk kishte folur për disa vite me këtë që u vra. Organet e shtetit me një herë kishin shkuar tek shtëpia e këtij që ndihmojë për fenë e Allahut xh. sh. duke menduar se ky e ka vra atë. Nga një herë thuhet një fjalë, të zen e keqëja pa e ba. Murshidja Aishe tha se Allahu madhërshëm më lajmëroi me anë të ëndrrës se filan njeri do të shpëtoi nga kjo akuzë e pa drejtë për shkakun e ndihmës financiare që ai e dha ndihmë për toben-për fenë. Dhe me të vërtetë ashtu doli se qeverija pasë shumë përpjekjesh e gjeti vrasësin. Kurani thotë: “Allahu pa tjetër do ta ndihmojë atë [njeri] që ndihmon rrugën[fenë]e Tij. ”S. Haxh. ajeti. 40. Muxhedidja Aisheja e Mirë, me dijen e fshehtë

që merrte nga Allahu xh. sh. paralajmëronte për shumë ngjarje të ndryshme, disa muaj e vite para se të ndodhin ato. Atë e njoftonte Allahu xh. sh, kurë ai dëshironte për të ia treguar asajë ndonjë gjë për të ia forcur besimin asajë dhe njerëzve besimtar. Muxhedidja Aishe rreth vitit 1980 tha këtë fjalë: "Unë themi se nuk ka më luftë të tretë botërore". Murshidja Aishe rahmetullahi alejha këtë fjalë e tha nga vetja e saj, pasi ajo nuk më tha mua që kam marrë njoftim prej Allahut x. sh. dhe unë për këtë gjë nuk e pyeta atë.

Muxhedidja Aishe tha "Fëmijët e kohës së fundit të dynjasë do të jenë të zjuar [do të kuptojnë shumë] por do të plaken shpejt". Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë: ". . Si do të mbroheni [ju] në një ditë [në një kohë] që fëmijët do ti bëj pleq". S. Muzemil. aj.17.

52-AKUZAT E NJERËZVE TË LIGË KUNDËR MUXHEDIDES AISHE DHE NJOFTIMET QË MERRTE AJO PREJ ALLAHUT XH. SH. DËNIMET QË ALLAHUT XH. SH. I DHA ATYRE NJERËZVE.

Vitet kalonin dhe muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, vazhdonte me shumë mundime e sakrifica nga më të ndryshmet, ta kryente shirbimin që Allahu xh. sh, ia kishte ngarkuar me dëshirën e sajë. Njerëzit me shpirtë të keq dhe xhahila-injoranta e akuzuan muxhediden Aishe, për gënjeshtare, e çmëndur, fallxhore e magjishtare por edhe për imoralitet këtë njeri të shkëlqyer me grada tek Allahu xh. sh. Kështu i kanë akuzuar edhe më parë pejgamberët paçin selam. Njerëzit e poshtër kanë akuzuar për imoralitet hazreti Musain a. s. në kohën e tij dhe hazreti Aishenë r. t. a. në kohën kur ishte vetë gjallë Pejgamberi a. s. Për të tillë njerëzish Allahu xh. sh. në Kuranë thotë: "Vërtetë, ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i prët një dënim shumë i madhë. " ...Të këqijat [gratë e pa nderëshme] janë për të këqinjte, ndërsa të ndershmet janë për të mirët, edhe të nderëshmit janë për të ndershmet..." S. Nur. Aj 23-26. I vërtetë i përkryer dhe i famshëm, është Kurani fjala e Allahut xh. sh. Me të vërtetë ata njerëz që e akuzuan për imoralitet muxhediden Aishe, këtë murshide të shekullit të njëzetë=këtë udhëzuse në rrugën e drejtë; Allahu xh. sh. ata njerëz i poshtrojë që këtu në

jetën e dynjasë, kurse në botën tjetër i pret një dënim shumë i madh. Këtyre njerëzve, ju kanë poshtruar nga të tjerët, gratë ose vajzat e tyre ose gratë dhe vajzat e djemëve të tyre që e kanë miratuar fjalën e prindëve të tyre, duke qenë në moshën e pjekurisë. Imoraliteti i tyre është kryer me dëshirë e jo me përdhunë. Në fshatin ku jetojmë dhe në qytet i dimë disa njerëz të tillë. I di mir un dhe disa besimtar të tjerë, se si e kanë pësuar këta njerëz pamvarësisht se ata vetë nuk e dinë shkakun se përse. Njeriu e harron atë të keqe që e ka thënë ose e ka bërë. Un do ti tregoja me emra personat që janë poshtruar, por një gjë të tillë nuk e lejon feja Islame. Ai që e ka bërë fajin nëse e kupton le të pendohet sinqerisht dhe ti bëjë shumë lutje Allahut vazhdimisht se po deshi Ai e fal në ahiret. Ndoshta brezat e ardhshëm drejtohen për së mbari inshaallah. Gjithashtu nuk është vetëm kjo gjë që thashë porë Allahu xh. sh. këta njerëz i ka luftuar në të gjitha drejtimet. Allahu xh. sh. i ka thënë Pejgamberit a. s. në një hadithi kudsî kështu : "Men aade li velijjen fekad aadhentehu' bil harrb, ve ma tekerr- rrebe ilej-je a' abdi bishejën eh' ab-be iljeje min mefterradh' tuhu' a' alejh. " Transmeton Buhariu.

Ky hadithë do të thotë : 'Kushdo që i bëhet armik=hasëm ndonjë të dashurit tim Unë [thotë Allahu] i kam shpallë luftë atijë njeriu.... " Ata që sot janë gjallë e dinë se çfarë kanë folur dikur për Aishenë rahmet past dhe duhet që tu kujtohet mirë. Nëse ndonjërit i duket çudi dua që mos ta provojë të keqen, por nëse e do të keqen, leta provojë. Është çudi se ashtu sikurëse e akuzuan për imoralitet në kohën e Pejgamberit a. s. nënën e besimtarëve hazreti Aishenë, r. t. a, ashtu e akuzuan edhe në fundin e dynjasë murshiden e madhe, muxhediden Aishe rahmetullahi alejha që i thërriste njerëzit me urdhër nga Allahu xh. sh, në Tobe. Në Tobe Nesuh. Disa njerëz të tjerë xhahila-të pa ditur thoshin se Aisheja, është e sigurimit të shtetit, ndërsa disa që ishin me ndonjë shkollë të mesme thoshin duhet të jetë ndonjë agjente e përgaditur nga të huajtë; sërëbët, grekët, italianët ose CIA, Amerikane.

Këta njerëz për të marrë ndonjë privilegj ose ledhatim nga regjimi Komunist në Shqipëri, kudo që ta shihnin murshiden Aishe rahmet pastë ajo nga Zoti xh. sh. shkonin e raportonin në organe përkatëse të shtetit. Më kujtohet një herë në fshatin Farkë e vogël të Tiranës në një mbledhje që bëri Aisheja me popullin e fshatit ,

një arsimtarë që kishte mësuar për fenë dhe kishte njohuri nga feja Islame, menjëher sapo ishin shpërndar njerëzit ishte nisur me biçikletë natën, pa zbardhur dita dhe kishte shkuar në qytet në degën e punëve të mbrendëshme dhe kishte raportuar për murshiden Aishe duke thënë atje se mbrëmë ka ardhur dhe ka mbledhur popullin në fshatin tonë një grua e pa njohur me emrin Aishe duke ju folur aty njerëzve për fenë. Ajo ndër të tjerë ishte e shoqëruar dhe nga kulaku Ymer Aga i cili është shkaktari që e ka sjellë këtë grua aty në fshat. Kështu spiuni ka mendur ta përzij çështjen e tobes me politikë se feja akoma nuk ishte e ndaluar nga shteti me ligjë të predikohej. Askush nuk dinte gjë për këtë veprim të fshehët që bëri spiuni kundër muxhedides Aishe rahmetullahi alejha që atë ta kapnin organet e sigurimit të shtetit dhe spiunin ta shpërblenin. Pasi ky njeriu i ligë e kishte bërë spiunimin në degën e punëve të brëndëshme, muxhedidja Aisheja na njoftoi në mëngjes neve kështu: Më lajmëroi Allahu xh.sh. me anë të një meleku kështu: “Një njeri i keq me këtë emër [filani...] ka shkuar në errsirën e natës me biçikletë në degën e punëve të mbredëshme dhe ka raportuar për ty duke shpifur= ka rrejtë e ka thënë atje se ajo gruja merret me politikë. Allahu xh. sh. veprimin e tij e ka krahasuar me veprimi e Judës kundër Isait a. s. se edhe ky ashtu si Juda shkoi natën në errsirë që të tregonte për ty ”.

Muxhedidja Aishe kur e përmëndte pastaj këtë njeri nuk ia thoshte më atij emrin që kishte por thoshte ai Juda.

Aisheja thoshte se ai kështu e ka marrë titullin tek Allahu xh. sh. Kjo ngjarje ndodhi rreth vitit 1963. Për lajmet që sjellin engjëjt me urdhër prej Allahut xh. sh. Kurani thotë: “Të gjitha lavdrimet i takojnë Allahut, Krijuesit të qiellnave dhe i tokës i cili i bëri engjëjt lajmëtarë me dy, tre ose katër krahë.” S. Fatir. aj. 1. Kishte dhe njerëz që ishin besimtarë e të sinqertë, por ishin të hutuar nga propaganda që mynafikët-dyftytrëshit bënin kundër Aishes së mirë, kundër shërbimit të sajë. Ishim një rast duke ecur me muxhediden Aishe rahmetullahi alejha, takuam një komshiun tim, një burrë besimtarë i urtë i quajtur Hasan Leci.

Pasi u përshëndetëm me të, murshidja Aishe si gjithmonë i foli atij për toben, dhe më kryesoren e sajë largimin nga shirku. Hasani pasi e dëgjojë i tha Aishes : Mirë thua ti o Aishe. Mua ma pranon mendja këtë gjë, por ne nuk po dim se kujtë ti besojmë, hoxhallarëve apo ty. Hoxhallarët na thonë se nuk është faj [shirk]

me e thirr njeriun me atë emër që thirret Zoti xh. sh. në atë gjuhë. Ajo i tha atij o xha Hasan; bani lutje Allahut xh. sh që ta bëj të qartë të drejtën e të udhëzohë tek e vërteta. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha u thoshte njerëzve gjithmonë; O njerëz përse nuk mendoni? Un nuk kam asnjë llojë interesi që lodhem me popullin për këtë çështje, me trup e financë me shumë mundime harxhoj frymën duke ju folur juve kudo që ju shoh. Unë prish qetësinë time, udhëtoj me shpenzimet e mija dhe me qefinin në krah për situatën politike që është, dhe ju kërkoi juve tu gjej atje ku rrini. Edhe unë njeri si ju jam me gjak kocka e mish. Por unë zbatoj urdhërin që më është dhënë nga Allahu xh. sh. për të mirën tuaj. A nuk kuptoni?

Murshidja Aishe ju thoshte vazhdimishtë njerëzve nëse ju jeni në dyshim për çka un ju them juve, ju lutjuni me sinqeritet Allahut xh. sh. që tua duki të vërtetën të vërtetë, dhe të keqen të keqe nëse jeni në dyshim. Allahu xh. sh. ka thënë në Kuran: "Mu lutuni që tu përgjigjem." Vërtetë Allahu xh. sh. iu përgjigjet njerëzve besimtarë që i luten Atij. Ai iu përgjigjet atyre me forma të qarta=të dukshme=direkt dhe indirekt. Un shkruesi i këtij libri ngjitur me shtëpinë time kishim një komshi besimtarë i thjeshtë pa dije fetare por që agjëronte edhe në kohën kur feja u ndalua. Ai quhej Zyber Aga. Një ditë kur shkova tek Aisheja ajo mua më tha; "Më shfaqi Allahu xh. sh. në ëndërr atë komshiun tëndë Zyberin ose Berin sikurse i thoni ju atij. Ishte duke marrë abdes e unë kalova aty afër tij. Pasi unë po kaloja ai më shikoi dhe foli këto fjalë: Nuk qenka e vërteta ashtu sikurse thonë disa horra për Aishen dhe pastaj ai i mbushi sytë me lot. Kjo tregon tha murshidja Aishe se ai është besimtar tamam." Un i thashë Aishes se e di që ai e agjëron Ramazanin por për falje namazi nuk e di se bëhet fshehur kjo gjë tani.

Muxhedidja Aishe, foli fjalë të mira për një besimtarë tjetër nga fshati Farkë e Tiranës që njerziti ja shkurtonin emrin Xhelë Molla. Ai quhej Zenel Molla dhe që shkurtimishtë e thirrnin Xhela. Ajo tha se ai është njeri i mirë. Të vërtetën tha Aisheja, se pak më vonë ky njeri u bë shkakëtar që i pajtoi dy familje në fshatin tonë Farkë që nuk flisnin me njëra tjetrën shumë kohë për një shkak. Allahu i drejtoftë tani e prapa njerëzit për nderim të mësuesit dhe bamirësit më të madhë të njerëzimit, vulës së pejgamberëve hazreti Muhamedit a. s. që është më i dashuri i Allahut=Zotit të botrave xh. sh. Aisheja qoftë i kënaqur Zoti xh. sh. prej asaj thoshte që mora këtë lajm prej Allahut

të madhëruar duke qenë zgjuar kështu:

“Nuk e kam drejtuar për së mbari këtë popull, vetëm nga sjellja e keqe që ka treguar ndaj teje”. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran thotë që Isai a. s. i tha popullit të vet: “Keni frikë Allahun dhe më respektoni mua”. S. Dhariat. aj. 4. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha gjithashtu në lidhje me këtë gjë thoshte se kam marrë nga Allahu xh. sh. këtë njoftim me ilham=inspirim kështu; “Sikur të mos kishim futur shumë zgjuarësi tek zyrtarët e lartë të shtetit, ky popull ty, pjesën më të vogël të trupit tëndë do ta bënte sa maja e gjilpërës. Për mirësinë që kam bërë për ty; ti të më bësh Mua shqyrrin-falenderimin.” Kurani thotë; “Allahu kujdeset për të mirët”. S. Araf. aj. 197. O njerëz u bëj thirrje të gjithë bëni tobe = pendohuni akoma sa pa lindur dielli nga perëndo. Më mir vonë se kurrë = se hiç fare thuhet një fjalë e urtë popullore.

Në Kuranë thuhet; “Allahu nuk i bën padrejtësi njerëzve por njerëzit i bëjnë vetes së tyre”. S. Junus. Aj. 44. Gjithashtu Kurani thotë; “Allahu nuk e humbë një popull pasi që ta ketë udhëzuar atë para se tu sqarojë atyre se prej çka duhet ruajtur [se prej çfarë gjëje duhet të ruhen ata]. Allahu është i gjithëdijshëm për secilin send.” S. Tobe Aj115. Ky ajet Kurani ndodhet në suren Tobe, dhe pikërisht për tobe bëri thirrje Aisheja e mirë. Sqarimin kryesor që ajo bëri ishte që populli të ruhet nga shirku=vënja shokë e ortakë Zotit xh. sh. të largohet nga ky faj i madh i pa falshëm e të bëjë një tobe të vërtetë=tobe nesuh duke u larguar nga punët veset dhe fjalët e këqija pergjithmon.

Ky popull nuk e pranoi kritikën e thirrjen e Allahut xh. sh. e kështu u shkatërrua nga çdo pikëpamje krejtësishtë. Allahu xh. sh. e drejtoftë tani e prapa. Megjithë këto argumente të qarta që po i lexoni në libër, populli në atë kohë, së bashku me hoxhallarët e shehelerët që kishin dije fetare, i kërkonin muxhedides Aishe ndonjë mrrekulli që atëherë ta besonin atë. Aisheja ju thoshte atyre; A nuk ju mjaftojnë argumentet e qarta të dukshme? Ndërsa mrrekullitë i bën Allahu xh. sh. kur dëshiron vetë Ai. Vërtetë Kurani tregon se të dërguarit e Allahut xh. sh. ju than njerëzve [në secilin vendë që ishin] kështu: “Ne nuk sjellim [nuk bëjmë vetë] asnjë mrrekulli pa dëshirën e Allahut...S. Ibrahim. aj. 11 Me që njerëzit filluan të kërkonin ndonjë mrrekulli nga un thoshte muxhedidja Aishe, atëherë unë mora këtë lajmë prej Allahut xh. sh. kështu: “ Nëse ata

të kërkojnë ty ndonjë mrekuulli, ti thuaju atyre; "Mrekullia që më ka dhënë Allahu mua është shkronja prej nuri [si leuha] në gjuhën arabe para syve të mi në horizont ngado që i rrotulloj sytë=nga do që un e hedh shikimin. Këtë shkronjë prej nuri do ta shohin të gjithë ata besimtarë burra dhe gra që nuk do të bëjnë shirk me gojat e tyre dhe do të largohen nga të gjitha punët e këqija [Haramet] duke bërë tobe istigfarë ". Mos u çuditni prej kësaj gjëje ju o besimtar. Shembullin e kemi tek nëna e Pejgamberit a. s. Amineja e nderuar. Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë. Në çastet kur ajo po lindte djalin e saj, Muhamedin a. s. më të dashurin e Allahut xh. sh. duke qënë zgjuar ajo ka shikuar lart në qiellë=në horizontë, tre flamuj prej nuri. Një në lindje, njëri në perëndim dhe tjetrin në kulmin e qabes.

Kjo nënë e nderuar këto flamuj dhe gjëra të tjera i shikoi në rrujetu=shikim i dukshëm me sy duke qënë zgjuar e jo në gjumë. Muxhedidja Aisheja rahmet pastë thoshte se shkronja ose fjala që më ka shfaqur mua Allahu xh. sh, dhe do të ia shfaqë atyre që do, është fjala e teuhidit=fjala e njisimit=fjala la il lahe il lallah. =Nuk ka tjetër Zot veç Allahut xh. sh. Ajo thoshte se ata që janë më të ruajtur, e shohin më të madhe dhe më të ndritur këtë shkronjën prej nuri. Me të vërtetë besimtarët e sinqert që bënë tobe të plotë e panë shkrojnë prej nuri dhe do ta shohin ata besimtarë që bajnë tobe sikurse i lajmëroi muxhedidja Aishe duke e njisuar në radhë të parë Allahun xh. sh. dhe bajnë tobe të vërtetë e të plotë me të gjitha kushtet që kemi treguar më sipër. Këta besimtar do ta shohin këtë shkronjë në formë leuhaje prej nuri, ngado që ti rrotullojnë sytë, ajo u del para syve atyre. E dhe unë e vërtetojë se pa dyshim shkronja prej nuri në gjuhën arabe, sipas formës që paraqitet te të gjithë ata që kanë bërë tobe e që në radhë të parë e njihësojnë Allahun për një të vetëm, me mendje dhe me gojë, është fjala e madhe : la il lahe il lallah =Nuk ka tjetër Zotë veç Allahut xh. sh. të cilën fjalë ia ka treguar çdo pejgamber dhe i dërgur popullit të vet.

Fjalët që thotë Aisheja janë të vërteta. Kjo gjë kuptohet dhe vërtetohet qartë nga biseda që bëri Allahu xh. sh. me Pejgamberin tonë a. s. , natën e Israsë dhe Miraxhit. Allahu xh. sh. i tha Pejgamberit a. s. kështu: " O Muhamed emrin tim Un ia kam bër pasqyrë syve të tu dhe emrin tim me emrin tënd e kamë afru. "Nga këto fjalë kuptohet që Pejgamberi a. s. nga do që e hidhte shikimin

ai shikonte në horizontë para syve të tijë emrin e madh emrin e përveçëm; Allah, La ila- he il lallah. Dhe e dyta gjë këtu kuptohet se ai njeri që ka dashuri për Allahun, duhet që të ketë dashuri për më të dashurin e Allahut xh. sh. , kryetarin e të dërguarve të Tijë hazreti Muhamed Mustafanë a. s. Gjithashtu ti duam të gjithë pejgamberët, të dërguarit, murshidat, hafizat e Kuranit, ulematë= dijetarët e fesë e gjithë besimtarët. Me gjithë këta argumente të shumta e të qarta që solli prej Allahut xh. sh. murshidja Aishe të cilat disa i treguam dhe të tjera do ti tregojmë në vazhdim, megjithatë populli Shqiptar në përgjithësi nuk u bindë me përjashtim të disa besimtarëve të pakët. Ai jo vetëm që nuk u bind me argumentet por përkundrazi u tallën duke e ofenduar si të çmendur muxhediden Aishe rahmetullahi alejha. Kështu i ka tallë dhe i ka akuzuar çdo popull gjithë pejgamberët dhe të dërguarit e Allahut xh. sh. thotë Kurani. Allahu xh. sh. ka thënë në Kuran: “Nuk ka argument që ju vjen atyre [njerëzve] nga argumentet e Zotit të tyre e që ata nuk u shmangën...E më vonë do ta kuptojnë lajmin e asajë me të cilën talleshin”. S. En-nam. aj. 4-5. Vërtetë kështu vepruan dhe Shqiptarët në përgjithësi dhe e pësuan.

Për ata njerëz që nuk i pranojnë argumentet, por tallen Allahu xh. sh. në Kuran i ka paralajmëruar njerëzit duke ju thënë: “Ata që u tallën e pësuan për shkak se talleshin.” S. En-nam. aj. 10. Kështu e pësojë dhe populli Shqiptar që ju do ti lexoni dënimet e mjerimet e tij më poshtë në vazhdim të librit. Allahu xh. sh. tregon në Kuran se kur popujve të ndryshëm ju ka çuar të dërguar për ti thirr në rrugën e drejtë e kur ata nuk janë bindur Allahu xh. sh. i ka dënuar ata me s’kamje e mjerim [varfëri, poshtrim e lodhje të madhe] me qëllim që ata të përuken. S. En-nam.

53-EDHE DIJETARËT E FESË NUK PËRJASHTOHEN NGA E BËRA GABIME.

Dijetarët e fesë nuk mund të përjashtohen nga të bëmit ndonjë gabim, përse i takon nzjerrjes së kuptimeve të ajeteve të Kuranit. Shum dijetarë në botë kanë gabuar në interpretimin e ajeteve të Kuranit të cilët tregojnë për ardhjen e Isait në tokë për dexhalin, për xhuxhmaxhuxhët, për kijametin e tjera. Muxhedidja Aishe

thoshte se një ditë unë lexova një libër të hafiz Abdullah Zëmlakut. Ai thoshte nuk është e mundur që haz. Isai të vinj përsëri në tokë, sepse kjo do të thotë se vjen profet tjetër pasë profrit Muhamed a. s. Kjo gjë është e pa mundur thotë Hafizi në librin Thëllëza, se Kurani për vdekjen e Isait a. s, thotë; " Felem ma Tevef fetejni, in ni mutevef fike". Në një ajet tjetër thuhet Kulun nefsun dhaikatul meuvt. =çdo gjë me shpirtë do ta përfshinjë vdekja. Prandajë thotë Hafiz Abdullah Zëmlaku, Isai vdiqë dhe trupi i tij mbeti në tokë ndërsa shpirti e tij e mori Allahu xh. sh. si gjithë shpirtat e tjerë. Muxhedidja Aisheja rahmetullahi alejha thoshte se kur e lexova këtë shkrim, u çudita se ne e dinim nga dijetarët e parë Islam që Isai a. s. do të zbresë përsëri në tokë dhe fillova të mendohem thoshte ajo pasi më hyri dyshimi nga fjala e tij. Allahu xh. sh. që dinë çdo send sado i vogël që i shkon njeriut në mendje, më solli këtë lajmë; "Mos ban dyshim se dyshimi njeriut i prish imanin=besimin.

Dijetarët e parë që kanë shkruar se Isai do të zbresë e kanë në rregull [fjalën], kurse Hafiz Abdullah Zëmlaku, këtu e ka gabim, se unë bëjë si dua vetë. "Allahu xh. sh. në Kuran thotë; "Atij [Allahut] nuk kanë të drejtë njerëzit ti bëjnë vërejtje. "S. Nebe=Lajmi. Aj. 37. Në suren Zuhruf Allahu thotë ; "Ai-Isai është parashenja e momentit= kiametit, pra kurrë mos dysho në të-[për ardhjen e tij.]"Po kështu dhe Pejgamberi a. s. me hadithë=fjalët e tij ka lajmëruar për ardhjen në tokë të hazreti Isait a. s. Mynyra si do të vinj e din vetëm Allahu xh. sh. e askushë tjetër.

Fjalët që thotë gabimishtë Hafiz Abdullah Zëmlaku në librin e tij i ka thënë para njëqindë vjetëve i quajhuri Ahmed Kadijani në Indi, ku sot është shteti i Pakistanit. Ai e shpalli veten profet dhe thoshte se jamë Mesiu dhe Mehdiu i paralajmëruar. Ai thoshte se Isai i biri i Merjemes vdiq dhe varri i tij është në lagjen Khanjer të Sringerit në Kashmir në Indi në krahinën Panxhab dhe Isai a. s. nuk vjen më për së dyti në këtë botë. Kadjanitë ose sikurse e quajnë veten ata Ahmeditë, thonë që Isai u gozhdua në kryq, por ai nuk vdiq në kryqë se vetëm disa plagë të lehta mori se nuk ia thyen kockat si atyre dy të tjerëve që ishin hajdutë dhe ishin varë në kryqë anash tij. Ndërsa Kurani thotë: ". . Por ata as nuk e vranë atë e as nuk e kryqëzuan, por ashtu iu duk atyre. "S. Nisa. aj. 157. Kështu që kjo që thotë Ahmed Kadijani është e krejtësishtë e pa vërtetë.

Ai thotë se pasi e zbritën Isain a. s. si të vdekur ai u shërua dhe iku nga vendi i vetë dhe erdhi në Indi në krahinën Panxhab për të këkuar delet e humbura njerëzit nga fisi i Izraelit. Qëllimi i tyre me të tilla thënje në kundërshtim me Kuranin ishte që të formonin anglezët e të tjerët, shtetin e Izraelit në lindjen e largët, në atë kohë që shteti Izraelit nuk ishte i formuar në lindjen e mesme. Kadjanitë e përkëthejnë dhe e komentojnë Kuranin dhe hadithet e Pejgamberit a. s. si pas dëshirës së tyre. Ata paraqiten si muslimanë të në dukje por sekti i tyre udhëhiqet nga anglezët e çifutët e budistët prandaj ata nuk i trazon=nuk i lufton askush nga shtetet kristiane dhe as çfutët e as budistët.

Kjo gjë shihet dhe në Kuranin që kanë përkëthyer ata në gjuhën Shqipe. Ja një shembull: Allahu xh. sh. në Kuranë në Suren Muëminun=Kapitulli Besimtarët në ajetin 50 thotë: "Edhe të birin e Merjemes dhe nënën e tij i paraqitëm si argument [mrekulli] dhe i vendosëm të dy në një vënd të lartë të rrafshët dhe me ujë rrjedhës. " Ndërsa Kadjanitë e kanë përkëthye dhe e kanë interpretuar kështu ajetin e Kuranit : Dhe birin e Merjemes dhe nënën e tij e kemi bërë një shenjë, dhe u kemi dhënë strehim në një vënd të lartë me plot luginë e burime me ujë të rrjedhshëm. Ky vend thonë Kadjanitë, siç na tregon historia, është Kashmiri në Indi. Këtë gjë thonë ata e vërteton Bibla dhe historia e jehudive-çifutëve dhe e Hindusëve. Themelusi i shoqërisë Xhemati musliman Ahmadia ka shkruar një libër me titull Mesihu=Isai në Indi ku themelusi i kësaj shoqërie thonë ata hedh dritë për udhëtimin e Isait në Indi e jo në qiell dhe rreth vdekjes së tij në atë vëndë ku gjindet dhe varri i tij. Dhe tre ajetet tjera ata i kanë përkëthyer kështu: Ne [thotë Allahu] ju tham : O ju profetë: Hani prej gjërave të pastra dhe bëni vepra të mira. Vërtetë Un jam në dijeni ndaj asaj që bëni ju. Dhe ta dini se ky komunitet i juaj [i profetëve] është i vetmi komunitet, dhe Unë jam Zoti juaj. Pra më pranoni mua si mbrojtësin tuaj. Dhe ta dini se ky komunitet i juaj [i profetëve] [këtu është fjala për komunitetin e çifutëve gjoja që ka qënë në Indi] është i vetmi komunitet, dhe Unë jamë Zoti juaj. Pra më pranoni Mua si mbrojtësin tuaj. Ndërsa Allahu xh sh. në realitet në Kuran thotë kështu: "[Ne iu patëm thënë të dërguarve] O ju të dërguar, hani atë që është e lejuar dhe e mirë-e pastër dhe bëni vepra të mira se Unë e di atë që ju veproni. Kjo feja juaj [ligji ose rruga që u kam dhënë Unë juve] është e vet-

mja fe e Un jam Zoti juaj, [thuajuni popullit] runju dënimit tim. E ata [popujt] më vonë u ndanë në grupe sipas çështjes së fesë dhe secili grup krenohej me atë që kishte përvetësuar [me atë që kishte arrit të mësojë]"S. Muëminun aj. 51, 52, 53. Në suren Rrahman, në ajetin numër 19 dhe 20 Allahu xh. sh. thotë: "Ai [Allahu] lejoi dy detet të puqen ndërmjet tyre. Ndërmjet atyre të dyve është një pengues [lëndë ndarëse] që ata nuk e kapërcejnë. "Pra secili qëndron me veçoritë e veta nuk përzihen. Shembull kemi naftën ose vain e ullirit po ti hedhim në ujë ata qëndrojnë të ndarë nga uji. Ndërsa Kadjanitë e kanë përkthyer dhe e kanë komentuar ajetin e Kuranit sipas mendjes e dëshirës së tyre tjetër për tjetër kështu. Ai do ti bashkojë dy dete, kështu që një ditë do të bashkohen. Ndërmjet tyre tani për tani është një pengesë për shkak të sëlilës ata nuk mund të bashkohen.

Ata thon se fjala dy detet është për detin e kuq dhe detin e baedhë ose oqeani Atlantik dhe oqeani i Qetë ose Paqësorë. Dy pengesa kanë qënë ndarja e këtyre deteve para se të çahet kanali i Suezit dhe ai i Panamas. Kurse në ajetin 31 të kësaj surje Allahu xh. sh. thotë: Ne do të merremi me [llogarinë për] ju, o dy të rëndësishmit [njerëz dhe xhindë] Ndërsa Kadjanitë e kanë komentuar kështu: Ne së shpejti do të angazhohemi për ju [do të ju drejtohem juve] o ju dy superfuqi = Amerika e Bashkimi Sovjetik. Kështu si këto ajete Kadjanitë kanë përkthyer e komentuar sipas dëshirës së tyre shumë ajete të Kuranit sipas mendjes e dëshirës së tyre që të çojnë në qyfer-kufër në mohimin e të vërtetës.

Kadjanit thonë se Pejgamberi ka thënë, se Isai kur do të zbresi në tokë do të ti presi kokën njerëzve të pa fe ateistave=dexhalave dhe do të vrasin derrat e do të thyej kryqat. Ata tallen duke thonë se: Nuk është logjike që të besosh se profeti i Zoti xh. sh. hazreti Isai a. s. kur të zbresi në tokë do të marrin çiftin e do të dali të vrasin derrat e shkretë, dhe do të ngjitet nëpër çatijat e kishave për të thyer kryqet. Gjithashtu ata thonë, ai nuk do të vinjë që ti fusi me detyrim njerëzit në fenë Islame se Kurani thotë ; "Nuk ka shtërngim=dhunë në fe. " Por Kadjanitë ose ndryshe ata e quajnë veten Ahmeditë bëjnë kufër-e mohojnë të vërtetën me fjalët që thonë për Isain a. s. se ai nuk vjen më në tokë. Ata thonë Isai dhe Mehdiu ishte Ahmed Kadjani. Ndërsa kur unë e pyeta muxhediden Aishe rahmetullahi alejha për çështjen e Mehdiut ajo tha se nuk kam lajm nga Allahu

xh. sh. për këtë çështje. Fjala ose emri Mehdi tha muxhedidja Aishe, është titull dhe do të thotë= i udhëzuar [njeriu i udhëzuar] dhe nuk është kuptimi për një njeri që ka emrin Mehdi skurse mendojnë e thonë disa njerëz. Kadjanitë ose ndryshe Ahmeditë tani në kohën e demokracisë [liri pa kufij] kanë ardhur dhe në Shqipëri. Ata kanë shoqatën e tyre dhe kanë ngrehur një xhami të madhe me dy minare në Tiranë tek fillon autostrada Tiranë-Durrës pranë fshatit Mëzez. Dhe që e kishim fjalën më sipër për xhihadin-luftën ajo është farz= urdhër i Allahut xh. sh. nëse të sulmon kush thotë Kurani famëlartë duke i treguar me hollësi veprimet e luftës me këta ajete.

Allahu xh. sh në Kuran thotë: " U bë farz për ju lufta [me armikun] duke qenë ajo e vrazhët [e pa dëshiruar për ju]." Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë: "O besimtar vrituni [luftoni] në rrugë të Allahut me ata që vriten[që luftojnë me ju]. " Dhe thotë: "Vrituni në rrugë të Zotit me armikun e fesë se Zoti i dëgjon fjalët dhe i di qëllimet e punët e juaja." S. Bekare. Ndërsa për ata njerëz ose popuj që nuk luftuan kundër muslimanëve, Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Allahu nuk ju ndalon [juve o muslimanë] të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata [njerëz] që nuk ju luftuan [juve] për shkak të fesë e as nuk ju dëbuan-nuk ju shpërngulën me forcë] prej shtëpijave tuaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësi. "S. Mumtehine= kapitulli Sprova. aj. 8. Sipas një hadithi të Pejgamberit a. s. xhihadi =lufta është një nga farzet e rëndësishme e nga sevebet=mirsitë ia kalon të gjitha të tjerave veç namazit jo. Se Allahu xh. sh. në Kuranë thotë; " Vema halaktul xhinne vel inse il la lijaë buduun. " d. m. th. [Nuk i kam krijuar për tjetër gjë xhindët dhe njerëzit, vetëmse të më falen Mua.]Pra edhe në luftë nuk lejohet të lihet falja e namazit, por ka rregull tjetër.

Allahu xh. sh. e ka bër farz=detyrë luftën kundër armikut tënd kur të sulmon se feja, atdheu, nderi e familja mbrohen me luftë duke dhënë jetën për ta. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ishte pro xhihadit-luftës së drejtë. Ajo nuk e kundërshtonte xhihadin-luftën e drejtë kurë armiqtë të sulmojnë për shkakë të fesë dhe të kanë njerrë nga vëndi ytë. Ajo thoshte e kur më është ajo ditë që un të vritem në një luftë të drejtë për të mbrojtur fenë dhe vëndin tim? Ajo ishte për atë xhihadë që është qëllimi me mbrojtë të vërtetën, fenë nderin vëndin vëllezërit dhe motrat, duke dhënë shpirtin me fjalën e fortë në gojë: La ilahe il lallah-Nuk ka tjetër Zot veç Allahut xh.

sh. dhe jo që nën maskën e fesë, munafikët-dy fytyrëshit të kenë qëllime të tjera dhe i shfrytëzojnë besimtarët e sinqertë të Zotit xh. sh. për llogaritë e tyre. Munafikët si më të rrezikshmit bashkë me qafirrat, për të ia arritur qëllimeve të tyre, shumë here kanë shfrytëzuar e shfrytëzojnë sot besimin e fortë të muslimanëve të sinqertë duke i përdorur ata si mish për top në shumë vende të botës për hesapet e tyre. Sigurisht që kështu ateistët kanë vepruar dhe me besimtarët kristianë. Faktet kan qenë dhe janë kokëforte sotë për këtë gjë në shumë vende të botës. Muslimanët në radhë të par duhet të largohen nga shirku i madh në çdo gjuhë. Duhet ta lartësojnë emrin e Allahu xh. sh. në çdo gjuhë. Pastaj do ti lartësojë edhe Allahu xh. sh. ata. Në Kuran Allahu xh. sh. thotë: "Pra ti [o njeri] lartësoje emrin e Zotit tend [Allahut që të ka krijuar]. "Ndërsa sot disa muslimanë në vende të ndryshëm i thërrasin parinë e tyre me titullin Mullah [filani] sikurse i thonë Omarit të Alkaedës e tjerëve që persisht do të thotë Allahu im, = Shqip im Zot ose Zoti im ose arabisht Allahu im. [estagfirullah, estagfirullah.] Kurse në gjuhën arabishte muslimanët po përdorin për parinë e tyre titullin Mevlana= i lartë madhërueshmi. Por Kurani thotë; "Vetëm Atij [Allahut xh. sh.] i takon lartëmadhërija [mëdhërimi i lartë] në qiellë e në tokë. "S. Xhathije. aj. 37. Kurani na mëson që kur ti lutemi Allahut xh. sh. ti drejtohem i atij me përlulësi e ti themi kështu: "Ente Mevlana fensurna alel kauvmil kafirijn."= Ti je i madhërueshmi dhe na ndihmo kundër popullit qafir-mohusë i së vërtetës.] Sure. Bekare. Shih tek ajeti Amene rresul. . . Sa për luftat që bëhen çdo herë kudo nëpër botë, ata nuk i ngrehin besimtarët muslimanë, se Kurani na ndalon neve muslimanëve që të luftojmë me ata që nuk na shpallin luftë dhe nuk na nxjerrin neve nga vëndet tona. Nëse të tjerët e fillojnë të parët luftën kundër nesh atëherë ne jemi të lejuar dhe të urdhëruar nga Allahu xh. sh. në Kuran, që ti kundër përgjigjemi atyre që na sulmojnë me të njëjtën mynyrë dhe tu bëjmë atyre atë që na bëjnë ata neve muslimanëve. Kjo gjë pa dyshim është ligjore dhe logjike. Muslimanët vetëm se mundohen dhe luftojnë për të mbrojtur veten, fenë, vëndin dhe traditat e tyre të mira kulturore kombëtare. Kjo gjë është e qartë dhe për njerëzit e thjeshtë. Muslimanët sot nuk kanë fuqi ushtarake dhe ekonomike që të maten me perëndimin e lindjen por Kurani thotë se Allahu xh. sh. është me të drejtët. E për ata që bëjnë luftë të drejtë Allahu xh. sh.

thotë kështu: "Allahu është shumë i fuqishëm dhe triumfus". S. Haxh. Vëllezër besimtar nuk ka luftë në botë dhe ngatërresë e çdo lloj kategorije qoftë ajo që mos të jetë aty dora e çifutëve. Qëllimi i tyre është përplasja e muslimanëve me të krishterët e kështu që ata të dalin të fituar nga çdo anë. Allahu xh. sh në Kuran për ata na ka pralajmëruar kështu: "Ata [çifutët] përpiqen për shkatërime në tokë. Allahu nuk i do ngatërrestarët." S. Maide. Ajeti.64. Ata që i akuzojnë muslimanët për terrorista janë vetë ashtu. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se; ajo që i dallon gjërat si do që të jenë, sot është vetëm Tobja=pendesa, hyrja e qëndrimi në tobe që kushti i parë i sajë është me e njësiuar Zotin-Allahun xh. sh, me u larguar nga shirku=kufri ose ndryshe qyfri që po bëjnë njerëzit me gojë orë e çast në çdo gjuhë që flasin. Pra me i qëndruar besnik në çdo gjuhë, fjalës La ilahe il lallah=Nuk ka tjetër Zot veç Allahut xh. sh. Allahu xh. sh. në Kuran thotë : "Janë të shpëtuar ato [njerëz] që thonë Allahu është Zoti ynë dhe qëndruan besnikërishtë." S. Ahkaf. aj. 13. Pra nuk e mohuan këtë thënje në asnjë lloj gjuhe.

Për këtë fjalë të madhe kanë ardhur e janë përpjekur dhe janë munduar të gjithë pejgamberët dhe të dërguarit e Allahut xh. sh. thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. "Pejgamberi ynë a. s. është përpjekur 13 vjet pa u ndarë, për tua bërë të qartë njerëzve domethënien e kësaj fjale të fortë dhe qëndrimin në të. Në Inxhil fjala e fortë=fjala: La ilahe il lal lah quhet Fjala e Madhe e cila do të thotë; Nuk ka tjetër Zot veç një Zoti xh. sh. pamvarsishtë ndryshimeve që i bënë çifutët Teuraitit e Inxhilit. Nga shumë dijetarë Islam është thënë se vrasja që do ti bëjë Isai a. s. dexhalit ose dexhalëvet=mashtrusave të mëdhej=[ateistave të rrafinuar e të shfrenuar për poshtërsira] që thuhet në hadithin e Pejgamberit a.s. mund të jetë në mynyrë metaforike dhe e ka kuptimin vrasja ose zhdukja e kufrit-mohimit të së vërtetës, zhdukja e gënjeshtres së madhe, hedhja poshtë e të pa vërtetës duke ia prerë rrënjat asaj me argumente e mrekulli të dukshme duke vërtetuar kështu fenë e vërtetë Islame. Por atëherë do të jetë vonë për dexhalat=ateistët e rrafinuar se atëherë ka arritur koha e lindjes së diellit andej nga perëndimi dhe kështu që atyre nuk ju bën më dobi. Ndërsa një pjesë nga dijetarët Islam duke e marrë hadithin ashtu drejtë sikurse është folur kanë thënë se haz. Isai a. s. do ti zhduki me shpatë [me luftë]

dexhalat në gjithë botën. Nëse në hadith=[fjala e Pejgamberit a. s.] nuk është me nënkuptim atëherë haz. Isai a. s. do të ketë ndihmë e fuqi të madhe prej Allahut xh. sh. dhe do ti vrasido ti zhduki me forcë dexhalat=ateistat nga faqëja e tokës. Nëse Isaia. s. do ti zhduki ateistët me anë forcës=me luftë atëherë unë shkruesi i këtij libri që jamë imam xhamie mendoj se ai do të ketë nën komandë ose ushtri prej engjësh ose ushtri prej njerzish besimtarë të mir e të fortë. Nëse do të ketë ushtri prej njerzish nuk dihet se nga do të jenë këta njerëz. A do të jenë njerëz besimtar të devotshëm e të fortë këtu nga toka=planeti jonë që Isai a. s. me ndihmën dhe fuqinë e Allahut xh. sh. do ti bashkoi ata në çdo vendë e do tu prij atyre si komandantë në fushëbetejat e luftës kundër dexhalëve apo do të jenë njerëz nga planeti tjetër sipër tokës tonë që për ekzistencën e tyre atje na tregoi me njoftim direkt prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe dhe indirekt na tregon Kurani. Për këtë gjë folëm në kapitullin 37.

Nëse do të jenë njerëz nga planeti tjetër unë mendoj se ata duhet të jenë me një teknikë luftarake tepër të përparuar në krahasim me teknikën luftarake që ndodhet sot në planetin tonë në tokë. Ndërsa për ndihmesën e Allahut xh. sh. me ushtri engjëjsh na tregon Kurani kur Allahu xh. sh. e ndihmoi profetin Muhamed a. s. në luftën e Bedrit kundër idhujtarëve me 5000 engjëj. Në fillim i dërgoi 1000, pastaj 2000 dhe së treti dhe 2000 të tjerë. Allahu xh.sh. i tha të dërguarit të Tij kështu: "... Zoti juaj ua vazhdoi juve ndihmën me 5000 prej engjësh të ushtruar =[të përgaditur për luftë] e të shënuar [me shenjë dalluse]. S. Ali Imran. Aj. 24. Dijetari i njohur musliman Fahrudin Rraziu në tevsirin e tij të Kuranit tregon se Ibni Abazi [djali i xhajës së Pejgamberit a. s.] ka thënë se engjëjt në luftën e Bedrit kanë ardhur kalorës me kuaj Kira dhe në kokë engjëjt kishin çallma të verdha.

Ndërsa kuajt kishin në kokën dhe bishtin e tyre nga një copë pëlhurë të bardhë me të cilën shenjë dalloheshin nga njerzit me kuajt e tyre. Nga tregimi i Ibni Abazit mendoj unë ka mbetur zakoni i pëlqyshëm [mustehabë] tek muslimanët deri më sot që kur shkojnë krushqit me kuaj ose me makina për të marrë nusen, ata iu ven kuajve të tyre nga një shami tek koka e tek bishti për tu dalluar nga kuajtë e tjerë të rrugës. Për ndihmën që iu ka dhënë Allahu xh. sh. me ushtri engjëjsh Pejgamberit a. s. me shokët e tij na tregon

Kurani shum qartë në suren Enfalë ku Allahu xh. sh. ju thotë atyre kështu: "Përkujtojeni [ose përmendeni atë kohë] kur ju kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj, e Ai ju ndihmoi me njëmi [1000] engjëj që vijnë një pas një [që erdhën njëri pas tjetrit".S. Enfalë. Ajeti. 9. Kështu që nuk dihet si, qysh dhe kurë do të zbresi Isai a. s. në tokë. Këtë gjë përveç Allahut xh. sh. nuk e din askush tjetër. E ditur dhe e qartë plotësishtë është kjo gjë se: Isai a. s. do të zbresi pa dyshim në planetin tonë=në tokë. Ai do të deklarojë se feja e vërtetë e pranushme tek Zoti xh. sh. është feja Islame dhe do të zbatojë sheriatin Islam=ligjin fetar të muslimanëve. Koha se kur do të zbresi ai, para apo pas lindjes së diellit nga perëndimi dhe si do të veprojë ai kur të vinjë, kjo gjë nuk dihet ekzaktë. Allahu xh. sh. në Kuran thotë;

"Ne do tua bëjmë atyre [njerëzvet] të mundur që të shohin argumentet tona në horizontë [në këndë vështrime të gjëra, në tokë e në qiellë] dhe në veten [trupin] e tyre, derisa tu bëhet e qartë atyre se Kurani është i vërtetë. [Nga Allahu=nga Zoti xh. sh. Krijuesi i Gjithasis]. "S. Fusulet. ajeti. 53. Ndërsa për vrasjen e derrave dhe thyerjen e kryqave fjala e ka kuptimin se duke u zbuluar me fakte shkencore mjeksore të vërtetat që thotë Kurani për dëmin e madhë që shkakton mishi i derrit atëherë ky do të zhduket si ushqim se njerëzit nuk do ta përdorin më atë. Ndërsa për thyerjen e kryqeve është qëllimi se njerëzit në kohën e fundit, në kohën e zbritjes së Isait në tokë, me argumente të dukshme, njerëzit do ta kuptojnë që kryqi nuk është asgjë, por ka qënë vetëm një shpikje nga çifutët për të mashtruar njerëzit. Allahu thotë në Kuranë;"A nuk e ke kuptuar se Allahu bëri shembull fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë [në tokë] e degët e saj janë lartë, e që me vullnetin e Allahut ajo e jep frutin e vet në çdo kohë. Allahu u parashtron njerëzve shembuj që ata të mendojnë. S. Ibrahim. aj. 24, 25.

Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë;"A nuk i shikove ata që dhuntinë e Allahut e ndërruan me mosbesim dhe popullin e vet e sollën në vëndin e shkatërrimit. "S. Ibrahim. aj. 28. Ndërsa qëllimi i anglezëvet me Ahmed Kadijanin ishte mesa kuptohet qartë që të formonin në krahinën Panxhabë të Indisë=sot Pakistani, shtetin e Izraelit, para se të themelonin atë në lindjen e mesme në Palestin në vitin 1948 ose të bënin dy shtete izrailite, një në lindjen e largët dhe një në lindjen e mesme. Un e pyeta muxhediden Aishe në lidhje

me Ahmed Kadijanin i cili kishte thënë se jam muxhedid me lajme nga Zoti xh. sh. Aisheja më tha: Un nuk kam njoftim nga Allahu xh. sh. për këtë njeri që ky njeri ka qënë i ngarkuar me shërbim nga Allahu xh. sh. Kuptohet pra që ai ka qënë rrenacak. Unë thoshte murshidja Aisheja kam njoftim nga Allahu xh. sh. për një burrë në Turqi, që ka qënë me shërbim të caktuar nga Allahu xh. sh. në atë vendë. Nuk ka më shpallje të re=ligje tjera të reja veçë atyre që jan në Kuran thoshte murshidja Aishe që Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë. Nga ata fjalë që thotë Ahmed Kadijani kuptohet qartë dhe vërtetohet plotësishtë dhe pa dyshim që ai ka qënë fallsifikatorë. Edhe në kohën e Pejgamberit a. s. doli Muselejme Ked- habi i cili e shpalli veten pejgamber.

Siç e thash mjaftojnë fjalët që thotë vetë Ahmed Kadijani, për hazreti Isain a. s. për ta kuptuar se ai ishte gënjeshtarë. Allahu xh. sh. në Kuranë pë Isain a. s. thotë; "As nuk e vranë e as nuk e kryqëzuan por ashtu iu duk atyre. "S. Nisa aj. 157. Eshtë e qartë pra plotësishtë se Isai a. s. do të zbresi përsëri në tokë, sikurse e treguam më sipër me argument nga Kurani e hadithi. Ndërsa Ahmed Kadijani ka thënë se Isai a. s. nuk vjen më në tokë e tjera e tjera. Pretendimin e tij e hodhi poshtë sikurse e thashë më sipër, mursshidja Aishe, muxhedidja e shekullit të njëzetë, me lajmet dhe njoftimet që mori prej Allahut të madhëruar xh. sh. Prandaj solli Allahu xh. sh. her pas here në çdo njëqindë vjet, pas Pejgamberit, a. s. nga një muxhedidë [ripërtëritës të fesë], për ta pastrar fenë nga bidaded-shpikjet që fusin njerëzit në të. Allahu xh. sh. i solli muxhedidat në ato vënde ku Ai e shikoi të arsyeshme për tu a bë të qartë njerëzve shumë çështje të ndryshme, kur njerëzit e humbënin rrugën e drejtë. Sado të mirë e të ditur që të ishin dijetarët e fesë nëpër botë, nuk është e mundur që ata të ishin në një mendim e të mos të gabonin në komentimet e shumë ajeteve të ndryshme të Kuranit. Ndërsa muxhedidat ishin me shërbimë prej Allahut xh. sh. dhe nuk gabojshin se ata udhëhiqeshin qartë e drejtë me dije direkt prej Tij.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha është muxhedidja e fundit në botë, për thirrje në tobe e cila dha sqarime dhe për disa çështje të tjera të ndryshme që do ti lexoni më poshtë. Pas muxhedides Aishe nuk vjenë muxhedidë tjetër me shërbim prej Allahut xh. sh. Veç çështjes së thirrjes në tobe ajo dha sqarime dhe për disa çështje

të ndryshme fetare të kuptuara gabim ose jo qartë nga dijetarët e fesë. Tani jemi ballë për ballë me kijametin, jemi në çastet e fundit. Njerëzvet ju duket çudi e madhe se Allahu xh. sh. dërgoi një grua afër kijametit me shërbimin e thirrjes së ymetit të Muhamedit në Tobe dhe që sqaroi disa çështje të rëndësishme të koklavitura fetare Islame. Muxhedidat që erdhën në çdo shekull pas Pejgamberit a. s. ishin të ngarkuar nga Allahu xh. sh. për ta pastru fenë nga pluhurat e shekullit, nga bidadet nga pa qartësitë e dyshimet që fusni në të munafikët dhe qafirat. Edhe në kohët e vjetra ju është dukur çudi njerëzvet të asaj kohe kur Zoti xh. sh. dërgonte ndonjë të dërguar për ti thirrur ata në rrugën e drejtë, për tu treguar atyre besimin e vërtetë. Këtë gjë e tregon Kurani, se ata thoshin; "A thua Allahu dërgoi njeriun Pejgamber=lajmëtarë"? S. Isra. aj. 94. Por njerëzit gjithmonë i huton djalli i mallkuar se nuk studiojnë e nuk mendojnë. Allahu xh. sh. thotë në Kuran : "E kemi zbritur Kurandin që ti studiojnë argumentet e tij ata [njerëz] që mendojnë=që kuptojnë. "S. Sad. aj. 29.

54-TAKIMI I PARË I MUXHEDIDES AISHE ME JUSUF SALKURTIN NGA DIBRA ISH MYFTI NË ELBASAN, KAVAJË DHE GRAMSH.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha gjatë shërbimit të saj u njoh me shumë njerëz besimtarë. Njëri ndër ta ishte dhe Jusuf Salkurti nga Peshkopija që ishte djalë i ri në atë kohë. Ishte i zgjuar e i thjeshtë. Unë e njoha Jusufin në vitet 1986-88, kur erdhi ushtarë në fshatin Sauk të Tiranës. Njohja ndodhi rastësishtë kështu; Unë një ditë isha për një hallin tim, në zyrat e këshillit të bashkuar në fshatin Sauk të Tiranës. Sekretari i këshillit të bashkuar ishte nga fshati im. Ishte muaji i Ramazanit. Sekretari ngriti gotën të pinte ujë dhe më tha mua; më fal-mos ma merr për ofendim o Haxhi që po pij ujë në pranin tënde se unë e di që ti je me agjërime. Sekretarit ia agjëronin xhaxhallarët. Unë i thash, për mua nuk ka gjë, se un jamë i vendosur për këtë gjë. Ai pastaj më tha; Ka nga të rijtë që janë besimtar dhe ai më tregojë se një oficer i rrepartit aty afër, i kishte thënë atij se ju kishte ardhur në repart një ushtarë që ishte shumë i edukuar por fetarë. Ai nuk pinte pije alkolike dhe as nuk harxhon-

te për ti gostitur shokët me pije alkoolike. Unë në ato moment u bëra kurioz shumë, me që ai ishte më i ri se unë. Ai ishte në atë kohë 18, 19 vjeç.

Të nesërmen unë shkova tek rrepartit duke pyetur me marifet për ta gjetur këtë ushtarin, se nuk ia dija as emrin e as vëndin nga ishte pasi as sekretari që më tregoi, nuk e dinte se kush ishte ai e nga ishte ai ushtari. Më në fund e gjeta Jusufin dhe e takova. Ishte vërtetë besimtarë i mirë për moshën që ishte. Unë isha dhjetë vjetë më i madh se Jusufi. Babai i tij ishte hafiz Kurani. Ata e falshin namazin që në atë kohë familjerisht. Pasi e njoha mirë Jusufin e futa në shtëpi. Shkoja shumë herë e takoja tek rrepartit dhe e merrja në shtëpi pasi unë nuk e kishim shumë larg shtëpinë nga repartit që Jusufi kryente shërbimin ushtarak. Unë fillova ti flas Jusufit për muxhediden Aishe rahmetullahi alejha, për këtë murshide të madhe të shekullit të njëzetë. Ai vetëm më dëgjonte. Një natë unë përgadita takimin e Jusufit me Aishen. Ishte ditë pranvere. Unë dhe Jusufi erdhëm në shtëpi në mbrëmje.

Pasi falëm namazin e akshamit, lartë në katin e dytë të shtëpisë, unë, Jusufi dhe djali i hallës time Enveri i tregova aty Jusufit se sot ka ardhur në shtëpinë time muxhedidja Aishe për të cilën i thash të kamë folur ty disa herë. Pasi zbritëm në katin e parë u takuam e u përshëndetëm me murshiden Aishe rahmetullahi alejha dhe me njerëzit e shtëpisë. Unë e prezentova murshiden Aishe me Jusufin. Aisheja filloi ti fliste Jusufit për shërbimin që i kishte ngarkuar Allahu xh. sh. që ta thërras popullin shqiptar për Tobe=që ai të pendohet e të largohet nga punët e liga duke i treguar Jusufit një pas një kushtet e tobes. Më në fundë muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha pasi e përfundojë fjalën i kërkoi Jusufit ashtu si gjithë njerëzve tjerë që ai ti jepte asaj besën për ta njisur Zotin xh. sh. mos të bënte më shirk=mos ti bënte më Zotit xh. sh. shokë e ortakë gjatë foljes me gojë.

Në ato momente Jusufi kundërshtoi. Ai sikurse më tregojë më prapa kishte dyshuar se; 1-mos është punë tarikati, 2-Mos është mashtruse, 3-Ose dyshonte se mos është ndonjë e metë nga mëndja, mos është me fiksime, mirpo nga paraqitja dhe fjalët, ajo nuk të lente dyshime. Pasi muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha i foli për Toben Jusufit, ai i bëri asaj disa pyetje dhe murshidja Aishe i dha përgjigje me Kuranë atij. Aisheja pastaj i kërkoi besën Jusufit se ai

nuk do ti shoqëronte asnjë send Zotit=Allahut xh. sh. por Jusufi kundërshtoi në fillim. Pasi Aisheja e sqaroi mirë atë se nuk kishte të bënte me çështje tarikati por ishte e urdhëruar nga Allahu xh. sh, me shërbimin e thirrjes në Tobe, të gjithë popullin pa dallim edhe ata që rrinë në brigjet e lumejve, bëjnë shporta e shesin gomarë e që ju i thoni atyre arrxhij. Më në fund Jusufi i tha asaj: Betohe në emrin e Allahut xh. sh. se ti nuk gënjen për këtë që thua. Muxhedidja Aishe si gjithmonë që përkulej me dorën në gjoks kur thoshte emrin Allahut xh. sh. u përkul dhe pasi ajo e drejtoi trupin përsëri, me gishtin tregues të ngritur lart dhe me lot ndër sy u betua tre tre herë rreshtë kështu:

Betohem në Allahun xh.sh. se jam e dërguar nga Ai me shërbim special për ta thirr në Tobe këtë popull, muslimanë e të krishterë, të ditur e të pa ditur, të bardhë e të zinjë, punëtorë, fshatarë dhe zyrtarë=nënpunësa. Muxhedidja Aishe gjithmonë derdhëte lot nga sytë për njerzit se asaj i vinte keq për ata se vuanin pasi kishin lën rrugën e Zotit xh. sh. e për këtë gjë ata i priste një dënim shumë i madh, në dynja dhe ahiret. Jusufit i bëri përshtypje betimi dhe fjalët e Aishes dhe menjëher zgjati dorën dhe i dha besën Murshihides Aishe që Allahu xh. sh, e lartëssoftë në xhenet. Pas kësaj dite Jusufi bashkë me mua shkonim vazhdimishtë tek Aisheja, për tu specializuar në dijen e thellë të fesë. Kur Isufi mbaroi ushtrinë, unë dhe muxhedidja Aishe me një shoqen e sajë besimtare, shkuam tekë shtëpia e Jusufit në Peshkopi. Muxhedidja Aishe mblodhi në shtëpinë e Jusufit në Rashnapojë familjen dhe fisin e afërt të Isufit dhe ju foli atyre për çështjen e madhe të Tobes. Edhe nëna me dajën tim shkuan në shtëpinë e Isufit, kur ai kreu shërbimin ushtarak, pasi ne atë e bëmë si njeriun tonë të afërt. Gjthashtu edhe nëna e babai i Jusufit Hafiz Tahiri e vëllai i tijë erdhën disa herë në shtëpinë tonë në fshatin Farkë të Tiranës.

55-KËSHILLAT E MURSHIDES AISHE PËR EMRAT E MUSLIMANËVE.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, kjo murshide e madhe e shekullit të njëzetë i këshillonte muslimanët që të kenë kujdes, ta ruajnë identitetin e tyre musliman duke filluar nga emri i tyre musliman i cili është simbol për ta. Ajo bënte çështje e mundur nga

do që shkonte duke i porosit muslimanët që tu vënin fëmijëve të tyre emra muslimanësh pasi qeveria komuniste para ndalimit të fesë me ligj, nuk ndërhynte për vënjën e emrave fëmijëve në zyrat e gjëndjes civile. Aisheja ju thoshte muslimanëve që tu vën të paktën fëmijëve të tyre emra shqiptarë me kuptim të bukur. Për shembull: Durim, Besnik, Fatmira, Fatbardha e tjer.

Më kujtohet një rast se një i afërmi i saj i vuri vajzës së tij emrin Dhimitrulla, kurse Aisheja posa e dëgjojë këtë gjë, menjëherë ia ndryshoi asaj e ja bëri Fatbardha. Ajo më tregoi mua se duke qenë shumë e mërzitur për ndryshimin e emrave ajo thoshte se Allahu xh. sh. më bëri me dije me inspirim se emri ka rëndësinë e vet. Muslimanët duhet të shërbejnë me emra muslimanësh por rëndësinë e madhe të pa diskutueshme e ka besimi në zemër të njeriut. Nuk bëhet njeriu musliman me emër. Pra muslimani nuk bëhet kristjan se ka emër të tillë dhe as kristjani nuk bëhet musliman sepse mban emër muslimani.

Por muslimanët duhet të ndjekin porosin e Pejgamberit a. s. që ka thënë: "Vëni fëmijëve tuaj emra me kuptim të bukur." Ai ka thënë; "Tri detyra kanë prindërit për fëmijët e tyre; 1-Kur ti lindin fëmija ti vëj emër të mirë muslimanësh, 2-Kur të bëhet për të kuptuar ti mësojë fenë, 3-Kur të bëhet në moshën për tu martuar, ta martojë atë." Trans. Muslimi. Ai gjithashtu ka thënë: Në ditën e gjykimit do të thirreni me emrin tuaj dhe baballarëve tuaj, prandaj vini emra të mirë me kuptim të mirë." Transmeton Buhariu dhe Ebu Dudi. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran thotë; Pas besimit [pasi të keni besuar] është keq të përhapet etikimi ose titullimi i keq. "Sure Huxhurat. aj 11.

Fatkeqsishtë ka më shumë se-70 vite që muslimanët janë larguar në praktikë nga feja e tyre Islami. Ata nuk po ju vënë më fëmijëve të tyre emra muslimanësh por ju vënë emra kaurrish e çifutësh. Zoti sh. sh. i zgjofte nga gjumi i pa diturisë. E ku ka më i pa ditur se ai njeri që nuk do emrin e vet, emrin e babës, nënës, gjyshit e gjyshes së tij, Ahmed, Ymer, Hasan, Nuriye, Fatime e Aishe dhe do emrat huaj, Robert, Maksim, Amarildo, Tatjana, Rovenia, e Paola. A nuk janë edhe emrat kristjanë të vjetër sikurse emrat e muslimanëve ? . Pa dyshim po. E përse atëherë veproni kështu ju o muslimanë në kundërshtim me fenë tuaj duke humbur identitetin dhe dinjitetin tuaj ? . A nuk kuptoni ? A nuk ju vjen turp dhe nga të kristianët që po tallen me juve e po ju thonë tradhëtar të fesë tuaj ? .

Këto fjalë un i kam dëgjuar nga një kushuriri im që ishte me punë në Greqi . Kristjani katolik gjatë bisedës për fenë i kishte thënë këtij kështu: Ju muslimanët keni fe të pastër por ju po e tradhëtoni fenë tuaj dalngadalë. Fakti është se ju thoni se jeni muslimanë por simbolet Islame nuk i doni. Ju nuk po ju vëni më fëmijëve tuaj emra muslimanësh por po ju ngjisni me emra kristjanësh. Ju nuk po i doni më emrat e baballarëve e gjyshllarëve tuaj. Nga kjo gjë ne krishterët çuditemi me ju muslimanët. Ndërsa ne të krishterët i kishte thënë ai, nuk i ndërrojmë emrat nga të krishterë në muslimanë. Atë fe që na kan lënë të parët tanë ashtu si është ajo, ne mundohemi ta mbajmë atë.

Vërtet është për tu çuditur me të krishterët. Ata në çdo llojë kushtesh e situatash që të jenë, ata nuk iu vënë fëmijëve të tyre emra muslimanësh. Kjo gjë më së miri u shikua këtu tek neve në Shqipëri në kohën e rregjimit komunist. Edhe kur Enver Hoxha ishte për dyzet vjet krytarë i shtetit Shqiptarë megjithatë asnjëri nga të krishterët nuk ia ngjiti fëmijës së vet emrin Enver të paktën për politikë ose servilitet. Po ju o muslimanë e si nuk ju vjen turp dhe i vëni fëmijëve tuaj emra kristianësh = emra kaurrish. Sa keq e sa turp për ju. Si po gaboni kështu ?. Nuk është çudi se një ditë stërnipat tuaj o musliman kur do të shohin gurët e varreve të stërgjyshëllarëve të tyre me emra muslimanësh do të çuditen. Pa dyshim në të ardhmen kristjanët do tu thonë nipave e stërnipërve të muslimanve që mbajnë emra kristjanësh se këto varre me këta emra muslimanësh, kanë qënë varre arabësh, turqish e persijanësh, varre armiqsh që kanë sulmuar dikurë vëndin tonë dhe janë varrosur këtu, prandaj o burra tani ka ardhur koha që ti prishim këta varre. Allahu xh. sh. ju sjell të mëndjen në vënd gjithë muslimanëve kudo që të jenë, duke i zgjuar ato nga gjumi i injorancës. Allahu xh. sh. në Kuran thotë; Lekum dijnukum ve lije dijn.= Ju keni fenë tuaj, ata kanë të tyren. "S. Kafirun. Murshiddja Aishe rahmetullahi alejha i këshillonte besimtarët muslimanë që ata mos të bënin martesë me kristjanët duke dhënë e duke marrë me ato pasi ata me fenë e tyre i kanë cilësitë ose sifetat e tyre në kundërshtim me vetitë ose cilësitë e muslimanëve dhe kështu muslimanët do ta humbin fenë e tyre Islame. Këto martesë u bëjnë në Shqipëri si pasoj e ndikimit të të ideologjisë ateiste në Shqipëri nga pa dituria e besimi i dobët i muslimanëve. Duke udhëtuar një rastë në Maqedoni një

musliman i ri në moshë më tha mua këto fjalë në lidhje me martesat: Ne shqiptarët musliman të Maqedonisë e kemi mbajtur fenë më shumë se ju muslimanët e Shqipërisë. Ne nuk bëjmë miqësi me kristjanët duke marrë vajzat e tyre ose duke ju dhënë atyre vajzat tona. Kristianët e Maqedonisë na thonë ne muslimanëve se ju muslimanët e këtushëm jeni të egër ndërsa muslimanët e Shqipërisë janë të urtë. se ata bëjnë miqësi me kristianët e atjeshëm. Unë i thash këto fjalë të quajturit Hizbi i cili na ndihmojë gjatë udhëtimit: Ju lumtë juve muslimanëve të Maqedonisë që e keni mbajtur fenë me shumë vështirësi. Zoti xh. sh. juve jua ka shpërblyer e do të jua shpërblejë në të ardhmen edhe më shumë nëse vazhdoni ta mbani fenë Islame. Muslimanët në Shqipëri i thash un atij, ashtu siç bënë ashtu gjetën. Zoti xh. sh. i drejtoftë për së mbari muslimanët kudo që ndodhen. Allahu xh. sh. iu thotë në Kuran muslimanëve kështu:

“ O besimtar: Mos i bëni miq as jahuditë [çifutët] e as kristianët [kaurrit]. Ata janë miq të njëri tjetrit. Cili prej jush i bën miq ata, ai është prej tyre [është si ata, është me ata]. ”S. Maide. aj. 32.

56-MUXHEDIDJA AISHE RAHMETULLAHI ALEJHA, MË DHA SIHARIQ=LAJM TË GËZUSHËM MUA TË QUAJTURIT HAXHI YMER AGA.

Si gjithmonë unë shkruasi i librit Haxhi Ymer Aga shkova një ditë tek shtëpia e muxhedides Aishe rahmetullahi alejha. Pasi ulem e përshëndetem me të, ajo më tha se kishte marrë një njoftim të mir për mua nëpërmjet rrujasë-ëndërrës, në kohën e zgjimit para namazit të sabahit kështu: “Ajo tha ishim një pallat të bukur në katin e katërt të tijë, unë dhe ti o Haxhi. Poshtë pallatit ishte Jusufi, [Jusuf Salkurti]. Ai ishte në një fushë bari të gjelbërt dhe aty po qëndronte në këmbë. Ai ishte i veshur me rroba ushtarake i qethur por nuk kishte kapele në kokë. Un thash hajër inshaallah. Të njëjtën fjalë tha dhe murshidja Aishe rahmetullahi alejha. Ajo më tha; Kjo shfaqje që më tregoi Allahu xh. sh. mua do të thotë mir për juve të dy por ti ishe më mirë se Jusufi se ti ishe në pallat brënda dhe lart ndërsa edhe Jusufi mirë ishte tha ajo por ai ishte jashtë pallatit por në vend të jeshiltë=vend të gjelbërt. Ky njoftim që mori ajo prej Allahut xh. sh. nëpërmjet ëndërrës ishte në vitin 1987. Allahu

xh. sh. thotë në Kuran kështu: " Secili sipas veprave që bën i takon shkalla=grada. "S. Ahkaf. aj. 19. Një rast me që unë isha vonuar pa shkuar disa ditë, murshidja Aishe më kishte kërkuar nëpërmjet një fisit tim. Unë shkova tek shtëpia e saj dhe posa hyra brënda më tha; mirë bërë që erdhe. Un thash hajër inshallah, po tha ajo hajër është nga Allahu xh. sh. Ajo më tregojë mua kështu: " Ajo tha më çfaqë Allahu xh. sh. mbrëmë në ëndërr ditën që do të parakalojnë në Masher, para Allahut xh. sh. pejgamberët me ymetet=popujt e tyre që ju besuan fjalëve të tyre. Kishte pejgamberë vetëm me dy ose tre veta prapa tyre tha ajo.

Pasi parakaluan pejgamberët me besimtarët e tyre unë dëgjo-va një zë që tha; Tani po parakalon Aisheja që bëri thirrje për Tobe. Unë thoshte Aisheja isha gjoja si spektatore dhe në atë çastë kur u thirr emri im, unë u çudita thoshte ajo duke menduar se unë jam këtu por ajo mendova duhet të jetë ndonjë Aishe tjetër dhe po shikoja se kush po shfaqet në atë fushë ku parakaluan pejgamberët. Në atë çast unë pashë veten time të veshur jashtëzakonisht mirë me një veshje që shkëlqente si atllaz. Për mesi kishim një gjerdan dhe në kokë kishim një përkrenare të bukur nga balli e vinte nga prapa duke u ngushtuar deri tek publat e këmbëve në drejtim të gjunjëvev. Ishte shumë e bukur, nuk mundem ta përshkruaj atë. Unë kishim prapa një grupë njerëzish, që ecnin pas meje, ashtu siç i pashë që ju vinin prapa dhe pejgamberëvev që parakaluan para meje thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha.

Pasi kalova un me atë grup njerëzish pas një ndërprerje të vogël shikimi u shfaqe ti o Haxhi i veshur mir me një grup njerëzish tjerë por ti kishe më shumë se unë njerëz prapa vetes. Un i thash asaj; mir paske pare. Hajër inshallah-mirësi në dashtë Zoti xh. sh. Po inshallah tha dhe muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Pastaj ajo vuri buzën në të qeshur dhe tha : Nuk dihet çfar planesh ka përgaditur Allahu xh. sh. për të ardhmen. Për grumbullimin e gjithë njerëzve në Ahiret= në botën tjetër pas vdekjes Allahu xh. sh. në Kuran thotë : "Edhe të parët dhe të fundit kemi për për ti mbledhur në një ditë të caktuar". Ndërsa se çfar punësh do të bëjnë njerëzit në të ardhmen, Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Allahu e di atë [vepër] që e punuan [njerëzit] më parë dhe atë që do të punojnë më vonë ata dhe të gjitha çështjet i kthehen Allahut". S. Haxh. aj. 76. Gjithashtu Kurani thot: "Ai [Allahu] më së miri di gjithshka për j edhe para se tu krijoi ".S. Nexhmë. Aj. 32.

Për paraqitjen në grupe në ditën e gjykimit Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Atë ditë njerëzit do të paraqiten të ndarë në grupe që tu tregohen veprat e tyre-që të shpërblehen për veprat e tyre." S. Zilzal. aj. 6. Ndërsa në suren Isra po në ajetin. 6 Allahu xh. sh. thotë: "Ditën kur do ta thërrasim secilin njeri me prijësin e tyre." Gjithashtu Allahu xh. sh, thotë; Atë ditë do të shkojnë pas thirrësit e nuk do ti largohen atij dhe përpara të Gjithë-Mëshirëshmit [Allahut xh. sh.] ulen zërat dhe nuk dëgjohet asgjë përveç zhurmës së hapave të tyre. "S. Ta-Ha. Ajeti. 108. Ndërsa për prijësat Allahu xh. sh. thotë: "Dhe prej tyre [njerëzve në çdo popull] Ne bëmë prijësa që me urdhërin tonë udhëzojnë. [ju tregojnë rrugën e drejtë njerëzve.]" S. Sexhde. Aj.24. Me të vërtetë pasë rreth 12 vitesh u bë realitet rrujaja=ëndrra që ia shfaqti Allahu xh. sh. murshides Aishe në kohën e regjimit komunist rreth vitit 1986 në lidhje me shumicën e njerëzve që do të kem un të rreshtuar prapa meje në ditën e parakalimit në Mahsher. Ajo nuk e e dinte se çfar do të bëja un në të ardhmen dhe as un nuk e dija se çfar do të bëja.

Por Kurani thotë: "Allahu ju ka krijuar juve dhe veprën që bini ju". S. Saf-fat. aj. 96. Muxhedidja Aishe nuk arriti ta shikojë se çfar pune bëra unë me shkrim duke i lajmëruar njerëzit për tobe se ajo kishte vdekur në atë kohë. Unë me dëshirën dhe financime e duke marr leje prej murshides Aishe rahmetullahi alejha kur ajo ishte e gjallë filllora ta përhap me shkrim lajmin për tobe që i komunikoi popullit muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Në këtë libër kam argumentuar gjërë e gjatë me Kuran dhe Hadith vërtetësinë e shërbimit të muxhedides Aishe që ajo ishte e dërguar me shërbim direkt prej Allahut xh. sh.për ta thirr popullin shqiptar në Tobe Istigfar. Veç këtij libri që tregon gjërsisht për jetën dhe shërbimin e muxhedides Aishe rahmetullahi alejha, unë kam folur shkurtimisht për kushtet e tobes dhe në librat tjera të shkruara më parë të cilët janë libri "Tobe Istigfar" dhe libri "Sqarime nga Kurani e Hadithi për disa çështje fetare Islame. Gjithashtu kam shkruar e shpërndarë broshurën e vogël me kushtet e Tobes me titull : "Largohuni Nga Shirku Krimi Kundër Zotit xh. sh.". Këtë broshurë e këtë libër e kam shpërndarë vetë në xhamiat e ndryshme të qyteteve e fshatrave në gjithë Shqipërinë dhe në Kosovë, Maqedoni, dhe në Malin e Zi. I kam dërguar librat dhe në trevat shqiptare të luginës së

Preshevës në Sërbi dhe në Greqi e në vende të ndryshme ku ka shqiptar në emigracion. Në Turqi, Itali, Zvicërr, Gjermani, Angli, Amerikë, Belgjikë, Bosnje, Kroci, Austri, Egjipt, Suedi dhe në Australi. Librat i kam dërguar në xhamiat e këtyre vendeve me anë të vizitorëve shqiptar besimtar që vinin në Shqipëri nga këto vende dhe nëpërmjet besimtarëve nga Shqipëria që shkonin për vizitë tek fëmijët dhe të afërmit e tyre jashtë Shqipërisë. Gjithashtu edhe nëpërmjet turistëve dhe shoferëve besimtar musliman nga Kosova, Maqedona dhe Bosnja.

Kjo broshurë bashkë me disa fletë palosje arriti një tirazh prej 80.000 kopjesh. Së bashku me gjithë librat tjera numri duhet të ketë arritur numrin 100.000. Për thirrjen e njerëzve në tobe unë kam shkruar dhe një broshurë të vogël në gjuhën Serbo-Kroate me titullin: "Poseban Poziv =Za Tobe Iskreno Kajanje" [Thirrje e posaçme për tobe=për pendesë]. E kam shkruar për boshnjakët e të tjerët që e flasin ose e kuptojnë këtë gjuhë. Këtë broshurë prej 1000 kopjesh e kam shpërndarë në Bosnje në disa qytete të sajë. Në Sarajev, Mostar, Srebenic e tjer. E kam dërguar këtë broshurë nëpërmjet vizitorëve dhe shoferave besimtarë në xhamiat në Serbi, në krahinën muslimane të Sanxhakut në qytetet Tutin, Prijepolje, Novi-Pazar e tjer. Në Malin e Zi në qytetet; Ulqin, Tivar, Tuz, Plavë, Podgoricë, Rozhaj, Gucij e Beranë.

Në qytetet Ulqin Tuz dhe Podgoricë e kam shpërndarë vetë personalisht broshurën e vogël të shkruar në gjuhën serbo-kroate i shoqëruar me një shok besimtarë i thjeshtë i quajtur Qazim Murati nga Fshati Guri i Bardhë i Burrelit. Në qytetin e Ulqinit dhe disa fshatra për rreth tij kam shpërndarë broshurën në gjuhën shqipe por dhe pak në gjuhën serbo-kroate. Gjithashtu në Ulqin dhe Tuz kam shpërndarë edhe këtë libër që keni para syve në gjuhën shqipe. Broshurën në gjuhën serbo-kroate e kam çuar gjithashtu edhe në Komunën e Dragashit në Kosovë të cilët janë musliman por që flasin gjuhën Sërbe. Edhe këtu i kam shpërndarë vetë me dorën time nëpër shumë xhamia të kësaj komune i shoqëruar nga kushuriri im besimtarë i thjeshtë Enver Xhabafti nga fshati Bulticë e Tiranës. Së bashku të gjitha, broshurat, librat dhe fletë palosjet besoj se duhet të kenë arritur edhe kaluar numrin 100.000. Libra i kam dërguar dhe shumë personaliteteve të njohura të fesë e të shtetit në atë kohë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Malin e Zi. Ndër ta unë po përmend :

Kryetarin e Komunitetit Musliman të Shqipërisë Haxhi Selim Muça, ish myftiun Ilir Vokshi dhe shumë imamve të xhamiave në Shqipëri. Ja kam dërguar kryetarin të kryegjyshitës Begtashiane në Shqipëri Edmond Brahimaj e disa dervishave të disa teqeve të ndryshme. Ja kam dërguar dhe disa qeveritarëve e ish qeveritarëve të rrangut të lartë që nuk po i përmed. Në Kosovë ia kam dërguar direkt në dorë Myftiut të Kosovës Naim Tërnavës. Kryetarin të imamëve të Kosovës Sabri Bajgorës, Qemal Morinës, Shefqet Krasniqit e Mazllëm Mazllëmit e disa hoxhllarëve dhe profesorëve tjerë. Në Maqedoni shumë imamëve, myftive, dijetarëve e besimtarëve të Strugës, Ohrit, Gostivarit, Kërçovës, Tetovës dhe Shkupit. Ish dijetari i devotshëm i këtij vendi Jakub Hasibi u bind plotsisht dhe u largua menjëher nga shirku gjuhësorë = shirku me gojë dhe ju bëri thirrje njerzvet që mos ta thërrasin njëri tjetrin me emrin që thirret Allahu xh. sh. në çfardo gjuhe qoftë. Librat un ju a kam çuar edhe krerëve të kishave Katolike e Ortodokse. Ndër ta po përmend kreun e kishës autoqefale të Shqipërisë Nikolla Markun më Elbasan të cilit ia dhash vetë në dorë. Gjithashtu ja çova dhe kreut të kishës katolike në Shqipëri Rrok Mirdita me qendër në Tiranë. E dërgova vetë personalisht në selin e tij tek katedralja në sekretari. Këto njerëz ndoshta nuk i kanë shikuar me sy fare librat se nuk e kanë përfillur thirrjen për tobe por duhet ta dinë se një ditë do të japin llogari para Zotit xh. sh. për veten e tyre dhe për njerëzit tjerë që kanë patur në mvarhtësin e tyre.

Zoti xh. sh. e drejtoftë për së mbari popullin shqiptar dhe gjithë popujt tjerë. Amin vel-hamdu lil-lahi rrab-bil aalemijn. Shkrimet, botimet dhe udhëtimet i kam bërë vetë me financën time. Mirnjohja dhe falenderimi janë për Allahun xh. sh.=Krijuesin e Gjthësis. Veprimtarinë time me gojë dhe shkrim duke i thirrur njerëzit në tobe me kushtin e parë kryesor teuhidin= njisimin e Allahut xh. sh. në çdo gjuhë=qëndrimin në fjalën La ilahe il-lallah=mos rrefuzimin e kësaj fjale në çdo gjuhë që flasim njerëzit, unë e kam vazhduar 13 vite rresht. Historia Islame tregon se dhe peygamberi jonë Muhamedi a. s. 13 vitet e para i bëri thirrje popullit për Teuhidin=Njisimin e Allahut xh.sh. Pastaj në 10 vitet tjera ai i mësoi popullit çshtjet e tjera të fesë. Gjithsejt 23 vjet. Pas 13 vitesh të veprimtarisë për thirrjen në tobe që bëri Muxhedidja Aishe në Shqipëri dhe populli nuk bëri tobe, atëher feja në Shqipëri iu ndalua popullit 23 vjetë. Aqë vite sa e vazhdoi detyrën e thirrjes në fenë Islame profeti ynë

Muhamedi a. s. Pas 23 vjetësh ndalese iu lejua popullit në Shqipëri e drejta e liris së ushtrimit e praktikimit të fesë. U rihapën përsëri xhamiat e kishat që paten mbetur pa u shembur nga rregjimi komunist dhe u ndërjuan të reja. Në vitin 2013 mbushen përsëri plot 23 vite që njerzit në Shqipëri janë të lirë ta praktikojnë fenë. Këto gjëra mendoj që nuk janë ratësira që kanë ndodhur kështu. Të shohim se ç'ka do të bëj Allahu xh. sh. tani e prapa. Allahu është alimul gajb= Ditës i të fshehtës. Qëllimi im ka qënë që besimtarët ta njisojnë Allahun e madhërshëm në çdo gjuhë që të flasin e të kthehen në rrugën e Tij, duke u penduar sinqerisht për fajet e tyre që mund të ketë secili. Ashtu si në Shqipëri, në Kosovë, në Malin e Zi e në Maqedoni sikurse thash më sipër ia kam shpërndarë vet librat besimtarëve në dy gjuhët: Shqip dhe Serbo-Kroatisht. Jashtë Shqipërisë deri tani në vitin 2012 kam udhëtuar 5 herë për tu bërë njerëzve thirrje për Tobe. Kam shkuar në Kosovë, Maqedoni e në Malin e Zi Dy herë isha i shoqëruar siç e thash më sipër me kushuririn tim Enverin, besimtar i thjeshtë por i vendosur në fenë Islame dhe dy herë tjera me një vëlla besimtar Islam i thjeshtë por i përkushtuar në fe, i quajtur Qazim Murati nga fshati Guri i Bardhë i Burrelit dhe një herë me djalin e xhaxhait tim Luanin i cili e njison Allahun xh. sh. ka bërë tobe dhe ndjekë fenë Islame duke falur rregullishtë namazin. Kemi shkuar vetëm për kënaqësinë e Allahut xh. sh. dhe duke çuar në vënd urdhërin e Tij që Ai thotë në Kuran : "Le të jetë prej juve një grup [njerëzish] që bën thirrje në atë që është e dobishme,...S. Ali Imran. aj.104. Kam qenë në Qabe në vitin 1996. Kam shkuar në Turqi në Stamboll si turist duke zbatuar dhe për këtë gjë urdhëresën e Allahut xh. sh. i cili thotë në Kuran; "Dilni e shetitni në faqen e tokës që të merrni përvojë= të shihni për të marrë njohuri të ndryshme". Edhe gjatë udhëtimit turistik unë nuk pushova duke folur e duke ndarë shkrimet e mia në Stamboll dhe në Shkup gjatë rrugës kur u këtheva. Gjithashtu për çështjen e rëndësishme të tobës e kryesisht për njisimin e Allahut xh. sh. në çdo gjuhë, unë kam folur në 1000 e ca kaseta magnetofoni të regjistruara me ilahi të ndryshme dhe kam mbajtur hutbe = ligjërata në namazin e xhumave [ditëve të Premteve] në 100 xhamia në qytete e fshatra brënda dhe jashtë Shqipërisë. Kam dëshirë ti plotsoj 104 xhamia aq sa është numri i librave që ju ka zbritur Allahu xh. sh. pejgambervet. Ai ju ka zbritur katër libra të mëdhaja; Zeburin, Teuratin, Inxhilin, Kuranin dhe 100 broshura të vogla. Nëse mundem kam dëshirë të plotsoj 114 xhamia. Baraz me numrin e sureve të Kuranit. Xhamiat në të cilat kam mbajtur hytbe [ligjirata] janë këto: Në Tiranë e në fshatrat

e Tiranës: Në xhamiat e fshatrave Farkë e Madhe, Lanabregas, Ibë, Bastar i Sipërm, Mullet, Bulticë, Zall-Bastar, Vaqarr, Pezë e Vogël, Pezë-Helmas, Ndroq, Mënik, Qerekë, Farkë lagjësja Çollak, Bërxullë 1, Bërxullë 2=lagjësja Loc, Bërxullë 3=Kulla e Vorbësit, Baldushk, Mihajas, Insitut Kamëz, Prezë, Domje, Vorë, Marikje, Xhamia te Ura e Beshirit, Priskë e Madhe, Kasallë, Yzberishti i Vjetër, Sharrë e Vjetër, Zallherr, Kasharë 1, Kashar 2, Ferrje, Tapizë, Brarë, Paskuqan, Zgurë, Mazrek, Babrru, Pëllumbas, Shkozë, Furtuzje, Prush, Shupal, Gurrë, Krrabë e tj. Në Durrës në xhaminë e Kastratit, Shkozetit, Shkallnurit dhe në xhamijat e fshatrave Rubjekë, Manzë, Rrushkull, Perlat, Sukthi i Ri, Vardardhë, Borakë, Radë e Ishëm. Në Elbasan në fshatin Labinot-Fushë, Bradashesh, Labinot-Katund e Shmil. Në Librazhd në xhaminë e Qendrës dhe në fshatrat Dragustun, Zgoshtë e Polis. Në Kavajë në xhaminë e OXHAKUT, në xhaminë e Munires dhe në fshatin Golem. Në Shkodër në xhaminë Rus, xhaminë e Tophanës e në fshatin Oblikë. Në Shijak në xhaminë e Qendrës, xhaminë e Sallmonjes dhe në Sukthin e Vjetër. Në Krujë në xhaminë e qytetit e në xhamiat e fshatrave: Budull, Bubq, Mazhje, Mukje, Rradhesh e Nikël. Në Prrenjas në xhaminë e qytetit. Në qytetin e Laçit në xhaminë e Sanxhakut. Në Burrel në xhaminë e qytetit dhe në xhaminë e qytezës së Klosit. Në qytetin e Fushë-Krujës në xhaminë e Arramerasit e në xhaminë e Re. Në Peshkopi në xhaminë e Re e në fshatin Maqellarë. Në Berat në xhaminë Mbret. Në Korçë në xhaminë e Iljas Bej Mirahorit dhe në fshatin Zemblak. Në qytetin e Lushnjes e të Peqinit. Në Kosovë në qytetin e Prishtinës në xhaminë Dardania në vitin 2008. Atë ditë në faljen e namazit të xhumas ishin rreth tetëqindë vetë e më shumë. Allahu xh. sh. ia shpërbleftë me të mira në dy botët imamit të xhamisë Remzi Haziri dhe muezinit të saj bashkë me tre shokët tjerë komisioni i asaj xhamie. Në Prizren në xhaminë e Kurilles. Në qytetin e Ferizait në Xhaminë e Madhe, Në Malim e Zi në qytetin e Ulqinit në xhaminë e Namazgjas. Në Pej kam mbajtur ligjeratë në kohën e mbledhjes në xhaminë sipër qendrës së qytetit por emri i saj nuk më kujtohet. Në Maqedoni kam folur pas namazit të akshamit në xhaminë e Strugës dhe Tetovës. Inshallah do shkoj së shpejti në qytetin e Ohrit pasi jam i mirpritur nga myftiu i këtij qyteti. Gjithashtu gjatë 13 vjetëve unë kam mbajtur ligjerata para njerëzve të grumbulluar në raste të shumta varrimesh e ceremonishë të ndryshme fetare duke i lajmëruar

së pari njerzit ta njisojnë Zotin xh. sh. dhe të bëjnë tobe të vërtetë. Të gjitha këto veprime i kam bërë për dashurinë ndaj Allahut xh. sh. ndaj fesë së Tij, fesë Islame e nga dashuria për Pejgamberin a. s. që ymeti i tij të shpëtojnë nga të këqiat në dy botët duke ju treguar njerzvet ilaçin e shpëtimit prej Allahut xh. sh. i cili është tobja [pendesa.] I përmenda këto që kam bërë jo për qillim tjetër, por vetëm për tu hequr dyshimet atyre njerëzve që duan të dinë për financimin e librave dhe udhëtimeve të mia. Këtë gjë detyrohem që të jua tregoj duke iu lutur Allahut xh. sh. që të më ruaj mua nga krenaria dhe uxhbi=vetpëlqimi e lavdrimi i vetëvetes. Un e arrita këtë gjë pasi shita pak tokë dhe harxhova aq sa ma bëri rrisk Allahu xh. sh. për fenë e Tij, për ti thirrur njerzit në rrugën e Tij.

Gjithashtu më ka ndihmuar me ndonjë gjë të vogël simbolike fisi im, motra ime Merjeme dhe tre vëllezër besimtar të tjerë. Allahu xh. sh. na e shpërbleftë të gjithëve me xhenet. Siç e thash më lart murshidja Aishe rahmetullahi alejha, nuk e dinte gajbin= të fshehtë. Ajo nuk dinte për ngjarjet që do të ndodhnin në të ardhmen në dynja dhe ahiret por Allahu xh. sh ia tregonte atë Ai donte. Ajo nuk e dinte se çfar do bëja un në të ardhmen me dëshirën time. Por Kurani thotë : "Allahu ju ka krijuar juve dhe veprën që bëni ju." S. Saf-fat. aj. 96. Allahu xh sh. gjithashtu thotë; "Për secilin prej jush Ne caktuam ligjë e program [të posatshëm] në çështjet e veprimit]. S. Maide. aj. 48. Mendoj se pa dyshim është vërtetuar me fakte konkrete sihariqi=lajmi i gëzuar që mori për mua prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe e cila më tha se ti o Haxhi kishe shumë njerëz të rreshtuar prapa teje gjatë parakalimit në masher ditën e gjykimit dhe kishe më shumë se unë njerëz. Kurani thotë: "Allahu ju ka krijuar juve dhe veprën që bëni ju". Sure.Saf-fat=kapiulli i të rreshtuarve në rreshta. Ajeti. 96. Siç e thash më sipër, ngjarjet janë në dijen e Allahut xh. sh. para se të ndodhin. Kurani thotë : "Allahu e di atë [gjë]=atë vepër]që punuan njerëzit më parë dhe atë [gjë =atë vepër] që do të punojnë [do të bëjnë] më vonë ata ". S. Haxh. aj. 76.

57-FIRASETI=HOLLËKUPTIMI I MUXHEDIDES AISHE RAHMETULLAHI ALEJHA.

Ishte verë rreth vitit 1962 në shtëpinë tonë në Farkë të Tranës erdhi si mysafir=bujtës i ftuar nga babai im, një besimtarë nga fshati Allgjatë i Tiranës i quajtur Sefer Feza së bashku me vajzën e tij besimtare 14-15 vjeçare e quajtur Hurma i shoqëruar nga një besimtarë nga Tirana i quajtur Hysen Cenaliu. Besimtari Sefer Feza kishte bërë disa vjet medrese. Kishte mësuar tek dijetari i mirënjohur Hafiz Haxhi Mahmud Dashi. Besimtari Sefer Feza çdo ditë xhumaje bënte 2 orë rrugë me këmbë për të shkuar në qytet, për faljen e namazit të xhumasë bashkë me vajzën e tij Hurmen. Vajza nuk i ndahej nga prapa çdo ditë xhumaje babait të saj Seferit, nga moshja 8 vjeçare e deri në moshën 12 vjeç. Ajo kishte dëshirë të madhe për të dëgjuar për fenë e Allahut xh. sh. Atë natë që besimtari Sefer Feza erdhi në shtëpinë tonë bujtës ishte tek ne edhe muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Unë në atë kohë isha 10 vjeç. Sefer Feza filloi të tregoi për dëshirën e vajzës së tij që ajo kishte për të mësuar për fenë Islame. Hurma në atë kohë kishte mësuar disa sure nga Kurani përmendësh e histori të ndryshme për jetën e Pejgamberit a. s, familjes e shokëve të tij dhe këndonte ilahij. Murshidja Aishe u kënaqte për dëshirën e madhe që kishte vajza e Seferit për të mësuar për fenë Islame. Më vonë ai erdhi dhe një herë tjetër në shtëpinë tonë dhe që nga ajo kohë kaluan rreth 48 vjet që nuk e shikua më në derën tonë Sefer Fezën dhe bijën e tij Hurmen. Arsyeja ishte se Seferi e kishte biografinë politike të pastër, ndërsa ne ishim të persekutuar e të cilësuar kulakë nga rregjimi komunist.

Një ditë në vitin 2008 pasi unë fala namazin e ikindisë në xhaminë e Et-hem Beut në Tiranë takohem me një besimtar të cilin e përsëhëdeta dhe e pyta se nga ishte. Ai më tha jamë nga fshati Prush i Tiranës. Unë e pyta për dy besimtar që i kishim njohur tani pas rihapjes së xhamijave dhe për çudi mu kujtua në atë momentë dhe besimtari Sefer Feza. Ky besimtar që takova më tha se unë jam dhëndërr i Sefer Fezës. Quhem Xhafer Nazlli. Ai ishte martuar me vajzën besimtare të Sefer Fezës, Hurmen. Unë pasi i tregova atij se dikur Seferi me vajzën e tij, gruan tënde i thashë kan pas ardhur në shtëpinë time e pyta për Hurmen nëse ajo kishte qëndruar në bes-

imin Islam apo jo. Xhaferi më tha po, dhe ajo është bërë shkaktare që fal dhe unë namaz. Kur erdha në shtëpi i tregova nënës se kam takuar një njeri që ishte dhëndërrri i atij besimtarit me atë vajzën e vogël që këndonte Kuran dhe ilahije në shtëpinë tonë dikur shumë kohë përpara. Nënës iu kujtua me një herë dhe më tha po e mbajë në kujtesë. Nëna pasi u mendua pak më tha : E dëgjova atë herë Aishen rahmet paste prej Zotit xh. sh, që tha; Kjo vajzë kaq e re me këtë drejtim që ka marrë, themi që nuk do ta lë më rrugën e Allahut xh. sh. Kur nëna më tha se kështu ka pas thënë Aisheja për atë vajzë, mua mu shtua më shumë kurioziteti për vërtetësinë e fjalës së muxhedides Aishe rahmetullahi alejha.

Një ditë bajrami unë shkova që ti bëja vizitë një vëllait musliman në fshatin Prush që doktorët i prenë këmbën e kalbur. Pasi mbarova vizitën aty, shkova pastaj ta verifikojë vetë fjalën që kishte thënë para 48 vjetësh muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha për qëndrimin apo jo në fe të ish vajzës së re e quajtur Hurma. Kur thirra tek shtëpia e Xhaferit më thanë se ai për momentin nuk është në shtëpi, kurse Hurmja është këtu. Hajde hyrë brënda më thanë, por do të presësh pak se Hurma është duke falur namazin. Vërtetë kur unë hyra në shtëpi në salloni unë pash të shtruar për tokë pak cepin e një sexhadeje të vogël që Hurma e kishte shtruar në tokë e po falte namazin e ikindisë.

Pejgamberi a. s. ka thënë; "Es-salatu imatuddijn. =Qëndrimi në fe është me namaz. "Pasi mbaroi namazin Hurmja erdhi në dhomën e pritjes dhe u përshëndetëm. Ajo mua nuk më njihte. Më pyti nga je dhe kush je. Unë fillova ti tregojë gjërë e gjatë. Ajo u çudit dhe më pyeti për murshiden Aishe rahmetullahi alejha, babain tim, gjyshen, dhe shokun besimtarë të babait Hysen Cenaliu rahmeti i Zotit xh. sh. qoftë për të gjithë këto dhe gjithë besimtarët e vdekur. Unë e pyeta pastaj Hurmen për namazin. I thashë asaj a e ke filluar tani në kohën e demokracisë? Apo e ke falur edhe në kohën e rregjimit komunist. Ajo më tha: Namazin dhe agjërimin nuk i kam lënë edhe në kohën e rregjimit komunistë me gjithë luftën e madhe që i bëhej fesë. Në fillim e pata pak vështirë kur erdha nuse në këtë familje nga që këta nuk dinin gjë nga feja. Atyre u dukej çudi që unë kaq e re që isha falsha namaz, por më vonë ata u mësuan me mua. Hurma më tha këto fjalë për namazin dhe agjërimin, unë thashë elhamdulillah duke qënë i përmalluar nga

paralajmërimi i muxhedides Aishe rahmetullahi alejha dhe i tregova pastaj Hurmes për paralajmërimin që kishte bërë ajo për këtë gjë. Hurma tha ; Nuk ka më sot ashtu njeriu-me gradë të naltë tek Allahu xh. sh. si Aisheja rahmet pastë. Hurma sot është në moshën rreth 62 vjeç. Pastaj si u llafosëm dhe pak minuta për çështjen e fesë e të besimtarëve, unë u ngrita dhe fala namazin e ikindisë. Pastaj un dola dhe ika nga aty i shoqëruar nga i biri i sajë, megjithëse më thanë të rrija aty atë natë.

E përmenda këtë tregim si argument për të vërtetuar fjalët e muxhedides Aishe rahmetullahi alejha që tha 48 vjet më parë për ish vajzën shumë e re Hurma. Një rastë tjetër muxhedidja Aishe, na lajmëroi kështu për një vajzë që ishte në atë kohë fëmijë e që ne mendonim e thoshim se është e urtë. Ajo na tha : “Unë po ju themi se ajo vajzë që thoni ju se është e urtë, ajo nuk është ashtu. Ajo do të jetë e mirë e zgjuar, por jo e urtë ashtu si thoni ju. ”Vërtet pas shumë vitesh u vërtetuan fjalët që pati thënë muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Gjithashtu ajo tha dhe për një djal të vogël kështu: Ky djalë kur të rritet do të jetë i egër-i ashpër=nevrik.” Vërtetë ai djal u bë i egër kur u rrit, u bë burrë. Elhamdulilah i qoftë Allahu xh.sh. se njerëzve të Tij të zgjedhur ju ka dhënë firaseh=hollëkuptim në mëndje e shpirt.

58-VAZHDOJMË ME NJOFTIMET QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE R. A.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, iu thoshte besimtarve që bënë tobe se kam marrë këtë lajmë prej Allahut xh. sh. kështu: “Mos rrini [miqësori e shoqërori] me ata njerëz që u lajmëruan për tobe dhe nuk pranuan [të bëjnë tobe] sepse kur të vijë dënimi i Allahut kundër tyre do tu kapi dhe juve. ” Aisheja që Zoti xh.sh. e lartësonte në xhenet na tha; Kur po udhëtoja një ditë me autobus, nga Kamëza për në Tiranë, në vitin 1984 e po shikoja në drejtim të fshatit Vlias, në ato çaste Zoti xh. sh. më dha mua me anë të një melekut këtë lajm kështu : “Shiko me vëmendje : Atje poshtë në atë fushë do të ndërtohet një xhami e cila do të quhet xhamia e Aishes. ”Vërtetë kur erdhi koha e demokrcisë aty u ndërtua një xhami nga një grua besimtare e quajtur Aishe nga Tropoja, që kishte emigruar

në Suedi ose Belgjikë pas luftës së dytë botërore. E xhamia quhet sot xhamia e nënë Aishes që Allahu e shpërbleftë me xhenet atë që e ndërtoi. Kurani thotë: "Askush veç Allahut, as në qiellna e as në tokë, nuk e di të fshehtë. "S. Nekl. aj. 65. Askush pra nuk mundet ta dij të fshehtë, se çfar do të bëhet apo do të ndodhi në të ardhmen për veç Allahut xh. sh, as engjëjt, as xhindët. Për dijen e melekëve Kurani thotë që ata thanë; "Ne nuk dimë veçse atë që na ke mësuar Ti [o Allah xh. sh.] Ndërsa për xhindët as që nuk mendohet fare. Ata nuk e dinë atë gjë që nuk ka ndodhur akoma. Këtë gjë na e tregon Allahu xh. sh. në Kuran dhe thotë: "E kur u rrëzua ai, [Sulejmani], për xhinët u bë e qartë [se ai kishte vdekur] se sikur të ishin ata që e dinin të fshehtë, nuk do të vazhdonin të qëndronin në mundimin e rëndë. "S. Sebe. aj. 14. Murshidja Aishe, më tregoi se i kishte shfaqur Allahu xh, sh. një natë me anë të ëndërrës mes gjumit e zgjimit, imamin e famshëm e të par Ebu Hanifen i mbiqaturimi imami Adham-imami i madh, që ne gjuhën shqipe i themi imami Azem r.t.a.

Allahu xh. sh. qoftë i kënaqur prej këtij dietari të famshëm. Unë thoshte Aisheja, pasi kishim blerë në treg ushqime e perime, e ngarkuar me dy çanta në dorë, po ikja në shtëpi. Në rrugë para meje po ecte një burrë i veshur me një veshje- kostum ngjyrëkafe e i pastër shumë në fytyrë e në trup. Flokët ai i kishte të krehur të shtrirë dhe tek qafa ishte i qethur dhe i pastruar. Flokët i shkëqenin sikurse ti kishte lyer me vaj flokësh. Tek po ecte para meje, unë shikova se ai çalonte pak në njëren këmbë që me kujdes u kuptonte.

Kur unë thoshte Aisheja iu afrova atij, ai u kthye nga unë e më tha; Më fal pak, se desha të pyes; A e di ti ku e ka shtëpinë një grua e quajtur Aishe që është fetare këtu në këtë lagje? Unë tha murshidja Aishe i thashë atij; Ecë para drejtë se ta tregojë unë ty atë, se e njoh unë. Gjoja unë po e çoja tek ajo Aisheja që e njihja. Në atë momentë dëgjova një zë që tha: Ky është imami Adhami=Ebu Hanifeja, dhe menjëherë mua më doli gjumi. Atë natë, kur rashë në gjumë, unë i kishim të lyera duart me kanë=këna, për të cilën ka porositur Pejgamberi a. s. që ta përdorin gratë. Ndërsa Ebu Hanifja, duke komentuar hadith të Pejgamberit a. s. mbi çështjen e pastrimit truporë, ka folur dhe mbi mirsinë e kanës ose kënas për gratë, thoshte Aisheja rahmetullahi alejha. Ajo tha, unë nuk mora ndonjë njoftim nga Allahu xh. sh, se përse Ebu Hanifeja çalonte pak

në njërën këmbë. Ndoshta vërtetë ai ka ecur pak ashtu ose ka pasur ndonjë të metë të vogël në medhhebin=drejtimin e tij përsa i takon ndonjë çështje të Fik-hut=jurisprudencës. Për këtë gjë tha muxhedidja Aishe nuk mora ndonjë njohuri me ilham nga Allahu xh. sh, kur un u zgjova nga gjumi. Kështu që mendojë tha ajo, se duhet të ketë qënë me një cen=mangësi të vogël në trup ai. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha me sa më kujtohet më pati treguar diçka dhe për imami Shafiun por unë nuk i kam të regjistruara fjalët e saj për këtë pasi në atë kohë isha i ri nuk kishim dije e nuk thellohesha shumë për kuptimin e çështjeve të ndryshme por e kam dëgjuar dhe regjistruar këtë gjë nga muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e cila më tha kështu: "Kam dije nga Allahu xh. sh, se lutja e namazit, është më e pëlqyer të bëhet në këmbë se ulur." Unë shkruasi i librit i kamë dëgjuar e shikuar vetë se ata që ndjekin medhhebin Shafijë e bëjnë në këmbë lutjen e namazit të sabahit ndoshta dhe të akshamit ose të jacisë. Mjer për të vetëquajturit selefi ose me emra tjerë që i vënë vetes së tyre sot në këtë kohë, të cilët nuk e bëjnë fare lutjen e namazit.

Allahu xh. sh. i udhëzofte që të veprojnë në rrugën e Pejgamberit a. s, që ndoqën 4 imamët e mëdhej, 1-imami Ebu Hanife, 2-imami Maliku, 3-imami Shafiu dhe 4-imami Hambeliu që Allahu xh. sh. qoftë i kënaqur prej këtyre prijsave të mëdhej të ymetit të Muhamedit a. s. Përsa i takon shikimit e takimit në ëndërr me njerëzit e vdekur, për këtë gjë nuk ka nevojë për sqarim se është gjë që dihet e pranohet nga të gjithë se çdo njeri sheh dhe bisedo me njerëz të vdekur në ëndërr. Ndërsa ëndrrat janë të ndryshme tek njerëz të ndryshëm. Pejgamberi a. s. thotë: Ëndrra e besimtarëve të devotshëm është 1\46-një e dyzet e gjashta pjesë e profetësisë. "Trans. Buhariu e tjerë. Ndërsa në një hadithë tjetër thuhet një e shtatëdhjeta pjesë. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se mora këtë lajmë prej Allahut xh. sh. kështu; "Ata [njerëzit] do të kërkojnë ty një ditë por ti nuk do të jesh" se do të jesh e vdekur. All-llahu xh. sh. e mëshiroftë.

59-MUXHEDIDJA AISHE MORI NJOFTIME PREJ ALLAHUT XH SH. PËR POLITIKËN DHE POLITIKANË TË NDRYSHËM TE VENDIT TONË.

Murshidja Aishe veç njoftimeve që ajo mori nga Allahu xh. sh për çështje fetare dhe për njerëz të ndryshëm që merreshin me diturinë e fesë ajo mori diktive nga Allahu xh. sh. edhe për çështje politike dhe për njerëz të ndryshëm që ishin marrë ose merreshin me politikën në vëndin tonë të cilët ndikonin drejt për së drejti ose indirektë tek feja. Ata kështu ndikonin dhe tek shërbimi për toben që i kishte ngarkuar Allahu xh. sh. muxhedides Aishe rahmetullahi alejha. Këto diktive prej Allahut të lartëmadhëruar kishin të bënin me politikën dhe politikanë të ndryshëm të vëndit tonë dhe më gjërë. Allahu xh. sh. e sqaronte muxhediden Aishe se si qëndronte e vërteta me ata njerëz që merreshin me politikën dhe ndikimin që kishin ata në popull. Ja çfar njoftimi mori muxhedidja Aishe prej Allahut të madhëruar, në lidhje me dy regjimet politike që erdhën në vëndin tonë.

Për regjimin feudal që kishte në krye mbretin Ahmed Zogu dhe regjimin socialist komunist që në krye ishte Enver Hoxha. Ajo tha mora këtë njoftim nga Allahu xh. sh. kështu: "Qeveria e kaluar [qeveria e Zogut] ka qenë qeveri imorale dhe dembele ndërsa qeveria e tanishme [Partia e Punës] është qeveri imorale por puntore". Është pa dyshim e vërtetë prej Allahut xh. sh. kjo fjalë se asnjëra qeveri e as tjetra nuk e mbështetën moralin e popullit tek feja. Një pjes nga qeveritarët ishin vetë imorala. Biografia e njerëzve u shikonte në anën politike e jo në anën morale. As njëra, as tjetra nuk i mësonte popullit ligjet dhe kulturën fetare. Pa dyshim fjalët që tha muxhedidja Aishe ishin prej Allahut xh. sh.

Përsa i përket punës, populli nuk kishte organizimi fare nga qeverija për punë. Nga kjo gjë varfëria ishte shumë e madhe në popull. Në vënd nuk prodhohej asgjë, populli mezi mbahej vetëm me blektorinë. Populli në përgjithësi ishte analfabet. Sëmundjet si malarja e kolera bënin kërdrinë në popull. Mbreti Ahmed Zogu deshi ta bënte reformën agrare por nuk e lanë çifligarët e mëdhenj si; Shefqet Verlaci, Toptanasit, Vrijonasit e tjerë. Kam dëgjuar nga babai im se ata i kishin thënë mbretit; Mos na prish se jemi mirë

kështu. Ata vërtetë ishi mire por populli ishte keq. Ndërsa mbreti Zog duke parë që ata kishin fuqinë ekonomike nuk mundi ta bënte reformën agrare. Mbreti Ahmet Zogu e besonte Zotin e madhruar dhe e faktonte këtë gjë hapur. Ai ishte burrë i mençur e atdhetar. Ai bëri shtetin Shqiptar por qeveria e tij, njerzit e shtetit që e rrethonin, shumica e tyre ishin njerëz të korruptuar, njerëz që mendonin vetëm për veten e tyre.

Në kohën e mbretit Zog e pyetën dijetarin e njohur musliman Hafiz Haxhi Dashin nga Tirana : Çfar ke për të thënë për rregjimin e Ahmed Zogut ? Dijtari Islam e përshkroi me 4 fjalë rregjimin feudal kështu; 1- Zogu rrin në çerdhet [d. m. th. mbreti rrin mbyllur brenda katër mureve në zyrë], 2, Gjarpijtë rrinë nëpër gjerdhet = pritë e bërë me shkurre gjethe e baltë në formë dige për të ngritur nivelin e ujit në një përrua. Këtu fjala ishte se se punët e rëndësishme nëpër zyrat e shtetit kishin ra në dorën e njerëzve të ligë që mendonin me mbushur xhepat e tyre dhe jo për forcimin e shtetit. Gjithashtu të pasurit në fshatra dhe të pasurit në qytete, shumica prej tyre mos me thënë të gjithë, nuk kishin fare dhimshuri për popullin fukara për arsye se ata ishin larguar nga rruga e Zotit xh. sh. e si pasojë dhe nga mëshira për fukaranë. Ata nuk e kishin më frik Zotin xh. sh. por kishin vetëm një besim formal pa vepra.

Tregtarët filluan të bëjnë tregëti haram=të jasht ligjshme, të pa drejtë duke spekuluar në kurriz të shumicës së varfër. Për sa i takonte çështjes së zekatit në përgjithësi nuk bëhej fjalë fare për të. Vetëm disa njerëz të rrallë që numëroheshin me gishtat e duarve e ndanin në atë kohë zekatin e pasurisë në qytete e fshatra. Të pasurit e mblidhnin florinin dhe e ruanin të mbyllur. Për të tillë njerëzish Allahu xh. sh. ka paralajmëruar në Kuran kështu; 'Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin [floririn e sermën] e nukë e japin për rrugën e Allahut, lajmëroi [ti o Muhamed ata] për një dënim të dhëmshëm. S. Tobe. aj. 34. Vërtet Allahu xh. sh. ju solli dënimin e dhëmshëm pasanikëve që e mbajtën të mbyllur pasurinë e nuk e dhanë për në rrugën e Allahut xh. sh. ,atje ku ishte i kënaqur ai, atëher Allahu xh. sh. i shkatroi e i zhduku ata përgjithmonë me anë të rregjimit komunist.

Ky ishte dënimi prej Allahut xh. sh. që ju çojë pasanikvet në vendin tonë e vende të tjera si ne. Allahu xh. sh. e ka bërë dhe do ta

bëjë gjithmonë realitet fjalën e vet. Allahu xh. sh. thotë në Kuran; “Disa mizorë=të pa mëshirshëm i shypim me disa të tjerë [të atij lloji]. 3-Namuzë sëzi=i pa tupshmi, i pa moralëshmi as nuk kuqet [nga turpi] e as nuk zverdheth [nga frika e qeverisë]: d. m. th. ata njerëz që janë pa turp, pa mëshirë, nuk po lënë poshtërsi pa bërë, dhe 4-Gota po mbushet dhe do të derdhet, =d. m. th. Kështu sikurse po shkojnë punët në këtë vend, ky regjim,=kjo qeveri nuk e ka të gjatë, për pak kohë do të shembet, dhe vërtetë kështu ndodhi. Rregjimi monarkistë i Zogut, pas pak kohësh u shembë. Ndërsa rregjimi komunist me Partinë e Punës, që në krye të saj ishte Enver Hoxha, vërtetë dhe ky ishte rregjim imoral, por me qeveri punëtore. Partia e Punës e udhëhequr nga Enver Hoxha, bëri rreformën agrare dhe më pastaj kolektivizimin e përgjithshëm të tokës. Me këtë mënyrë veprimi u bë shumë punë në këtë vendë që ishte i varfër i prapambetur dhe aqë më keq i shkatërruar dhe nga lufta e dytë botërore. U ndërtuan aq sa ishte e mundur; fabrika, uzina, rrugë, u ngrit industria, u thanë kënetat u hapën toka të reja bujqësore, u ndërtuan qytete, u zhvillua bujqësia, u luftua analfabetizmi e u hapën shkolla e universitete, u ndërtuan hidrocentrale u elektrifikua gjithë vendi e tjera e tjera. Këto janë të vërteta, janë fakte reale.

Përparimi i vëndit ishte i madh në kohën që e drejtonte vendin Partija e Punës, me Enver Hoxhën në krye të saj. Nuk mund të krahasohet përparimi që bëri Shqipëria me Enver Hoxhën në krye me atë që bëri kur ishte në krye të saj mbreti Ahmed Zogu. Mbreti Zog e ngriti më këmbë shtetin Shqiptar ndërsa Enver Hoxha e konsolidoi atë. Enver Hoxha ndenj në krye të shtetit 40 vjet ndërsa mbreti Ahmed Zogu ndenji 15 vjet. Kështu që edhe kokëforti më i madh duhet ta pranojë të vërtetën që është e qartë si drita e diellit. Duhet ta besojë çdo besimtar sinqerishtë lajmin që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e cila ishte muxhedidja e fundit e dërguar nga Allahu xh. sh. me shërbimin e thirrjes për tobe-për pendesë para kijametit për të gjithë njerëzimin mbarë kudo në botë.

60-JA ÇFAR THA MUXHEDIDJA AISHE PËR RILINDASIT E KOMBIT SHQIPTAR = RILINDASIT E NACIONALIZMIT.

Një rastë un e pyeta muxhediden Aishe për rilindasit për punën e tyre në të mirën e kombit tonë. Ajo qeshi pak e tha: E kush vjetërlindasit? Unë e shikova me habi e kureshtje muxhedien. Kur ajo e pa që unë po e shikoja me vëmëndje se çfar do të thoshte më tepër, ajo tha; E çfar rilindën more djalë ata, veç besimeve dhe zakoneve të vjetra pagane = idhujtare? dhe murshidja Aishe qeshi nëpër dhëmbë ha. ha. ha. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e kishte fjalën se rilindasit sikurse u quajtën ata që punuan për formimin e shtetit Shqiptar duke e larguar popullin nga feja, u ngjallën besimet dhe zakonet e vjetra pagane që feja Islame i pati groposur.

Ndërsa ata të pakët që kishin dije feje, dhe disa besimtarë të pakët nga mosha e vjetër që e ndiqnin fenë pa dituri, por si zakon, me që ata nuk bëri Tobe edhe atyre ju hyri lepuri në bark nga frika dhe disa nga interesi se i kishin fëmijët nënpunësa me detyra e rroga të mira në atë kohë, nuk guxuan të mblidheshin për të protestuar kundër inisiativës së rinisë për luftën kundër fesë. Nëse do të ishte Enver Hoxha fajtori për prishjen e xhamiave dhe kishave në këtë vëndë ndërsa të tjerët të ishin gjithë të mirë, atëherë Zoti xh. sh. do të ia kishte marrë shpirtin menjëherë në atë kohë Enverit se për qefin e një njeriu Zoti xh. sh. nuk do të lejonte të prisheshin faltoret ku aty njerëzit i faleshin e i luteshin Zotit xh. sh. Por Enver Hoxhës si person i mbeti gota e thyer në dorë.

Kjo është e vërteta përse i takon personalishtë Enver Hoxhës. Gjithashtu edhe nga ana logjike është e pa mundur një njeri i vetëm ta bënte një gjë të keqe kaq të madhe, nëse të tjerët nuk do të ishin dakort. Por duhet ta mendojmë mirë çështjen. E vërteta është ndryshe. Populli në përgjithësi siç e tham më sipër nuk vepronte sipas fesë e as nuk e çmonte rëndësinë e sajë. Ai në përgjithësi e ndiqte fenë me imitim nga babai tek i biri më tepër si punë zakoni. Populli mendonte dhe po mendon edhe sot vetëm për të mbushur barkun dhe as për gjë tjetër.

Të pakët ishin e janë njerëzit e që e kuptonin dhe kuptojnë sot rëndësinë që ka feja për njerëzit në çdo vënd të botës. Allahu xh. sh. thotë në Kuran; "Ne ta shpallëm [o Muhamed Kuranin] që ti

studiojnë argumentet e tijë ata që kan mend=që kuptojnë. "S. Sad. aj. 29. Allahu xh. sh. bëri që me dërgimin e muxhedides Aishe për thirrje në tobe, populli të zgjedhi njëren nga të dyjat: Ose të bëjnë Tobe e të lumturohen, ose të jenë nën diktaturë e të dërrmohen. Allahu xh. sh. me sa u kuptua e la popullin tonë që të zgjedhin: "Ose fenë Ose frenë" por populli Shqiptar nuk bëri tobe. Allahu xh. sh. i dha atë që meritoi= i vuri frenë. Si atëher në atë koh, ashtu dhe sot populli jonë nuk po bën tobe=pendesë. Ai nuk po largohet nga fjalët dhe veprat e liga. Në radhë të parë duhet të largohet nga shirku=krimi kundër Zotit xh. sh. vënja shok e ortak Allahut xh.sh. në gjuhën që flet. Shum pak njerëz e njisojnë Zotin xh.sh. në gjuhën që flasin. Po vazhdojnë akoma ky populli me në krye hoxhallarët dhe pushtetarët duke thirrur njëri tjetrin Zoti e zotnesha ose zonja. Estagfirullah. O njerëz nuk ka tjerë Zotër veç një Zoti xh. sh. dhe Ai nuk ka as grua e as djalë. Kurani thotë:

"Allahu nuk e humb një popull pasi ta ketë udhëzuar atë [tia ketë vënë në dukje fajet] pare se tu sqaroi atyre se prej çka [të këqish] duhet ruajtur. "Pikërisht është surja ose kapitulli që mbanë emrin Tobe-Pendesë. ajeti 115. Popullit në atë kohë ju kishte dobsuar krejtësishtë besimi në zemër dhe vetëm fliste aty këtu ndojë fjalë feje por pa vepra. Disa njerëz kryenin disa rite=bënin disa gjëra gjoja fetare por që në fakt nuk kishin lidhje fare me fenë Islame. Në disa fshatra që e falnin namazin e xhumas kishte raste të shumta që nuk bëheshin as tre veta për të fal namazin e xhumas. Mendoni tani se në çfar gjendje besimi ishte atëherë populli ynë. Gjysma e më shum as që e besonin botën e përtejme pas vdekjes=ringjalljen ashtu sikurse sotë me përjashtim të disa njerëzve të pakët. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ne nuk dënojmë asnjëherë [ndonjë popull] përderisa të mos i dërgojmë të dërguarin = paralajmërusin. "S. Isra. aj. 15. Allahu xh. sh. nuk e drejtoi për së mbari popullin Shqiptar se ai nuk e njisoi Atë në gjuhën e vet.

63-TURMAT E POPULLIT KËRKUAN QË MURSHIDJA AISHE TË GJYKOHEJ PARA TYRE. ATA KËRKUAN DËNIME TË RËNDA PËR TË.

Pas luftës kundër fesë filloi edhe luftimi, poshtrimi edhe

dënimi kundër njerëzve të fesë; hoxhallarëve, priftërijve e besimtarëve të çdo feje. Nga ky sulmim kundër njerëzve të fesë nuk shpëtoi dhe murshidja Aishe qoftë i kënaqur Zoti xh. sh. prej sajë. Aishen e sulmuan me fletë rrëfyse ose fletë rrufe sikurse i quanin në atë kohë, dhe i bënë akuza të pa baza. Më kujtohet se një nga akuzat që i bënë Aishesë ishte se ajo gjoja kishte thënë që burrat le ti rrahin ose le ti lëshojnë gratë. e stagfirullah. Në fund të fletë rrufesë ishte kjo kërkesë nga rinia e atëherëshme pa mëndje në kokë; Kërkojmë të burgoset, të internohet ose edhe të vritet sepse ka shkelur fjalën e shokut Enver i cili në atë kohë kishte thënë sa më kujtohet për afërsishtë kështu: “ Cili njeri merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, ti këputet koka dhe të digjet në zjarr ”. Kjo parrullë shihej në atë kohë e shkruar kudo në mure. Më në fund si shumë njerëz të fesë dhe muxhedidja Aishe u përballë me popullin dhe me organizatat shtetërore, në sheshin e shkollës Mihal Grameno. Aty kishte njerëz të ndryshëm; nga organizata e partisë e rinisë, gruas, frontit, nga këshilli popullorë i lagjes e tjerë.

Populli u ngrit duke folur kundër murshides Aishe rahmetullahi alejha. Ata kërkonin që të dënohej me burgim ose të internohej në një vendë të izoluar kjo murshide=udhëzuse e famshme e shekullit të njëzetë. Ata nuk e kuptonin që muxhedidja Aishe mendohej për të mirën e tyre pa dallim. Në atë kohë populli ynë me nxitjen e disa djajëve prej njerëzish e xhindësh kishte marrë hov të madh kundër fesë. Ateistët=të pa fetë thoshin në atë kohë se feja është opium=drogë për popullin por kjo gjë nuk ishte aspak e vërtetë por përkundrazi ateizmi=pafesia ishte dhe është helm për popullin.

Kjo e vërtetë u shikua mirë atëherë dhe pasojat e ateizmit po shihen në popull akoma më shumë sot në këtë kohë që jemi. Ishkreti popull mendoi se pasi të luftoi fenë, atëherë do të bëj jetë të lumtur por ndodhi e kundërta. Filloi për popullin në Shqipëri në përgjithësi kalvari i vuajtjeve fizike, ekonomike dhe shpirtërore. Inshallah bëjnë tobe=pendohen tani; se është më mirë vonë se pa gjë fare. Murshidja Aishe rahmetullahi alejha në atë mbledhje deklaroi hapur këto fjalë: Unë pranoj vdekjen nga qeveria dhe nuk largohem Nga ky shërbim që më ka ngarkuar Allahu xh. sh. Pas Aishes e merr fjalën njëri nga të deleguarit që kryesonte mbledhjen, në këtë balla-

faqim mes popullit dhe muxhedides Aishe. Ai u ngrit e tha këto fjalë; Neve Aishe na vjenë shumë keq që na thua se pranoj vdekjen nga qeveria. Ne Aishe nuk i vrasim të tillë njerëzish si ti. [Fjala e tij me sa kuptohet ishte; si ti me kulturë të lartë shpirtërore që përpiqesh për edukimin moral të popullit].

I deleguari i qeverisë tha : Aisheja na ka sjellë pak telashe me popullin por ajo nuk ka asgjë politike që dëmton shtetin. Aisheja që është një grua e mënçur, sot e kupton dhe do ta kuptojë dhe më mirë në të ardhmen se ky popull nuk e do fenë [duke e zgjatur dorën në drejtim të turmës]. Me të vërtetë populli nuk e deshi fenë se donte frenë. Në fund të mbledhjes autoritetet u ndalën të rreshtuar në shenjë respekti, për tu përshëndetur me muxhediden Aishe rahmetullahi alejha. Ballafaqimi i muxhedides Aishe me popullin e organet e shtetit në ata mbledhje është i filmuar si shumë ngjarje të filmuara gjatë revolucionit anti fetarë në Shqipëri. Un e kam parë një her atë pjesë filmi në vitin 1968 kur isha në moshën 15 vjeç dhe duhet të jetë në arshivën e filmave në kino studio. Pas kësaj ngjarje mesa më kujtohet ishte shkaku që murshidja Aishe mori këtë njoftim nga Allahu xh. sh. kështu; "Si kur mos të kishim futur shumë zgjuarësi tek qeveritarët e rangut të lartë [të shtetit] ty [Aishe]ky popull kishte për ta bërë çiklën më të vogël të trupit sa maja e gjilpërës por Allahu është [Ai] që i rregullon çështjet. Të më bëshë mua shyqyrin = falenderimin për këtë. "Pa dyshim kjo ishte fjalë prej Allahut xh. sh. për ti dhënë kurajo muxhedides Aishe rahmetullahi alejha. Vërtetë Kurani thotë; "Ai [Allahu] është që i udhëheq çështjet prej qiellit në tokë...S. Sexhde-kapitulli Përrulje. Kurani thotë: "Ai [Allahu] kujdeset për të mirët. "S. Araf. aj197. Gjithashtu Allahu xh. sh. në Kuran thotë; "O i dërguar...Allahu ty të garanton mbrojtje prej njerëzish [armiqëve]" S. Maide. aj. 67. Në çdo kohë e situatë ata njerëz që janë në krye të punëve të shtetit nuk duhet të nguten për ndonjë çështje, por duhet ti shoshisin mir të dhënat që u vinë nga poshtë se në popull gjinden gjithmonë njerëz që nuk kuptojnë ose kanë mllafe e hasmëria njëri me tjetrin për hesapet e tyre personale. Është fakt i pa kundërshtues se kombi Shqiptar në përgjithsi parinë kryesore udhëheqëse në çdo kohë i ka pasur njerëz të zgjuar ndërsa vetë populli në përgjithësi shumë herë është hutuar e nganjëherë disa edhe janë tërbuar sikurse dje nga propoganda

komuniste anti fetare dhe sot nga propaganda demokratike anti morale, që është anti fetare dhe anti kombëtare. Allahu xh. sh. i drejtoftë të gjithë për së mbari.

**64-PËRPEKJET E MUXHEDIDES AISHE PËR TË BËRË
HIXHRET=SHPËRNGULJE NGA VENDËBANIMI I SAJ
PAS NDALIMIT TË FESË ME LIGJ NGA SHTETI
SHQIPTAR NË VITIN 1967.**

Pas ndalimit të lirisë së fesë murshidja Aishe rahmetullahi alejha mori dije dhe pëlqim nga Allahu xh. sh, që ajo të bëjë hixhret=emigrim=shpërngulje nga vendë banimi i saj Tirana, ashtu sikurse bëri hixhret Pejgamberi a. s. i cili iku nga Meka dhe shkoi në Medine. Ajo kishte marrë njoftim prej Allahut xh. sh, që hixhretin ta bënte në një fshat në krahun lindor të Tiranës. Arsyeya ishte që ajo të largohej sado pak nga grumbulli i ateistave e munafikëve=dyftytrëshve që e luftonin me shum rreptësi fenë dhe e u urrenin murshiden Aishe rahmetullahi alejha. Ndërsa në fshat ishte më ndryshe problem pasi aty kishte njerëz të thjeshtë besimtarë që e besonin Zotin xh. sh. dhe kishte më pak ateista.

Në atë kohë në gjithë Shqipërin por më shumë në veri; në rrethet Lezhë, Kurbin e Shkodër dhe në zonat e jugut të vendit u shtuan me shumicë ateistat që shanin me fjalë të pista Zotin xh. sh. [estagfirullah]. Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë "Janë të mallkuar ata që ofenduan Allahun. "Allahu i drejtoftë ata që janë gjallë se ndoshta Ai e fal atë që do. Dhe që e kishim fjalën për hixhretin Allahu xh. sh. thotë në Kuranë; " Kush shpërngulet [bën hixhret] për hatër të Allahut =[për kënaqësi të Allahut= për fenë e Tij], ai [njeri] gjen mundësi të madhe dhe begati në tokë. . "S. Nisa. ajeti. 100. Gjithashtu Allahu xh. sh. ka thënë: "A nuk ishte e gjërë toka e Allahut e të emigrojshi në të. [e ta praktikojshi lirishtë fenë]...ata [që nuk e bënë hixhretin] do të dënohen, përveç atyre që ishin të pa aftë, nga burrat, gratë e fëmijët dhe që nuk kishin mundësi të gjenin as mënyr as rrugë [për tu shpërngul]. "S. Nisa. aj. 97, 98. Në atë kohë në Shqipëri ishte e vështirë lëvizja e lirë e popullit tonë dhe brenda vendit. Megjithse muxhedidja Aishe bërë çka ishte e mundur për të bërë hixhretin por këtë gjë ajo nuk ia arriti qëllimit megjithëse bëri disa herë përpjekje. Muxhedidja Ashe bëri përpje-

kje për hixhret =për të shkuar me banim në këta fshatra të Tiranës; Sauk, Mullet, Farkë e Madhe dhe Farkë e Vogël. Në fshatrat Farkë e Vogël dhe Farkë e Madhe isha edhe unë që e shoqëroja. Një tjetër arsye e sajë ishte se ajo ishte e vetmuar pa njerëz të familjes, pa burrë, pa fëmijë, pa vëllezër e motra që ta shoqëronin. Një vëlla dhe një motër që kishte të gjallë, ata shikonin hallin e vetes e fëmijëve të tyre dhe nuk e kishin hallin e hixhretit= shpërnguljes për zbatimin e urdhërit të Allahut xh. sh. të dilnin nga qyteti e të shkonin në fshat. Ata nuk ishin në atë gradë besimi, që ta dinin rëndësinë që ka hixhreti për të ikur nga ai vend që e mbulon kufri sado pak kilometra qoftë. Murshidja Aishe tentoi disa here për të bërë hixhretin por ishte e pa mundur për shumë arsye.

Ajo ishte gati të bënte këmbim shtëpije me ndonjë fshatarë, por e para gjë ishte se murshidja Aishe nuk e kishte të vetën atë dhomë prej qërpiçi me një aneks të rrethuar me teneqe në të cilën gatuate porë e kishte në përdorim me pagesë mujore nga një plak tiranas i vjetër. E dyta dhe më kryesorja ishte se nuk e lejonte shteti fshatarin të vinte aqë kollaj me banim në qytet se mbeste bujqësia pa njerëz. Gjithmonë çështjen e hixhretit muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e kishte në mëndje. Ajo thoshte duke qënë e dëshpruar për këtë gjë.

Hixhretin = shpërnguljen nga vëndbanimi unë nuk arrita ta bëjë në jetën time ashtu sikurse e bëri Pejgamberi a. s. dhe sa herë që ajo fliste për Pejgamberin a. s. asaj i rridhshin lotët si ujë. Hixhreti për vullnetin e Allahut xh. sh. ka shumë dobina këtu dhe në jetën pasë vdekjes thoshte muxhedidja Aishe që Zoti xh. sh. e mëshiroftë atë. Ajo thoshte; Duke qënë gjithmonë në hall për të bërë hixhretin Allahu xh. sh. që di çdo gjë, në ato dit që u mbyllën xhamiat, më shfaqti mua në ëndërr thoshte Aisheja, këtë pamje kështu; Ishim duke u ngjitur nëpër shkallët e jashtëme të xhamisë së madhe të Durrësit, unë bashkë me hoxhën myftiun e Durrësit përkrah njëri tjetrit.

Në ato momente thoshte murshidja Aishe dëgjova një zë që tha këto fjalë: “Këta dy njerëz janë në hall të madhë tani. Hoxha rrin duke menduar se po vjen hëna e Mevludit dhe mendon se nuk ka ku të marrë ndonjë lek, ndërsa Aisheja mendohet se ku ta ta bëj tani hixhretin. ” Nga kjo shfaqje filmike prej Allahut xh. sh. e shoqëruar me këto fjalë thoshte muxhedidja Aishe, është

i qartë kuptimi se njerëzit që merren posaçërisht me mësimin e fesë duhet që ta kenë mëndjen tek daveti=thirrja e mësimi i njerëzve në rrugën e Allahut xh. sh, që të fitojnë dashurinë e Tij dhe jo tek lekët. Ai që e merr hoxhën dhe këndo Mevludin për shpirtin e vet, ai njeri pa dyshim do ta paguaj Hoxhën për respektin ndaj fesë dhe dijetarit të fesë si dhuratë për kohën që ai harxhon. Por hoxha i mir nuk duhet ta mbajë mëndjen tek lekët por tek detyra e fesë që ai të shfrytëzojë rastin për të përhapur në popull dijen e fesë.

Dijetari i sinqertë i fesë është trashëgimtar i Pejgamberit a. s. Ai duhet të shpërndajë rrezet e diturisë Islame në popull. Ai duhet të jetë i bindur për rriskun që ka caktuar Allahu xh. sh. për të se nuk mbahet jetesë me lekët e këndimit të Mevludit e të jasinave sado që populli bën detyrën e vet në respektë të dijetarëve të fesë, të mundit të harxhuar prej tyre.

Murshidja Aishe thoshte se inshallah mua ma shkruan Allahu xh.sh. për hixhret shpërnguljen që kamë bërë nga lagjja ku isha me banim në rrugën e Durrësit dhe ardhjen në lagjen e quajtur Ali Demi në afërsi të "Qytetit Studenti." Për çështjen e hixhretit, murshidja Aishe e shoqëruar dhe nga un Haxhi Ymer Aga në vitin 1982 shkuam në fshatin Farkë e Madhe, në shtëpinë e ish kryetarit të këshillit popullorë të fshatit Bajram Abdurrahman Shkalla për ti kërkuar atij një truall shtëpije për muxhediden Aishe rahmetullahi alejha. Arsyja i thashë unë Bajramit që kjo mikësja ime do që të shpërngulet nga qyteti në fshat, është ana shëndetësore e saj se kjo vuan nga mushkëritë=vuan nga azma. Kjo juve nuk ju kërkon punë, dhe truallin ti jepja kësajë në emrin tim. Më vonë unë do të ja jap Aishes.

Bajrami ishte komunist, por ai na priti mirë dhe na e premtojë këtë gjë duke na thënë që do ta bëj. Ne u larguam të kënaqur prej Bajramit. Muxhedidja Aishe më tha mua se Bajrami ishte njeri i butë-i arsyshëm. Un i thashë asaj se ai i ka pasur prindërit besimtarë. Babai dhe nëna e tij agjëronin dhe faleshin. Mesa e di un, nëna e tij dinte ta lexonte Kuranin Arabisht. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha gjithmonë për çdo punë me rëndësi kërkonte rrugë zgjidhje prej Allahut xh. sh me namazë e duanë e istihares. Edhe për këtë rastë ajo fali namaz natën dhe bëri duanë e istihares duke iu lutur Allahut xh. sh. që ti jepte me kuptuar nëse hixhreti në lagjen tonë në fshatin Farkë ishte i përballushëm për Aishen apo jo. Allahu xh. sh. që di e sheh çdo gjë e njoftojë murshiden Aishe

me anë të ëndrrës se për arsye të kushteve shumë të këqija që ishin në lagjen tonë ajo nuk mund ti përballonte vështitë e shumta për të jetuar aty duke qenë se ishte e moshuar dhe e vetmuar atëherë. Vërtetë ashtu ishte. Lagjës jonë ndahej në dy pjesë për sa i takonte biografisë politike në atë kohë. Njëra pjesë e lagjes ishim të persekutuar=kulakë e fis kulakësh dhe tjetra me dëshmorë e fis dëshmorësh porë të gjithë ishim në pikë të hallit pa kushte jetese. Në atë kohë në lagjen tonë nuk kishim ujë fare. Mbushnin ujë dy lagjet në një pus të Ali Agës që Zoti xh. sh. ia shpërbleftë atij, por kur në verë pusët shterojnë, pusi i Aliut e shtonte ujin se mbushej me ujë e turbullt e të pistë të kanalit vaditës që vinte nga lumi Erzen. Dyqan në lagje nuk kishim. Punojshim gjithë ditën dhe shkojshim një orë rrugë me shkuar dhe ardhur për të marrë bukën, qumështin e ushqimet. Ishim elektrifikuar por drita ne më shumë nuk kishim se kishim. Për mjete transporti për udhëtarë as që bëhej fjalë fare dhe më e keqja ishte se në dimër për të shkuar në qytet do ta qarkoje gjatë rrugën një orë e gjysëm në këmbë për shkak të ujërave të përrenjëvet dhe baltës së madhe që bëhej nga shirat. Kështu që dhe në këtë rast që motra e saj ia dha fjalën murshides Aishe se do ti shkante asaj nga pas me djalin e saj invalid edhe kjo tentativë që ishte e fundit për të ba hixhret=shpërngulje nga qyteti ishte e pa mundur për muxhediden Aishe rahmetullahi alejha që ajo ta bënte hixhretin. Ajo vdiq duke qenë me merakun që nuk arriti ta bëj hixhretin. Por Allahu xh. sh. në Kuran na sqaron qart ku thotë se: "...Do të dënohen ata që nuk e bënë hixhretin përveç atyre që ishin të pa aftë nga burrat, gratë e fëmijët e që nuk kishin mundësi të gjenin as mynyrë e as rrugë për tu shpërngulur. Atyre do tua fali Allahu. . S. Nisa. =Kapitulli Gratë. ajetet 97, 98, 99.

65-PASË VITIT 1967 QË FILLOJË LUFTA KUNDËR FESË NË SHQIPËRI, FILLOJË DHE AZABI-DËNIMI I MADH PIKËLLUES PËR GJITHË POPULLIN.

Fill pas shembjes së xhamiave e kishave në Shqipëri, pasi populli nuk pranojë të bëj tobe, u bënë realitet fjalët e Allahut xh. sh. me të cilat Ai e kishte paralajmruar popullin tonë me anë të muxhedides Aishe, me këto fjalë kështu; "Thuaju ti [Aishe] njerëzve

[popullit] nëqoftë se nuk do të bëjnë tobe do, ti përfshinjë ata me një azabë=dënim pikllus që sytë dhe veshët e këtijë populli mos ta kenë pa e dëgjuar ndonjëherë nga të parët e tyre; Ky dënim pikëllus do ti përfshinjë të gjithë mohusat [qafirat e munafikët-dyfytyrëshat] dhe ata njerëz që u lajmëruan për të bërë tobe [e dëgjuan] lajmin për tobe] dhe tobe nuk bënë, dhe me anë të këtij azabi pikëllues=dënimi pikllus do ti transferoj një nga një në xhehenem. "Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë: "Çdo lajm ka afatin e realizimit, më vonë ju do ta kuptoni. "S. En-nam. aj. 86.

Me të vërtetë Allahu xh. sh. e bëri realitet fjalën e vet me të cilën e kishte paralajmëruar më parë popullin shqiptar nëpërmjetë muxhedides Aishe, qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej sajë. Kushte të vështira jetese i krijoi Allahu xh. sh, këtij populli që u thirr për të bërë tobe, por nuk bëri. Ky popull vuajti jashtëzakonisht në përgjithësi. Vuajti fizikishtë ekonomikishtë dhe shpirtërisht. Nëse nuk pendohet-nuk kthehet në rrugën e Zotit xh. sh. përsëri keq do ta ketë punën në të ardhmen populli Shqiptarë. Në një ajet Kurani Allahu xh. sh. thotë; "Thuaju [o Pejgamber] prisni se dhe ne po presim. " Në vitin 1968-1969 një vit pas ndalimit të fesë, qeveria ia hoqi me ligjë fshatarëve që punonin në fermat bujqësore shtetërore të drejtën që të mbanin një lopë ose një dhi të vetme për qumësht dhe as të mbanin më kafshë për ngarkesë. Menjëher pas kësaj iu hoqë fshatarëve gjithashtu edhe e drejta që të kenë tokë private, iu hoq e drejta e mbajtjes së kopshteve shtëpiake që në atë kohë ishte me ligjë deri një dylm e gjysëm. Pastaj u bë shtatëqidë metra e më pas vetëm oborrin e shtëpisë.

Duke filluar nga viti 1970 normat për proceset e ndryshme të punës në çdo ndërmarrje filluan të ngriheshin nga shteti ndërsa puna që bënin njerzit nuk i paguhej me vlerën që duhej. Leku filloi të paksohej gjithnjë e më shumë. Ekonomia e vogël shtëpiake u luftua deri në fund. Puna në industri filloi të bëhet me tre turne. Populli filloi të varfërohet. Pas luftës kundër fesë shteti nxorri ligjin që meshkujt të bënin zbor, punë e shërbim të detyrueshëm dy javë në vit si ushtarë rrezervë duke filluar që pas shërbimit ushtarak e deri sa të dilnin në pension. Filloi hapja e tuneleve nëntokësor nëpër kodra e shkëmbij dhe traseve të mbuluar me mjete rrethamore në fusha e kodra dhe ndërtimin e vendstrehimeve me beton

e hekur nëpër lagjet e qyteteve e fshatrave për tu mbrojtur nga bombardimi i armikut të jashtëm Amerikan e Sovjetik=Rus. Sidomos kur bëhej lojë ushtarake, zboristët kishte raste që kan shkuar nga Tirana në Korçë duke ecur me këmbë, natë e ditë në shi e në borë e duke fjetur jashtë me kurrizin në tokë. Ata që kan bërë zbor e dinë mirë se çfar kan hequr dhe le tua tregojnë të vërtetën fëmive dhe nipërve të tyre. Allahu xh. sh. thotë në Kuranë: “Ne nuk dënuam asnjëherë, para se tia dërgojmë [atij populli] të dërguarin. [para se ti paralajmërojmë ata]. S. Isra. Aj. 15’’. Kjo fjalë e Allahut xh. sh. u bë realitet dhe për popullin në Shqipëri. Allahu xh. sh, në Kuran thotë: “I tillë pra është ndëshkimi i Zotit tëndë kur dënon vëndet që [njerëzit] janë zullumqarë. Vërtetë ndëshkimi i Tij është i dhëmshëm e i ashpër’’. S. Hud. aj 102. Çdo vit që erdhi pastaj, fillojë të luftohet nga shteti çdo gjë private dhe diktatura forcohej gjithnjë e më shumë. Në vitin 1972 u godit nga shteti prona private. Fshatarëve iu hoq toka e blegtorija. U bë çdo gjë pronë shtetërore. Edhe vezët e pulave si gjë private u ndaluan të shiten në treg, po lere të tjerat gjëra. Mendo i shkreti popull se pasi të luftojë kundër Zotit xh. sh. do rrij rehat e do të bëj qef por ndodhi e kundërta. Zoti xh. sh. i luftojë ata. Normat e punës filluan të ngriheshin në industri dhe në bujqësi. Lodhja filloi të jetë e madhe e ndërsa fitimi ishte i pakët. Puna arriti deri aty që iu ndalua pastaj fshatarëve edhe mbajtja e pulave.

Më kujtohet vendimi numër 507 i kryeministri Mehmet Shehu që ndalonte mbajtjen e pulave jashtë kotecit. Drejtorja e fermës ku unë punoja nxori një shpallje që nuk lejonte të mbaje më shumë se 5, 6 pula dhe këto ti mbaje në kotec se dëmtonin pronën e shtetit pasi anëtari i fermës nuk kishte tokë fare veçse oborrit të shtëpisë. Mua më kujtohet kjo ngjarje në atë kohë. Un punoja në fermë dhe një ditë brigadieri që drejtonte brigatën e punës mua nuk më dha punë më përzuri në shtëpi se nënës i kishin dalë nga koteci 4 pulat dhe një gjelë që ne kishim. Fshatarët në muajt e verës ishin të detyruar të punonin me orar të zgjatur 11 deri në 13 orë në ditë. Dilnin nga shtëpia kur lindte dielli dhe këtheheshin kur perëndonte. Kjo gjë vazhdonte 5 muaj në vit. Puntorët e industrisë në uzina e fabrika punonin me tre turne.

Ndodhte që burri nuk e takonte gruan e tij një javë ditë se kur vinte burri nga puna ikte grua në punë se merrte turnin. Megjithse

populli punonte kaq shumë, ndërsa pagesa ishte shumë e vogël. Populli punonte vetëm për bukën e gojës e cila disa vite ishte me racion, 700 gram për frymë e sidomos në fshatra. Fshatarët e mjer e prodhonin vetë grurin por ata nuk hanin bukë gruri por bukë misri. Adhe bukën e misrit e hanin të pa pjekur mir e me mbeturina Brenda, Me rërë e kashtë Ata rrinin prapa dyrëve të dyqaneve në qytet si lypsa e të ofenduar duke iu lutur e përgjëruar shitësve të bukëve e duke iu lënë nga një her dhe nga një lek bakshish vetëm se tu jepshin ndonjë bukë gruri për fëmijët e vegjël dhe pleqtë. Ndërsa fshatarët e fermave bujqësore që e prodhonin qumështin nuk e hanin vetë pa furnizuar qytetin. Nëse tepronte gjë ata e merrnin me racion 1 deri 2 kg. qumësht për një familje prej 5 ose 7 antarësh. Qumështi ishte gjysma ujë e gjysma qumësht. Mjelset e lopëve i mbushnin kovat me ujë kur shkonin të milnin lopët që të ralizinin normën ose ta tejkalonin atë për të marrë ndonjë lek më shumë. Përgjegjësit e tyre e bënë një sy qorr e një vesh të shurdhët se Komiteti i Partisë së qytetit i kërkonte llogari drejtorisë së fermave bujqësore për furnizimin me qumësht qytetin. Kur qumështi në dimër ishte i pakët, fshatarët i lenin pa qumësht fare. Sillnin një bidon qumësht me 25 litra për gjithë fshatin dhe njerzit e shkretë grindeshin njëri me jetrin në radhën për qumësht se kushë të merrte më parë për fëmijët e vegjël. Gratë e burrat e fshatit në fermat bujqësore ngarkonin në kurriz pompat e spërkatjes së vreshtave me solucion që peshonin 25 e 30 kg dhe punonin në pikun e vapës nga mëngjezi deri darkë kur perendonte dielli. Gratë e fshatarvet dhe puntorvet në regjimin komunist peshonin në përgjithsi 50 deri në 60 kg. Ndërsa burrat peshonin nga 53 kg deri në 65 kg. Ata burra që peshonin 70 deri 73 kg quheshin burra të mëdhej. Ndërsa në anën tjetër regjimi komunist bënte propogandë të madhe se gruas fshatare ia kishte hequr barren nga kurrizi se dikurë gratë e fshatit ngarkoheshin në kurriz me dru e shkurre për zjarr në shtëpi. Ndërsa gratë e klasës puntore të qytetit punonin me tre turne. Qytetarët ngriheshin në orën 4 ose 5 të mëngjesit për të zënë rradhën pran dyqaneve për të marr qumësht. Nga lodhja e madhe dhe të ushqyerit keq, në regjimin komunist filluan të përhapen shumë te puntorët e fshatarët sëmundjet e luçemisë [pishjes së gjakut], tuberkulozi e kanceri. Ndërsa në kohën e mbretit Ahmet Zogu bënëin kërdrinë në popull sëmundjet e malarjes, tifës e dizanterisë. Murshides Ashe rahmetullahi alejha i vinte keq për njerëzit kur i shikonte duke vuajtur aq shumë. Ajo thoshte se un jua thash atyre lajmin që mora prej Allahut xh. sh. kështu: "Thuaju ti atyre [njerëzvet] nëse ata bëjnë tobe do ta ndryshoj situatën [politike]". Mirpo me përjashtim të disa njerëzve të rrallë, populli shqiptarë nuk bëri tobe. Pas 10 vjetësh, në

vitin 1978 iu ndalua nga qeveria edhe antarëve të kooperativave bujqësore të mbanin një lopë për të ushqye fëmijët. Ekonomia e vogël private pothuajse u eliminua plotsisht në gjithë vendin. Atëherë dyqanet u boshatisën krejtësisht. Filluan ushqimet të shiten me racion. Varfëria në Shqipëri arriti deri aty sa që duhej të kishe mik ndonjë shitës për të gjetur letra duhani të paktën në raste vdekjesh. Pa lëre pastaj punën e mishit, sheqerit, sapunit, të vajit të lule diellit të cilat ishin me racion. E sa për vajin e ullirit kishte vite që kishte humbur e nuk bëhej fjalë për të. Gjëndja ekonomike, fizike e shpirtërore e popullit u bë e mjerushme. Fshatarët që punonin në kooperativa bujqësore hanin bukë misri të pa bluar mirë dhe me zhurë=zhavor ose zallë brënda e gjithashtu akoma më keq e pa pjekur mir. Për çdo ditë pune nuk merrshin më shumë se 30 ose 40 lekë në ditë mezatarja e përgjithshme e vendit që me këto lekë merrje një bukë gruri ose gjysëm kile sheqer. Çmimet për veshje e mbathje dhe për sendet shtëpiake ishin shumë të shtrejtja. Një palë çizme gome [llastiku] për punë kushtonin 1000 e 1200 lekë. Punëtorit të fermës i duhej të punonte 6 ose 7 ditë pune për ti bler ata se ai merrte 160 ose 170 lekë në ditë. Ndërsa punëtorit të kooperativës i duhej të punonte 26 e deri 30 ditë punë për ti blerë. Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë: "Ne nuk e dërguam asnjë lajmëtarë në ndonjë vendëbanim e që [pastaj] nuk e ndëshkuam atë [popull që nuk u bind] me skamje e vështërsi të tjera. S. Arafë. aj. 94. Kështu që pas ndalimit të fesë filloi të jetë e ashpër diktatura dhe ngushtica e madhe ekonomike në Shqipëri. Cili njeri që guxonte të fliste ndonjë fjalë sa do të vogël që tregonte shenjë pakënaqësie ndaj rregjimit e fuste qeveria menjëherë në burg duke për axhitacion e propogandë kundër shtetit. Burgjet filluan të mbushen plot e përplot me njerëz. Allahu xh. sh. në Kuran thotë : "Le të ruhen ata [njerëz] që kundërshtojnë rrugën e tij [thirrjen e të dërguarit] se ata [njerëz] do ti zëj ndonjë telashe ose do ti godasi dënimi i idhët [dënim i dhëmshtëm pikllues]". S. Nurë = kapitulli Drita. aj. 63. Vërtetë kështu ndodhi tekë ne në Shqipëri. Vuajtjet, grindjet e mjerimet në këtë vend nuk patën të mbaruar sikurse i shikuam e po i shohim dhe sot për të cilat do të flasim gjithnjë në vazhdim në këtë libër. Dënimin e hidhët populli në Shqipëri e pësoi në përgjithsi. Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë: "Çfarë do e keqe që ju godet [juve o njerëz] vjen si pasojë e

asaj që keni bër vetë. "S. Shura. aj. 30. Pasi u realizua fjala e Allahut xh. sh. edhe kryetari i shtetit politikani Enver Hoxha që nga ajo kohë e mprehu më mirë shpatën për situatën. Ai çdo ditë që vinte e forconte akoma më shumë diktaturën. Me fjalë të shkurtuara unë themi se Allahu xh. sh. e kishte vendosur Enver Hoxhën si një çekiç mbi këtë popull të pa bindur që kishte dalë nga rruga e Zotit xh. sh. Me kushtet e situatat e ndryshme që i krijoi Zoti xh. sh. këtij populli të pa bindur edhe Enveri me zgjuarsinë që ia dha Zoti xh. sh. bëri politikën e vet siç e dinte. Ai pastaj e forcojë shumë diktaturën për këtë popull që ai e kishte kuptuar mirë se ky popull nuk donte fe por dojte fre. Rinisë që u ngritë e para kundër fesë ai i vuri frenin për të mos e lënë të degjenerohej si në vendet tjera lindore komuniste e perendimore kapitaliste. Allahu xh. sh. në Kuran tregon se kur një populli i ka çuar të dërguar [për ti thirr në rrugën e drejtë] dhe njerëzit nuk janë bindur, atëherë Ai i ka dënuar ata me varfëri e mjerim për ti nënshtruar. Shihni ç'ka thuhet në suren En-Nam.

66-SHEMBJA E XHAMIAVE DHE KISHAVE NË SHQIPËRI ISHTE ME CAKTIMIN E ZOTIT TË MADHËRUSHËM = ALLAHUT XH. SH, PASI KY POPULLI NUK BËRI TOBE.

Allahu xh. sh thotë në Kuran: "Nuk ndodh as një fatkeqësi, në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë e shënuar para se të ngjajë ajo...S. Hadid. aj. 22. Çdo gjë para se të ndodhi është në dijen e Allahut xh. sh. dhe ai vendos për çdo gjë. Allahu xh. sh. i ka paralajmëru- ar në Kuranë besimtarët kështu: 'Nëse i bën shok Allahut veprat tuaja [të mira] janë të asgjësuar-të pa pranushme dhe ti [o njeri] do të jeshë prej të humburve." S. Zumer. ajeti. 65. Pejgamberi a. s. me dijen që ka marrë prej Allahut xh. sh. në një hadithë ka thënë; Në fundin e botës një popull i vogël do ti prishi faltoret e Zotit xh. sh. " Vërtetë xhamijat e kishat u shembën në Shqipëri nga duart e këtij populli me dëshirën e shumicës pamvarësishtë se qysh dhe përse.

Çdo gjë vjen nga Zoti xh. sh. por shkaktarë janë njerëzit. As gjë nuk ndodh në botë pa dëshirën e vendimin e Allahut xh. sh. Ai e bëri realitet fjalën e vet që pati paralajmëruar nëpërmjet muxhedides Aishe rahmetullahi alejha. që në vitin 1955 për dënimin e madh

pikëllues të këtij populli në këtë vend. Pas shëmbjes së xhamiave Allahu xh. sh. i tregojë muxhedides Aishe si do ta lexoni më poshtë se me lajmin që i kishte dhënë profetit Muhamed a. s. se ymetit të tij ia kishte bërë tokën xhami e kishte patur qëllimin pikërisht për këtë popull dhe për këtë vend. Pasi populli Shqiptarë e kundërshtoi lajmin për të bërë tobe, atëherë me caktimin e Allahut xh. sh. iu ndalua këtij populli me ligjë nga qeveria e drejta e lirisë së besimit fetarë. Kjo gjë nuk kishte ndodhur asnjë herë në asnjë vend të botës. I vetmi vend në botë Shqipëria u bë shtetë ateistë=shtet pa fe=shtet kundër Zotit xh. sh. Estagfirullah. Kjo gjë është me domethënje për njerëzit që mendojnë e kuptojnë. Allahu xh. sh. thotë në Kuranë: "Dënimin iu jep Allahu atyre që nuk mendohen". S. Junus. Nga kjo kuptohet qartë se Zoti xh. sh. nuk ishte i kënaqur prej veprimeve të këtij populli, që nuk pranoi të bënte tobe=të pendohej. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte; Menjëherë pasi në Shqipëri rinia filloi ti shembi xhamiat atëherë Allahu xh. sh. për të më hequr mua dëshprimin e madh që kishim në shpirt më sqaroi duke më ngushulluar me këto fjalë kështu: "Hiqe atë dëshpërim të madh që ke në shpirt. Duhet ta dish ti [Aishe] se asnjë gjë e vogël nuk ndodh në asnjë vëndë, pa urdhërin tim e jo më kjo gjë e madhe. Namazin e atyre njerëzve që më bëjnë shokë mua, Un nuk e dua. Namazin atyre njerëzve Un nuk jua kam pranuar fare se ju a kam shkruar [ju a kam regjistruar] për putat=idhujt. Nëse ata të thonë ty se ne nuk kemi idhuj [nuk i falemi idhujve] si popujt e më parshëm të pa ditur; ti thuaju atyre; idhuj jeni bërë ju për njëri tjetrin se thërrësnë njëri tjetrin me atë emër që thërrisni Allahun në gjuhën tuaj. Thuaju ti Aishe atyre [njerëzve] që duan të më falen Mua, mos të kërkojnë minare e çallma porë ta falin namazin atje ku ti zë koha e tij duke mos më bërë mua shokë e ortakë. I kam thënë të dashurit tim Muhamedit a. s, thuaj ymeti tëndë se, ia kam ba tokën xhamijë. Këtë fjalë Un nuk ia thash atij për atë kohë kur ishte ai por ia thashë për këtë kohë [për njerëzit e shekullit të njëzetë] e për këtë vend".

Nga këto fjalë kuptohet se minaret dhe çallmat janë sende të pëlqyeshme që simbolizojnë në dukjen e jashtëme objektin fetarë

Islam dhe dijetarët e fesë që ti kuptojnë njerzit. Këta nuk kanë shumë rëndësi por rëndësi ka namazi që duhet të kryhet brenda rregullave e duke mos i bërë shokë Allahut xh. sh. se nëse i bën shokë Allahut xh. sh. Ai nuk ta pranon fare namazin. Minaret dhe çallmat janë shpikje të mira të cilat janë bërë pas Pejgamberit a. s. porë nuk vlejnë xhamijat në një vend që njerëzit e atij vendi nuk shkojnë të falen në to. E nuk kanë vlerë çallmat në kokat e ulemave =dijetarëve të fesë kur ata nga mëndja janë vetë të errsuar duke i bërë shok Allahut xh. sh. Vërtet i vetmi vend në botë që u shembën xhamiat e kishat dhe iu ndalua popullit me ligj nga qeverija e drejta e lirisë së besimit e ushtrimit të fesë ishte Shqipëria. I vetmi vend në botë Shqipëria e shpalli veten shtet ateist = shtet kundër Zotit xh.sh.=shtet pa fe. Në fakt lufta kundër fesë indirekt kishte filluar para vitit 1967. Por pasi Partia e Punës e shpalli Shqipërinë shtet i pa fe, ajo pas vitit 1987 nxori ligjin për denim me burgë 3 deri në 5 vjet për ata njerëz që bënin axhitacion e propogandë fetare=që i flisnin popullit për dijen e praktikimin e fesë. Qeveria shqiptare e bëri ligj për ta dënuar me burgim atë njeri që merrej me propogandë fetare. Rregjimi komunist në Shqipëri i ruhej shumë organizimit të ndonjë revolte popullore anti qeveritare nën maskën e fesë nga klerikët e kryesisht nga kleri kristian katolik të cilët ishin të shkolluar për fe e politikë, kryesisht në Itali e vendet tjera perendimore. Ata ishin të organizuar mir dhe kishin ndikim të madh në popullatën kristiane katolike. Ndërsa kleri kristian ortodoks ishte në përgjithësi i pa shkolluar, i pa organizuar dhe nuk kishte shumë ndikim tek popullsiakristjane ortodokse. Kurse dijetarët e fesë muslimane nuk paraqisnin rrezik se ata nuk i lidhte ana fetare me shtetet fqinje të Shqipërisë. Gjithashtu ata nuk kishin ndikim të fuqishëm tek popullsia muslimane. Në fenë Islame nuk ka kler. Pushtetin dhe të drejtën për nxjerrjen e ligjeve për dënime e falje, për ti futur njerzit në fe ose për ti përjashtuar nga feja, për ti futur në xhenet ose në xhehenem, për veprat që bëjnë njerzit, të drejtën për këta e ka vetëm Zoti xh. sh. e askush tjetër.

Dijetarët musliman në fenë Islame janë vetëm mësuesat e ligjit të Zotit xh. sh. Ata nuk kanë kompetenca ti fusin njerzit në fe e as ti nxjerrin nga feja. Ndërsa në fenë kristiane po të mallkoi prifti je i dënuar edhe nga Zoti dhe ndryshe po ta fali gjynahun ose mëkatin prifti ta ka falur edhe Zoti xh. sh. Po të ç'kishëroi = po të përjashtoi prifti nga feja atëher

të ka përshtuar edhe Zoti xh. sh. thonë ata. Zoti xh. sh. thotë në Kuran për besimtarët e thjeshtë jahudij [çifutë] dhe kristianë kështu : “Ata i konsideruan për zota veç Zotit [xh. sh. sh.] priftat jahudij të tyre ruhbanët, murgjit priftat kristianë të tyre dhe Mesihun [Isain] të birin e Merjemes. . . ”. S.Tobe. Aj. 31. Megjithatë ligji i shtetit shqiptar ishte për të gjithë njësoj për sa i përkiste propogandës fetare dhe ushtrimit të riteve fetare nga populli. Pas ndalimit me ligjë të fesë disa njerëz besimtar të pakët që më shumë nga këta ishin në fshatra mundoheshin që ti kryenin fshehur disa urdhëresa fetare siç ishin, namazi, agjërimi dhe e bëra synet fëmijët meshkuj për muslimanët dhe pagzimi për kristjanët. Këto veprime ishin tepër të zorshme dhe me pasoja të këqia dhe të rënda nga qeveria pasi u ndalu me ligjë nga shteti mbajtja e fesë.

Disa besimtar të pakët ashtu si ishin, e sa ishin vazhdonin ta mbanin fenë me shumë sakrifica. Një pjesë e vogël nga këta besimtar e falnin namazin dhe agjëronin ramazanin ndërsa, pjesa tjetër prej tyre agjëronin vetëm Ramazanin. Besimtarët ndiqeshin nga organet e shtetit për shkakun e fesë. si pas dijes, biografisë e arsimit që kishin. Disa nga njerzit e shtetit që ishin komunistë e aktivistë të organizatave të rinisë e frontit që ishin pa mend në kokë e pa besim në zemrat e tyre, duke përfutur nga ligji e propaganda e madhe anti fetare ngaj rregjimi komunistë i ndiqni besimtarët me qëllim që të afroreshin sa më shumë me rregjimin komunist. Më të shumtët nga këta ishin në fshatra se të tilla ishin dhe rrethanat atje në lidhje me fenë, njerzit dhe terrenin. Të azdisur ur nga joshja me ndonjë detyrë e përfitim të vogël dhe nga ledha timet e premtimet gënjeshtro që ju bënte rregjimi komunistët këta mendje lehtë hidheshin në sulm si të tërbuar në luftë kundër fesë e besimtarëve.

Këto qyqarë nuk e kuptonin se me ideologjinë ateiste të çifutit, dexhalit Karl Marksi po shkatronin moralin e popullit se feja e mbron moralin. Kur ata i zbulonin besimtarët se agjëronin Ramazanin jua prishni agjërimin dhe i nxirrnin para kolektivit të punës dhe i demaskonin duke i ofenduar e akuzuar për injoranta e të prapa mbetur dhe si njerëz të pa bindur ndaj ligjit të shtetit. Në ditën e festës së Bajramit komunistët më aktivistë prej organizatës së rinisë shkonin në shtëpiat e atyre njerëzve që i dinin ose

që dyshonin se kanë mbajtur Ramazan për ti kontrolluar nëse kanë gatuar mish ose ëmbëlsirë në festën e Bajramit. Nëse ata gjenin tenxheren ose vorbën e mishit duke zier në zjarr, ata merrnin hirin e zjarrit e ia hidhnin në tenxheren e mishit që mos ta hanin familjarët atë, pasi këtë mish ose ëmbëlsirë ata e kishin bërë për të festuar Bajramin të cilat festa fetare rregjimi komunist në Shqipëri i kishte ndaluar me ligjë. Ja pra deri këtu kishte arritur egërsia e luftës kundër fesë prej rregjimit komunist në Shqipëri. Por siç e përmenda më sipër dënimi më i madh ishte për ata njerëz që bënin propogandë fetare=përhapnin mësimet e fesë me gojë ose kryenin ritet fetare. E e aq më keq duke qenë të grupuar.

Ato pak besimtar që agjëronin muajin e Ramazanit kur ngriheshin për të ngrënë syfyryn i mbyllnin me çarçafë dritaret e shtëpivët që mos të dukej drita se i shihnin spiunët se janë ngritur nga gjumi me ngrënë syfyr dhe shkonin e i raportonin në organet shtetërore përkatëse. Nëse i zbulonin i demaskonin para popullit [para kolektivit punojës] në qendrat e punës dhe i largonin nga ajo punë ku ishin dhe i transferonin në një vendë pune tjetër të largët, nëse ishin njerëz puntorë e fshatarë të thjeshtë. Nëse ishin njerëz të ditur merrni masa më të rënda duke i larguar nga puna e duke i kërcënuar dhe me burgim ose internim. Akoma më e vështirë ishte çështja e synetllëkut të fëmijëve.

Besimtarët me sakrificë tepër të mëdhaja e në kushte shumë të vështira mundoheshin që djemtë e nipërit e tyre ti bënin synet sidomos më shumë në fshatra. Berberët që bënin fëmijët synet vinin me frik të madhe fshehur dhe me njerëz të njohur por nganjëher ata zbuloheshin dhe i raportonin tek organet e shtetit bashkë me prindërit e fëmijëve. Më kujtohet kur unë ishim 16 vjeç, në fshatin tim Farkë spiunët zbuluan se rreth 10 familje për një herë i kishin bërë fëmijët e tyre synet. Berberi që i kishte bërë synet fëmijët kishte qenë Reshit Tarja nga qyteti i Tiranës i cili ishte dënuar me burgim disa here, nga 3 muaj, 6 muaj e deri 1 vit burg për këtë veprim. Berberi Reshit Tarja dhe një i quajtur berber Ismail Fejza nga Dibra që banonte në Tiranë ishin nga më të njohurit që kishin ra në syun e organeve shtetërore për veprimin e synetllëkut që ishte i ndaluar me ligj nga shteti dhe ishin dënuar me burg për këtë veprim disa herë.

E që e kishim fjalën tek berberi i vjetër Reshit Tarja, ai u zbulua se kishte bërë fëmijët synet në fshatin Farkë dhe Daias të Tiranës.

Berber Reshitin bashkë me gjithë prindët e fëmijëve i nxorën para popullit të fshatit e i dënuan për veprimin që kishin bërë. Berber Reshitin e dënuan përsëri me burg si përsëritës të fajit edhe se fshatarët thanë në mbledhje se berberi nuk ka faj se e kemi thirr ne atë. Ndërsa prindët e fëmijëve të bërë synet i transferuan për disa kohë nga qëndrat e punës ku ishin në fshatin e tyre duke i dënuar të shkonin e të punonin në fshatrat tjerë 3 orë rrugë largë me këmbë vajtje e ardhje nga fshati tyre. Pas ndalimit të fesë me ligjë nga shteti iu ndalua prindëve vënja e emrave musliman fëmijëve të tyre. Punojsit e gjendjeve civile i bënë agjitacion dhe presion psikik prindëve musliman se gjoja emrat musliman janë emra të vjetër. Ndërsa emrat e kaurëve Robert, Edmond, Albert e Artur, Natasha, Rajmonda, Silvana e Rovena i lejonin në gjendjen civile të ia ngjisje fëmijëve se sipas disa nënpunësve të gjendjeve civile këto emra që morëm si shembull, ishin emra të rij thoshin ata, ndërsa emrat muslimanë ishin të vjetër. Edhe emrat kristianë të vjetër ishin por për fëmijët e muslimanëve quheshin të rinjë. Punojësit e gjendjeve civile thoshin se për këtë gjë kishin urdhër nga komitetet ekzekutiv të rrethit. Kundër emrave musliman filloi të bëhet propogandë e fortë duke i injoruar nëpërmjet teatrit, estradës ose shfaqjeve humoristike. Personazhet negative në këto shfaqje i paraqisnin me emra musliman për ti përqeshur. Ndërsa muslimanët që i kishin në dorë punët e shtetit heshtnin. Syt ju kishin vën lesh e mendja ju ishte bërë përshesh. Edhe sot në Demokraci kjo gjë po ndodh përsëri. Disa muslimanë, ca nga ana fetare e ca nga ana politike filluan në atë kohë tu vinin fëmive të tyre emrin Enver që mos ti kundërshtonin në gjendjen civile. Njerzit që mbanin këtë emër u shtuan shumë në Shqipëri. Por edhe për këtë emër ishte problem tjetër. Nëse e kishte mbiemrin Hoxha nuk të lenin të ia ngjisje fëmijës emrin Enver. Shkaku ishte se disa nënpunës hileqar në dikasteret e ndryshme shtetërore që e paraqisnin veten mbrojtës të kultit të Enver Hoxhës thoshin: Ka vetëm një Enver Hoxha e jo dy. Më kujtohet një rast në fshatin Mullet të Tiranës kështu. Një djali atje ia kishin vënë prindët emrin Enver dhe mbiemrin ai e kishte Hoxha. Kjo gjë si duket i kishte rrëshqitur pa dashje punojësit të gjendjes civile të fshatit i cili rregjistronte emrat e fëmive të lindur. Fëmia me emrin Enver Hoxha u rrit dhe hyri në shkollë. Një ditë shkojnë për kontroll në atë shkollë një grup inspektorësh nga ministria e arsimit. Kur ata dëgjojnë e shohin në regjistrin e klasës emrin

Enver Hoxha dhe notatat e tij të këqia në mësim, me një herë e urdhërojnë mësuesin që djalin mos ta thërrasin më Enver Hoxha por ta thërrasin Enver Rexhëhoxha duke i vënë para mbiemrit Hoxha emrin e babait të tij Rexhep që e thirrnin për shkurtim Rexhë. E ashtu u bë. Komunistët nuk pranorin të kishte adash me emër e mbiemër të njëjtë Enver Hoxha të cilin ata e kishin bërë idhull. Po ju o besimtar të Zotit xh. sh. e si pranoni ti bëni adash Zotit xh. sh. duke i thirrur njerzit Zoti ose Zotni filan dhe pranoni që të tjerët tu thërrasin juve ashtu duke u bërë adashë me Zotin xh. sh. i cili është Krijuesi i Gjithësisë ? A nuk mendoni ? A nuk kuptoni se çfarë krimi po bëni ndaj Zotit xh. sh. ? Adash quhen dy vetë me të njëjtin emër. Zoti xh. sh. thotë në Kuran se Ai nuk ka adash. Ai thotë: “ Hel ta-lemu lehu semij jen ? ” = A din ti për mua ndonjë emnak = adash ? “. S. Merjem. aj. 65. Pendohuni pra të gjithë o besimtarë. Mos ia vëni veshin se çka ju thonë juve për çështjen e kufrit, çështjen e shirkut të madh me gojë disa saze të politikës e altoparlanda të politikanëve të cilët e quajnë veten hoxhallarë të ditur shumë sot në kohën e demokracisë. Ata folin sipas politikës e jo sipas ligjit të Zotit xh. sh. Megjithatë kjo botë është bota e sprovës. Secili sot është i lirë të veprojë si të dojë. Ky dënim i madh që e zuri popullin në Shqipëri ishte me caktimin e Allahut xh. sh. se populli shqiptar nuk pranojë ta njsojë Allahun xh. sh. në gjuhën e tij dhe të bënte tobe të vërtetë=Pendesë të sinqertë.

Fjalët që ju thoshte besimtarvet muhedidja Aishe rahmetullahi alejha se Allahu xh. sh. nuk ja u ka pranuar namazin atyre njerëzve që kanë bërë shirk mbasi ishin lajmëruar për këtë gjë, ishin pa dyshim lajm prej Allahut xh. sh. Vërtet Allahu xh. sh. i ka paralajmëruar muslimanët në Kuran kështu: “Nëse i bëni shokë Allahut, veprat tuaja [o besimtar] janë të asgjësuar dhe do të jeni prej të humburve”. S. Zumer. Ajeti 65. Dihet nga Kurani se kush janë të humburit. Të humburit që e kanë humbur besimin e drejtë ndaj Zotit xh. sh. janë kriistianët të cilët besojnë njeriun për Zot dhe Zotin njeri. Estagfirullah, estagfirullah. Ata besojnë në trinitet [i ati, i biri dhe shpirti i shenjtë dhe u falen e ju lutën idhujve=ikonave duke ju përgjyruar atyre. Kjo është e vërtetë e dukshme por megjithatë kjo është punë e tyre. Allahu xh. sh. në Kuran thotë: “Lekum dijnukum ve lije din”. = Ata kanë fenë e tyre dhe ju keni fenë tuaj. Ndërsa për ata njerëz të pakët besimtarë siçë thash më sipër që e donin fenë e që u dëshpëruan shumë pas shembjes së xhamiave se mendojshin për çështjen e namazit,

murshidja Aishe thoshte se Allahu xh. sh. më njoftoi mua kështu: "Thuaju atyre që duan të më falen Mua; Mos të kërkojnë çallma e minare por ta falin namazin ku ti zëj koha e tij duke mos më vënë mua shok e ortak. I kam thënë të dashurit tim Muhamedit thuaj ymetit tënd se ia kam ba xhamij faqen e tokës. Këtë fjalë Un nuk ia thash atij për atë kohë kur ishte ai por për këtë kohë e për këtë vend [për njerzit e këtij vendi]. "Në Kuranë thuhet; " Ai [Allahu] di më së miri për ju [për veprimet tuaja o njerëz] edhe para se tu krijoi..." Sure Nexhmë. Ajeti. 32.

Allahu xh. sh. thotë në Kuran : " Kur duam të shkatërrojmë ndonjë vend [kur populli i atij vendi është bërë i meritushëm për tu shkatërruar] i urdhërojmë=i çojmë lajm parisë së atij vendi [dijetarëve të fesë, nëpunësve të shtetit [pushtetarëve] dhe tregëtarëve] që të vin në rrugë të drejtë e kur ata kundërshtojnë, atëherë zbatohet dënimi i merituar kundër tyre dhe i shkatërrojmë krejtësishtë. [nga çdo pikëpamje]. "S. Isra = kapitulli Mrekullija Ajeti. 16.

67-POPULLI SHQIPTARË NË PËRGJITHËSI FILLOJË TË ANKOHEJ GJITHNJË E MË SHUMË NGA VUAJTJET PREJ RREGJIMIT KOMUNIST, PAS LUFTËS KUNDËR FESË.

Një ditë un duke biseduar me muxhediden Aishe rahmetullahi alejha, doli fjala tekë vujtjet e popullit tonë, që ankoheshin prej punës së rëndë në kushte tepër të këqia e normave të punës të ngritura shumë në bujqësi, industri e ndërtim, lodhjes së madhe e pagesës së pakët, varfëris së madhe e diktaturës së fortë që ishte në atë kohë në vëndin tonë, se për një fjalë të vogël që tregoje pa kënaqësi ndaj qeverisë=rregjimit në fuqi, të futnin menjëherë në burg. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha; Një popull i dalë nga rruga e Zotit xh. sh. i prishur moralishtë-i pa bindur e arrogant meriton një mbret ose kryetarë shteti të ashpër, me ligje të forta. Me të vërtetë Allahu xh. sh. thotë në Kuranë; "Disa mizorë]zullumqar=[të pa bindur e kokë fortë] i shtypim me disa të tjerë, [të ashpër=më kokë fortë. "S. En-nam aj 159. Muxhedidja Aishe thoshte: "Sipas kokës Allahu xh. sh. ia ka vënë qeleshen këtij populli ". Mirpo mua që isha i persekutuar me pa të drejtë se më kishin cilsuar kulak, duke qënë i dëshpruar pasi nuk kishim të drejta të barabarta si

nënshtetasit e tjerë të këtij vëndi i thash murshides=prijëses fetare muxhedides Aishe rahmetullahi alejha kështu; Po përse kështu o Aishe? A kaq të këqisë qën kemi ne si popull të gjithë ? Ne një pjesë nga të persekutuarit e të pa persekutuarit jemi besimtar siç je dhe ti që je e persekutuar por je besimtare dhe e caktuar me shërbim prej Allahut xh. sh. Muxhedidja Aishe më tha këtë ajet nga Kurani; "Kur e godet e keqëja një vend, nuk godet vetëm ata të këqitë [që bëjnë keqë]" S. Enfalë. Ti po deshe more djalë më tha ajo, qëndro në fe tamam siç duhet deri në vdekje se ata besimtarë që kan vuajtur dhe vuajnë pa të drejtë nga rregjimi komunist dhe çdo lloj rregjimi tjetër qoftë ai, atyre iu pastrohen gjynahet dhe inshallah shkojnë në xhennet pasi në këtë botë kanë vuajtur dhe pejgamberët."

Vërtetë Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Për ato njerëz të cilëve kur iu bie ndonjë katastrofë durojnë dhe thonë: Ne jemi të Allahut dhe tek Ai kthehemi e lutemi (për ata njerëz) zbresin lavdrime të bukura dhe mëshirë e madhe prej anës së Allahut dhe ato janë të vetmit (njerëz) që kan gjetur rrugën e drejtë (janë udhëzuar drejtë)." S. Bekare. aj 159. Un i pa thelluar në atë kohë në diturinë e fesë dhe i vrarë shpirtërisht pasi isha i vuajtur shumë nga që isha i persekutuar 40 vjetë duke punuar her në buqësi, her në minjer e her në ndërtim dhe i raskapitur nga shëndeti i trupit i thash murshides Aishe rahmetullahi alejha këto fjalë: Ndoshta gjynahet tona e të gjithë njerëzve të pafajshëm në këtë vend ia ngarkon Allahu xh. sh. atyre, Partisë së Punës me në krye Enver Hoxhën që ishte kryetari i shtetit.

Por murshidja Aishe rahmetullahi alejha asnjëher nuk fliste sipas qejfit me inate me gjithëse ajo kishte vuajtur shumë prej rregjimit komunist, që në krye ishte Enver Hoxha. Ajo më tha: Dëgjo këtu: "Çdo njeri do të përgjigjet për fajet e veta dhe askush për fajet e tjetrit. Si populli ashtu dhe drejtuesat e shtetit në krye Enver Hoxhën do të merren një ditë në pyetje nga Allahu xh. sh. secili për punët e veta. Allahu xh. sh. i gjykon drejt punët e njerzvet. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Ata [njerëzit] të gjithë do ti marrim në pyetje [para përgjegjesis]...S. Hixher. aj. 92, 93. Vërtet ishte gjë e çudiçme tek ne. Mijra njerëz nga ky popull, u vranë gjatë luftës dhe pas saj, mijra të tjerë u pushkatuan dhe vdiqën në burgje e internime nga diktatura komuniste. Populli nga

zori i hutuar filloi të spiunoj e të luftoj me çdo lloj mënyre njëri tjetrin se gjoja të mbijetonte por përkundrazi e shkatërroi veten më keq. Populli jonë e pësoi tamam si dikurë populli i hazreti Musait alejhi selam të cilët vranë njëri tjetrin.

Dikur në Irakun e sotëm, kishte qënë një mbret i egër-shumë diktator që e quanin Haxhaxh. Aty në atë vend në atë kohë kishte qënë dhe dijetari i shquar murshidi Hasan Basriu rametullahi alejh. Populli i atij vendi në atë kohë shkonte për tu ankuar tek i dijetari i devotshëm Hasan Basriu për vuajtjet që ju shkaktonte atyre diktatori Haxhaxhi. Ndërsa dijetari Hasan Basriu iu thoshte atyre; Nëse ju jeni të urtë e të mir, nuk ka se përse tu mendojë juve Haxhaxhi. Ndërsa Enver Hoxha kishte dhe një gjë tjetër, se ai të rrihte dhe nuk të lente as me qa.

Edhe pasi vdiq Enveri përsëri popullit nuk iu ndan vuajtjet. Edhe ditët e pushimit javorë u bënë ditë pune vullnetare me goditje të përqëndruar dhe quheshin ditët e Enverit. Me një fjalë Enveri iku nga kjo botë por shkopi e tij e la pas derës. Ky ishte pra në përgjithësi në atë kohë gazepi=dënimi i madhë e pikëllus prej Allahut xh. sh. që paralajmëroi muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha në vitin 1955. Kurani thotë; "Allahu nuk e drejton për së mbari popullin mizorë=zullumqarë me moral të prishur e i pa bindur". S. Ali Imran. aj. 86. Shkaku ishte ideologjia e politika fashiste e komuniste e shpikur nga çifutët dhe e vënë në zbatim nga kristianët e cila gjeti vëndë=gjeti tokë pjellore tek popujt e prishur që e kishin lënë rrugën e Zotit xh. sh. sikurse ishte populli jonë që edhe pasi i tërhoqi Zoti xh. sh. vërejtje ai nuk u bind. Populli në përgjithësi vuan, por më shumë vuanin puntorët dhe fshatarët. Populli u ankonte shumë por pa zë se në diktaturë nuk të lenin të ankohesh. Të rrihnin e nuk të lenin për të qa. Njerëzit në përgjithësi filluan të ankoheshin nga rënja ekonomike dhe forcimi akoma më shumë i diktaturës që filloi të ushtronte mbi këtë popull regjimi komunist pas ndalimit të liris së fesë. Një nga veprimet e shumta të gabuara me të cilën e shkatërroi veten populli Shqiptar ishin martesat me dashuri që filloi të bëjë brezi i ri, pa u bazuar në ligjin fetarë dhe pa dëshirën e prindëve. Ata u bazuan vetëm në pamjen e jashtëme të njëri tjetrit, vajza e djali, në biografinë politike e interesin ekonomik. Kështu që shumë familje e humbën identitetin fetarë dhe fisnikrinë familjare. Pejgamberi a.s. ka thënë: Vajzën lakmojnë për ta marrë për

këto 3 gjëra; 1 Për bukurinë e saj. 2. Ekonomija e pozita shoqërore, 3- Imani=besimi=besnikëria edukata fetare. Juve o musliman zgjidhni atë vajzë që është besimtare se për ndryshe keni vepruar gabim dhe do ta shkatërroni veten tuaj. " Gjithashtu Pejgamberi a. s. ka thënë për prindët kështu; "Kush e marton vajzën e tij ke i ligu ke njeriu i keqë e ka ndarë atë nga farefisi i vet. " Si pasojë e largimit të popullit nga feja, të ritë filluan të bëjnë martesë me dashuri musliman e kristian me njëri tjetrin. Këta martesë ishin në kundërshtim me ligjin fetar dhe pa dëshirën e prindëve të secilës palë por në veçanti të prindëve musliman se muslimanes nuk i lejohet kurr në asnjë mënyrë ta marrë burrin kristjan se kristjanët nuk e besojnë profetsinë e Muhamedit a. s. Ndërsa djemtë musliman filluan të martohen me kaurre=me vajza krstiane, me Vasilikën, Sofikën e Marikën duke i lënë beqare Sabrijen, Bedrijen e Nurijen. E kush do ti merrte pastaj vajzat muslimane ? Kjo ishte tradhëti e djemvet musliman ndaj vajzave muslimane. Kjo solli tekë shumë besimtar musliman ftohjen dhe ndarjen e fëmijëve me prindët e fisin e tyre. Si pasojë e largimit nga feja u prish dhe harmonia familjare në Shqipëri ndërmjet prindëve dhe fëmijëve. Të parët që filluan të bëjnë këto martesë ishin studentët. Shumë studentë që studionin në shtetet komuniste në Rusi, Bullgari, Hungari, Çeki, Rumani e Sërbe nuk e morën parasysh as anën kombëtare. Ata u martuan me gra të huja. Por Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë: " O ju njerëz ju bëmë [ju ndam] në kombe e fise që të dallohi nga njëri tjetri..." S. Huxhurat. Aj.13. Më vonë Enver Hoxha të shumtat nga këto gra i quajti spiune=agjente të shërbimeve të huja në Shqipëri. Disa nga këto i burgosi e disa tjera i internoi bashkë me burrat e tyre. Ndërsa Enveri martesën e tij e bëri të bazuar në anën kombëtare e fetare. Populli i vuajtur e i mërzhitur rrinin me shpresë e flasin fshehurazi se hë sot e hë nesër do të shembet Partia e Punës. Disa që ishin të besushëm i thoshin muxhedides Aishe se insha-llah së shpejti do të shembet kjo Parti. Murshidja Aishe ju thoshte se këtë gjë nuk e di askush veç Zotit xh. sh. Muxhedidja Aishe thoshte se Allahu xh. sh. që din se ç'far mendojnë e flasin njerëzit më solli mua këtë lajmë kështu: " Thuaju ti atyre: Kjo parti do të jetë [do të sundojë] deri në ditën e kijametit". Është fjala që bir pas biri, nip pas nipi, mik pas miku e shok pas shoku do të jenë në pushtet komunistët dhe miqtë e tyre. Ata do ta kenë në dorë qeverinë dhe pasurinë. Këtë të vërtetë të paralajmruar prej Allahut xh .sh. nëpërmjet muxhedides Aishe, të mençurit duhet ta pranojnë. Vërtet u ndërrua sistemi ekonomik e politik në Shqipëri por klasa sunduese nuk u ndërrua. Në pushtet mbetën komunistët, fëmijët e shokët e tyre. Komunistët në pushtet e ndryshuan vet me marifet sistemin politik

dhe ekomomik prej rrethanave të ndryshme gjeopolitike. Prej ndryshimeve të mëdhaja politike që ndodhën në botë si pasojë e dështimit të rendit socialist. Kështu që komunistët kudo në vendet ish komuniste e ndryshuan sistemin socialistë; në ekonomi tregu=në ekonomi private dhe pranuan pluralizmin. Të vërtetën tha Nexhmije Hoxha kur vdiq bashkëshorti i sajë Enver Hoxha e cila foli këto fjalë; “Enveri vdiq por partinë e la të pastër”. Enveri megjith se ishte musliman nga origjina, ai nuk bëri dallime në popull përse i përket veshjes me pushtet të njerëzve =me detyra të larta shtetore e rroga të mira duke u nisur nga prejardhja tyre fetare.

Është fakt i pa kundërshtueshëm që kristianët ortodoks në regjimin komunist, kan jetuar më mir se muslimanët dhe katolikët dhe kjo gjë për disa arsye por më kryesoret ishin dy arsye. E para gjë ishte se komunizmin e përqufuan në përgjithsi kristianët ortodoks me vendin më të madh, Rusinë. E dyta ishte se kristinët ortodoks ishin më të lidhur me njëri tjetrin dhe u treguan më të etur për arsimim. Në vitin 2009 dëgjova se Frrok Çupi që është kristian katolik kërkoi të bëjë aleancë me ateistin Fatos Nano i krahut ortodoks dhe shokët e tij të majtë. Frroku në një emision televiziv tha se Evropa po gabon që përkrah mazhorancën me Sali Berishën në krye.

U çudita nga fjalët që tha Frroku se un medoja që ai është një katolik i fortë në fenë e tij. Nuk kishte përse ta përkrahi ai të majtën që është kundër fesë. Ai si besimtar katolik që është dhe të tjerë si ai e bashkë me ata që i përkasin besimit musliman nuk duhet ta përkrahin të majtën që dihet se është krejtësishtë ateiste. Kurani thotë: “ Dhe i sqaruam atij [njeriut] për dy rrugët. E ai [njeriu] nuk u hodh në të përpjetën [nuk ndoqi rrugën e vështirë...e cila; është lirimi i një skllavi [ose të burgosuri pa të drejtë], Ose dhënja ushqimit në kohën kur mbretëron urija; Ndonjë jetimi që është i afërt ose ndonjë të varfëri që e ka molisur varfërija; Dhe pastaj të bëhej prej atyre që besuan [Zotin xh. sh. dhe botën tjetër pas vdekjes], që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë. Të tillë [njerëzish janë të anës së djatht. Ndërsa ata që nuk besuan argumentet tona janë të majtës. Kundër tyre është zjarri i mbyllur. [E keqëja nga se presin dhe xhehenemi në botën tjetër.’ ‘S. Beled.aj. 10.... 20. Pra ata që nuk i besojnë argumentet e Allahut xh. sh. janë të majtë. Kurani na tregon se pasi të shëmbet kjo botë, njerëzit në

Ahiret=në botën e përtejme-në jetën tjetër pas vdekjes do të ndahen në tre grupime. Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë: "Dhe ju do të ndaheni në tre grupe...të djathtit...të majtit...të përparmit [ata që janë në ballë]. të cilët janë të dalluar Ata janë më të afruarit [tek Zoti xh. sh.] Janë në xhenete të begatëshme. [ata janë] Shumë prej [popujve] të hershëm. E janë pak prej [popujve] të më vonshëm. S. Vakia. aj. 7, ...14. Evropën nuk e ka lënë mendja që të vinjë Moska dyqindë kilometra afër përballë Romës. Kështu i ka rregulluar Zoti xh. sh. këto punë more Frrok. Prandaj ju themi; O njerëz; kthehuni në rrugën e Zotit xh. sh. që Ai t'ju mëshirojë. Nuk keni çfarë të provoni më tani se i provuat të gjitha teoritë ideologjike e politike; Nacionalizmin me Laicizmin, Fashizmin me liberalizmin, Komunizmin me diktaturën, dhe së fundi Demokracinë me liri pa kufi. Nuk lat gjë o njerëz pa bërë e pa provuar në faqen e tokës.

Kthehuni tani në rrugën e Zotit xh. sh. Kurani thotë: " Allahu është Ai që e pranon pendimin e njerëzve të vet. "S. Tobe. aj. 104. Allahu xh. sh. në Kuranë thotë; "Mos ndiqni rrugë të tjera që ju devijojnë nga rruga e Tij [rruga e Allahut]. "S. En-nam. aj. 153. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se un kam marrë këtë lajm prej Allahut të madhruar kështu: "Cili njeri është regjistruar komunist [këtu në tokë], ai njeri tekë Allahu xh. sh. është regjistruar qafir=muhus i Zotit xh. sh.]"'. Kjo gjë është e vërtet se kushti i parë i bërjes komunist ishte mohimi i Zotit xh. sh. Estagfirullah, estagfirullah.

Shumica u bënë komuniste me dëshirën e tyre nga interesi i dynjasë. Ata i gënjeu teorija e dexhalëve çifutë, Marksit, Engelsit e Leninit. Vetëm ndonjë njeri i rrallë ka qenë i detyruar nga halli të bëhet komunist. Për atë njeri që është bërë komunist i detyruar nga halli, Allahu xh. sh. në Kuranë thotë : "Dënim të madh i jep Allahu atij [njeriu] që pas besimit të tij e mohon Allahun, me përjshitim të atij që detyrohet [për të thënë ashtu] por zemra e ti është e bindur plotsisht me besim Ata [njerëz që e kanë mohuar me dëshirën e tyre] e kanë hidhëruar Allahun dhe ata kan një dënim të madh". Sure Nahl. ajeti 106.

Nuk ka dyshim dhe dihet mir që pothuaj se çdo njeri është bërë komunist me dëshirën e tij se nuk të detyronte kush me imponim. Gjithashtu qafira kishte edhe nga ata njerëz që nuk ishin të regjistruar komunistë me dokument por që nuk besonin

në ekzistencën e Zotit xh. sh. dhe botës tjetër pas vdekjes. Edhe sot në këtë kohë shohim e dëgjojmë se ka shumë ateista nga të dyja klasat, ish komunistë e jo komunistë të përkrahur nga regjimi komunist e të persekutuar, të vuajturit e të ledhatuar nga ai regjim. Allahu xh. sh. i drejtoftë të gjithë për së mbari ata që janë gjallë për nderimin e Profetit Muhamed a. s. që është dërguar mëshirë për botërat. Për atë njeri që do të pendohet Allahu xh. sh. po deshi ia pranon pendimin. Kurani thotë: "Allahu ia pranon pendimin atij që do se Allahu i di të fshehtat dhe me urtësi zgjidh çdo çështje". Po deshi Allahu xh. sh. e ç'rregjistron nga regjistri i të pafeve atë që do.

Kurani thotë; "Allahu shlyen [heq nga ajo evidencë] çka të dojë dhe forcon [çka të dojë]. Vetëm te Ai është baza e librit [rregjistrin të shënimeve = Levhi Mahfudhi.]" S. Rad. aj. 39.

Ndërsa ata njerëz që akoma nuk pendohen, nuk duan ti përulen Zotit xh. sh. por akoma përsëri duan komunizmin ose ateizmin e çdo ngjyre tjetër politike, këta njerëz Allahu i madhrushëm xh. sh. do ti dënojë rëndë. Ata janë armiq të Zotit xh. sh. të vetes, të familjes dhe gjithë shoqërisë. Tani o popull këthehuni te feja e Zotit xh. sh. me gjithëse vonë por jo hiç fare. Ejani në rrugën e Zotit xh. sh. ejani në tobe=ejani në pendim që Allahu xh. sh. tu mëshiroi juve e ti bëjë dhe pushtetarët të mirë, të drejtë dhe të mëshirshëm për ju ose ti heqë ata e ti zëvendësojë me të tjerë të mirë. Thuhet një fjalë e urtë popullore kështu: Ena pikon atë send që ka brënda. Kurani thotë: "Allahu nuk e ndryshon gjëndjen e një populli për derisa ata të ndryshojnë veten e tyre". S. Rad. aj. 11. Un shkruesi i librit themi : Allahu i madhëruar e drejtoftë për së mbari tani e prapa popullin Shqiptar dhe gjithë popujt e tjerë, gjithë ymetin e Muamedid a. s.

68- ISH UDHËHEQËSI DHE KRYETAR I SHTETIT SHQIPTAR ENVER HOXHA KA FOLUR SHKURTIMISHTË PËR HISTORIKUN E FESË ISLAME.

Sikurse shihet në librin "Shënime Për Lindjen e Mesme" në kapitullin: "E kaluara e lavdishme e popujve nuk mund të mohohet e as të lihet në harresë" Enver Hoxha dinte në mënyrë të përgjithshme edhe nga feja Islame. Në këtë libër ai shkruan: Në kohët e lira, që në rininë time shkollore kam lexuar vepra të autorëve dhe studiuesëve të ndershëm mbi kulturën

e madhe e të lashtë arabe dhe persiane [iraniene] dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e shkencës dhe kulturës botërore.

Pëveç të tjerave kjo më ka ngjallur ndjenja të një respekti të thellë për këta popuj. "Traditat kulturore" [fetare e kombëtare] të popujve arabë i kanë dhënë njerëzimit shkencëtarë të famshëm në fusha të ndryshme të dijes, pionjerë të mjekësisë, të astronomisë, të matematikës, filozofisë e poetë të mëdhenj që as nuk mund të mohohen e as të lihen në harresë. Me aq sa më lejon koha dhe vendi [situatë politike dhe detyra që kam] po rradhis këtu disa nga mendimet që kam për qytetërimin arab dhe persian dhe fenë Islame që e ka burimin në këtë rajon.

Qytetimi arab [qytetimi Islam] lindi në shekullin e 13-të ose shekullin e 6-të sipas hixhretit [kalendarit të muslimanvet]. Kjo kulturë e madhe u bë feneri që ndriste natën e errët të mesjetës të shkatërrimeve që kishin sjellë perandoria Romake, invadimet barbare, kontët e markezët që nuk dinin të përdornin penën por veç se shpatën. Priftërinjtë dhe murgjit më të mësuar në atë kohë rrinin mbyllur nëpër manastire e kuvende, në vende të ngritura e të izoluara, dhe mendonin më shumë për botën tjetër se për këtë botë. Kurse në Bagdad në brigjet e lumejve Tigër dhe Eufrat pallatet ishin të veshur me mure mermeri. Qytetet ishin me kanalizime e ujësjellës me rrugë të shtruara me kalldrëm që ndriqoheshin me drita. Kishte banjo publike e biblioteka kombëtare me qindra mijë vëllime e zhvilloheshin konkurse.

Ndërsa dy qëndrat e mëdhaja Bagdadi e Kordova, njëra në lindje e tjetra në perëndim, ndërtonin=zhvillonin, mbronin diturinë dhe shkencat. Ndihtonin ngritjen e shkollave, librarive e shoqatave shkencore, në një kohë kurë shumica e kontëve dhe markezëve [nëpunësve] të Sharlamanit, mbretit të Francës Karli i madh, nuk dinin të shkruanin as emrin e tyre. Shkencëtarët e mëdhenj të popujve arabë dhe persianë ishin; Muhamed Ibni Zekeria-Al Rraziu, mjek, kimist dhe filozof Persian. Al-Hazis mjek i cili përcaktoi diagnozën e gushës "goitre" dhe diktoi operacionin e lithotomisë duke përcaktuar se ku duhet bërë prerja që përdoret dhe sot. Vdiq në vitin 903. Al-Hazin Ebu Muhamed Ibni Al-Hajtam. Lindi në Basra në 965 dhe vdiq në Kajro më 1039 si dhe mjekë e dijetar të tjerë si Avicena = Ebu Ali Sinaja, Averroes=Muhamed Ibni Ruzhdi, fizikan, mjek, astranom, matematicien, e filozof me tërë kuptimin e fjalës. Imami Gazaliu-Ebu Hamid Muhamed Gazaliu. Gazaliu vdiq

në vitin 1111. Gazaliu ishte profesor në medresen = Universitetin Nizamije të Bagdadit. Gazaliu ngriti lartë besimin [imanin] mbi mendjen. Ai tha se kërkimet filozofike në kuadrin e teologjisë muslimane duhet të bëheshin sipas Kuranit që vlerësohej si shkencë mbi shkencat = si dituri mbi dituritë. Ligjit të Kuranit nuk mund ti bëhet asnjë ndryshim dhe përmirësim. Ai është përsosja vetë, është fjala e Allahut xh. sh. Feja merr për sipër përsosjen e njerëzimit. Tezat e Gazaliut janë: Islami është absolutizmi, hyjnor dhe racional. [Islami është kryesisht pa dyshim për të gjithë, i mundshëm, i arsyeshëm se ai ka ardhur nga Zoti. xh. sh.] Zoti xh. sh. me plotëfuqishmërinë e Tij ka krijuar botën. Të jesh apo të mos jesh varet nga vullneti i Tij. Kurse në kapitullin: “Islami është një fe monoteiste” universale [fe që njeh e na mëson se është një Zot i vetëm për të gjithë kombet] Ai shkruajti për përhapjen e fesë Islame aq sa ia lejonte politika e detyra që kishte. Në këtë libër ai thotë: Parimet e vendosura nga profeti Muhamed a. s. vazhdojnë gjatë shekujve të frymzojnë mendimin filozofik të muslimanëve. Edhe sot në botën muslimane politika nuk mund të konceptohet jashtë fesë “.Është fjala që politika te ka bazën tek feja.

Nga kjo thënie kuptohet se çdo ideologji që është kundër fesë është e pa pranushme për besimtarët musliman. Nga fjalët që ka shkruar, kuptohet qartë se Enver Hoxha kishte nostalgji për fenë Islame. Ai e donte në shpirt atë por ideologjia ateiste që ishte në fuqi, ishte kundër besimit në Zotin xh. sh. e kundër fevet në përgjithësi. Nga kjo gjë për arsye politike Enver Hoxha detyrohej të dukej nga halli si ateist [njeri i pa fe=njeri që nuk e besonte Zotin xh. sh.] por ishte e kundërta. Ai me shpirtë e besonte. Allahu xh. sh. në Kuran thotë : “Dënim të madh i jep Allahu atij njeriu që e mohon Allahun, me përjashtim të atij që detyrohet por zemra e tij është e bindur plotësisht për besim por fjala është për atë [njeri] që i hap gjoksin mohimit [mos besimit]. S. Nahl. Ajeti. 106. Unë mendoj se Enver Hoxha me këto shkrime që bëri në fundin e jetës së tij, i njoftoi njerzit se ai nuk kishte qenë kundër fesë dhe se ai ishte krenar që i përkiste besimit musliman, i përkiste fesë Islame.

69- ENVER HOXHA NUK E BESOI QË MURSHIDJA AISHE ISHTE E DËRGUAR PREJ ALLAHUT XH. SH. ME LAJMIN E THIRRJES SË POPULLIT PËR TOBE.

Muxhedidja Aishe që Zoti xh. sh. e lartësoftë në gradat e xhenetit një ditë më tregoi se kishte parë në ëndërr këtë pjesë filmike mes gjumit dhe zgjimit në kohën e namazit të sabahut. “Ajo tha sot në kohën e sabahit më shfaqti Allahu xh. sh. në dukje Enver Hoxhën që ishte në një ndërtesë dhe po qëndronte pranë një dritarje të vogël në formën e një sporteli dhe shihej fytyra e gjoksi i tij deri nga mezi i trupit. Përballë tij në anën tjetër të rrugës isha unë thoshte Aisheja. Neve na ndante vetëm rruga nga njëri tjetri, se në distancë ishim afër. Un po e shikoja Enverin dhe ai më shikonte mua. Në atë çast dikush i tha Enverit : “Kjo gruaja është ajo Aisheja e cila thotë se un jam e dërguar nga Zoti që ta thërras popullin në tobe istigfar”.

Enveri nxori pak kokën nga sporteli e tha: Ajo gënjen, nuk është e dërguar. Në atë çast që ai e tha këtë fjalë atij iu nxi fytyra. Unë në atë moment, thoshte muxhedidja Aishe, i thashë Enverit kështu: “Nëse unë gënjej, ti do të rrish aty ku je, e nëse unë nuk gënjej ti nuk do të rrish më aty. ” Me kaq u ndërpre nga meleku pjesa filmike e njoftimit nga Allahu xh. sh. me anë të ëndrrës tregonte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Aisheja me dijen që kishte marrë prej Allahut xh. sh, me ilham=me inspirim e komentonte ëndrrën kështu: Pamja e Enverit në sportel nga mesi e sipër thoshte Aisheja është fotografia e Enverit në kornizë e vendosur në në zyrat e shtetit.

Ndërsa ai dikushi që i foli atij për mua thoshte ajo, ishte kup-timi se Enver Hoxha është njoftuar nga organet e partisë e të sig-urimit të shtetit se një grua e quajtur Aishe e thërret popullin në tobe=në pendesë dhe thotë se jam e dërguar nga Zoti xh. sh, me këtë shërbim por Enveri thoshte ajo nuk e besoi që unë jam me shërbim e urdhëruar direktë nga Allahu xh. sh. Ndërsa për pro-gramin e tobes=për kushtet e saj Enveri nuk ishte në kundërshtim se fundja në ndihmë të politikës së tij ishin pothuajse të gjitha kushtet për tobe. Ndërsa unë shkruasi i librit mendojë se rruga që i ndante ata mes tyre; Aishen që ishte një murshide = udhëheqëse

për popullin për në rrugën e Zotit xh. sh. në moralin e shëndosh të mbështetur tek feja dhe Enver Hoxhën që ishte një politikan i afirmuar udhëheqës i popullit në anë politike. Rruga që i ndante këto sipas shfaqëjes filmike që tregonte muxhedidja Aishe ishte kufiri ndarës në mes edukimit moralo=fetar për të cilin përpiquej muxhedidja Aishe edukimin moral kombëtar me politikë komuniste që ndiqte Enver Hoxha duke sheqerosur atë me idealizëm.

Enver Hoxha ngrente lartë flamurin e komunizmit duke e vënë në shtizën e nacionalizmit ndërsa murshidja Aishe që ishte e dërguar nga Allahu xh. sh. me shërbimin e thirrjes së popullit të saj në tobe, përpiquej që të ngrente lart flamurin e fesë me bazë toben që në krye të sajë ishte teuhidi=njisimi i Zotit të madhërushëm në çdo gjuhë.

Enver Hoxha i thoshte popullit : “Atdheu mbi gjitha.” Ndërsa murshidja Aishe thoshte : Dashurija për Zotin xh.sh. duhet të jetë mbi çdo gjë se pa fe, pa besim tekë Zoti xh.sh. nuk mund të ketë moral e as dashuri e besnikëri askush ndaj atdheut. Thirrja që i bënte popullit murshidja Aishe ishte fetare e kombëtare. Murshidja Aishe thoshte shumë her me të qeshur këto fjalë: Un murshidja = udhëzuesja e këtij shekulli në anën fetare dhe Enveri udhëheqësi i këtij shteti në anën politike, kemi halle. Edhe ai [Enveri] edhe un thoshte muxhedidja Aishe, me popullin e kemi punën. Nga këto fjalë që thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha, un shkruesi i librit mendoj se Allahu xh. sh. i shtroi dy alternative popullit në Shqipëri që ai të zgjidhte njërën nga të dyjat: Ose fenë ose frenë [ose kulaçin ose kërbacën]. Un thoshte murshidja Aishe i themi popullit ecni këndejdërsa Enveri ju thotë jo andej; ejani këndeje nga ju them un.” Këto fjalë mendoj un kan këtë kuptimin: Aisheja i thoshte popullit kthelhuni me fytyrën e gjoksin nga e mbara dhe ecni përpara, kurse Enveri me politikën e tij që luante i thoshte indirekt: Ecni përpara por mbrapësh, ktheni kurrizin nga e mbare e jo fytyrën. E si mundet të eci njeriu i shkretë mbrapësh ? Ai nuk shikon pastaj ku shkel e ku bie. Un them se shumë ligje të shtetit shqiptar nën udhëheqëjen e Enver Hoxhës kishin bazë fetare.

Përshembull: 1- Ai njeri që vriste, vritej, 2, Pedofilija dënohej 5 deri në 12 vjet burg. 3-Vjedhja, rrahja, akuzimi, përdhunimi, bixhozi e tjera e tjera dënoheshin me burg ata njerëz që i punonin. Njerzit pa gjykim këto dënime i quanin dhe i quajn diktaturë. Ndërsa ligji fetar =sheriati Islam vjedhsin e dënon me prerjen e dorës, pedofilin ose homoseksulin e dënon me vdekje. Prishsit e nderit [imoralin e imoralen] që janë të martuar i dënon me vdekje, ndërsa të pa martuarit i dënon me rrahje mes popullit me 100 kamxhkë. Vrasësin e dënon me vdekje. Pijenezin e dënon me rrahje 70 deri 80 kamxhikë . E tjera.

Atëher armiqtë e fesë do të thonë për sheriatin Islam se ai është supër diktaturë. Por e drejta është se fajtorët për veprat e këqia duhet dënohen rëndë që populli të jetoj në paq e qetësi. Për ndryshe vjen shkatërimi nga çdo anë Kurani thotë: "Kush nuk gjykon sipas asaj që solli Allahu, nuk janë besimtar". Kushtetuta më e plotë është Kurani dhe ligji më i përsosur është Islami=ligji i tij sheriati. Por nuk mund të gjenë zbatim nga populli me dëshirë ligjet e fesë nëse njerzit nuk janë besimtarë dhe nuk janë besimtar të sinqertë ata njerëz që nuk i zbatojnë ligjet e Zotit xh. sh. Besimi pa vepra është besim pa vlerë. Dje ishte ndryshe por pa rezultat dhe sot në sistemin demokratik është ndryshe por përsiri pa rezultat. Sot në vëndin tonë dhe kudo në botë nuk bëhet më propogandë direct kundër Zotit xh.sh. por kundër ligjeve të Tij, që njerëzit mos ti zbatojnë në jetën e tyre të përditëshme por nëse ata duan që ta besojnë Zotin xh .sh. nga ana teorike, le ta besojnë. Dhe që e kishim fjalën tek muxhedidja Aishe në lidhje .me Enver Hoxhën, në fakt si murshidja Aishe të cilën e kishte dërguar Allahut xh. sh. me shërbimn, udhëqëse për në rrugën e fesë, ashtu dhe Enverin që e kishte lënë udhëheqës politik i shteti, ishin në këtë vend të dy me pëlqimin e caktimin e Allahut xh.sh. dhe të dy këta e kishin punën me popullin, por secili në rrugën e tij.

Por dihet se njerëzit lumturohen nëse i binden Zotit xh. sh. dhe jo kur e lënë rrugën e Tij. Për ndryshe Ai i krijon situatat që sipas kokës tu vihet njerëzve qeleshja. Kurani thotë: "Allahu nuk i jep udhëzim [nuk e drejton për së mbari] popullin zullumqar". S. Ali Imran. aj. 86. Besimtarët duhet ta kenë të qartë se të fituar janë ata njerëz që besojnë Zotin xh. sh. e veprojnë siç thotë Ai. Ndërsa Enveri mendonte se çështja e Tobes ishte e kurdisur nga hileqarët. Por n ë fakt thirrja për tobe që i bënte popullit murshidja Aishe rahmetullahi alejha ishte pa dyshim, urdhër prej Allahut xh.sh. Ndërsa përgjigjësja që unë i dhash Enverit thoshte murshidja Aishe ka këtë kuptim: Nëse un do të isha gënjeshtarë =rrenacake siç më akuzoi Enveri mua, figura e tij nuk do të binte poshtë kurr në Shqipëri. Por un nuk gënjej. Vërtetë jam e dërguar prej Allahut xh. sh. me shërbim të posaçëm për të thirr popullin në Tobe. Por me që këtë gjë Enver Hoxha nuk e beson, atëherë figura e tij do të bjeri poshtë tha murshidja Aishe rahmetullahi alejha e nuk është e mundur të ngrihet më lartë=nuk mund të rehabilitohet. Këto fjalë murshidja Aishe i tha në kohën kur Enver Hoxha ishte në kulmin e forcës së tij politike pas vitit 1961. Me të vërtet mbas tridhjetë vjetësh të shfaqjes nga Allahu xh. sh. figura e Enver Hoxhës u rrëzua. Allahu xh. sh. e bëri realitet ëndërrën qi i

shfaqi murshides Aishe rahmetullahi alejha. Si pas dijes që ka marr murshidja Aishe prej Allahut xh. sh. un shkruesi i librit mendoj se figura e Enver Hoxhës nuk mund të rehabilitohet më në Shqipëri. Dëshën apo nuk deshën njerëzit, kjo gjë që ndodhi ishte e vendosur nga Allahu xh. sh. Ai është krijuesi i situatave në çdo vend të botës. Kurani thotë: "Allahu është Ai që i udhëheq çështjet nga qielli në tokë." Shkakut është se ai nuk e faktoi urdhëresën e Allahut xh. sh. për tobe por vetëm e pranojë në heshtje si një gjë jo të keqe për rregjimin që ishte. Nëse dashamirsit e tij në një anë tentojnë që ta ngrejnë lartë = ta rehabilitojnë figurën e tij me qëllim lavdije dhe në anën tjetër armiqtë e tij tentojnë që ta ngrejnë lartë figurën e tij me qëllim djallëzije, un mendoj se për të dy palët kjo gjë do të jetë një bombë që do t'ju pëlcasë në dorë. Arsya është se Enver Hoxha nuk e besoi që lajmi për të bërë populli tobe ishte direkt prej Zotit xh. sh. dhe nuk ishte i shpikur nga njeriu nga njeriu. Çdo gjë është me rrisht=me fat nga Zoti xh. sh. Enveri nuk e pati rrisht=nuk e pati fat që ta pranonte e ta faktonte këtë gjë. Nëse Enver Hoxha do ta pranonte të paktën 5 vjeçarim e fundit të jetës së tij lajmin e Zotit xh. sh. për tobe, fi gura e tij nuk do të binte poshtë se do të merrte një kuptim e drejtim tjetër puna e tij. Gjithashtu dhe mentaliteti në popull do të ishte ndryshe për të se ai do ta shkarkonte barrën e tij duke e pastruar në këtë mënyr veten se ai nuk kishte qenë inisiatori i luftës kundër fesë në Shqipëri. Me këtë veprim ai do ta lante veten. Duke u bazuar në njofimin që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe, un shkruesi i librit mendoj se figura e Enver Hoxhës duhet të qëndrojë kështu siç është tani, as më shumë e as më pak. Politika që ia imponuan situatat e ndryshme atij, ishte një politikë e pamvarur, as me perëndimin e as me lindjen. Un shkruesi këtij libri themi se; Jo vetëm figura ose emri i Enverit dhe i Ahmed Zogut por çdo llojë figure tjetër që mund të vinjë në Shqipëri, do të bjeri poshtë më vonë. Këtu në Shqipëri rrin i hapur një pus i thellë që në të bien brënda gjithë kryetarët e shtetit se këtu politika është mbi fenë. Figura ose emri i atij njeriu që nuk do të bjerë poshtë, do të jetë vetëm emri i atij njeriu që do të ngrej lart emrin dhe lavdinë e Zotit të madhëruar; do të ngrej lart moralen mbi imoralen, të vërtetën mbi gënjeshtren, të drejtën mbi të shtrembëtën, fenë mbi ateizmin.

Do të jetë inshallah ai burrë shteti që do ta përkrah forcimin e fesë duke e veçuar e ngritur lart e më lart në radhë të pare emrin e Allahut xh. sh. që ne në gjuhën tonë shqipe i themi Zoti xh. sh. Ai njeri që do ta largoi popullin nga adhurimi i njerëzve e do ta çojë në adhurimin e Zotit xh. sh, duke i mbledhur të gjithë rreth fjalës La ilahe il lallah = Nuk ka tjetër Zot veç një Zoti=veç Allahut xh. sh. dhe do ta luftojë të keqen dhe të këqitë. Allahu xh. sh- Zoti i madhërshëm do ta ruaj e do ta ngrejë atë njeri në shkallë të lart.

Pra të gjithë sa jeni o popull shqiptar dhe ju o njerëz besimtar kudo që jeni në botë kthehuni në rrugën e Allahut = rrugën e Zoti xh. sh. Të gjithë bëni Tobe=pendohuni për të këqiat që keni bërë në të kaluarën. Largohuni nga të ligat. Më mirë vonë se hiç fare. Ejani në rrugën e Zotit xh. sh. duke zbatuar një për një kushtet e Tobes që të shpëtoni veten dhe fëmijët tuaj nga të këqiat. Thirrja për Tobe=për pendesë është thirrja e fundit që Allahu xh. sh. i bëri njerzimit nëpërmjet muxhedides Aishe rahmetullahi alejha pak kohë para krijimit=shkatërrimit të botës.

70- NJOFTIME TË NDRYSHME QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE PËR VETITË E ENVER HOXHËS DHE GRUAS SË TIJ NEXHMIJE HOXHA.

Për njoftimet ose lajmet e fshehta që ju jep Allahu xh. sh. me mënyra të ndryshme njerëzve të dërguar me shërbim na tregon Kurani famëlartë. Allahu xh. sh. i ka thënë Pejgamberit a. s. kështu: “Këto janë nga lajmet e fshehta që po ti shpallim ty [o Muhamed].” S. Ali Imran. aj. 44. Gjithashtu kemi si argument edhe njoftimin që mori prej Allahut xh. sh. në atë kohë Pejgamberi a. s. për ish mbretin e Abisinisë Nexhashiun se ai ishte kristjan por ishte njeri i matur, njeri i zgjuar e i sinqertë e që më vonë do tu bënte musliman dhe vërtetë ai vdiq musliman. Këtë gjë e tregon Historia Islame. Pejgamberi a. s. ju tha shokëve të tij që të emigrojnë në mbretërin e tij në Abisini për ti shpëtuar ndjekjeve të idhujtarëve arabë në atë kohë. Kur vdiq Nexhashiu e lajmëroi Allahu xh. sh. Pejgamberin për këtë gjë. Pejgamberi a. s. lajmëroi sehabet=shokët e tij për ti falur namazin e xhenazes Nexhashiut nga nga larg [nga Hixhazi që sot Arabia Saudite] duke mos qenë xhenazja aty.

Disa vite pas ndalimit të fesë me ligjë nga shteti Shqiptar, murshidja Aishe tha se një natë Allahu xh. sh. më shfaqti në ëndërr këtë pamje kështu: “Unë thoshte ajo sikur isha duke ecur në një koridor të gjatë dhe aty në koridor takova Enver Hoxhën dhe gruan e tij Nexhmijen. Unë gjoja kishim shkuar për një ankesë, thoshte murshidja Aishe, dhe për respekt desha ti puthë dorën Enverit por ai nuk pranoi. Ai e tërhoqi dorën edhe tha tre herë fjalën: Jo, jo, jo në asnjë mënyrë. Unë thoshte muxhedidja Aishe i thashë se ti e meriton pasi je i pari i shtetit dhe je i moshuar por ai nuk pranoi. Pastaj unë, tha Aisheja, i paraqita ankesën time Enverit për hallin që kishim duke iu përgjëruar atij. Ai pa u shqetësuar aspak për hallin tim më tha: Sipas ligjit le ta shikojnë ata që janë caktuar për këtë punë. Pasi ai nuk ma mbaroi mua hallin që kishim, unë thoshte murshidja Aishe iu drejtova Nexhmije Hoxhës dhe i mora dorën për të ia puthur asaj. Ndërsa ajo pranoi. Un me lotë ndërsy ia para-shtrova asaj hallin që gjoja kishim dhe pastaj i thashë asajë: Ne jemi patriote bashkë se jemi të dyja dibrane. Ajo i mbushi sytë me lot. Me anën e kësajë shfaqjeje të shkurtër filmike thoshte Aisheja më bëri Allahu xh. sh. me dije me inspirim në shpirtë këto hollësira në lidhje me Enver dhe Nexhmije Hoxhën; E para gjë ishte se Enver Hoxha nuk tërhoq prapa për mëshirë pasi vendoste për një çështje. Ai nuk donte të dinte për asgjë tjetër para ligjit që ishte. Ai thoshte muxhedidja Aishe, i kontrollon me shumë kujdes e imtësi punët e shtetit. Ai do që ti sqarojë e ti kontrollojë mirë dhe deri në fund çështjet si do që të jenë ato.

Ndërsa e dyta gjë që Allahu xh. sh. më dha mua të kuptoja thoshte murshidja Aishe ishte kjo gjë; Sado që populli brohorit, këndon e shkruan për Enver Hoxhën por atij nuk i bëjnë përshtypje fare këto gjëra. Në njërin vesh i hynë lëvdatat e njerëzve dhe në veshin tjetër i dalin. Sipas dijes që më jep Allahu xh.sh. mua, Ai nuk ishte fudull = mendjemadh. Muxhedidja Aishe thoshte se ai nuk e do në shpirt krenarin por thjeshtësinë. Ndërsa për Nexhmijen, murshidja Aishe tha se Allahu xh. sh. më dha për të kuptuar se ajo është e ndjeshme në shpirt; është e mëshirshme. Me kaq Aisheja e ndërpreu fjalën ndërsa un i thash asaj: Çfar kuptimi ka që Nexhmija pranoi që t’ia puthje ti dorën asaj? Muxhedidja Aishe i uli sytë në tokë dhe tha: Gratë kështu i ka krijuar Zoti xh. sh. Ata nuk janë si burrat në shumë veti. Sigurisht që është në natyrën e grave që e pëlqejnë më

shumë se burrat anën temporal=paraqitjen e jashtme dhe me kaq u mbyllë kjo bisedë mes neve. Allahu xh. sh. në Kuranë thotë : “Asnjë popull nuk mund ta shpejtoi afatin e vet dhe as ta shtyjë për më vonë.” S.Hixhër. Ajeti 5.

71-POLITIKA KOMUNISTE NË SHQIPËRI ISHTE NDRYSHE NGA AJO E VËNDEVE TJERA KOMUNISTE.

Vërtet komunizmi dhe ateizmi i çdo ngjyre tjetër ideologjike e politike është pjellë e çifutëve=jehudive. Komunizmi është një ide politike kundër fesë=kundër besimit në Zotin xh. sh, dhe të botës tjetër pas vdekjes. Si i tillë, ai kështu është pa moral. Kjo gjë dihet tani mire se u pa dhe po shihet sot në praktikë. Por një gjë ishte çuditshme në regjimin komunist në Shqipëri. Megjithëse regjimi komunist në pushtet ishte shumë i egër por nuk ishte kundër traditave të mira morale të popullit tonë por përkundrazi i mbronte ata. Ndërsa në vendet tjera ish komuniste, përse i përkiste moralit të popullit, puna qëndronte ndryshe. Rinia atje u degjenerua krejtësisht. Mjetet e propagandës: Televizioni, gazetat e revistat në vendet tjera ish komuniste përhapshin imoralitetin. Rinia atje mori rrugën e drogës, vjedhjes, rrugaçerisë, bixhozit, alkolizmit, kuvërisë, krimit e tjera vese të liga. U shkatrrua pothuajse krejtësishtë celula e shoqërisë, familja dhe mbinë një mijë e një të këqia. Ndërsa Enver Hoxha me sa u shikua u mundua aqë sa i kishte mundësitë si pas rrethanave politike e gjeografike që kishte Shqipëria që komunizmit ti jepte ngjyra të forta kombëtare tradicionale që burimin e kishin tekë feja. Ai nuk lejoi që rinia të degjenerohej, ashtu si në vendet e tjera lindore komuniste dhe perendimore kapitaliste. Ishte e pa mundur që Shqipëria të krahasohej me ata. Këtë gjë ai e arriti se ishte i gjallë brezi i vjetër i shqiptarëve i cili në përgjithësi, nuk ishte i zhveshur nga besimi e morali fetarë e kryesisht nga turpi e nderi. Sigurishtë kjo gjë ishte pasojë e ndikimit të kulturës fetare Islame tekë shumica e popullsisë në vendin tonë. Kështu që Enver Hoxha u mundua që komunizmin ta vishte me rroben tradicionale kombëtare. Pamvarësisht nga ideologjia politike ateiste që ishte në fuqi në Shqipëri.

Por është e pa mundur të qëndrojë një popull në rregull, kur njerëzit në atë popull janë të prishur shpirtërisht, pasi iu mungon morali i shëndoshë, iu mungon ushqimi i shpirtit feja. Kjo gjë u pa qartë në vendin tonë porsa kaloi brezi i vjetër dhe erdhi brezi i ri [njeriu i ri] i cili u edukua me ateizëm me iden anti fetare]. Për këtë gjë ka fakte të dukshme që jetuam dhe po i jetojmë sot. Deri sa ishte në njërën anë “të peshores” brezi i vjetër i edukuar me kulturën fetare, me vetitë e bukura si besën, ndershmërinë, besnikërinë e mëshirën dhe turpin; dhe në krahun tjetër të peshores ligjet e forta të shtetit për ata njerëz që ishin pa besim e pa kulturë, punët shkuan disi mirë. Këto dy gjëra ndikuan që morali në popull mos të binte në nivelin xerro. U bë njëfar ballancimi për ruajtjen e vlerave morale të popullit tone, që ai mos të binte poshtë siç ka rënë sot. Por menjëherë porsa u rrit brezi i ri, i pa edukuar me vlerat fetare por përkundrazi i helmuar me ateizëm i cili ishte opjum për popullin atëher u shkatërrua deri në themel morali i popullit shqiptar duke u shembur një e nga një tullat e ndërtesës morale të cilën e patën ndërtuar me djersë e gjak të parët e këtij populli që për këtë gjë shumë prej tyre dhan edhe jetën. Po të bazoheni në fakte, kjo është e vërteta. Ky është mendimi im. Por si do që të pranohet, të gjitha u provun nga populli jonë. Un sot në rregjimin demokratik çuditem me dy grupe njerëzish. Çuditem me disa muslimanë të persekutuar që flasin e çirren nëpër medja të ndryshme kundër Enver Hoxhës si diktator por nuk e marrin në mbrojtje fenë Islame dhe çuditem me të krishterë si piktori Maks Velo ish i dënuari politik prej regjimit komunist dhe politikanët e sotëm Ben Blushi , Pirro Misha e tjerë të cilët nuk sulmojnë komunizmin, por sulmojnë fenë Islame nëpërmjet ish perandorisë së madhe Turke Osmane. Piktori i burgusur politik Maks Velo tha se Perandoria Turke me kulturën që solli këtu [në Shqipëri] na ka shpërfytëruar. Në realitet është e kundërta e asaj që thotë Maks Velo dhe të tjerë që flasin ose mendojnë si ai.

Sot nën maskën e zhvillimit e përparimit po poshtrohet femra duke u shpërfytëruar krejtësisht dhe si pasojë po shkatërrohet bërthama e shoqëris njerëzore familja. Femra në këtë kohë sot është këthyer në një kukëll vitrine vetëm për të kaluar kohën meshkujt, pasi nderi i saj sot po shitet si mall tregu kudo. Ndërsa feja Islame i jep femrës vendin e nderit që ajo meriton si nënë se

ky emër është emri më i dashur për njerëzit që janë normal nga mëndja. Nëna është edukatorja e brezit të ardhshëm që ka të bëjë me fatet e popullit në të ardhmen. Nëse femrës i hiqet detyra për të cilën e ka krijuar Allahu=Zoti madhrushëm, atëher nuk mund të ketë shoqëri të rregullt njerëzore, por një grumbull krijesash me pamje njerzish, por me veprime kafshësh e më keq se kafshët e egra e të mallkuara siç janë derrat. Sot po vërtetohet kjo gjë. Faktet po shihen çdo ditë kudo në çdo vend të botës. Nëse do të vazhdohet me këtë lloj edukimi e trajtimi që i bëhet gruas, e ardhmja e kombeve do të jetë disa her më e keqe. Gratë duhet të bëhen të vetëdijshme se nuk i ka krijuar Zoti xh. sh vetëm me qëllimin për të plotësuar tekat e meshkujve, por ata kan një mision të shenjtë në jetë, misionin e nënës, misionin e edukimit të të brezit të ri, të ardhmes së shoqërisë. Që ata të bëhen të vetëdijshme, duhet të mësohen e të edukohen me fe, të dijnë se çfar ka thënë Zoti xh. sh. për ata. Maks Velo në një emision në televizor u ankua duke thënë se: “Po ngrihen kudo në Shqipëri minaret e xhamijave që duken si rraketa. ”Ai e kishte fjalën se pas rënjes së komunizmit me ideologjinë ataiste mos po kalohet në ndërtimin e një shteti fetar me ngjyra Islamike. Un i them Maksit e shokëve të tij se sikur të ndodhte ashtu do të ishte gjëja më e mirë për gjithë popullin pa përjashtim se do të rregullohe-shin shumë gjëra, por kjo gjë sot është e pa mundur. E çfar shteti me ngjura fetare ka frikë Maks Velo kur qeveria shqiptare ka miratuar ligjin për lejimin e pederastisë që është gjëja më e ulët për njeriun. Martesat brenda një seksi=martesën e burrit me burrin është një veprim anti moral, anti njerzor dhe anti shtazorë. Pra është në kundërshtim me natyrën njerzore e kafshore. Ky ligj që ia kan si kusht Evropa kristiane katolike qeverisë shqiptare për pranimin në bashkimin evropian është i dënuar nga feja Islame dhe Kristiane. Ky ligj e të tjerë si ky që po iu imponohen sot prej dexhalave kudo, muslimanëve dhe kristianëve, janë ligje të nxjerra prej çifutëve. Nga ky ves i ulët kundër natyrës njerzore u shkatërrua dikur prej Zotit xh. sh. populli i profetit Lut a. s. Këtë gjë e tregon Kurani por edhe Bibla. E çfar shteti me ngjyra fetare Islame ka frikë Maks Velo e të tjerët që mendojnë si ai kur sot shteti shqiptar ditën e Shtunë e cila është dita e shejtë e javës për çifutët, dhe ditën e djelë që është ditë e shejtë për kristianët i ka bërë ditë pushimi, ndërsa ditën e Premte, ditën e shejtë për muslimanët që e kanë detyr muslimanët të falin namazin e xhumasë nuk e ka bërë qeverija ditë pushimi me gjithë se shumica e popullsis në Shqipëri=75 përqindë

janë muslimanë. Kjo gjë është padrejtësi për muslimanët. Unë i them Maks Velos e gjithë të tjerëve që mendojnë si ai, qofshin kristianë, çifutë e ateistë; le të rrijnë pa frikë për shtet me ngjyra fetare Islame se në Shipëri si në shumicën e vendeve të botës sot, është politika mbi fenë e jo feja mbi politikën. Në krye të institucioneve fetare Islame janë politikanët ose fëmijët e miqtë e tyre. Këta janë që e bëjnë sot dhe propogandën fetare në mjetet kryesore të propogandimit siç është televizori, radio dhe gazetat. Kjo gjë është pa dyshim e vërtetë dhe e themi që ta flenë mendjen e mos të rrinë me frikë Maks Velo dhe të tjerët si ai se gjoja Shqipëria mund të bëhet një shtet me ngjyra të forta Islame. Kjo gjë nuk ekziston. Por gjithashtu ia kujtoj Maks Velos dhe të tjerëve që mendojnë si ai; mos të rrinë me shpresë duke menduar se muslimanët shumë shpejtë do ta lënë fenë Islame e do të bëhen Kristianë ose Jehudij=[çifutë]. Kjo gjë nuk ka për të ndodhur kurrë. Na ka siguruar për këtë gjë me fjalën e tij vetë profeti ynë Muhamedi a. s. se muslimani nuk kthehet më mbrapa. Shqipëria është një kockë e fortë që ju mbetet në gurmazin e fytyrës që mundohen ta gëlltisnin.

Prandaj un them se populli Shqiptar dhe çdo popull tjetër që dëshiron të jetojë i lumtur duhet të kërket sa më shpejt tek feja=tek ligjet e Zotit xh. sh. duke bërë tobe [pendesë] për të këqiat e kaluara e nëse jo; atëherë Zoti xh. sh. do ti dënojë tani e prapa edhe më shumë njerzit se ata i provuan të gjitha Nacionalizmin, Fashizmin, Komunizmin e Demokracinë e përsëri nuk afrohen tek rruga e Zotit xh. Sh. tek feja e Tij. Ateizmi me çdo llojë ngjyre politike që të jetë, është armiku i fesë armiku i moralit të njerëzve dhe si i tillë ai është dhe armiku i kombit i traditave të mira kulturore të popullit tonë e të çdo populli tjetër që ka tradita të mira. Ata njerëz që nuk duan që populli të edukohet me moralin fetarë janë armiqtë e Zotit xh. sh. armiqtë e vetes, të familjes dhe mbar shoqërisë. Allahu xh. sh. ka për ti ndëshkuar rëndë ata bijë e bija të muslimanëve kudo në botë që sot nga pushteti dhe pasuria që që kanë në dorë e kanë tradhëtuar ose harruar fare fenë Islame, fenë të cilën e ndoqën dikur baballarët e gjyshllarët tanë për të cilën shumë prej tyre dhanë jetën për ta mbrojtur atë. Këta njerëz duhet ta kenë parasysh se Allahu xh. sh. i ka ndëshkuar rëndë tradhëtarët gjithmonë dhe këtu në këtë botë në çdo kohë e vendë.

Faktet janë të qarta e të shumta. Populli ynë thotë këtë fjalë; Zoti ta vonon, [dënimin] por nuk të harron. Ndërsa të krishterët sot po përpiqen me të gjitha fuqitë dhe mënyrat për forcimin e fesë së tyre. Në Shqipëri megjithëse shumica janë muslimanë, xhamijat kanë mbetur në harresë, dhe ata të pakta që janë, kanë mbetur pa mirëmbajtje dhe imamët=drejtusat e tyre nuk i paguan askush. Disa xhamia në fshatra janë të mbyllura përsëri sot se nuk shkojnë njerzit të falen në to. Sot edhe ata pak xhamia që ndërtohen aty këtu në disa qendra, po i fshehin nëpër skuta të errta që mos të duken, mos të bien shumë në sy, ndërsa kishat e kryqet vezullojnë kudo, në rrugët e në sheshet kryesore të qyteteve e fshatrave tona. Kjo e vërtetë shihet jo larg, por si shembull marrim bashkinë e Kamzës ku duket shumë qartë kjo që thashë. Xhaminë e kanë fshehur. Aty është e zorshme për atë njeri që shkon për të parën herë, që të gjejë xhaminë dhe rrugën për të hyrë në të.

Ndërsa kisha është vendosur në mes të qendrës së qytetit me popullsi muslimane me përjashtim të disa familjeve kristiane të ardhura tani. Gjithashtu sot në kryeqytetin tonë Tiranë njerëzit në shumë raste e falin namazin në shi e në borë pasi nuk kanë akoma një xhamij të madhe ndërsa kishat e mëdhaja qendrore=katedralet ortodokse e katolike janë ndërtuar në mes të kryeqytetit të vendit tonë me popullsi shtatëdhjetë e pesë përqind muslimanë. Mos ndërtimi i një xhamije të madhe nuk është për fajin e askujt përveçse disa bijëve dhe bijave të muslimanëve që i kanë punët e shtetit në dorë. Ku jeni ju o muslimanë, deri kur kështu?! Le të mendohen mirë bijtë e muslimanëve që kanë pushtetin dhe paran sot në dorë. Bota e di që ne jemi vendë me popullsi të shumtën muslimanë.

Këtë gjë e deklarojë dhe ish presidenti Amerikan Xhorxh Bush në një intervistë që ai dha me rastin e ardhjes së tij për vizitë në Shqipëri. Kështu që duhet ta kenë të qartë pushtetarët me origjinë muslimane se minarja e xhamisë nuk mund të futet në thes. Vëllezër besimtarë Allahu xh. sh. nuk ka nevojë për njerëzit por ata kanë për Të. Kurani thotë: "Allahu është mbrojtësi i fesë së Tij [i fesë fesë Islame]. Allahu xh. sh. thotë: "O ju që besuat [dikur] Kush largohet prej jush nga feja e vet [i bën dëm vetes], nuk ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull që Ai e do atë [popull] dhe ata e duan Atë [Allahun xh. sh.]; Ai ka për të sjellë një popull] që është modest e i butë ndaj besimtarëve por i ashpër dhe i fortë ndaj mohusave,

që lufton në rrugën e Allahut dhe nuk i friksohet kërcënimit të asnjë kërcënusi..." S. Maide. aj. 54.

Nëse ju o bij dhe bija muslimanësh nuk e doni fenë, Un thotë Allahu xh. sh. sjellë një popull tjetër që ata më duan mua dhe un i dua ata. Muslimanët duhet të jenë të parët për të bërë Tobe. Ata duhet ti rikthehen singërisht fesë së tyre Islame, që është feja e vërtetë e pranushme tek Allahu xh. sh. është feja e paqes, e moralit e pastërtisë e vlerave morale. Është dhe fe humane. Nëse muslimanët e duan veten, fëmijët dhe vëndin e tyre duhet të veprojnë kështu. Inshaallah shpejtë edhe kristianët do ta kuptojnë se nuk ka jetë të lumtur pa u futur në rrugën e Zotit xh.sh. Me dobësimin e muslimanëve bota sot ka humbur ekuilibrin e saj moral dhe politik. Jehuditë ose ndryshe çifutët si gjithmonë me aleatët e tyre të bindur ateistët, sot më shumë se kurrë, po bëjnë lloj lloje kurthesh e ngatërresash të ndryshme të mëdhaja ekonomike e morale kudo në botë për të shkatërruar nga çdo pikëpamje në radhë të parë besimtarët musliman por edhe kristianët që besojnë tek Zoti xh.sh. Kurani thotë: "Ata [çifutët] përpiqen për shkatërrime e ngatërresa në faqen e tokës." S.Maide. Kristianët e mençur të mendohen mir se nga ateizmi i çdo ngjyre politike që erdhi nga teoricienët çifutë në botë u bënë dy luftat botërore dhe përsëri si pasojë e ngatërresave prej tyre me teorinë politike "Liri Demokraci"=Liri pa Kufij=Liri pa Moral po vuajn sot popujt e botës përsëri në shumë pikëpamje. Allahu xh. sh. në Kuran thotë; Ata [Jahuditë=çifutët] përpiqen për shkatërrime në tokë, [por] Allahu nuk i do ngatërrestarët. "S. Maide. aj. 64. Kështu që un mendoj se me ngatërresat e çifutëve rraca e verdhë do ta shkatrojnë një ditë, shumë shpejt qytetërimin dekadentë e të korruptuar perendimorë. Kjo gjë mos të ju duket çudi, por këtë gjë e di vetëm Zoti i madhërushëm=Allahu xh. sh. Sovrani i Botrave i cili vepron si të dojë dhe kur të doi. Të shohim vendimin e Tij në të ardhmen. Jua kujtoj se Kurani thotë: "I madhërushëm=i plotëpushtetshëm është Ai [Allahu] që në dorën e fuqisë së Tij është i tërë sundimi dhe Ai ka fuqi mbi çdo send." S. Mulk=Kapitulli i Sundimit. Ajeti 1. Klasa e ateistëve të shkolluar për djallëzira=dexhalat e rafinuar e kanë në dorën e tyre sot ekonominë dhe pushtetin në çdo vend të botës. Kjo klasë politikanësh kudo nën maskën e lirisë e të drejtave të njeriut dhe propogandës kundër diktaturës po e shkatërron rininë me mjete e forma të ndryshme siç janë alkoli, bixhozi = lojrat e fatit, muzika e vall-

zimet në diskoteka e sheshe, filmat me skena krimesh, pornografisë vjedhesh e tjera dhe kështu i përdorin ata si mish për top kur të duan.

72-NJOFTIMI QË MORI NË ATË KOHË PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE PËR ISH MINISTRIN E MBROJTJES SË SHQIPËRISË BEQIR BALLUKU.

Sikurse u shikuan e dihen nga gjithë populli jonë ngjarjet të trishtuara ndodhën në Shqipëri gjatë luftës e pas sajë. Që pas vitit 1941 deri në vitin 1981 nuk patën të mbaruar grupet politike armiqsore ndaj njëri tjetrit brenda Partis Komuniste që më vonë u quajt Partia e Punës e Shqipërisë. Siç e përmenda më lart si pasoje e politikës u vranë u burgosën, u internuan e u persekutuan mijra njerëz.

Nga vija politike që ishte shumë e ashpër në rregjimin komunist dështonin për me qëndruar në këtë rrugë edhe ministrat e shtetit.

Ja çfarë tha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha në lidhje me ish ministrin e mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë Beqir Ballukun. Ajo tha se Allahu xh. sh. më njoftoi për të me anë të rrujasë=ëndrës kështu; Më shfaqti Allahu xh. sh. një kanal pak të gjërë e të thellë dhe në anë të tij rrinte në këmbë Beqir Balluku. Përtej kanalit në anë tjetër të tij ishin duke ndenjtur tre ushtarakë të huaj. Njëri nga këta ushtarakët i tha Beqirit, hajde hidhu=kaloje kanalën. Beqiri u hodh por ra brënda në kanal, nuk mundi ta kalonte atë. Njëri nga ata tre personat ushtarakë që ishin në anën tjetër të kanalit tha këtë fjalë turqisht në formë pyetje; Napollom shendi? = Po tani çfarë të bëjmë?

Me këtë fjalë turqisht, tha Aisheja, që unë e dija se çfarë do të thoshte në gjuhën shqipe, u ndërpre shfaqja filmike nga Allahu xh. sh. thoshte murshidja Aishe rahmet pastë. Ishte tamam koha për të fal namazin e sabas. U ngrita mora abdes dhe porsa fala namazin Allahu xh. sh. më dha dije me ilham=inspirim brenda në shpirt për domethënien e kësaj rrujaje=ëndrre se; "Beqir Balluku do të gabojë, pasi ai do të tentoi që të bëjë diçka kundër regjimit politik në fuqi, por ai do të dështojë, nuk do të ketë sukses." Me të vërtetë pasë 7-8 muajsh u vërtetua fjala që na tha muxhedidja Aishe neve dy a tre besimtarëve por rregjimi në fuqi nuk e tregoi qartë për arsye politike se me kë i kshte pasur lidhjet Beqir Balluku.

Prandaj nuk është e vërtetë fjala që thoshin edhe thonë akoma disa njerëz se Beqir Balluku është vrar i pa fajshëm se ai nuk ka

tentur të bëjë ndonjë gjë kundër rregjimit politik në fuqi që drejtohej nga Enver Hoxha. Ky ishte një nga njoftimet sekret që mori në atë kohë prej Allahut xh. sh. murshidja Aishe rahmetullahi alejha.

73-NJOFTIMI QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MURSHIDJA AISHE NË ATË KOHË, SE ENVER HOXHËN PO MUND OHESHIN TA RRËZONIN NGA FRONI = NGA UDHËHEQJA E SHTETIT.

Një ditë pasi mbarova punën ashtu si gjithmonë, unë shkova tek muxhedidja Aishe që Zoti xh. sh. e mëshiroftë atë. Sapo un ulem ajo më gostiti me diçka dhe ulet dhe vetë në një karrige përball meje. Ajo më tha se kishte marrë këtë njoftim prej Allahut xh.sh. nëpërmjet ëndrrës në kohën që po hynte namazi i sabahit. Ajo tha : Më paraqiti Allahu xh. sh. në një pamje filmike mes gjumit e zgjimit Enver Hoxhën i cili ishte i shtrirë në krevat i sëmur dhe një njeri tjetër ngjitur me të. Më tutje ishin dhe dy veta të tjerë. Ky që ishte afër Enverit, thoshte Aisheja, mu paraqit mua sikur ky ishte xha Hyseni nga Kruja, që muxhedidja Aishe e njihte atë se ajo shkonte vazhdimisht në shtëpinë e tij pasi Aisheja e kishte sehave=shoqe feje gruan e tij Cajen. Xha Hyseni ishte me origjinë nga sekti bektashij por pasi u njohën me muxhediden Aishe, ai filloi të fali pesë kohët e namazit dhe të agjërojë Ramazanin. Ndërsa gruaja e tij Caja nuk ishte në tarikatin bektashi por ishte sunij.

Ky njeriu që mu paraqit në ëndërr me fytyrën e xha Hysenit tha murshidja Aishe, filloi ta shtynte me krahë Enverin se donte ta rrëzonte nga krevati por me shumë kujdes. Murshidja Aishe tha se un po e shikoja me vëmendje se çfar po bënte xha Hyseni që ne për shkurtim i thoshim atij xha Sena. Në momentin që ai gati se po e rrëzonte nga krevati Enverin, i cili ishte i përgjumur, Aisheja tha se unë i thirra me zë të fortë xha Hysenit; Ç'bën ashtu more xha Sena, se po e hedh në tokë Enverin. Ai tani është i vjetër dhe i sëmurë. Në atë çast Enverit i doli gjumi e mori veten dhe u ngrit në këmbë shpëtoi nuk ra nga krevati. Kështu e përfundoi tregimin murshidja Aishe rahmetullahi alejha.

Aisheja ma shpjegoi kështu domethënja e kësaj ëndërre: Sipas frymëzimit që më jep Allahu xh. sh. mua në shpirt, përsëri po mundohen ta rrëzojnë Enver Hoxhën nga pushteti. Po mundohen ta

eleminojnë fare. Krevati tha ajo simbolizon fronin ose postin zyrtar të tij. Në këtë rast njeriu që e lun rolin kryesor për ta rrëzuar nga fronti Enverin, është nga Kruja. Un i thash murshides Aishe se në byronë politike nuk ka Krutan dhe un nuk di që të ketë as ministër nga Kruja. Murshidja Aishe tha: Ai është pa dyshim Krutan sipas njoftimit dhe dijes për brënda me ilham që më jep Allahu xh. sh. mua të kuptoj. Nëse nuk ka ministër Krutan, ai duhet të jetë me ndonjë detyrë tjetër por që ai është pa dyshim Krutan dhe është nga njerëzit që kanë takim të shpeshtë ose lidhje direkte me Enver Hoxhën.

Pasi murshidja Aishe ishte e vedosur në këtë mendim, unë pastaj nuk fola më, megjithëse unë rrija me mendimin se nuk ka nga Kruja ndonjë njeri me detyrë të lartë shtetëror që të ketë lidhje drejtë për së drejti personalisht me Enver Hoxhën. Mirpo kur u dënua ministri i punëve të brendëshme Kadri Hazbiu dëgjova se dikush në një qëndër pune kishte thënë se nuk ka faj filani e filani por fajin e ka Hamdi, Haxhi ose Haki Koni ose Kruja, që ky njeri than se ishte Krutan. Emrin dhe mbiemrin unë nuk mudem ta saktësoj tamam si e dëgjova pasi ka kaluar një kohë e gjatë prej tridhjetë vitesh dhe se ai emër nuk ishte emër i dëgjuar në gazeta, radio e televizion por vërtetë i dëgjova diku ato fjalë.

E tregova këtë gjë për të vërtetuar njoftimin që mori prej Allahut xh. sh, muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Kush do që të ketë qënë ai njeri nga Kruja megjithëse u mundua, ai nuk ia arriti qëllimit ta realizonte planin e tij për ta shëmbur=për ta asgjësuar Enver Hoxhën nga udhëheqëja e shtetit pasi nuk deshë Allahu xh. sh.

74- NJOFTIMI QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE PËR ISH KRYEMINISTRIN E SHQIPËRISË MEHMET SHEHU.

Pas kapjes së grupit puçistë ushtarak të ish ministrit të mbrojtjes të Shqipërisë Beqir Balluku me shokët, përsëri pati tronditje politike. Murshidja Aishe, më tregoi se disa kohë pasë vrasjes së Beqir Ballukut, mua më shfaqti Allahu xh. sh. këtë pamje filmike mes gjumit e zgjimit në kohën e namazit të sabahit: "Ishin në një mbledhje krerët kryesorë të shtetit, ku pas disa debatesh që unë

i shikova nga lëvizjet e gojës dhe duarve, Mehmet Shehu u nxehtë dhe iu vërsul Enver Hoxhës me këto fjalë që erdhën në veshin tim: “Un të heq nga froni = nga udhëheqëja e shtetit”.

Muxhedidja Aishe tha se Enveriu u tërhoq pak në bisedë duke e anashkaluar fjalën. Un me shumë çudi e pyeta murshiden Aishe rahmetullahi alejha; A nuk paska respekt Mehmeti për Enverin që iu paska vërsulur atij aqë ashpër? Muxhedidja Aishe më tha: Jo vetëm që nuk ka respekt për të, por me këtë informacion që më dha Allahu xh. sh. mua nëpërmjet rrujasë, më bën të kuptoj se tani Mehmeti nuk e ka më frikë fare atë [Enverin] pasi mesa kuptohet, Mehmeti tani i ka krahët e forta. Të shohim si do të zhvillohen ngjarjet në të ardhmen se çfarë do të bëhet më vonë, se Allahu xh. sh. është Sovrani i Gjithësis që vendos për gjithçka.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha pasi më kishte treguar mua shfaqjen filmike të fjalosjes së Enverit me Mehmetin; një ditë ajo më tregoi kështu; Mbrëmë tha ajo, pash në ëndërr se un po kaloja duke ecur më këmbë nga bulevardi. Aty pash disa puntorë rë që me sa mundeshin po i nxirrnin themelet godinës së kryeministrit. Un, thoshte murshidja Aishe i pyta ata: Përse po e prishni këtë godinë? Njëri nga puntorët më tha; “Do ta prishim se do të bëjmë një tjetër të re më të mirë.” Me kaq mori fund ëndërra dhe më doli gjumi, tha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha.

Un i thash asaj, hajër inshallah= mirsi në dashtë Zoti xh.sh. Po inshallah e përsëriti fjalën ajo. Aisheja më tha se kur rashë të fle gjumë isha me abdes. Nga dija që më jep Allahu xh.sh. nga brenda me ilham tha ajo, do të ketë ndonjë rrëmuje ose ngjarje të madhe në kryeministrië. Nuk kaluan veçse 6 ose 7 muaj dhe u vërtetua qart e plotsishtë ëndërra që i shfaqti Allahu xh. sh. muxhedides Aishe rahmetullahi alejha. Un isha duke ndenjtur në shtëpinë e hxaxhait tim kur në lajmet e orës 10 të mbrëmjes së datës 17 dhjetorë të vitit 1981 Radio Tirana dha këtë lajm: “Nga një moment krize nervore vrau veten kryeministri i Shqipërisë Mehmet Shehu”.

75-MUXHEDIDJA AISHE MORI NJOFTIM PREJ ALLAHUT XH. SH. PËR NJË KRYETARË SHTETI TË HUAJ TË MIRË.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha një ditë rreth vitit 1978 më tregojë mua se Allahu xh. sh. i kishte shfaqur asaj në ëndërr në kohën pak çaste para kohës së namazit të sabahit, një njeri të veshur me një veshje tipike të veçantë; jo si e jona. Ai njeriu po qëndronte më këmbë larg meje përtej detit me fytyrën nga unë thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha. Në atë moment dëgjova një zë tha ajo që më foli mua këto fjalë për atë njeri kështu: "Ja këtu përtej Italisë në anën tjetër të detit ndodhet ky njeri i cili është krytar shteti që e udhëheq mirë popullin e tij." Kështu ma tha mua fjalën shkurtimishtë muxhedidja Aishe rahmetullahi aljha por un nuk e shënova fjal për fjalë më gjatë se në atë kohë mua nuk më interesonin mbretërit e huaj por më interesonte udhëheqëja që na bënte neve kryetari i shtetit tonë, mbreti ynë i pashpallur = Sulltan Enveri.

Më kujtohet mirë që Aisheja rahmetullahi alejha më tha jo nga Misiri=nga Egjipti. Ndërsa për ish kryetarin apo presidentin e Tunizisë Habib Burgiba as që mund të mendohet për atë se në atë kohë është thënë që ai dilte e hante bukë në muajin e Ramazanit para syve të popullit, që të jepte shembullin e tij si njeri kundër fesë=anti fetarë. Murshidja Aishe ma tregojë dhe pamjen e fytyrës së atij njeriut që thashë, por un nuk u bëra kurioz në atë kohë që ta mbaja plotësisht të shënuar fjalën e saj se atëherë unë isha i ri në moshë. Meqë murshidja Aishe tha se ishte përtej Italisë, në anën tjetër të detit, në anën perendimore të vendit tonën dhe nuk ju tregua me emër se cili ishte ky njeri me atë veshje ndryshe nga e jona, unë personalishtë mendojë se pa dyshim ai ka qënë kryetari i Libisë gjeneral Kolonel Muamer Kadafi që kishte bër një lloj socializmi me fe, ndryshe nga të tjerët. Un e kam shikuar në televizor udhëheqësin e Libisë Muamer Kadafin duke falë namazë vetëm por edhe duke ju prijë imam për të fal namazin qindra njerëzve në sheshe edhe jashtë xhamisë. Edhe himnin kombëtar Muamer Kadafi e kishte bër me fjalë lavdruse për Allahun xh. sh. Kam dëgjuar se ai i ka ndihmuar nga ana ekonomike popujt e varfër të

Afrikës dhe e kam parë duke i vizituar shumë vënde atje. Ish udhëheqësi i shtetit Shqiptar Enver Hoxha në librin e tij 'Shënime Për Lindjen e Mesme' në atë kohë thoshte kështu: "Muamer Kadafi e ka shpallur veten kryetarë të muslimanizmit. Është e drejtë e tij të thotë çfar të doi". Kështu shkruante në atë kohë kryetari i shtetit Shqiptar Enver Hoxha. Unë shkruasi i këtij libri e kamë pa vetë me sytë e mi në televizionin kombëtar të Libisë udhëheqësin e këtij vendi Muhamer Kadafin duke ju prij imam në faljen e namazit mijëra muslimanëve në vendet e Afrikës.

Është gjë ineresante se shumë kryetarë shtetesh muslimane duke qenë të gjallë kanë pranuar që portretet e tyre të bëjnë buste = të bëjnë idhuj prej bronxi e të vënë në qendrat e qytetve të mëdha të vendeve të tyre ndërsa udhëheqësi i Libisë Muamer Kadafi i kaloi 40 vjetët në pushtet dhe nuk ka pranuar ta bëjnë populli për lavdi figurën e tij shtatore në bronxë e allçin. Unë e lus Allahun xh.sh. që ta ruaj atë njeri nga çdo e keqe kushdo qoftë nëse ai është gjallë dhe nëse nuk është i gjallë e lusë Allahun xh. sh. që të japi atij njeriu xhenetin në ahiret, në botën tjetër pas vdekjes.

Allahu xh. sh. i shumoftë dhe i forcoftë udhëheqësit dhe qeveritarët e mirë e të zgjuar në çdo vend të botës që i udhëheqin mirë dhe drejtë popujt e tyre.

76-NJOFTIMI QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE PËR ISH KRYETARIN E KOMITETIT EKZEKUTIV TË TIRANËS LLAMBI GEGË PRIFTI.

Ishte dita e djelë ishte ditë pushimi. Unë si gjithmonë shkova tek shtëpia e Aishes past rahmet nga Zoti xh. sh. Porsa hyra brënda dhe u përshëndetëm me selamë unë si kureshtarë që isha e pyta si gjithmonë nëse kishte ndonjë gjë të re=ndonjë njoftim ose lajmë të ri. Ajo më tha: Sot afër sabahit më shfaqti Allahu xh. sh. para syvet Llambi Gegëpriftin që ishte me fytyrën të pastër, jo të nxime dhe foli këto fjalë; Unë do të punojë drejtë, drejtë dhe vetëm drejtë. Fjalën drejtë ai e përsëriti tre herë thoshte murshidja Aishe që nga Zoti xh. sh. past mëshirë. Unë e pyta Aishen për domethënjen e kësaj pjesë filmike të shkurtër. Ajo më tha; Mesa kuptova dikush po i bënte thirrje direkt ose indirektë Llambi Gegëpriftit që të veprojë kundër vijës ose linjës politike të Enver Hoxhës por ai nuk pranoi.

Nga paraqitja e tij dhe fjala drejtë, që e përsëriti tri herë thoshte muxhedidja Aishe, vërtetohet se ai është zyrtar i sinqertë ndaj politikës që bën Enver Hoxha. Për njerëz të drejtë nga rradhët e kristianëve, Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Është një grup i drejtë [i matur] prej tyre [prej kristianëve] por është e keqe ajo që punojnë [që veprojnë] shumica prej tyre." S. Maide. Aj.66.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha më thoshte se Rita Marko e Spiro Koleka janë njerëz ateista=njerëz pa besim në Zotin xh. sh. Ndërsa un mendoj se të tillë si këta ka plot të tjerë sot në shtetin tone në Shqipëri. Prandaj besimtarët e Zotit xh. sh. duhet të jenë të kujdesëshëm e të vendosur për mbrojtjen e fesë nga shtrembërimet e hileqarvet.

Besimtarët musliman duhet të jenë të bashkuar me njëri tjetrin dhe që të jenë të bashkuar duhet të bëjnë tobe me kushtet që ka urdhëruar Allahu xh. sh. nëpërmjet muxhedides Aishe rahmetullahi alejha, në krye kushtin e parë të tobës, njisimin e Zotit xh.sh. me gojë në çdo gjuhë të botës. Zoti xh. sh. është një i vetëm. Ai nuk ka shok e ortak. Nuk ka tjetër Zot veç Tij. Po kështu edhe kristianët që besojnë, nëse e duan veten dhe fëmijët e tyre duhet të bëjnë tobe=pendesë. Vetëm kështu do të shpëtojnë njerzit e sinqertë = besimtarët e Zotit xh. sh. prej sundimit të ateistëve [të dexhalëve] në çdo vend të botës.

77-NJOFTIMI QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE PËR POLITIKANËT E RANGUT TË LARTË TË SHTETIT SHQIPTAR QË U PUSHKATUAN NË FUNDIN E JETËS SË ENVER HOXHËS TË CILËT U CILËSUAN ARMIQTË E POPULLIT.

Muxhedidja Aishe që Allahu xh. sh. e mëshiroftë, tha: Pas zbulimit e dënimit të grupeve armiqësore politike, të ish ministrit të mbrojtjes Beqir Ballukut, kryeministrit Mehmet Shehu dhe ministrit të punëve të mbrendëshme Kadri Hazbiut më njoftoi Allahu xh. sh. me anë të ëndrrës duke më shfaqur në kohën afër namazit të sabahit këtë pamje që ishte kështu; Ishte mbledhur shumë popull në të dyja anët e bulevardit që të çon nga busti Skënderbeut e deri

tek ishë pallati i komitetit Qëndrorë të P. P. SH. Aty ndodhesha dhe unë thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Nga godina e Komitetit Qëndrorë, thoshte ajo dolën njëri pasë tjetërit të shtrirë nëpër arkivola të pushkatuarit e këtyre grupeve. Ata rrinin shtrirë në arkivola dhe e këthenin kokën herë djathtas e herë majtas nga populli që rrinte më këmbë në dy anët e bulevardit dhe të gjithë njëri pas tjetërit kur kalonin ashtu të shtrir thoshin këto fjalë : “Për ne ju mos flisni keq se ne për ju u munduam por ja si e pësuam”. pësuam.” Sipas dijes që merrte prej Allahut të madhërushëm, murshidja Aishe e komentonte ëndrrën kështu: ‘Këto që i vranë kan pasur qëllimin që të bënin ndryshim në politikë për këtë vendë me mendimin për të mirën e popullit se vetë ata ishin mir por dëshira e tyre nuk përputhej me dëshirën e vendimin e Allahut xh. sh. për këtë popull. Kurani na thotë: “Ju nuk mund të doni nëse nuk do Allahu”. Për kurthet që thurin njerëzit kundër njëri tjetërit fshehur me pa të drejtë Allahu xh.sh. thotë në Kuran: “Ata vërtetë bëjnë kurthe po edhe Un përgatis dështimin e kurtheve të tyre”. S. Tarik. Aj. 15, 16. Me që ky popull nuk deshi të bëjë tobe, Allahu xh. sh. nuk dëshironte që të ndryshoi politika ndryshe asaj që bënte Enver Hoxha deri në afatin që kishte caktuar vet Allahu xh.sh.

Sipas kësaj që tregova këta që u pushkatuan në fakt nuk ishin armiq të popullit por armiq të vijës politike që ndiqte Enver Hoxha. Djali i Enverit Sokol Hoxha në një emision televiziv Tha: Enverit ata [kundërshtarët] deshën të ia fus...hidhnin, por ai jua fu...hodhi atyre. Un them se atëher Enveri, me dije ose pa dije, me dashje ose pa dashje, paska zbatuar ajetin e Kuranit që flet për kundërvënjen me të njëjtën mënyrë atyre që të tradhëtojnë fshehur ku aty thuhet: “Nëse e heton= e dikton [o Muhamed] tradhëtin e një populli [ose grupi njerzish] edhe ti jua hidh atyre në mënyrë të njëjtë se Allahu nuk i do ata që tradhëtojnë”. S. Enfal aj. 58.

**78-NJOFTIMI QË MORI NË ATË KOHË PREJ ALLAHUT XH. SH.
MUXHEDIDJA AISHE PËR ISH SEKRETARIN E PARË TË KOMITETIT
TË PARTISË TË TIRANËS DHE ZËVËNDËS KRYEMINISTRIN E SH-
QIPËRISË MANUSH MYFTIU**

Sikurse e thash më sipër muxhedidja Aishe jetonte duke qepur në shtëpi rroba grash e fëmijësh dhe i shiste më të shumtat në

qytetin Durrësit tek shtresa e puntorëve të thjeshtë. Ajo nëpërmjet shitjes së rrobave kryente dhe shërbimin që i kishte ngarkuar Allahu xh. sh. me gjithëse ishte e ndaluar me ligjë propagandimi i fesë. Për këtë gjë ajo kishte rënë në sy të organeve të qeverisë. Një ditë duke udhëtuar me tren nga Tirana në Durrës, murshides Aishe i bëjnë kontroll në tren dhe veç rrobave të qepura që kishte në dy çantat i gjejnë edhe disa libra feje në gjuhën shqipe e arabishtë. Në atë kohë ishte e ndaluar me ligjë puna private dhe propaganda fetare. Menjëher Aishen e ndalojnë në qëndrën e stacionit të trenit në Durrës. Pasi e procedojnë ia marrin librat e fesë.

Murshidja Aishe mërzitet shumë, por më tepër për librat e fesë. Nga këta që kontrollonin aty në Durrës për punë private kryesori ishte i quajturi Skënder Dervishi. Muxhedida Aishe këthehet në Tiranë dhe i lutet shumë Allahut xh sh. në namazin e natës që mos ta dënojnë dhe librat e fesë të ia kthenin përsëri asaj. Kështu ndodhi pasi lutja iu pranua nga Allahu xh. sh. Ajo e mallkoi ndihmësin ose puntorin e policisë të quajturin Skënder Dervishin që Allahu xh. sh. ti jepte atij me njëherë dënimin e merituar se ai ishte kryesori që e shikoi dhe e kapën me çantat e mbushura plot me rroba murshiden Aishe rahmetullahi alejha. Por ajo thoshte se nga Allahu xh. sh. mora këtë kritikë:

“Mos e mallko se është krejtësishtë i pa ditur.” Pas dhjetë ditëve murshiden Aishe e thërresin në rajonin e policisë së lagjes së sajë në Tiranë. Atë ditë në shtëpinë e Aishesë ndodha edhe unë dhe së bashku shkuam tek rajoni i policisë që në atë kohë ishte ngjitur me degën ushtarake dhe qëndrën e zjarrëfikësve. Aisheja duke bërë zikër Zotin xh. sh. gjatë gjithë rrugës u futë brënda në polici e unë e prisja jashtë. Ajo tha kur unë u futa brënda gjeta aty dhe sekretarin e këshillit të lagjes që porsa më pa mua filloi ti thotë shefit të policisë se e njoh unë këtë se kush është kjo. Ai deshi ti flasi atij keq për mua por shefi i policisë ia ndërpreu fjalën, dhe nxorri nga sirtari librat e fesë dhe pasi mi dha në dorë ata, ai me fjalë butësishtë më tha mua për çudi kështu; A i ke tamam librat? Unë thoshte Aisheja i thash: Po tamam i kam. Dhe gati se më shpëtuan lotët nga mrekullia e Allahut xh. sh. Ndërsa sekretari i lagjes u çudit se qysh shefi i policisë mi dha mua librat e fesë se ai po priste të kundërtën, që ai të më procedonte mua. Sekretari i lagjes i cili më urrente mua se isha fetare priste një dënim me burg për mua për agjitacion e propogandë

feje pasi feja ishte e ndaluar me ligjë nga shteti. Ndërsa nëpunësi i policisë më tha mua se ai ke tamam librat ? Me kaq murshidja Aishe rahmetullahi alejha doli nga rrajoni i policisë. Pas pak ditësh tha Aisheja mua më shfaqti Allahu xh. sh. në rruja-në ëndërr në kohën e sabasë këtë pamje të filmuar nga engjëjt; Ishte Manush Myftiu sekretari i parë i rrethit të Tiranës dhe një grup njerëzish që po i ankoheshin atij për mua duke i thënë se ajo bën propogandë të madhe fetare.

Ndërsa Manush Myftiu ju tha atyre me të butë: Jo more jo se ajo nuk paraqet rrezik për shtetin por thotë se kryen një amanet që i është lënë. " Kështu e mora sinjalin prej anës së Allahut xh. sh thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha. Aisheja më tha se nga ky sinjal që më dha Allahu xh. sh. unë kuptova që çështja e librave të mia kishte shkuar deri lartë në komitetin e partisë së rrethit nga të vegjëlit andej poshtë se gjoja janë vigjilentë për të ruajtë Partinë e Punës. Nga kjo ngjarje, u vërtetua përsëri paralajmërimi që Allahu xh. sh. i pati dhënë më parë muxhedides Aishe kështu:

"Tek qeveritarët e rrangut të lartë [të shtetit] kam futur shumë Zjuarsië". Allahu xh. sh. në Kuran thotë; " Nuk janë të barabartë ata që dijnë me ata që nuk dijnë. " Gjithashtu Kurani thotë: " Ai [Allahu] kujdeset për të mirët. " S. Araf. aj. 197

79-NJOFTIMI QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH, MUXHEDIDJA AISHE SE KRYETARI I SHTETIT SHQIPTAR ENVER HOXHA E BESONTE ZOTIN XH. SH. -EKZISTENCËN E TIJ.

Kur ish kryetari i shtetit Shqiptarë Enver Hoxha ishte nga fundi i jetës, muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha se mua më njoftojë Allahu xh. sh. me anë të ëndrrës kështu; Enveri ishte në një dhomë të madhe duke qëndruar në këmbë i veshur me një kostum me ngjyrë të bardhë dhe tha; Bismilahi Rrahmani Rrahim. Tani duhet ta provojë fortësinë=ashpërsinë e tokës. Un thoshte Aisheja që gjoja sikur isha aty në atë dhomë bashkë me disa njerëz të tjer i thash atij: Po duhet ta provosh sa e fortë është toka, me ballin dhe me hundën. E kishim fjalën që të falte namaz, të vente kokën në sexhde duke iu falur Zotit xh. sh. Kurse Enveri mu përgjigj : A tani

po më thua ?

Kaq ishte pjesa filmike prej Allahut xh. sh. e përgaditur nga engjëjt thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Unë e pyta murshiden Aishe se çfar domethënje ka ky njoftim me ëndërr nga ana e Allahut xh. sh. Ajo mua më tha; Me sa më bën Allahu xh. sh. të kuptoj, Enverit tani i është afruar vdekja. Nga fjala Bismilahi Rrahmani Rrahim që ai foli, kuptohet qartë që ai nuk ka qenë ateist. E ka besuar ekzistencën e Zotit xh. sh. pamvarsishtë dukjes së jashtëme si komunist, si marksistë-leninistë por sigurishtë me një besim të thatë pa vepra = pa namaz. Ndërsa Allahu në Kuran thotë: " Nuk i kam krijuar njerëzit dhe xhindët [për tjetër] veçse të më falen mua. "Ndërsa për besimin e fshehtë në zemër Kurani thotë; "Allahu është që i din të fshehtat në gjoksa=në zemra. "Sure. Hadidë=Kapitulli Hekuri. Ajeti 6.

Përsa i takon përgjigjes së tij; A tani po më thua?. Kjo përgjigje kështu në formë çudije mund të ketë dy kuptime thoshte murshidja Aishe. Kuptimi i parë; A tani që unë jam në pleqërinë afër vdekjes, po më thua mua që të falem ? I dyti mund të ishte se A këtu në mes të tjerëve po mi thua mua këto fjalë=që të falem? . Domethënjen e përgjigjes që ai më dha mua thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, vetëm Allahu xh. sh. e di tamam se mua nga brënda me ilham nuk më dha gjë tjetër. Ju o besimtar të Allahut xh. sh. mos çuditi se qysh Allahu xh. sh. e paska njoftuar muxhediden Aishe se Enver Hoxha e paska besuar Zotin xh. sh. Shembullin e kemi tek Pejgamberi a. s. i cili mori njoftim prej Allahut xh. sh. dhe i lajmëroi shokët e tij se mbreti kristian i Abisinisë Nexhashiu besonte si mulimanët, në një Zot xh. sh. që nuk ishte i lindur nga dikush dhe askush nuk kishte lindur prej Tij. Pejgamberi a. s. ju tha shokëve të emigrojshin atje për tu shpëtuar përndjekjeve të idhujtarëve. Shokët shkuan atje dhe mbreti i priti e i mbajti mirë ata. Kështu pra edhe Muxhedidja Aishe mori dije prej Allahut xh. sh. se Enver Hoxha e besonte Zotin xh. sh. Mbreti i Abisinisë pati guximin dhe e faktoi para shokëve të Pejgamberit a. s. mes njerëzve të tij besimin e pastër në Zotin xh. sh. një i vetëm dhe Mesihun="Krishtin" e besonte si i dërguari i Tij. Ndërsa Enveri nuk pati guxim deri sa vdiq që ta deklaronte hapur ekzistencën e Zotit=ekzistencën e Allahut xh. sh. dhe profetinë e të dërguarit të Tij Muhamedit a. s. Më në fund nuk kaloi shumë

kohë dhe Enver Hoxha vdiq=ndërroi jetë, kaloi nga kjo botë kalimtare sikurse do të kalojmë të gjithë ne. Disa njerëz më thanë mua shkruesit të këtij libri: A e dëgjove ti se vet bashkëshortja e Enverit Nexhmije Hoxha deklaroi hapur se Enveri nuk ka qenë besimtar. Dhe më thanë mua: Ja pra ai nuk ka besuar në Zotin xh. sh. ashtu sikur ke thënë ti në Librin Tobe Istigfarë. Un ju thash atyre se Nexhmija është grua e zjuar dhe e ditur për politikë dhe ka folur për politikanët. Ajo ka qenë politikane dhe flet si politikane. Ndërsa murshidja Aishe rahmetullahi alejha ka qenë fetare dhe me njoftimet met sekrete që ka marr prej Allahut xh. sh. ajo ka folur për besimtarët që i besojnë gajbit [të fshehtës].

**80-MUXHEDIDJA AISHE MORI LAJM PREJ ALLAHUT XH. SH.
QË TË ÇOI NJË DHURATË TË CAKTUAR NË QABE NË KOHËN E
PARTISË SË PUNËS DHE DISA LAJME TË TJERA QË MORI AJO
PREJ ALLAHUT XH. SH.**

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha bënte çdo vit kurban në festën e Bajramit të kurbanëve me përjashtim të rasteve shumë të rralla, ndërsa haxhin =vizitën në Qabe nuk mund ta kryente se rruga për të shkuar atje ishte e mbyllur nga shteti Shqiptar. Murshidja Aishe bënte kurban dash ose dele. Kur nuk i gjente nga që u paksuan këta në Shqipëri ose ndoshta në disa raste nuk e ka pasur tamam buxhedin financiar, un e kam pa me syt e mi që ajo ka ther për kurban edhe qingja mbi moshën 6 muajsh që ne nga Tirana ju themi xheleke ose sheleke ose qinza.Allahu xh.sh.thotë në Kuran: “E kryeni Haxhin dhe Umren për hir të Allahut, por në qoftë se pengoheni, atëherë [thorni për kurban] çka tju vijë më lehtë prej kurbanëve. . . ” S. Bekare. aj. 196. Murshidja Aishe mbante nga mishi i kurbanit pjesën që i takonte sipas ligjit të fesë= sheriatit dhe pjesët tjera jua ndante besimtarëve që ishin në gjendje të keqe ekonomike. Rreth vitit 1984-1985 muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, thoshte se Allahu xh. sh. mua më lajmëroi që të çoja në Qabe në Arabinë Saudite dhuratë 14 peshqira për të fshij haxhilerët ujët e abdesit. Un i shikova me sytë e mi që ajo i bleu e i palosi në një çantë bezeje ngjyrë ushtarake e qepur nga vet ajo me makinën e vet qepse dhe ia çoi një njeriu që rridhte nga një familje e mir e

dikush kush e njihje atë. Ai punonte me sa më kujtohet mua në atasheun tregëtarë të Shipërisë në Egjipt i cili shkonte e vinte. Muxhedidja Aishe kishte folur me një grua që e njihje këtë njeriun që punonte në Egjipt pasi e kishte të vetin dhe ja dorzoi atij peshqirat për ti çuar me anë të haxhilerëve të Egjiptit në Mekë, në Qabe, pasi ai e kishte marrë përsipër vetë këtë gjë. Murshidja Aishe më tha se Allahu xh. sh. më njoftoi mua me anë të ëndrrës se nuk arritën aritën në kohën e haxhit peshqirat në Qabe pasi rrugët ajrore e detare për të hyrë në Arabin Saudite ishin mbyllur si gjithmonë që mbyllen në kohën se fillojnë cermonitë e Haxhit. Peshqirat kishin arritur deri në Egjipt. Më vonë thoshte murshidja Aishe mora dije nga Allahu xh. sh. se peshqirat i dërguan në Qabe për të fshir njerzit që falen aty ujët e abdesit. Muxhedidja Aishe tha se një ditë rreth vitit 1984 pasi mbarova faljen e namazit mora prej Allahut xh. sh. këtë lajm kështu: "Tani po vjen Adem mekuli." =Që do të thotë: Tani [në botë] po vjen njeriu i prishur [brezi i njerëzve të prishur]. Brezi i njerëzvet të prishur krejtësisht nga çdo pikpamje: Nga shpirti, nga morali dhe nga mendja. Pra pa besim, pa gjykim, pa turp e pa moral, pa mëshirshirë, bixhozçij, drogaxhij e pesimistë për jetën. Pa vullnet për punë, keq bërës, grindavecë e të pa mëshirshirshëm edhe për prindët e tyre. Disa nga këta të rij, janë agresivë dhe kriminelë, të cilët i ofendojnë, i rrahin por edhe i vrasin prindët e tyre. Janë njerëz që nuk guxojnë të marrë mbi supet e tyre përgjegjësinë familjare=për të formuar e mbajtur familje. Vërtet prej Allahut xh.sh. është lajmi që dha murshidja Aishe rahmetullahi alejha se për vetitë e njerëzvet të kohës së fundit ka treguar i dërguari i Allahut xh. sh. Muhamedi a. s. Vërtetë ne po e shohim sot se brezi i njerëzvet që lindën rreth vitit 1984 kudo në botë, është brezi i njerëzvet të prishur krejtësisht nga çdo anë, të cilët janë bërë si të çmendur fare. Këto janë brezi i njerëzvet që do ti zëj kijameti ata që nuk janë besimtar, se besimtarët do të vdesin para kijametit të rijë e të vjetër. Allahu xh. sh. i drejtoftë të rijtë se nuk din se çka bëjnë pasi i kan tërbuar dexhalat me propogandën e tyre me mjetet e propogandës e cila është anti morale, anti fetare. Muxhedidja Aishe thoshte keni kujdes, ruani nderin. Ajo nuk hipte kurrë në autobus nëse kishte njerëz shumë dhe ishin të detyruar të rrinin ngjitur me njëri tjetrin. Ajo thoshte se për këtë gjë e kam marrë nga ana e Allahut xh. sh. njoftimin kështu: "Nuk janë më afër ngjitur me njëri tjetrin burri me gruan e tij në krevat se burrat dhe gratë e huaja ngjitur njëri me tjetrin në autobus". Sipas lajmit që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, çdo njeri duhet ta kuptoi mir se

udhëtimi i njerëzve me autobus burra e gra duke qenë ngjitur me njëri tjetrin para e prapa, pa dyshim formon ose sjell imoralitet si mbas shariatit=ligjit të fesë Islame.

Gjithashtu muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha më tregoi mua se kam marrë dije prej Allahut xh. sh. për filan familje në Tiranë se dy antarë të asaj familje me emër: . . . "Filani e filani do ta prishin atë familje". Me fjalën prishje nënkuptohet rënje prestigji=rënje vlere, shkatërrim ekonomije ose humbje fizike]. Vërtet pas pakë kohësh u vërtetua kjo gjë që më tregojë mua ajo. Elhamdulillah.

Shembull për lajmërimin e disa gjërave në të ardhmen e kemi tek Pejgamberi a. s. që lajmërojë për shumë gjëra para se të ndodhin ato. Një pjesë e tyre ndodhën pasi ai kalojë nga kjo botë. Shembujt janë të shumtë për kështu gjërash.

81-NJOFTIMET QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MURSHIDJA AISHE PËR POLITIKËN QË DO TË NDIQTE RAMIZ ALIA PAS VDEKJES SË ENVER HOXHËS.

Pas vdekjes së Enver Hoxhës në krye të shtetit erdhi Ramiz Alia. Në atë kohë njerëzve filloi tu dali pak e nga pak frika. Si pasoj e rënjes së forcës së diktaturës, në veçanti rinia filloi të çthuret shumë. Pasi erdhi Ramiz Alia në krye të shtetit, ekonomija e vëndit kishte ra krejtësishtë. Shteti Shqipëtar në atë kohë ishte varfëruar tej mase. Edhe ata rezerva ushqimore që i kishte pasur shteti dikur ishin mbaruar. Për arsye të ndryshimit të situatës politike në botë, Ramiz Alia filloi të bëjë lëshime të ndryshme. Ai filloi të bëjë disa reforma të vogla në blektori e bujqësi, që paralajmëronin për ndryshime ekonomike e politike. Më shumë ata ishin në fushën ekonomike. Filluan tufëzimet ose tufzat e lopëve me arëzat e vogla=pjesë e vogël toke për çdo kolektivë të brigadave bujqësore.

Filloi lejimi i tregëtisë së vogël private ambulante, që indirekt me këto ndryshime ai paralajmëronte një politikë të re. Kryetari i ri i shtetit Shqiptar Ramiz Alia i ruhej gjakderdhjes së popullit me çdo kusht. Më në fund sikurse e pamë ai ia arriti qëllimit që me dëshirën e Zotit xh. sh. të ia dilte mbanë. Ai ndërrimin e sistemit politik e bëri pa gjak derdhje. Kjo gjë ishte meritë e tij dhe ishte

fitore për popullin tonë të vogël e të shumë vuajtur. Por pamvarsishtë edhe se u rivendos e drejta e lirisë së fesë, populli ynë përsëri nuk e përqafoi fenë=rrugën e Zotit xh. sh. Ai nuk veproi si mbas fesë. Muxhedidja Aishe rahmet past tha se në atë kohë që drejtonte shtetin Ramiz Alia, mua më njoftoi Allahu xh. sh. me anë të një ëndrre pak para namazit të sabahit. se këtu në Shqipëri do të ketë ndryshime në politkë.

Para se të prishet në Shqipëri sistemi i qeverisjes me një parti, Aisheja tha se Allahu xh. sh. më njoftoi mua nëpërmjet ëndrrës se qysh do të jetë strategjia politike në të ardhmen në Shqipëri. Në në kohën e sabahut Allahu xh. sh. thoshte muxhedidja Aishe më shfaqti këtë pamje filmike në gjumë kështu: Doli gjithë populli për të votuar. Ashtu si të tjerët dola dhe un thoshte murshidja Aishe. Kryetarët e qendrës së votimit ju thoshin popullit këto fjalë: Tani jeni të lirë. Hidheni votën ku të dëshironi ju [asaj partije që të doni ju].” Kështu që secili njeri votonte për atë parti që dëshironte vetë.

Ndërsa un thoshte murshidja Aishe e mora fletën time të votimit dhe nuk e hodha në kutinë përkatëse por jua lash në tavolinë komisionit të qendrës së votimit dhe ju thash kështu: “Votën time hidheni ku të dëshironi ju.” Kur un ju thash këto fjalë, atyre nuk ju erdhi mir fare ndërsa un dola pastaj jashtë qendrës së votimit.” Me këtë pamje që më shfaqti Allahu xh.sh.thoshte murshidja Aishe mua më doli gjumi dhe ishte gati koha e namazit të sabahit. Ajo mua ma komentonte ëndrrën kështu: Partia e Punës që është në pushtet do ta ndërrojë politikën por po ata komunistët, fëmijët dhe miqtë e tyre do të jenë në pushtet. Ata do ti formojnë vetë shumë parti të tjera për ta nda popullin në grupe për hesape të ndryshme thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha . Vërtet kështu ndodhi pas katër vitesh.Partia e Punës e Shqipërisë u lidh politikisht me SH. B. të Amerikës. Në vitin 1990 Ramiz Alia shkoi në SH. B. A. të Amerikës për të bërë lidhjet politike me Amerikanët. Pas vizitës së Ramiz Alisë atje, vjen në Shqipëri ministri i jashtëm i Sh. B. të Amerikës Xhejms Bejker të cilin rregjimi komunist e priti me shumë nderime me pritje madhështore duke shtruar qilimat në sheshin qendror të Tiranës në shenjë respekti. Ata pa dyshim u lidhën me kusht që demokracinë në Shqipëri ta bënte Partia e Punës, ta bënin komunistët në pushtet. Amerikës kësaj hileqarje e dredharakje të madhe i ineresonte kjo gjë për shumë arsye abjektve.

Kështu që Partia e Punës [komunistët, miqtë e shokët e tyre me testa se pa testa partie nuk ranë nga pushteti por ndërruan politikën. Sistemin ekonomik socialist e kthyen në ekonomi tregu. Parrullat e simbolet socialiste komuniste i zëvendësuan me parrulla e simbole demokratike ndërsa diktaturën e zëvendësuan me dinakërinë. Kjo gjë ndodhi kudo në ish vendet socialiste se nuk u bë revolucion nga populli në asnjë vendë. Kokat drejtuse të regjimeve komuniste e ndryshuan vetë sistemin. Ata që nuk deshën ndryshim, i vranë ose i nxorrën jashtë lojës politike. Tani në rregjimin demokratik me ekomomi tregu, komunistët, fimijët, miqtë dhe shokët e tyre e kan përsëri në dorë pushtetin politik e atë ekonomik. Për Amerikanët nuk kishte rëndësi se kush do ta bënte demokracinë në Shqipëri, komunistët apo antikomunistët e mbetur nga klasa e përmbysura prej komunizmit në vitin 1944.

Për Amerikën kishte rëndësi që ata që do ta bënin demokracinë, ta bënin siç donte Amerika duke ndjekur politikën e saj. Amerika e kishte hallin që udhëheqëja politike komuniste e Shqipërisë mos tu rilidhte me Rusinë që ajo mos të kishte influence në Shqipëri e Ballkan. Ateistëve të çdo ngjyre politike brenda vendit në bashkpunim me misionarët anti fetarë të ardhur nga jashtë, ju erdhi rasti i duhur në sistemin demokratik për ti shkukur tani themelet vlerave morale me prejardhje nga feja që kishin mbetur sado tekë populli ynë. Ata po vepronë sot me të gjitha mjetet e propogandës për ta larguar rininë nga çdo mendim i pastër e vepër e mir me vlera kombëtare e fetare. Këto tipa njerzishzish duke përfituar nga politika aktuale po vepronë sot me të gjitha mënyrat dhe mjetet për ti nxjerrë themel çdo gjëje të mir me vlera morale që ka mbetur tekë populli ynë prej traditave të mira kombëtare.

Këtyre njerëzve jua pret fuqinë e veprimt vetëm kthimi sa më shpejtë i popullit tekë Zoti xh.sh. tek feja=tek ligjet e Zotit xh.sh. Përpjekja e besimtarvet të sinqertë duhet të jetë me qëllim të pastër duke i bër thirrje njerzvet që e besojnë sinqerisht Zotin xh. sh. dhe ringjalljen në botën tjetër botën tjetër pas vdekjes që të bëjnë tobe=pendesë të sinqertë duke u larguar nga punët e liga që i ndalon Allahu xh. sh. Kurani thotë: "Allahu nuk ia ndryshon gjëndjen e jetesës një populli përderisa ai të ndryshoi veten". S. Rrad. Un mendoj se marrvshetjet politike që bëri udhëheqëja komuniste e Shqipëris me Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ka bërë nga halli e jo nga malli.... Era e ndryshimeve politike në në Shqipëri filloi të ndihet kur kryetari i shtetit Shqiptar Ramiz Alia vizitoi Sh. B. të Amerikës.

Pas kthimit të tij nga SH. B. të Amerikës Partija e Punës shpalli pranimin e pluralizmit partiak. Ajo lejoi formimin e shumë partive politike në Shqipëri por të gjitha partit të komandohen nga komunistët, nga ish kuadrot e Partisë Punës, nga djemtë dhe miqtë e tyre. Drejtusat e partive sot bëjnë sikur po grinden me njëri tjetrin por në fakt ata e bëjnë vetë lojën ashtu, për të përçarë popullin që ta mbajnë të nënshtruar. Ky popull nuk e ka mendjen tekë e mira por e ka mendjen vetëm për poshtërsira. Ky popull e ka mendjen për horlliqe e maskaralliqe :

E ka mendjen me pi alkool, me bërë imoralitet, me u marr me thash e theme, me mashtru, me vjedh, me plaçkit, me u grindë e me i ba tan-gërllik e karshëllik njëri tjetrit, me shkatru, me djeg, me prish e me vra njëri tjetrin. Një popull që ka dalë nga rruga e Zotit xh. sh. mbahet i nënshtruar ose me diktaturë ose me dinakëri [përçarje]. Kështu që populli në demokraci do të vazhdoi të grinden e të vriten njëri me tjetrin për deri sa të vin në rrugën e Zotit xh. sh. dhe Zoti xh.sh. nuk do ti drejtoi e bashkoi ata deri sa ta njisojnë Zotin xh.sh. Atëherë do të shpëtojnë ata nga e keqëja. Kështu është vendosur nga Allahu xh. sh. kjo gjë thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha.

Ajo tha: “Ky popull [populli shqiptar] u dënua nga Allahu xh.sh. se nuk pranoi të bëj tobe = pendesë me kushtet e diktuara prej Tij”. Fare pak janë sot kudo në çdo popull njerzit e mir që e kan frikë Allahun e madhrueshëm. Ai e drejtoftë në rrugën e drejtë popullin shqiptar dhe gjithë popujt e botës. Siç e thash më sipër si në gjithë vendet ish socialiste, ashtu edhe në Shqipëri pushtetin e kan përsëri në dorë ata që e kishin më parë, komunistët, fëmijët, miqtë e shokët e tyre. Sot ish pushtetarët e rregjimit komunist, miqtë dhe shokët e tyre janë më të fortë se ishin më parë. Ata sot e kan në dorën e tyre edhe qeverinë edhe pasurinë. Këtu e kam fjalën për komunistët që ishin me detyra të larta në shtet e jo për komunistët e thjeshtë që ishin puntorë e fshatarë. Amerika e din mir që pushtetin politik dhe ekonomik kudo e kan komunistët ata që e kishin më par por asaj i intereson që ta kenë në dorë ata, se komunistët janë atestë të deklaruar. Duke qenë se komunistët janë materialist, ata nuk i marrin parasysh ligjet e normat e fesë. Me nxitjen e Amerikës dhe Evropës ata do ta shkatrojnë tani si në vendet perendimore deri në themel moralin e popullit me politikën që bëjnë. Ish komunistët për

të ruajt pushtetin e tyre janë të gatshëm të shkatrojnë çdo gjë prej vlerave morale të kombit.. Këtë gjë Amerika dhe Evropa e din mir. Në kohën e kaluar, në rregjimin Socialist, pushtetarët komunistë vranë, burgosën e internuan mijra njerëz për shkak se një pjesë e tyre ishin të pasur dhe nuk e donin sistemin komunist por pëlqenin atë kapitalist. Ndërsa një pjesë nga të vrarët e të burgosurit nuk e deshën komunizmin për të vetmen arsye se ai ishte kundër fesë. Ndërsa sot komunistët janë bërë miq me Amerikën e vendet tjera kapitaliste të Perëndimit. Ata sot janë bërë kapitalista. Janë bërë pronar të mëdhej tokash, fabrikash, e biznesesh tjera të madhaja. Dikur të pasurit quheshin Bejler e Agallar, ndërsa sot komunistëve që u bën të pasur ju thonë Bosa e Pronar. Një pjesë e tyre janë me rroga ose pensione të larta. Ata e kanë në dorë ekonominë dhe pushtetin. Ndërsa ish të persekutuarit, ashtu si gjithë populli mbetën përsëri të varfër siç ishin. Ata nuk fituan asgjë përveç liris së fjalës=liris për tu shprehur si të duan e asgjë më shumë. Ashtu si gjithë popullin edhe të persekutuarit i ka hutuar me koh shejtani i mallkuar duke thirrur parinë e vendit Zotër e zotnesha . Estagfirullah. Fjalët e kufrit, fjalët shirk me termat e zotsisë në forma të ndryshme janë përdurur para dhe gjatë rregjimit komunistë me përjashtim të fjalës ose titullit të lartë Zoti ose Zotri që rregjimi komunist e ndaloi më vonë për arsye politike dhe e zëvendësoi me fjalën “shoku” që për fat të mir kjo fjalë [fjala shoku] nuk është në kundërshtim me fenë Islame. Prandaj të ish persekutuarit dhe gjithë populli pa përjashtim duhet ti urrejnë gjërat e këqia e jo të mallëngjehen duke pasur nostalgji për ata. Allahu xh. sh. e drejtoftë për së mbari gjithë popullin tonë. Un them se vetëm dy kategori njerëzish nuk i do Amerika në çdo vend të botës. Ajo nuk i do besimtarët e vërtetë dhe nacionalistët e sinqertë. Grupimet tjera politike të çfar do lloji qofshin ato, Amerika i do se ata e çojnë ujin në mullirin e saj. Ajo do që të shkatrojë moralin e popujve në gjithë botën e të fusi grindje me qëllim që ti nënshtrio e ti grabisi kollaj. Këtë mision mendon ajo, e kryejnë më së miri ateistët. O ju njerëz që besoni: Ejani në rrugën e Zotit = në rrugën Allahut xh. sh. duke bërë tobe nesuh=pendesë të sinqertë se për ndryshe do ta keni punën keq e më keq. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha tha: Një natë si gjithmon në kohën e sabahut më shfaqti Allahu xh. sh. këtë pamje

filmike para syve të mi kështu; " Ishte një murë pak i lartë dhe aty ishte vendosur në krye të radhës flamuri i vëndit tonë. Ishte i madh. Ndërsa pas tij në radhë njëri pas tjetrit ishin vendosur disa flamuj tjerë më të vegjël e pastaj në radhë dhe më të vegjël. Gjithë ishin me pamje e ngjyra të ndryshme që un nuk i kishim parë asnjë herë ata flamuj. Flamujtë lëviznin nga era me shumë shpejtësi pa pushuar. Aty afër atij murit mua mu paraqit një njeri që un e kishim në lagje dhe e quanin Qerem ose Eqrem. Edhe un thoshte murshidja Aishe e kishim në dorë një flamur si ata që ishin vendosur në atë murë por flamuri im ishte flamur feje, flamuri i tobës=i pendesës. Me këtë flamur në dorë i afrohem dhe i them atij të quaturit Qerem këto fjal: "O Qerem merre dhe këtë flamurin që kamë un dhe vëje atje në murë tek ata të tjerët. Qeremi e mori flamurin dhe me shumë mundim u ngjit duke u kacavjerrë në atë murë e pastaj e nguli flamurin tim tek flamujtë tjerë.

Por ndërsa flamujt tjerë me flamurin e madh me shqiponjën në krye lëviznin [tundeshin] me shpejtësi ndërsa flamuri im lëvizte shumë pak. Me vështirësi u dallonte se po lëvizte. Muxhedidja Aishe tha se me këtë pamje që mua më shfaqti Allahu xh.sh. më njoftoi se tani do të ketë ndryshime në politikë. Partia e Punës së Shqipërisë e cila është e vetme në pushtet, do të bëjë në të ardhmen politikë me shumë parti. Këtë gjë thoshte ajo e kuptova me ilham=me inspirimin që më dha Allahu xh. sh. në shpirt. Kjo shfaqje filmike me anë të rrujasë=ëndrrës tha murshidja Aishe ka këtë kuptim : Flamuri i madh tha ajo simbolizon Partinë e Punës, ndërsa flumujtë tjerë simbolizojnë partitë e ndryshme që do të dalin ose formohen nga Partia e Punës, ashtu sikurse flamujt e tjerë që mu shfaqën mua para syve të rreshtuar pas flamurit të madh. Ndërsa feja nuk do të ketë fuqi tha murshidja Aishe edhe se në dukje ajo do të jetë e lir. Vërtetë kështu ndodhi e vërteta dhe po vazhdo deri tani në vitin 2012. Feja nuk përkehet nga shteti. Përkundrazi feja Islame vazhdon të luftohet dhe sabotohet nga armiqtë e saj ateistët dhe gjithë llojet e qafirave e munafikëve nga brenda e nga jashtë, duke përdor njerzit shitur e të pa diturit si vegla për të futur përçarje mes besimtarvet të sinqert musliman. Vërtet feja këtu në Shqipëri është sa për formë. Ashtu si politikanët që nuk janë fetarë por shkojnë për formalitet në selitë e komunitetve fetare për urime në raste festash edhe mësusat e fesë bashkë me popullin që deklarojnë se janë besimtar, nuk janë të vendosur në besim se këta

nuk e kan në shpirt frikën e Zotit xh. sh. Fakti është se këta të gjithë së bashku thërrasin njëri tjetrin Zoti filani ose o Zotni filani [estagfirullah]. Kështu që këta Zotin e bëjnë njeri dhe njeriun e bëjnë Zot estagfirullah, estagfirullah.

Me këtë veprim këta tani kaluan nga ateizmi që ishte në rregjimin komunist dhe shkuan në politeizëm në rregjimin Demokratik. Doli e vërteta që paralajmrojë disa vite para demokracisë muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e cila tha se: “Feja do të lihet e lirë por nuk do të ketë fuqi.” Vërtetë feja Islame jo vetëm që nuk po ndihmohet por përkundrazi po luftohet sistematikisht në Shqipëri me lloj lloje mynyrash nga armiqtë e sajë, brenda dhe nga jashtë Shqipërisë. Shihet qartë në shumë aspekte që feja Islame luftohet. Me gjithë se Shqipëria është një shtet me një popullsi 75 përqindë muslimanë e ndërsa muslimanët falen jashtë në shi e në borë se akoma edhe pas 23 vitesh demokraci nuk i lejojnë armiqtë e fesë Islame për të ndërtuar një xhami të madhe në kryeqytetin e vendit në Tiranë, duke nxjerrë lloj lloje justifikimesh të ndryshme. Ndërsa dy katedralet kristiane njëra katolike e tjetra ortodokse ka vite që janë ndërtuar në trojet e tiransvet muslimanë autoktonë.

Një tjetër aspekt ku shihet qartë luftimi i fes Islame janë edhe ditët e pushimit javor për punojstit. Megjithse shumica e popullsis=75 përqind janë muslimanë shteti ka caktuar për njerzit ditë pushimi javor ditën e Shtunë dhe të Djelë që janë ditët e shejta të javës për çifutët dhe kristianët. Ndërsa në ditën Xhuma = ditën e Premte e cila është dita e shenjtë e javës për muslimanët, nuk bëhet Pushim javorë. Në kohën e komunizmit ishte vetëm dita e Djelë ditë pushimi ndërsa tani në rregjimin demokratik qeverija për ti bërë qefin edhe çifutëve kudo që ndodhen, në Amerikë e Izrael e bëri edhe ditën e Shtunë ditë pushimi javorë për punojstit e vendit. Kjo gjë është padrjetësi për besimtarët musliman. Allahu xh.sh. e i dërguari i Tij Muhamedi a. s. e ka caktuar ditën e Premte = ditën e Xhuma ditë pushimi = ditë feste=ditë ibadeti = ditë falje e lutje për muslimanët. Ndërsa muslimanët sot po trajtohen si kategoria e tretë e popllsis së vendit. Besimtarët muslimanë janë të detyruar të punojnë në ditën e Premte = ditën e Xhuma të cilën muslimanët e kan ditë të shenjtë të javës. Besimtarët muslimanë janë të detyruar tu luten e tu përgjërohen punëdhënësve ateistë e kristianë që tu japin leje ata për të falur namazin e ditës Xhuma.

Të shumtë janë ata muslimanë që duan ta falin namazin e xhumas por nuk kanë mundësi pasi nuk ju japin leje punëdhënësit. Disa muslimanë që kanë guxuar ta ndërpresin një orë punën për të shkuar në xhami për të falur namazin e Xhumas i kanë larguar nga puna punëdhënësit. Ndërsa disa të tjerë janë detyruar që një ditë Premtje ta falin namazin e Xhumas dhe javën tjetër që vjen të mos e falin nga shkak se kanë frikë se i nxjerrin nga puna. A kështu janë të drejtat e njeriut që po na servir Evropa? Jo. Këto nuk janë të drejtat e njeriut por të drejtat e "ariut" = të drejtat e më të fortit. Ky veprim kështu quhet ligji i xhunglës. Shteti nuk e përkrah as pak fenë Islame dhe nuk i ka lënë asaj asnjë dritare të vogël që të lëshojë dritë ajo. Lufta kundër ligjeve fetare në përgjithsi dhe kundër fesë Islame në veçanti me një mënyrë ose tjetrën po bëhet tani e fortë në çdo vendë të botës nga ateistët qafirat e munafikët=hipokritët dhe veglat e tyre qorre. Sot është koha e dexhalit për të cilin Pejgamberi jonë a. s. ka lajmëruar kështu: "Ka për të dalë dexhali me shëtit gjithë dynjanë mjer gjynahqari= njeriu i keq se besimtarit nuk ka çfarë i ban." Pra fjala është se kanë për të komanduar në çdo vendë të botës njerëzit e këqij mashtrusa e mëdhej=njerëzit e pa fe=pa moral por mjerë njeriu i keq, i prishur nga besimi që gabohet nga fjalët e tyre rrena se besimtarin e mir nuk e mashtron dot. Do të vuaj pak njeriu i mir por imanin =besimin nuk mundet të ia heqi atij dexhali [ose dexhalat] nga zemra. Siç e thash më sipër, çdo njeri që është kundër besimit në Zotin xh. sh. në ligjet e Tij, në profetët=mesazhjerët e Tij dhe botën tjetër pas vdekjes është dexhal = mashtrus i madh ateist. Kristjanët i thonë atij anti Krishti. Profeti ynë Muhamedi a.s. ka lajmëruar me hadith se dexhali i parë ose ndryshe kryetari i dexhalëve ka për të dalë ose ka me qenë prej çifutëve. Kjo gjë pa asnjë dyshim u vërtetua qartë me daljen e teorisë së materializmit e më pas të evolucionit nga çifutët Karl Marksi e Çarls Darvini, mallkuar qofshin ata. Nëse besimtarët e Allahut xh. sh. kudo qofshin, nuk do të ndahen nga qafirat duke bërë tobe=pendes me bazë kushtin e par të saj, Njisimin e Allahut xh. sh. në çdo gjuhë, duke u larguar prej fjalëve të shirkut e kufrit që flasin ata, do të jenë vazhdimisht në sundimin e dexhalëve në çdo vendë që të jenë, pamvarsisht mënyrës së politikës që dexhalat e ndryshojnë atë herë pas here.

Muslimanët ka shumë kohë që po e faktojnë gabimisht me gojën tyre fjalën e kufrit një llojë si kristanët që janë udhëhequr gabim nga priftërinjtë e tyre dhe nuk mendohen se çka po flasin. Ata si kristianrët po e thërrasin njeriun në gjuhë të ndryshme Zoti, Gospoda, Boga, Theos ose Qirja, Mullah dhe indirekt Meuvlana estagfirullah, estagfirullah. Ndërsa përkundrazi Allahu xh. sh. ju thotë muslimanëve në Kuranë kështu; 'Thuaju [o Muhamed] atyre [që ndjekin librat e tjera [Teuratin e Ungjillin] Ejani të bashkohemi tek një fjalë që është e njëjtë mes nesh dhe mes jush, të mos adhurojmë [tjetër kendë] përveç Allahut=veç Zotit, të mos ti bëjmë atij asnjë send shok; të mos quajmë ose thërrasim njëri tjetrin zotër veç Allahut=[Zotit që na ka kriju], nëse ata [ndjekësit e Teuratis dhe Ungjillit] refuzojnë [nuk duan], ju [o muslimanë] thoni [atyre] Dëshmoni=ta keni të qartë se ne jemi muslimanë [Jemi të sinqertë e të bindur dhe nuk largohemi kurr nga feja jonë Islami]. S. Ali Imran. aj. 64.

Mjerisht ka disa kohë që muslimanët me fjalët e kufrit që po flasin në çdo gjuhë, po bëjnë të kundërtën e asaj që thotë Allahu xh. sh. në Kuran. Besimtarët e sinqertë kudo në botë duhet të bashkohen të gjithë rreth fjalës së madhe=fjalës së lavdishme: La il lahe il lall-llah=Nuk ka tjetër Zot veç një Zoti xh.sh.pa dallim gjuhe. Për ndryshe do të do jenë të përçar, të humbur e të persekutuar nga çdo pikëpamje. Kur ata ta njisojnë Allahun e madhrushëm në çdo gjuhë atëher dhe Allahu xh. sh. do ti shpëtojë ata nga dora e dexhalëve. Muslimanët kurrë nuk do të kenë bashkim me njëri tjetrin për deri të bëjnë tobe dhe ti qëndrojnë besnikë në çdo gjuhë fjalës së madhe=fjalës së lavdishme La il lahe il lallah = Nuk ka tjetër Zot veç një Zoti xh. sh. Përndryshe besimtarët muslimanë do të jenë vazhdimisht nën sundimin e persekutimin e dexhalëve=ateistëve e qafirave të ndryshëm të çdo ngjyre politike në çdo vend të botës. Ateistët=Dexhalat i kan munduar e do ti mendojnë me mënyra të ndryshme gjithashtu dhe të vetquajturit kristianë që e besojnë Zotin xh. sh. dhe botën tjetër pas vdekjes. Besimtarët muslimanë duhet ta duan njëri tjetrin si sytë e ballit dhe ta përkrasin dhe mbrojnë me çdo lloj mynyre njëri tjetrin. A nuk i shikoni ateistët e qfirat e çdo lloji ju o besimtar musliman se qysh janë lidhur me njëri tjetrin dhe se qysh e përkrasin ata njëri tjetrin në çdo vend të botës ? . Allahu xh. sh. i udhëzofhtë e i ruajt besimtarët e Tij të sinqertë. Amin.

84-MUXHEDIDJA AISHE MORI NJOFTIMI PREJ ALLAHUT XH. SH. PËR ENVER HOXHËN PAS VDEKJES SË TIJ.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha kjo murshide= udhëheqëse shpirtërore fetare e shekullit të njëzetë thoshte: Në pesë vitet e fundit të rregjimit komunist në kohën që vëndin e drejtonte Ramiz Alia u zbut pak diktatura. Popullit filloi ti dali pak frika dhe rinia filloi të ç' thuret më shumë moralisht. Filluan në masë poshtërsitë nga më të ndryshmet, në qytete e fshatra. Mua thoshte Aisheja më interesonte morali mbi çdo gjë. Një natë Allahu xh. sh. tha ajo më shfaqti në ëndërr afër sabahit Enver Hoxhën që ishte ngritur nga varri e qëndronte në këmbë me fytyrën nga qytyti në drejtim shtëpi-së time ku banoja un, në lagjen Ali Demi në Tiranë.

Ai ishte i veshur me rroba të vjetra, ngjyrë ushtarake të asaj kohe, por në fytyr ishte i pastër. Unë thoshte murshidja Aishe e mërzhitur më shumë për çthurjen e rinisë e rënjen morale akoma më shumë të popullit, duke qënë ballë përballë me Enverin i thirra atij nga larg: "Hajde more ti Enver rregulloje pak situatën, se këta [populli], morën për së koti tani. Ai mu përgjigjë; "jo, jo, jo. Un nuk vi më atje. Do të rrinë ata, ata, ata. " Fjalën "Ata" thoshte Aisheja ai e përsëriti tre herë. Aisheja ma tregoi domethënien e ëndrrës mua kështu: Shikimi që bënte ai nga larg e ka kuptimin se të vdekurit njoftohen nga Allahu xh. sh. nëpërmjet ëngjëjsh, për shumë gjëra që ndodhin këtu në këtë botë.

Rrobat e vjetra që kishte veshur Enveri tregojnë që ai punët e mira për ahiretin=botën tjetër, i ka pasur të pakta. Fytyra e pastër do të thotë se ai ka vdekur me besim në Zotin xh. sh. sipas dijes që më dha Allahu xh. sh. mua thoshte muxhedidja Aishe rahmetullahi lejha. Qëllimet ai i ka pasur të mira thoshte ajo, pamvarsisht vendimit të Allahut xh. sh. të caktuar për këtë popull i cili nuk pranoi të bëj tobe. Si doqoftë ajo punë që bëri populli në Shqipëri nën udhëheqëjen e Enver Hoxhës u pa dhe dihet mir. Një pjesë e popullit thonë se ai bëri shumë punë e disa thonë bëri pak. Populli ynë ishte analfabet dhe vendi ishte i varfër ekonomikishtë e i shkatërruar nga lufta. Un shkruesi i librit po ju kujtoj këtë hadith besimtarëve të Zotit xh.sh. se Pegamberi=Muhamedi a. s. ka thënë: "Nuk është e drejtë të shahet

ai njeri që ka dashuri për vendin e tij, që mundohet për popullin e tijë. "Megjithatë veprimet e tij të këqia e të mira, të dukëshme e të pa dukëshme, do ti gjykojë Allahu xh. sh. në botën tjetër=Ahiret. Përmendëm fjalën të këqia se pa dyshim së bashku me fajtorët, janë vrarë, burgosur e persekutuar dhe shumë njerëz të pa fajshëm, si pasoj e politikës që ndiqte Partia Komuniste që më vonë ajo u quajt Partia e Punës e që në krye të saj ka qenë gjithmon Enver Hoxha.

Që janë burgosur e vrar shumë njerëz të pa fajshëm këtë gjë Enveri e ka pranuar vetë. Ai në një fjalim të tij është shprehur kështu: "Pa dyshim prej barit të thatë është djegur edhe ndonjë fije e njomë. "Sigurisht që ai e ka thënë kështu fjalën sa për të mos me thënë gjë fare pasi e ka zvogëluar shumë numrin e të vrarëve të pa fajshëm. Kështu ia donte politika atij. E çfar faji kishin ata që vuanin nga të tjerët pa bër asgjë. ? Kurani thotë se nuk është e drejtë të dënohet e të persekutohet njeriu i pa fajshëm, deri gruaja, plaku, fëmija dhe i marri= njeriu me të meta mendore për fajin që mund të ketë bërë baba, xhaja, kushuriri, daja, nipit, fisi dhe miku e shoku. Kurani thotë: "Ai [Pejgamberi Jusufi [kur u bë ministër] tha: "Allahu na ruajt që mos të dënojmë atë [njeri] që është i pafajshëm." S. Jusuf. Gjithashtu Kurani thotë: "Allahu ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. "S. Nisa. aj. 58.

Un shkruesi i librit mendoj se qoftë për të mirat e qoftë për të këqiat Enver Hoxha ka pjesën e vet në historinë e Shqipërisë. Ramiz Alia ishë kryetari i shtetit Shqiptar i cili zëvendësoi Enver Hoxhën pas vdekjes së tij, në librin e tij Shpresa dhe Zhgënjime faqe 14 dhe 15 ka thënë kështu: "Enver Hoxha si dhe çdo udhëheqës tjetër i vendit për kohën dhe fushën që ka vepruar nuk mund të përjashtohet as nga të mirat e as nga të këqiat. As nga veprimet pozitive as nga ato negative". Ndërsa në librin tjetër të tij me titull "Unë Ramiz Alia Dëshmoj Për Historinë" në faqen 105 ai ka thënë kështu: "Enver Hoxha ka pasur të mira dhe të këqia. Të mirat dhe të këqiat i merr numri një [i pari i shtetit]. "Unë shkruesi i këtij libri mendoj de themi se figura e Enver Hoxhës nuk mund të ngrihet më kurrë lartë dhe nuk duhet të ngrihet se Partia që drejtoi ai shpall ideologji sunduse në Shqipëri ateizmin duke e shpallur vendin botërishtë shteti i parë dhe i vetëm ateist në gjithë botën, pamvarsishtë se kjo gjë ishte me vullnetin e Zotit xh. sh. siç e meritonte

ky populli, pasi ky popull nuk pranoi të bëj tobe. Por ama në krye të shtetit ishte Enver Hoxha. Për fajet e fëmive mban përgjegjësi dhe prindi. Ndërsa për popullin mban përgjegjësi krytari i shtetit Me vendosjen e rendit demokratik në Shqipëri një pjesë e konsiderushme e komunistëve që ishin gjallë ia hodhën fajet e tyre të gjitha Enver Hoxhës për vrasjet, burgosjet, internimet e cilësimet kulakë, që ata të dilnin të pa fajshëm. Por ishte e pamundur që Enveri të dinte për çdo njeri në qytet e në fshat se cili njeri ishte fajtor dhe ishte për tu vra, për tu burgosur ose për tu internuar dhe cili jo. Por ishin komunistët e bazës në çdo zonë të vendit për inate të vjetra personale shfrytëzuan rastin që u erdhi në dorë dhe bashkë me fajtorët vranë, burgosën, internuan e cilësuan kulakë e armiq të popullit shumë njerëz të pa fajshëm.

Në fakt komunistët që ishin në bazë duhet të dënoheshin më parë moralisht se ata që ishin në krye të shtetit. Si do që u bë e keqja e gjeti popullin tonë. Allahu xh. sh. në Kuranë thotë: "Ruhuni nga e keqja [nga dënimi] që nuk i godet vetëm ata që bëjnë mizori [bëjnë keq] prej jush [por dhe të mirët] dhe ta dini se Allahu është ndëshkues i rreptë." S. Enfal. Kështu që kur e godet e keqja një vendë, nuk godet vetëm ata që e bëjnë të keqen, por dhe ata të paktët që nuk kan faj, qoftë nga populli i thjeshtë, qoftë nga parijs. Kurse fjala që ai tha tre herë "jo, jo, jo. Un nuk vinj më atje". Kjo do të thotë që me vdekjen e Enver Hoxhës mori fund mënyra e udhëheqëjes me një njeri e një parti. Ndërsa fjala "ata, ata, ata" që ai e përsëriti tre herë thoshte murshidja Aishe, do të thotë që nuk do të jetë gjithmonë vetëm i njëjti njeri në krye të shtetit për të udhëhequr por pas tij [pas Enverit] udhëheqëja do të jetë kolektive e drejtuar me shumë persona=me shumë kryetar të zgjedhur në udhëheqëjen e shteti njëri pas tjetrit. Pas gjashtë vitesh u bënë realitet fjalët që tha murshidja Aishe rahmetullahi alejha nga njoftimi që ajo mori prej Allahut xh.sh. me anë të rujasë=ëndrrës.

Nga sa u tha e nga sa u pa, kuptohet qartë se Enver Hoxha nuk ka qenë me shpirtë komunist por e mbante këtë flamurë si më të përshtatshëm për këtë popull, sipas kushteve dhe situatave politike që erdhën në Shqipëri. Un them se ai ishte nacionalist i flakët por u maskonte mir me flamurin internacionalizmit për të mbrojtur nacionalizmin. Kjo gjë vërtetohet edhe nga thënjet e disa politikanëve të njohur, ndër të cilët po përmendim; Abaz Ermenin

eksponent i Ballit Kombëtar icili ka thënë: Në një takim që un kishim rastësishtë me Enver Hoxhën, ai mu shpreh mua shkurtimisht me këto fjalë: “Këtu në këtë vendë duhet pa tjetër komunizmi për ti rregulluar shum gjëra”. Ndërsa politikani Arshi Pipa ka thënë: Enver Hoxha i përkiste sektit bektashij dhe shfrytëzoi parrullën “feja e shqiptarit është shqiptaria”. Ai ishte ishte me bindje patriotike fetare dhe i përkiste sektit shia sufi. Ky sekt kishte ndikim të veçantë në Shqipëri si rezultat i veprimtarisë patriotike nacionaliste. Ai vazhdo e thotë: Libri Shënime për Lindjen e Mesme, zbulon parti pris animin e Hoxhës thotë Arshi Pipa. Përsa i përket prejardhjes fetare të Enver Hoxhës un shkruasi i librit themi se Arshi Pipa e ka thënë gabim fjalën këtu se siç dihet Enver Hoxha nuk ka qenë me prej ardhje bektashiane por sunite. Ndërsa Nexhmije Hoxha bashkëshortja e tij tha se Enveri e ka pasur dikurë mbiemrin Kola.

Ndoshta ashtu e ka pasur. Dikur origjina e largët e fisit të Enverit paska qenë katolike sipas mbiemrit që tregoi tani gruaja e tij, kurse më vonë të tjerët mundet ta nxjerrin atë me prejardhje ortodokse. Si do qoftë e kaluara e largët por në fakt Enver Hoxha rridhte nga një familje muslimane. Enveri kur ishte vetë gjallë ka thënë që në familjen time agjëronin, mbanin Ramazan. Vërtetë babai dhe nëna e tij ishin besimtarë. Këtë gjë veçë Enverit e kanë thënë dhe të tjerë. Mua më ka treguar këtë ngjarje një besimtarë nga Gjirokastra i quajtur Naser Mezini që kishte qenë familje dëshmori por i dënuar për politikë=agjitacion e propogandë 8 vjet burg në kohën e Enverit, thoshte ai. Babain e Naserit e quanin Refik Mezini i cili ishte Hoxhë në qytetin e Gjirokastrës në kohën mbretit Ahmed Zogu. Ne thoshte Nasiri ishim në gjendje të varfër atë kohë, pasi ne ishim shum fëmij. Një natë në darkë nëna i tha babait :

Nesër o burrë nuk kemi çfar të hamë. Nuk kemi më miell për të gatuar bukë. Babai i tha asaj: Nesër nuk dihet se çfarë bën Allahu xh. sh. Nëna ia këthen fjalën atij: Po, po ti ashtu thua. Mirpo të nesërmen në mëngjes heret troket dikush në portë. Un thoshte Nasiri hapa portën dhe hyri brënda Halil Hoxha, babai i Enver Hoxhës. Ne atë e kishim në mëhallë=në një lagje e kishim komshi. Ai rrinte vazhdimisht me babain tim Refik Mezinin thoshte Naseri. Halil Hoxha thoshte ai, ishte njeri i urtë e besimtar i mir. Pasi Halili piu kafen si pas zakonit që kemi ne shqiptarët i tha babait: Dëgjo

o Refik efendi: Un erdha të sjell si për çdo vit detyrimin që kam ndaj teje si kuadër feje. Un po të pyes ty: A do që ti jap lekë apo do bereqet, të sjell grurë.

Babai i tha atij: Tu rritë ndera o Halil Hoxha. A vetëm ti do ta paguajshë hoxhën? Tani vetëm ti ke mbetur nga ata njerëz që i paguanin dikurë mësusat e fesë = hoxhallarët. Ndërsa Halil Hoxha i tha : Un do të bëj detyrën time ndërsa të tjerët le të bëjnë si të duan. Nëse nuk duan të paguajnë hoxhallarët, le të paguajn priftërinjtë se ndoshta jau ka qefi të paguajn ata. E me njëher xha Halili nxori nga xhepi lekët që i kishte taksur për babain tim. Un thoshte Nasiri si fëmij që isha në atë kohë rreth 10 ose 11 vjeç u gëzova shumë kur xha Halili nxorri lekët nga xhepi e ia dha babait tim. Ne u çuditëm familjarisht nga kjo gjë që ndodhi sipas fjalëve që i kishte thënë nënës babai mbrëmë në darkë duke qenë i mbështetur sinqerisht tekë Zoti xh.sh. për ushqimin e familjes.

Babai i mallëngjyer bëri këtë lutje për Halil Hoxhën duke i thënë atij këto fjalë; Ej vallah O Halil Hoxha. Ta bëftë Zoti xh. sh. djalin mbret. Halil Hoxha ia këthen fjalën: Inshallah të na rrojnë fëmijët mua dhe ty o Refik efendi por për mbretër ka të tjer për tu bërë në Shqipëri. Pas pak Halil Hoxha u ngrit dhe doli nga shtëpia. Kjo ngjarje ishte në kohën e mbretit Ahmed Zogu. Koha kaloi thoshte Nasiri dhe un u rrita e u bëra burrë. U bë lufta e dytë botërore dhe vendi u çlirua nga itajlanët e gjermanët. Pas çlirimit në kohën e Enverit mua më futi qeverija në burg edhe se un isha familje dëshmori prej vëllait që u vra gjatë luftës thoshte Nasir Mezini nga Gjirokastra. Shkaku që më futën mua në burg thoshte ai, ishte për politikë: Axhitacion e propogandë kundër politikës së shtetit]. Isha në burgun e Burrelit për të kryer dënimin. Një ditë afër mbrëmjes isha duke ndenjor jashtë në oborrin e burgut ulur në një stol. Atë natë po fliste Enver Hoxha dhe un kur po dëgjoja radio Tiranën nga altoperlanti, mu kujtua babai im dhe dua=lutja që ai bëri në atë kohë për Halil Hoxhën; "Ta bëftë Zoti xh. sh. djalin mbret." Në ato momente mua më shpërthyn lotët e thash me veten time: Ah more baba lutja jote që bëre për Halil Hoxhën u pranua nga Zoti xh. sh. Djali i Halilit vërtet u bë mbret por e pësoi djali yt se djali i Halilit mua më futi në burg. Aty në atë çast pran meje kaloi një i shok i burgosur si un dhe kur ai më pa me lot në sy më tha; E more po qan se po mallëngjehesh për fjalimin e Enver

Hoxhës? Akoma more ty nuk të është mbushur mendja këtu ku të ka futur Enveri ? Hë more fol. Un pastaj i tregova shokut të burgut thoshte Nasiri se përse qaja un. Ai më dëgjoji me vëmëndje dhe pasi u çudit pak më tha: E po ashtu ka qëlluar ajo gjë=Ajo ka qenë koiçidencë.

Ndërsa un autori i librit themi se nuk është aspak koiçidencë= e rastësishme ajo gjë. Nuk ka për besimtarët e Zotit xh. sh. as ndonjë gjë ashtu qëllonjë. Koiçidencën [rastësinë] e besojnë të pa fetë=ateistët. Asgjë nuk ndodh pa caktimin e Zotit= e Allahu xh. sh. Kështu që ardhja e Enver Hoxhës në krye të shtetit ishte paracaktuar nga Allahu xh. sh. dhe në këtë rast u mor në pranim edhe lutja e Refik efendiut ish Hoxhës fukara sabirin=durimtar. Për këtë gjë teologët e rinj të fesë le ta studiojnë mirë Kuranin dhe hadithet e Pejgamberit a. s. se çfar thonë për fukarejtë durimtarë dhe për lutjet e tyre. Profeti ynë Muhamedi a. s. ka thënë se njerëzimi jeton në rregull me 4 lloje grupe njerëzish. 1-Me diturinë e ditjetarëve, 2- me drejtësinë e kryetarëve, 3 me dorëdhënjen=bujarinë e pasanikëve dhe 3- me duan=lutjen e të varfërve=fukarave. Të pasurit e kohës së sotme le ta mbledhin mendjen mir.

Ai njeri i pasur që nuk i jepë fukarait zeqatin=pjes nga pasuria e tij që i takon pjesë fukarait=të varfërit, ai njeri është hajduti i fukarait por dhe më i keq se hajduti se hajduti vjedh atje ku ka ndërsa njeriu që nuk i jepë zeqatin fukarait, vjedh atje ku nuk ka; vjedhë fukaran. Keni kujdes sot ju o njerëz të pasur se Zoti xh. sh. në këtë botë ngjarjet i përsërit si në ndonjë skenë teatri porë aktorët i ndryshon. Zoti xh. sh. e drejtoftë gjithë popullin për së mbari. Nga kjo dhe shumë dëshmi të tjera nga njerëzit e ndershëm vërtetohet se Enver Hoxha kishte lindur nga një nënë e babë besimtar të mirë, njerëz të ndershëm. Në një libër nga kujtimet e Enverit kam lexuar se ai tregon që babai i tij ishte fetar. Ai lexonte çdo natë librat e fesë që ishin me kapakë të shkruar me shkronja ngjyrë ari. Janë akuzat të rënda e shpifje të ulta ato që thotë Kastriot Myftari me shokë që për inate politike përqeshin dhe akuzojnë me shpifjet më të ulta Enver Hoxhën, prindët dhe familjen e tij. Akuzime të tilla janë në kundërshtim, jo vetëm me fenë por dhe në kundërshtim me etikën, me normat më elementare të sjelljes së njerëzve. Allahu xh. sh. thotë në Kuran; " Vërtetë ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pa fajshme, janë të mallkuar në këtë

botë dhe në botën tjetër, dhe ata i pret një dënim shumë i madhë. "S. Nurë =dritë.aj. 23. Megjithatë secili e ka për veten e tij. Një ditë do të japi llogari në Ahiret=në botën tjetër para Allahut xh. sh. Unë që shkrova këtë libër jam nga Tirana dhe kam qenë i persekutuar nga rregjimi komunist. Kam qenë afër dyzet vjetë kulak. Mua nuk më ka lidhur as fisi asë miqësia as vendi e as politika me Enver Hoxhën por feja ime Islami më bën të flas e të mbroj të vërtetën e të drejtën. E falenderoj shumë Allahun xh. sh. që më bëri njeri me mendje në kokë dhe nuk më bëri hajvan. E falënderoj Allahun xh. sh. që më udhëzoi në fenë e vërtetë Islame. E që e kishim fjalën më sipër tek Arshi Pipa, përse i takonë bindjes që kishte Enveri dhe parrullës që ai shfrytëzoi janë të vërteta këto fjalë që thotë Arshiu.

Gjithashtu Enver Hoxha nuk e ndërronte nacionalizmin me internacionalizmin pamvarsishtë politikës së tij në dukje internacionalist. Këtë që themi unë e vërtetoi qartë, hapur e bukur bashkëshortja e tij Nexhmije Hoxha e cila ishte nxënësjë dhe ndihmëtarja e Enverit. Kur Nato bombardoi Sërbinë ajo në një emision televiziv tha: "Mua më pyetën disa miq e shokë marksistë; A është kjo gjë në pajtim me teorinë e internacionalizmit? Unë tha ajo ju thashë atyre se lejohet kompromisi në rastë nevojë. Nuk mund ta mohojë atdheun tim për arsye të internacionalizmit. [teorisë komuniste=njeriut qytetarë i gjithë botës]. Përgjigje kjo e drejtë dhe e bukur. Vërtetë lejohet kompromisi kur është i dobishëm. Edhe Profeti Muhamed a. s. ka bërë kompromis me idhujtarët e judejtë [çfutë] kurë e ka dashur nevoja pa ndërhy në çështjet e fesë.

Nga të gjitha sa thashë kuptohet se Enver Hoxha nuk ka punuar që të triumfojë komunizmi por këtë teori e futi në shërbim të nacionalizmit, që të ndërtohej e fuqizohej vëndi i tij Shqipërija. Vëllezër besimtarë të Allahut xh. sh. ju duhet ta keni të qartë se kryetari i shtetit që komandon në mynyrë të pamvarur vjen në krye të kësajë detyre me caktimin e Allahut xh. sh. direkt ose indirekt sipas rrethanave e shkaqeve që i krijon vet Allahu xh. sh. që të përshtatet për vëndin dhe popullin, ashtu si e do dhe e meriton ai. Kuran thotë; " Edhe gjethi nga pema nuk bie pa dëshirën e Allahut xh. sh. " Kështu që pa dyshim, mbreti ose kryetari i shtetit vjen në këtë detyrë me caktimin ose vëndimin e Allahut xh. sh. Këtë na e bën të ditur Allahu xh.sh. në Kuran ku thotë; "Dhe pejegamberi i tyre

-[i dërguar nga Zoti për atë popull] ju tha; [popullit] se Allahu ka caktuar me të vërtetë Talutin si mbret=sundimtar për ju. Ata [parija e vendit] i than [atij]; Qysh mund të bëhet Taluti mbret mbi ne ndërsa ne jemi më të merituar se ai për të mbretëruar, gjithashtu ai nuk është i pasur. Pejgamberi [i asaj kohe] ju tha [atyre] Allahu e ka zgjedhur atë për mbret mbi ju. Atij i ka dhënë zgjerim në dituri dhe në trup [i ka dhënë dije të mjaftushme për të komanduar dhe trup të fort=të shëndetshëm] Allahu ia jep komandimin kuj të doi se Allahu është dhënës për së tepri dhe i ditshtëm plotsishtë." Unë mendoj: Pa dyshim Enver Hoxha me dritëhijet e tij ishte politikan i kompletuar, i caktuar nga Allahu xh.sh.për udhëheqës shteti, i posaçëm për këtë vend e popull. Ai sundoi plot 40 vjetë në këtë vendë. Dëgjoreshin nga disa njerëzve të vjetër në atë kohë këto fjalë kështu : Enveri do të qeverisi ose dyzetë dit ose dyzetë muaj ose dyzetë vjet. Disa njerëz kan thënë se thënja; "Kur të mbushet e dyzeta shihet qartë e vërteta" është thënje profetike. Por unë nuk e kam par të shkruar dhe nuk e di që kjo fjal është thënë nga Pejgamberi jonë a. s. Por për numrin dyzet ka disa thënje në Kuran e hadith; Në Kuranë tregohet se; dyzet ditë foli Allahu xh.sh. me hazreti Musain a. s. në Tur. S Bekare Aj 51. Pejgamberi a. s, me hadith ka thënë; Dyzet ditë rreshtë dielli do të lindi nga perëndo, dyzet vite bota do të rrij pa asnjë krijesë të gjallë, dyzet ditë rresht do të bjeri shi pa pushuar, para ringjalljes. Profeti Muhamed a. s, gjithashtu ka thënë; dyzet ditë mblidhet brumi i krijesës së secilit njeri si lëng në mitrën e nënës,pastaj për dyzet dit të tjera bëhet si gjak i gufutë, pastaj për dyzet ditë tjera bëhet një copë mish e pastaj i dërgohet një engjëll nga Allahu xh. sh. dhe i fryn shpirtin..." Trans Buhariu dhe Muslimi.

Në Kuranë gjithashtu Allahu xh. sh. thotë në suren Bekare se Ai i izoloi çifutët dyzet vite në shkretëtirën e Tihit. Shih S. Maide. Aj. 26. Edhe ne si popull këtu në Shqipëri si askush popull tjetër në botë ishim të izoluar plotsishtë dyzet vjet duke filluar nga viti 1950 - 1990 se para vitit 1950 e kaloje kollaj kufirin por askush nga populli nuk u mundonte të ikte nga Shqipëria me përjashtim të njerëzve për arsye politike. Për sa i takon Enver Hoxhës un them se ai është vërtet një figur historike e ndërlikuar. Nuk ka qenë Enver Hoxha as ashtu siç e kan menduar komunistët e as ashtu siç flasin anti komunistët. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha

me dije prej Zotit xh.sh. ka thënë të vërtetën. Ndoshta më vonë historianët e pa ndikuar nga politika mund ta vërtetojnë këtë gjë.

83-NJOFTIMI QË MORI PREJ ALLAHUT XH. SH. MUXHEDIDJA AISHE PËR ISH PRESIDENTIN RAMIZ ALIA DHE OPOZITARIN E TIJ POLITIK.

Disa vite para se të bëhet demokracia në vëndin tonë muxhedidja Aishe tha : Ishte një natë rreth vitit 1985-1986. Allahu i madhëruar më shfaqti mua para syve në ëndërr Ramiz Alinë bashkë me tre, katër shokë të tij në këmbë në një lëndinë pak të pjerrët. Duke qenë më këmbë un u ndodha ball për ballë me Ramizin thoshte murshidja Aishe rahmetullahi alejha. Në çastin që un fillova të bisedoj me Ramizin thoshte Aisheja, shokët e lan vetëm atë. Ata u ulën në tokë në atë lëndinë të pjerrët e duke u rrokullisur si fëmijët sa në njërin krah në tjetrin në atë lëndinë më humbën mua nga sytë. Un thoshte Aisheja pastaj iu drejtova Ramiz Alisë me këto fjalë : “Po për çështjen e fesë si do të ia bëni tani ? . Feja e mbron popullin nga çdo e keqe ” .

Muxhedidja Aishe tha se Ramizi menjëherë ra në gjunjë dhe tha : “ Po. Ke të drejtë ashtu është ” . Ky njoftim që më dha Allahu xh. sh. me anë të ëndrrës thoshte murshidja Aishe, tregon se Ramiz Alia është dashamirës i fesë por është i vetmuar, nuk ka përkrahje nga shokët. Po në ato çaste pas tij në krahun tjetër thoshte murshidja Aishe, më paraqiti Allahu xh. sh. para syvet, një njeri të ri në moshë, ishte me syze, ishte pak brun=i zeshkët në ngjyrën e fytyrës dhe flokët i kishte të zeza me dredha si kaçurrel që i kishin rën pak tek balli. Rreth tij ishin grumbulluar disa të rinjë, djemë e vajza. Ky njeriu i ri kur i fliste asaj turmës të rinjëve e ndryshonte dialektin e të folurit. Her fliste si nga jugu, nga Labëria, her si Tiranas e her si nga veriu si Shkodran.

Un tha Aisheja iu drejtova për ballë edhe këtij të riut dhe fillova ti flas për fenë, për mirësinë që i sjellë ajo popullit. Ndërsa ky i riu më tha: “Ti për fenë foli brezit të vjetër se unë këta [fjala ishte për të rritë] do ti çojë në drejtim tjetër. ” Muxhedidja Aishe rahmet past më thoshte se Ramiz Alia është njeri pozitiv për popullin, nuk është kundër fesë kundër moralit të shëndoshë por do ta lënë vetëm shokët, sipas asaj që mua më informojë Allahu xh. sh. në

ëndërr tha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Gjatë ngjarjeve që do të zhvillohen në të ardhmen tha ajo, do të dalë dikush nga politikanët e rinjë, kundër fesë=kundër edukimit të popullit me moralin fetarë. Allahu xh. sh. pë veprimet që bënë dhe do të bëjnë njerëzit në të ardhmen, në Kuranë thotë: "Allahu i di ata që punuan njerëzit më përpara dhe ata që do të punojnë më vonë." Sure Haxh. Aj. 76. Në Kuran thuhet: "Allahu është që i di të fshehtat [e njerëzve] në gjoksa." S. Hadidë aj. 6. Un them se pa dyshim u vërtetuan pas 6 ose 7 vitesh në kohën e demokracisë fjalët që më kishte thënë mua muxhedidja Aishe rreth vitit 1986, 1987. Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë. Në vitin 1990 kur ishte kryetar i shtetit Ramiz Alia, rinija filloi të hyjë nëpër ambasadat e huaja në Tiranë e në ata perendimore kryesishtë për të ikur jashtë Shqipërisë në kërkim të një jetese më të mirë. Pastaj valë të mëdha eksodesh [largimesh në masë i njerëzve nga vendi filluan në vitin 1991 e më prapa. Kjo ikje masive e popullit dhe kryesishtë e rinisë nga vendi i vet ishte nga varfëria e madhe si pasojë e dështimit të sistemit ekonomik socialist. E luftës së madhe të pa mëshirshme deri në gjën më të vogël që iu bë pronës private në Shqipëri.

84-NË SHQIPËRI U VENDOS SISTEMI POLITIK DEMOKRATIK.

Pas rënjes së diktaturës komuniste me ardhjen rregjimit demokratik, shumica e popullit ikën nga fshatrat dhe erdhën në qytete për një jetë më të mirë. U mbipopulluan = u tejmbushën qytetet e vendit tonë por më shumë qytetet e mëdhaja: Tirana, Durrësi, Shkodra, Vlora, Fieri Korça dhe Elbasani. Si pasojë e këtij mbi popullimi është i pamundur punësimi për të gjithë. Vendi tani është mbërthyer akoma më shumë me probleme sociale dhe e ardhmja duket pa shpresë për punësimin e popullit në qytet. Fillimi i ikjes së njerëzve nga fshati në qytet filloi që në kohën e rregjimit komunist nga që ai rregjim e luftoi në mënyrë të pa mëshirshme pronën private. Më të shumtët, fshatarët që ikën nga fshatrat e tyre në kohën e rregjimit komunistë ishin nga jugu i Shqipërisë. Ata erdhën në qytetet e mëdhaja Tiranë, Durrës Elbasan. Ata iknin kollaj nga fshatrat se nuk i pengonte kush pasi pushtetin qeverisës

e kishin në dorë njerzit nga jugu i vendit. Ata duke qenë të shumtit kuadro shteti tërhoqën njëri tjetrin në mënyrë masive se në këta qytete fillojë gjithashtu të ngrihet dhe industria. Shtëpitë atyre ja u jepte shteti gati. Ndërsa në kohën e demokracisë njerzit nga gjithë rrethet e vendit i braktisën shumica fshatrat dhe e erdhën në qytete për një jetë më të mirë. Popullsia e vendit është përqëndruar më së shumti në qytetet Tiran, Durrës, Elbasan, Shkodër, Fush Krujë e fshatrat rreth tyre. Kjo gjë solli pasoja të rënda sociale në popull. Un mendoj se kjo gjë erdhi prej disa shkaqeve por më kryesoret ishin: E para gjë ishte mos interesimi i qeverisë për ti lehtësuar e ndihmuar fshatarët me fonde financiare e rrugë automobilistike që ti shtojnë e ti tregëtojnë kollaj e me interes prodhimet e tyre dhe të jenë të kënaqur prej fitimeve. E dyta gjë ishte se në rregjimin demokratik njerzit u shpërngulën nga fshati në qytet në gjithë Shqipërinë për këto arsye. 1-Një pjesë e madhe fshatarësh u frikësuan nga parrullat fallco anti komuniste të rregjimit demokratik dhe ajo që i çorjento i shumë ishte rënja e figurës së Enver Hoxhës. Ata menduan se me shkatërrimin e socializmit do të kthehet përsëri koha e çifligarëve; bejlerëve e bajraktarëve të cilët i kishin pas dikur shumicën e tokave.

Kështu që fshatarët nga që nuk kishin tokë të mjaftushme e disa hiç fare menduan se do të punonin përsëri si dikur bujkë ose argatë tek bejlerët e bajraktarët, pamvarsisht se kjo gjë nuk ndodhi dhe nuk kishte si të ndodhte. 2-Ndërsa ato fshatarë që kishin tokë të mjaftushme kishin frikë se qeverija do ti shtrydhte përsëri si dikur në rregjimin komunist me plane e tatime=detyrime e taksa shtetërore dhe do vuanin më keq se ishin. Brezit ti ri i kishte treguar brezi i vjetër se dikurë kur ishin privat në rregjimin komunist, parrulla e taksa mbledhësve në atë kohë ishte kjo:“Ose planin ose jorganin.” 3-Injorimi ose përçmimi që i është bërë vazhdimisht fshatarit kudo në botë prej altoperlantëve të propogandës së keqe prej gojëve të liga të disa mendjehetëve e sharlatanëve, njerëzve të kafeneve, parazitë, alkolistë e bixhozëçij që ndodhen nëpër qytete, duke i ofenduar fshatarët e malësorët se gjoja ata janë injoranta që nuk dijnë se çka është jeta, se ç’ka është qefi. Jazëk u qoftë injorantëve të çdo kallëpi që akoma vazhdojnë ti ofendojnë fshatarët Por tani këta injoranta ju marrshin të keqen atyre se rinija e fshatit

dhe e malcisë e ndau mendjen top me u bë qytetarë dhe mos të mbjelli gjë më askush prej tyre në arë. Qeveritë pa fe kudo në botë nxisin e përhapin imoralitetin dhe krimin me medjat e ndryshme që kan në dorë. Ata nuk flasin më për virtutet e larta morale që duhet të paiset njeriu por bëjnë propogandë, flasin e këndojnë për maskarallëqet e batakçillëqet. Profeti Muhamed a.s. ka thënë: Njeriu që është besimtar dhe ushqen veten dhe familjen me djersën e ballit është i dashur te Zoti xh. sh ". Tobja në krye njisimin e Zotit xh. sh. në çdo gjuh është ilaçi i sigurt për të shpëtuar nga çdo e keqe populli jonë e të tjerët. Ky dhe vetëm ky është ilaçi i vetëm për shpëtim nga çdo keqe. Siç po e shohim, sot kudo, imoraliteti e alkolizmi ka marrë përpjestime të mëdhaja. Janë përhapur në masë në popull droga, vjedhja, grabitja, korrupsioni e krimi. Duhet të përkraket feja nga shteti pa rrezerva. Thuhet një fjalë popullore:

Më mirë vonë se hiç fare. Populli duhet të drejtohet në rrugën e Zotit xh. sh. të bëjë tobe. Mësusat e fesë ta njisojnë të parët Zotin e Madhrushëm=Allahun xh. sh. duke e pastruar veten nga shirku i madh që e bëjnë me gojë orë e çast dhe të bëjnë tobe=të largohen nga çdo e keqe që mund të ketë secili. Që të shërohet populli nga sëmundja e moralit, ata duhet të punojnë për fenë natë e ditë kudo në çdo vënd e shtëpi. Nëse e do dhe e kupton të mirën shteti duhet ti paguaj me rrogë mësusat e fesë, sikurse arsimtarët. Mësusët e fesë kanë të bëjnë me tre breza njerëzish; të rijtë, brezin e mesëm dhe të moshuarit. Mësimi i fesë duhet të futet në shkolla dhe në medjet vizive nëse na dhimsen fëmijët dhe vetja jonë. Nuk ka patriotizëm ose atëdhedashuri një rini që nuk edukohet me ndjeja fetare, që nuk beson në përgjegjësinë që do të ketë para Zotit xh. sh. në jetën tjetër pas vdekjes për sjelljet dhe veprimet e këqia që bën ndaj prindërve e fisit të vet, ndaj miqëvet e shokëvet dhe gjithë shoqërisë.

Populli jonë tani në kohën e demokracisë lajthiti më shumë nga mendja nga çdo pikpamje. Ai filloi ti thërrasë pushtetarët Zoti filan që me këtë emër të veçantë ky popull thërret Krijusin e Gjithsisë në gjuhën e tij . Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Janë disa prej njerëzish që në vend të Allahut besojnë (adhurojnë) disa gjëra të tjera (idhujt ose parinë e tyre) dhe ia bëjnë shembulla (shokë) Allahut. Sikur ta dijsim [ata] se gjithë fuqia=pushteti është vetëm tek Allahu dhe dënimi i tij është shumë i rreptë; atëherë (ata) do të

pendoheshin plotësisht. . . ”. S. Bekare. 165.

Idhujtarët para kohës së profetit Muhamed a. s. kishin zakon që kur bëjshin ose shikonin ndonjë idhull më të madh ose më të bukur e hiqnin dashurinë nga ai i pari dhe jepeshin pas idhullit të ri. Ndonjëherë bënin idhuj prej ëmbëlsirash dhe i merrnin atje ku shkonin e punonin me qëllimin që idhujt t’u ndihmonin atyre. Kur lodheshin ata pastaj i hanin idhujt e tyre që i konsideronin për zotër. Çudi! Ngjarjet në kohë të ndyshme ja përgjasin njëra tjetrës. Ateistët në kohën e sotme, hedhin një idhull dhe ngren një tjetër por kurrë në besimin tek Allahu xh. sh. nuk kthehen.

Pushtetarët ish komunistët sot janë bër shumë të pasur. Kumunistët e kuadrot tjerë jo komunistë të Partisë së Punës nuk duhet të harrojnë se dje ata ose baballarët e tyre, xhaxhallarët e dajallarët e tyre, vranë e persekutuan shumë njerëz në qytete e fshatra. Shumë familje të mesme fshatare i persekutuan vetëm për shkakun se ishin të pasur me nga një kalë dhe 50 deri 100 dylm tokë e punueshme e pyllë së bashku dhe se gjoja ata pasurinë e kishin vënë pa djersë por me zaptime mashtrime e rrëmbime dhe se nuk kishin menduar për popullin. Sigurisht që ka pasur nga ata, por jo të gjithë. Luftimet e familjeve të persekutuar nga rregjimi komunist në qytetet e fshatrat e Shqipërisë ishin nga të gjitha anët. Të persekutuarit jo vetëm që nuk kishin të drejtë vote e shkollimi veç arsimit 7 ose 8 vjeçarë por arriti luftimi i tyre deri aty sa që nuk donin për ti lënë që të shtoheshin me fëmijë e nipa, por përkundrazi ti zhduknin fare si klasë që ishin kundër rregjimit komunistë.

Organizatat e Partisë, komunistët bënin propagandë tek populli i thjeshtë që ata mos të bënin martesë me të persekutuarit nga rregjimi komunist sepse përndryshe do të kishin pasoja të këqia, do të merreshin masa të rënda kundër tyre njerëzve që jepnin vajzat tek kulakët e ish të burgosurit politik ose merrnin vajzat e tyre për djemtë e vet. Gjithashtu e keqja më e madhe ishte se rregjimi komunistë nëpërmjet veglave të tyre bënte propagandë që të persekutuarit mos të bënin martesë edhe me njëri tjetrin sepse do ta nxinin edhe më keq biografinë e tyre pasi kjo gjë do të thoshte se ata po lidhin miqësi me njëri tjetrin që të bashkohen kundër Partisë në pushtet=kundër rregjimit. Vërtet në atë kohë martesat ishin shumë problem për të persekutuarit. Me përjashtim të një pakice të vogël, shumica prej tyre ishin të detyruar të bënin miqësi nga halli vetëm

që mos të zhduken fare si fis. Të persekutuarit ishin të bojkutu= të izoluar nga të tjerët. Partija e Punës e ndalonte popullin që të shkonte në raste gëzimesh e hidhërimesh e deri në raste vdekjesh tek të persekutuarit. Në këto raste shkonin vetëm më të afërmit prej fisit dhe tek e tuk ndonjë njeri i singhtë që e ruante zakonin. Komunistët i luftuan dhe fisin dhe miqtë e të persekutuarve. Me anë të biografisë politike e ndanë dhe e përçanë popullin duke i hedhur të luftojnë njëri tjetrin. Ndoshta në të ardhmen Allahu xh. sh. do ta sjelli punën ndryshe. Kjo të mos ju duket çudi njerëzve. Nëse nuk bëjnë tobe edhe mundet të ndodhi ndoshta kjo gjë se Kurani thotë: ‘Ne e rrotullojmë triumfin [mes njerëzve] me rradhë. Sure. Ali Imran.aj.140. ’

Fjalën e kam për komunistët që ishin kuadro drejtuse e jo për ish puntorët e fshatarët e thjeshtë. Në Kuran Allahu xh. sh. e përmend biografinë e njerëzve të mirë dhe të lig duke treguar cilsitë e mira të besimtarëve dhe cilësitë e këqia të jobesimtarëve=qafirave e munafikëve=mohusave të Allahut xh. sh. Një nga cilësitë larta të besimtarëve është se ata kufrin=mohimin e kan frikë sukur djegëjen në zjarr thot profeti Muhamed a. s. Dhe që e kishim fjalën më sipër, ky luftim kaq i ashpër që ju bë shumë njerëzve të pa fajshëm nga rregjimi komunistë në Shqipëri prej bashkatdhetarëve të tyre ishte i pa drejtë. Kjo gjë nuk mund të harrohet nga ishë të persekutuarit e pa fajshëm, djemtë, nipërit dhe miqtë e tyre.

Sot ish komunistët dhe ishë kuadrot rëndësishëm të Partisë së Punës, fëmijët dhe miqtë e tyre të afërt janë bërë më të pasur se pasanikët e dikurshëm në kohën e mbretit Ahmed Zogu. Në bazë të ligjit të fesë edhe këta në rrugë të gabuar kan hyrë, por të shikojmë si do të zhvillohen ngjarjet në të ardhmen. Po e përsëris dhe njëherë fjalën e Allahut xh. sh. i cili thotë në Kuran : “Ne e rrotullojmë triumfin [mes njerëzve] me rradhë”. S. Ali Imran. Ajeti. 140.

Pasanikëve të sotëm ju është rritur shumë mendja. Ata mendojnë se nuk kan nevojë për fenë. Edhe këta ashtu si pasanikët e dikurshëm indirektë po e mësojnë popullin që ti thërrasin ata zotër, estagfirullah ashtu siç i thirrën parinë e vendit; zyrtarët e shtetit, pasanikët dhe tregtarët e mëdhenj në kohën e mbretit Ahmed Zogu. Por këtu kemi një ndryshim se paria e vendit në kohën e tij nuk ishin të iformuar për këtë krim ndaj Allahut xh. sh. ndërsa sot janë të iformuar njerëzit këtu. Ky krim ndaj Zotit të madhrueshëm=

ndaj Allahut xh. sh. është përhapur tekë të gjithë popujt e botës se me atë emër që thërrasin Krijusin e Gjithësis = Zotin xh. sh. po thërrasin dhe njeriun. Sot është koha e dexhalit=koha e dexhalëve=mashtrusave të mëdhej. Kështu ka vepruar dikur Firauni në Egjiptin e lashtë, që pretendoi se ishte Zoti estagfirullah dhe donte që kështu ta njihte e ta thirrte populli atë. Allahu xh. sh. i ruajtë në çdo kohë besimtarët e vet. Veç këtij krimi të pafalshëm ndaj Zotit xh. sh. që po bën populli shqipëtar, ai futi dhe lekët me fajde me mashtrimin dhe nxitjen që i bënë politikanët e rrafinuar komunistë, ata më të zjuarit, më marifetçijtë. Kështu që ky popull vrau vehten me duart e veta. Në fakt një pjesë e popullit lekët i kishin fituar me djersë=hallall por ju bënë haram se i dhan me faiz=me fajde. Ndërsa pjesa tjetër i kishin fituar pa derdhur mund e djersë=i kishin fituar haram në bazë të ligjit të fesë pasi kush ishin më të fortit e më hileqarët, vodhën pasurinë e përbashkët duke shfrytëzuar situatën. Mirpo ka hileqar të zgjuar, por ka dhe më të zgjuar. Shëndetin këtij populli ia mori rregjimi komunist duke punuar si kali e duke ngrënë si miu. Një pjese prej të persekutuarve më parë i morën edhe lekët edhe kokën. Ndërsa tani në regjimin neokomunist “demokratik” këtij populli të pa bindur ndaj Zotit xh. sh. komunistët me ndryshimin që i bënë regjimit po i marrin këtij populli të pa bindur edhe pasurinë edhe imanin=besimin. Kuadrot e Partis së Punës e futën në dorë krejtë pasurinë e përbashkët të shtetit të regjimit socialist se ata e kishin në dorën e tyre letrën dhe vulën. Kuadrot e Partis së Punës në rregjimin demokratik u bënë me njëher të pasur ashtu siç u bënë Brenda një nate demokratë. Disa nga këta e quajtën veten socialistë por në fakt nuk ishin socialistë por specialist. Ata u bënë kapitalistë me biznese nga të gjitha llojet deri tek pronar të mëdhej tokash në fshatra. Komunistët formuan dhe shumë parti të tjera me emra të ndryshëm që numri i tyre arriti mbi 50 e ca parti me një popullsi prej 4 milion banorësh e që çereku jetojnë jashtë Shqipërisë.

Gjith populli punojnë për këto parti të ndryshme të cilat kanë dalë nga gjiri i Partis së Punës. Nga këto parti, katër janë të mëdhaja. Ndër këto parti, dy janë që qeverisin së bashku. Një her i prin përpara popullit njëra e herë i prin tjetra. Sa her që ndërrojnë radhën e qeverisjes këto dy parti, populli luftojnë njëri tjetrit për ta hequr nga puna duke spiunuar tekë partia e tij që vjen në pushtet se filani nuk është me partin tonë. Kështu që dhe sot po vazhdo përsëri lufta e klasave si më parë, por tani

brenda klasës puntore e fshatare. Pushtetarët e vendit janë ish komunistët, fëmijët e miqtë e tyre. Ata janë të bashkuar ndërsa popullin e kan përçarë. Sot pushtetarët qeverisin më kollaj se dje. Ata shetisin, hanë e pine, pa e lodhur mendjen për popullin . Qeverija e ka për detyrë të ruaj jetën dhe pronën e populli të vet e të mbajë drejtësi mes njerzish. Ndërsa këta qeveritarë një her në muaj i tregojnë popullit nga një përrallë të lezeçme siç ia ka qefi atij. U lodhën analistët e politikës, sazet e politikanvet duke i analizuar fije për fije rrenat e politikanvet për ta hutuar popullin. Ndërsa populli i dëgjon me kureshtje ata kur diskutojnë përse kalorsit i shëlaren këmbët. Kështu po e vazhdojnë me rradhë lojën politike dy partitë e mëdhaja të cilat bëjnë sikur janë të ndara por në realitet janë të bashkuara. Një her e merr në dorë qeverisjen njëra parti e her e merr tjetra, sipas dëshirës së popullit të hutuar por ata qeverisin së bashku. “Karrocës” nuk i zvoglohet pasha e ngarkesës edhe se i ndërrohen kuajt asaj. Për njerzit. Për njerzit që nuk janë besimtar, Allahu xh. sh. në Kuran thotë: “Juridune en jetehakemu ilet taguti...= Ata duan si arbitër [tua bëjë gjyginj =tua ndaj të drejtën nga jo e drejta taguti [djalli më i rrezikshëm nga rraca e djajvet]”. Gjithashtu Kurani thotë: “Njerzit me veset e djajvet janë më të rrezikshëm se djajtë prej xhindësh”. Tani në Demokraci pushtetarët ish komunist po i thonë indirekt popullit kështu : Çfar keni dashur e merituar ju, ne jua kemi bërë juve. “Çka do populli bën partia” ishte dikurë parrulla e Partis së Punës së Shqipëris. Sipas kokës të vente Partia qeleshen. Edhe tani në Demokraci kjo gjë është. Tani ish komunistët me parti të shumta që i formuan vet, po i thonë popullit : Na thirrni neve tani Zoti e Zotnia, Zotnesha e Zotnusha ashtu siç i thirrret dikur pasanikët e kohës së mbretit Ahmed Zogu. Estagfirullah. Allahu xh.sh. i ruajt besimtarët e Tij nga fjalët e kufrit. Me këtë veprim komunistët tani në Demokraci e çuan popullin nga ateizmi në politeizëm. Nga mohimi i Zotit xh. sh. e çuan në njohjen e shumë zotave. E çuan tani popullin në një idhujtari bashkohore që njerëzit sot mos ti thyrin më Zoti idhujve=pikturave e skulpturave por të dëshmojnë me gojën e tyre për Zot njeriun që është me pushtet dhe pasuri. Estagfirullah. Kështu që përse i përket anës fetare populli ynë nxorri njëren këmbë nga balta dhe futi këmbën tjetër. Allahu xh. sh. jua ndriçoftë mëndjen besimtarëve të sinqertë që ta ruajnë gojën nga ky shirk i madh= nga ky krim i madh ndaj Tij duke mos i thirr më kurr paris së vendit e askujt tjetër Zoti, Zotnia, Zotnesha ose Zonja e Zonjusha kushdo qofshin ata të djathtë e të majtë, të pasur e të varfër, hoxhallarë e priftërij. Për ndryshe duhet ta din mir o popull se pa dyshim jeni të humbur në dy botët. Bëni tobe o njerëz të gjithë sa jeni . Allahu xh.sh. i ruajt besimtarët.

Allahu xh. sh. iu thotë besimtarvet në Kuran kështu: “Keni frikë Allahun po qe se jeni besimtarë”. Për ata që nuk janë besimtarë Allahu xh. sh. thotë: “Argumentet dhe qortimet nuk bëjnë dobi ndaj një populli që nuk beson”. S. Junus. Aj. 101. Allahu xh. sh. i drejtoftë të gjithë nga e mbara ato që kan besim tek Ai. Populli me nxitjen e djajvet prej njerëzish nga jashtë e nga brënda dogji e shkatërrojë vendin. Vranë e po vazhdojnë të vrasin njëri tjetrin. Sipas të dhënave vetëm tani në demokraci u tha se janë vrarë rreth 5500 njerëz dhe gjithnjë po vazhdojnë vrasjet. Allahu xh. sh. thot në Kuran: “Zoti yt nuk i shkatërron padrejtësisht vëndet nëse banorët e tyre janë punë mirë”. S. Hud. Aj. 117. Populli përsëri tani nuk di se çfar thotë se çfar bën, se çfar kërkon dhe ku po shkon. Nuk ju bie ndërmend fare se çdo gjë e ligë që ju ka ardhur, është pasojë e daljes nga rruga e Zotit xh. sh. e largimit nga mësimet e fesë me të cilën njerëzit bëhen të lumtur në dy botët. Allahu xh. sh. i drejtoftë për së mbari. Sot në sistemin demokratik, të këqiat u shtuan akoma më shumë e sidomos imoraliteti. Imoraliteti [kuvërija] në Shqipëri filloi të ndihet mjaftë në popull në kohën e Zogut, u përhap shumë në kohën e pushtimit nga Italia fashiste, mori hov të madh në regjimin komunist dhe shpërtheu krejtësisht dhe arriti kulmin në regjimin demokratik. Në regjimin demokratik u shtuan akoma më shumë alkolicizmi, imoraliteti e vjedhja. Tani në këtë u shtuan dhe 4 të këqia të tjera, droga, krimi, lojrat e fatit dhe korrupsioni që nuk ishin në rregjimin e kaluar komunist. Krimet sot po shtohen çdo ditë e më shumë. Askush nuk është sot i sigurt për jetën e tij. Tani në vitet 2011- 2012 rinia ka filluar në masë të madhe të përdori drogën. Së bashku me të po lindin pedofilija dhe vetvrasjet. Populli ynë në përgjithësi por rinia krejtësisht sot po bëjnë gara me njëri tjetrin se kush e kushë të bëhet ma i poshtë, më intrigant e i pa besë se tjetri. Kush e kushë të bëjë më shumë horrligje, pisllogje grindje, vjedhje e krime. U vërtetua lajmi që mori prej Allahut xh.sh. murshidja Aishe rreth vitit 1984 që ishte: “Tani po vjen [në botë] brezi i njerëzve të prishur”. Ishte fjala të prishur nga shpirti, nga mendja e nga morali njerëzit që do vin pas këtyre viteve deri në fundin e botës që do të jet në këtë shekull që jemi [në shekullin 21 njëzet e një]. Me kalendarin hënor= Hixhri brënda vitit 1500 që i takon brenda 56 viteve të këtij shekulli që jemi sipas lajmit që ka marrë prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. Por se kur në çfar viti prej këtyre 56 viteve do të bëhet kijameti, a tani afër apo pak vite më vonë nuk e din askush

tjetër veç Allahut xh.sh. Në kuran thuhet se kijameti do të vi befas = pa e diktuar askush. E që e kishim fjalën tek morali, dikurë nga ky popull njerëzit bënëin gara me njëri tjetrin për punë të mira në shërbim të fesë e atdheut. Dy cilsitë e mëdha morale me të cilat dallohen njerëzit nga kafshët të cilat janë turpi dhe mëshira po zhduken tani çdo ditë që vjen tekë të rijtë kudo në botë. Njeriu pa turp e pa mëshir nuk len gjë të keqe pa bërë. Këtë gjëmë të madhe ja solli botës laicizmi e ateizmi duke ju prishur mendjen e moralin miljona e miljona njerëzve në gjithë botën. Sot në gjithë botën ateistët=dexhalat=mashtrusat e mëdhej e të fuqishëm ushtarakishtë me parrullën fallco: “Për të drejtat e njeriut” po e shkatrojnë deri në themel moralin njerëzve në mbarë botën. Ata po i bëjnë presione të ndryshme e deri në kërcënim me ndërhyrje ushtarake gjithë qeverive që qeverisin me ligje fetare ose ligje të mira kombëtare që të qeverisin me ligje anti morale kundër moralit të shëndoshë, me ligje këqia e të pa drejta që të përhapet, krimi, prostitucioni pa drejtësia, korrupsioni e njëmij të këqia të tjera. Me ligjet që ju propozojnë ata këtyre, hapet rruga e së keqes plotsishtë. Ata qeveri ose kryetar shtetesh që kundërshtojnë, ndëshkohen prej tyre .Dexhalat e mëdhenj [mashtrusat e rafinuar] sot ia kanë arritur qëllimit të tyre që është: Shkatrimi i moralit të popujve në gjithë botën. Për këtë gjë ata kanë filluar të punojnë që me ndarjen e fesë nga shteti. Për t’ju kundërvënë fesë, nxitën nacionalizmin. Për t’ju kundërvënë nacionalizmit shpikën komunizmin dhe për t’ju kundërvënë komunizmit, nxorrën demokracinë e cila siç shihet është liri pa kufië, pa norma morali. Kjo koh sot është koha e dexhalit për të cilën Pejgamberi a. s. ka thënë : “Sprova më e madhe për besimtarët e Allahut xh. sh. është koha në të cilën do të sundojë kudo në botë dexhali [dexhalat ”. Dexhali ose shumës dexhalat janë ateistët e çdo ngjyre shkalle e rangu. Allahu xh. sh. i ruajt besimtarët nga ngatrrerat e dexhalvet. Allahu xh. sh. i drejtoftë në rrugën e drejtë të gjithë njerëzit për nder të dërguarit të Tij Muhamedit a. s. Amin vel hamdu lil-lahi rrab bil alemijn.

85- MURSHIDJA AISHE DHA MENDIMIN E SAJ PËR ISH PRESIDENTIN DHE MË VONË KRYEMINISTER I SHQIPERIË SALI BERISHA

Në kohën kur Sali Berisha erdhi në krye të shtetit si president i Shqipërisë, muxhedidja Aishe që Zoti xh. sh. e mëshiroftë, tha për Sali Berishën këto fjalë: "Saliu është njeri i drejtë. Ai nuk është fajtor për asnjë gjë të keqe që ka ndodhur në vëndin tonë. Fajet i kan të tjerët, por Saliu nuk është i aftë për atë detyrë ku është. "Nga kjo fjalë e saj kuptohet se Sali Berisha është nga ata të pakët njerëz që janë bërë kumunistë pa dëshirë por ka qenë i detyruar nga ndonjë hall i madh dhe e dyta gjë që kuptohet është se nuk ka tjetër tani më të mirë se ai. Me që është i drejt siç tha muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha njerëzit duhet ta dinë se Allahu xh. sh. në Kuran i urdhëron kështu besimtarët; "O ju që besuat ta keni në kujdes Allahun dhe të jeni me ata të drejtit. "S. Tobe-Kapitulli Pendimi.

Fjalën që tha murshidja Aisheja rahmetullahi alejha për Sali Berishën ajo e foli në fillim të detyrës së tij politike. Ndërsa un mendoj që Saliu tani, ia ka marrë mir dorën punëve të shtetit. Un personalishtë nga vetja ime themë se Sali Berisha ndjekë politikën e Skënderbeut. Ai është laik nuk merret me fenë por vetë ai e beson Zotin xh. sh. dhe këtë gjë ai e ka deklaruar vetë në televizor. Saliu nuk di gjë nga dituriya fetare, por vetëm që ai e beson Zotin xh. sh, është besimtarë. Fjalën që thash un se Saliu nuk ka dije fetare e kuptova mirë nga kjo thënje që dëgjova nga një besimtarë rastësishtë kështu për të. Ai më tha se Sali Berisha në një miting si shumë herë që thoshte fjalët lavdi Zotit dhe Zoti e ruajtë Shqipërinë, atë ditë ai bërtet e thotë: Rroftë Zoti. [xh. sh.] Kur kishte mbaruar mitingu këshilltarët i kishin thënë gabove o Sali në fund të fjalimit. Saliu iu thotë atyre; përse gabova? Ato i kishin thënë gabove kur the fjalën rroftë Zoti [xh. sh.] Saliu iu thotë atyre; un nuk kam thënë gjë të keqe kam thënë fjalë të mirë për Zotin. [xh. sh.] Këshilltarët kishin qeshur dhe i kishin thënë atij: Fjala që fole ti është në kundërshtim me fenë. Nuk thuhet rroftë Zoti [xh. sh.] se Zoti [xh. sh.] është i

pavdekshëm. nuk vdes Zoti xh. sh, por thuaj gjithmonë lavdi Zotit [xh. sh.] Saliu u kishte thënë harrova se nuk po mundem ti mbajë të gjitha tani në mëndje. Por un themi mjafton që Saliu ka qëllimin e mirë për vëndin dhe popullin, ai beson në Zotin xh. sh. si pas deklarimit që ka bërë vetë në televizion. E tregova dhe këtë gjë për të vërtetuar fjalën e murshides Aishe rahmetullahi alejha që tha se Sali Berisha është njeri i drejtë=i sinqertë por nuk ka aftësi për postin ku është. Por sikurse e thash më sipër, tani Saliu ka fituar shumë përvojë. Ai ka mësuar shumë. Zoti xh. sh. e ndihmoftë në punët e mbara për të mirën e vendit. Dhe që e kishim fjalën më sipër tek politika, populli jonë me politikën e Skënderit thonë se jan mësuar por thon: inshallah Saliu nuk ndjek politikën e Enverit. Saliu është njeri i zgjuar e me kultur. Ai dhe kur shprehet për Enver Hoxhën e cilson atë vetëm me fjalën diktatori. Kjo fjalë është e vërtetë që thotë Saliu se Enveri thoshte: Këtu në Shqipëri sundon diktatura e proletariatit. Ky thoshte ai është shteti i diktaturës së proletariatit. Kryetari i shtetit ishte vetë Enveri. Kështu që Saliu nuk po thotë ndonjë gjë të shpikur për ta ofenduar Enverin, por po thotë veç se të vëtetën Inshallah Sali Berisha do ta njisojë Zotin xh. sh. do të largohet nga shirku=krimi kundër Zotit xh. sh. duke mos i thënë më askujtë nga njerëzit Zoti ose Zotni filani, dhe të mos pranoi që të tjerët ti thonë atij ashtu. Të gjithë besimtarët të përdorim shprehjen e bukur apo tiullin e bukur; i nderuari filani: Të nderuar dhe të nderume, Të nderuar vëllezër e motra bashkatdhetarë e bashkëatdhetare. Thonë populli se Saliut i pret timoni i drejtimit të politikës shtetërore krejtësishtë majtas. Un them se pa dëshirën e tij.

Mendoj që e kan fajin shokët. Ai nuk ka shokë të mirë. Sigurishtë mendojë un, i nderumi Sali Berisha është i mendimit për një shtet social pasi Saliu është nga ata njerëz që do të mirën për të gjithë popullin pa dallim. Ai do të mirën e përgjithshme. Kjo gjë u duk qartë kur Saliu nxorri ligjin me numër 7501 për tokën me të cilin ai ribëri përsëri me këtë ligj reformën agrare sç e bëri Partia e Punës me në krye Enver Hoxhën në vitin 1946. Edhe Sali Berisha me këtë ligj nuk jua ktheu më tokat ish pronarëve të vjetër, që të shumtat i kishin pasur dikurë Bejlerët e Bajraktarët dhe jua dha atyre njerëzve që nuk kishin pasur tokë fare.

Un mendoj se këtë gjë ai e bëri me qëllimin që të kishin mundësi

të ushqeheshin gjithë populli pa dallim. Mirpo sot problemi qëndron ndryshe. Në kohën e Enverit tokat e të pasurve që i morën fshatarët nga reforma agrare nuk i lejonte shteti komunist që ata ti shitnin ndërsa tani fshatarët pa tokë me ligjin 7501 përfituan tokë nga tokat e ish pronarëve dhe e shitën tokën që ju dha shteti demokratik me ligjin që nxorri dhe u banë milionera. Tokat dhe pronat sigurisht i bleu kasta komuniste, fëmijët dhe miqtë e tyre të cilët i bënë lekët me korrupsion duke vjedhur shtetin dhe popullin. Të tjerët i morën tokat me zaptime me forcë. Kështu që toka ndërroi pronarët nga të vjetër në të rij. Tani u bënë pronar inteligjenca komuniste. Por e keqëja më e madhe është se vendin e ish pronarëve ose feudalëve të mëdhej të tokave si Shefqet Bej Vërlacit, Ali Bej Këlcyrës, Abdi Bej Toptanit, Omer Bej Vrionit po e zën dhe grekët dhe grekofilët të ndihmuar nga Greqia dhe italianët e italianofilët të ndihmuar nga Italia. Ata kanë blerë e vazhdojnë të blejnë toka më shumë në Shqipërinë e mesme. Miljarderat e sotëm në përgjithsi në Shqipëri veç tokave të shumta, ata kanë futur në dorë shumë prona e biznese të ndryshme. Ata kanë fabrika e punishte. Merren me tregtimin e mallrave të mëdha që marrin nga jashtë. Un them: Çdo gjë ndodhë me kaderin=caktimin e Zotit xh. sh. i cili do që ti provojë njerëzit se çfar do të bëjnë ata me dëshirën e tyre e kështu ata ti shikojnë e ti njohin mir veprimet e njëri tjetrit në këtë botë që vazhdimisht rrotullohet. Të shohim si do të zhvillohen ngjarjet në të ardhmen. Allahu xh. sh. është dijtës i të fshehtës. Ai ka paralajmëruar në Kuran kështu:

Ky ishte takimi im i par dhe i fundit me murshiden Aishe rahmet past pasi un shumë shpejtë ika pastaj për stududjime Islame në Kajro të Egjptit. Vërtetë Aisheja ishte njeri me autoritet megjithse në moshë të vjetër. Naim Leci është i bindur plotsisht me argumente nga Kurani e hadithi për detyrën që kryente murshidja Aishe rahmetullahi alejha. Naimi tha se e kam par të shkruar se dijetarët Islam kan thënë se inspirimi=frymëzimi prej Allahut xh.. tek njerëzit e Tij të dashur ka vazhduar dhe pas Pejgamberit a.s. Gentijan Hoxha nga Tirana i cili ka mbaruar medresen në Tiran në praninë time tha: Ata që thotë Aisheja janë të vërtetuar me Kuran. Çështja e Tobes me kushtin e par largimin nga shirku është e vërtetë, është e drejtë por nuk ju mbushet mendja njerëzvet sot. Allahu xh. sh. e qëndroftë në besim duke e ruajtë nga shirku me gojë Gentin.

Ndërsa Qazim Selimaj nga Dibra fshati Trebishtë i cili ka mbaruar studjimet e larta për sheriatin= ligjin Islam në univrsitetin e Riadit në Arabinë Saudite tha këto fjalë : Un e kam takuar Aishen për her të parë në fillimin e demokracisë pasi un banoja në Tiranë. Mua më foli për Aishen, ish shoku im i punës Haxhi Ymer Aga, me të cilin punonim bashkë në atë kohë në ndërtim. Ai ishte i pari që më foli në fillim për Islamin dhe ishte shkaktari që un bëra tobe, u riktheva në mënyrë praktike në Islam familjerishtë. Tobja është e vetmja mënyrë për të shpëtuar nga të këqiat në këtë botë dhe tjetrën. Pak muaj pas ardhjes së demokracisë, Haxhi Ymer Aga më orjento i mua që të shkoja ta takoj Aishen. Ajo më foli vet mua për çështjen e Tobes tha Qazimi. Për her të dytë kam shkruar te shtëpia e Aishes i shoqëruar me një hoxhë nga Tetova i quajtur Ejub Selmani që ne të rihtë e thërrisnim për respektë Sheh Ejubi. Ai erdhi tekë Aisheja me gruan e tij. Aisheja rahmet past na foli për rëndësinë e tobës, duke na thënë se ishte e urdhëruar me këtë shërbim nga Allahu xh.sh. Kushtet për të cilat fliste ajo për toben ishin krejtësisht nga Kurani thoshte Sheh Ejub Selmani. Shkëmbyem pak fjal me të dhe u larguam tha Qazimi. Në atë kohë un akoma nuk kishim studiuar për fenë Islame. Përsa i takonë çështjes së largimit nga shirku me gojë dhe njisimit

të Allahut xh. sh. në gjuhën shqipe dhe në çdo gjuhë tjetër, un jam dakort me atë që tha Aishja. Për shirkun ka argumente në Kuran e hadith tha Qazimi. Gjithashtu edhe vet mendja po të arsyetohesh nuk të lë që ta thërrasësh njeriun me atë emër që në atë gjuhë thirret Allahu xh. sh. tha ai.

Në këtë gjuhë ne me këtë emër thërrasim Allahun xh. sh. Në gjuhë e në kombe të ndryshme njerëzit i ka ndarë vetë Allahu xh. sh. Ndërsa për pyetjen se a është Aisheja nga muxhedidët e dërguar me shërbimin e tobes apo jo? Un nuk mund të them as jo e as po tha ai, por themë Allahu xh.sh. alimul gajb=llahu xh.sh. e di të fshehtën. Un nuk e shaj dhe nuk kam përse ta shaj Aishen tha ai se ajo ju bënte thirrje njerëzve për tu larguar nga punët e liga= nga haramet. Un them si për çdo besimtar tjetër lutjen Allahu xh. sh, e mëshiroftë atë. Në ato dy takime që pata un me Aishen rahmet past, themë vetëm kaq për të: Aisheja ishte grua besimtare e vendosur e zjuar dhe me autoritet.

“Vërtet Qazim Selimaj nga fshati Trebishti i Dibrës i cili banon në Tiranë nuk bën më shirk dhe nuk i përdor termat gjuhësore që bëhet me to shirk kur flet e shkruan. Kjo është gjëja më e rëndësishme për të. Allahu ia shtoftë diturin. Qazimi është njeri i zgjuar dhe besimtarë i sinqertë. O ju nxënës të dijes keni kujdes, mos u ngutni. Mos folni pa u menduar se ngutja është vesi i shejtanit=djallit të mallkuar. Ju o besimtar mos mendoni për muxhediden Aishe ashtu siç mendoni për disa gra mashtruse që dalin në kanalet e televizorëve dhe secila nga ata thotë se jam e dërguar nga Zoti xh. sh. Jo, jo nuk është si ata murshidja Aishe.Muxhedidaja Aishe ka fakte. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Ata që i përgënjeshtrojnë faktet tona, ata i kap dënimi ...”S.En-Nam.aj.49. Ndërsa këto gra munafike i nxjerrin sot në televizor qafirat që merren me politikën me qëllim për ti çorjentuar besimtarët që ata mos ta besojnë se muxhedidja Aishe është vërtetë e dërguar prej Zotit xh.sh. Ata duan ta mbulojnë të vërtetën me të pa vërtetën ashtu siç doli dikur para popullit në kohën e Profetit a.s. i quajhuri Muselejme Kedhabi i cili ju thoshte njerëzve: Edhe un jam i dërguar nga Allahu xh.sh. ashtu si Muhamedi a.s. Ateistët që merren me politikën përdorin veglat e tyre munafikët e munafiket për tu prishur mendjen besimtarëve të Allahut xh.sh. duke i ngatërruar ata që mos ta kuptojnë të vërtetën.

Qëllimi i tyre është ti çorjentojnë besimtarët për ti përçarë që ata mos të jenë të bashkuar me një mendim. Dexhalat [mashtrusat e mëdhej] me veglat e tyre të bindura munafikët po i përçajn besim-

tarët e Allahut xh. sh. në çdo vendë të botës, duke i ndarë ata në grupe të ndryshme fetare me qëllim që muslimanët mos të jenë të bashkuar. Ndërsa Allahu xh. sh. ju thotë muslimanëve në Kuran: “La teferr- rreju”=Mos ndahi e mos përçahi. S. Ali Imran. aj. 103. Allahu xh. sh. nuk i lejon muslimanët që të ndahen në grupacione të ndryshme. Ai thotë: “Mos bëhi [o musliman] si idhujtarët që e përçan fenë e tyre dhe u ndan në grupe dhe secili grup i gëzohet ides së vet [kënaqet me mendjen e vet sipas asaj që ka mësuar]”. S. Rrum. aj. 32. Veç munafikvet, fenë Islame po e dëmtojnë shumë edhe disa hoxhallar me dije gjysmake = të pa thelluar në dijen e fesë. Pejgamberi a. s. ka thënë: “Un kam frikë se ymetin tim [popullin] do ta prishin më shumë ata që paraqiten si dijetarë feje [pseudo dijetarët që fshihen me petkun e fesë me paraqitjen e jashtme e me diploma] dhe dijetarët=ose hoxhallarët me dituri gjysmake se sa dexhalat = mashtrusat e mëdhej të pa fetë.”

O ju vëllezër besimtar: Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ka fakte me argumente të shumta e të çdo lloji sikurse i shikoni në këtë libër që vërtetojnë pa dyshim se kjo murshide ishte vërtetë muxhedide e dërguar nga Allahu xh. sh. me shërbimin e thirrjes së popullit në Tobe Istigfar Kjo thirrje për tobe=për pendesë e rikthim sinqerisht në fenë e Allahut xh. sh. është për të gjithë ymetin e Muhamedit a. s. në mbarë botën.

89-ALLLAHU XH. SH. E NJOFTOI MURSHIDEN AISHE RAHMETULLAHI ALEJHA PËR CERMONINË E VARRIMIT TË SAJ.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha. më tregoi mua se Allahu xh. sh. asaj i kishte treguar me anë të rrujasë=ëndërrës, pamje nga dita e varrimit të sajë, momentet kur ajo do të dilte nga shtëpia. Ajo më tregoi kështu ; “Hajër inshallah më shfaqti Allahu xh. sh, tha mbrëmë në ëndërr një pamje sikur unë kishim vdekur, dhe tek porta e shtëpisë time ishin mbledhur shumë njerëz, burra dhe gra. Në ato çaste doli arkivoli im, që e mbanin me duart lartë. Arkivoli sipër ishte i mbuluar me një pëlhurë-guverte me ngjyrë jeshile dhe i shkruar me ajete Kurani në gjuhën Arabe. Në ajër rreth arkivolit, kishte shumë xixa të bukura të vogla prej nuri me ngjyra të ndrysh-

hme. "Kjo shfaqëje tha murshidja Aishe është sinjal ose ndryshe paralajmërim që vdekja mua po më afrohet dhe mynyra e varrimit është e projektuar nga Allahu xh. sh. sikurse e pash në ëndërr. Por un çuditem tha ajo me guverten e shkruar me shkronja arabe që ishte sipër arkivolit tim. Në këtë vend e situatë politike që jemi ne këtu sot, nuk të lënë ti mbash as brenda në shtëpi gjërat simbolike të fesë e jo më në dukje jashtë. Por dhe sikur të lënë ne këtu nuk kemi pëlhura e guverte të shkruara me ajete Kurani në gjuhën arabe. Un i thash asaj hajër inshallah=që do të thotë mirësi në dashtë Zoti xh. sh. Me kaq ajo e mbylli bisedën. Kjo bisedë me murshiden Aishe ishte në vitin 1986. Pasë 12 vitesh në qershorë të vitit 1998 u vërtetua plotsisht ëndrra e murshides Aishe qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej asaj. Në vitin 1993, 1994 filluan të vin shoqata të ndryshme fetare nga vendet arabe për të dhënë ndihmesën e tyre për ndërtimin e xhamiave dhe për të përhapur në popull mësimet e fesë. Arabët ndihmuan nga ana financiare për botimin e librave fetarë.

Ata sollën dhe panaroma e pëlhura të shkruara në to ajete Kurani në në gjuhën arabe. Ditën e varrimit të Aishes rahmetu-llahi alejha, dikush nga besimtarët kishte gjetur diku në një shoqatë një guvertë të madhe me ngjyrë jeshile të shkruar arabishtë mbi të ajete nga Kurani dhe e kishin hedhur sipër arkivolit të Aishes rahmetullahi alejha. Vërtetë xhenazja e saj kishte shkëlqyer jashtëzakonisht më than të pranishmit se un vet nuk isha në varrim pasi nuk dija gjë për vdekjen e saj. Un isha para tre ditëve dhe nuk e kuptova që ajo do të vdiste aq shpejt. Njerzit që kishin qenë aty kur kishte vdekur muxhedidja Aishe nuk e dinin as shtëpin e as numrin e telefonit tim që të më lajmëronin mua për vdekjen e saj. Siç e thash më parë, 7 muajt e fundit të jetës, murshides Aishe i shërbeu me shumë kujdes e respektë nënë Xhemilja nga Peshkopija, gruaja e Hafiz Tahir Salkurtit nga fshati Rashnapojë. Nemazin e xhenazes asaj ia fal ish nënkryetari i komunitetit musliman të Shqipërisë, Ramazan Rusheku dhe ish myftiu i Kavajës Jusuf Salkurti. Në varrimin e saj morën pjesë shumë besimtar nga Tirana, Durrësi, Dibra por më shumë ishin nga Kavaja. Dëgjova se nga Kavaja kishin ardhur dy autobuza me besimtar me myftiun Jusuf Salkurti në krye i cili i kishte paguar vetë autobuzat. Ndërsa shpenzimet e varrimit i kishte paguar besimtari Skënder Gazheli nga Kruja me banim në Tiranë i cili i kishte dhënë besën muxhedides Aishe për njësimin e Allahut xh. sh. dhe e kishte mbajtur. Pa dyshim ishte vërtet paralajmë-

rim prej Allahut xh. sh. kjo që më tregoi mua dise vite më parë
muxhedidja Aishe për varrimin e saj se si do të ishte e cila gjë u
bë realitet pas disa vitesh.

Vërtet ashtu ndodhi. Për paralajmërimet që ju bën Allahu xh.sh.
njerëzve të tij të dashur edhe nëpërmjet ëndrrave duke i filmuar
ngjarjet para se të ndodhin, na tregon Kurani famëlart i cili thotë:
"Allahu ëndrën e të dërguarit të vet e vërtetoi me realitet se me
vullnetin e Allahut, do të hyni në xhaminë e shejtë [në Qabe]."
[në Qabe]."S.Fet-hit.aj.27. Nëse dikush i pa thelluar në dije thotë
si ka mundësi që ta shikoi njeriu ngjarjen të filmuar para se të
ngjajë ajo? Fuqija dhe dituria e Allahut xh. sh. o njerëz është e pa
kufishme. Kurani thotë: "Kur Ai [Allahu] dëshiron një sendë,
urdhëri i Tij është vetëm ti thotë Bëhu, ai menjëher bëhet".
S. Jasin. aj. 82. Gjithashtu në Kuran Allahu xh. sh, thotë: "Ne kur
dëshirojmë një send vetëm i themi atij; Bëhu, ai menjëherë bëhet.
S. Nah I. aj. 40. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha kur ishte
gjallë më thoshte mua "Un mendoj gjithmonë hallin e varrit se a
do mundem të gjej vend që të varrosem pran atyre njerëzve që
kanë vdekur disa kohë më parë se ata besonin dhe e kishin frikë
Allahun xh.sh. më shumë se njerzitet e kohës së sotme". Aisheja
për këtë kishte folur me një përgjegjës tek varrezat e Tufinës.
Vërtetë ajo është varrosur në Tufinë në parcelën madhe nga jug-
lindja. Në atë parcelë janë varrosur shumë njerëz nga të hershmit,
të ardhur disa nga ish varrezat e vjetra të quajtura varrezat e
Bamit. Një parcelë më poshtë Aishes, është i varrosur edhe
dijetari i devotshëm Haxhi Hafiz Mahmud Dashi e të tjerë njerëz
nga të mirët. Allahu xh.sh. ia plotësoi dëshirën murshides Aishe
rahmetullahi alejha. Pejgamberi a. s. ka thënë; "Varrosni besimtarët
te besimtarët=të mirët pranë të mirvet se ashtu si në jetën e dynjasë
njerëzitet e mir nuk kan qetësi prej komshivet të këqinjë, e njëjta gjë
është dhe në jetën e varrit".

90-PAK NGA JETA, PAMJA E JASHTME, CILËSITË, VEPRIMET DHE IBADETI I MUXHEDIDES AISHE.

Murshidja Aishe Daudi rahmetullahi alejha ishte e bija e Isa Daudit
dhe e Fatimes. Lindi nga një familje e mesme në fshatin Radovesh
rrethi i Peshkopisë [Dibra e vogël] zona e Gollobordës në vitin 1923.

Kur ishte në moshën 2 vjeç, asaj i vdiq babai. Nëna e saj me tre fëmijët, 2 djemtë dhe Aishen e vogël iku nga fshati Radovesh dhe erdhi në Tiranë pasi këtu ajo kishte dajat e saj, Hysni e Ismail Reka.

1-Aisheja nuk kishte mësuar në shkollë. Ajo ishte e pa arsimuar. Dinte thjeshtë vetëm shkrim e lexim. Veç gjuhës Shqipe ajo fliste Maqedonishtë e Greqishtë e pak Turqishtë e Italishtë.

2-Kishte trup mesatar ishte shumë e bukur në pamje dhe kishte shumë autoritet. Ta impononte edhe pa dashur respektin ndaj saj.

3-Kur ecte rrugës i ndritshin rrobat dhe fytyra shumë e bardhë i shkëlqente dritë. 4-Ajo e kishte zërin të kumbushëm dhe fliste qartë e rrjedhshëm. 5-Ajo rrinte e mbuluar krejtësishtë sipas sheri-atit-ligjit të fesë Islame. U vishte me çarçaf duke mbuluar gjysmën e fytyrës. Mbulonte ballin krejtësishtë me gjithë bishtat e vetullave, mjekrën, dy nofullat me përjashtim të syvet, buzëve dhe hundës të cilat nuk i mbulonte se nuk të lejonte në atë kohë ligji i shtetit ta mbu-loje gjithë fytyrën por që edhe ligji i fesë =sheriati e lejon kësh-tu. Kështu dilte ajo jashta shtëpisë kur ishte në moshë të re. Ndër-sa kur u moshua e zbuloi krejtësishtë fytyrën dhe në kokë mbante napë të bardhë. 6-Ishte tip serioz jashtë shtëpisë sa që nuk mund ta shikoje me qëllim të keq se të kallte frikën. 7-Ishte fytyr qeshur me njerëzit e ndershëm besimtar që i njihte. 8- Jetonte ekonomikishtë dhe ishte shumë guximtare, ishte trimëresh=ishte burrëresh. 9-Ishte shumë e ashpër me imoralët, hajdutët, gënjeshtarët dhe shpifara-kët= ata që akuzojnë të tjerët. 10-E kishte shumë frikë Zotin xh. sh. Çdo herë që fliste për urdhërat e Zotit xh. sh, dhe porosinë e Pejgamberit a. s. qante, derdhte lot nga sytë. 11-Gjënë më të dashur kishte namazin. U falte dhe natën. Kurr nuk e linte namazin e pes kohëvet pa e falur në kohën e vet me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë që nuk kishte mundësi ta falte në kohë kur ishte duke udhë-tuar. Ajo thoshte se nga Allahu xh. sh. kam këtë njoftim për çështjen e namazit; "Nëse dhe pejgamberët nuk do ta falnin namazin nuk do të hynin në xhenet por ata e falnin. "Ndërsa për namazin e sabahut thoshte ajo mora këtë lajm nga Allahu xh. sh. kështu" Ai njeri që nuk e fal namazin e sabahit në kohën e vet, vetëm mallkimin ka mangut nga Unë [e lajmëroi Allahu xh. sh. atë se gjitha të këqijat i ka ai njeri. " Për rëndësinë që i jepte ajo namazit, unë e kam pare vetë atë.

Një rastë Aisheja duke ecur në qytet po nxitonte shumë. Unë i dola para dhe e pyta se çfarë halli kishte që po nxitonte aq shumë. Ajo më tha ; nuk kam asgjë por po më ikën koha e ikindisë=ko-ha pas mesditës e cila ka shumë rëndësi. Vërtetë Allahu xh. sh. në Kuran na tërheqë vërejtjen për namazet e sabahit, ikindisë dhe namazin e natës. 12-Aisheja fliste qartë dhe bukur. Ajo kishte zë të kumbushëm. 13-Këndonte shumë Kuran, ditën e natën.Ajo dinte 3-4 xhuza Kuran për mendësh. 14-Ishte shumë bujare, e mëshirshme, vishej thjeshtë, hante pak dhe flinte pak. Gjumin e kishte shumë të lehtë. Një rastë nëna ime e pyeti atë; A ke fjetur rahat sonte o Aishe ? Ajo i përgjigjet duke qeshur : Unë flej porsì zogu në degën e pemës. Vetëm sytë i mbaj të mbyllur se e kam gjumin shumë të lehtë. Ajo nuk kishte kryllartësi=mendjemadhësi, por kishte mjaftë itibarë-autoritë. 15- Ishte shumë mikpritëse dhe shumë respektuse në shtëpi. Tek ajo në shtëpi nuk mund të hynte çdo lloj njeriu. Aty hynin njerëzit e fisit të saj të afërt dhe besimtarët të shoqëruar me gratë e tyre. Sidomos kur ishte në moshë të re, meshkujt duhet të ishin të shoqëruar me grate ose fisin e tyre të afërt. Ndërsa kur shkonte ndonjëherë si mysafire=bujtëse e shoqëruar tek ndonjë familje besimtare dhe rrinte më shumë se 24 orë , ajo sillte ushqime në trastë atje ku shkonte, se kishte frikë mos të futej në hakun=të drejtën e të tjerëve, megjithëse njerëzit e mbainin me shumë dëshirë e respektë. 16-Agjëronte shumë. Gjatë vitit agjëronte Ramazanin, ditët e hëna dhe të enjtet, agjëronte në muajt e shenjtë, Rexheb dhe Shaban. Agjëronte 10 ditët e hënës Muharrem, 6 ditët e hënës Sheval, 10 ditët e hënës Dhulhixhe dhe ditën e Arafatit. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha, i agjëronte natat e mëdhaja ose ndryshe natat e mira. Ajo thoshte agjërimi në këto ditë është nafile jo farz, por ka shumë sevab-mirësi nëse agjëron në këto ditë me vlera të mëdhaja. Ajo e respektonte hënën Mevludit=hënën Rebiul Euvel, hënën që ka lindur mësuesi i njerzimit më i dashuri i Allahut xh. sh, Profeti Muhamed a. s. Gjithmonë çdo vit murshidja Aishe rahmetullahi alejha e këndonte me gratë [mblidhte vetëm gra]. Mevludin e Pejgamberit a. s.

Ajo thoshte: Kam njoftim prej Allahut xh. sh. se Ai kënaqet kur njerëzit mblidhen për ta nderuar e lavdruar së bashku të dërguarin e Tij. E vërtetë nga Allahu xh. sh. është kjo fjalë se Kurani në suren Ahzab thotë se Allahu xh. sh. dhe engjëjt e Tij e urojnë-e lav-

drojnë Pejgamberin a. s. dhe e përshëndesin me selam. 17-Ashtu si Pejgamberi a. s. edhe murshides Aishe i vinte keq për popullin e saj. Ajo shpesh qante për njerëzit, për popullin e saj se i vinte keq që ata vuanin nga rruga e gabuar që ato kishin marrë. Ajo gjithmonë iu luste Allahut xh. sh. që ta mëshironte popullin e saj e ti drejtonte ata për së mbari. Allahu xh. sh. thotë kështu për Pejgamberin a. s. në Kuran; ‘Juve ju erdhi i dërguari nga lloji juaj. Atij i vjen rëndë [i vjen keq] për vuajtjet tuaja se ai është lakmues i rrugës së drejtë për ju [o popull], Eshtë i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët. ‘S. Tobe. aj. 128. Muxhedidja Aishe thoshte: Ata njerëz që nuk e besojnë Zotin xh. sh. të çdo llojë ngjyre politike që të jenë, qofshin nacionalistë, fashistë, komunistë e demokratë janë të njëjtë por ata grinden me njëri tjetrin për interesa dynjaje. 18]Muxhedidja Aishe bënte shumë zikër. Ajo në shtëpi mbante një palë tespih të gjata me 1000 kokrra për të bërë zikër të veçantë me numër të caktuar ndërsa për namazin mbante tespih të zakonshëm. Vërtet Kurani thotë përmendeni shumë Allahun që të shpëtoni. ‘S. Xhuma. ajeti. 8. Allahu xh.sh. dhe Pejgamberi a.s me fjalën dhikër kanë për qëllim zikrin e veçantë. Për besimtarët që bëjnë zikër të veçantë Allahu xh.sh. thotë: ‘Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për të dhënë zekatin...’S.Nur =Kapitulli Drita.aj.37.Kuptohet se është fjala për zikrin e veçantë se këtu përmendet zikri para namazit.Veç Kuranit Aisheja lexonte edhe libra feje të përkthyer nga Arabishtja e Turqishtja në gjuhën Shqipe. 19] Murshidja Aishe rahmetullahi alejha e donte shumë pastërtinë. Ajo ishte shumë meraklije për pastërtinë e veshjes, shtëpis dhe ambjentit ku rrinte. Ajo thoshte se ‘Ata njerëz që janë shumë të kujdesëshëm për pastërtinë janë besimtar’ 20- Muxhedidja Aishe punonte në shtëpi me një makinë qepse të vjetër duke qepur vetëm rroba të thjeshta fëmijësh e grash dhe i shiste veresi të shumtat. Ajo punonte vetë për të jetuar, lante e pastronte shtëpinë dhe kryente detyrën që i kishte ngarkuar Allahu xh. sh. për të thirr popullin në Tobe. Ajo iu thoshte njerëzve: Un jam balta e këpucëve të profetit Muhamed a.s. por jam me shërbim të caktuar nga Allahu xh. sh. për ti thirr njerëzit të bëjnë tobe. Një pjesë nga populli ia vuri asaj titullin Aisheja e Mirë. Ndërsa tekë Allahu xh. sh. e kam titullin ‘Nur =Drit’=Drita thoshte ajo. Vërtetë ajo ishte një dritë prej Allahut xh. sh. për ti ndriçuar rrugën besimtarëve. Allahu xh.sh. e mëshiroftë atë dhe e udhëzoftë popullin tonë e mbarë njerëzimin në fenë e Tij. Zoti xh. sh. në Kuran thotë: ‘ Pa dyshim feja e pranushme tek Zoti është feja Islame.’ S. Ali Imran.

**91-DËSHMITË E DISA HOXHALLARËVE DHE BESIMTARËVE
TE THJESHT QË NUK E NJOHËN NGA AFËR MUXHEDIDEN
AISHE POR DËGJUAN PËR TË NË KOHËN E DEMOKRACISË
PASI AJO NDËRROI JETË.**

Ish medresisti imami i xhamisë së Vorës në Tiranë hoxha

Junuz Haxhiu foli këto fjalë për librin Tobe Istigfar: Ky njeri që e ka shkruar këtë libër që bën fjalë për shërbimin e muxhedides Aishe e cila i thirri njerëzit për të bërë tobe, duke filluar prej largimit nga shirku me gojë, ka thënë veçse të vërtetën. Hoxha i cili ishte imam në xhaminë e Vorës, mbajti dy ditë Xhumaje vazin=predikimin: Thirrja për Tobe Istigfar. Ai tha: largimi nga shirku i madh itme gojë dhe një tobe e vërtetë, janë të domosdoshme sot për të shpëtuar nga të këqijat që na kanosen çdo ditë e më shumë. Askujt nga hoxhallarët nuk i ranë ndërmend fjalët me Zotësi që formojnë shirk=formojnë kufër. Me të vërtetë Aisheja e Mirë ka thënë të vërtetën me inspirim nga Allahu xh. sh. Imami i xhamisë Vaqarrit Tahir Xhabafti nga fshati Arbanë e Tiranës tha: Ah që un nuk e pata fatin ta njihja murshiden Aishe dhe të dëgjoja për fenë Islame prej sajë. Çështja e njësimit të Allahut =njësimit të Zotit xh. sh. në çdo gjuhë është plotësisht e drejtë. Nuk duhet të thirret njeriu që është krijesa e Zotit xh. sh. me atë emër që çdo njeri në gjuhën që flet, thërret Zotin xh. sh.=Allahun xh. sh. Krijuesin e Gjithësis.

Besimtari i mirë, i sinqertë dhe ndihmtarë i fesë Islame Qazim Murati nga Guri Bardhë i Burrelit, porsa dëgjoji për njësimin e Zotit xh. sh. largimin prej shirkut me një herë e ruajti gojën prej shirkut=të bëmit shokë Zotit = Allahut xh. sh. Mua tha Qazimi nuk ma pranonte mendja këtë gjë kur e dëgjoja dhe para se të takoja me ty o Haxhi Ymer Aga, por mendoja se me që nuk po flasim parijsë e fesë për këtë gjë atëherë nuk qenka e keqe kjo sikurse më thotë mua mendja ime. Por puna paska qenë ndryshe. Mësusat e fesë [hoxhallarë] i paska hutuar djalli i mallkuar. Fjala e këtij besimtari është e vërtetë se Allahu xh. sh. thotë në Kuran; "Atyre [njerëzve] ua futi djalli në harresë porositë e Allahut." Besimtari i vendosur Qazim Murati tha megjithë se nuk e njoha personalishtë muxhediden Aishe rahmet past por un edhe familja ime që e falim të gjithë

namazin e kemi besuar që Aisheja ka qenë me shërbim nga Allahu xh. sh. për thirrjen e popullit tonë në Tobe. Ne si familje, un me gruan e fëmijët, nëna e babai dhe vëllai me nusen nuk bajmë më shirk kur flasim. Un i thërras dhe të tjerët që mos të bëjnë shirk. Fjalët që ka thënë muxhedidja Aishe janë në bazë të Kuranit. Allahu ia shpërbleftë asaj me të mirat e xhenetit. Allahu xh.sh. ia shpërbleftë me xhenet edhe Hoxhës Haxhi Ymer Aga i cili na bëri me dije për këtë çështje të madhe. Familja e Ali Muratit i cili është është babai i Qazimit janë familje besimtare e sinqertë. Aliu ka bërë dhe detyrën e imamit në muajin e Ramazanit në shtëpin e tij. Një dhomë të madhe ai e bëri si xhamijë [musalah]=vendë për falje namazi. Aliu e kishte mësuar Kuranin kur ishte i ri, tek hoxha i fshatit të vet Guri Bardhë. Qazimi ju thotë dhe të tjerëve këto fjalë: Çështja kryesore e fesë sot është largimi i njerëzve nga shirku i madh=pra njisimi i Allahut në çdo gjuhë që flasin njerëzit. Ky është kushti bazë i fesë. Allahu xh. sh. çdo gjë ia fal po deshi atij njeriu që do por gjynahin e madh të bëmit shok Atij nuk ia falë askujt thotë Kurani. E Falenderoj shumë Allahun xh.sh.që na drejtoi familje- risht. Që më bëri të mundur që të dëgjoj dhe të bindem. Allahu xh. sh. na bëri që ta kuptojmë të vërtetën. Ai na udhëzoi neve. Një muezin i një xhamije në qytetin e Shkupit në Maqedoni, medresist me origjinë Turke, pasi un e sqarova për çështjen e shirkut ai tha se çështja e njisimit të Allahut në çdo gjuhë është e drejtë dhe e qartë plotësisht. Un me mëndjen time tha ai, pa qenë i njoftuar për këtë gjë e kam menduar vetë dhe ju kam thënë disa muslimanëve të të ditur të cilët flasin Maqedonisht se ju nuk bëni mir, e keni gabim që e thirrni edhe njeriun Gospod ashtu sikurse thirrni në gjuhën gjuhën tuaj Allahun xh. sh. Këtë gjë tha ai, un jau thash atyre me me mendjen time nga që mua këtë gjë nuk ma pranonte llogjika. Ndërsa ata më thanë se nuk e shihnin si gjë të keqe.

Tani me fakte të bazuara në Kuran që un shoh në broshurën: "Largohuni nga shirku krimi kundër Zotit xh. sh." un jam krejtësisht i qartë për këtë çështje më të rëndësishmen e fesë. Hoxha Isa Alosi imam xhamie në Ulqin në Malin e Zi për çështjen e njisimit të Allahut xh .sh.u shpreh kështu:Kjo thirrje më bëri përshtypje shumë. Është vërtetë e çuditshme që këtë gjë nuk e kanë kuptuar të diturit që, me atë emër që thërrasin Allahun xh. sh. në gjuhën e tyre, ata thërrasin dhe njëri tjetrin. Kjo vërtetë është gjë për tu çuditur. Besimtari Rakip Pajolli arsimtar nga Lushnja i cili

kishte dije, kur unë i fola për thirrjen e muxhedides Aishe, ai me dyshim u shpreh; Nëse është e vërtetë sikurse ka thënë ajo dhe e ke shkruar ti në libër, atëherë përse nuk thua ti o Haxhi Ymer Aga se neve muslimanët kështu paskemi marrë fund, paskemi dalë nga binarët, paskemi lajthitur?

Un i thashë atij: A nuk e ke kuptuar akoma këtë gjë ? Rakipi tha nuk më besohet që kemi shkruar deri në atë gradë dhe u ngrit me njëherë në këmbë nga vëndi ku ishim duke ndenjmur dhe u ndamë me njëri tjetrin. Ky ishte takimi i tretë dhe i fundit që pata rastësisht në Tiranë me Rakip Pajollin nga qyteti i Lushnjës. Abdyl Fetah Ademi ish arsimtarë e pastajë muezin xhamije në qytetin e Shkupit porsa un i fola atij për çështjen e njisimit të Allahut xh. sh. në çdo gjuhë, largimit nga shirku me gojë. Ai më ndigjoi me vëmëndje dhe menjëherë u bind për këtë. Ai tha kjo gjë është mëse e qartë. Allahu xh. sh. e ruajt atë deri në vdekje nga ky shirk i madh dhe i drejtoftë dhe të tjerët. Namik Hoti politikan ishë krytari i Partisë Ekologjike në Shqipëri u shpreh kështu:

E kamë takuar tha ai Aishen në vitet kur feja ishte e ndaluar të praktikohej në vendin tonë. Aisheja ishte grua serioze me shumë autoritet, shumë e zgjuar dhe oratore. Vishej sipasë sheriatit-ligjit të fesë Islame, dhe ishte me virtute të larta. Ajo fliste për një shoqëri që të kishte për bazë moralin mbi materialen. Ndoshta ajo ka qënë e shenjtë [euvlija]. Ndërsa mjeku Haxhi Fadili nga Suhareka e Kosovës kur unë i fola atij për çështjen e njisimit të Zotit xh. sh. =largimit nga fjalët e shirkut me gojë ai nuk më kundër- shtojë. Këtij unë iu fola vetëm për çëshjen rëndësishme të njisimit të Allahut xh. sh. në çdo gjuhë. Allahu xh. sh. i largoftë nga shirku gjithë besimtarët. Dëgjova se mjeku Haxhi Fadili kishte një familje të rregullt e përqëndruar në Islam.

92-PËRÇARJET MES BREZIT TË RI DHE BREZIT TË VJETËR TË MUSLIMANËVE.

Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Mos u bëni si idhujtarët që përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe dhe secili grup i gëzohet ides së vet. S. Rrum. aj. 32." Gëzohem shumë kur i shoh djem e vajza të reja duke iu falur Zotit xh. sh. Rinija është e ardhmja e popullit. Mirpo aq sa gëzohem edhe dëshprohem nga që sot në

këtë kohë disa të rij që kan studiuar në vendet muslimane dhe kanë marrë ndonjë diplomë, më shumë po grinden me brezin e vjetër se po punojnë në shërbim të fesë. Në këtë mënyrë po hapet dera e grindjeve mes muslimanëve dhe kështu po përçahen kudo besimtarët e Zotit xh. sh. Si të vjetrit ashtu dhe të rinjtë nuk merren me çështjen kryesore; Toben=largimin nga haramet e mëdhaja=largimin prej punëve, fjalëve e veprave të liga, por merren me çështje që nuk kanë të bëjnë me bazat e fesë. E para çështje kryesore e fesë është besimi në Zotin xh. sh. dhe besimin e vërteton njisimi i Zotit xh. sh. me gojë në çdo gjuhë që flasin besimtarët dhe pas kësaj duhet të largohen nga haramet=gjërat e ndaluara nga Allahu xh. sh. për të cilat e thërriste popullin murshidja Aishe rahmetullahi alejha që janë kushtet bazë për shpëtimin e njerëzve nga të këqiat në dy botët. Janë bazat e qëndrimit në besim. Këto janë kushtet e kthimit sinqerisht në rrugën e Zotit xh.sh. Sot ata që e mbajnë veten të ditur të rinjë e të vjetër, nuk po merren me çështjet themelore të fesë që kan të bëjnë me besimin dhe veprat e njerëzve. Ata nuk po përpiqen për luftimin e veseve e zakoneve të liga të cilat janë haram por po grinden me njëri tjetrin në kundërshtim me fenë Islame. Po grinden çdo ditë për disa gjëra të parëndësishme. Ata diskutojnë se a duhet ta thuash me gojë nijetin =qëllimin kurë fillon namazin se çfar namazi po fal dhe se për çfar e falë apo vetëm ta sjellësh në mendje pa e përcaktuar me gojë. Kjo gjë për sa i takon përcaktimit të namazit të kujtë kohe po fal duke e shprehur me goj apo duke e menduar vetëm me mendje se namazin e kujtë kohe je duke falur. Kjo gjë nuk ka shumë rëndësi. Namazi është brenda rregullave por, është mustehab = e pëlqyshme që nijetin ose qëllimin ta shprehësh me gojë se kjo gjë të bën që menjëher të përgaditesh direkt me përqëndrim në namaz.

Ndërsa për nijetin se për çfarë qëllimi e fal namazin puna këtu ndryshon se është nga kushtet e namazit që ta përcaktosh se për çfar e falë namazin. A e fal namazin si detyrë që e ke ndajë Zotit xh. sh. që të ka kriju ose për ndonjë interes tjetër e sikur të mos të ishte ai interes ti nuk iu falshe Atij. Dijetarë e parë Islam kanë thënë; Nëse një njeri thotë me mendje ose me gojë që po e bëj nijet me falë namazë për të hyrë në xhenet, namazi i atij njeriu është i pa vlerë. Ky namazë është i pa rregullt. Në xhenet hyhet vetëm me mëshirën e Allahut xh. sh. se njeriu nuk mundet të ja shpërblejë ose ndryshe ti lajë borxhet Allahut xh. sh. për të gjitha ata të mira që i ka dhënë në

këtë dynja edhe nëse njeriu rrin duke u falur dit e natë pa pushuar asnjëher e cila gjë është e pa mundur të bëhet nga njerzit. Prandaj duhet që namazin ta bëjsh me nijetin kështu; E bëra nijet me falë namazin e filan vakti ose kohje për vullnetin ose pëlqimin e Allahut xh. sh. u drejtova drejtë qabes. Të rrijtë tanë në këtë kohë po grinden me të vjetrit për agjërimin e ditëve ose netëve të mëdhaja=për natat e mira, për këndimin e Kuranit të vdekurve, për festimin e Mevludit e tjera gjëra të cilat janë vepra të mira të porositura nga feja jonë, feja Islame.

Gjithashtu të rrijtë tanë muslimanë sot në këtë kohë shumë të vështirë për muslimanët kudo në botë po diskutojnë e grinden me të vjetrit për pantallonat për mjekrat, për çallmat dhe brekushtet ose fustanat e bardha që i veshin pakistanezët dhe disa vënde arabe. Feja nuk është me ia përngjasuar në veshjen kombëtare një populli kushdo qoftë ai, por është veprimi në rrugën e Allahut të madhrueshëm ashtu siç na urdhëron Ai. Mjafton që veshja të jetë brenda rregullave që thotë ligji Islam=sheriati. Po të bazohet feja vetëm në veshjen e brekusheve dhe fustanave, ne shqiptarët kemi veshjet tona kombëtare, kemi qeleshet, xhamadanin, brekushtet e fustanellat tona. Gjithashtu feja nuk është vetëm aq sa e mendojnë disa nga të vjetrit që janë të pa ditur, të cilët mendojnë se për të qënë musliman tamam, mjafton nëse mban në kokë kësul ose ndryshe qylaf të bardhë ose të zi, i falë 16 rekatë namaz ditën e xhuma, bën Mevludin e këndo Jasina e hatme për të vdekurit dhe feston natat e mira ose natat e mëdhaja. Këto vërtetë janë gjëra të mira të lejshme e të rrekomanduara që ti bëjnë muslimanët, por feja nuk është vetëm kaq. Këto që përmënda, janë të lejuara të bëhen dhe ai që i bën shpërblehet nga Allahu xh. sh. por puna e parë kryesore është që të vjetërit të bëjnë tobe=të largohen nga qyfri-shirku ta njisojnë Zotin xh. sh. në gjuhën e tyre e në çdo gjuhë që flasin e jo vetëm në gjuhën arabe. Mos ti thonë më njerëzve në gjuhën shqipe o Zoti filan, i Zoti filani, Zotnija e Zotnesha ose Zonja e Zonjusha. i del Zot ose e Zotnon filani, Zotrote e Zotohet dhe ti mësojnë dhe familjet e tyre, sidomos brezin e ri; fëmijët, nipërit e mbesat e tyre dhe njerëzit tjerë që ta njisojnë Allahun xh. sh. në çdo gjuhë dhe ta falin namazin për Të dike u larguar nga haramet-gjërat e ndaluara që përcaktohen në kushtet e tobës = pendesës të cilat janë bazat themelore të qëndrimit në rrugë e drejtë, qëndrimit në fenë e Allahut xh.sh. në fenë Islame.

Ndërsa besimtarët nga brezi i ri të cilët me shumë sakrificë janë larguar nga haramet dhe po i falen Allahut xh. sh. janë për tu lavdruar e përkrahur por ata duhet ta din mirë se nëse nuk pranojnë ta njisojnë Allahun xh. sh, në gjuhën amtare dhe në çdo gjuhë që dijnë të flasin nuk jua pranon Allahu xh. sh. atyre namazin dhe mos largimi nga fjalët e kufrit nga fjalët e shirkut vërteton se ata nuk janë të sinqertë në fe. Nuk e kanë punën e fes me sinqeritet bashkë me ata që i mësojnë. Sikurse e thash po e përsëris dhe një herë të rinjtë nuk duhet të grinden me brezin e vjetër duke kundërshtuar veprimet e mira; synetet, nafilët e mustehabet e duke diskutuar se duhet apo nuk duhet që nijetin=qëllimin ta shprehësh me gojë kur fillon me falur namazin e tjera e tjera pa rëndësi. Këto gjëra nxiten nga ateistët nëpërmjet munafikëve për të futur grindje e përçarje tek besimtarët, për tu humbur atyre kohën duke i shmangur të rrijtë besimtar që mos të mendojnë e diskutojnë për problemet e mëdhaja fetare, morale e sociale që ka populli e vendi por të merren me gjëra të pa rëndësishme. Të rinjtë duhet të mendojnë e të diskutojnë për të arthmen e tyre se janë pa të arthme. Ata duhet të ngren zërin e tyre kundër veseve të këqia që po i nxisin dëshirat në botë. Ata duhet të mbështeten në Kuran për çdo gjë e pastaj në argumentet që jepen në hadithet e Pejgamberit a. s. e në mendimet që ka dhënë Ixhmai Ymeti=mendimi i përbashkët i dijetarëve Islam dhe nga Kijasi Fukahaja=krahasimi i një çështje me një çështje tjetër. Hadithet, Ixhmai dhe Kijasi e kanë bazën në Kuran. Çdo thënjë e mendim që direktë ose indirektë nuk përmendet ose nuk ka bazë në Kuran, ajo gjë ose ai mendim është i pa pranueshëm se Allahu xh. sh. thotë për Kuranin kështu : “Ne ty [o Muhamed] ta shpallëm librin [Kuranin] nsqarim për çdo send...” S. Nahl. ajeti. 89. Kurani përfshin çdo gjë, të njomë e të thatë. Allahu xh. sh. thotë; . . Ne e shpallëm atë [Kurain] kushtetutë në arabishtë [në gjuhën Arabe.] S. Rad. Aj..37. Allahu xh sh. thotë: “A nuk e përfillin ata Kuranin? Sikur të ishte prej dikujtë tjetër [ai] përveçse prej Allahut do të gjenin në të shumë kundërthënie”. S. Nisa. aj. 82. Dhe Allahu thotë: “Pra atëher çfar fjalësh të tjera veç Kuranit do të besojnë [ata=njerëzit]?. S. Araf. aj. 85. Ata hadithe e mendime dijetarësh që nuk kanë baza në Kuran direkt ose indirekt janë sajesa = janë bidade = shpikje dhe janë të pa pranueshme. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai njeri që shpik fjalë nga vetja e tij e thotë se kështu ka thënë Pejgamberi a. s. ai njeri do të jetë në zjarrin e xhehenemit. Trans. Buhariu e Muslimi.

Të rinjtë nuk duhen të nguten duke menduar se i dinë të gjitha. Un nuk e kam të qartë qartë se a vërtetë kështu i kan mësuar të rrijtë tanë dijetarët Islam në vëndet arabe apo ata veprojnë vet ashtu nga dituria e pakët që kan marrë atje për fenë? .

Pa dyshim që ka dhe nga ata profesora në vëndet e ndryshme Islame që disa janë të hutuar e disa janë të mashtruar nga shejtani i mallkuar e disa të maskuar me petkun Islam të cilët paguhen nga qafirat e munafikët për të futur përçarje e grindje tekë muslimanët. Sot pothuajse kudo në vendet e botës feja nuk ka më fuqi në popull se drejtusat e komuniteteve fetare nuk veprojnë sipas fesë por sipas udhëzimeve të politikanvet të cilët fenë e kan ndarë nga shteti duke mos i marrë fare para syshë ligjet e saj në çdo aspekt, qoftë moral, social, ekonomik dhe juridik. Ata fenë e predikojnë në xhamia vetëm nga ana teorike dhe flasin ata gjëra që nuk bien në kundërshtim me politkën aktuale dhe me interesat e politikanëve që kanë pushtetin në dorë. Ata nuk veprojnë si pasë udhëzimeve që jep Allahu xh. sh. në Kuran për të gjitha çështjet. Pejgamberi ynë a. s. ka thënë: “ Afër kijametit dijetarët e mir që e kan frikë Allahun xh. sh. nuk do të jenë më në këtë botë. Do të japin mendime për çështjet e fesë xhahilat [injorantët] e munafikët”. Sot është koha për të cilën ka paralajmëruar me këtë hadith Pejgamberi jonë a. s. Dijetarët që janë munafikë kudo në botë nga që marrin rroga të majme flasin sot sipas dëshirave të ateistave që e kan pushtetin në dorë dhe jo sipas ligjit të Allahut xh. sh. Ata me këtë veprim kështu nga interesi i dynjasë e kanë tadhëtuar fenë, amanetin e Pejgamberit a. s. Për dijetarët që kan dije por nuk veprojnë siç thotë Allahu xh. sh. [se janë munafikë] Kurani thotë: “Kush nuk gjykon [nuk flet e nuk vepron] sipas ligjit të Allahut, ata [njerëz] janë mohusa[nuk janë besimtar]. ” Ndërsa për xhahilat=të pa diturit [për ata që japin mendime ose fetva pa pasur dije e gjykim] Allahu xh. sh. për të tillë njerzish thotë: “Mos fol për atë gjë që nuk ke dije [mos jep mendim ose fetva për atë gjë ose çështje që nuk ke dituri]”. Të rijvet dhe të vjetërve ju kujtojmë se ka dhe nga të rinjtë kudo në vendet e ndryshme të botës që i kanë çuar qafirat dhe munafikët në shkollat fetare Islame në vendet arabe për ti përdor në shërbim të tyre për ti përça muslimanët. Si pasojë e këtyre llojë njerëzve që thash e kan humbur rrugën e drejtë shumë muslimanë në vende të dryshme të botës duke u bë pa dashur vegla të propogandës anti Islame. Të

rinjtë që janë vërtet besimtarë të sinqertë dhe që duan ta shpëtojnë popullin nga rruga e gabuar le të këshillojnë njerëzit që janë pa moral që përpiqen me të gjitha mënyrat që ta shkatërrojnë plotësishtë moralin e popullit.

Të rinjtë besimtar mos të bëjnë konflikte me të vjetrit besimtar se prej atyre ata e trashëgjuan fenë. Sinqeriteti në Islam i disa të rijëvet që e mbajnë veten si besimtar ose mendojnë se janë besimtarë të fortë në fe, do tu shihte atëherë nëse ata në radh të parë do ta njisonin Allahun xh. sh, në gjuhën që flasin dhe do ti kundërshtonin me të madhe: alkolizmin e drogën, krimin, vjedhjen, korrupsionin, lojrat e fatit, imoralitetin dhe padrejtësinë me çdo lloj mënyrash që i kanë mundësitë. Disa nga këta lloje të rinjesh që e mbajnë sotë veten si besimtarë të fortë në fe po kundërshtojnë të mirën. Ata po grisin lajmërimet që bën brezi i vjetër i komuniteti musliman për natat e mëdhaja-natat e mira dhe për festën e Mevludit.

Ky veprim që bëjnë ata është në kundërshtim të hapur me fenë Islame. Nëse këta do të ishin besimtarë të sinqertë, do të grisinin posterat me fotografitë e femrave lakuriq që vihen në muret, rrugët e sheshet e qyteteve tona, nga armiqtë e moralit njerëzor, që janë armiqtë e fesë në përgjithësi dhe armiqtë e kombit në veçanti. Ndërsa këta të rinjë që e heqin veten si të ditur po grinden me brezin e vjetër për të vetmen arsye se besimtarët e moshës së vjetër veç farzit=detyrës dhe sunetit-veprimit të profetit Muhamed a. s, duan të bëjnë dhe disa gjëra nafile=gjëra të mira jashtë detyrimit-farzit, si namazë jashtë pesë kohëve, agjërimit vec Ramazanit, këndim Kurani e zikër jashta namazit dhe të tjera veprime të mira synete, nafile e mustehabe-gjëra të pëlqyshme prej Allahut xh. sh. dhe të porositura e të lavdruara prej Pejgamberit a. s. Çfarë të keqeje ka nga këto veçse të mira? Këto tipa të këtij kallëpi që i kundërshtojnë këto vepra të mira, me veprimet që bëjnë nuk veprojnë si besimtar musliman të sinqertë. Disa nga këto po vënë dhe shenja në ballë siç vën indjanët. Ata thonë se këta shenja na kan dal vetë në ballë se kemi bër sexhde shum=kemi bërë namaz shum. Zoti xh. sh, i udhëzoftë tek e mira dhe e drejta të gjithë njerëzit e sinqertë, të rinjë e të vjetër dhe i ruajtë nga hilet e armiqve të fesë; qafirave, ateistave dhe munafikëve-hipokritëve. Allahu xh. sh. i ruajt dhe i udhëzoftë besimtarët e vërtetë të rinjë e të vjetër Allahu xh. sh. ju thotë musli-

manëve në Kuran kështu: “Kapuni të gjithë ju pas fjalës së Allahut [Kuranit] e mos u përçani”S. Ali Imran. aj. 103. Vëllezër besimtar ju duhet ta dini se ateistët e munafikët=hipokritët paran=lekun e njohin për Zot, estagfirullah, femrën për kukull, vetëm për tu zbavitur me të dhe pijen e alkoolit për ushqim të zgjedhur. Në lidhje me dëmin shëndetsorë dhe moral që shkakton pirja e alkoolit nga prindërit alkoolista tek fëmijët e tyre, unë kam shkruar për to në librin me titull; Feja dhe Mjekësija në Luftë Kundër Abortit, Alkoolizmit e Drogës, Bixhozit dhe Lojrave të Fatit. Viti 2001.

93-DALJA E DISA NJERËZVE NË VËNDET MUSLIMANE SI BAMIRËSA DHE SI MJEKË FETARË.

Në vëndin tonë kanë ardhur nga vënde të ndryshme të botës edhe disa njerëz që thonë se kan ardhur për bamirësi te populli jonë por në faktë ata kanë bërë e po bëjnë poshtërsira nga më të ndryshmet e më të ultat që është turp ti thuash. Disa nga këta që ishin anglezë shteti ynë i kapi dhe e dënojë veprimin e tyre. Gjithashtu në vëndin tonë, veç atyre që punojnë natë e ditë për rrevizionimin e shkatërrimin e fesë Islame me anë të misionarëve të ndryshëm brenda dhe jashtë rradhëve të muslimanëve, janë dhe disa njerëz të tjerë që paraqiten si fetarë të cilët merren me xhindët dhe sihirin= magjinë, për ti përçarë njerëzit me njëri tjetrin, e për ti larguar nga feja e Zotit xh. sh. Disa persona të veçantë nga besimtarët musliman, kanë mësuar prej disa njerëzve që nuk janë besimtarë porë janë munafikë=hipokrita, janë qafira ose janë xhahila-injoranta dhe kan mësuar prej tyre dijen e nuxhumit-parashikimit me anë të yjeve, dijen e Nirinxhatit, lidhjen me xhindët dhe dijen e magjisë-sihirit. Ato sot kanë hapur dhe klinika mjekësore, gjoja për të shëruar njerëzit e sëmurë nga xhindët dhe goditja nga shejtani i mallkuar dhe nga hasedi=zilia ose siç i thotë populli ynë, syu i keq. Disa nga këta njerëz që e mbajnë veten për muslimanë e të ditur thonë se Ibni Kaimi ka thënë; Kjo është shkencë të cilën nuk mund ta njohë askush tjetër, përveçë disa personave të veçantë, ... Ndikimin e tyre dhe lidhjen që kan ata me natyrën... nuk e njeh askush, përveç atyre... të cilët e kanë gjetur shijen e kësaj shkence=kësaj dije. Kështu është shkruar e thënë nga ata që merren me

këto gjëra. Vërtetë hasedi-smira ose syu i keq dhe magjia=sihiri ekzistojnë janë gjëra të këqija që ndodhin nga njerëzit e këqijë, dhe nga këto duhet të mbrohem veçse me Kuran e lutje Allahut xh. sh.

Çdo veprim a send tjetër kundër magjis e hasedit përveç se me Kuran nuk ka efektë dhe të largon nga feja Islame të çon në qyfer e shirk ndaj Allahut xh. sh. Allahu xh. sh. vëllezër besimtarë thotë në Kuran: “Mos ndiqni rrugë tjera që ju nxjerrin nga rruga= feja e Tij. [feja e Allahut xh. sh. ”]. S. En-Nam. aj. 153. Dhe përsa i takon shërim- it të sëmurëve nga xhindët, nga syu i keq dhe goditja nga shejtani i mallkuar, Kurani thotë; “Allahu nuk pranon [lutjen ose punën e mirë] vetëm se prej të mirëve. Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë: “A nuk e ke kuptuar për ata që vlerësojnë veten , Jo [nuk është ashtu] por Allahu vlerëson atë që do dhe nuk bën asnjë grimcë padrejtësi. ”S. Nisa aj. 49. Këto njerëz të këtyre kallëpeve që treguam më sipër kuptohen që janë të larguar nga e vërteta se ata nuk pranojnë ta njisojnë Allahun xh. sh, në gjuhën e tyre amtare. Ata janë dakortë me ateistët që njeriu të thirret Zoti estagfirullah.

Ata po i bëjnë karshillëk Zotit xh. sh. duke thënë un i dal Zot asaj ose këtij, unë e Zotnoj ose jam Zoti i kësaj ose i asaj gjëje. E stagfirullah, estagfirullah. Këto thënie të tyre nuk janë gjë tjetër veçse kufër e shirk. Allahu xh. sh. thotë në Kuran; ‘Ve min jekul minhum in-nij ilahum min dunihi fedhalike nexhzijhi xheheneme . ”Kush thotë prej tyre-[prej njerëzve e xhinëve] se un jam Zoti përveç Tij [përveç Zotit xh. sh.] dënimi për të është xhehenemi. ”S. Enbija. aj. 29. Pra kushë i thotë prej njerëzve vetes ose tjetrit se unë jamë Zoti, un i dalë Zotë asaj ose atij, i Zoti i kësaj ose i thotë tjetrit; ti Zoti ose Zotni filani, Zoti i asaj e kësaj estagfirullah, estagfirullah, estagfirullah, përveçë Zotit të vërtetë xh..sh. i cili është një Zot i vetëm pa shok e ortak, dënimi për atë njeri pa dyshim është xhehenemi. Zotsija o besimtarë është e posaçme për Zotin se Ai është Zoti dhe Ai e ka Zotsin. Kurani thotë; ‘Nuk ka Zot tjetër, vetëm Ai që jep jetë dhe vdekje. ”S. Duhan. aj. 8. Ndërsa për besimtarët e vërtetë që e njisojnë Zotin xh. sh. Kurani thotë: Janë të shpëtuar ata që thanë Allahu është Zoti ynë dhe qëndruan besnikërishtë. ”=[nuk e mohuan këtë fjalë që thanë në asnjë gjuhë që flasin]. S. Ahkaf ajeti. 13. Disa nga këta llojë tipa njerzish të veçantë prej të rijëve që thashë më sipër flasin keq dhe për njerëzit e devotshëm, që kanë qënë dhe mund të jenë me grada tek Allahu

xh. sh. Këto tipa njerzish po mbjellin armiçësi në gjeneratën e fundit të këtij ymeti=të këtij populli, kundër dijetarëve e besimtarëve të brezave të kaluar.

Ndërsa Allahu xh. sh. na mëson që mos ta shajmë brezin e vjetër besimtar që ishin para nesh por ti lutemi Allahut xh. sh. që ti mëshirojë ata. Ja si na mëson Allahu xh. sh, ti lutemi Atij për ata: “..Zoti ynë falna neve dhe vëllezërit tan që na papraprin-na udhëhoqën me besim [na mësuam fenë] dhe mos krijë në zemrat tona kurrëfar urrejtje për ata që besuan.... S. Hashr. aj. 10. = [Kapitulli i grumbullim- it]. Ja një shembull i bukur nga haz. Musai a. s. për të marrë mësim të rihtë e të vjetrit. Një ditë në atë kohë Allahu xh. sh. i tha profetit Musa a. s. se Un dua nga ti o Musa të më gjesjë një krijesë nga krijesat e mija që ta mendosh ti si më të pa vlerë se veten tënde dhe radhën tjetër kur të vishë në Tur, të më thuash se përse mendove ashtu për atë krijesë. Haz Musai a. s, atë ditë që do të shkonte në Turisinaj doli për të gjetur ndonjë krijesë, cfar do qoftë ajo, njeri ose kafshë.

Duke ecur në rrugë takoj një plak të vjetër në moshë e i çrregulluar nga pamja e veshja. Profeti Musai a. s. mendojë për një çast se ky plaku nuk i kishte vlerat e tij. Pasi u përshëndetën Musai a. s. e pyeti plakun; A e beson Zotin xh. sh. ti ? Plaku i tha atij; po e besoj. Musai duke ecur pak me plakun filloi të mendohet shumë dhe gjykoi kështu; Plaku mendoj ai ka më shumë vlerë se unë se ky e ka njohur Zotin xh. sh. më parë nga unë dhe u nda me plakun. Duke ecur më tutje takon një djalë të vogël i pa arritur moshën pesëmbëdhjetë vjecare. Pasi e përshëndet djalin e pyet; A e beson Zotin xh. sh. ti o djalë? Djali i thotë po e besoj. Musai a. s. filloi të mendohet përsëri dhe e gjykojë çështjen kështu; Djali mendoi ai është i vogël dhe nuk ka bërë shumë gjynahe ndërsa un jamë i vjetër dhe është e pa mundur që unë mos të kemë bërë ndonjë gjynah edhe pa dashje. E dhe ky mendojë Musai a. s. është më me vlerë se unë. Duke vazhduar rrugën profeti Musa a. s. sheh një qen dhe mendojë në atë çast se e gjeti një krijesë më pa vlerë se veten e tij. Edhe për atë e ndërrojë mendimin Musai a. s. duke menduar kështu: Ky qeni vërtetë është kafshë por kafsha është pa mend dhe nuk ka për të dhënë llogari para Allahut xh. sh. për gjynahet ndërsa unë do të japi llogari. dhe kështu Musai a. s. pejgamber i Allahut xh. sh. iku në malin Tur pa e gjetur krijesën më të keqe se veten e tij.

Pastaj kur arriti në malin Tur, Allahu xh. sh. e pyeti haz. Musain duke i thënë: O Musa: A e gjete ti atë krijesën më të keqe= më pa mvlerë se veten tënde? Musai a.s. iu përgjigj: O Allah xh.sh. un veprova kështu e mendova ashtu për të tre rastet.Un o Allah xh. sh. nuk gjeta ndonjë krijesë më të ulët se veten time. Allahu xh. sh, u kënaq shumë nga përgjigjeja që i dha haz. Musai a. s. dhe i tha atij kështu: Beto hem për madhërinë time o Musa se nëse ti do ta mendojshe njëren nga ata tri krijesat e mija më pa vlerë se veten tënde; Un do të hidhërohesha nga ti o Musa dhe do ti ulësja gradat ty por ti je shumë i drejtë [je i përvullur, nuk je kryelartë=mendje madh=nga ata që ju pëlqen vetja e tyre].” Përsa i takon ngritjes e uljes së gradave Kurani thotë: “Allahu xh. sh. ngre lartë dhe ulë poshtë.” Kurani na tregon se Allahu xh. sh. i ka thënë Musait a. s. : “Unë të zgjodha ty [o Musa] për shpalljen Time. ”S. Taha. aj. 41. Le të marrin shembull nga kjo ngjarje të vjetërit dhe të rijtë.

Allahu xh. sh i udhëzoftë të sinqertit.

94-PAQARTËSIJA E DISA TË RINJËVE MUSLIMANË DHE RËNJA E TYRE NË GRACKËN E QAFIRAVE DHE MUNAFIKËVE

Disa nga të rinjtë tanë sot në këtë kohë po thonë se Zoti=Allahu xh. sh. ka duar, ka këmbë, ka fytyrë dhe Ai qëndron në karrien e Tij. Kështu që janë të detyruar që ti japin Zotit xh. sh. edhe anë majtas e djathtas, poshtë e lartë dhe kështu Zoti xh. sh. si pas tyre del në formë njeriu sikurse e cilsojnë kristjanët estagfirullah. Këto gjëra dikur i kan pas thënë mytezilitët=të shkëputurit-të devijuarit nga Islami, të cilët në atë kohë të largët e dërrmuan fenë Islame dhe librat me idet e tyre po e dëmtojnë përsëri sot fenë Islame dhe muslimanët. Për këto gjëra kan dhënë sqarime dijetarët e parë Islam. Në Kuran ka ajete ku Allahu xh. sh. ka folur me alegori-indirekt dhe me metafora krahasime apo nënkuptime të bukura. Fjala dora e Allahut e ka kuptimin në formë metaforike pushteti=fuqija e madhe e Allahut xh. sh. Ja një shembull me këtë kuptim: Mos luaj me qeverinë se qeveria e ka dorën e madhe=[pra është kuptimi ajo e ka fuqinë të madhe]. Allahu xh. sh, në Kuran na e bën të ditur këtë gjë që mora si shembull. Ai thotë : “I madhërushëm është Ai [Allahu], që në dorën e fuqisë së Tij është i tërë sundimi dhe Ai ka

fuqi mbi çdo send. "S. Mulk. ajet. 1. Fjala dorë është metaforë, është me nënkuptim për fuqin e madhe të Allahut xh. sh. Sikurse e thash më lartë disa njerëz nga të rinjtë nuk i pranojnë sevapet-mirësitë e këndimit të Kuranit për të vdekurin. Indirekt ata dashje pa dashje e mohojnë kështu pa vdekësinë e shpirtit, mohojnë kështu jetën e varrit e cila vërtetohet me Kuran dhe hadithe.

Kjo gjë që bëjnë ata shkon drejtë mohimit të botës tjetër pas vdekjes-ahiretin. Ata gjithashtu nuk besojnë se ka pasur dhe ka euvlija e nuk i pranojnë kerametet e evlijavet. Ata nuk pranojnë se ka më frymëzim=inspirim prej Allahut xh. sh. Ata nuk pranojnë se ka pasur murshida=udhëzusa të mëdhenj pas Pejgamberit=pas profetit Muhamed a. s. që disa nga këto kanë qenë me inspirim dhe hikmet prej Allahut xh. sh. ndërsa në anën tjetër ata pranojnë që shejtanët e mallkuar i inspirojnë-i frymëzojnë njerëzit që janë miqë të tyre. Kurani thotë; Vërtetë shejtanët i frymëzojnë [i inspirojnë] miqtë e tyre. "S. En-nam. aj. 121. Por edhe Allahu xh. sh ka miqtë e Tij-të dashurit e Tij.

Kurani thotë: "Të dashurit e Allahut janë vetëm ata që ruhen nga të bëmit shok Allahut dhe nga gjërat e ndalume = haramet." S.Enfalë. Edhe Allahu xh.sh. i inspiron= i frymëzon, ju jep hikmet e dije të fshehtë miqëve të Tij, njerëzve që do më shumë, për ta ditur ata se cila është e vërteta dhe cila është gënjeshtër e shpikur nga djalli dhe miqtë e tij. Për këta njerëz me shpirt të pastër me hidajet e hikmet. Për të udhëzuarit tek e vërteta, Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Për ju [o njerëz] krijuam imam [prijësa] që me urdhërin tonë udhëzojnë [ju tregojnë njerëzve udhën ose rrugën e drejtë]." S. Sexhde. aj. 24. Nga këta prinjësa kanë qenë Imam Ebu Hanifja, Imam Ahmedi, Imam, Maliku, Imam Shafiu e të tjerë.. Këta njerëz me shpirt të pastër i ruante Allahu xh. sh. që mos të devijonin nga e vërteta e nga e drejta. Kurani thotë: Ai [Allahu xh. sh.] ndërhyr ngushtë tek ai [shpirti i pastër] me inspirim për ta ruajtur atë që mos të rrëshqasi nga e vërteta dhe ta mbrojë atë nga e keqëja. "aj. 8. Një njeri i ditur ka thënë; vazhdimisht përsëritet gënjeshtria, por vazhdimisht e kërkon nevoja të përsëritet dhe e vërteta. Kjo gjë është fjalë e vërtetë. Vërtetë është çudi me disa të rinjë të hutuar që; në një anë besojnë që ka magjistarë e fallxhorë që janë miqtë e djallit të mallkuar dhe marrin lajme prej këtij të mallkuari, ndërsa në anën tjetër nuk besojnë se dhe miqtë e Allahut

xh. sh, kan marrë dije e njoftime prej Allahut xh. sh. kur ka dashur dhe si ka dashur Ai.

Në Kuran përmenden të dyja palët edhe euvlijai shejtan= miqtë e shejtanit=djallit të mallkuar, dhe euvlijauallah=miqtë e Allahut të madhëruar, xh. sh. Shum nga djemtë e rinj që kan mësuar për fenë Islame nuk i shohim që ti bëjnë lutje Allahut xh.sh. pas mbaimit të namazin dhe nuk është çudi që ka nga ata që asnjëher fare nuk i luten Atij. Disa të tjerë janë më shum natyralista se besimtar. Ata thonë se Zoti xh. sh. i ka dhënë njeriut mëndjen në kokë dhe i ka treguar ligjin=Kuranin dhe njeriu është i lirë të veprojë si të dojë. Me besu se njeriu ka liri të pakufishme e kopetencia të plota,kjo gjë të çon në mohimin kaderit=caktimit ose vendimit të Zotit xh.sh. Ky mendim të çon në mohimin e ushtrimit të veprimtaris së Allahut xh.sh. në gjithsi duke e nxjerr atë indiferent nga punët botës.Ndërsa Kurani thotë: "Allahu çdo ditë është i zën [i proukupuar] me çështje të reja." S. Rrad. Për lutjen Allahu xh.sh. në Kuran thotë: "Mu lutni që unë tu përgjigjem e ata që nga mendjemadhësia i shmangen lutjes ndaj meje [thotë Allahu xh.sh.] do të hynë të nënçmuar në xhehenem" S.Gafir. aj. 60. Pejgamberi a. s. ka thënë: "Duaja=lutja është kripa e namazit, lutja është thelbi i adhurimit. Trans. Tirmidhiu dhe Ibni Hibani. "Allahu ka thënë në Kuran; 'Bëhu prej atyre që luten. "S. Hixher. aj. 98. Ai gjithashtu thotë: "Allahu heq nga evidenca e fut në evidencë. "S. Rrad. Ndërsa për kaderin-caktimin e Tij Allahu xh. sh. thotë: "Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj e që të mos jetë në shënime para se të ngajë ajo e kjo për Allahun është e lehtë. S. Hadid. aj. 22. Allahu xh. sh. thotë në Kuran; A kujton njeriu se do të lihet i lirë-pa përgjegjësi ? Gjithashtu Kurani thotë: "Atij-[Allahut] nuk kan të drejtë njerëzit ti bëjnë vërejtje [kritika]". S. Neb-be. aj. 37. Një njeri që thotë jam besimtar dhe në anën tjetër nuk beson se çdo gjë dhe e vogël i nënshtrohet vendimit e urdhërit të Allahut xh. sh. ai njeri quhet natyralist=beson natyrën për Zot estagfirullah; do të thotë që është ateist me një mënyrë të stërholluar, por natyra është e krijuar nga Zoti xh.sh. Disa nga këta studentë të rinj të fesë si kudo në botë edhe këtu në vendin tone po hedhin baltë mbi dijetarët e par Islam. Këtu në vëndin tonë po i akuzojnë për të pa ditur dhe me bidade=shpikje të dëmëshme në me fenë Islame, shum dijetarë të njohur të vendit tone që punuan shum si Haxhi Vehbi Agollin [Dibra] nga Dibra e Madhe, Haxhi

Hafiz Mahmud Dashin nga Tirana, Sheh Qazim Hoxhën e Hasan Tahsinin nga Shkodra, Hafiz Ali Korçën e Hafiz Abdullah Zemlakun nga Korça, Hafiz Qazim Ismailin nga Vlora, nga Berati e të tjerë nga të gjitha trevat shqipëtare brënda dhe jashtë kufive të Shqipërisë. Allahu xh. sh. i mëshiroftë të vjetrit që na paraprinë neve në besimin Islam.

Këto të rinjë mjerishtë sot po ju thonë popullit se dijetarët e vjetër kanë folur e vepruar gabim në shumë çështje e rregulla të fesë Islame. Për disa çështje e rregulla të fesë që disa nga të rinjë po i kundërshtojnë shumë, un sa kam pasur mundësi kam shkruar për ti sqaruar ata në librin me titullin; SQARIME ME ARGUMENTE NGA KURANI E HADITHI PËR DISA ÇËSHTJE FETARE ISLAME. Tiranë 2006. E theksoj se fenë nuk e njihnin mir vetëm disa hoxhallarë që kishin mësuar disa gjëra të thjeshta sa për të krye faljen e namazit dhe ceremonitë mortore por jo dijetarët që kishin studiuar e vepruar si pas dijes shumë vite. Edhe ata me shumë përkushtim në vëndet muslimane kishin mësuar:Në Egjipt, Turqi, Pakistan, Siri e tje. Është e vërtetë që dijetarët mundet të bëjnë gabim, se vetëm Allahu xh. sh, nuk gabon. Ata mund të gabojnë për ndonjë çështje fetare që nuk është thënë shumë qartë në Kuran ose në Hadithë se është thënë në mënyrë indirekte, metaforike ose ajo gjë përfshin shumë kuptime por dijetarët nuk kanë gabuar në çështjet që janë të qarta si drita e diellit.

Dijetarët tanë Islam që përmënda më sipër dhe shumë të tjerë si ata në fshatra e qytete, jua kanë mësuar tamam çështjet e fesë Islame besimtarëve muslimanë në vëndin tonë. Këto dijetarë kanë qenë të kujdesëshëm pasi e kishin frikë Allahun xh. sh. Përsa i takon çështjeve kryesore të fesë Islame, ata kanë gabuar vetëm në çështjen e madhe kryesore në çështjen e njisimit të Allahut xh. sh. në gjuhën amtare-në gjuhën Shqipe e në çdo gjuhë tjetër duke ra kështu pa dashje në shirkun me gojë të cilin Allahu xh. sh. nuk ia fal njeriut nëse njeriu bëhet me dije=lajmërohet për këtë gjë. Këtu në këtë çështje dijetarët Islam kanë gabuar por jo nga paditurija por u ngatërruan në fjalorin e ri të gjuhës Shqipe që fillojë të shkruhet me vonesë në vëndin tonë. Ata i përdorën fjalët që formojnë qyfer dhe shirk në gjuhën Shqipe ashtu sikurse i dëgjuan e i mësuan nga ata që u morën me shkrimin e zhvillimin gjuhës Shqipe të cilët nuk kishin dituri feje dhe as që e morën fare parasyshë

domethënjën e termave gjuhësore shqipe në lidhje me fenë Islame. Në gjuhën shqipe me emrin Zoti besimtarët thërrasin Krijusin e Gjithsisë. Në gjuhën shqipe muslimanët me emrin Zoti xh. sh. i thonë Allahut xh.sh. që është një Zot i vetëm pa shok e ortak. Ndërsa kristjanët, vërtetë besojnë në një Zot të vetëm por ata Zoti i thonë njeriut, “Jezusit ose Krishtit” estagfirullah i cili ishte njeri si gjithë njerëzit tjerë. Gjithashtu kristianët edhe priftit i thonë im Zot ose dryshe Zoti im estagfirullah-estagfirullah. Allahu xh.sh. na ruajtë ne muslimanëve nga këta fjalë jashtë fesë e jashtë llogjikës. Allahu xh. sh. i udhëzofhtë ata kriistian që kan besim e që duan ta dinë të vërtetën se qysh është dhe si është ajo. Kështu që “kristianët” që u morën me gjuhën shqipe nuk e quajtën dhe nuk e quajnë edhe sot fjalë të keqe në kundërshtim me fenë që ti thuash njeriut Zoti: Estagfirullah, estagfirullah. Zoti xh. sh. na ruajt.

Zoti xh. sh. ju dhashtë dije njerëzve të sinqertë që të gjykojnë e të flasin sipas rregullave të fesë. Për ti dhënë rrugëzgjdhje çështjeve të pa kuptushme nga dijetarët e fesë, Allahu xh. sh. her pas here dërgoi me shërbim pas Pejgamberit a. s. në çdo njëqindë vite, një muxhedidë-ripërtëritës të fesë prej muslimanëve në ata vende ku deshi për ta pastruar fenë nga bidadet=nga shpikjet në emër të saj që feja të mbetet e pastër. Nga këta muxhedida e fundit ishte murshidja Aishe rahmetullahi alejha e cila ishte e ngarkuar prej Allahut xh. sh. me shërbimin e thirrjes të njerëzve në tobe me kushtin e pare njisimin e Allahut xh. sh. në çdo gjuh. Kurani thotë: “Allahu zgjedh të dërguar prej engjëjve dhe prej njerëzve. Allahu dëgjon [se çfarë thonë njerëzit] dhe shikon [se çfarë bëjnë ata.] S. Haxh. aj. 75. Kurani gjithashtu na sqaron kështu: Allahu nuk bën që ti lë besimtarët ashtu sikur janë pa dalluar të keqin nga i miri; Allahu nuk jua zbulon juve të gjithëve [sa jeni] të fshehtat por Allahu është Ai që nga të dërguarit e vet zgjedh atë që do [dhe ia zbulon ndonjë të fshehtë që do.] Prandaj besoni Allahut dhe të dërguarit e Tij. Nëse besoni dhe nëse ruheni [nga të këqijat] atëherë ju keni një shpërbim të madh. ” S. Ali Imran. aj. 179. Kështu pra 1434 vite më par Allahu xh. sh. na paralajmëron në Kuran për dërgimin me shërbim të muxhedidave=ripërtëritësve të fesë me shërbim prej Tij për ta ruajtë fenë gjithmon të pastër. Po ta themi me fjalë popullore muxhedidat që i sollli Allahu xh. sh. në çdo shekull ishin rojet e fesë. Me anë të muxhedidave Allahu xh. sh. e pastronte fenë e Tij

nga bidadet-gjërat e shpikura në emër të saj nga njerëzit me qëllim të keq ose kur dijetarët kishin mendime të ndryshme për një ose disa çështje që dilnin në atë shekull. Muxhedidad ishin rir-freskusa të imanit në zemrat e besimtarëve duke e ndar të vërtetën nga e pa vërteta siç e ndan bujku kokrrën e grurit nga kashta. Muxhedidat nuk gabojschin siç mund të gabonin dijetarët të cilët flasin sipas asaj që kanë mësuar në shkollë.

Muxhedidat e merrnin dijen direkt prej Allahut xh. sh. për çështjet e ndërlikuara që dilnin në atë shekull për fusha të ndryshme të jetës së njerëzve. Këta njerëz të ngarkuar me shërbim prej Allahut xh. sh. kan qenë euvlijaullah=miqtë ose të dashurit e Allahut xh. sh. dhe kan ecur në gjurmat e Pejgamberit a. s. pa deviju pa dalë asnjë grimë nga rruga e tij. Prandaj ju them sot të rijëve e të vjetërve mos të nguten duke menduar se i dinë të gjitha çështjet e fesë se ngutja dhe uni=fjala unë janë veprime të shejtanit të mallkuar lanetullah. Ai e gjeti belanë se u ngut pa u menduar mir. Lus Allahun xh. sh. që të gjithë besimtarët e besimtareti ti udhëzojë gjithmonë tek e vërteta, tek e drejta.

Kurani thotë: “Besimtarë të vërtetë janë ata të cilët kur përmëndet Allahu ju rrënqethen zemrat e tyre, të cilët kur ju lexohen ajetet e Tij [ose ju tregohen shenjat e mrekullive dhe fuqis së Tij] ju shtohet besimi dhe janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. [që e kan besuar sinqerishtë]”. S. Enfalë. aj.2 . Lus Allahun xh. sh. që të gjithë besimtarët e sinqertë që e kan nga pa diturija të rinjë e të vjetër ti udhëzojë gjithmonë tek e drejta dhe e vërteta se Allahu xh. sh. është i kënaqur prej saj. Kurani thotë: “Largë të metave [o besimtar] është Zoti ytë, Zoti i gjithëfuqishëm nga ajo që ata [mohuat dhe mendje lehtit] i përshkruajn [shokë e ortakë]. Çdo e mir qoftë ndaj të dërguarve [të Tij] dhe falenderimi i qoftë Allahut, Zotit të gjithësisë. ”S. Safat. ajetet 180, 181, 182.

95- ÇFAR JANË EUVLIJATË, SI JANË ATA, DHE A KA SOT NË BOTË EUVLIA?

Kurani famëlart thotë: “Pejgamberët dhe euvlijatë trashëgimtarët e pejgamberëve, vetëm këta i ka bër hidajet [i ka udhëzuar tamam] Allahu xh. sh.” Euvlija do të thotë miku i Allahut ose i

dashuri i Allahut xh. sh. . Euvlijatë përmenden në Kuranë. Për cilësitë e euvlijavet Kurani thotë: "Ta dini se të dashurit e Allahut [evlijatë] nuk kanë frikë e as kurrëfar brengosje. [Ata] Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepet myzhde-mubesherat [lajme të mira] në jetën e dynjasë dhe në jetën tjetër. Premtimet e Allahut nuk mundë të kenë ndryshim. E ai është sukcesi i madh" S. Junus. aj. 62, 63, 64. Të afërmit e Allahut xh. sh. pra janë ato që e duan shumë Allahun xh. sh. dhe i binden caktimeve ose vendimeve të Tij. Allahu xh. sh. në Kuran tregon dy cilësitë kryesore të evlijavet. Kurani thotë; "Të dashurit e Allahut janë vetëm ata që ruhen nga vënja shok Atij [Allahut] dhe nga gjërat e ndalume [haramet]". Atyre u rrënqethet lëkura e trupit nga dashurija dhe frika kur e përmendin Allahun xh. sh. Ata zbatojnë mësimet e Kuranit të madhërshëm largohen nga veprimet, shikimet, dëgjimet dhe mendimet e liga. Ata e duan shumë Pejgamberin a. s. i zbatojnë porositë e tij dhe e përshëndesin atë vazhdimisht me selam kurë e kujtojnë ose dëgjojnë emrin e tij.

Ndërsa miqtë e shejtanit janë ata që i binden djallit të mallkuar, dhe veprojnë në kundërshtim me Kuranin duke e urrejtë Pejgamberin a. s. Ata janë gënjeshtarë të mëdhej, rrinë xhunub, kanë mendime të liga e bëjnë vepra të liga ashtu sikurse i nxitë shejtani mallkuar lanetullah. Evlijatë=miqtë e Allahut xh. sh. janë ata njerëz të rrallë që kanë arritur në shkallën e hakikatit me besimin e fortë në Allahun xh. sh. dhe zbatimin me përpikëmeri të urdhërave të Tij, duke i shumëfishuar vazhdimisht punët e mira e duke qënë të bindur ndaj kadereve=caktimeve ose vendimeve të Allahut xh. sh. Për këto njerëz flet Allahu xh. sh, në Kuranë ; "Ela inne evlijaellahi la khaufun alejhim ve la hum jahzenun. " =Miqtë e Allahut janë ata që as nuk frikësohen e as nuk dëshpërohen" [duke thënë o bobo si e pësuam ne kështu.] Këto njerëz nuk kanë qëllim tjetër porë vetëm të fitojnë dashurinë e Allahut xh. sh. Ata ruhen nga haramet që mosë ta hidhërojnë Allahun xh. sh. dhe i zbatojnë ligjet e fesë duke i krye detyrimet e saj, farzet, vaxhibet, synetet, nafilet dhe mustehabet. Këtyre njerëzve Allahu xh. sh. iu jep hidajet = i drejton plotsishtë në rrugën e drejtë=sirati mustekijm. Këta llojë njerzish janë evlija ose shqip të shejtë. Evlijatë janë miqtë e Allahut xh. sh. dhe Ai i pranon lutjet e tyre por ata nuk mundë ti shpëtojnë njerëzit nga dënimi i Allahut xh. sh. për fajet që kanë bërë e as

nuk mundet ti shërojnë njerëzit. Shërimi vjen vetëm prej Allahut xh. sh. nëse ai dëshiron. Evlijatë nuk kan asgjë në dorën e tyre. Prandaj nuk kërkohet ndihmë e shërim nga evlijatë i vdekur ose i gjallë qoftë nëse njerzit mendojn nga kerametet që shohin se ai është evlija por kërkohet ndihmë vetëm prej Allahut xh.sh. Njeriu i mir i bën lutje Allahut xh. sh. dhe po deshi Allahu ia pranon lutjen atij. Ai nuk ka asgjë në dorën e vet. Kush i mbështetet=dorëzohet për ndihmë tjetër kujtë veç Allahut xh. sh, ai njeri ka bër shirk ose kufër, kamohuar të vërtetën. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: "Dhe mos ju lut tjetër kujtë veç Allahut..." Nëse Allahu të provon me një gjë të keqe atë nuk mund ta largojë askush përveç Tij. . S. Junus. aj. 106. gjithashtu Kurani thotë: "Lutja e vërtetë është vetëm ajo drejtuar Atij [Allahut xh. sh.] e ata që iu luten të tjerëve përveç Tij, ata nuk ju përgjigjen atyre [nuk jua mbarojnë hallin atyre]...S. Rad. aj. 14 dhe 15.

Njerëzit si nga pamja ashtu dhe nga forca e besimit nuk janë të një llojtë. Po ashtu ndryshojnë edhe në cilësinë e punëve. Shkallët e punëve të mira të njeriut ndahen në disa kategori që quhen mekame=shkallë ose grada. Bota e mbinatyrshme-bota tjetër e pa dukëshme, është ajo botë që do të shkojmë pas vdekjes. Ai njeri që do për të shkuar që tani shpirtërishtë e jo fizikisht me trup, në botën e pa dukshme duhet një përkushtim i madh shumë në rrugën e Allahut xh. sh. Natë e ditë duhet të bëjsh ibadet në rrugën e Allahut xh. sh. të punosh për të fituar xhenetin e më pak punë dynjaje. Me punuar sa për të jetuar dhe me ushqye trupin me ushqim hallall me djersën e ballit dhe të fleshë gjumë sa për të mbajtur shëndetin. Mirpo këta veprime nuk mundë ti bëjnë të gjithë njerëzit. Kësaj shkalle i bën shenjë Kurani në shtatë ajetet e sures Fatiha ku jemi urdhëruar të themi në çdo namazë ij-jakennesteijn-Vetem te Ti [o Zot] kërkujmë ndihmë. Po kush janë ata njerëz që vërtetë i bështeten plotësishtë vetëm Zotit-Allahut xh. sh. Ai thotë në Kuran; Ata që i mbështeten plotësishtë Allahut, Ai u mjafton atyre. Vërtetë se ne jemi të urdhëruar nga Zoti xh. sh. që ti bëjmë mir njëri tjetrit dhe me e dijtë të mirën që na e ban neve dikush, por mos të harrojmë për asnjë momentë se bamirësi i vërtetë është Zoti xh. sh. dhe njeriu që të ban të mirën është një mjet i dukshëm që ta bëri Zoti xh. sh. shkaktarë për me të dhanë të mirën ose me të mbaruar hallin. Një njeri që i hudhë ndjejat e dashurisë e sim-

patisë ke shkaktari i dukshëm, tek njeriu që ja bëri të mirën duke e falenderuar atë njeri me gojë, me zemër e ndoshta dhe me ndonjë dhuratë, duke menduar se mos të ishte filani atij nuk do ti vinte ajo e mirë në dorë.

Ndërsa bamirësin e vërtetë-Zotin e plotfuqishëm xh. sh nuk. e falenderon me gojë, me shpirtë dhe me më të madhin falenderim me kokën në sexhde duke falur namaz. Ky tip njeriu kështu që e heq dashurinë e simpatinë prej Zotit xh. sh. dhe e hudhë tekë njeriu ka bër shirk hafij=shirk e kufër të fshehtë ndaj Allahut xh.sh.

Njeriu që mendo e vepron kështu nuk mundet të bëhet njeri i dashur tekë Zoti=tekë Allahu xh. sh. Sigurisht që njeriu duhet ta dijë, ta njoh ose ta çmojë të mirën që ja bëri ai tjetri. Ta urojë e ta nderojë me fjalë të mira atë njeri që ia bëri të mirën e gjithashtu nëse i jepet rasti të mundohet të ia shpërblej atij por mendjen dhe dashurinë ta ketë krysishtë dhe krejtësishtë vetëm te Allahu xh. sh. Ta falenderojë me shpirtë dhe me gojë duke thënë fjalën elhamdu lil lah dhe me sexhde duke fal namazë për Allahun xh.sh. 3-Mekami ose shkalla e Marifetit dhe Hakikatit.

Kësaj shkalle i jep shenjë ajeti tjetër në suren Fatiha ajeti: "Ihdinas sirratal mustekijm." "Na udhëzo [o Zot xh. sh.] në rrugën e drejtë. Ai njeri që e arrin këtë shkallë me punë dhe jo me fjalë, me praktikë e jo me teori, ai njeri atëherë vetëm se me trup është i gjallë në këtë botë por mendja dhe shpirti i tij mendojnë natë e ditë për të fituar lumturinë e botës së përherëshme=xhenetin duke i vu frena të forta ndjeve të lakmisë, të nefsit, e të unit=vetpëlqimit. Profeti Muhamed a. s. ka qenë njeriu më i plotësuar dhe më i përsosur në gjithësi, në të gjitha pikëpamjet. Ai ia jepte çdo gjëje të drejtën që i përkiste me një drejtësi tepër të madhe e preçize. Pejgamberi a. s. ka qenë njeri qamilë=i plotësuar dhe ekmel=i përsosur. Në rrugën e tij janë munduar të ecin shumë njerëz nga ymeti i tij. Nga këta njerëz më të dalluarit ishin katër hulefai rashidinët-halifët e drejtë; haz Ebu Bekiri, Ymeri, Osmani, Aliu qoftë i kënaqur Allahu xh. sh. prej tyre. Ehli Suneti thonë se besimi në kerametet e evlijave është prej bazave të imanit=besimit. Ata njerëz që i mohuan dhe i mohojnë kerametet e evlijave ishin dhe janë mytezilitë=të larguar ose devijuar nga feja Islame. Për kerametet e evlijavet tregon Allahu xh. sh. në Kuran e Pejgamberi a. s. me hadith. Gjithashtu shumë njerëz të ndryshëm dijetarë e besimtarë të thjeshtë kanë dëshmuar

për kerametet e euvlijave në çdo kohë dhe në çdo vendë.

Imam Ahmedi thotë: "Ata njerëz që nuk i besojnë kerametet e evlijavet janë të humbur e të devijuar=të larguar nga feja Islame. "Kerametet janë gjëra të jashtzakonshme, të çuditëshme që jua jep Allahu xh. sh. njerëzve të Tij të dashur [evlijavet] për shkak të besimit të fort=të pa lëkundur e dashuris së madhe që ata kanë për Allahun xh. sh. dhe për të dërguarin e Tij profetin Muhamed a. s. Ata i zbatojnë vendosmërisht urdhërat e Allahut xh. sh. dhe porosinë e Pejgamberit a. s.

96-SHKALLËT E UDHËZIMIT PREJ ALLAHUT XH. SH. TEK KRIJESAT E TIJ.

Allahu xh. sh. në Kuran thotë: "Këta ishin që Allahu i gradoi nga pejgamberët.....dhe prej atyre [që nuk ishin pejgamberë] që i udhëzua dhe i bëme të zgjedhur. "S. Merjem. aj. 58. O vëllezër besimtar : Hidajeti=udhëzimi nga Allahu xh. sh. është disa llojesh tek krijesat e Tij, por mënyrat janë katër llojesh. 1-Me anë të mendjes dhe shqisave [syve e veshëve] me të cilën dallojnë të mirën e të keqen, 2-Me argumentet ose fakte të pa kundërshtueshme, 3-Me pejgamberët=lajmëtarët e Zotit dhe librat e shejtë, dhe 4-Udhëzim tek e vërteta direkt nga Allahu xh. sh. me njërin nga këto forma; 1-Me vahji=revelatë direkt prej Allahut xh. sh. pa ndërmjetësimin e melekut=engjëllit sikurse e mori haz Musai a. s. ose sikurse profeti ynë haz Muhamedi natën e miraxhit, 2- me ndërmjetës me anën e melekut=engjëllit, 3-Me ilham=me inspirim sikurse nëna e Musait a. s. dhe 4-Me rruëja=me ëndërr pjesë filmike mes gjumit e zgjimit, sikurse e mori haz Ibrahim a. s, që ta bënte kurban djalin e tij Ismailin a. s. dhe ashtu si haz. Jusufi a. s. që pa ëndërr në lidhje me vëllezërit e tij. Selam paçin profetët e Zotit xh. sh. Më së shumti me vaji e nëpërmjet melekut janë ba hidajet ose shqip janë udhëzuar nga Allahu xh. sh. pejgamberët ndërsa me ilham me inspirim ose frymzim dhe me rrujë= me anë të ëndrrës janë udhëhequr prej Allahu xh. sh. më shumë evlijatë=miqtë ose të dashurit e Allahut xh. sh. Pra pejgamberët dhe evlijatë i ka udhëhequr Allahu xh. sh, me hidajet të veçantë. Allahu xh. sh. thotë në Kuran për ata kështu: "Pejgamberët dhe evlijatë si trashëgimtarë të pejgamberëve, vetëm këto i ka bër hidajet=i ka udhëzuar Allahu". Sikurse kuptohet nga

ky ajet Kurani kategoria më e lartë e hidajetit=e udhizimit është e posaçme për profetët dhe euvlijatë. Për këtë hidajet i luten Allahu xh. sh. në çdo namazë besimtarët kur thonë "ihdinas siratal mustekim"= "Na udhëhiq o Allah xh. sh. në rrugën e drejtë." Ata njerëz që arritën në këtë shkallë e ruajtën veten jo vetëm nga haramet=gjërat e ndaluara por edhe nga gjërat e dyshimta. Lindë pyetja se a ka në botë sot euvlija? Dijetarët Islam kan thënë; mos thoni që në në këtë botë nuk ka më evlija.

Këto njerëz që mbërrijnë gradën e evlijallëkut=miqësis me Allahun xh. sh. janë njerëz që kan iman të pa tronditur dhe takva= bindje e mbështetje të plotë te Allahu xh. sh. Lum si ai njeri që ka pasur fatin prej Allahut xh. sh, me pas këtë llojë hidajeti=këtë lloj udhëzimi. Këtë udhëzim e kan pasur dhe mund ta kenë vetëm ato njerëz prej muslimanëve që kan një besim shumë të fortë. Ata që e kan shumë frikë Allahun xh. sh. dhe duan mbi çdo gjë, edhe mbi veten e tyre Pejgamberin a. s. që është më i dashuri i Allahut xh. sh. Për këto llojë njerëzish flet Kurani i madhërshëm i cili thotë: "Jehdihim Rabbuhum bi imanihim"-Ata i udhëheq Allahu xh. sh. sipas besimit të tyre=Pra i udhëzon=për ta kuptuar të vërtetën sipas forcës së besimit të tyre.

Ky lloj hidajeti = udhëzimi i veçantë në shkallë të lartë që i jep Allahu xh. sh. atij që do nga njerëzit e Tij, vjen vetëm se duke ndjekur si shembull në besim e veprime më të dashurin e Allahut xh. sh. të dërguarin e tij, profetin Muhamed a. s. Për tu lartësuar me gradën e Allahut xh. sh, duhet pra me ndjek sikur duhet Pejgamberin a. s. për të cilin Allahu xh. sh. thotë në Kuran: " O ju besimtar nëse doni të keni para sysh një shembull të bukur=[të lartë] mbase të cilit ti rregulloni veprimet tuaja; [Beto hem për madhërin Time] se këtë model të bukur e gjeni te i dërguari i Allahut [tek personaliteti i Muhamedit a. s.]. "S. Ahzab. aj. 21. Duhet imani = besimi i fortë dhe shumë ibadet=përkushtim në fenë e Allahut xh. sh. si; namazë, agjërim, mësim dituri, zikër, salavat për Pejgamberin a. s, istgfarë lutje dhe me u mbështetur krejtësisht vetëm te Allahu xh. sh. duke qenë i larguar nga fjalët e liga dhe të kota e duke pasur moral të lartë sjellje të mira me njerëzit. Mos të jeshë mendje madhe mos të keshë kryelartësi, mos të jeshë lakmiqarë në ngrënjë, të ruajsh barkun, sytë, veshët dhe gojën nga haramet=gjërat e ndaluara nga feja Islame dhe gjërat që janë me dyshim të cilat nuk dihen se janë

hallall apo haram. Pas këtyre duhet shumë durim, shumë kanaat =me mjaftu me pak për çdo gjë edhe në gjërat hallall=të lejshme mos me ia plotësuar dëshirën tepër epshit e lakmisë pa kufi. Me pas dije të mjaftueshme dhe me frenuar gojën nga thashethemet,=] gïbeti] fjalët e këqia por dhe nga fjalët e kota e nga mallkimi i besimtarëve. Me e ruajtë veten shumë jo vetëm nga haramet, por dhe nga mekruhet e gjërat me dyshim nga çdo pikpamje. Me mbajtë pastër trupin dhe vendin ku qëndron, ushqimin ta fitoshë me djersën e ballit duke e bërë një lloj pune e jo me qenë dembel e parazit. Duke e ushqye veten në kurrizin e të tjerëve. Të gjithë profetët e Zotit xh. sh. kanë punuar vetë për tu ushqye veten dhe familjen e tyre. Duhet me qenë i vërtetë në fjalë e i drejtë në gjykim. Të keshë shumë frikë Allahun xh. sh. Të jeshë i mëshirshëm për krijesat e Tij kushdo qofshin ata që nuk të dëmtojnë=ose nuk të sulmojnë dhe të jeshë trim për të thënë e mbrojtur të vërtetën e të drejtën. Mos të mendosh, të përfytërosh të imagjinosh=të biesh ndërmend gjëra haram të këqia e të pista për kënaqësi epshore ose gjëra tjera të liga që janë padrejtësina.

Të jeshë i zgjuar e vigilent dhe gjithmonë ti lutesh Allahut xh. sh. që të ruaj nga sherri= [e keqja] e djallit të mallkuar e qafirave, munafikëve, sherri i ziliqarëve, tradhëtarëve e lakmiqarëve dhe sherri i të marrëve-budallejve. Të bësh shumë namazë e agjërime nafile-veç farzeve e syneteve. Nëse i përmbahesh këtyre kushteve duke e ruajt gojën në radhë të parë nga shirku me gojë atëher me dëshirën e Allahut xh. sh. bëhesh miku i Allahut xh. sh.=bëhesh euvlija. Allahu xh. sh. në një hadithi kudsij thotë; "Nuk pushon njeriu im duke mu afruar mua me nafile [namazë e agjërime veç atyre që janë farz=detyrim] dhe kur unë ta dua atë njeri, unë bëhem dora e tij=ai njeri vepron me dorën= forcën ose ndihmën time, bëhem veshi i tij, ai njeri e kupton kur e dëgjon një gjë se ai ndjen udhëzimin tim, bëhem syu i tij =ai njeri shikon realitetin e gjërave, shikon me shqisat e mbrendëshme = me syt e trurit e të zëmrës". Kësaj shkalle vëllezër besimtar që është më e larta i thonë Hak kal jekijn. Fjala jekijn tregon një besim të pa tronditur në asnjë llojë rrethane nga asnjë llojë shkak. Kemi 3 llojë jekini; 1-ilmeljekijn=besim i forcuar me anën e diturisë. 2- ajneljekijn=besim i forcuar me shikim=me anë të argumenteve shkencore. 3-hakkaljekijn=besim

i forcuar me udhëzim të posaçëm prej Allahut xh. sh. Këtyre njerëzve që arrijnë shkallën e tretë ju thonë Euvlija-evlijaullah-të zgjedhurit ose miqtë e Allahut xh. sh. Në gjuhën shqipe ju themi njerëz të shenjtë-të veçantë=të dalluar nga të tjerët. Nga këto njerëz në gradën më të lartë kanë qenë pejgamberët të cilët kanë pasur edhe profetësinë=pejgamberllëkun detyrën lajmëtar i Allahut xh. sh. edhe evlijallëkun=shqip=shejtërinë= ngritjen në shkallë të lartë shpirtërore mbi njerëzit tjerë. Kryetari i gjithë profetëve dhe i gjithë evlijavet është Pejgamberi jonë haz Muhamedi s. s. që ishte i paisur me moralin e Kuranit dhe që në gradën ose shkallën e të cilit nukë e arriti dhe nuk e arrin më askush.

Ata njerëz të tjerë që mbërritën pas tij në shkallën evlijaullah-miku i Allahut ose shqip miku i Zotit xh. sh. ndoqën sheriatin=ligjin fetar Islam. Në këtë shkallë arritën ata njerëz që përveç sheriatit e tarikatit kishin arritur në shkallën e hakikatit. Ata kotrollonin edhe mendimet e veta. Ata veç ruajtjes së organeve të trupit nga haramet=gjërat e dëmshme të ndaluara nga Zoti xh. sh, e ruanin veten dhe nga mendimet e imagjinimet e liga duke menduar ose përfytyruar ndonjë gjë sa do të vogël imorale. Ata vepronin kështu pa pasur asnjë lloj interesi këtu në dynja, por vetëm donin për të fituar kënaqësinë e Allahut xh. sh. Vëllezër besimtarë duhet ta dinj se veprimet e mirat janë me shkallë. Po ashtu dhe njerëzit që vepronjë në këto janë në shkallë të ndryshme. Allahu xh. sh. thot në Kuran kështu: "Secilit sipas veprave që bën i takon shkalla [ose grada]. "S. Ahkaf. aj. 19. Po marrim një shembull. Agjërimi ndahet në tre shkallë ose ndryshe i themi kategori. 1- Shkalla ose kategoria e par është agjërimi i besimtarëve të thjeshtë në përgjithësi, të cilët e ruajnë veten e tyre gjatë agjërimit nga të gjitha ato sende materiale që të prishin agjërimin siç janë; e ngrëna, e pira, duhani dhe kontakti seksual me gruan. 2-Kategorija e dytë është agjërimi i dijetarëve të devotshëm dhe i besimtarëve të fortë në besim është të mbroshë gojën sytë dhe veshët nga të gjitha ata gjëra që janë haram siç janë: E ngrëna haram, e shikuara me qëllim të keq gratë e botës, e dëgjuara ata gjëra që janë gjynah siç është ahengumuzika, lojrat e kota e tjera. Të rujash gojën mos të hashë gjëra me dyshim, të ruhesh nga gënjeshtria, përgojimi=eçuara fjalë tekë tjetri për grindje e mosmarrveshtje dhe kur ta çelësh iftarin, mos të hashë shumë por mesatarishtë. 3-Agjërimi i shkallës së tretë është

agjërimi i njerëzve të dashur të Allahut xh. sh.. pejgamberëve dhe evlijavet-miqëve të Allahut xh. sh.

Këta njerëz veç gjërave të tjera haram që treguam më sipër për njerzit me agjërim të shkallës par dhe të dytë këta njerëz kan ruajtur edhe mendjen nga të menduarit haram, nga imagjinimet ose përfytyrimet haram dhe nga mekruhët=gjërat ose veprimet e neveritëshme. Pra agjërimi i shkallës së tretë bëhet atëherë kur e ruan edhe mendjen mos të shkoi gjatë agjërimit tek dashurija, lakmija e qefet e kësaj bote =qefet e dynjas edhe në qofshin ata hallall-të lejuara. Përshebull afrimi tekë gruaja yte pas ngrënjes së iftarit e deri afër syfyrit është e lejuar por jo e rekomanduar dhe e pylqyshme nga Allahu xh. sh, në muajin e Ramazanit, sepse muaji i Ramazanit është muaj më i rëndësishëm për besimtarët për të ba shumë ibaded=namazë, zikër e dua=lutje Allahut xh. sh. dhe për të shtuar punët tjera të mira. Muaji i Ramazanit është muaji i rahmetit=muaji i mëshirës së Zotit xh. sh. për besimtarët e Tij. Me që njerëzit nuk mund të frenoheshin të gjithë nga kjo gjë që thamë më sipër, Allahu xh. sh. duke e dijtë këtë mos përmbajtje të njerëzve në përgjithsi nuk jua ndalojë pastaj burrave ndarjen nga gratë e tyre natën në muajin e Ramazanit deri në kohën afër syfyrit-fundit të natës nëse dëshirojnë. Një rastë Pejgamberi a. s. ju kishte folur më par shokëve për rëndësinë e ibadetit e të vetë përmbajtjes në muajin e Ramazanit.

Më vonë pas disa ditësh me njoftimin që mori prej Allahut xh. sh. Pejgamberi a. s. i pyeti shokët a keni qëndruar tamam ju o shokë duke e përmbajtë veten në këtë muaj? Disa nga shokët i thanë: Ne nuk e kemi përmbajtë veten tonë o i dërguari i Allahut xh.sh. Ne kemi shkuar te gratë tona të cilat i kemi hallall=të ligjëshme. Të njëjtën fjalë si ata tha dhe njëri nga sahabet=shokët e tij të parë e të afërt. [Thuhet në tevsir se ka qenë haz. Ymeri. r. t. a.] Pejgamberi a. s. atij shokut i tha: Ti o filan nuk duhet ta bëjshe këtë veprim. Nuk të takonte ty o filan ta bëje një veprim të tillë.Nga fjala e Pejgamberit a. s. kuptohet qartë se për besimtarët e devotshëm nuk është veprim i mirë afrimi tek gruaja yte=mardhënjet intime me gruan në muajin e shenjtë të Ramazanit, pamvarsishtë se Allahu xh. sh. e ka lejuar pas kohës së ngrënjes së iftarit deri afër agimit të ditës=para se të kaloj koha e syfyrit. Allahu xh. sh. pastaj sikurse e thashë e ka urdhëruar që besimtarët të ndalojnë veten nga e ngrëna e pira duhan dhe kon-

taktimi me gruan prej syfyrit=fundit të natës para sabahit e deri në kohën pasi të çelin iftar në mbrëmje.

E tregova këtë ngjarje për të vënë në dukje shkallët e veprimit të njerëzve në punët e mira dhe gradat e njerëzve sipas mënyrës që i kryejnë ata. Dhe që e kishim fjalën për njerëzit që arrijnë shkallën "hakkal=jekijn" =besim i forcuar me hidajet=udhëzim direkt prej Allahut xh. sh. këta njerëz mbështeten krejtësisht dhe kryesisht vetëm ke Allahu xh. sh, dhe ke askush tjetër e çdo të mir e dijnë dhe e presin vetëm prej Tij, se Ai është që krijon shkaqet e shkaktarët. Njerëzit me grada të larta ke Allahu xh. sh. i kan nxjerrë nga shpirti qefet dhe lakmitë e dynjasë. Ata në vend të dashurisë dhe lakmisë për të mirat e dynjas, kan futur dashurinë dhe lakminë për të mirat e ahiretit=jetës tjetër pas vdekjes. Këto njerëz mundohen se qysh të kënaqin Allahun xh. sh. që të fitojnë dashurinë e Tij. Që të bëhesh i dashur ke Allahu xh. sh. duhen shum punë të mira e sakrifica të mëdhaja. Allahu xh. sh. na bëftë dhe neve prej atyre njerëzve. Njerëzve të devotshëm që ju vëlon në zemër dashuria për Allahun xh. sh. dhe për Pejgamberin e Tij, mundohen me ia ndriçuar rrugën mbarë njerëzve se ata e konsiderojnë njerzimin si një familje e madhe. Pejgamberi a. s. ka thënë: "Lum si ata që janë të sinqert e të përzemërt. Ata janë llampa ndriçuse të rrugës së mbarë, prej këtyre ndriçohet çdo gjë e mbyllët=çdo gjë e errët." Vëllezër besimtarë duhet ta dini se dashuria për Allahun xh.sh. dhe për Pejgamberin e Tij Muhamedin a. s. është rrëja e fesë dhe duhet ta dini se dashuria e plotë për Allahun xh.sh.nuk mund të rrië bashkë me dashurinë e Masivasë =dashjes dhe nënshtrimit të gjërave të tjera të dynjas, veç Allahut xh. sh. Dijetarët e devotshëm musliman që quhen Ulemai bil lah nuk kan pasur në zemrat e tyre tjetër gjë veç dashurisë së Allahut xh. sh. Mjer ne ku jemi sot. Iterpretuesi i famshëm i Kuranit imami Fahrudin Rraziu duke e komentuar ajetin e Kuranit..."Ve men ahsenu kavlen dea il'Allahi ve amile salihan..." = që do të thotë: Kush mundet me folë fjalë më mirë se ai [njeri] që thërret për tek Allahu xh.sh. dhe punon punë të mira...?" Ai thotë se dijetarët Islam janë tre llojesh ose tre kategorishë. 1-Ulemai bil lah-Dijetarët e Zotit xh..sh. 2-Ulemai bi sifatil lah=Dijetarët e cilësive të Zotit xh. sh. = pra ata dijetarë që i dijnë e i mendojnë thellë cilësitë e Zotit xh. sh. 3-Ulema bi ahkamil lah=Dijetarët e ligjeve të Zotit xh. sh. -dijetarët që i njohin mirë

ligjet e Zotit xh.sh. Vëllezër besimtarë dijetarët e klasit të par, janë ata që e kanë kuptuar si duhet Zotin e madhërshëm-Allahun xh. sh. diturinë dhe forcën e Tij të pakufijshme.

Këtyre njerëzve ju thonë në gjuhën shqipe të shejtë=të dalluar nga të tjerët ose në gjuhën Arabe u thuhet atyre Euvlija, të dashurit ose miqtë e Allahut xh. sh. Këta cilësohen ndryshe dhe Aktab, Arifë, Velij, ose Mukarrebunë=të afërmit e Zotit xh. sh. Vëllezër besimtar; duhet ta dijni mir se të dashurit e Allahut xh.sh. nuk i ka hutar asnjëherë dynjaja. Ata e kundërshtojnë shejtanin alejhi lanet dhe i kishin vu fre nefsit=lakmis së tyre. Këta njerëz të dashur të Allahut xh. sh. kanë pasur një besim shumë të fortë e të pa tronditur në çdo situatë, sado e vështirë të ishte ajo. Nga ky besim që ata kishin, Allahu xh. sh. i udhëzonte kah e mbara vazhdimisht herë pas here. Udhëzimi ose hidajet është dy llojesh. 1=Hidajet ose shqip udhëzim i përgjithshëm dhe udhëzim=hidajet i veçantë=i posaçëm. Hidajeti i përgjithshëm përfshin dhe kafshët. Këtë e vërteton ky ajet nga Kurani : "El-ledhi aëta kul-le shejin khalkahu thumme heda"d. m. th. Allahu pasi e krijoi çdo gjë i dha drejtim=e vu në rrugë. 2-Ndërsa hidajeti ose udhëzimi i veçantë është hidajeti i atyre njerëzve që e besuan vendosmërisht Allahun xh. sh. dhe Kuranin fjalën e Tijë dhe patën dashuri të madhe për Pejgamberin a. s. .

Ky lloj hidajeti-udhëzimi kuptohet sikurse e thashë prej ajetit të Kuranit; "Jehdihim Rabbuhum bi imanihim". =Ata [njerëz] i udhëheq Allahu në rrugë sipas besimit të tyre" Askush në botë o vëllezër besimtar nuk mund ta arrijë këtë gradë që është grada e evlijallëkut=miqësis me Allahun xh. sh. pa ndjekur e pik për pikë profetin Muhamed a. s. Ai që do që ta arrijë këtë gradë të lartë duhet të paiset me moralin e Pejgamberit a. s. =të praktikojë moralin e profetit Muhamed a. s. i cili ka qenë Kuran i gjallë. Me praktikë plotësisht Kuranit famëlartë është shumë punë e vështirë se duhet dituri e mjaftueshme, besim shumë i fortë e i pa tronditur dhe sakrificë të madhaja. Për ta shkoqitur rëndësinë e kësaj vështëresie po përmendim fjalën e Pejgamberit a. s. i cili ka thënë ; "Mua më ka plakur surja e Hudit. "Në këtë sure ndodhet ky ajet Kurani ; "Puno drejtë sikur je urdhëru" Për me gjetë rrugën mes dy ekstremizmave që quhen ifrat e tefrit nuk është punë e lehtë o vëllezër besimtar. Muslimanët e par e kishin kuptuar mirë

ajetin e Kuranit që thotë "Innemel hajatud dunja leibun ve leh'un ve zijnetun ve tefakhurun bejnekum ve tekathurun fil emvali vel evladi kemetheli gajthin". D. m. th. "O ju që e doni dynjan ta dini se dynjaja është lojë, nxitëse e nepsit, stoli e lavdrim mes njëri tjetërit, shtesë pasurije e fëmije. Dynjaja ia përngjanë një shiu që bie në kohën e duhur dhe i jep bimës një hijeshi nga e cila kënaqet bujku që e ka mbjellë. Por ajo shpejt zhduket, vyshket e thahet dhe bujku mbetet pa gjë."

Ndërsa Pejgamberi a. s. në një hadith ka thënë "Un nuk e lakmoj dynjan se un jam si një udhëtar që eci dhe ulem në një hije sa me pushu edhe çohem e vazhdoj rrugën." Që të kuptohemi mirë, feja Islame nuk na mëson me heq dor fare nga dynjaja, mos me punuar e shijuar gjërat hallall të kësaj bote por të punojmë aq sa për të jetuar mesatarisht. Dynjaja, pasurija e paraja na duhen sikurse ujë që i duhet varkës ose anijes. Nëse nuk ka ujë fare anija nuk ecën, por dhe nëse ka ujë me shumë dallgë anija mbytet. Në Kuranë Allahu xh. sh. Thotë: "Kel, la innel insane lejetga. En reahus stagna" = "Me të vërtetë njeriu bëhet kryelartë = mendje madh = rrebelon=bëhet mos falenderus ndaj Allahut xh. sh. sapo e ndien veten të pasur [sapo bëhet i pasur e i fortë me shumë miq dhe shokë]". S. Alak. aj. 6, 7. O vëllezër besimtar ta dini se dynjaja është mjet por jo qëllim. Dynjaja neve na duhet sa për të udhëtuar anija e jetës. Në fenë Islame është e përbuzur lakmia e tepërt, por nuk lejohet edhe papunsia. Profeti Muhamed a. s. ka thënë: "Nuk e do Allahu xh.sh. njeriun që është dembel". Pra njeriu që ka fuqi të punoi por nuk punon asnjë lloj pune, ai njeri është armiku i Allahut xh. sh. Gjithashtu Pejgamberi a. s. ka thënë: "Ruhuni, mos bëhi si të vdekur duke ndenjor pa punë." Ai ka thënë: "Është i urrejtur prej Allahut xh. sh. ai njeri që e ka shëndetin dhe nuk punon asnjë lloj pune, por pret nga të tjerët që ta ushqejnë." Sikurse e kam thënë muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha vinte orën para syvet kur punonte në makinën qepëse dhe e ndante kohën gjatë 24 orëve në katër pjesë. Për ibadet, për punë, për pastrim e gatim ushqimi dhe për gjumë. Allahu xh. sh. e mëshiroftë atë dhe të gjithë besimtarët që ndoqën rrugën e profetit Muhamed a. s.

97-VAZHDOJMË TË FLASIM GJITHËNJË PËR EVLIJATË.

Pejgamberi a. s. ka thënë: "Janë disa njerëz të Allahut xh. sh. të cilët nuk janë pejgamber e as shehida [dëshmor për fenë e Allahut xh. sh.] porë për pozitën [për gradën] që ju ka dhënë Allahu xh. sh. i kan lakmi edhe pejgamberët. "Vëllezër besimtar sikurse e tham më sipër evlijatë i përmend Allahu xh. sh. në Kuranin famëlartë me fjalën euvlijaullah=miqtë e Allahut xh. sh. Hazreti Aliu r. t. a. ka thënë për euvlijatë kështu; "Këto njerëz që janë miqtë e Allahut xh. sh. barkun e kanë të zgropët [nuk hanë shumë=nuk janë të shëndoshët] buzët i kanë të thata se agjërojnë shumë dhe fytyrën të verdhë." Nga këto njerëz që përmendë imam Aliu r. t. a. disa nga këto o vëllezër besimtar ishin të caktuar me shërbim nga Allahu xh. sh. Këto njerëz të caktuar me shërbim nga Allahu xh. sh. si prinjësia për besimtarët, ishin të ruajtur shumë nga haramet, dhe mekruhët, hanin pak dhe bënin shumë ibadet, ishin të durushëm dhe mundoheshin për ti udhëzuar njerëzit në rrugën e Allahut xh. sh.

Këta murshida me hidajet të veçantë prej Allahut xh. sh. mundoheshin për të mirën e njerëzve. Këta kan qenë njerëzit më të mir në fytyrën e tokës, pas pejgamberëve. Punuan shumë për botën tjetër=ahiretin, duke u larguar nga qefet e dynjas. Qëllimi i tyre në këtë botë ishte luftimi kundër nefsit e shejtanit të mallkuar dhe shokëve të tij qafirave dhe munafikëve, për të fituar xhenetin. Ata përveç farzeve e syneteve bënë dhe ibadete nafile=tepër detyrës së urdhërume e të porositme, dhe në gjërat hallall=të lejuara, ata nuk lakmonin. Nuk është prinjës i pa gabuar ai njeri që e zgjedhin dhe e shejtërojnë nëpër kuvendet e tyre, ata njerëz që sot i thonë vehtes Alevij dhe veprojnë ashtu sikurse të krishterët që i shënjtërojnë vet njerëzit me vendim komisioni ose duke e lënë sipas dëshirës së vet, i ati të birin. Por prinjës i dalluar nga të tjerët dhe që nuk gabonte në atë që thoshte, ishte ai njeri që e zgjedhte vet Allahu xh. sh. Ai atë njeri kur e ngarkonte me shërbim të caktuar i jepte argumente të qarta [me keramete] që vërtetohen në Kuran e hadith. Allahu xh. sh. thotë në Kuran në suren Ali Imran se të dërguarit kan ardhë te popujt e tyre me argumente të prera, me shkrime qiellore[keramete e paralajmërime] dhe me libër të

ndritshëm. Njeriu që merrte ilham=frymëzim prej Allahut xh.sh. vepron= te plotësishtë sipas Kuranit famëlartë dhe porosive të Pejgamberit tonë Muhamedid a. s, pa asnjë devijim ose shtrembërim. Këta njerëz të zgjedhur prej Allahut xh. sh. ishin njerëz me hikmet=me urtësi=dituri të thellë dhe merrnin dhe lajme e njoftime prej Allahut xh. sh. në format e ndryshme që i tregon Kurani e që i treguam më sipër.

Un po ju kujtoj të vetquajturve Alivij, fjalët e prijsave të famshëm, imamvet të dikurshëm të udhëzuar nga Allahu xh. sh. siç kanë qenë murshidat Ahmed Rrufaiu, Shabi Nakshibendiu, Ahmed Tixhaniu, e tjerë e tjerë. Të gjithë këta ju kanë thënë nxënësve të tyre këto fjalë kështu; Shum dervisha [antarë të një sekti] në tarikat [në një rrugë] hyjnë, por kush është shehu nuk e dinë. Shehu [njeriu me hikmet = me dije të thellë] është sirri [sekreti] i Allahut xh. sh. vjen nga fisi = origjina e Resulullahut a. s. Vërtet kjo është fjalë e drejtë se nga origjina = prejardhja e Pejgamberit a. s. erdhën këta njerëz murshida të zgjedhur nga Allahu xh. sh. Por duhet ta dini mir se me ehlibejtin familjen ose fisin e Profetit Muhamed a. s. kanë qenë ata njerëz që vepruan sipas Kuranit dhe porosive të Pejgamberit Muhamed a. s.

Sot janë vetëm ata besimtar që veprojnë gjithnjë sipas Kuranit. Muxhedidja e shekullit të fundit murshidja Aishe rahmetullahi alejha tha që mora prej Allahut xh.sh. lajmin se: "Nga origjina e ehlibejtit janë ata njerëz që në këtë kohë sot do të bëjnë Tobe".= Do të besojnë e veprojnë në baz të Kuranit siç ka besuar e vepruar i dërguari i Allahut xh. sh. profeti Muhamed.a.s.

Kështu ka vepruar familja e hazreti Muhamedit a.s. shlibejti i nderuar që Allahu xh. sh. është i kënaqur prej tyre. Familja e Pegamberit a. s. ka vepruar sipas Kuranit. Ata kanë falur namazin, kanë agjëruar në gjithë muajin e Ramazanit, nuk janë ndarë nga vëllezërit tjerë besimtarë, nuk kanë pije alkolike, nuk kanë qenë lakmiqar për këtë botë, e tjera e tjera. Nuk janë me ehlibejtin ata që merren me xhindët dhe djajtë për ti afruar njerëzit, duke i bërë kureshtar dhe kështu dal e nga dalë i largojnë e i nxjerrin krejtësishtë nga feja Islame. Ose disa të tjerë të vetquajtur dervisha që bëjnë sikur po çpohen me shtiza e gjylpana, në faqe e hundë ose bëjnë sikur han xhama e mbajnë në dorë zjarrin. Disa kërcejnë si të dehur dhe lëshojnë pastajë disa klithma: hej, hu, haj,

hi. Disa njerëz të tjerë bëjnë disa kërcime e veprime që janë të ndaluara nga feja Islame. Këta shkyejnë teshat e rrahin veten e tyre me zinxhira duke u gjakosur në shenjë dashurije gjoja për ehlibejtin e nderuar e disa çirren me të madhe duke kënduar vjersha për imam Aliun, Hasani, Hysejnin, siç bëjnë sot disa njerëz në Kerbela=Qerbela të Irakut e në Iran duke futur urrejtje, përçarje e luftë mesë muslimanëve. Këta njerëz të tillë nuk veprojnë sipas Kuranit ashtu si veprojnë ehlibejti i nderuar. Këta njerëz të pa ditur financohen nga armiqtë e muslimanëve.

Muslimanët sot janë të ndarë në grupe. Kurani e ndalon ndarjen e muslimanëve në grupe të ndryshme. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “Mos u bani si idhujtarët që e përçan fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ku secili grup i gëzohet ides së vet”. S. Rrum. aj. 31, 32. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha i thërriste njerëzit që të bënin tobe. Ajo thoshte; Un jam kundër grupacioneve=ndarjes së muslimanëve në grupe e tarikate të ndryshme. Kam marrë lajm prej Allahut xh. sh. për tu thënë juve se është e ndaluar hyrja në tarikate të ndryshme. Vërtet Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “O ju besimtar: respektoni Allahun dhe të dërguarin e Tj e mos u përçani mes njëri tjetrit se do të dobsoheni e do ta humbëni fuqinë ”. S. Enfalë. Aj. 45-46. Një pjesë njerëzish thonë përsëri sot se janë në tarikat. Shumica nga këta pinë pije alkolike, nuk e falin namazin, nukë agjërojnë hënën e Ramazanit dhe bëjnë llojë llojë dredhash e akuzash për ti poshtuar njerëzit e mir që i ka nderuar Allahu xh. sh. Disa nga këta tipa njerzish nga që nuk kan fare dije feje me nxitjen që ju bëjnë armiqtë e fesë Islame, akuzojnë e shajnë shumë shabe Pejgamberit a. s. duke thënë se ne duam ehlibejtin. Por ata duhet ta dijnë mir se me ehlibejtin janë ata njerëz qe besojnë e veprojnë sikurse besoi e punoi ehlibejti i bekuar të cilët besuan e veprouan sipas Pejgamberit a. s. i cili veproi sipas Kuranit që i zbriti Allahu xh. sh. Nuk është me ehlibejtin e bekuar ai njeri që i thotë vetes sheh ose imam dhe vepron në kundërshtim me Kurantin.

Kurani thotë: “Kush nuk vepron sipas asaj që zbriti Allahu, ata [njerëz] janë mohusa [nuk janë besimtar] ”. Shum njerëz ka pasur nga ata që thoshin se jemi prijësa të zgjedhur nga Allahu xh. sh. Edhe sot ka të tillë nga ata që thonë ashtu por ata janë gënjejshtar. Sot atyre që pretendojnë ashtu ju është bërë qafa si qafa e muzatit duke ngrënë e duke pirë sa munden, haram dhe

hallall bashkë. Një pjesë nga ata që janë bektashij pinë pije alkolike, nuk e falin namazin e pesë kohëve, as nuk agjërojnë muajin e Ramazanit dhe nuk e falin namazin e ditës së xhuma e tjera e tjera. Disa prej tyre kanë kaluar në kufër me besimet dhe veprimet që bëjnë në kundërshtim me Kuranin e synein e Pofetit Muhamed a. s. Ka rreth një shekull që nuk ka më në të vërtetë shehelerë por sherrëlerë = ngetërrestarë=ziliqarë e lakmiqarë. Allahu xh. sh. thotë : “E kush i ruhet lakmis së vetvetes, të tillë[njerëzish] janë të shpëtuat”S. Tegabun. aj. 16. Allahu xh. sh. i drejtoftë të gjithë për së mbari ata që veprojnë gabim nga që nuk dijnë.

98-MREKULLITË E PEJGAMBERËVE DHE KERAMETET E EVLIJAVE.

Mrrekullitë e peygamberëve dhe kerametet e evlijavet janë të vërteta se i tregon Kurani. Ai që i mohon këta ka mohuar atë çka thotë Allahu xh. sh. në Kuran. Mrrekullitë dhe kerametet i krijon Allahu xh. sh. kur dëshiron por i ka treguar ose i ka bërë nëpërmjet gojës ose duarve të peygamberëve dhe evlijavet. Kerametet Allahu xh. sh. i ka bërë nëpërmjet evlijavet edhe pas profetit Muhamed a.s. se kerametet janë në një nivel më poshtë se mrrekullit e peygamberëve. Disa nga mrrekullitë që përmenden në Kuran janë këto: “Ai [Musai] e hodhi shkopin e vet i cili u shndërrua në gjarpër të vërtetë. Nxorri dorën nga xhepi dhe ajo në sy të shikuesve shkëlqente nga bardhësia. ” S.Shuara. Aj.32,33.

Gjthashtu Kurani tregon: “Ndërsa Ne [thotë Allahu] i tham Musait bjeri detit [me shkopin tënd] dhe deti u nda e çdo pjes [ose dallgë e tij] u bë si kodër e madhe [e pa lëvizshme]. S. Shuara. aj. 63. Kemi gjithashtu mrrekullit e Peygamberit tone a. s. Njëra ndër ata është çarja e hënës. Kurani thotë: “Dhe hëna u ça [në dyshë]. ” S. Kamerr. aj. 1.

Peygamberi a. s. ka thënë: mos e besoni për njeri të shenjtë [evlija] një njeri edhe nëse ai rrin ulur lart në ajër përderisa ai nuk e fal rregullisht namazin e nuk zbaton përgjithsishtë ligjin e Allahut xh. sh.=Kuranin. Peygamberi a. s. ka treguar se “Kur Allahu xh. sh. e do shumë një njeri në ndonjë vendë, Ai i thotë Xhebrailit: Un e dua filan njeri o Xhebrail edhe ti ta duash atë. Pastaj Xhebraili lajmëron engjëjt tjerë duke ju thënë se Allahu xh.sh.e do filan njeri në filan vendë, prandaj edhe ju ta doni atë. ”

Muxhizet=mrekullitë-veprimet e jashtëzakonshme të profetëve të Allahut xh. sh. dhe kerametet nderimet e euvlijavet siç e thamë më sipër janë të vërteta që i vërteton Kurani dhe i ka treguar Pejgamberi a. s. me hadithë. Muxhize ose shqip mrekulli është çdo vepër e jashtëzakonshme që është çfaqur me dëshirën e Allahut xh. sh. nga pejgamberët, për të vërtetuar vërtetësinë e dërgesës së tyre nga Allahu xh. sh. si lajmëtarë të Tij. Ata nuk mund ti bënin vet mrekullitë, por i shfaqte Allahu xh. sh. ata nëpërmjet tyre. Këtë gjë e vërteton Kurani i cili thotë se të dërguarit e Allahut xh. sh. ju than njerëzve [popujve të tyre] kështu: "Ne nuk sjellim [nuk bëjmë] asnjë mrekulli pa dëshirën e Allahut, e pra besimtarët le ti mbështeten [për ndihmë e mbrojtje] vetëm Allahut." S. Ibrahim. aj. 11. Dijetari Xhurxhani ka thënë: Muxhizja=mrekullija është vepër e jashtëzakonshme e cila është shkak thirrje për mirësi dhe lumturi.

Ndërsa dijetari i dëgjuar Ramadan El Buti ka thënë; Me fjalën e thënë se muxhizja është gjë e jashtëzakonshme, është qëllimi për diçka që ndryshon nga ajo gjë që është e zakonshme, por që nuk e kundërshton mendjen dhe të mundëshmen. Shih librin Buti; Kubra eljekinijjat el-kavnijje. faqe. 214. Veprat e jashtëzakonshme ndahen në dy grupe. 1-Në grupin e parë janë nderimet e Allahut xh. sh. ndaj besimtarëve të cilat janë tre llojesh; 1-Elmuxhizet-muxhize=mrekullia, e cila ishte për lajmëtarët e Allahut xh. sh, për ata njerëz që Ai i kishte ngarkuar me shërbim tek një popull. 2-El keramet=keramet=nderim=respektim ose më qartë dhuratë jo materiale por vepër e jashtëzakonshme të cilën Allahu xh. sh. e shfaq në dorën ose gojën e ndonjërit prej njerëzve të zgjedhur, njerëzve të dashur të Tij, të cilët quhen evlija ose shqip miqt e Allahut xh. sh. 3-Elmaunet=ndihma e cila është vepër e jashtëzakonshme të cilën Allahu xh. sh. ia shfaq besimtarit të devotshëm në dorën ose në gojën e tij për mbrojtje në ndonjë situatë të vështirë dhe në shenjë ndihme ndaj tij. Në grupin e dytë të veprave të jashtëzakonshme është dhe El istidraxhi veprim i jashtëzakonshëm që duket nga një qafir magjistar ose ndryshe sihirbaz i madh. Por kjo është shkatrim për personin se është vërtet veprim i jashtëzakonshëm por këtë e bëjnë magjistaret nëpërmjet shejtanit të mallkuar ashtu si dëshiron ai sa here që të duan ata, e që të shtyn tek e keqja e shkatërrimi gradualisht pasi nuk të orjenton tek e mira por tek e keqja ose e

kota. Veç disa të tjerave një nga shenjat dalluse të mrrekullive dhe kerameteve në njëren anë dhe istidraxhit në anën tjetër është se të dashurit e Allahut xh. sh. nuk mund ti sjellin ose ti bëjnë vetë mrrekullitë vetëm se kur do Allahu xh. sh. ndërsa magjistarët bëjnë istidraxh [hitnime ose ndryshe magji] nëpërmjet shejtanit të mallkuar sa herë që duan ti shohin njerzit e prishur. Këto njerëz që merren me djallin e mallkuar dalin nëpër kanalet e televizorve kudo në sheshe e salla të ndryshme duke bërë të tilla magjirash në sy të publikut që shkojnë për ti shikuar ata. Allahu xh. sh. i ruajtë besimtarët e vet nga hilet e shejtanëve prej xhindësh dhe shejtanëve prej njerzish. Kurani tregon se jan dy grupe shejtanësh. Ka shejtanë prej xhindësh dhe shejtanë prej njerzish. Allahu xh.sh.thotë në Kuran se shejtanët prej njerzish janë më të rrezikshëm se shejtanët prej xhindësh.

99-MBI BESIMIN NDAJ MREKULLIVE TË PEJGAMBERËVE DHE KERAMETEVE TË EVLIJAVE=MIQËVE TË ALLAHUT xh. sh.

Në përgjithësi pejgamberët e Allahut xh. sh. paçin selam kan qënë të pajisur me mrekuulli. Detyrohet nga feja çdo musliman të besoi se Allahu xh. sh. i ka pajisur pejgamberët dhe të dërguarit e Tij me muxhizemrekuulli. Qëllimi ka qënë për të vërtetuar para njerëzve se ishin të dërguar nga Allahu xh. sh. për ti thirr njerëzit në rrugën e drejtë duke i sqaruar ata në lidhje me mësimet e Allahut xh. sh. Profeti Muhamed a. s. ka thënë; Çdo pejgamberi i është dhënë muxhize=mrekuulli.... Trans. Buhariu. Për çështjen e mrekuullive Allahu xh. sh. në Kuran ka thënë: Thuaju [o Muhamed] Çështja e mrekuullive është vetëm në duar të Allahut, e un nuk jam tjetër veç se tërheqës i vërejtjes dhe shpjegues'' S.Ankebut=Kapitulli Merimanga. aj. 50. Ndërsa për kerametet e evlijave imami Maturidiu në librin Kitabu usulud-din ka thënë: Kerametet e evlijave[njerëzve të dashur të Allahut xh. sh.] pa dyshim ekzistojnë. Mytezilitët=të larguarit nga Islami dyshojnë për këtë çështje. Ata thonë; Nëse pranohet mendimi që ekzistojnë kerametet e evlijave, njerëzit nuk do të mund ti dallonin ata nga muxhizet=mrekuullitë e pejgamberëve. Ndërsa imam Nesefiu në librin Shehrul akaid faqe. 220 thotë; Kerametet e evlijave janë të vërteta, dhe personit që i janë dhënë nga Allahu xh. sh. keramete quhet velijullah-i zgjedhuri ose miku

i Allahut xh. sh. i dashur tek Allahu xh. sh. bëhet ai njeri i cili ka besim të fortë të pa lëkundur, dashuri të madhe e njohuri të thellë ndaj Allahut xh. sh. dhe cilësive të Tij. Ky njeri pastaj është këmbëngulës i rreptë për të bërë vepra të mira, është i larguar nga gjynahet, dhe i distancuar nga çdo veprim që të çon në orekse dhe kënaqësi pa masë e kriter edhe nëse janë ata gjëra hallall=të lejshme. Dëshira kryesore e këtyre njerëzve është të kënaqin shpirtin me kënaqësinë e Allahut xh. sh. e jo trupin dhe epshin=nepsin me kënaqësitë e kësaj bote që është vetëm sprovë për njerzit. Allahu xh. sh. në Kuranë i thotë Pejgamberit a. s. kështu: “Dhe vetëm ke Zoti ytë përqëndroje syminin [qëllimin për të fituar dashurinë e Tij.”

” Kerametet e evlijave janë një shfaqje e jashtëzakonëshme prej Allahut xh. sh. të janë një nderim për ata dhe nuk është kusht që të jetë ai njeri i ngarkuar me detyrën e thirrjes siç ishin pejgamberët paçin selamin e Allahut xh. sh. Për evlijatë Allahu xh. sh. në Kuran thotë: “Ta keni të ditur[ta keni të qartë] se të dashurit e Allahut [evlijatë] nuk kan frikë e as kurrëfar brengosje, [Ata janë ata njerëz] të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepet myzhde [premtime të kënaqëshme] në jetën e dynjas dhe në jetën tjetër[pas vdekjes]. Premtimi i Allahut nuk mund të pësojë ndryshim . E ai është sukseesi i madhë. ”S. Junus. aj. 62, 64. Dijetari Neveviu në librin Bustanul Arifijn thotë; Duhet ta dini se drejtimi i Ehlul Hakut=mbrojtësve të së vërtetës është vërtetimi i kerameteve të evlijave dhe se ato ndodhin vazhdimisht në periudha të dryshme kohore atje ku do Allahu xh. sh. Këtë gjë e vërteton Kurani dhe hadithet=fjalët e Pejgamberit tonë a. s. thotë Neveviu në librin Bustanul Arifinë. Ekzistojnë shumë ajete nga Kurani madhërshëm që flasin mbi ndodhjen e kerameteve tek burrat dhe gratë që janë evlija. Prej grave po marrim shembull hazreti Merjemen r. t. a. , nënën e hazreti Isait a. s. Allahu xh. sh. i ka thënë asaj kështu: “E ti [Merjeme] tunde trupin e hurmës [së thatë] se do të binë ty hurma të freskëta. Ti pra ha [prej tyre]...”S. Merjem. ajeti. 25.

Imami Ebu Meali-Imamul-Haremejni që Allahu xh. sh. e mëshiroft ka thënë: Mendimi i përgjithshëm i dijetarëve Islam është se, Merjemja nuk ka qënë pejgambere por ka qënë evlija. Po kështu si kjo kemi dhe raste të tjera. Gjithashtu hadithet e Pejgamberit a.s. që vërtetojnë se kan ndodhur kerametet janë të shumta thotë Neveviu në librin Bustanul Arifinë.Nga Enesi r.t.a. shoku Pejgam-

berit a. s. transmetohet ky hadith; Dy sehabë=shokë të Pejgamberit a. s. kishin qenë me të dhe ishin larguar prej tij në një natë të errët. Bashk me ta dy kandila=llampa të vogla ndricimi bënë dritë mes duarvet të tyre. Kur ata u ndanë me secilin nga këta kishte vazhduar nga një dritë deri sa kishin arritur tek familja e tyre. Transmeton Sahihul Buhariu.

Kerametet e evlijave janë vërtetuar dhe pas Pejgamberit a. s. nga sehabet=shokët e tij, siç është ngjarja e haz Ymerit r. a. kur ai ishte në minberin e xhamisë së qytetit të Medines dhe i foli komandantit të ushtrisë që quhej Sarije i cili ishte larg në vëndin e quajtur Binhaved, duke i tërhequr vërejtjen për kurthin e armikut nga prapa kodrës, dhe Sariju e dëgjojë zërin e haz Ymerit r. t. a. megjithëse në largësi të madhe. Trans. Teftaziniu. Shehrul akaidi. fq. 24. Keramete të ngjajshme pas Pejgamberit tonë a. s. kanë pasur dhe shumë sehabë tjerë. Kerametet e evlijave mytezilitët i kundërshtuan dhe vazhdojnë ti kundërshtojnë dhe sot, ndërsa shiitët i pranuan vetëm për dymbëdhjetë imamët e tyre dhe për askënd tjetër dhe me këtë mendim janë dhe sot, pa pasur kurrëfar argumenti të qëndrueshëm me bazë nga Kurani e hadithi.

Këto fjalë që thash në dy paragrafët e fundit për muxhizet=mrekullitë e pejgamberëve, për kerametet e evlijave dhe rregullat ose kushtet e besimit ndaj tyre, janë marrë nga libri Akaidi Hanefi El Fikhul Ekber të Imami Adhamit=Imami Azemit ose ndryshe Ebu Hanifes rametullahi alejh.

Sikurse e thash më sipër dijetarët e Ehli synet vel xhemeatit thonë se besimi në kerametet e evlijave është njëra prej bazave të imanit=besimit. Ata njerëz që i mohuan kerametet e evlijave ishin muëtezilet. Profeti Muhamed a. s. ka qenë pejgamber dhe evlija.

100-FJALËT E FUNDIT PËR SHËRBIMIN E MUXHEDIDES AISHE rahmetullahi alejha.

Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha kjo murshide-udheqse fetare e shekullit të njëzet, ishte e dërguar nga Allahuxh. sh. me urdhëresën për ti bërë thirrje njerzvet të bëjnë Tobe. Ajo e kreu me shumë sakrificë në Shqipëri, shërbimin që i kishte caktuar

Allahu xh. sh. Po thuaj se të gjithë hoxhallarët dhe mbar popu-

Ili mepërjashtim të disa njerëzve të pakët nuk ju nënshtruan urdhërit të Allahut xh. sh. për të bërë Tobe. Edhe ata që bënin namazë nuk e hoqën nga goja shirkun, vënjen shok Allahut xh. sh, për të cilën gjë kan qenë të urdhëruar të gjithë pejgamberët të dërguarit e Allahut xh. sh. Në Kuran Allahu xh. sh. i thotë Pejgamberit a.s.: "Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: "Nuk ka tjetër Zot përveç meje" [thotë Allahu xh. sh.] ...S. Enbija aj. 25. Ndërsa muxhedidja Aishe me lajmin që mori prej Allahut xh. sh. i sqaroi besimtarët se duhet të qëndrojnë pa e mohuar në gjuhën e tyre kombëtare fjalën e fortë, fjalën më të madhe; La il-lahe il lallah-që do të thotë; Nuk ka tjetër Zot veç Allahut=Nuk ka tjetër veç një Zoti. Kjo pra vëllezër besimtar është baza kryesore e fesë. Mos jua vini veshin qafirave e munafikëve hipokritëve=dyftytyrëshve dhe atyre hoxhallarëve që i ka hutuar dynjaja e shejtani i mallkuar e disa janë të shitur dhe ju thonë juve se nuk ka gjë se i themi njerëzve me gojë Zoti, i Zoti, Zotnia, Zotnusha-Zotnjusha, Zotja ose Zonja, i del ose dal Zot , e Zotënoj e Zotohem në gjuhën shqipe estagfirullah. Gospod e Gospodin dhe Gospozha në maqedonishtë. Bog, Bogin e Bozhe në sërabishtë. Theos, Qirja ose Kirja në greqishtë. Dio e Don në italishtë. Mullah në persisht. Gad në gjuhën anglishte. Meuvlana indirekt në gjuhën arabe e të tjera si këto në gjuhë të ndryshme të botës. Estagfirullah. Allahu xh. sh. jua ruajt gojën besimtarëve që mos të bëjnë shirk, mos të bëjnë kufër me asnjë lloj gjuhe që flasin. Allahu xh. sh. në një hadithi kudsii ka thënë Pejgamberit a. s. kështu: "Të dërgova që të sprovtoj dhe ti sprovtoj me ty të tjerët." Trans. Muslimi në Sahihun e tij. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte: Ata njerëz që do ti bëjnë shirk duke i bër me gojën e tyre shok Zotit xh.sh. duke u mashtruar prej njerëzve të prishur krejtësisht, të cilët në gjuhën arabe quhen dexhala, do të hynë pa dyshim në xhehenem. Përse nuk pranojnë munafikët=dyftytyrshitet e ateistët=të pa fetë tu thuash atyre, shejtan filani ose djalli filan ? . Por këtë emër ata nuk e duan se është emër i keq.Me këtë emër thirret i mallkuari. O besimtar largohuni nga shirku i madh që po bëni çdo ditë me gojën tuaj se nuk du tua pranojë Allahu xh.sh. namazin.. Mos dëgjoni e mos veproni se çka ju thonë juve dexhalat=mashtrusat e mëdhenj=ateistët e çdo ngjyre politike. Mos e tradhëtoni ju o besimtarë të Allahut,

fjalën e fjalën fortë=fjalën e madhe, fjalën e teuhidit=njisimit të Zotit xh. sh. fjalën: La il lahe il lallah=Nuk ka tjetër Zot veç Allahut xh. sh. në çdo gjuhë që ju flisni dhe bëni Tobe të vërtetë=të sinqertë. Largohuni një herë e përgjithmonë nga fjalët dhe veprat e liga. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “Është e vërtetë se Allahu nuk e fal [gjynahin] e të bëmit shok Atij [shirkun] veç këtij të tjerat ia fal atij që do.” S. Nisa. aj. 116. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte se nga Allahu xh. sh. un e kam marrë njoftimin kështu: “Shtatëdhjet e pesë përqind e popullsis [në Shqipëri] e kan dëgjuar thirrjen për tobe [për tu penduar]”. Kjo gjë është e vërtetë se murshidja Aishe rahmetullahi alejha vazhdoi 40 vjet me detyrën e thirrjes së popullit shqiptar për tobe [për pendesë] por fatkeqsisht ishin të rrallë ata njerëz që u penduan sinqerisht prej frikës së Allahut xh. sh. e u larguan nga fjalët e veprat e këqia. Kurani thotë: “... Nuk ka dyshim se Allahu një popull që është mizorë [i pa bindur e zullumqar] nuk e udhëzon në rrugën shpëtimit [nuk e drejton nga e mbara..”. S. Ahkaf. aj. 10. Un kam frikë se shqiptarët në përgjithsi, por kryesisht muslimanët do ta pësojnë më keq se çifutët që silleshin dikurë vërdallë në shkretëtir. Kam frikë se muslimanët do të mbeten pa prone e pa atdhe duke u endur sa në një vend të botës në tjetrin, duke punuar hyzmeqarë [shërbëtorë] tek jo muslimanët. Allahu xh. sh. ju drejtohet në përgjithsi njerzvet në Kuran e ju thotë: “O ju njerëz kokëfortësija juaj është vetëm kundër vetes tuaj...”. Sure. Junus. ajeti. 23. Prandaj o njerëz të gjithë sa jeni ju që besoni, ejani në rrugën e Zotit xh. sh. duke bërë tobe [duke u penduar] sinqerisht, me kushtet që treguam, sa është pa ardhur akoma kijameti=kataklizma=shkatërimi ose fundi i botës. Kjo thirrje për ta njisuar Zotin xh. sh. e për të bërë tobe=për tu larguar përgjithmonë nga punët e fjalët e këqia është e domosdoshme për të gjithë besimtarët kudo që janë të cilët e besojnë Zotin xh. sh. dhe besojnë në gjyqin e madh të llogarisë para Tij në jetën tjetër pas vdekjes. Kurani thotë: “O ju që besuat pendohuni tekë Allahu me një pendim të sinqert [bëni tobe të vërtetë] në mënyrë që Zoti juaj ti largojë prej jush të këqiajt [në dynja] e t’ju çoi në xhenete [në botën tjetër pas vdekjes]...”. S. Tahrimë. Aj. 8. Allahu xh.sh. thotë: “Kërkoni falje Zotit tuaj e sinqerishtë pendohuni”. S. Huxhurat. Aj. 90. Për ata që nuk pendohen Allahu xh. sh.thotë: “E ata që nuk pendohen janë mizorë [janë të këqisë, janë zullumqar]”. S. Huxhurat. Ajeti.11. Vel hamdu lil lahi rrab bil aalemijn.

101-PASTHËNIE PËR LIBRIN

Këtu e përfundova këtë libër un i quajturi Haxhi Ymer Aga nga fshtati Farkë e Tiranës dhe ia vura titullin:

PËR BESIMTARËT E ALLAHUT XH. SH. -
MUXHEDIDJA AISHE=RIPËRTËRITËSJA E FESË ISLAME
DHE POPULLI SHQIPTAR NË REGJIMIN KOMUNIST
DHE DEMOKRATIK NË SHEKULLIN E NJËZETË.

E shkrova këtë libër me shumë lodhje dhe sakrificë që të mbesi në kujtesën e brezave të ardhshëm si një pikë referimi për të kontrolluar e kritikuar më par veten secili nga besimtarët e Zotit xh. sh. të cilët duan të korigojnë gabimet e tyre. Në këtë libër tregova kryesisht për çështjen e Tobes për të cilën e thirri popullin muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha dhe dhash disa sqarime rreth çështjeve të fesë Islame nga kjo murshide e madhe e shekullit të njëzetë. Kam treguar në libër për qëndrimin e popullit Shqiptar ndaj shërbimit të saj e kryesisht muslimanvet, si dhe qëndrimin e politikës zyrtare në Shqipëri ndaj fesë në përgjithësi para njëqind vjetësh. Nga viti 1912 e deri tani në vitin 2012. Kam përmendur ngjarje dhe emra të ndryshëm për ta vërtetuar me fakte konkrete veprimtarinë e muxhedides Aishe rahmetullahi alejha dhe qëndrimin e popullit tone në lidhje me fenë në Shqipëri e në veçanti me fenë Islame që është feja e vërtetë pranushme tekë Allahu xh. sh. e që është feja e shumicës së popullit Shqiptar. Qëllimi im ka qenë që të nxjerrë në dritë të vërtetën që të dihet ajo duke pasur parasysh thënjen e Allahut xh. sh. i cili thotë në Kuran : “Ata llojë njerëzish që i fshehin ç’ka kemi zbritur prej anës tonë nga ajetet (shenjat ose argumentet)... Ata njerëz i mallkon Allahu i mallkojnë dhe gjithë ata [krijesa] që mallkojnë (që ju pranohet mallkimi).” S. Aj. 159. Gjithashtu Allahu xh. sh. thotë: “O ju besimtarë, përmbajuni mësimëve të Allahut [Kuranit] dhe thoni fjalë të drejta”. S.Ahzab. aj. 70. Ndërsa Pejgamberi a. s. në një hadith ka thënë: “Thuaje të vërtetën edhe nëse është e hidhur ajo tekë shumë kush.” Ju tregova besimtarve për dsa çështje madhore të fesë Islame për të cilat dha sqarime të hollësishtme prej Allahut xh .sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha e cila ishte e fundit në botë në rradhën e muxhedidave. Besimtarët duhet ti kenë të qarta këto që kështu të ruhen nga propaganda që bëjnë qafirat e munafikët kudo

për të futur përçarje e grindje mes beimtarëve musliman.
Zoti madhërshëm e drejtoftë në rrugën e drejtë popullin tonë
e të gjithë njerëzit e sinqert kudo në botë. Falenderimi dhe mir-
njohja për gjithçka i takojnë posaçërisht Allahut xh. sh. = Zotit
të madhëruar, Krijuesit të Gjithësis.

Betohem në Allahun xh. sh. se diktimet ose njoftimet që mori
prej Allahut xh. sh. në forma të ndryshme muxhedidja Aishe
rahmetullahi alejha i kam shkruar tekstualishtë, pa shtuar e
zbukuruar asgjë nga vetja ime por vetëm se ashtu siç mi ka
treguar ajo të cilat i kam mbajtur të shkruara. Argumentat për
ti vërtetuar fjalët e saj i mora nga Kurani që është fjala e Allahut
xh. sh. e hadithet=fjalët e Pejgamberit tonë Muhamedit a. s. dhe
nga komentimet që kanë bërë dijetarët e shquar Islam. Ndërsa disa
mendime të mia për disa njerëz e ngjarje, unë shkruesi i librit i
kam shprehur duke u bazuar në fakte të shëndosha konkrete pasi i
kam jetuar vetë, i kam pa me sy ose i kam dëgjuar nga besimtarët
e vjetër të sinqertë që kanë ndenjur në atë kohë me këta njerëz
e i kanë jetuar vetë ngjarjet. Kështu që unë dhe nga mendimet e mia
nuk kam shprehur asnjë fjalë, sipas dëshirës time pa patur baza
të shëndosha e fakte konkrete.

Nuk kam folur sipas interesit tim e interesit të një grupi të
caktuar njerëzish dhe as sipas politikës është sot në fuqi, por kam
folur të vërtetën e të drejtën që është në interesin e të gjithëve dhe
është pikë referimi për të kaluarën dhe të ardhmen tonë si popull.
Allahu xh. sh. i udhëzoftë të gjithë njerëzit për së mbari. Besimtarët
e Allahut xh. sh. kudo që ndodhen në botë duhet ta dinë se nëse
nuk do të bëjnë Tobe sipas kushteve të caktuara e të diktuar nga
Allahu xh. sh. nëpërmjet muxhedides së shekullit të njëzetë mur-
shides Aishe rahmetullahi alejha, do të jenë të shtypur nga qafirët
e munafikët. Kështu ata do të jenë të humbur në këtë botë dhe në
botën tjetër pas vdekjes. Kushti i parë i Tobes që kërkohet nga Allahu
xh. sh. për besimtarët është teuhidi=njisimi=veçimi i emrit të Tij nga
emrat e njerzvet në çdo gjuhë që flet secili njeri. Kurani thotë në
formë pyetje: A din ti [ose a dini ju] që Unë [thotë Allahu xh. sh.]
të kemë Emnak=adash? . "S. Merjem . aj. 65. Adashë quhen ose janë
dy vetë me të njëjtin emër. Allahu xh. sh. thotë: A nuk e kupton
ti o besimtari im se me atë emër që më thërret mua nuk duhet të
thërrasësh tjetër kënd ? . Nuk duhet të thirret krijesa ime njeriu

me atë emër që thirrem un thotë Allahu xh. sh. S. Merjem. Aj. 65. Allahu xh. sh. nuk i shikon me mëshir njerzit që bëjnë shok Atij e kështu as lutjet nuk jua pranon atyre. Allahu xh. sh. i drejtoftë nga e mbara ata që nuk e kan humbur besimin ndaj Tij. Thirrje për tobe është shansi i fundit prej Allahut xh. sh. për shpëtim për njerzit e kohës së fundit të botës por dhe një sprovë e madhe për ata. Muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha thoshte: “Tobja është ajo që i shoshit mir veprimet e njerëzvet se kjo i dallon besimtarët e vërtetë nga ata që nuk janë besimtar të sinqertë”. Un Ju bëj thirrje lexsave të librit që tua japin për ta lexuar këtë libër dhe të tjerëve që nuk e kan dhe tu flisni me gojë për çka thuhet në libër se do të fitoni mirësina të shumta prej Allahut të madhruar.

Çështja tobes [e pendesës] është çështja madhore e fesë. Zoti xh. sh. e fal dhe e do atë njeri që pendohet sinqerisht. Kurani thot: “Allahu ia fal gjynahet atij [njeriu] që pendohet e mëshiron atë që përmirsohet...Ai e pranon pendimin e robërve të vet...” .S.Tobe.aj.102, 104. Allahu xh. sh. thotë : “Ndërsa ata që nuk pendohen janë mizor [të këqijë]”. S. Huxhurat. aj. 11. Ne jua parashtruam juve o besimtar këtë libër me argumente të shumta nga Kurani. Allahu xh.sh. në Kurani thotë:...”Ne pra ju kemi sqaruar faktet [juve o besimtar] nëse ju i kuptoni”. S. Ali Imran aj. 118. Këtë libër e kuptojnë drejt ata njerëz që janë shum të ditur dhe ata që janë besimtar të sinqertë, ndërsa të pa bindurvet e munafikvet jua shton më shum urrejtjen ndaj së vërtetës. Ky libër është mir të përkthehet në 4 gjuh të mëdha që i flasin miljona njerëz në gjithë botën. Në gjuhët arabisht, në turqishtë, në anglishtë dhe në një gjuh sllave=në sërbo-kroatisht ose rusisht. Ata njerëz që do ta bëjnë këtë gjë, i bëjnë një shërbim të madh besimtarvet. Allahu i madhruar do tua shpërblej atyre shum fish. Ves-selamu alejkum ve rahmetullah = Paqja dhe mëshira e Allahut xh. sh. qoftë për besimtarët .

PËRGATITI: H.HAXHI YMER AGA.

TIRANË : 2009.

RIBOTIM 2012.

102 - PAK NGA JETA IME SHKRUESI I LIBRIT

Un shkruasi i këtij librit quhem Haxhi Aga. Jam besimtar musliman me kombësi shqiptar. Kam lindur në fshatin Farkë të Tiranës në tetor të vitit 1952 nga një familje e mesme fshatare nga ana ekonomike, familje besimtare Islame. Fshati im Farka ndodhet ngjitur me kryeqytetin, Tiranën. Dy lagje të saj janë në administrimin e bashkis së qytetit. Un jam i biri i Ymerit dhe i Emines. Sipasë traditës un kam marrë emrin e gjyshit tim Haxhi Junuz Agës. Kam qenë në Mekë për të bërë Haxhin=vizitën në Qabe në vitin 1996 duke e marrë pastaj me të drejtë titullin Haxhi. Shum nga besimtarët më thërrasin Haxhi Ymer Aga se babai im e kishte emrin Ymer Aga. Jam munduar ta mbaj fenë që kur isha i ri. Jam falur dhe kam agjëruar në kohën kur feja Në vëndin tonë ishte e ndaluar me ligjë nga shteti që të praktikohet. Fshati im Farka ka qenë fshat me traditë fetare. Ka pasur dy xhamija dhe sot janë bër tri të tilla.

Farka ka pasur shum hoxhallarë=mësusa të fesë Islame që një pjesë e madhe nga këto kanë pasë studiuar në Medresen=shkollën fetare Islame në Tiranë. Un nuk kam kryer shkollë tjetër përveç arsimit të përgjithshëm. Kam qenë nxënës i mirë në mësimet por pas mbarimit të arsimit të përgjithshëm nuk kishim mundësi të vazhdoja më tej shkollën për arsye të biografis, pasi ishim familje e persekutuar politikishtë prej rregjimit komunist. Ishim të cilësuar kulakë. Kam qenë shumë i dhënë pas diturisë. Studjoja në shtëpi e në bibliotekat e Tiranës libra të ndryshëm, fetarë, historikë, mjek sorë e gjeografikë. Kam studjuar më shum për fenë Islame dhe kam përfituar shum duke dëgjuar e duke u konsultuar me njerëz të ditur që ishin në atë kohë.

Disa nga ata kam shkuar për ti takuar dhe në qytetet tjera, për të marrë dije aq sa ishin mundësitë në atë kohë të vështirë për besimtarët e Zotit xh. sh. dhe mbaja shënime nga bisedat me ata. Gjithashtu merrja prej tyre dhe libra fetar duke e pasuruar bilotekën time personale në shtëpi. Por mbi të gjitha sa thash e ndjej veten të lumtur që kishim fatin të takohem e të rrij shum vite me muxhediden e shekullit të njëzetë, murshiden [prinjësen] Aishe

rahmetullahi alejha. Mësova prej saj dituri të thellë aq sa deshti Allahu xh. sh. Prindërit mua më jepnin kurajo, pasi ata ishin besimtar, agjëronin dhe falnin namaz. Babai im falej dhe lexonte libra feje, dhe dashurinë për fenë e mbolli dhe në familje. Unë që në moshë të re në kohën e rregjimit komunist, fillova të agjëroj dhe të fal namazin e përditshëm të pesë kohëve. Sigurishtë kur nuk kishim mundësi ti falë rregullishtë ditën, i falja në mbremje gaza [të prapambetura=mbas kohës që i takon].

Kam punuar në bujqësi, në ndërtim por ca kohë dhe në minjerë që janë punët më të rënda. Tridhjetë vjetë kemi qënë të cilësuar kulakë nga rregjimi komunistë. Gjyshi im Haxhi Januz Aga, ishte fshatar i shtresës së mesme. Ai sikurse është thënë e thuhet akoma nga populli i zonës tonë, ishte burrë fisnik, i ndershëm dhe besimtar. Që në fillim të luftës së dytë botërore gjyshi im doli hapur kundër ardhjes në Shqipëri të rregjimit fashist dhe komunist. Haxhi Januz Aga nuk e donte komunizmin. Ai kishte thënë se komunizmi është pa fe, është pa moral. Ai u rradhiti në organizatën e quajtur Legaliteti, që ishte në brojtje të mbretit legjitim të Shqipërisë Ahmed Zogut.

Haxhi Junuz Aga mori pjesë si anëtar në mbledhjen e rinisë legaliste në fshatin Mukje të qytetit të Krujës sikur është thënë e shkruar. Ai nuk ishte nëpunës në qeverinë e mbretit Ahmed Zogu porë u bashkua me organizatën e quajtur Legaliteti në mbrojtje të mbretërisë me qëllim që Shqipëria të kishte stabilitet politik. Shtëpinë tonë në kohën e luftës e dogjën partizanët me çka kishte brënda. Shpëtuan vetëm bagëtitë, si pasojë e ndërhyrjes së shpejtë të disa komshijëve. Haxhi Januz Aga gjatë luftës vuri veten e tij në rrezik dhe shpëtoi nga vrasja 27 burra nga fshati i tij e fshatrat aty për rreth, që ishin lidhur dhe bërë gati për tu pushkatuar nga qeverija e kohës së fashizmit për shkakun e vrasjes së një xhandari [polici] nga çeta partizane e Dajtit. Por kjo gjë mbeti vetëm në kujtesën e popullit se Partija Komuniste që erdhi në pushtet në Shqipëri në vitin 1944 nukë e mori fare parasysh fare këtë gjë.

Por Allahu xh. sh. në Kuran thotë kështu: "Kush shpëton një njeri është [sevapi=mirësija e tij] sikur ti ketë shpëtuar gjithë njerëzit." S. Maide. aj. 32. Pasë mbarimit të luftës e fitores së Partisë Komuniste në Shqipëri, gjyshi im Haxhi Januz Aga u dënua nga rregjimi komunistë me 30 vite burg me këtë akuzë: "Me vendim

numër 216 datë 11. 8. 1945 të gjykatës ushtarake Tiranë Haxhi Januz Aga i arrestuar me 12. 12. 1944 dënohet me 30 vjetë burg e konfiskimin e pasurisë se ka penguar luftën e popullit kundër fashizmit me cilësinë e tij si komandant çete të Legalitetit duke rekrutuar njerëz. "Është për tu çuditur nga kjo akuzë pa kuptim, pasi gjyshi im ishte kundër fashizmit, por sigurishtë dhe kundër komunizmit. Ai kishte thënë: Çfar kuptimi do ketë lufta e popullit tonë kundër pushtimit të vëndit nga të huajtë, nëse luftojmë kundër njërit armik të atdheut fashistëve italo-gjermanë dhe pranojmë tjetrin, duke pranuar që të vin këtu të na pushtojnë drejtë për së drejti ose indirekt Rusët e Sërbët. Të huajt për ne një llojë janë. Nuk mund të mbështetesh tek njëri për tu mbrojtur nga tjetri. Vërtetë pas mbarimit të luftës së dytë botërore shqiptarët u miqsuan me Serbët.

Ndërsa Rusët me flotën e tyre detare erdhën e qëndruan disa vite në Shqipëri, në bregdetin e Vlorës gjoja për të na mbrojtur nga të tjerët por ishte e kundërta se pa dyshim bazat e huaja ushtarake nuk e mbrojnë porë e minojnë pamvarësinë e një vendi. Më vonë Partia e Punës së Shqipërisë me Enver Hoxhën në krye e kuptoi rrezikun që i kanosej Shqipërisë prej bazës ushtarake detare Ruse dhe urdhëroi që ajo të largohet menjëher nga Shqipërija. Me largimin e flotës detare Ruse [Sovjetike] nga bregdeti i Vlorës Enver Hoxha i bëri mirë kështu jo vetëm vendit të tij Shqipërisë por edhe Italisë e vëndeve të tjera të perëndimit. Dy shtetet më të fuqishme të kohës ish Bashkimin Sovjetik vendi më i madh komunist dhe SH.B.të

Amerikës vendi më i madh kapitalist e anti komunist grindeshin me njëri tjetrin për zonat e influencës kudo në botë. Ata ishin edhe janë në kundërshtim me njëri tjetrin për shumë pikpamje politike, fetare dhe ekonomike. Megjith se janë me popullsi të krishtera , ortodoks e katolikë por grindja ndërmjet tyre ka vazhduar e do të vazhdoi deri në fundin e botës. Allahu xh. sh. në Kuran thotë : " ...Ne kemi nxitur [kemi futur] armiqtë e urrejtjen ndërmjet tyre [ndërmjet kristianëve] deri në ditën e kijametit." S. Maide. aj. 14. Fakt për armiqtë ndërmjet tyre ishin dy luftat botërore në të cilat u vranë miljona e miljona kristianë katolikë e ortodoks. Sipas statistikave të ndryshme vetëm në luftën e dytë botërore janë vrarë rreth 40 milion krishtianë, katolikë e ortodoks.

Enver Hoxha i dinte mirë këto gjëra dhe duke përfituar nga situata politike e largojë bazën ushtarake Ruse nga Shqipëria. Kështu ai shfrytëzoi rastin dhe përgaditi terrenin për ta qeverisur vendin e tij i pamvarur nga askush. Kështu ai pastaj komandoi në Shqipëri si mbret i pa shpallur megjithëse ai në fjalimet e tij thoshte; iku koha e mbretërve. Dy shtetet e fuqishme të botës SH. B. të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik e kuptuan shumë mirë këtë gjë por ata ishin të detyruar nga halli ta pranojnë këtë gjendje politike në Shqipëri për të evituar përplasjen ushtarake mes tyre luftën mesë dy blloqeve të ndryshme politike; bllokut socialistë të lindjes dhe atij kapitalistë të perëndimit. Të vërtetën tha Ramiz Alia ish zëvendësi i Enver Hoxhës në një fjalim të tij i cili u shpreh kështu; 'Shqipëria nuk është as lindje e as perëndim.' Ndërsa un them : Lavdia dhe falenderimi i takojnë Allahut xh. sh. Sovranit të Gjithsis i cili ka vën ekuilibrin=ballancimin në gjithësi për çdo gjë në çdo kohë. Kur të priset ekuilibri për çdo gjë në këtë botë atëherë vjen shkatërrimi i përgjithshëm i botës=vjen kijameti.

Dhe që kishim fjalën më sipër për gjyshin tim Haxhi Januz Aga, edhe kur ai ishte në burg në kushte jashtëzakonisht të vështira ashtu si shumë të burgosur tjerë besimtarë nuk e la deri sa vdiq agjërimin e muajit të Ramazanit. Pas 8 vjetësh ai vdes në burgun e Tiranës më datën 29. 8. 1952. Më vonë qeveria në komuniste arrestoi edhe babain tim Ymerin i cili në atë kohë ishte në moshën 22 vjeç me këtë akuzë: Me vendim numër 290 datë 26. 9. 1951 të gjykatës ushtarake Tiranë i quajtur Ymer Haxhi Aga deklarohet fajtor për mosdenoncim e strehim kriminelësh. Atë e akuzuan si pjesëtarë i një grupi politik që e quajtën grupi i rezistencës anti komuniste. Babain e torturuan shumë në birucë por për arsye se nuk kishin fakte për akuzën që i bënë pas 6 muajsh i dha gjykata pafajsinë. Pas dyzet e pesë viteve që u vendos në Shqipëri rendi demokratik un e fisi im nuk kemi përfituar asgjë nga shteti prej rregjimit demokratik.

Nuk kemi përfituar as shpërblim për të burgosurit dhe as ndonjë vendë pune. Un sot jamë në moshën 60 vjeç. Jam pa pension dhe pa aftësi për punë pasi u sëmura para dhjetë vitesh me plevitë, sëmundjen e rëndë të mushkërivet. Me vendosjen e rendit demokratik kur u lejua e drejta e liris së fesë, un u bëra shkaktarë i ndërtimit të xhamisë në lagjen ku banoj duke dhënë kështu ndihmesën time për fenë Islame. Që nga viti 1994 dhe deri sot në vitin 2012, un vazhdoj të shërbej imam xhamije [Hoxhë] në

xhaminë e lagjes së fshatit tim Farkë dhe nuk më paguan askush, pasi kryesija e Komunitetit Musliman thonë që nuk kemi financim nga shteti për të paguar hoxhallarët. Shpërblimin e shpresoj prej Allahut xh. sh. =prej Zotit të madhërshëm xh. sh. Un i tregova gjërisht këto, për tu hequr dyshimet lexisave të librit që mos të më paragjykojnë duke formuar për mua shkruetin e këtij libri, bindje të ndryshme veç bindjes fetare Islame. Allahu xh. sh. thotë në Kuran kështu: “Ata [njerëz] që luftojnë [përpiqen] për çështjen tone, pa dyshim Ne [thotë Allahu] do ti udhëzojmë drejtë rrugëve Tona [veprave që i pëlqejmë Ne]”. S. Ankebut. aj. 69. Qëllimi im që e shkrova këtë libër është që besimtarët [ata që besojnë tek Zoti xh. sh. ta njisojnë Zotin=Allahun xh. sh. në çdo gjuhë që flasin dhe të bëjnë tobe=të largohen nga fjalët dhe veprat e liga nëqoftëse duan të shpëtojnë veten, fëmijët dhe nipërit e tyre në këtë botë dhe tjetrën pas vdekjes. Allahu xh. sh. thotë në Kuran: “O ju që keni besuar pendohuni tek Allahu me një pendim të sinqertë [me tobe të vërtetë] në mynyrë që Zoti juaj ti largojë prej jush të këqiat [në këtë dynja] e tu çojë në xhenete [në botën tjetër pas vdekjes].” S. Tahrijm. Aj. 8. “In ne dine indallahil Islam.”= “Pa dyshim feja e pranushme tek Allahu është feja Islame”. Kjo është thirrja e fundit që i bëri Allahu xh. sh. njerzimit pak kohë para kijametit.

Vel-hamdu lil-lahi Rrab-bil aalemin

Ves-selamu alejkum ve rahmetullah.

Paqja dhe mëshira e Allahut xh. sh. qoftë për besimtarët. Esh hedu en La il lahe il lallah ve esh hedu ene Muhammeden Resulallah.

FUND.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1-Parathënja.

Kpitulli: 2-Çështë muxhedidi?

Kapitulli: 3-Mënyrat që Allahu xh. sh. i informon njerëzit e Tij të dashur.

4- Ja çfar kan thënë dijetarët Islam për frymëzimin.

5-Ardhja e muxhedidave vërtetohet me Kuran e Hadith.

6-Kush ishte muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha ?

7-Muxhedidja Aishe në moshën e fëmijërisë.

8-Muxhedidja Aishe në moshën e rinisë.

9-Muxhedidja Aishe ngarkohet nga Allahu xh. sh. me shërbimin e thirrjes së popullit për Tobe.

10-Muxhedidja Aishe filloi ti komunikojë popullit lajmin e Allahut xh. sh. që të bëjë Tobe.

11-Muxhedidja Aishe lajmëron për rrezikun e shirkut gjuhësorë.

12-Gjynahun e shirkut-vënjen shok e ortak Allahut xh. sh. në çdo lloj mynyre Allahu xh. sh. nuk ia fal askujt.

13-Besimtarët duhet të jenë të kujdesëshëm në fe që mos të bin në grackën e qafirave dhe munafikëve.

14-Njoftimi që i bën Allahu xh. sh. besimtarëve në Kuran për shirkun të cilin e bën të krishterët.

15-Qëndrimi i popullit të thjeshtë ndaj thirrjes për tobe që bënte muxhedidja Aishe. r. a.

16-Muxhedidja Aishe dhe njerëzit që ishin në tarikate.

17-Ç'është tarikati ?

18-Murshidja Aishe mori njoftime prej Allahut xh. sh. për disa dijetarë musliman të devotshëm të vendit tonë.

19-Pjesë nga predikimet fetare Islame të dijetarit të devotshëm: Sheh Qazim Hoxha nga Shkodra.

20-Njoftimet që mori nga Allahu xh. sh. muxhedidja Aishe për dijetarin e devotëshëm Islam : Hafiz Haxhi Mahmud Dashin nga Tirana.

21-Muxhedidja Aishe r. a. tregon për dijetarë tjerë të devotshëm Islam në vëndin tonë.

22-Vizita e muxhedides Aishe në qytetin e Shkodrës.

- 23-Murshidja Aishe rahmetullahi alejha thërret në Tobe shehelerë e kryetarë të tarikateve.
- 24-Takimi i murshides Aishe me Hafiz Sabri Koçin. Qëndrimi i tij ndaj lajm urdhëresës së Allahut xh. sh. për Tobe.
- 25-Muxhedidja Aishe vazhdoi takimet me intelektualë e dijetarë të fesë dhe popullin e thjeshtë.
- 26-Muxhedidja Aishe vazhdoi detyrën e saj duke e thirrë popullin në Tobe edhe pas ndalimit me ligjë të fesë nga shteti shqiptar
- 27-Muxhedidja Aishe shkon në qytetin e Peshkopisë=Dibrës së vogël për tu njoftuar njerëzve komunikatën e Allahut xh. sh. për Tobe.
- 28-Murshidja Aishe vazhdoi ti komunikojë popullit Shqiptar urdhëresën e Allahut xh. sh. për të bërë Tobe. Qëndrimi i disa hoxhallarëve dhe njerëzve të ndryshëm në atë kohë ndaj shërbimit të saj.
- 29-Dëshmitë e disa besimtarëve të thjeshtë për murshiden Aishe rahmetullahi alejha.
- 30-Komunikimi që ju bëra unë shkruesi i librit disa hoxhallarëve nga koha e rregjimit komunist dhe deri sot në rregjimin demokratik për çështjen e Tobes që lajmëronte muxhedidja Aishe r.a.
- 31-Vazhdojmë të tregojmë lajmet dhe njoftimet që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe r. a.
- 32-Njoftimet që mori prej Allahut xh. sh. murshidja Aishe për rëndësinë e namazit.
- 33-Muxhedidja Aishe mori lajmin prej Allahut xh. sh. për daljen e dexhalit. Ajo i sqaroi njerëzit se cili është e si është dexhali.
- 34-Muxhedidja Aishe mori njoftim prej Allahut xh. sh. që njerëzit ta këndojnë Mevludin=lindjen e Pejgamberit-Muhamedit a.s
- 35-Argumentat e dijetarëve të parë Islam për festimin e ditës së Mevludit-ditëlindjes së profetit Muhamed a. s.
- 36-Njoftimet që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe për këndimin e Kuranit dhe çfar tha ajo për nuskat e shkruara në to vetëm Kuran.
- 37-Muxhedidja Aishe mori njoftim nga Allahu xh.sh. se lart në qiellë në një planet afër tokës ka njerëz me qytetrim si këtu në tokë.
- 38-Këshillat e vërejtjet që mori prej Allahut xh. sh. murshidja Aishe

- për veten e saj.
- 39-Muxhedidja Aishe tregoi për xhindët se i ka parë ata. Allahu xh. ia shfaqti pamjen e tyre në keqsh=rrujetu duke qenë zgjuar
- 40-Shfaqje, keramete dhe lajme të tjera që i dha Allahu xh. sh. muxhedides Aishe rahmetullahi alejha
- 41-Muxhedidja Aishe mori njoftim prej Allahut xh. sh. për çështjen e Ehlibejtit=familjes së Pejgamberit tonë, hazreti Muhamedit. a. s.
- 42-Muxhedidja Aishe mori njoftim prej Allahut xh. sh. për njeriun që e vranë të pa fajshëm dhe ai vdiq shehid=dëshmor.
- 43-Çifuti=jehudija që kërkoi të takohet me murshiden Aishe rahmetullahi alejha.
- 44-Gjithnjë me lajmet që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha.
- 45-Muxhedidja Aishe mori njoftim prej Allahut xh. sh. për Xhuxhmeëxhuxhët. Ç'janë Xhuxh e Meëxhuxhët ?
- 46-Muxhedidja Aishe mori lajmin prej Allahut xh. sh. për kija-jametin=katakлизмën=fundin e botës.
- 47-Disa nga shenjat e kijametit që i ka paralajmëruar Pejgamberi jonë a. s.
- 48-Gjithnjë me njoftimet që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha.
- 49-Allahu xh. sh. e njofton muxhediden Aishe që të më tërheqë vërejtje mua të quajturit Haxhi Ymer Aga.
- 50-Disa këshilla mjeksore që mori nga Allahu xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha.
- 51-Gjithnjë vazhdojmë me lajmet dhe njoftimet me mënyra të ndryshme që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha.
- 52-Akuzat e njerëzve të ligë kundër murshides Aishe dhe njoftimet që merrte ajo nga Allahu xh. sh. Dënimet që Allahu xh. sh. iu dha atyre njerëzve.
- 53-Edhe dijetarët e fesë nuk përjashtohen nga e bëra gabime.
- 54-Takimi i parë i muxhedides Aishe me Jusuf Salkurtin nga Dibra.
- 55-Këshillat e muxhedides Aishe rahmetullahi alejha për emrat musliman.
- 56-Muxhedidja Aishe më dha sihariq = lajm të gëzuar mua të

- quajturit Haxhi Ymer Aga.
- 57-Firaseti=hollëkuptimi i murshides Aishe r. a.
- 58-Vazhdojmë me njoftimet që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe rahmetullahi alejha.
- 59-Muxhedidja Aishe mori njoftime prej Allahut xh. sh. për politikën dhe politikanë të ndryshëm të vendit tonë.
- 60-Ja se ç'far tha muxhedidja Aishe për Rilindasit e kombit shqiptar-rilindasit e nacionalizmit.
- 61-Njoftimet që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe: për ish kryetarin e shtetit Shqiptarë politikanin Enver Hoxha që e udhëhoqi dyzet vjet popullin me një diktaturë të fortë.
- 62-Në Shqipëri shpërtheu lufta kundër fesë. Shqipërija bëhet shteti i parë dhe i vetëm ateist në botë. Në këtë vëndë populli i shembën faltoret e Zotit xh. sh.
- 63-Turmat e popullit kërkuan që murshidja Aishe rahmetullahi alejha të gjykohet para tyre. Ata kërkuan dënime të rënda për të.
- 64-Përpjekjet e muxhedides Aishe për të bërë hixhret=shpërngulje nga vendë banimi i saj, pas ndalimit të fesë me ligjë nga shteti.
- 65-Pas vitit vitit 1967 që fillojë hapur lufta kundër fesë në Shqipëri filloi plotësishtë azabi=dënimi pikëllus për gjithë popullin Shqipëtarë.
- 66-Shembja e xhamiave dhe e kishave në Shqipëri ishte me caktimin e Zotit të madhërushëm-Allahut xh. sh. pasi ky popull nukë bani Tobe=Pendesë [nuk e korigjoi veten].
- 67-Populli Shqiptarë në përgjithësi filloi të ankohej gjithnjë e më shumë prej rregjimit komunist pas luftës kundër fesë.
- 66-Ish kryetari i shtetit Shqiptarë Enver Hoxha ka folur shkurtimishtë për historikun e fesë Islame.
- 69-Enver Hoxha nuk e besoi që murshidja Aishe ishte e dërguar prej Allahut xh. sh. me lajmin e thirrjes së popullit për Tobe.
- 70-Njoftimet e ndryshme që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe për vetitë e Enver Hoxhës dhe gruas së tij Nexhmije Hoxha.
- 71-Politika komuniste në Shqipëri ishte ndryshe nga ajo në vendet tjera komuniste.
- 72-Njoftimi që mori në atë kohë prej Allahut xh. sh. muxhedidja

- Aishe për ish ministrin e mbrojtjes së Shqipërisë Beqir Balluku.
- 73-Njoftimi që mori prej Allahut xh. sh. në atë kohë murshidja Aishe se Enver Hoxhën po mundoheshin ta rrëzonin nga fronin nga udhëheqëja e shtetit.
- 74-Njoftimi që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe për ish kryeministrin e Shqipërisë Mehmet Shehu.
- 75-Muxhedidja Aishe mori njoftim prej Allahut xh. sh. për një kryetar shteti të huaj i cili e udhëhiqte mir popullin e tij.
- 76-Njoftimi që mori prej Allahut xh. sh. në atë kohë muxhedidja Aishe për ish kryetarin e komitetit ekzekutiv të Tiranës Llambi Gegëprifti.
- 77-Njoftimet që mori muxhedidja Aishe për politikanët e rrangut të lartë të shtetit Shqipëtarë që u pushkatuan në fundin e jetës së Enver Hoxhës të cilët u cilësuan armiqtë e popullit.
- 78-Njoftimi që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe për ish sekretarin e parë të komitetit të partisë të Tiranës dhe zëvendës kryeministrin e Shqipërisë Manush Myftiu.
- 79-Njoftimi që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe se ish kryetari i shtetit Shqiptarë Enver Hoxha e besonte Zotin xh.sh = ekzistencën e Tij.
- 80-Muxhedidja Aishe mori lajmë prej Allahut xh. sh. në kohën e rregjimit komunist që të çoi një dhuratë të caktuar në Qabe dhe disa lajme të tjera që mori ajo.
- 81-Njoftimi që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe për politikën e shtetit që do të ndiqte Ramiz Alia pas vdekjes së Enver Hoxhës.
- 82-Muxhedidja Aishe mori njoftim prej Allahut xh. sh. për Enver Hoxhën pas vdekjes së tij.
- 83-Njoftimi që mori prej Allahut xh. s. në atë kohë muxhedidja Aishe për presidentin Ramiz Alia dhe opozitarin e tij politik.
- 84-Në Shqipëri u vendos sistemi politik Demokratik.
- 85-Murshidja Aishe dha mendimin e saj për Sali Berishën që ishte në atë koh President dhe më vonë Kryeministër i Shqipërisë.
- 86-Lajmërimi që mori prej Allahut xh. sh. muxhedidja Aishe për gjëndjen politike ndërkombëtare në të ardhmen.
- 87-Muxhedidja Aishe vazhdojë ta kryej detyrën e thirrjes së popullit në Tobe edhe në kohën e rregjimit politik Demokratik.
- 88-Muxhedidja Aishe dhe mendimet e disa hoxhallarëve të kohës

- së sotme në Shqipëri ndaj shërbimit të saj.
- 89-Allahu xh. sh. e njoftojë murshiden Aishe për ceremoninë e varrimit të saj.
- 90-Pak nga jeta, pamja e jashtëme, cilësitë, veprimet dhe ibadedi i muxhedides Aishe rahmetullahi alejha.
- 91-Dëshmitë e disa hoxhallarëve dhe besimtarëve që nuk e njohën nga afër muxhediden Aishe por vetëm dëgjuan për të pasi ajo kalojë nga kjo botë.
- 92-Allahu xh. sh. e njoftojë murshiden Aishe për ceremoninë e varrimit të sajë.
- 93-Përçarjet mes brezit të rinj dhe brezit të vjetër të muslima nëve.
- 94-Dalja e disa njerëzve në vëndet me popullsi muslimane si bamirësa dhe disa si mjekë fetarë.
- 95-Pa qartësia e disa të rinjëve muslimanë dhe rënja e tyre në grackën e qafirave dhe munafikëve.
- 96-Ç'far janë euvlijatë? Si janë ata dhe a ka sot në botë euvlija.
- 97-Shkallët e udhëzimit prej Allahut xh. sh. tek krijesat e Tij.
- 98-Vazhdojmë të flasim gjithnjë për evlijatë.
- 99-Mrrekullitë e peygamberëve dhe kerametet e euvlijave- miqëve të Allahut xh. sh.
- 100-Mbi besimin ndaj mrrekullive të peygamberëve dhe kerameteve të euvlijave.
- 101-Fjalët e fundit për shërbimin e muxhedides Aishe rahmetullahi alejha.
- 102-Pasthënje për librin.
- 103-Pak nga jeta ime shkruesi i këtij librit.

FUND

PËRGATITI: H. HAXHI YMER AGA.

TIRANE: 2009

Ribotim 2012.